REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI
I PRAKTIKËS GJYQËSORE
2014

Vëllimi II

Botues:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Bordi redaktues:

Prof. Dr. Enver Hasani, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese
Almiro Rodrigues, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese
Prof.Dr. Snezhana Botusharova, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese
Milot Vokshi, Sekretar i Përgjithshme e Gjykatës Kushtetues
Njësia Ligjore e Gjykatës Kushtetuese

Kontribuesit:

Z. Malte Kirchner , Menaxher i projektit, GIZ
Znj. Pranvera Ejupi- Hajzeraj, Kordinatore e projektit, GIZ
Z. Lavdim Krasniqi, Ekspert Ligjor
Premium Consulting

© 2015 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Të drejtat e autorit:

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përjashtim i përgjegjësisë:

Sipas nenit 116.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila është burim primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbizotëron versioni i botuar në Gazetën Zyrtare.

Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Përmbledhja e vendimeve dhe aktgjykimeve është përpiluar nga "Projekti për Reformë Juridike" implementuar nga Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ), dhe si i tillë, nuk zëvendëson vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe nuk përfaqësojnë formulimin e vërtetë të vendimeve/aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Published by giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2014

I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ky Buletin është mundësuar nga " Projekti për Reformë Juridike" implementuar nga Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, nën mbështetjen e Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

Tabela e përmbajtjes

Nr.1. KI05/13, Florim Gashi, Aktvendim i datës 7 maj 2014 -Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 811/2006, të 14 marsit 2007.....16

Nr.2. KI121/13, Lumturije Morina, Aktvendim i datës 25 mars 2014– Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC. nr. 1791/13, të 12 korrikut 2013 26

Nr.3. KI219/13, Avdi Abdullahu, Aktvendim i datës 25 mars 2014 -Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-09-0001, të 24 shkurtit 2011.... 35

Nr.4. KI02/14, Hamdi Ademi, Aktvendim i datës 2 prill 2014 -Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0069, të 22 prillit 2013 42

Nr.5. KI228/13, KI04/14, KI11/14, KI13/14, Lulzim Ramaj dhe Shahe Ramaj, Aktvendim i dates 24 mars 2014, Vlerësimi i kushtetutshmërisë se Njoftimit te Prokurorit te Shtetit, KMLP. I. nr. 11/13 të 5 gushtit 2013, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ZPD/11/0133, të 8 shkurtit 2011, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit P. nr. 470/13, të Gjykatës Themelore në Pejë, të 27 qershorit 2013 49

Nr.6. KI104/13, Adem Maloku, Aktvendim i datës 2 prill 2014 -Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-11-0069, të 22 prillit 2013..... 63

Nr.7. KI211/13, Demush Krasniqi, Aktvendim i datës 28 mars 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Njoftim nr. 01/118-682, të 27 tetorit 2010 72

Nr.8. KI114/13, Emsale Zoni, Aktvendim i datës 11 shkurt 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 170/2012, të 24 shtatorit 2012 78

Nr.9. KI28/14, Skender Mezini and Ferbend Haxhijaj, Aktvendim i datës 13 qershor 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 26/2012, të 16 shtatorit 2013 85

Nr.10. KI01/14, Qazim Dragusha, Aktvendim i datës 2 prill 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0035, të 23 nëntorit 2012 95

Nr.11. KI10/14, Shoqëria aksionare Raiffeisen Bank Kosovë SH. A, Aktgjykim i datës 20 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CN. nr. 7/2013, të 19 tetorit 2013.....101

Nr.12. KI 93/12, Imer Ibriqaj, Aktvendim i datës 11 mars 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 03V-115, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 4 qershorit 2009 114

Nr.13. KI163/13, Naser Dragusha dhe 6 punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës, Aktvendim i datës 8 maj 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 25/2012, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 10 majit 2013 123

Nr.14. KI193/13 and KI213/13, Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore SHKABAJ SH.P.K., Aktvendim i datës 5 maj 2014 - e cila kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 229/2012, të 10 qershorit 2013 dhe të Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 70/2013, të 12 korrikut 2013 133

Nr.15. KO103/14, Presidentja e Republikës së Kosovës, Aktgjykim i datës 30 qershor 2014 - Përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.....144

Nr.16. KI22/14, Lulzim Hoti, Aktvendim i datës 12 maj 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 237/2013, të 5 nëntorit 2013 182

Nr.17. KI 26/12, Bujar Ahmetaj, Aktvendim i datës 8 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, nr. 557/2009, të 9 shkurtit 2012..... 190

Nr.18. KI29/14, Halit Islami, Aktvendim i datës 12 maj 2014 -Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 138/2013, të 11 korrikut 2013..... 198

Nr.19. KI 33/13, Abdyl Pasjaqa, Aktvendim i datës 7 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 167/12, të 29 nëntorit 2012.....204

Nr.20. KI198/13, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendim i datës 13 mars 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. AC-II-12-0193, të 4 korrikut 2013..... 211

Nr.21. KI212/13, Svetlana Stefanović, Aktvendim i datës 12 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së kërkesës për sqarim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, KO 108/13, të 9 shtatorit 2013 222

Nr.22. KI33/14, Kamer Hajdini, Aktvendim i datës 31 mars 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 111/2013, të 24 shtatorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 21 tetor 2013, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 248/2012, të 3 shtatorit 2012, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 1327/12, të 3 prillit 2013, Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ED. nr. 201/13, te 25 qershorit 2013, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, P. nr. 568/13, të 20 gushtit 2013, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, P. nr. 16/2014, i 21 janarit 2014 229

Nr.23. KI54/14, Hamdi Ademi, Aktvendim i datës 19 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 375/2007, të 26 nëntorit 2007, dhe Aktvendimit të Këshillit të Ankesave të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, nr. 5054321, të 10 nëntorit 2005 244

Nr.24. KI225/13, Hasan Isafi dhe z. Muharrem Isafi, Aktvendim i datës 12 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 972/2013, të 18 tetorit 2013 250

Nr.25. KI99/14 dhe KI100/14, Shyqyri Syla dhe Laura Pula, Vendim për masë të përkohshme i datës 3 korrik 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e përzgjedhjes për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror te Shtetit 258

Nr.26. KI35/14, Brahim Rama, Aktvendim i datës 27 mars 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0079-A0001-A0004, të 23 janarit 2014 264

Nr.27. KI41/14, Bajram Osmani, Aktvendim i datës 19 maj 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 4984/2912 të 29 nëntorit 2013 271

Nr.28. KI46/14, Slobodan Vujičić, Aktvendim i datës 30 qershor 2014 - Kërkesë për interpretimin e nenit 57.1 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës 279

Nr.29. KI27/14, Nexhmi Bërnica, Aktvendim i datës 12 maj 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-09-0001, të 10 qershorit 2011 284

Nr.30. KI199/13, Sinan Rashica, Akvendim i datës 20 maj 2014, - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 331/2011, të 11 janarit 2013 290

Nr.31. KI227/13, Izjadin Shehu, Aktvendim i datës 30 qershor 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 93/2013, të 20 shtatorit 2013..... 297

Nr.32. KI99/14 dhe KI100/14, Shyqyri Syla and Laura Pula, Aktgjykim i datës 3 korrik 2014, Vlerësimi i kushtetuetshmërisë së Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e përzgjedhjes për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit 309

Nr.33. KI216/13, Agron Vula, Aktvendim i datës 23 janar 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 22/2011, të 3 qershorit 2013, me kërkesën për masë të përkohshme 336

Nr.34. KI53/14, N.P.T "Llabjani" Klinë, Aktvendim i datës 13 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 22/2013, të 13 nëntorit 2013 346

Nr.35. KI57/14, Besianë Gashi, Aktvendim i datës 7 korrik 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nr. 03/1586, të 20 shtatorit 2013..... 354

Nr.36. KI05/14, Bejtullah Sogojeva, Aktvendim i datës 19 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 396/2012, të 11 shtatorit 2013..... 362

Nr.37. KI43/14, Rexhep Kuqi dhe Milazim Kuqi, Aktvendim i datës 26 qershor 2014 - Vlerësimin e Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 203/2013, të 24 dhjetorit 2013 368

Nr.38. KI71/14, Asllan Bahtiri, Aktvendim i datës 26 qershor 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AA. nr. 404/2013, të 4 marsit 2014 378

Nr.39. KI184/13, 12/14,KI 16/14,KI 17/14,KI 24/14,KI 25/14, Korporata Energjetike e Kosovës, Aktvendim i datës 8 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 379/11, të 2 majit 2013, Rev. nr. 192/13, të 3 tetorit 2013, Rev. nr. 244/13, të 8 tetorit 2013, Rev. nr. 192/13, të 3 tetorit 2013, Rev. nr. 246/13, të 1 tetorit 2013, Rev. nr. 271/13, të 31 nëntorit 2013 387

Nr.40. KI30/14, Zymrije Haxhimusa, Ekrem Abazi, Ferinaze Isufi, Avdullah Hoxha dhe Hyzri Delolli, Aktvendim i datës 26 qershor 2014 – Vlerësim i kushtetutshmërisë së njoftimit të Ministrisë së Administratës Publike të Republikës së Kosovës, Nr. 4278, të 29 gushtit 2013 406

Nr.41. KI88/14, Medija Smailji, Aktvendim i datës 2 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ca. nr. 3875/2012, të 31 janarit 2014 413

Nr.42. KO119/14, Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vendim për masë të përkohshme i datës 23 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001 të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014..... 423

Nr.43. KI38/14, Gani Balaj, Aktvendim i datës 26 qershor 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, AC-II-12-0165, të 10 tetorit 2013..... 433

Nr.44. KI42/14, PTK-SHA, Prishtinë, Aktvendim i datës 19 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 238/2013, të 7 nëntorit 2013, me kërkesë për aplikimin e Masës së përkohshme. 440

Nr.45. KI45/14, Faton Sefa, Aktvendim i datës 1 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 60/2013, të 13 nëntorit 2013.....451

Nr.46. KI81/14, Avni Zogaj, Aktvendim i datës 2 korrik 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 28/2014, të 2 prillit 2014 459

Nr.47. KI90/14, Rrahim Preteni, Aktvendim i datës 2 korrik 2014 Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 1067/13, të 17 janarit 2013 466

Nr.48. KO59/14, Hilmi Hoxha, Aktvendim i datës 26 qershor 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 29.2 dhe 38.2 të Kodit të Procedurës Penale dhe të neneve 11.1 dhe 39.2 të Ligjit për gjykatat..... 476

Nr.49. KI58/14, Shefqet Hasimi, Aktvendim i datës 1 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, KA. nr. 89/2014, të 6 shkurtit 2014..... 493

Nr.50. KI66/14, Ruhan Sadiku, Zymrije Hyseni, Ramadan Palushi, Xhevat Haziri, Mehdi Dibra dhe Aziz Hashani, Aktvendim i datës 3 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 210/13, të 18 dhjetorit 2013 501

Nr.51. KI52/14, Rasić Verica, Aksić Rašić Danijela, Aksić Dosta, Arsić Dragica, Bečelić Danica, Bulatović Rade, Cvejić (Mariković) Vesna, Furunović (llić) Dušanka, Galić Svetislav, Joksimović (Drašković) Jasmina, Joksimović Malina, Jovanović Milena, Kilibarda Branislav, Kilibarda (Arsić) Zlatana, Krivokapić Staljinka, Lekić Božidar, Lekić Duško, Maksimović Živko, Marinković Svetislav, Marinković Zoran, Micić Rodoljub, Milanović Vasna, Milošević Darko, Milovanović Nebojša,

Milovanović Radovan, Milovanović Zlatija, Mitrović Bačević Dušanka, Nedeljković Stana, Novaković Dragoljub, Novaković Nikola, Novaković Zdenka, Ognjenović Miloslavka, Pavić Biserka, Stamenković-Janković Jasmina, Stojanović Desanka, Stojković (Nikolić) Vidosava, Trajković Zoran, Vasić Siniša dhe Kovačević Marija, Aktvendim i datës 3 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-12-0012, të 24 tetorit 2013 ..... **Error! Bookmark not defined.**

Nr.52. KI39/14, Bujar Spahiu, Aktvendim i datës 3 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 215/2013, të 9 dhjetorit 2013 523

Nr.53. KI03/14, Afrim Terpeza, Aktvendim i datës 2 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 214/2013, të 12 dhjetorit 2013 536

Nr.54. KI117/12/A, KI119/12/A, KI121/12/A, KI138/12, Fatmire Berisha, Musa Pllana dhe Ismije Pllana, Vesel Bardhi, Ramë Berisha dhe Dragica Stanojević, Aktvendim i datës 11 shkurt 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 130/12, të 17 shtatorit 2012, Ac. nr. 1070/2012, të 2 majit 2013, Ac. nr. 138/12, të 9 korrikut 2012, Ac. nr. 1068/2012, të 2 majit 2013. 547

Nr.55. KI208/13, Rexhep Kabashi, Aktvendim i datës 8 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ACI-13-0094-A0001, të 30 tetorit 2013 553

Nr.56. KI68/14, Fahri Rexhepi, Aktvendim i datës 3 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit ASC-II-0035, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 23 nëntorit 2012 561

Nr.57. KI62/14, Rexhep Haziri, Vendim i datës 3 korrik 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së listës përfundimtare Fi-64/90 të punëtorëve të kualifikuar për kompensim nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku" nga Prishtina, të publikuar nga Agjencia e Privatizimit të Kosovës, më 27 mars 2009 567

Nr.58. KO119/14, Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i datës 21 gusht 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001 të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014. 574

Nr.59. KI75/14, Tefik Dedinca, Vendim i datës 1 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së një vendimi të paspecifikuar të një autoriteti të paspecifikuar publik 636

Nr.60. KI47/14, Mustaf Zejnullahu, Aktvendim i datës 26 qershor 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 89/2013, të 8 tetorit 2013 642

Nr.61. KI40/14, Valon Haskaj, Aktvendim i datës 26 qershor 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, KZZ. nr. 187/2013, të 8 nëntorit 2013 651

Nr.62. KI95/14, N.P.P. Adriatik Commerce, Aktvendim i datës 3 korrik 2014 - vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 30/2013, të 9 dhjetorit 2013 660

Nr.63. KI67/14, Muharrem Sopa, Aktvendim i datës 1 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 59/2013, të 23 tetorit 2013 671

Nr.64. KI06/14, Olga Petrović, Svetolik Patrnogić, Vesna Dejanović dhe Miroslava Ivanović, Aktvendim i datës 4 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Pc. Nr. 559/10 të 18 shtatorit 2013 679

Nr.65. KI31/14, Luan Ramadani, Aktvendim i datës 3 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. Nr. 222/2013, të 24 dhjetorit 2013 690

Nr.66. KI54/12, Mustafë Xhekaj, Aktvendim i datës 11 mars 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Ap. nr. 376/2009, të 23 shkurtit 2011 697

Nr.67. KI65/14, Bajram Santuri, Aktvendim i datës 1 korrik 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 791/13, të 23 shtatorit 2013; i Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, P. nr. 43/10, të 31 tetorit 2012; i Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012; i Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 247/08, të 15 shkurtit 2010; i Njoftimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ZDP/12/ZP/910, të 29 nëntorit 2012; dhe i Njoftimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të 21 janarit 2011 702

Nr.68. KI56/14, Beqir Zhushi, Aktvendim i datës 26 qershor 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-11-0069, të 22 prillit 2013 712

Nr.69. KI220/13, Hysen Çeku, Aktvendim i datës 7 shkurt 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Ac. nr. 4952/2012, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 27 majit 2013 718

Nr.70. KI51/13, Shemsi Haliti, Aktvendim i datës 11 mars 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 113/2010, të 19 dhjetorit 2012 726

Nr.71. KI92/14, Fidaie Bytyqi, Aktvendim i datës 2 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. E. nr. 1/2014, të 12 shkurtit 2014 735

Nr.72. KI84/14, Arlind Kaçaniku, Aktvendim i datës 16 shtator 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 18/2014, të 3 shkurtit 2014 745

Nr.73. KI73/14, Xhafer Dvorani, Aktvendim i datës 16 shtator 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Ac. nr. 2770/2013 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 17 marsit 2014..... 753

Nr.74. KI104/14, Agron Çerreti, Aktvendim i datës 17 shtator 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të paspecifikuara të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës së Apelit dhe i Aktgjykimit P. nr. 88/2012 të Gjykatës Komunale në Gjilan 759

Nr.75. KI229/13, Pashk Thaqi, Mark Thaqi dhe Linda Thaqi, Aktvendim i datës 23 shtator 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 147/2013, të 03 korrikut 2013.....767

Nr.76. KI78/14, Mentor Paçak, Aktvendim i datës 16 shtator 2014 - Vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit PN. nr. 637/2013 të Gjykatës së Apelit, të 16 tetorit 2013 775

Nr.77. KI106/14, Kompania „Adler Com sh.p.k.“, Aktvendim i datës 18 shtator 2014 –Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 47/2013, të 17 majit 2014 780

Nr.78. KI83/14, Sahit Rakaj, Aktvendim i datës 23 shtator 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 188/2013, të 7 nëntorit 2013.....788

Nr.79. KI124/14, Zineta Nikočević, Vendim i datës 18 shtator 2014 - e cila kërkoi përshpejtimin e procedurës në Gjykatën Themelore 796

Nr.80. KI76/14, Jakup Berisha, Aktvendim i datës 23 shtator 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 292/2013, të 9 dhjetorit 2013.....802

Nr.81. KI 74/14, Radomir Filipović, Aktvendim i datës 15 shtator 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 86/2011, të 23 janarit 2013.....809

Nr.82. KI 217/13, "H. P. G" SH. P. K., Aktvendim i datës 23 shtator 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. AC-I-13-0169, të 10 tetorit 2013 824

Nr.83. KI108/14, Sevdije Sllovinja, Aktvendim i datës 17 shtator 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 107/2014, të 22 prillit 2014 833

Nr.84. KO155/14, Avokati i Popullit të Republikës së Kosovës, Aktvendim i datës 13 nëntor 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Dekretit së Presidentes së Republikës së Kosovës, për konfirmimin e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. DKGJK-001-2014,të 31 gushtit 2014..... 840

Nr.85. KI125/14, Universiteti për Biznes dhe Teknologji, Aktvendim i datës 23 shtator 2014, – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 9/2014, të 6 marsit 2014 853

Nr.86. KI113/14, Albion Sherifi, Aktvendim i datës 21 tetor 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë se Urdhëresës së Kryetarit të Komunës së Ferizajt, të 30 prillit 2014..... 862

Nr.87. KI107/14, Xufe Rracaj, Aktvendim i datës 23 shtator 2014- Njoftim i Prokurorit të Shtetit, KMLC Nr. 01/2011, i 13 dhjetorit 2013 869

Nr.88. KI101/14, Shkodran Pllana, Aktvendim i datës 17 shtator 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 41/2014, të 7 marsit 2014 876

Nr.89. KI86/14, Advije Nimani, Aktvendim i datës 17 shtator 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 32/2014, të 13 marsit 2014 884

Nr.90. KI63/14, Misin Rifati, Aktvendim i datës 23 shtator 2014- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 71/2002, të 17 dhjetorit 2002..... 892

Nr.91. KI20/14, Musa Gjetaj, Aktvendim i datës 15 shtator 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, CA. nr. 2976/2013, të 5 dhjetorit 2013..... 898

Nr.92. KI110/14, Sokol Stavileci, Aktvendim i datës 17 shtator 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit Nr. 254 të Bankës Qendrore të Kosovës, të 14 prillit 2014 908

Nr.93. KI50/14, Shemsi Bekteshi, Aktvendim i datës 16 shtator 2014 - Vlersimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr.277/2013, të dates 06.dhjetor.2013..... 914

Nr.94. KI117/14, Kurtesh Halimi, Aktvendim i datës 5 nëntor 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 543/2013, të 16 majit 2014. 923

Nr.95. KI 19/14 & KI 21/14, Tafil Qorri dhe Mehdi Syla, Aktvendim i datës 16 shtator 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013 930

Nr.96. KI09/14, Skender Çoçaj, Aktvendim i datës 16 shtator 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. 399/2012, të 22 gushtit 2013 938

Nr.97. KI115/14, Azem Ademi, Vendim i datës 17 shtator 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së një vendimi të paidentifikuar të një autoriteti publik të paidentifikuar 946

Nr.98. KI167/14, Zelqif Berisha, Vendim për masë të përkohshme i datës 8 dhjetor 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës se Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0045-Ao001, të 26 qershorit 2014 951

Nr.99. KI94/14, Sadat Ademi, Aktvendim i datës 5 nëntor 2014 - Mospërmbarimi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Kosovë, PA1 nr. 966/2013, të 27 nëntorit 2013 959

Nr.100. KI36/14, Bojan Đokić, Ljubica Đokić, Zvonko Đokić dhe Đorđe Đokić, Aktvendim i datës 7 nëntor 2014 - Ankesë për mungesë të hetimeve të një vrasjeje dhe të kompensimit për shkatërrimin e pronës. 965

Nr.101. KI85/14, Gafurr Osmani, Aktvendim i datës 16 shtator 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 269/2013, të 9 dhjetorit 2013. 974

KI05/13, Florim Gashi, Aktvendim i datës 7 maj 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 811/2006, të 14 marsit 2007

Rasti KI 05/13, vendimi i 7 majit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, përmbarimi i aktgjykimeve, konflikt administrativ, e papranueshme, mosshterimi i mjeteve juridike

Parashtruesi i kërkesës konteston moszbatimin e Aktgjykimit te Gjykatës Supreme të Kosovës, të 14 marsit 2007, me të cilin Gjykata Supreme, në procedurën administrative, e refuzoi ankesën e Komunës së Klinës dhe e obligoi Komunën e Klinës të nxjerrë një vendim të ri lidhur me parashtruesin e kërkesës.

Procedura administrative ka të bëjë me aktvendimin e organeve komunale te Klinës për rrënimin e objektit, të shfrytëzuar nga parashtruesi i kërkesës për qëllime afariste.

Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që ta detyrojë Komunën e Klinës që ta zbatojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

Pas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Komuna e Klinës nuk nxori vendim të ri në lidhje me parashtruesin e kërkesës. Në bazë të dispozitave të Ligjit për Konflikt Administrativ, Komuna e Klinës ka qenë e obliguar që të nxjerrë këtë vendim brenda tridhjetë (30) ditësh. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Konflikt Administrativ konstatoi se parashtruesi i kërkesës, pas skadimit të afatit prej tridhjetë (30) ditësh duhet të kishte proceduar më tej me konfliktin administrativ dhe në këtë mënyrë të kishte shterur mjetet juridike të parapara me ligj.

Gjykata Kushtetuese konsideroi duke mos proceduar me inicimin e konfliktit administrativ, pra duke mos ushtruar ankesë në organin e shkallës së dytë brenda afatit të paraparë, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës që rasti i tij shpallet i papranueshëm, pasi që kjo do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për procedura të mëtejme për te kundërshtuar shkeljen e të drejtave kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI05/13
Parashtrues
Florim Gashi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 811/2006, të 14 marsit 2007

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Florim Gashi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Klinë, i cili përfaqësohet nga z. Skënder Gashi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston moszbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 811/2006, të 14 marsit 2007, nga Komuna e Klinës, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës në një datë të paspecifikuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit A. nr. 811/2006, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 14 marsit 2007, me të cilin Gjykata Supreme, në procedurën administrative, e refuzoi ankesën e Komunës së Klinës. Procedura administrative ka të bëjë me aktvendimin e organeve komunale të Klinës për rrënimin e objektit, të përdorur nga parashtruesi i kërkesës për qëllime afariste.

4. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) *"[...] që ta detyrojë Komunën e Klinës për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme"*.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 16 janar 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 30 janar 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI05/13, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI05/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova (anëtare) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).

8. Më 28 shkurt 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Gjykatës Supreme kopjen e kërkesës.

9. Më 7 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 14 mars 2005, në bazë të planit të ndryshuar urbanistik, Bordi i Drejtorëve i Komunës së Klinës nxori vendimin 1/3 NR. 353-247/2005, duke i revokuar të gjitha lejet ekzistuese për ndërtimin e objekteve të përkohshme në komunë. Bordi i Drejtorëve e justifikoi këtë vendim në bazë të pretendimit që të gjitha ndërtimet e përkohshme ekzistuese ishin ndërtuar në pronën që ishte në pronësi të Komunës, pronë kjo që Komunës i nevojitej për qëllime publike.

11. Ky vendim i Bordit të Drejtorëve, i 14 marsit 2005, kishte prekur edhe parashtruesin e kërkesës, i cili ishte duke e përdorur objektin për aktivitetet e tij afariste.

12. Rrjedhimisht, më 17 gusht 2005, Drejtoria për Urbanizëm dhe Shërbime Publike e Komunës së Klinës lëshoi Urdhrin nr. 07 nr. 354-122/2005 (në tekstin e mëtejmë: Urdhri i Drejtorisë), duke e detyruar parashtruesin e kërkesës që ta rrënojë objektin.

13. Parashtruesit të kërkesës iu dhanë 15 ditë kohë për ta rrënuar objektin, ose Drejtoria do të vazhdonte me përmbarimin e dhunshëm të urdhrit të saj.

14. Pas kësaj, më 2 shtator 2005, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë te Kryeshefi ekzekutiv i Komunës së Klinës kundër urdhrit të Komunës së Klinës.

15. Më 15 shtator 2005, Kryeshefi ekzekutiv i Klinës, me Aktvendimin 07 Nr. 354-122/2005 (në tekstin e mëtejmë: aktvendimi i Kryeshefit ekzekutiv), hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi urdhrin e Drejtorisë.

16. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, më 14 tetor 2005, Drejtoria vazhdoi rrënimin e objektit.

17. Më 31 tetor 2005, kundër aktvendimit të kryeshefit ekzekutiv, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejmë: MMPH).

18. Më 20 mars 2006, MMPH, me Vendimin e saj, A-106/05, e aprovoi ankesën e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, me të cilin anuloi aktvendimin e Kryeshefit ekzekutiv dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim.

19. MMPH-ja arsyetoi se Kryeshefi ekzekutiv në Klinë në aktvendimin e tij nuk e kishte konstatuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe nuk ua kishte kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave përkatëse ligjore për procedurë administrative, për shkak të të cilave u nxorën vendimet e padrejta. Rrjedhimisht, MMPH-ja vendosi:

> "*Sipas nenit 242, al. 2 të Ligjit mi Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor [...] që lëndën ta kthejë në rishqyrtim. Organi i shkallës së parë është i detyruar të veprojë sipas vendimit të*

shkallës së dytë, jo më vonë se brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij Vendimi dhe të nxjerrë Aktvendim të ri, duke i administruar provat e lartshënuara".

20. Komuna e Klinës paraqiti ankesë kundër vendimit të MMPH-së në Gjykatën Supreme. Në ankesën e saj, Komuna e Klinës pretendoi se aktvendimi i MMPH-së nuk ishte në pajtim me ligjin dhe se ligji ishte zbatuar në dëm të Komunës së Klinës.

21. Më 14 mars 2007, Gjykata Supreme e refuzoi ankesën e Komunës së Klinës.

22. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme konstatoi se:

"Me vendimin e kontestuar është aprovuar ankesa e Florim Gashi nga KIina dhe është anuluar aktvendimi i Kryeshefit ekzekutiv të Komunës së KIinës 07. nr. 354-122/2005 datë 15.09.2005 dhe lënda është kthyer në rishqyrtim.

[...]

"Gjykata konkludon se në këtë çështje juridike-administrative ekzistojnë kundërthënie të cilat nuk u evituan gjatë vendosjes nga ana e organit të shkallës së parë sepse nuk u morën parasysh provat në shkresat e lëndës dhe nuk u dhanë arsye për fakte vendimtare, të rëndësishme për vendosjen e drejtë të kësaj çështje juridike e konkretisht vërtetimi i faktit se a ekziston dhe a është aprovuar plani urbanistik për qytetin e Klinës, se është marrë vendimi nga Komuna e Klinës për revokimin e lejeve të përkohshme, se në rastin konkret a kemi të bëjmë me mënjanimit e objektit të përkohshëm apo rrënimin e dhunshëm të objektit i cili paraqitet në fazën e ekzekutimit të dhunshëm, çka nuk duhet të jetë situata në rastin konkret por edhe për faktin se nuk është konstatuar se ka kaluar apo jo afati i lejes sipas të cilës është bërë vendosja e objektit të përkohshëm

[...] Për këto arsye e me qëllim të evitimit të lëshimeve të theksuara në aktvendimin e kundërshtuar, organi administrativ i paditur anuloi vendimin e kundërshtuar duke dhënë udhëzime që në riprocedurë të evitohen të metat e me qëllim të marrjes së vendimit të drejtë dhe të ligjshëm".

23. Pas aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Komuna e Klinës nuk ndërmori asnjë veprim në lidhje me parashtruesin e kërkesës.

24. Në bazë të parashtresave, parashtruesi i kërkesës iu drejtua MMPH-së (letra e 17 prillit 2008) dhe Kuvendit Komunal të Klinës (letra e 21 prillit 2009) në lidhje me përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

25. Më 23 janar 2013, Komuna e Klinës kishte parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe anulimin e Aktgjykimit të lartpërmendur, A. nr. 811/2006, të Gjykatës Supreme dhe të 15 aktgjykimeve të tjera të Gjykatës Supreme. Komuna e Klinës më tej kërkoi anulimin e aktvendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor në të 16 rastet. Komuna e Klinës kishte paraqitur kërkesën e saj në bazë të nenit 113, paragrafi 4, të Kushtetutës (shih Rastin KO08/13, Gjykata Kushtetuese, Vendimi për papranueshmëri, i 29 nëntorit 2013).

26. Më 14 nëntor 2013, Gjykata, pas shqyrtimit, njëzëri vendosi ta deklarojë kërkesën të papranueshme, sepse Komuna e Klinës nuk ishte palë e autorizuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës argumenton se *"[...] me këto vendime arbitrare, Komuna e Klinës ka bërë shkelje të rënda të dispozitave kushtetuese, duke ia pamundësuar* [parashtruesit të kërkesës] *sigurimin e mjeteve më elementare për ekzistencën e tij dhe familjes së tij 6 antarshe. Duke vepruar kështu Komuna e Klinës ka bërë shkelje të dispozitave kushtetuese mbi të drejtat dhe lirit e njeriut sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. "*

28. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se ai i ishte drejtuar Komunës së Klinës me gojë dhe me shkrim për përmbarimin e aktgjykimit.

29. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës si në vijim:

> "*Është relevante të theksohet se të gjitha procedurat e rregullta ligjore janë ndjekur në mënyrë të përpikt nga i dëmtuari* [parashtruesi i kërkesës] *deri te Gjykata Supreme e Kosovës, dhe pasi janë shterrur të gjitha mjetet juridike, jemi të detyruar që ti drejtohemi Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës që ta vlerëson ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e*

aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 811/2006 të 14.03.2007."

30. Parashtruesi i kërkesës përfundon, duke kërkuar nga Gjykata:

"Përmes kërkesës tonë, kërkojmë prej Gjykatës Kushtetuese që ta detyroi Komunën e Klinës në zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke u mbështetur në nenin 116.1 sipas të cilit thuhet, se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Si dhe nenit 124.6 të obligohet Komuna që ta zbatoi Aktgjykimin e Republikës së Kosovës A. nr. 811/2006, si dhe Vendimin e Ministrisë së Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor Prishtinë Nr. A-106/2005 data 20.03/2006 i cili ka marrë formën e prerë në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës. [...]"

Pranueshmëria e kërkesës

31. Së pari, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

33. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

34. Siç u tha më lart, parashtruesi, në kërkesën e tij, konteston mospërmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 811/2006, të 14 marsit 2007, nga Komuna e Klinës dhe kërkon nga Gjykata *"[...] që ta detyrojë Komunën e Klinës në zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme"* .

35. Gjykata vëren se Gjykata Supreme, në procedurën administrative, refuzoi si të pabazuar ankesën e Komunës së Klinës, të paraqitur kundër vendimit të MMPH-së. Sipas vendimit të MMPH-së, MMPH-ja kishte vendosur ta kthente rastin për rishqyrtim dhe kishte detyruar organin e shkallës së parë, përkatësisht Komunën e Klinës, që brenda 30 ditësh nga marrja e vendimit, të nxjerr vendim të ri bazuar në rekomandimin e MMPH-së. Për këtë arsye, pas aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Komuna e Klinës ka qenë e obliguar të marrë një vendim të ri në lidhje me parashtruesin e kërkesës. Deri më tani, Komuna e Klinës nuk ka nxjerrë një vendim të tillë.

36. Duke pasur parasysh se procedura e ndjekur ka qenë procedurë administrative, Gjykata e konsideron të rëndësishme dhe të nevojshme t'i referohet dispozitave të Ligjit për konfliktet administrative.

37. Neni 29 i Ligjit për konfliktet administrative, Nr. 03/L-202, përcakton:

> *1. Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejmë prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t'i është refuzuar ankesa.*
>
> *2. Në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni mund të veprojë pala edhe kur sipas kërkesës së saj nuk është nxjerrë vendimi nga organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit nuk mund të bëhet ankesa.*
>
> *3. Nëse organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit mund të bëhet ankesa, nuk ka nxjerrë asnjë vendim në bazë të kërkesës brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh ose në një afat më të shkurtër të paraparë me dispozita të veçanta, pala ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë organit të shkallës së dytë. Kundër vendimit të organit të shkallës së dytë, pala mund të fillojë konfliktin administrativ, por mundet, nën kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, ta fillojë edhe nëse ky organ nuk ka nxjerrë vendim.*

38. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i është drejtuar MMPH-së (letra e 17 prillit 2008) dhe Kuvendit Komunal

të Klinës (letra e 21 prillit 2009), vetëm duke kërkuar zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

39. Bazuar në si më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, pas skadimit të afatit të parashikuar me dispozitën e lartpërmendur të Ligjit për konfliktet administrative, duhej të kishte proceduar më tej me konfliktin administrativ dhe, në këtë mënyrë, do t'i shteronte mjetet juridike të parapara me ligj.

40. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi i kërkesës është i obliguar të shterojë të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, siç parashihet me nenin 113, paragrafi 7, dhe me dispozitat e tjera ligjore, siç u përmend më lart. Prandaj, parashtruesi i kërkesës duhet të kishte paraqitur ankesë në organin e shkallës së dytë, pasi organi i shkallës së parë, Komuna e Klinës, nuk kishte arritur të merrte një vendim brenda afatit të paraparë.

41. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi përkitazi me kërkesën për shterim të mjeteve juridike është që t'u ofrohet mundësia autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive ligjore kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (Shih rastin *Selmouni kundër Francës*, GJEDNJ, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999*;* dhe rastin KI06/10, parashtrues i kërkesës *Valon Bislimi*, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykimi i 30 tetorit 2010).

42. Pra, në të vërtetë, duke mos proceduar me inicimin e konfliktit administrativ, pra duke mos ushtruar ankesë në organin e shkallës së dytë brenda afatit të paraparë, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës që rasti tij shpallet i papranueshëm, pasi që kjo do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për procedura të mëtejme për të kundërshtuar shkeljen e të drejtave kushtetuese (Shih rastin KI16/12, parashtrues *Gazmend Tahiraj*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri i 22 majit 2012).

43. Si përmbledhje, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 47, paragrafi 2, të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, më 7 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI121/13, Lumturije Morina, Aktvendim i datës 25 mars 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC. nr. 1791/13, të 12 korrikut 2013

Rasti KI121/13, vendimi i 25 marsit 2014.

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, procedura përmbarimore, Udhëzimi Administrativ, qartazi i pabazuar

Parashtruesja e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me të cilën konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC. nr. 1791/13, të 12 korrikut 2013, i cili sipas pretendimit të parashtrueses së kërkesës i ishte dorëzuar më 1 gusht 2013 dhe Udhëzimin Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore.

Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1791/13, të 12 korrikut 2013, i cili në procedurën përmbarimore ndaj parashtrueses së kërkesës në cilësinë e debitorit e refuzon ankesën e saj si të pabazuar dhe e vërteton Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, E. nr. 934/12, të 8 marsit 2013. Parashtruesja e kërkesës kërkon edhe vlerësimin e kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 2008/ 02 për unifikimin e taksave gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Parashtruesja e kërkesës konsideron se i janë shkelur të drejtat e saj kushtetuese nga neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe i Instrumenteve Ndërkombëtare], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe konkretisht të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe të protokolleve të saj, posaçërisht të Protokollit 1, nenit 1.

Për sa i përket kërkesës së parashtrueses që Gjykata të anulojë Udhëzimin Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Gjykata thekson vetëm palët e autorizuara sipas nenit 113.2 i Kushtetutës kanë të drejtë të ngrenë çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Prandaj, parashtruesja e kërkesës nuk është palë e autorizuar sipas nenit 113.2 të Kushtetutës (shih Rastin KI34/11, parashtrues *Sami Bunjaku*, Aktvendim për papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese, i 8 dhjetorit 2011.)

Duke shqyrtuar kërkesën e parashtrueses lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC. nr. 1791/13, të 12 korrikut 2013, Gjykata Kushtetuese konsideron që faktet e paraqitura nga parashtruesja nuk kanë arsyetuar në asnjë mënyrë pretendimin e shkeljes së të drejtave kushtetuese dhe parashtruesja nuk i ka mbështetur sa duhet pretendimet e saj. Prandaj Gjykata konkludoi se faktet e paraqitura nga parashtruesja nuk kanë arsyetuar në asnjë mënyrë pretendimin e shkeljes së të drejtave të saj kushtetuese, prandaj kërkesa është qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI121/13
Parashtrues
Lumturije Morina
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1791/13, të 12 korrikut 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Lumturije Morina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson z. Teki Bokshi, avokat nga komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë: përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1791/13, i 12 korrikut 2013, të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon se e ka pranuar më 1 gusht 2013 si dhe Udhëzimi Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1791/13, të 12 korrikut 2013, i cili në procedurën përmbarimore ndaj parashtrueses së kërkesës në cilësinë e debitorit e refuzon ankesën e saj si të pabazuar dhe e vërteton Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, E. nr. 934/12, të 8 marsit 2013. Parashtruesja e kërkesës kërkon edhe vlerësimin e

kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 gusht 2013, parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 30 gusht 2013, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI121/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI121/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

7. Më 18 shtator 2013, Gjykata informoi përfaqësuesin e parashtrueses së kërkesës për regjistrim të kërkesës dhe kërkoi nga ai që të nënshkruajë formularin zyrtar të kërkesës, pasi që formulari i dorëzuar më 7 gusht 2013 nuk ishte i nënshkruar nga ai.

8. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës nuk i është përgjigjur kërkesës së Gjykatës.

9. Më 21 shkurt 2014, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës që të dorëzonte në Gjykatë të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me kërkesën e parashtrueses së kërkesës.

10. Më 4 mars 2014, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e Gjykatës të nënshkruar nga ai.

11. Më 25 mars 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në bazë të dokumentacionit jo të plotë, të cilin e ka dorëzuar parashtruesja e kërkesës në Gjykatë, dhe i cili është i lidhur vetëm me procesin përmbarimor, Gjykata ka arritur deri te këto fakte.

13. Parashtruesja e kërkesës ka parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë ndaj Aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit, E nr. 934/12, të 1 marsit 2013, ku parashtruesja paraqitet në cilësinë e debitorit.

14. Më 8 maj 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë, duke vendosur në bazë të ankesës së parashtrueses së kërkesës ndaj Aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit, E nr. 934/12, të 1 marsit 2013, refuzon ankesën si të pabazuar dhe konsideron se parashtruesja ankesën e ushtruar kundër Aktvendimit E nr. 934/12, të 1 marsit 2013 (Aktvendimi E nr. 934/12, të 1 marsit 2013 nuk gjendet në shkresat e lëndës) , e ka tërhequr në tërësi. Gjykata më tej thekson:

> *"Debitorja nuk i ka bashkëngjitur ankesës, dëshminë mbi pagesën e taksës. ... meqenëse debitorja brenda afatit nga konkluzioni i dt 22.03.2013 nuk e ka paguar taksën gjyqësore, në kuptim të nenit 19 të LPK-së, dhe nenit 102 të LPK-së, u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi*".

15. Më 12 korrik 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vepruar në bazë të ankesës së parashtrueses së kërkesës, nxori Aktvendimin Ac. nr. 1791/13, duke refuzuar si të pabazuar ankesën. Gjykata, më tej në arsyetimin e saj, shton:

> *"[...] kjo gjykatë konsideron se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitores, sepse duke u bazuar në dispozitën e nenit 2.2 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.... ndërsa me dispozitën nenit 6.5 të udhëzimit të sipërpërmendur parashihet se nëse ata (taksat) nuk paguhen deri në datën përfundimtare, gjykata do ta hudhë poshtë parashtresën për të cilën nuk janë paguar taksat, e që në rastin konkret ajo është taksë gjyqësore për ankesë nga neni 10.11 i këtij Udhëzimi".*
>
> *[...]*

"Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë as shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesja pretendon që me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1791/13, të 12 korrikut 2013, i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, si në vijim:

    Neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe i Instrumenteve Ndërkombëtare], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe konkretisht të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe të protokolleve të saj, posaçërisht të Protokollit 1, nenit 1.

17. Parashtruesja, më tej, thekson:

    "Taksat gjyqësore dhe detyrimet fiskale mund të përcaktohen ekskluzivisht me ligj... e assesi me Udhëzimin Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ".

18. Parashtruesja përfundon duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që:

    - *"të anuloj Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjykatë E nr. 934/12 të datës 08.05.2013*
    - *Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 1791/13 të datë 12.07.2013, dhe*
    - *të anuloj Udhëzimin Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës".*

Pranueshmëria e kërkesës

19. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara

me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

Pretendimi përkitazi me kërkesën për anulimin e Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

20. Lidhur me kërkesën e parashtrueses për anulimin e Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafëve 1, 2 dhe 7 të Kushtetutës, i cili përcakton që:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet si në vijim:*
>
> *(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën*
>
> *(2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën"*
>
> [...]
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

21. Për sa i përket kërkesës së parashtrueses që Gjykata të anulojë Udhëzimin Administrativ nr. 2008/2 për unifikimin e taksave gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Gjykata thekson se vetëm palët e autorizuara sipas nenit 113.2 të Kushtetutës, kanë të drejtë të parashtrojnë pyetjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Prandaj, parashtruesja e kërkesës nuk është palë e autorizuar sipas nenit 113.2 të Kushtetutës (shih Rastin KI34/11, parashtrues Sami Bunjaku, Aktvendim për papranueshmëri i Gjykatës Kushtetese, i 8 dhjetorit 2011.

Pretendimi përkitazi me vendimet e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe Gjykatës së Apelit të Kosovës

22. Në lidhje me pretendimet e parashtrueses që Gjykata Themelore në Gjakovë dhe Gjykata e Apelit e Kosovës përmes aktvendimeve të tyre kanë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë, parashtruesja duhet të vërtetojë që ka përmbushur kërkesat e parapara me nenet 113.7 të Kushtetutës, si dhe nenin 47. 2 dhe 49 të Ligjit. Mund të shihet nga shkresat e rastit që parashtruesja ka paraqitur fakte që i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjeve në fuqi dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit katër (4) mujor, siç përcaktohet me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

> *"(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...], ose*
>
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*
>
> *[...], ose*
>
> *(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij;"*

24. Parashtruesja nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që do të vërtetonte shkeljen e të drejtave të tyre sipas Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, Vanek kundër Republikës Sllovake, nr. 53363/99, Aktgjykimi i 31 majit 2005). Parashtruesja nuk argumenton si në çfarë mënyre i janë shkelur neni 22, neni 31 dhe neni 54 i Kushtetutës dhe Protokolli 1, neni 1.

25. Parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se në çfarë mënyre mospagesa e taksës gjyqësore ka sjellë deri në shkeljen e të drejtave të saja kushtetuese.

26. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si Gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i këtyre të fundit që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis,* Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96,

GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 shkurtit 2011).

27. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të trajtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesja të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, Komisioni Evropian për të Drejta të Njeriut, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. nr. 13071/87, 10 korrik 1991).

28. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata është e bindur që faktet e dorëzuara nga parashtruesja nuk kanë arsyetuar në asnjë mënyrë pretendimin e shkeljes së të drejtave kushtetuese dhe parashtruesja nuk i ka mbështetur sa duhet pretendimet e saj.

29. Gjykata gjeti se kërkesa nuk i përmbush kriteret për pranueshmëri, të kërkuara me nenin 113.1 të Kushtetutës dhe me rregullin 36 (2), b) dhe d) dhe 36 (3), c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 36 (2) b) e d) dhe 36 (3) c) të Rregullores së punës, më 25 mars 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. Dr. Enver Hasani

KI219/13, Avdi Abdullahu, Aktvendim i datës 25 mars 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-09-0001, të 24 shkurtit 2011

Rasti KI219/13, vendimi i 25 marsit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesa individuale, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Më 3 dhjetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke kërkuar nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Parashtruesi në kërkesë pretendon se Gjykata Supreme e Kosovës ka bërë shkelje procedurale të dispozitave ligjore dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike, si dhe ka bërë shkeljen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht neneve 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Me Vendimin e Kryetarit nr. GJR. KI219/13, të 8 janarit 2014, gjyqtari Altay Suroy është caktuar si gjyqtar raportues, dhe të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit nr. KSH. KI219/13, është caktuar edhe Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

Bazuar në të dhënat nga shkresat e lëndës, Gjykata gjen se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij më 3 dhjetor 2013. Sipas shkresave në dispozicion, Gjykata përcaktoi se Aktvendimi i fundit, SCEL-09-0001 i Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme, i është dorëzuar parashtruesit më 19 mars 2011, prandaj, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së parashtruar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në seancën e 25 marsit 2014, vendosi që kërkesën ta deklarojë të papranueshme sepse është dorëzuar jashtë afatit kohor të paraparë me ligj.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI219/13
Parashtrues
Avdi Abdullahu
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-09-0001, të 24 shkurtit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Avdi Abdullahu nga fshati Gllamnik, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktvendimin SCEL-09-0001, të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme), të 24 shkurtit 2011, i cili iu dorëzua parashtruesit më 19 mars 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit, i cili pretendohet ta ketë penguar parashtruesin e kërkesës që të realizojë të drejtën e tij në 20% të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes “Ramiz Sadiku” (në tekstin e mëtejmë: NSH “Ramiz Sadiku“) në Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës nuk specifikon se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113. 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 3 dhjetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 8 janar 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI219/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI219/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 27 janar 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 25 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi pretendon se ai ishte punonjës i NSH “Ramiz Sadiku“ për 8 (tetë) vjet.

10. Më 27 qershor 2006, NSH „Ramiz Sadiku“ e kishte përfunduar procesin e privatizimit.

11. Më 5 mars 2010, parashtruesi, i pakënaqur me vendimin e Agjencisë së Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Agjencia), e cila nuk e kishte përfshirë në listën e punëtorëve me të drejtë në një pjesë të 20% nga privatizimi, ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

12. Në ankesën drejtuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, parashtruesi theksoi se ai ishte punëtor i NSH "Ramiz Sadiku", dhe se ai kishte punuar deri në vitin 1992, kur ai është dëbuar me

dhunë nga puna. Parashtruesi i bashkëngjiti ankesës së Dhomës së Posaçme një kopje të vendimit, si provë e statusit të tij të punësimit në NSH "Ramiz Sadiku", si dhe një kopje të librezës së punës.

13. Agjencia, përmes një letre dërguar Dhomës së Posaçme, iu përgjigj ankesës së parashtruesit, duke pretenduar se parashtruesi nuk i plotëson kushtet, pasi që ai nuk ka parashtruar ankesë brenda afatit ligjor, i cili kishte skaduar më 27 mars 2009, kundër listës përfundimtare të punëtorëve, të hartuar nga Agjencia.

14. Më 24 shkurt 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme nxori Aktvendimin SCEL-09-0001, me të cilin e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme. Në arsyetimin e vendimit të tij, Trupi gjykues deklaroi: *„Duke e marrë parasysh se ankesa është ushtruar tre muaj nga dita e skadimit të afatit për parashtrimin e ankesës (afati kohor për parashtrimin e ankesës ka skaduar më 27 mars 2009), në bazë të arsyeve të përmendura më lart nuk ka mundësi të miratohet kthimi në gjendjen e mëparshme dhe të konsiderohet ankesa si e afatshme; prandaj, ankesa hedhet poshtë si e papranueshme".*

15. Në përfundimin e Aktvendimit SCEL-09-0001, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme deklaron*: „Në bazë të nenit 9,5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 ankesa kundër këtij aktvendimi parashtrohet me shkrim pranë kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme e Kosovës ka bërë shkelje procedurale të dispozitave ligjore dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike, si dhe ka bërë shkeljen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

17. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesë:

> *„Kërkesa ime është që 20% që është privatizuar ndërmarrja, që më është garantuar të më kompensohet siç i është kompensuar një pjesë të ish-punëtorëve të ndërmarrjes Ramiz Sadiku".*

Pranueshmëria e kërkesës

18. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

20. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)".*

21. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
> *...*
> *b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi;...".*

22. Bazuar në informatat në shkresat e lëndës, Gjykata gjen se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij më 3 dhjetor 2013. Sipas shkresave në dispozicion, Gjykata përcaktoi se Aktvendimi i fundit, SCEL-09-0001, i Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme, i është dorëzuar parashtruesit me 19 mars 2011, prandaj, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës.

23. Gjykata rikujton se qëllimi i rregullit katër (4) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) është që të promovojë sigurinë juridike, që të sigurojë që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme, si dhe vendimet e nxjerra më herët të mos jenë të hapura pafundësisht për t'u kontestuar (shih, rastin O'Loughlin dhe të tjerët kundër

Mbretërisë së Bashkuar, nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005).

24. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e jashtëafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 25 mars 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI02/14, Hamdi Ademi, Aktvendim i datës 2 prill 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0069, të 22 prillit 2013

Rasti KI02/14, vendimi i 2 prillit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Më 9 janar 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke kërkuar nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.
Parashtruesi në kërkesë pretendon se ai e ka humbur të drejtën në 20% nga privatizimi për shkak të gabimit të personit përgjegjës në ndërmarrjen NSH "Ramiz Sadiku".

Me Vendimin e Kryetarit të Gjykatës, nr. GJR. KI02/14, të 30 janarit 2014, gjyqtari Altay Suroy është caktuar si gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari me Vendimin nr. KSH. KI02/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

Në bazë të të dhënave në shkresat e lëndës, Gjykata konstaton që tashmë është marrë me rastin e përmendur në lëndën nr. KI73/13, Aktvendimi për papranueshmëri, në të cilën, më 18 nëntor 2013 e deklaroi aktvendimin për papranueshmëri të kërkesës. Gjykata në aktvendim ka theksuar që parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij në lidhje me shkeljen e dispozitave kushtetuese, sepse faktet që ai i ka parashtruar në asnjë mënyrë nuk vërtetojnë që Trupi gjykues dhe Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme i kanë cenuar të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë. Gjykata gjen që tashme ka marrë vendim për çështjen në fjalë dhe që kërkesa nuk përmban baza të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri. Andaj, Gjykata e deklaron kërkesën të papranueshme në pajtim me rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së parashtruar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në seancën e mbajtur më 2 prill 2014, vendosi që kërkesën ta deklarojë të papranueshme për arsye se kërkesa nuk përmban baza të mjaftueshme për nxjerrjen e vendimit të ri.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI02/14
Parashtrues
Hamdi Ademi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0069,
të 22 prillit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama- Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Hamdi Ademi, nga fshati Gllamnik, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin ASC-11-0069 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave) të 22 prillit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 3 maj 2013. Vendimi i lartcekur është shqyrtuar në Gjykatën Kushtetuese në rastin nr. KI73/13, Aktvendimi për papranueshmëri, të cilin Gjykata e ka shqyrtuar më 18 nëntor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit, i cili pretendohet t'ia pamundësojë parashtruesit realizimin e të drejtave në një pjesë të 20% të të ardhurave nga

privatizimi i ndërmarrjes shoqërore “Ramiz Sadiku” (në tekstin e mëtejmë: NSH “Ramiz Sadiku“) në Prishtinë.

4. Parashtruesi i kërkesës nuk përmend konkretisht nenet e Kushtetutës që janë cenuar.

Baza juridike

5. Baza juridike për parashtrimin e kërkesës është neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) si dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 9 janar 2014, parashtruesi ka parashtruar kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 30 janar 2014, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI02/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI02/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 24 shkurt 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS), për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 2 prill 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 16 maj 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë e cila ishte regjistruar me numër KI73/13, duke kontestuar Vendimin ASC-11-0069, të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, të 22 prillit 2013.

11. Në kërkesën KI73/13, parashtruesi pretendon që aktgjykimi i kontestuar cenon të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, si të

drejtën për jetë, të drejtën për punë, si dhe që është viktimë e diskriminimit.

12. Në kërkesën KI73/13, parashtruesi ka kërkuar nga Gjykata: *„ta fitojë të drejtën e 20% për punën që ka bërë në ndërmarrjen 'Ramiz Sadiku', dhe të paguhet për pushimin mjekësor prej datës së aksidentit në trafik e deri sa ai t'i mbushë 65 vjet"*.

13. Më 18 nëntor 2013, Gjykata e deklaroi kërkesën e parashtruesit të papranueshme (rasti nr. KI73/13, Aktvendimi për papranueshmëri).

14. Më 9 janar 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesë të re në Gjykatë (duke kontestuar vendimin e njëjtë si në rastin nr. KI73/13), të regjistruar me nr. KI02/14.

15. Në kërkesën nr. KI02/14, parashtruesi nuk ka dorëzuar fakte të reja apo ndonjë provë të re në lidhje me natyrën e rastit të tij, por shprehimisht kërkon që Gjykata: *„t'i mundësojë ballafaqimin me Sekretarin e NSH 'Ramiz Sadiku', të cilin e konsideron personin e vetëm përgjegjës për humbjen e të drejtës në 20% të privatizimit"*.

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi në kërkesë pretendon që ka humbur të drejtën në 20% të privatizimit për shkak të gabimit të personit përgjegjës në ndërmarrjen NSH "Ramiz Sadiku".

17. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën:

> *„Dua të ballafaqohem me ish-sekretarin e Ndërmarrjes 'Ramiz Sadiku', i cili e ka humbur dokumentacionin tim në lidhje me historinë e punës në ndërmarrjen 'Ramiz Sadiku'"*.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata, së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë si dhe të specifikuara më tutje me Ligj dhe me Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.1 të Kushtetutës [Efekti Juridik i Vendimeve], i cili përcakton që:

„1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës“.

20. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 63 (1) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

„(1) Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës“.

21. Për më tepër, rregulli 36 (3) e) i Rregullores së punës përcakton që:

„(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:
(...)
e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri“.

22. Gjykata konsideron që faktet dhe pretendimet që parashtruesi i ka dhënë në kërkesën e re nuk paraqesin bazë e as arsye të mjaftueshme e relevante për vendim të ri.

23. Në të vërtetë, Gjykata përkujton që tashmë është marrë me rastin e përmendur nr. KI73/13, Aktvendimi për papranueshmëri, në të cilin, më 18 nëntor 2013, e deklaroi aktvendimin për papranueshmëri të kërkesës. Gjykata në aktvendim ka theksuar që parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij në lidhje me shkeljen e dispozitave kushtetuese, sepse faktet që ai i ka parashtruar në asnjë mënyrë nuk vërtetojnë që Trupi gjykues dhe Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme i kanë cenuar të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

24. Gjykata gjen që tashmë ka marrë vendim për çështjen në fjalë, ndërsa kërkesa nuk përmban baza të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri.

25. Andaj, Gjykata e deklaron kërkesën të papranueshme në pajtim me rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 2 prill 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI228/13, KI04/14, KI11/14, KI13/14, Lulzim Ramaj dhe znj. Shahe Ramaj, Aktvendim i dates 24 mars 2014-Vlerësimi i kushtetutshmërisë se Njoftimit te Prokurorit te Shtetit, KMLP. I. nr. 11/13, të 5 gushtit 2013, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ZPD/11/0133, të 8 shkurtit 2011, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit P. nr. 470/13, të Gjykatës Themelore në Pejë, të 27 qershorit 2013

Rastet e bashkuara nr. KI228/13, KI04/14, KI11/14, KI13/14, vendimi i 24 marsit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, keqpërdorim i të drejtës për ankesë

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të një katalogu të të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë dhe me Konventë në dëm të tyre nga Prokurori i Shtetit, Zyra e Prokurorit Disiplinor, Gjykata Themelore në Pejë dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë kërkesat në mënyrë kumulative si një keqpërdorim të së drejtës për ankesë, sepse ato ishin të pabazuara dhe për shkak të mënyrës se si kërkesat u parashtruan në Gjykatë.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastet e bashkuara nr.
KI228/13, KI04/14, KI11/14, KI13/14
Parashtrues
Lulzim Ramaj dhe Shahe Ramaj së bashku në rastin nr. KI228/13, dhe
Lulzim Ramaj ndaras në rastet nr. KI04/14, KI11/14, KI13/14
Rasti. nr. KI228/13
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit, KMLP. I. nr. 11/13, të 5 gushtit 2013, përkitazi me Aktvendimin për papranueshmëri të rastit nr. KI126/10, të Gjykatës Kushtetuese, të 19 janarit 2012; Aktvendimit për papranueshmëri, Rastin nr. KI32/11, të Gjykatës Kushtetuese, të 20 prillit 2012; dhe të Aktvendimit për papranueshmëri, Rasti nr. KI102/11, të Gjykatës Kushtetuese, të 12 dhjetorit 2011
Rastet nr. KI04/14, KI13/14
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ZPD/11/0133, të 8 shkurtit 2011, lidhur me Vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit për papranueshmëri, Rasti nr. KI32/11, i Gjykatës Kushtetuese, i 20 prillit 2012
Rasti nr. KI11/14
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit P. nr. 470/13, të Gjykatës Themelore në Pejë, të 27 qershorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI228/13 është dorëzuar nga z. Lulzim Ramaj dhe znj. Shahe Ramaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), me

vendbanim në Pejë, përderisa kërkesat KI04/14, KI11/14 dhe KI13/14 ishin dorëzuar nga parashtruesi Lulzim Ramaj.

Vendimi i kontestuar

A. Sa i përket kërkesës KI228/13

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Njoftimin KMLP. I. nr. 11/13, të Prokurorit të Shtetit, të 5 gushtit 2013, i cili u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 7 gusht 2013.

3. Për më tepër, në kërkesën KI228/13, parashtruesit e kërkesës ankohen ndaj Aktvendimit për papranueshmëri, Rasti nr. KI126/10 i Gjykatës Kushtetuese, të 19 janarit 2012; Aktvendimit për papranueshmëri, Rasti nr. KI32/11, të Gjykatës Kushtetuese, të 20 prillit 2012; dhe Aktvendimit për papranueshmëri, Rasti nr. KI102/11 i Gjykatës Kushtetuese, i 12 dhjetorit 2011.

B. Sa i përket kërkesës KI11/14

4. Parashtruesi i kërkesës, Lulzim Ramaj e konteston Aktvendimin P. nr. 470/13, të Gjykatës Themelore në Pejë, të 27 qershorit 2013, i cili i është dorëzuar atij më 15 korrik 2013.

C. Sa i përket kërkesave KI04/14 dhe KI13/14

5. Parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj e konteston Vendimin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor ZPD/11/0133, të 8 shkurtit 2011, i cili i është dorëzuar atij më 9 shkurt 2011.

6. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj, në kërkesat KI04/14 & KI11/14 ankohet se Aktvendimi për papranueshmëri, Rasti nr. KI32/11 i Gjykatës, i 20 prillit 2012, është "*i paligjshëm, i mungon arsyetimi dhe se nuk është dashur të publikohet*".

Objekti i çështjes

7. Objekt i çështjes së kërkesës KI228/13 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit KMLP. I. nr. 11/13 të Prokurorit të Shtetit të 5 gushtit 2013 sepse *"[...]Edhe vendimi i Prokurorit të shtetit bie ndesh me nenin 392 të KPK-së [Kodi Penal i Kosovës], për nxjerrje të vendimeve kundër ligjore sepse në dosje ekzistojnë të gjitha shkresat e lëndës dhe Prokurori nuk ka dhënë asnjë shpjegim ligjor në të cilën e mbështetë vendimin e vetë."*, në lidhje me Aktvendimin për papranueshmëri rasti nr. KI126/10 i Gjykatës

Kushtetuese, i 19 janarit 2012; Aktvendimin për papranueshmëri rasti nr. KI32/11 i Gjykatës Kushtetuese, i 20 prillit 2012; dhe Aktvendimin për papranueshmëri rasti nr. KI102/11 i Gjykatës Kushtetuese, i 12 dhjetorit 2011. Ata nuk janë të kënaqur me aktvendimet e Gjykatës, sepse ata konsiderojnë që *"[...] Gjykata Kushtetuese nuk më ka shpjeguar pse nuk i kam shteruar të gjitha mjetet juridike, kur e kam paraqitur kërkesën në Ministrinë e Pushtetit Lokal për ndërtimin e shtëpisë sime...Gjykata e ka publikuar vendimin në kundërshtim me nenin 17.2.3. të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese edhe pas kërkesës time që vendimi të mos publikohet. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim kundërligjor nga neni 346 I KPK-së".*

8. Objekt i çështjes së kërkesës KI11/14 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit P. nr. 470/13 të Gjykatës Themelore në Pejë, të 27 qershorit 2013, sepse *"Mos ndihma shtetërore për të na dalë në ndihmë ligjore për ndërtimin shtëpisë dhe pasi ka ardhë për të verifikuar rastin dhe na ka premtuar se do të na sjellë materialin ndërtimor, bie ndesh me nenin 3 (Barazia para Ligjit), nenin 16 (Epërsia e Kushtetutës), nenin 17 (Marrëveshjet Ndërkombëtare), nenin 18 (Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare), nenin 19 (Zbatimi i së drejtës Ndërkombëtare), 21, paragrafi 1 (Parimet e Përgjithshme), nenin 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) nenin 24, paragrafi 1 (Barazia para Ligjit), nenin 31 (E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe te Paanshëm), nenin 53 (Interpretimi i dispozitave për të drejtat e Njeriut) dhe nenin 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës së Kosovës nenin 1, nenin 2, paragrafi 1, nenin 7, nenin 8 dhe nenin 29, paragrafi 2, të Deklaratës Universale për te Drejtat e Njeriut; nenin 2, paragrafi 1 (a) dhe (b), nenin 5, paragrafi 11 dhe 2, nenin 8, paragrafi 2, nenin 14, paragrafi 1, nenin 25, paragrafi 1 dhe nenin 26 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe nenin 1 (E drejta për të respektuar të drejtat e njeriut), nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolleve të saj".*

9. Objekt i çështjes së kërkesës KI04/14 dhe KI13/14 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ZPD/11/0133, të 8 shkurtit 2011 sepse *"Refuzimi i dhënies së vërtetimit të pjesëtarit të UÇK-së dhe mohimi i njohjes së statusit të pjesëtarit të UÇK-së, publikimi i rastit në media dhe shpifjet nga OVL e UÇK-së, bie ndesh me nenin 21, paragrafi 1, nenin 24, paragrafi 1, nenin 36, paragrafi 1 dhe nenin 41, paragrafi 1 të*

Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 1, nenin 2, paragrafi 1, nenin 7, nenin 8 dhe nenin 29, paragrafi 2 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, nenin 2,paragrafi 1 (a) dhe (b),nenin 5, paragrafi 11 dhe 2, nenin 8, paragrafi 2, nenin 14, paragrafi 1, nenin 25, paragrafi 1 dhe nenin 26 te Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, nenin 1 (E drejta për të respektuar të drejtat e njeriut), nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) te Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolleve te saj", në lidhje me Aktvendimin për papranueshmëri, rasti KI32/11 i Gjykatës Kushtetuese, i 20 prillit 2012. Ai nuk është i kënaqur me Aktvendimin e Gjykatës, sepse konsideron se *"është i paligjshëm, i mungon arsyetimi dhe se nuk është dashur të publikohet"*.

10. Për më tepër, në të gjitha kërkesat, parashtruesit kërkojnë që identiteti i tyre të mos zbulohet bazuar në *"nenin 17.2.3 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nenin 36, paragrafi 1 i Kushtetutës së Kosovës, dhe nenet 1 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe Protokollet e saj"*.

Baza juridike

11. Kërkesa bazohet në Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në Rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

12. Më 7 dhjetor 2013, parashtruesit Lulzim Ramaj dhe Shahe Ramaj e dërguan me postë një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata). Kërkesa kishte arritur në Gjykatë më 10 dhjetor 2013 dhe ishte regjistruar me numrin KI228/13.

13. Më 15 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI228/13, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI228/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

14. Më 16 janar 2014, parashtruesi Lulzim Ramaj parashtroi kërkesë në Gjykatë. Kërkesa ishte regjistruar me nr. KI04/14.

15. Më 23 janar 2014, parashtruesi Lulzim Ramaj parashtroi kërkesë në Gjykatë. Kërkesa ishte regjistruar me nr. KI11/14.

16. Më 24 janar 2014, parashtruesi Lulzim Ramaj parashtroi kërkesë në Gjykatë. Kërkesa ishte regjistruar me nr. KI13/14.

17. Më 3 shkurt 2014, Kryetari i Gjykatës, në pajtim me rregullin 37.1 të Rregullores së punës, me Vendimin Urdh. KI228/13, KI04/14, KI11/14, KI13/14, urdhëroi bashkimin e kërkesave KI04/14, KI11/14 dhe KI13/14 me kërkesën KI228/13.
18. Më 7 shkurt 2014, në pajtim me rregullin 37 të Rregullores së punës, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave.

19. Më 24 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

A. Kërkesa KI228/13

20. Më 5 mars 2012, parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj parashtroi padi private në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Gjykatës për nxjerrjen e paligjshme të Aktvendimeve KI102/11, KI32/11 dhe KI126/10 sipas nenit 346 të Kodit Penal të Kosovës sepse Gjykata Kushtetuese "*... nuk më ka shpjeguar pse nuk i kam shteruar të gjitha mjetet juridike, kur e kam paraqitur kërkesën në Ministrinë e Pushtetit Lokal për ndërtimin e shtëpisë sime...Gjykata e ka publikuar vendimin në kundërshtim me nenin 17.2.3. të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese edhe pas kërkesës time që vendimi të mos publikohet. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim kundërligjor nga neni 346 I KPK-së*".

21. Më 27 mars 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin P. nr. 803/11, e hodhi poshtë padinë private të Lulzim Ramajt si të pabazuar.

22. Ankesa pasuese nga parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj ishte hedhur poshtë si e pabazuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës (Aktvendimi PA1. nr. 407/2013, të 17 majit 2013).

23. Më 5 gusht 2013, Prokurori i Shtetit, (Njoftimi KMLP. I. nr. 11/13), e njoftoi parashtruesin e kërkesës se Prokurori i Shtetit nuk kishte gjetur bazë ligjore të vazhdojë me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit.

B. Kërkesa KI11/14

24. Më 5 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj ka kërkuar nga Drejtoria për Rindërtim në Komunën e Pejës që t'i sigurojë atij material të nevojshëm për rindërtimin e shtëpisë së tij.

25. Sipas parashtruesit të kërkesës, Drejtoria për Rindërtim nuk i siguroi atij materialin e kërkuar për ndërtim. Parashtruesi i kërkesës vendosi të paraqesë padi private në gjykatën e rregullt të Kosovës kundër drejtorit të Drejtorisë për Rindërtim në Komunën e Pejës.

26. Më 27 qershor 2013, Gjykata Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin P. nr. 470/13, e hodhi poshtë padinë private të Lulzim Ramajt si të pabazuar.

C. Kërkesat KI04/14 dhe KI13/14

27. Parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj ankohet se Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e veteranëve të UÇK-së nuk ia pranoi atij statusin e veteranit të UÇK-së.

28. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Aktvendimi për papranueshmëri nr. KI32/11 i Gjykatës, me parashtrues të kërkesës Lulzim Ramaj, që ka të bëjë me kërkesën për njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së, të 20 prillit 2012, është i paligjshëm, i mungon arsyetimi dhe se nuk është dashur të publikohet.

29. Për më tepër, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me vërejtjet si në vijim *"këtë herë kur të merrni një vendim, pa marrë parasysh a e aprovoni ose refuzoni kërkesën, më ofroni arsyetim ligjor dhe jo të veproni si deri më tani, të nxirrni vendime pa arsyetim ligjor"*.

Pranueshmëria e kërkesës KI228/13

30. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse ata i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të

përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

31. Lidhur me kërkesën KI228/13, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

32. Dispozita e lartcekur kushtetuese kërkon nga parashtruesit e kërkesës që t'i dorëzojnë kërkesat e tyre në Gjykatë në mënyrë ligjore, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike.

33. Gjykata i referohet Nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".*

34. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, që parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (...)*
>
> *(b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi...".*

35. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Njoftimi KMLP. I. nr. 11/13, i Prokurorit të Shtetit, i 5 gushtit 2013, u ishte dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 7 gusht 2013.

36. Për më tepër, Gjykata vëren se edhe pse kërkesa KI228/13 ishte regjistruar më 10 dhjetor 2013, Gjykata do ta marrë parasysh datën e regjistrimit të vulës postare si datë kur kërkesa KI228/13 është parashtruar në Gjykatë, që është 7 dhjetori 2013 (shih rastin *Kiprici kundër Turqisë*, Nr. 14294/04, GJEDNJ, Vendimi i 3 shtatorit 2008).

37. Nga kjo rrjedh se kërkesa KI228/13 është parashtruar brenda afatit ligjor prej katër (4) muajve të paraparë me Nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

38. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës Shahe Ramaj nuk ishte përfshirë, në asnjë fazë apo cilësi, në procedurat në gjykatat e rregullta. Gjykata vëren se ajo kishte parashtruar kërkesën KI228/13 së bashku me parashtruesin tjetër të kërkesës dhe se parashtruesja Shahe Ramaj vetëm ankohet se aktvendimet e Gjykatës janë "*janë të paligjshme dhe u mungon arsyetimi*".

39. Gjykata përsërit se Neni 113.7 i Kushtetutës përcakton " *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë"*.

40. Në kërkesën konkrete, parashtruesja Shahe Ramaj nuk ishte palë as në procedurë dhe as në kërkesat e mëparshme në Gjykatë KI102/11, KI32/11 dhe KI126/10, si dhe as në procedurat pasuese në gjykatat e rregullta. Nga kjo rrjedh se parashtruesja e kërkesës Shahe Ramaj nuk mund të konsiderohet palë e autorizuar për të dorëzuar kërkesë, në kuptim të Nenit 113.7 të Kushtetutës.
41. Si rezultat, Gjykata duhet ta refuzojë kërkesën si të papranueshme për aq sa ka të bëjë me Shahe Ramaj.

42. Sa i përket ankesave tjera, të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj në këtë kërkesë, Gjykata vëren se ankesa themelore e parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me kushtetutshmërinë e Aktvendimeve për papranueshmëri në kërkesat 102/11, 32/11 dhe 126/10.

43. Gjykata i referohet nenit 116.1 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës"*.

44. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (3) f) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese:*
> *...*
> *f) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën"*.

45. Gjykata vëren se vendimet e saj janë përfundimtare dhe detyruese dhe si të tilla nuk mund të kontestohen nga vetë Gjykata ose nga ndonjë autoritet tjetër publik.

46. Nga kjo rrjedh se këto ankesa, të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës Lulzim Ramaj në kërkesën KI228/13 duhet të refuzohen nga Gjykata si *ratione materiae* të papajtueshme me Kushtetutën, siç parashihet në rregullin 36 (3) f) të Rregullores së punës.

Pranueshmëria e kërkesës KI11/14

47. Lidhur me kërkesën KI11/14, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

48. Gjykata i referohet Nenit 47 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

49. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *(a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar".*

50. Nga dokumentet e dorëzuara, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, Lulzim Ramaj nuk e ka kontestuar Aktvendimin P. nr. 470/13, të Gjykatës Themelore në Pejë, në instancat e larta të gjyqësorit të rregullt.

51. Nga kjo rrjedh se kërkesa KI11/14 duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, sepse parashtruesi Lulzim Ramaj nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, siç kërkohet me Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës.

KI04/14 dhe KI13/14

52. Përkitazi me kërkesat KI04/14 dhe KI13/14, të dorëzuara nga parashtruesi Lulzim Ramaj, Gjykata i referohet Nenit 116.1 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës".*

53. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (3) f) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*
> *...*
> *f) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën".*

54. Gjykata vëren se në kërkesat KI04/14 dhe KI13/14, parashtruesi i kërkesës, Lulzim Ramaj ankohet se Aktvendimi për papranueshmëri nr. KI32/11, parashtrues i kërkesës Lulzim Ramaj, i 20 prillit 2012, përkitazi me statusin e tij si veteran i UÇK-së, duke pretenduar *inter alia,* se ai është aktvendim i paligjshëm.
55. Gjykata vëren se vendimet e saj janë përfundimtare dhe detyruese dhe si të tilla nuk mund të kontestohen nga vetë Gjykata ose nga ndonjë autoritet tjetër publik.

56. Nga kjo rrjedh se kërkesat KI04/13 dhe KI13/14, përkitazi me parashtruesin e kërkesës, Lulzim Ramaj, janë hedhur poshtë nga Gjykata si *ratione materiae* të papajtueshme me Kushtetutën, siç parashihet me rregullin 36 (3) f) të Rregullores së punës.

Pranueshmëria lidhur me kërkesat KI228/13, KI04/14, KI11/14, KI13/14

57. Gjykata konsideron se përkundër kritereve të ndara të pranueshmërisë, të aplikuara në secilën kërkesë dhe të përfundimeve të bazuara në to, kërkesat duhet t'i përmbushin më

së shumti kriteret e rregullit 36 (3) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*
>
> *(...)*
>
> *d) Gjykata konsideron që kërkesa është keqpërdorim i të drejtës për peticion;*

58. Sa i përket keqpërdorimit të së drejtës për kërkesë, Gjykata thekson se praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut shtjellon çështjen se kur ekziston keqpërdorimi i së drejtës për kërkesë. Një prej tyre është, *inter alia,* kur parashtruesi në mënyrë të përsëritur paraqet kërkesë të bezdisshme dhe qartazi të pabazuar në GJEDNJ, të cilat janë të ngjashme me një kërkesë që ai ose ajo e ka parashtruar në të kaluarën që tashmë është deklaruar e papranueshme (shih *M. kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), dhe *Philis kundër Greqisë* (vendim).

59. Gjykata vlerëson se në rastet në fjalë, parashtruesit e kërkesës kanë parashtruar kërkesa të pabazuara dhe të përsëritura. Kështu deri më tani, ata kanë parashtruar gjithsej tetë kërkesa në Gjykatë, përfshirë dhe të tanishmet.

a. KI126/10, parashtrues i kërkesës, Lulzim Ramaj, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 19 janar 2012;

b. KI32/11 parashtrues i kërkesës, Lulzim Ramaj, Kërkesë për njohje të statutit të veteranit të UÇK-së, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 20 prill 2012:

c. KI102/11, parashtruese e kërkesës, Shahe Ramaj kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 12 dhjetor 2011.

d. KI106/12, parashtrues i kërkesës, Lulzim Ramaj, Kërkesë për njohjen e statusit të anëtarit të UÇK-së, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 29 janar 2013;

e. KI116/12, parashtrues i kërkesës, Lulzim Ramaj, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 25 janar 2013;

f. KI228/13, parashtrues të kërkesës, Lulzim Ramaj & Shahe Ramaj, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit, KMLP. I. nr. 11/13, të 5 gushtit 2013, përkitazi me Aktvendimin për papranueshmëri, Rasti nr. KI126/10 i Gjykatës Kushtetuese, i 19 janarit 2012; Aktvendim për papranueshmëri, Rasti nr. KI32/11 i Gjykatës Kushtetuese, i 20 prillit 2012; dhe Aktvendimi për papranueshmëri, Rasti nr. KI102/11 i Gjykatës Kushtetuese, i 12 dhjetorit 2011, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 24 mars 2014;

g. KI04/14 & KI13/14, parashtrues të kërkesës Lulzim Ramaj, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ZPD/11/0133, të 8 shkurtit 2011, lidhur me Vlerësimin e kushtetutshmërisë, Rasti nr. KI32/11 i Gjykatës Kushtetuese, i 20 prillit 2012, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 24 mars 2014;

h. KI11/14, parashtrues i kërkesës, Lulzim Ramaj, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit P. nr. 470/13, të Gjykatës Themelore në Pejë, e deklaruar e papranueshme nga Gjykata më 24 mars 2014.

60. Gjykata konsideron se në rastet e tanishme, parashtruesit e kërkesës kanë dorëzuar kërkesa të pabazuara, të përsëritura, abuzive dhe të bezdisshme, duke penguar punën e Gjykatës dhe duke i marrë kohën dhe mjetet e saj.

61. Duke marrë parasysh të gjitha ato që u thanë më lart, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës përfitojnë nga e drejta për ankesë në mënyrë që të sulmojnë, denigrojnë dhe të njollosin reputacionin e gjyqtarëve si profesionistë dhe individë, dhe të Gjykatës si institucion i drejtësisë.

62. Për më tepër, Gjykata e refuzon kërkesën e parashtruesve për moszbulimin e identitetit të tyre, si të pabazuar.

63. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesat KI228/13, KI04/14, KI11/14 dhe KI13/14 përbëjnë keqpërdorim të së drejtës për ankesë në pajtim me rregullin 36 (3) d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të Nenit 113.7 të Kushtetutës; Nenit 47 të Ligjit; si dhe në pajtim me rregullin 36 (3) d) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 24 mars 2014, njëzëri

VENDOS

I. T'I HEDHË POSHTË kërkesat të papranueshme;

II. TË KONSTATOJË se kërkesat e tanishme përbëjnë keqpërdorim të së drejtës për ankesë, sipas formulimit të rregullit 36 (3) d) të Rregullores së punës;

III. TA REFUZOJË kërkesën e parashtruesve për moszbulim të identitetit;

IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

V. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI104/13, Adem Maloku, Aktvendim i datës 2 prill 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-11-0069, të 22 prillit 2013

Rasti KI104/13 vendim i 2 prillit 2014

Fjalët kyçe; Kërkesë individuale, e drejta e pronës, e paafatshme

Parashtruesi parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-11-0069, të 22 prillit 2013.

Parashtruesi kërkon që të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejta legjitime ndaj të ardhurave te grumbulluara nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku".

Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-11-0069, të 22 prillit 2013, Gjykata Kushtetuese gjeti se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkelje të së drejtave kushtetuese dhe parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij. Prandaj, Gjykata konkludoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkelje të së drejtave të tij kushtetuese, prandaj kërkesa e tij është qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI104/13
Parashtrues
Adem Maloku
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-11-0069, të 22 prillit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues,gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Adem Maloku, i përfaqësuar nga z. Ali Latifi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0069, i 22 prillit 2013.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullat 56 (1) dhe 74 (1) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Kërkesa ka për objekt çështjeje vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës

Supreme, ASC-11-0069, të 22 prillit 2013, përkitazi me të drejtën e supozuar të parashtruesit të kërkesës që të përfshihet në listën e të punësuarve që gëzojnë të drejtën për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH KNI "Ramiz Sadiku" Prishtinë.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 korrik 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 5 gusht 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI104/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI104/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović (anëtarë).

7. Më 29 gusht 2013, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme).

8. Më 26 shtator 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi që të sqarojë disa aspekte të kërkesës së tij.

9. Më 13 shtator dhe më 3 tetor 2013, Gjykata kërkoi sqarim nga Dhoma e Posaçme për vendimet e Trupit gjykues dhe Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme përkitazi me kërkesën dhe pretendimet e parashtruesit.

10. Më 13 mars 2014, Kolegji shqyrtues, pas shqyrtimit të raportit paraprak, vlerësoi se raporti duhet të plotësohet akoma dhe shqyrtimin e shtyu për një datë tjetër.

11. Më 18 mars 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të deklarohet përkitazi me sqarimet e Dhomës së Posaçme, të 3 shtatorit 2013, përkatësisht të 3 tetorit 2013.

12. Më 1 e 2 prill 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Në një kohë të caktuar, parashtruesi ishte i punësuar si punëtor i NSH "Ramiz Sadiku".

14. Më 27 qershor 2006, NSH "Ramiz Sadiku" ishte privatizuar.

15. Më 23 mars 2009, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një ankesë në Dhomën e Posaçme, kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), me ç'rast kërkoi të përfshihej në listën e të punësuarve që gëzojnë të drejtën për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH KNI "Ramiz Sadiku" në Prishtinë.

16. Më 10 qershor 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme, me Aktgjykimin SCEL-09-0001, hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të papranueshme.

17. Me Aktgjykimin e lartpërmendur, SCEL-09-0001, të 10 qershorit 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme, ndër të tjera kishte arsyetuar:

> *"... Trupi Gjykues vëren se në kohën privatizimit, ankuesi ishte mbi moshën 65 vjeçare, sipas dokumenteve në dosje (i lindur më 1 tetor 1939)...".*
>
> *"Trupi Gjykues konsideron se ankuesi nuk i plotëson kërkesat e Nenit 10.4 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut 2003/13 pasi që ai kishte arritur moshën e pensionimit para datës së privatizimit të NSH-së, 27 qershor 2006".*

18. Më 24 tetor 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë te Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme, kundër aktgjykimit të Trupit gjykues.

19. Më 22 prill 2013, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme, me Aktvendimin ASC-11-0069, hodhi poshtë si të pabazë ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, duke arsyetuar:

> *"Trupi gjykues kishte gjetur se ankuesi i kishte plotësuar kriteret për të qenë në listën punëtorëve të cilët i gëzojnë të drejtat legjitime për 20 përqind të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së, andaj ankesa është e papranueshme".*

20. Më 13 shtator 2013, Gjykata kërkoi nga Dhoma e Posaçme që të sqarojë paqartësitë e lartpërmendura ndërmjet Aktgjykimit SCEL-09-0001 dhe Aktvendimit ASC-11-0069, të nxjerra nga Trupi gjykues përkatësisht nga Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme.

21. Më 20 shtator 2013, përkitazi me kërkesën e parashtruesit, Gjykata pranoi sqarim nga Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme, ku, ndër të tjera, thuhej:

> *"Kolegji i Ankesave, pasi e ka shqyrtuar ankesën, ka vërejtur se z. Maloku (parashtruesi i kërkesës) ka bërë ankesë gabimisht, sepse ai ka qenë i përfshirë në listë. Kolegji i Ankesave është dashur që të jap një zgjidhje për këtë ankesë, andaj për Kolegjin e Apelit ankesat e tilla janë të papranueshme, sepse i njëjti është i përfshirë në listën për të përfituar të drejtën e 20 për qind të të ardhurave nga shitja-privatizimi i ndërmarrjes dhe nuk është dashur që të parashtroj ankesë".*

22. Më 3 tetor 2013, Gjykata kërkoi nga Dhoma e Posaçme që të dorëzojë dokumentacion relevant që përfundimisht do të sqaronte nëse parashtruesi i kërkesës ishte i përfshirë në listë të punëtorëve që gëzojnë të drejtën për përfitim nga një pjesë e të ardhurave të privatizimit të NSH "Ramiz Sadiku", ose jo.

23. Më 17 tetor 2013, Gjykata pranoi një sqarim tjetër nga Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme, ku, ndër të tjera, thuhej:

> *"Kolegji i Apelit me Aktvendimin ASC-11-0069 të datës 18 prill 2013, ankesën e ankuesit (ASC-11-0069-A0091), e ka hedhur poshtë si të papranueshme, duke menduar për z. Adem Maloku nga fshati Bradash... Këtu është bërë pshtjellim për shkak të emrave dhe mbiemrave të njëjtë, andaj është bërë edhe gabimi në procedurë. Është e qartë se z. Adem Malokut (parashtruesi i kërkesës) nga fshati Bellopojë e Podujevës me numër 619, në shkallë të parë iu kishte refuzuar ankesa si e pabazuar, dhe se Kolegji i Apelit, ankesën e ankuesit duhej ta përfshinte në Aktgjykimin ASC-11-0069 të datës 22 prill 2013 dhe të vendos në merita, duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e tij.*
>
> *Andaj, ju njoftojë se edhe po të ishte shqyrtuar ankesa e ankuesit Adem Maloku nga Bellopoja, ankesa e tij do të refuzohej si e pabazuar, sepse nuk i plotësonte kriteret e parapara në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ai kishte arritur moshën e pensionimit para datës së privatizimit të NSH-së".*

24. Më 20 mars 2014, përkitazi me shpjegimet e sipërpërmendura të Dhomës së Posaçme, parashtruesi i kërkesës, mes tjerash, komentoi: *"... vet komentimet e kësaj gjykate, të posaqme [...], janë kontradiktore në mes vetit, këtë nuk po e them unë por ata vet po e dëshmoin"*.

Pretendimet e parashtruesit

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"... Aktvendimi ASC-11-0069, të dt. 18.04/13 Faqa nr. 4, arsyetimi për Adem Malokun se ka të drejtë, por ka përjashtuar dëgjimin drejtpërdrejt që është shkelje e rëndë e procedurës"*.

26. Parashtruesi po ashtu pretendon: *"... vet Gjykata (Dhoma e Posaçme) ka konstatuar se me pa të drejtë është hjekë nga lista e 20%"*.

27. Parashtruesi kërkon që të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejta legjitime ndaj të ardhurave të grumbulluara nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku" dhe po ashtu pretendon se: "*... njerëzit e pandërgjegjshëm më kanë larguar nga lista, këtë e vërteton edhe Gjykata Supreme e cila nuk më ka udhëzuar se çka të bëj, nuk më janë dhënë këshilla juridike për ato që më takojnë"*.

Dispozitat relevante

Ligji Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 14
Shfuqizimi i ligjeve të mëparshme; konfliktet; interpretimi

4. Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

LIGJI Nr. 03/L-006
PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 165

Korrigjimi i aktgjykimit

165.1 Gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi i kopjes me origjinalin e aktgjykimit, i korrigjon gjykata në çdo kohë.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Për të qenë në gjendje për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

29. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

30. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, që përcakton:

> *(1) "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *(...)*
>
> *c) kërkesa është qartazi e bazuar".*

31. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit për të gëzuar të drejtën e realizimit nga 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku", Gjykata vëren se Trupi gjykues kishte hedhur poshtë ankesën e parashtruesit si të papranueshme për shkak se ai kishte arritur moshën e pensionimit para datës së privatizimit të NSH "Ramiz Sadiku", më 27 qershor 2006.

32. Gjykata, po ashtu, vëren se Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme është përgjigjur se parashtruesi nuk gëzon të drejtën e realizimit nga 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku" për shkak se ai kishte arritur moshën e pensionimit para datës së privatizimit të ndërmarrjes në fjalë.

33. Përkitazi me gabimet teknike ose ngatërrimet e identitetit, Gjykata konsideron se ato janë çështje të ligjshmërisë dhe se nuk është detyrë e saj që të përmirësojë gabimet e natyrës së tillë të gjykatave të rregullta.

34. Për më tepër, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit në substancë nuk ka merita, sepse Trupi gjykues përkatësisht Kolegji i Apelit të Dhomës Posaçme kanë konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk gëzon të drejtën e realizimit nga 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku" për shkak se ai kishte arritur moshën e pensionimit para datës së privatizimit të ndërmarrjes në fjalë.

35. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore. Prandaj Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt (shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65 dhe, po ashtu, shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

36. Përveç kësaj, kërkesa nuk arrin të dëshmojë që gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

37. Fakti që parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

38. Në këto rrethana, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura

nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

39. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në përputhje me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 2 prill 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI211/13, Demush Krasniqi, Aktvendim i datës 28 mars 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Njoftim nr. 01/118-682, të 27 tetorit 2010

Rasti KI 211/13, vendimi i 28 marsit 2014.

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, shterja e të gjitha mjeteve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzim Administrativ

Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në bazë të nenit 113. 7 të Kushtetutës, me të cilën konteston Njoftimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 01/118-682 (në tekstin e mëtejmë: KGJK), të 27 tetorit 2010, për largimin e tij nga posti i gjyqtarit në Gjykatën Komunale në Malishevë.

Parashtruesi i kërkesës është ish-gjyqtar i Gjykatës Komunale në Malishevë, i cili më 27 tetor 2010 e mori Njoftimin nga KGJK-ja, nr. 01/118-682, me të cilin njoftohej se mandati i tij si gjyqtar ne Gjykatën Komunale në Malisheve përfundon më 27 tetor 2010.

Njoftimi i KGJK-së erdhi si rezultat i procesit të riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve përgjatë fazës së tretë, ne bazë të nenit 2.11, nenit 2.16 dhe nenit 14.2 të Urdhëresës Administrative Nr. 2008/02 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe nenit 150 të Kushtetutës.

Duke vendosur për kërkesën e parashtruesit Demush Krasniqi, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi se ka kontestuar vendimin e KGJK-së në ndonjërën nga gjykatat e rregullta të Kosovës apo që ka shteruar ndonjë mjet efektiv juridik para se t'i drejtohej me kërkesë Gjykatës Kushtetuese. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për kërkesën e shterimit te mjeteve juridike është që t'iu ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet ne supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese.

Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj dhe prandaj deklaroi kërkesën të papranueshme në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI211/13
Parashtrues
Demush Krasniqi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Njoftim nr. 01/118-682,të 27 tetorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Demush Krasniqi, me vendbanim në fshatin Drenoc, komuna e Malishevës, të cilin me autorizim e përfaqëson z. Daut Krasniqi, avokat nga komuna e Malishevës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Njoftimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KGJK), nr. 01/118-682, të 27 tetorit 2010, për largimin e tij nga posti i gjyqtarit në Gjykatën Komunale në Malishevë.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Njoftimit të KGJK-së nr. 01/118-682, të 27 tetorit 2010, ku si rezultat i riemërimit të gjyqtarëve, KGJK-ja, më 27 dhjetor 2010, ka njoftuar parashtruesin e kërkesës se mandati i tij si gjyqtar ka përfunduar.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 19 nëntor 2013, parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

6. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 19 dhjetor 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë formularin zyrtar të Gjykatës.

8. Më 30 dhjetor 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë formularin e kërkesës.

9. Më 17 janar 2014, Gjykata njoftoi KGJK-në për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 28 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi është ish-gjyqtar i Gjykatës Komunale në Malishevë, i cili më 27 tetor 2010 e mori Njoftimin nga KGJK-ja, nr. 01/118-682, me të cilin njoftohej se mandati i tij si gjyqtar në Gjykatën Komunale në Malishevë përfundon më 27 tetor 2010.

12. Njoftimi i KGJK-së erdhi si rezultat i procesit të riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve përgjatë fazës së tretë, në bazë të nenit 2.11, nenit 2.16 dhe nenit 14.2 të Urdhëresës Administrative Nr. 2008/02 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe nenit 150 të Kushtetutës.

Pretendimet e parashtruesit

13. Parashtruesi pretendon që me njoftimin e KGJK-së, "*është shkelur Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2006/25 Mbi Kornizën Rregullative për Sistemin e Drejtësisë në Kosovë të (PSSP) si dhe neni 104 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Karta Evropiane mbi Statutin për Gjyqtarët, neni 6 pika 1.2.3 dhe 4 Paga dhe mbrojtja sociale e gjyqtarëve profesionist*".

14. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që "*njoftimin e KGJK-së ta shpall si kundërkushtetues e kundër ligjor dhe të më njohë të gjitha të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës që nga data e largimit e deri kur të vendoset me Vendim meritor*".

Pranueshmëria e kërkesës

15. Për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

17. Gjithashtu nenin 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

18. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 36 (1) a) të Rregullores, i cili përcakton:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse*:
>
> *a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar…".*

19. Sa i përket kësaj kërkese, Gjykata Kushtetuese vëren që më 27 tetor 2010, KGJK-ja e njoftoi parashtruesin, me anë të Njoftimit nr. 01/118-682, që mandati i tij si gjyqtar në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Malishevë përfundoi më 27 tetor 2010.

20. KGJK-ja e bazoi lëshimin e këtij njoftimi në nenin 150 të Kushtetutës dhe në nenet 2.11, 2.16 dhe 14.2 të Urdhëresës Administrative Nr. 2008/02 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë.

21. Gjykata, në këtë drejtim, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi se ka kontestuar vendimin e KGJK-së në ndonjërën nga gjykatat e rregullta të Kosovës apo që ka shteruar ndonjë mjet efektiv juridik para se t'i drejtohej me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

22. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për kërkesën e shterimit të mjeteve juridike është që t'iu ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih rastin *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803194, GJEDNJ, vendimi i 28 korrikut 1999).

23. Gjykata zbatoi të njëjtin arsyetim, kur nxori aktvendimin për papranueshmëri, në bazë të asaj se nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike në rastin (shih rastin KI104/10, *Vahide Badivuku kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës*, Aktvendimi për papranueshmëri, të 14 qershorit 2011).

24. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me Ligj, që të mund të dorëzojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese dhe kërkesa duhet të hidhet si e papranueshme në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) a) të Rregullores.

25. Gjykata gjithashtu vëren që edhe sikur parashtruesi të ketë shteruar të gjitha mjetet e tij juridike para se të parashtronte këtë kërkesë në Gjykatë më 19 nëntor 2013, kërkesa e tij do të ishte e papranueshme sepse nuk ishte parashtruar brenda afatit prej katër (4) muajve siç është paraparë me ligj. Shih nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47.2 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 28 mars 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI114/13, Emsale Zoni, Aktvendim i datës 11 shkurt 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 170/2012, të 24 shtatorit 2012

Rasti KI 114/13, vendimi i 11 shkurtit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale,shkelja e të drejtave sipas nenit 53 (Interpretimi I dispozitave të të Drejtave të Njeriut) dhe nenit 54(Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës Kosovës,kërkesa e papranueshme

Vendimi i kontestuar- Parashtruesja në kërksë veqanerisht konteston Aktgjykimin e Gjykatës

Komunale në Vushtrri, Republika e Kosovës, C. nr. 215/06 të 3.korrikut. 20063. Megjithatë, vendimi përfundimtar në këtë rast është Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 170/2012, i 24 shtatorit 2012,

Parashtruesi kërkesën e sajë e ka parashtruar në baz të nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës,ku pretendon se i janë shkelur të drejtat e sajë të garantuara me Kushtetutës,konkretisht ajo thekson që i është shkelur e drejta sipas nenit 53(Interpretimi I dispozitave të të Drejtave të Njeriut) dhe nenit 54(Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës së Kosovës. Parashtruesja thekson se ka qenë e punësuar në ndërmarrjen"Qyqavica" deri në vitin 1991 kur forcat serbe e larguan nga puna,ajo më tejë thekson që NSH "Qyqavica" në Vushtrri ka qene e obliguar t'i kompensoje te ardhurat personale prej vitit 1992 deri më 1999,por ndërmarrja nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Gjykata Kushtetuese sa i përket këtij rasti vendosi që kërkesën e parashtrueses ta hudhë poshtë si të papranuëshme.

Gjykata vendimin e sajë e arsyeton në bazë të nenit 49 të ligjit pëe Gjykatën kushtetuese dhe rregullin 36 pika 1(b) të rregullorës së punës së kësaj gjykata.Duke u bazuar në këtë,Gjykata thekson që parashtruesa nuk e ka rrespektuar afatin kohorë prej 4 (katër) muajve nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi.
Për shkak të arsyeve të përmënduar,Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI114/13
Parashtrues
Emsale Zoni
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 170/2012, të 24 shtatorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Emsale Zoni, me banim në Vushtrri.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja në kërkesë veçanërisht konteston Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, Republika e Kosovës, C. nr. 215/06 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale në Vushtrri), të 3 korrikut 2006, e pranuar nga parashtruesja e kërkesës në një datë të pacaktuar.

3. Megjithatë, vendimi përfundimtar në këtë rast është Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 170/2012, i 24 shtatorit 2012, i pranuar nga parashtruesja e kërkesës në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të lartpërmendura të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë.

5. Pa marrë parasysh këtë, parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin kolektiv të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006, për shkak të mospërmbarimit të vendimit.

Baza juridike

6. Kërkesat janë të bazuara në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Parashtruesja e kërkesës ka parashtruar kërkesën më 29 korrik 2013.

8. Më 5 tetor 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. GJR. KI114/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI114/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 12 shtator 2013, kërkesat iu komunikuan Gjykatës Themelore në Vushtrri (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

10. Më 26 shtator 2013, Gjykata Themelore në Vushtrri ia dorëzoi Gjykatës Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Vushtrri, E. nr. 273/08, të 21 shkurtit 2008, si dhe të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 170/12, të 24 shtatorit 2012, të cilës parashtruesi nuk ia ka dorëzuar në fillim.

11. Më 21 nëntor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës në lidhje me dokumentet e dorëzuara nga Gjykata Themelore në Vushtrri.

12. Më 11 shkurt 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Parashtruesja e kërkesës ka qenë e punësuar në Ndërmarrjen shoqërore "Qyqavica" deri në vitin 1992.

14. Sipas dokumenteve të parashtruara, në bazë të Aktgjykimit kolektiv të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006, NSH "Qyqavica" në Vushtrri ka qenë e obliguar t'i kompensojë të ardhurat personale prej vitit 1992 deri më 1999, me kamatë vjetore prej 4.5%, duke filluar nga 29 qershori 2005, deri në pagesën përfundimtare për të gjithë parashtruesit e kërkesës.

15. Parashtruesit e kërkesës kanë parashtruar kërkesë në Gjykatën Komunale në Vushtrri, për ekzekutimin e Aktgjykimit të mëparshëm të Gjykatës Komunale, C. nr. 215/05, të 3 korrikut 2006.

16. Më 5 tetor 2006, Gjykata Komunale në Vushtrri ka marrë vendim për përmbarimin e Aktgjykimit C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006 *(*Aktvendimi E. nr. 2846/06, i 5 tetorit 2006). Llogaria e NSH "Qyqavica" është bllokuar, dhe "Bankës së Re të Kosovës", dega në Vushtrri, i është urdhëruar që parashtruesve të kërkesës t'ua paguajë shumën e caktuar, së bashku me kamatën e caktuar.

17. Megjithatë, më 21 shkurt 2008, Gjykata Komunale mori vendim të anulojë procedurën përmbarimore (Aktvendimi E. nr. 273/08*)*.

18. Në Aktvendimin e saj, Gjykata Komunale në Vushtrri arsyetoi vendimin e saj për anulimin e përmbarimit duke iu referuar shkresës së 31 dhjetorit 2007 nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, ku kërkohet nga Gjykata Komunale që "*...në lidhje me të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me NSH "Qyqavica", të anulojë procedurën e përmbarimit, sepse në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2005/4 përcaktohet që me nxjerrjen e rregulloreve të veçanta për rregullimin e fushave të caktuara përjashtohet LPP-ja (Ligji për procedurën përmbarimore), si dhe është përcaktuar që NSH-ja nuk është në procesin e likuidimit, megjithatë, kreditori mund të realizojë të drejtat e tij në AKM [Agjencia Kosovare e Mirëbesimit] dhe këto kërkesa do të konsiderohen si tituj përmbarimorë, megjithatë në procedurën e likuidimit të ndërmarrjes, kërkesat do të përmbushen nga Komisioni i Likuidimit të NSH-së "*.

19. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, E. nr. 273/08, të 21 shkurtit 2009, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

20. Më 24 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë (Aktvendimi Ac. nr. 170/12) hodhi poshtë ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale, E. nr. 273/08, të 21 shkurtit 2009. Gjykata e Qarkut thekson që *"NSH-të janë kompetencë ekskluzive e Dhomës së Posaçme në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13 për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesja e kërkesës pretendon që ka punuar në NSH "Qyqavica" në Vushtrri deri më 1991, kur forcat serbe e kanë larguar me dhunë nga puna, si dhe e kanë diskriminuar.

22. Parashtruesja e kërkesës pretendon që të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë janë cenuar, sepse ajo ka të drejtë të marrë një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Qyqavica", në kuptimin e kompensimit të të ardhurave të saj personale për periudhën nga viti 1991 deri më 1999. Parashtruesja e kërkesës thirret në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave të të Drejtave të Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata vëren se, për të gjykuar kërkesën e parashtrueses së kërkesës, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse ajo i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton që:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. (...)".*

25. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b), i cili përcakton që:

"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi".

26. Gjykata vëren se vendimi i fundit i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 170/12, i 24 shtatorit 2012, i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës në një datë të pacaktuar, ndërsa parashtruesja e ka parashtruar kërkesën në Gjykatë më 29 shtator 2013. Pasi që parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të dorëzojë dëshmi në këtë Gjykatë mbi atë se kur i është dorëzuar vendimi i Gjykatës së Qarkut, kjo gjykatë konsideron që dita në të cilën është publikuar vendimi është dita e dorëzimit, gjegj. 24 shtatori 2012.

27. Gjykata thekson që kushti juridik i zbatueshmërisë së afatit prej katër (4) muajve për parashtrim të kërkesës ka për qëllim të promovojë parimin e sigurisë juridike si dhe të sigurojë palët që rastet që janë nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese të trajtohen në afat të arsyeshëm, si dhe që organet dhe palët e tjera të interesuara të mbrohen nga situata të paqartësisë për shkak të afatit të zgjatur kohor (shih, *mutatis mutandis, P.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Aplikacioni nr. 6638/03, Vendimi i 24 gushtit 2004)

28. Për më tepër, Gjykata rithekson që parashtruesja e kërkesës është e obliguar të informojë Gjykatën për të gjitha rrethanat në lidhje me kërkesën, si dhe mos të mbajë asnjë informatë që i është e njohur. Në të kundërtën, mbajtja apo vënia e Gjykatës në lajthitje mund të ngrejë çështjen e keqpërdorimit të së drejtës për kërkesë.

29. Gjykata vëren se në këtë rast, parashtruesit e kërkesave nuk e kanë informuar Gjykatën për Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri (E. nr. 273/08, të 21 shkurtit 2008) për anulimin e procedurës së përmbarimit dhe për Aktvendimin e Gjykatës së Apelit (Ac. nr. 170/2012, të 24 shtatorit 2012) që të shfuqizojë vendimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale në Vushtrri. Sjellja e tillë nuk është në përputhje me të drejtën për kërkesë individuale sipas standardeve juridike evropiane. (shih *mutatis mutandis,* Vendimi i GJEDNJ-së *Hadrabova dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* për lejueshmërinë, nr. 42165/02 dhe 466/03, të 25 shtatorit 2007).

30. Në këto rrethana, parashtruesja e kërkesës nuk i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë sa i përket afatit brenda të cilit duhet parashtruar kërkesa në Gjykatën Kushtetuese.

31. Andaj, Gjykata konkludon që kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 shkurt 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI28/14, Skender Mezini and Ferbend Haxhijaj, Aktvendim i datës 13 qershor 2014 -Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 26/2012, të 16 shtatorit 2013

KI28/14, vendimi i 13 qershorit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, Kërkesë për Masë të përkohshme, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, e papranueshme, qartazi e pabazuar

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Deçan dhe të Gjykatës Supreme përkitazi me kërkesën e parashtruesve për vërtetimin e pronësisë së pronës së paluajtshme në bazë të trashëgimisë.

Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese të suspendojë përkohësisht Aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe të ndërpritet ekzekutimi dhe tjetërsimi i patundshmërisë deri sa Gjykata Kushtetuese të nxjerrë një vendim për këtë çështje.

Parashtruesit pretendojnë se aktgjykimi i gjykatës i ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar sepse faktet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tyre për shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe parashtruesit nuk kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme si dhe pse aktgjykimi i Gjykatës Supreme i kishte shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë.

Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese refuzoi kërkesën e parashtruesve për Masë të përkohshme, sepse nuk ka rast *prima facie* për shqiptimin e masës së përkohshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI28/14
Parashtrues
Skender Mezini dhe Ferbend Haxhijaj
Vlerësimi i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 26/2012,
të 16 shtatorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Skender Mezini dhe z. Ferbend Haxhijaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit), shtetas të Republikës së Shqipërisë me banim në Durrës, Republika e Shqipërisë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 26/2012, të 16 shtatorit 2013, të cilin parashtruesit e kanë pranuar më 11 nëntor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Deçan (C. nr. 54/2010, të 5 shkurtit 2010) dhe të Gjykatës Supreme (Rev. nr. 26/2012, të 16 shtatorit 2013) përkitazi me kërkesën e parashtruesve për vërtetimin e pronësisë së pronës së paluajtshme në bazë të trashëgimisë.

4. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të "*SUSPENDOHET PËRKOHESISHT Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Deçan C. nr. 54/2009 dt. 05.02.2010 dhe ndërpritet ekzekutimi dhe tjetërsimi i patundshmërisë në qfarëdo mënyre deri në përfundimin e kësaj qështje juridiko civile*".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 10 shkurt 2014, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatë.

7. Më 6 mars 2014, Kryetari i Gjykatës, në bazë të Vendimit nr. GJR. KI28/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, në bazë të Vendimit nr. KSH. KI28/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

8. Më 25 mars 2014, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe iu kërkoi të kompletojnë kërkesën e tyre.

9. Më 10 prill 2014, parashtruesit i dërguan Gjykatës kopjet e aktgjykimeve të kontestuara.

10. Më 10 prill 2014, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme lidhur me kërkesën. Të njëjtën ditë, Gjykata i kërkoi Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Deçan, që të sigurojë një kopje të fletëkthesës, e cila tregon se kur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 26/2012, i 16 shtatorit 2013.

11. Më 16 prill 2014, Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Deçan, dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën, e cila tregon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 26/2012, i 16 shtatorit 2013, iu është dorëzuar parashtruesve më 11 nëntor 2013.

12. Më 19 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme dhe ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

13. Në vitin 2002, parashtruesit dhe anëtarë tjerë të familjes, kundër poseduesve të pronave të paluajtshme në Junik, në bazë të trashëgimisë kishin paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Deçan, duke kërkuar vërtetimin e pronësisë së këtyre pronave të paluajtshme.

14. Parashtruesit kishin pretenduar që paluajtshmëritë e kontestuara kishin qenë pronë e paraardhësit të tyre me prejardhje nga Juniku.

15. Më 8 dhjetor 2006, Gjykata Komunale, përmes Aktgjykimit, C. nr. 208/2002, kishte vërtetuar se parashtruesit dhe paditësit e tjerë, në bazë të trashëgimisë janë pronarë të paluajtshmërive dhe kishte detyruar poseduesit që paluajtshmëritë e evidentuara si ngastra kadastrale me numra përkatës në bazë të fletëposedimit, t'ua dorëzojnë parashtruesve dhe paditësve të tjerë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pasi që aktgjykimi të ketë marrë formë të prerë.

16. Bazuar në kronologjinë e procedurës së zhvilluar pas aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Komunale, C. nr. 208/2002, duket se lënda ka qenë kthyer në Gjykatën Komunale për rishqyrtim.

17. Më 5 shkurt 2010, Gjykata Komunale në Deçan, përmes Aktgjykimit C. nr. 54/09, kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesve dhe paditësve të tjerë për vërtetimin e pronësisë së paluajtshmërive në bazë të trashëgimisë.

18. Gjykata Komunale, bazuar në historikun e Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi dhe Pronë të Deçanit, si dhe vlerësimit të ekspertëve, kishte vërtetuar se paraardhësit e të paditurve të drejtën e pronësisë e kishin fituar në bazë të punës së vlefshme juridike për fitimin e së drejtës së pronësisë.

19. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Deçan, C. nr. 54/09, të 5 shkurtit 2010, parashtruesit dhe paditësit e tjerë paraqitën ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

20. Më 10 tetor 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktgjykimin Ac. nr. 145/10, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve dhe paditësve të tjerë dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Deçan, C. nr. 54/09, të 5 shkurtit 2010.

21. Gjykata e Qarkut në Pejë, po ashtu kishte vërtetuar se paraardhësit e të paditurve, të drejtën e pronësisë e kishin fituar në bazë të kontratave për shitblerje të lidhura në formë të shkruar dhe të vërtetuara në Gjykatë dhe si rrjedhojë e posedimit të këtyre paluajtshmërive mbi 20 vjet si posedues të ligjshëm, të paditurit e kishin fituar të drejtën e pronësisë.

22. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, parashtruesit dhe paditësit e tjerë me pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, kishin paraqitur revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

23. Më 16 shtator 2013, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar revizionin e paraqitur nga parashtruesit dhe paditësit e tjerë.

24. Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj, konstatoi si në vijim:

[...]

"Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë drejt e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësve dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për çka ka dhënë arsye të mjaftueshme cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Gjykatat e instancës më të ulet me të drejtë kanë vlerësuar se të paditurit e kane fituar te drejtën e pronësisë në bazë të kontratave mbi shitblerjen, të lidhura në formën e shkruar, në mënyrën e parashikuar në bazë të Ligjit mbi Qarkullimin e Patundshmërive, të nënshkruara nga palët kontraktuese dhe të vërtetuara në Gjykatën Komunale në Pejë, e cila në baze të dispozitave të Ligjit për Qarkullimin e Patundshmërisë përfaqëson punë të vlefshme juridike, për fitimin derivativ të drejtës së pronësisë në bazë të nenit 20 par. 1 të Ligjit mbi Bazat e Marrëdhënieve Juridike-Pronësore dhe në bazë të nenit 36 te Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore. Të paditurit kanë qenë edhe posedues të ligjshëm dhe me mirëbesim duke e mbajtur patundshmërinë mbi 20 vjet, e cila gjithashtu është baze për të fituar të drejtën e pronësisë.

[...]

Gjykata e shkallës se dytë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye në të gjitha pretendimet ankimore, përfshirë edhe deklaratat e dëshmitarëve, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se është i pabazuar pretendimi i përsëritur në revizion se gjykata nuk ka vlerësuar faktin se paraardhësit të paditësve me rastin kur është larguar nga Kosova patundshmërinë ia ka lënë ne ruajtje paraardhësve te padituve".

Pretendimet e parashtruesit

25. Parashtruesit pretendojnë se aktgjykimi i gjykatës i ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

26. Në lidhje me këtë, parashtruesit pohojnë si në vijim:

"Mes tjerash, parashtruesit konsiderojn se atyre nuk u eshte mundesuar si trashegimtar nga radha e pare e trashegimise te gezojne te drejten ne pronesin e paraardhesve te tyre.
Aq ma teper kur dihen rrethanat dhe mundesit e asaj kohe ku realishte parashtruesit nuk kane patur asnji mundesi e as teorike te kerkojne realizimin e te drejtes ne trashegimi duke patur parasyshe situaten politike ne ate kohe si ne Shqiperi ashtu edhe ne ishe jugosllavi.
Pos tjerash, eshte theksue se te njejtit si qytetare pa dijeni juridike dhe pa ndikim ne gjykatat e rregullta jane manipuluar dhe mashtruar."

27. Parashtruesit përfundojnë duke kërkuar si në vijim:

"[...] shfuqizimin e Aktgjykimit te plotfuqishem te Gjykates Komunale ne Deçan C.nr. 54/2010 si dhe Aktgjykimit te Gjykates Supreme Rev. Nr. 26/2012".

"SUSPENDOHET PERKOHESISHTE Aktgjykimi i Gjykates Komunale ne Dcean C. nr. 54/2009 dt. 05.02.2010 dhe ndërpritet ekzekutimi dhe tjetërsimi i patundshmerise ne qfaredo menyre deri ne përfundimin e kësaj qeshtje juridiko civile".

Pranueshmëria e kërkesës

28. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës të Gjykatës.

29. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

30. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa është qartazi e bazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...], ose*
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*
>
> *[...], ose*
>
> *d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

31. Ashtu siç u cek më lart, parashtruesit pretendojnë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 26/2012, i 16 shtatorit 2013, i ka shkelur të drejtat e tyre, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

32. Në lidhje me këtë, parashtruesit fare nuk kanë shpjeguar si dhe pse aktgjykimi i Gjykatës Supreme kishte shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë.

33. Parashtruesit vetëm pohojnë se *"[...] atyre nuk u eshte mundesuar si trashegimtar nga radha e pare e trashegimise te gezojne te drejten ne pronesin e paraardhesve te tyre. [...] se te njejtit si qytetare pa dijeni juridike dhe pa ndikim ne gjykatat e rregullta jane manipuluar dhe mashtruar"*.

34. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese ripërsërit se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

35. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesit të kenë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).

36. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat në gjykatat e rregullta nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).

37. Për më tepër, Gjykata Supreme, në aktgjykimin e saj, gjeti se [...]"*Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë drejt e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësve dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për çka ka dhënë arsye të mjaftueshme cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Gjykatat e instancës më të ulet me të drejtë kanë vlerësuar se të padituri e kane fituar te drejtën e pronësisë në bazë të kontratave mbi shitblerjen, të lidhura në formën e shkruar, në mënyrën e parashikuar në bazë të Ligjit mbi Qarkullimin e Patundshmërive*

[...]".

38. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesit në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tyre për shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe parashtruesit nuk kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme si dhe pse aktgjykimi i Gjykatës Supreme i kishte shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë.

Kërkesa për masë të përkohshme

39. Ashtu siç u cek më lart, parashtruesit gjithashtu kërkojnë nga Gjykata të "*SUSPENDOHET PËRKOHËSISHT Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Deçan C. nr. 54/2009 dt. 05.02.2010 dhe ndërpritet ekzekutimi dhe tjetërsimi i patundshmërisë në çfarëdo mënyre deri në përfundimin e kësaj çështje juridiko civile*".

40. Parashtruesit nuk kanë paraqitur ndonjë argument dhe as nuk kanë paraqitur ndonjë evidencë pse dhe si masa e përkohshme është e nevojshme.

41. Në mënyrë që Gjykata të lejojë një masë të përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, ajo duhet të përcaktojë se:

> *"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të*
> *pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe*
>
> *(...)*
>
> *Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do ta rekomandojë refuzimin e kërkesës".*

42. Siç u konstatua më lart, kërkesa është e papranueshme dhe, për këtë arsye, nuk ka rast *prima facie* për shqiptimin e masës së përkohshme. Për këto arsye, refuzohet kërkesa për masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) dhe d), 55 (4) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 13 qershor 2014, njëzëri:

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI01/14, Qazim Dragusha, Aktvendim i datës 2 prill 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0035, të 23 nëntorit 2012

Rasti KI01/14, vendimi i 2 prillit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, e paafatshme

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktvendimin ASC-11-0035, të 23 nëntorit 2012 konstatoi se kërkesa e parashtruesit është e paafatshme duke shpallur kërkesën të papranueshme në baza procedurale.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se për shkak të sëmundjes ai nuk mundi ta parashtrojë kërkesën në kohë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke pretenduar shkeljen e neneve 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si të paafatshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk e ka dorëzuar kërkesën e tij brenda afateve ligjore të përcaktuara me Ligj dhe të specifikuara më tej në Rregulloren e punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI01/14
Parashtrues
Qazim Dragusha
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0035, të 23 nëntorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Qazim Dragusha, i përfaqësuar nga z. Bejtush Isufi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0035, të 23 nëntorit 2012, i cili i është dorëzuar atij më 12 janar 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, i cili pretendohet se *"është diskriminues në dëm të parashtruesit të kërkesës, sepse nuk kishte marrë parasysh të gjitha provat e paraqitura nga ai, duke e privuar atë nga e drejta për një pjesë të të ardhurave, të fituara nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore 'Ramiz Sadiku' në Prishtinë"*.

4. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të

Paanshëm], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 3 janar 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 30 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI01/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI01/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 26 shkurt 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme) për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 11 mars 2014, Gjykata kërkoi informata shtesë nga parashtruesi i kërkesës dhe nga Dhoma e Posaçme.

10. Më 13 mars 2014, Dhoma e Posaçme i dorëzoi informatat shtesë të kërkuara nga Gjykata.

11. Më 2 prill 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Gjatë një periudhe të caktuar kohore, parashtruesi i kërkesës ishte punonjës i NSH “Ramiz Sadiku”.

13. Më 27 qershor 2006, NSH “Ramiz Sadiku” ishte privatizuar.

14. Më 4, 5 dhe 7 mars 2009, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) e ka publikuar listën përfundimtare të

punëtorëve të kualifikuar për një pjesë të 20% të të ardhurave nga privatizimi. Afati i fundit për të ushtruar ankesë kundër listës në fjalë ishte 27 marsi 2009.

15. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër listës përfundimtare të punëtorëve më 30 mars 2009.

16. Më 24 shkurt 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme, me Aktvendimin SCEL-09-0001, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme, për shkak se ishte e paafatshme.

17. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Kolegjin për Ankesa të Dhomës së Posaçme, me pretendim se ai e kishte dorëzuar ankesën në Trupin gjykues vetëm tri ose 4 (katër) ditë pas afatit dhe se Trupi gjykues është dashur ta marrë parasysh faktin se parashtruesi i kërkesës kishte vështirësi objektive për të dorëzuar ankesën me kohë.

18. Më 23 nëntor 2012, Kolegji për Ankesa i Dhomës së Posaçme, me Aktvendimin ASC-11-0035, e vërtetoi aktvendimin e Trupit gjykues dhe e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar.

19. Në aktvendimin e lartcekur, Kolegji për Ankesa i Dhomës së Posaçme, *inter alia*, arsyetoi: *"Trupi gjykues ka vlerësuar drejt që ankesat kundër listës përfundimtare, të cilat ata i kanë dorëzuar pas 27 marsit 2009, janë të paafatshme. Pasi që ankuesit nuk kanë paraqitur kërkesë për kthim në Trupin gjykues, nuk është relevante nëse ata e kanë humbur afatin me fajin e tyre apo jo".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"... për arsye shëndetësore kam lëshuar afatin, sepse gjatë periudhës së paraparë për ankesë isha i sëmurë nga sëmundja e zemrës çka dëshmohet edhe në bazë të raporteve mjekësore të cilat do të ju bashkangjes më vonë me ane ten je parashtrese sepse dokumentacionin nuk e kam me vete pasi qe i kam dorezuar ne Dhome te Posaçme".*

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"...si pasoje e sëmundjes gjatë gjithë kohës qëndroja i shtrirë në shtëpi në gjendje të rëndë shëndetësore, sepse nuk mund të ngrihesha nga shtrati e të dal dhe të informohem nga të tjerët lidhur me afatin".*

22. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se *"... edhe pse i plotësova të gjitha kushtet te cilat kërkohen që të jem i përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve me te drejte të 20%, prapë se prapë nuk jam përfshirë në këtë listë"*.

23. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

26. Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi"*.

27. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> > *b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi"*.

28. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se vendimi i fundit, ndaj të cilit ankohet parashtruesi i kërkesës, i është dorëzuar atij më 12 janar

2013, përderisa kërkesa është dorëzuar në Gjykatë më 3 janar 2014.

29. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit katër mujor, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, pasi që ajo ishte dorëzuar në Gjykatë gati një vit pasi që vendimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës.

30. Gjykata përkujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, është të promovojë siguri
ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme si dhe vendimet e kaluara të mos jenë vazhdimisht të hapura për kontestim (shih rastin *O'LOUGHLIN dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi i 25 gushtit 2005).

31. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 2 prill 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI10/14, Shoqëria aksionare Raiffeisen Bank Kosovë SH. A, Aktgjykim i datës 20 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CN. nr. 7/2013, të 19 tetorit 2013

Rasti KI10/14, vendimi i 20 majit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm

Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i kontestuar përbën shkelje të nenit 3.2 [Barazia para Ligjit], nenit 24.1 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme e ka shkelur rëndë parimin e kontradiktoritetit, sepse ajo e kishte deklaruar të pranueshme kërkesën e E. N. për kthim në gjendje të mëparshme, pa e njoftuar dhe pa e thirrur parashtruesin që të marrë pjesë në procedurë.

Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur mundësi të paraqesë rastin e tij, duke përfshirë edhe provat, pasi që rasti tashmë kishte përfunduar, dhe, si një palë e interesuar në procedurë, ai ishte vënë në disavantazh të konsiderueshëm vis-à-vis kundërshtarit të tij E. N.

Gjykata konkludon se ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit, dhe rregullit 56 (1) dhe rregullit 74 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 20 maj 2014, njëzëri deklaron kërkesën të pranueshme dhe konstaton se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

AKTGJYKIM
në
Rastin nr. KI10/14
Parashtrues
Shoqëria aksionare Raiffeisen Bank Kosovë SH. A.
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CN. nr. 7/2013,
të 19 tetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shoqëria aksionare Raiffeisen Bank Kosovë SH. A., me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), e përfaqësuar nga z. Dastid Pallaska, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, CN. nr. 7/2013, i 19 tetorit 2013, i cili pretendohet të jetë marrë pa e njoftuar dhe pa e ftuar parashtruesin e kërkesës që të marrë pjesë në procedurë sipas kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme.

3. Ky aktgjykim i është dorëzuar parashtruesit më 5 dhjetor 2013.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet "*t'i ketë shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit, të garantuara me nenin 3.2 [Barazia para Ligjit], nenin 24.1 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta*

për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore" [në tekstin e mëtejmë: KEDNJ].

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 28 janar 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 7 shkurt 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy, Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 10 shkurt 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 20 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 18 qershor 2002, Banka Amerikane e Kosovës, si paraardhëse juridike e parashtruesit të kërkesës (në tekstin e mëtejmë: paraardhësja e parashtruesit), kishte lidhur kontratë pune me E. N., qytetar i Kosovës. Neni 1 i kësaj kontrate parashihte kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve si punë provuese. Gjatë asaj periudhe, të dyja palët kishin të drejtë që ta shkëpusnin kontratën me 24 orë paralajmërim, pa kurrfarë dëmshpërblimi apo kompensimi.

11. Më 13 shtator 2002, paraardhësi i parashtruesit të kërkesës i dërgoi E. N. njoftimin lidhur me shkëputjen e kontratës, duke ia njohur atij të drejtën e pagesës deri në fund të muajit shtator dhe një rrogë bonus për muajin tetor 2002.

12. Më 30 tetor 2002, E. N. kishte paraqitur kërkesë për rishqyrtimin e vendimit për mosvazhdimin e kontratës ashtu që ta angazhonte atë në njërën nga filialet e parashtruesit të kërkesës, në njërin nga qytetet e Kosovës.

13. Më 10 nëntor 2002, parashtruesi i kërkesës konfirmoi se vendimi për mosvazhdimin e kontratës së punësimit ishte përfundimtar.

14. Më 21 nëntor 2002,6 E. N. kërkoi nga Gjykata Komunale në Prishtinë që të prishë vendimin për ndërprerjen e kontratës së punës.

15. Më 14 tetor 2009, Gjykata Komunale (Aktgjykimi nr. C1. 32/2006) e miratoi padinë e E. N. si të bazuar dhe e anuloi vendimin e parashtruesit të kërkesës të 10 nëntorit 2002.

16. Më 8 dhjetor 2009, parashtruesi paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

17. Më 16 shtator 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi Ac. nr. 118/2010) e aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të bazuar dhe e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale, duke e miratuar ankesën e parashtruesit si të bazuar. Gjykata e Qarkut arsyetoi se "*gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të shqyrtuara e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe në arsyetimin e aktgjykimit ankimor ka paraqit arsye të plota dhe të kuptueshme lidhur me faktet vendimtare, mirëpo gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar*".

18. Më 12 tetor 2011, E. N. parashtroi revizion në Gjykatën Supreme për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

19. Më 3 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigje me shkrim lidhur me revizionin, duke pohuar se E. N. ishte plotësisht në dijeni për kushtet e kontratës së punësimit dhe duke i sugjeruar Gjykatës Supreme që, në rrethana të ngjashme, në rastin Rev. 49/2005, Gjykata Supreme ka refuzuar revizionin dhe se ai vendim do të duhej të merrej parasysh gjatë vendosjes së rastit së E. N.

20. Më 21 janar 2013, Gjykata Supreme (Rev. nr. 333/2011) hodhi poshtë revizionin si të paafatshëm. Gjykata Supreme konkludoi se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut ishte pranuar nga përfaqësuesi i E.

N. më 3 shtator 2011, përderisa kërkesa për revizion ishte dorëzuar më 12 tetor 2011, që do të thotë 9 (nëntë) ditë pas afatit të përcaktuar prej 30 (tridhjetë) ditësh.

21. E. N. parashtroi në Gjykatën Supreme kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme.

22. Më 19 tetor 2013, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin e kontestuar, C. nr. 7/2013, duke miratuar kërkesën e E. N. për kthim në gjendje të mëparshme. Në aktgjykim thuhet se përfaqësuesi i E. N. e pranoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut më 1 tetor 2011, kurse në fletëkthesë shkruan data 3 shtator 2011. Revizioni ishte dorëzuar më 12 tetor 2011. Kësisoj, Gjykata Supreme konkludoi se revizioni ishte dorëzuar brenda 30 (tridhjetë) ditësh, ashtu siç kërkohet në bazë të nenit 211 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

23. Në dispozitiv të aktgjykimit të kontestuar thuhet si në vijim:

"I. LEJOHET kërkesa e paditësit për kthimin në gjendje të mëparshme, prishet aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 333/2011 datë 21.01.2013.

II. Pranohet si i themeltë revizioni i paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 118/2010 datë 16.09.2011, ashtu që NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 118/2010 datë 16.09.2011, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, Cl. nr. 32/2006 datë 14.10.2009, mbetet në fuqi në pjesën I e dispozitivit, që i referohet anulimit të vendimit të paditurës dt 10.11.2002, në bazë të të cilit në procedurën e rishqyrtimit sipas kërkesës së paditësit është vërtetuar vendimi i shkallës së parë i datës 13.09.2002, në bazë të të cilit paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës si dhe pjesa II e dispozitivit, që i referohet detyrimit të paditurës që paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës që i përgjigjet pregaditjes së tij profesionale.

Pjesa II e dispozitivit, të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, Cl. nr. 32/2006 datë 14.10.2009, në pjesën që i referohet kthimit të paditësit në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës nga data 01.10.2002, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi, PRISHET dhe lënda i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Pjesa III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, Cl. nr. 32/2006 datë 14.10.2009, që i referohet shpenzimeve të procedurës mbetet e pashqyrtuar".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i kontestuar përbën shkelje të nenit 3.2 [Barazia para Ligjit], nenit 24.1 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme e ka shkelur rëndë parimin e kontradiktoritetit, sepse ajo e kishte deklaruar të pranueshme kërkesën e E. N. për kthim në gjendje të mëparshme, pa e njoftuar dhe pa e thirrur parashtruesin që të marrë pjesë në procedurë.

26. Parashtruesi i kërkesës e bazon arsyetimin në praktikën gjyqësore të Gjykatës, përkatësisht në rastet KI103/10 dhe KI108/10.

27. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata *"ta shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të* Kosovës *CN. Nr. 7/2013, të datës 19 tetor 2013, dhe e kthen lëndën për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese."*

Pranueshmëria e kërkesës

28. Para së gjithash, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

30. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 dhe 49 të Ligjit, të cilët parashohin:

"**Neni 48**

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".

31. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, se e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit kohor prej 4 (katër) muajve siç parashihet me ligj, se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj dhe ka qartësuar në mënyrë të saktë cilat të drejta dhe liri i janë shkelur, si dhe ka treguar aktin e kontestuar të autoritetit publik.

32. Prandaj, kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë.

Dispozitat përkatëse juridike lidhur me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme

33. Kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme është e rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, të 20 shtatorit 2008, në nenet vijuese.

Neni 129

1. Në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen.
2. Kur lejohet kthimi në gjendje të mëparshme procesi kontestimor kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhej para mosveprimit dhe prishen të gjitha vendimet që i ka dhënë gjykata për shkak të mosveprimit.

Neni 131

Nuk lejohet kthimi në gjendje të mëparshme nëse nuk është ruajtur afati për paraqitjen e propozimit për kthimin në gjendje të mëparshme apo nëse pala nuk ka ardhur në seancën e caktuar për shqyrtimin e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme.

Neni 132

1. Propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme zakonisht nuk ndikon në rrjedhën e procedimit, por gjykata mund të vendos që procedimi të ndërpritet derisa të bëhet i formës së prerë aktvendimi mbi propozimin.
2. Në qoftë se është paraqitur propozimi për kthimin në gjendjen e mëparshme gjatë zhvillimit të procedurës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë duhet ta njoftojë për propozimin e paraqitur gjykatën e shkallës së dytë.

Neni 133

1. Propozimin e paraqitur pas afatit, apo propozimin e palejueshëm për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata e hedhë poshtë me anë të aktvendimit.
2. Lidhur me propozimin për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata cakton séancë vetëm kur një gjë të tillë e propozon pala shprehimisht. Po që se faktet në të cilat mbështetet propozimi janë të ditura botërisht (notore) gjykata nuk cakton seancë në asnjë rast. Po në këtë mënyrë gjykata vepron edhe kur faktet në të cilat mbështetet propozimi janë qartë të pajustifikueshme, por edhe kur gjykata ka prova të mjaftueshme në dosjen e lëndës për dhënien e vendimit sipas propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme.
3. Kundër aktvendimit me të cilin aprovohet propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme nuk lejohet ankim i veçantë.
4. Kundër aktvendimit me të cilin refuzohet propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme nuk lejohet ankim i veçantë, përveç kur propozimi paraqitet nga shkaku i dhënies së aktgjykimit për shkak të mungesës së palës së paditur nga seanca gjyqësore.

Aspektet substanciale juridike të kërkesës

34. Siç u cek më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Supreme i kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31. të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe të neneve 3.2 dhe 24.1 (Barazia para Ligjit) të Kushtetutës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31.1 dhe 2 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

36. Në anën tjetër, neni 53 i Kushtetutës parasheh:

> *"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

37. Për më tepër, neni 6.1 i KEDNJ-së:

> *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme... në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile".*

38. Në fakt, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të marrë një vendim të gjykatës në përputhje me ligjin. Përveç kësaj, e drejta për një shqyrtim të drejtë, siç mishërohet në nenin 31 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, është e natyrës thelbësore për të mbrojtur të drejtat themelore.

39. Gjykata thekson se e drejta themelore për gjykim të drejtë rrjedh nga e drejta themelore për mbrojtje gjyqësore, e garantuar me nenin 54 të Kushtetutës. Më shumë se të drejtat e tjera themelore, e drejta për gjykim të drejtë kërkon që gjyqtarët të jenë të kujdesshëm, pasi që ata janë gjithmonë në rrezik për ta shkelur atë

të drejtë. Në të vërtetë, e drejta për gjykim të drejtë është një referencë e përgjithshme për një kompleks të të drejtave të tjera: konkretisht, e drejta për qasje në gjykata, e drejta për të paraqitur argumente dhe prova, parimet e adversialitetit dhe të barazisë së armëve.

40. Gjykata po ashtu rikujton se ndikimi i nenit 6.1 është *inter alia* që ta obligojë "gjykatën të bëjë shqyrtim të mirëfilltë të parashtresave, të argumenteve dhe të provave të paraqitura nga palët, dhe të vlerësojë, pa paragjykim, nëse ato janë relevante për vendimin e saj" (shih GJEDNJ, *Kraska kundër Zvicrës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1993, Seria A nr. 254-B, f. 49, § 30).

41. Parimi i "barazisë së armëve" në mes të palëve në një rast është një kusht thelbësor i shqyrtimit të drejtë. Barazia e armëve, e cila duhet të respektohet gjatë tërë procesit të gjykimit, do të thotë që palët duhet të trajtohen në atë mënyrë, duke siguruar që ato të kenë pozitë procedurale të barabartë gjatë zhvillimit të gjykimit, dhe të jenë në pozitë të barabartë për të paraqitur rastin e tyre. (shih aktgjykimet e GJEDNJ-së në rastet *Ofrer dhe Hopfinger*, nr 524/59 dhe 617/59, 19.12.60, Vjetari 6, f. 680 dhe 696). Kjo do të thotë që secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj, në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të konsiderueshëm *vis à vis* palës kundërshtare.

42. Gjykata më tej rikujton se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka përcaktuar se " *kërkesa e "barazisë së armëve", në kuptimin e një "ekuilibri të drejtë" midis palëve, vlen në parim për raste të tilla [lëndë civile lidhur me të drejtat dhe detyrimet civile] si dhe për rastet penale" dhe "çështje gjyqësore që përfshijnë interesa private të kundërta, "barazia e armëve" nënkupton që secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj - duke përfshirë provat e saj - në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të konsiderueshëm vis-à-vis kundërshtarit të saj"* (shih *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës,* aktgjykimi i 27 tetorit 1993, Seria A, nr. 274).

43. Mungesa e ftesës për një rast ose të njoftimit për vendimin e marrë lidhur me rastin, i cili ndikon ose ndërhyn në ushtrimin e të drejtave (civile) të një personi, është *a fortiori* një disavantazh i konsiderueshëm *vis a vis* palës kundërshtare. Për më tepër, kur ka dy (ose edhe tri) nivele të juridiksionit, procedura ankimore duhet gjithmonë të shoqërohet me garancitë e paraqitura në nenin 6. (shih *Ekbatani kundër Suedisë*, Aktgjykimi, 26 maj 1988, nr. 10563/83 § 26ss).

44. Gjykata konsideron se praktika gjyqësore e shqyrtuar në mënyrë të arsyeshme lejon që të arrihet në përfundim se barazia e armëve *"nuk është e zbatueshme vetëm në procedurat të cilat tashmë janë në zhvillim e sipër",* por edhe kur njëra palë *"nuk ka pasur mundësinë që ta paraqesë"* pikëpamjen e saj në gjykatë në çfarëdo faze të procedurës.

45. Faktet e rastit tregojnë se Gjykata Supreme nuk e ka njoftuar parashtruesin e kërkesës për ekzistencën e procedurës lidhur me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme, të parashtruar nga E. N. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës ka kuptuar për procedurën për kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme vetëm kur e ka pranuar aktgjykimin e kontestuar.

46. Kështu, parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur mundësi të paraqesë rastin e tij, duke përfshirë edhe provat, pasi që rasti tashmë kishte përfunduar, dhe, si një palë e interesuar në procedurë, ai ishte vënë në një disavantazh të konsiderueshëm *vis-à-vis* kundërshtarit të tij E. N.

47. Për më tepër, Gjykata merr parasysh se parashtruesi i kërkesës ishte në dijeni se "*Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor*" (Neni 103 i Kushtetutës). Kështu që parashtruesi i kërkesës, me arsye, mund të ketë qenë i bindur se kishte marrë një vendim përfundimtar dhe detyrues me të cilin ishte mbyllur përfundimisht kontesti i punës.

48. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme ka kryer shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së me rastin e rihapjes së rastit pa e njoftuar parashtruesin e kërkesës, pa ofruar mundësinë për të prezantuar argumente, dhe pa e dëgjuar palën tjetër.

49. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rastit Grozdanoski (shih *Grozdanoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 21510/03, të 31 majit 2007). Në këtë rast, prokurori publik paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Pala tjetër nuk ishte njoftuar kurrë lidhur me atë kërkesë. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë çoi në vendimin e Gjykatës Supreme, e cila ishte në disavantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër. GJEDNJ-ja ka konsideruar se dështimi procedural për të njoftuar palën tjetër e ka penguar atë nga pjesëmarrja në mënyrë efektive në procedurë para Gjykatës Supreme të Maqedonisë.

50. Për më tepër, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore duke vënë në dukje se në rrethana të ngjashme e kishte deklaruar kërkesën e pranueshme dhe kishte gjetur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së. (shih, Gjykata Kushtetuese, rasti KI103/10, Aktgjykimi i 12 prillit 2012). Ngjashëm, Gjykata kishte vendosur se *"parashtruesi është dashur të thirrej në procedurë gjyqësore jo vetëm për të pasur njohuri për ekzistimin e saj, por edhe për t'i parashtruar argumentet dhe provat gjatë rrjedhës së procedurës"*. (shih po ashtu Gjykata Kushtetuese, Rasti KI108/10, *Fadil Selmanaj* – Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 170/2009 të 25 shtatorit 2009).

51. Prandaj, Gjykata konkludon se ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe neni 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit, dhe rregullit 56 (1) dhe rregullit 74 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 20 maj 2014, njëzëri:

I. DEKLARON kërkesën të pranueshme;

II. KONSTATON se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;

III. SHPALL të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, CN. nr. 7/2013, të 19 tetorit 2013;

IV. IA KTHEN Gjykatës Supreme Aktgjykimin CN. nr. 7/2013, të 19 tetorit 2013, për rishqyrtim në pajtim me këtë aktgjykim të Gjykatës;

V. URDHËRON Gjykatën Supreme që, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, t'i dorëzojë informacione Gjykatës Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij aktgjykimi të Gjykatës;

VI. MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të këtij Urdhri;

VII. URDHËRON që ky aktgjykim t'u komunikohet palëve;

VIII. PUBLIKON këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IX. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 93/12, Imer Ibriqaj, Aktvendim i datës 11 mars 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 03V-115, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 4 qershorit 2009

Rasti KI 93/12, vendimi 11 marsit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale,procedura e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, kërkesa qartazi e pabazuar.

Parashtruesi kërkesën e tij e ka bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës Kosoves,duke e kontestuar në menyrë të veqaantë Vendimin nr. 03V-115, të Kuvendit të Republikes së Kosoves. Megjithatë, vendimi i fundit në këtë rast është aktvendimi A. nr. 594/09, I Gjykatës Supreme i datës 23 shkurt 2011.

Parashtruesi kishtë kandiduar në konkursin për "Avokat të Popullit",mirpo nuk ishte ftuar në mesin e 23(njëzet e tre) kandidatëve për intervistim,ndërsa pas intervistimit në Kuvendin e Kosovës ishin propozuar 3(tre) kandidatë,ku ishte zgjedhur si Avokat i Popullit z.Sami Kurteshi me Vendimin nr. 03V-115.

Parashtruesi kishte bër ankes kunder këtij vendimi në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe në Zyren Ndërkombëtare Civile, por ankesa e tij ishte refuzuar.Andaj parashtruesi pretendon se kërkesa e tij ishte refuzuar *në mënyre të paligjshme* nga Kuvendi i Kosoves dhe se emërimi i Avokatit të tanishem të Popullit ishte bërë në mënyrë të paligjshme dhe të padrejtë Gjykata Kushtetuese vëren se në këtë rastë , kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshte si e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullorës së punës.

Gjykata vendimin e sajë e arsyeton me faktin që, nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Eshte roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale ,duke ju referuar një rasti praktik në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut(shih, *mutatis mutandis,* Garcia Ruiz kunder Spanjes [DHM], nr. 30544/96,).

Gjykata më tej theksonë që në rastin në fjalë,janë plotësuar garancite procedurale të së drejtës për një gjykim të drejtë, siq parashikohet me Kushtetutë dhe me Konventë, nuk ka asnje gjurme të arbitraritetit nga ana e Gjykatës Supreme. Fakti se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të paraqesë kërkesë të pranueshme për shkeljë të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshem].Për

shkak të arsyeve të përmënduar,Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI93/12
Parashtrues
Imer Ibriqaj
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 03V-115, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 4 qershorit 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan,
gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Imer Ibriqaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), me vendbanim në Gllogovc.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi në kërkesë e konteston në mënyrë të veçantë Vendimin nr. 03V-115, të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi i Kosovës), të 4 qershorit 2009.

3. Megjithatë, vendimi i fundit në këtë rast është aktvendimi A. nr. 594/09, i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), i 23 shkurtit 2011, pranuar nga parashtruesi më 13 shtator 2012.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Supreme të Kosovës.

5. Pa marrë parasysh këtë, parashtruesi në kërkesë e konteston Vendimin nr. 03V-115, të Kuvendit të Kosovës, të 4 qershorit 2009.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

7. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën më 20 shtator 2012.

8. Më 31 tetor 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI93/12, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI93/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Enver Hasani.

9. Më 26 nëntor 2013, Gjykata Supreme u njoftua lidhur me kërkesën.

10. Më 11 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Kërkesa e mëparshme e parashtruesit në Gjykatë

11. Më 18 mars 2011, Gjykata Kushtetuese, në rastin e mëparshëm të parashtruesit, Rasti Nr. KI34/09, e shpalli kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Kuvendit të Kosovës, Vendimit nr. 03V-115, të 4 qershorit 2009, si të papranueshme.

12. Në atë rast, parashtruesi i kërkesës pretendoi se emërimi i Avokatit aktual të Popullit ishte *"i paligjshëm dhe i padrejtë"*. Në atë drejtim, Gjykata gjeti se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjit të zbatueshëm, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit, sepse rasti ishte në procedurë në Gjykatën Supreme. Procedura e përmendur kishte përfunduar me nxjerrjen e Aktvendimit A. nr. 549/09, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të cilin parashtruesi e konteston në rastin konkret.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 13 mars 2010, parashtruesi kishte paraqitur kërkesë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pas konkursit të shpallur për pozitën e Avokatit të Popullit.

14. Më 18 maj 2010, Komisioni përzgjedhës ia paraqiti raportin e tij Kuvendit të Kosovës, duke i rekomanduar tre (3) kandidatë potencialë për pozitën e Avokatit të Popullit. Përveç raportit, Komisioni përzgjedhës kishte bashkëngjitur një listë, që përmbante pikët e njëzet e tre (23) kandidatëve që ishin intervistuar.

15. Parashtruesi nuk ishte në mesin e njëzet e tre (23) kandidatëve që ishin ftuar për intervistë.

16. Më 4 qershor 2010, ishte mbajtur një mbledhje e Kuvendit me qëllim të përzgjedhjes së Avokatit të Popullit. Të njëjtën ditë, Kryetari i Kuvendit, mori Vendimin nr. 03V-115, duke e emëruar z. Sami Kurteshi si Avokat të Popullit të Republikës së Kosovës.

17. Parashtruesi ushtroi ankesë në Kuvendin e Kosovës dhe në Zyrën Ndërkombëtare Civile kundër procesit të përzgjedhjes.

18. Më 29 korrik 2009, parashtruesi inicioi procedurë administrative në Gjykatën Supreme.

19. Më 23 shkurt 2011, Gjykata Supreme, me Vendimin A. nr. 594/09, e refuzoi padinë e parashtruesit, duke theksuar se emërimi i Avokatit të Popullit është kompetencë e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

20. Në aktvendimin e lartpërmendur, Gjykata Supreme argumentoi më tej: *"Në përputhje me dispozitën e nenit 9 par 3 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ("Gazeta zyrtare e RSFJ" nr. 4/77) ligj i zbatueshëm në përputhje me nenin 145 par. 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për çështjet rreth të cilave drejtpërdrejt, në bazë të autorizimeve kushtetuese vendos Kuvendi i Kosovës, konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet".*

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi pretendon se kërkesa e tij ishte refuzuar *"në mënyrë të paligjshme"* nga Kuvendi i Kosovës dhe se emërimi i Avokatit të

tanishëm të Popullit *"ishte bërë në mënyrë të paligjshme dhe të padrejtë"*.

22. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata kthimin në gjendje të mëparshme të rastit KI34/09, duke theksuar se *"Aktvendimi për papranueshmëri në Rastin KI34/09 i ishte dorëzuar parashtruesit më 11 shtator 2012 dhe se për shkak të kësaj, parashtruesi e kishte humbur të drejtën e tij për tu ankuar kundër këtij vendimi në Gjykatën Kushtetuese"*.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të shqyrtojë nëse ai i ka plotësuar kushtet për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili parasheh që:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

25. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi"*.

26. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi është person i autorizuar, se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me nenin 113. 7 të Kushtetutës, dhe se kërkesa është paraqitur brenda afatit kohor prej katër (4) muajve në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

27. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

...
c) kërkesa është qartazi e bazuar".

28. Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1, shih edhe Aktvendimin për papranueshmëri në rastin nr. 70/11, parashtruesit Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011).

29. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se gjykata e rregullt ka vepruar në mënyrë arbitrare apo në mënyrë të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me ato të gjykatave të rregullta dhe si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë dëshmitë para vetes. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato dëshmi, (shih, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

30. Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se janë plotësuar garancitë procedurale të së drejtës për një gjykim të drejtë, siç parashikohet me Kushtetutë dhe me Konventë, nuk ka asnjë gjurmë të arbitraritetit nga ana e Gjykatës Supreme. Për më tepër, Gjykata konsideron se aktvendimi i Gjykatës Supreme është i arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe koherente për shkak se ai i shpjegon parashtruesit kompetencat e Kuvendit në lidhje me procesin e zgjedhjes së Avokatit të Popullit.

31. Fakti se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të pranueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës (shih rastin Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

32. Në këto rrethana, parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ai nuk

tregojnë në asnjë mënyrë se gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

33. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë si e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

34. Për më tepër, në lidhje me kërkesën e parashtruesit për kthim në gjendje të mëparshme në Rastin KI34/09, Gjykata merr parasysh nenin 50 të Ligjit, i cili parasheh: *"Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj"*.

35. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se aktvendimi për papranueshmëri në Rastin KI34/09 ishte hedhur poshtë, sepse kërkesa e parashtruesit ishte e parakohshme dhe prandaj nuk ka mundur të konsiderohet t'i ketë plotësuar kërkesat e nenit 113. 7 të Kushtetutës dhe të specifikuar më tej në nenin 47. 2 të Ligjit; prandaj neni 50 i Ligjit nuk mund të zbatohet në këtë rast. Rrjedh se parashtruesi nuk ka ofruar bazë dhe dëshmi mbështetëse për ta mbështetur kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme.

36. Për më tepër, Gjykata dëshiron të theksojë se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme dhe nuk i nënshtrohen rishikimit; prandaj Gjykata konsideron se në rastin në fjalë, nuk ishte në pyetje afati i fundit, siç ishte pretenduar nga parashtruesi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (2) b) e 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 mars 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI163/13, Naser Dragusha dhe 6 punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës, Aktvendimi i datës 8 maj 2014, të cilët kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 25/2012, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 10 majit 2013

Rasti KI163/13, vendimi i 8 majit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e pronës, qartazi e pabazuar

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullit 56 paragrafi 2 i Rregullores së punës.

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktgjykimi i kontestuar shkakton shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit], dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, parashtruesit konsiderojnë se vendimet *"janë të gabuara dhe kundërkushtetuese, sepse parashtruesve iu është mohuar padrejtësisht kompensimi në pagë"*.

Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit, Rev. nr. 25/2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 10 majit 2013, Gjykata Kushtetuese konstatoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij dhe rrjedhimisht, kërkesa e tij është qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI163/13
Parashtrues
Naser Dragusha dhe 6 punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës
Vlerësimi kushtetues i Aktgjykimit Rev. nr. 25/2012, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 10 majit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Cukalovic, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, Gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Naser Dragusha, z. Mehmet Shaqiri, z. Bajram Ahmeti, z. Shasivar Hashani, z. Qazim Igrishta, z. Fahri Asllani dhe znj. Selvete Preniqi, të përfaqësuar nga z. Ilaz Çerkinaj, avokat nga Prishtina.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesit në kërkesën e tyre ankohen ndaj Aktgjykimit Rev. Nr. 25/2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës të 10 majit 2013 që atyre iu është dorëzuar më 10 korrik 2013, Aktgjykimit Ac. nr. 270/2009 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të 28 shkurtit 2011 dhe Aktvendimit C. nr. 268/07 të Gjykatës Komunale në Prishtinë të 2 qershorit 2008.

Objekti i çështjes

3. Objekt çështjeje është vlerësimi kushtetues i vendimeve që pretendohet *"se janë të gabuara dhe kundërkushtetuese, sepse parashtruesve iu është mohuar padrejtësisht kompensimi në pagë"*.

4. Në këtë drejtim, parashtruesit pretendojnë shkelje të Nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Nenit 49 [E Drejta e Punës dhe

e Ushtrimit të Profesionit], dhe Nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza ligjore

5. Kërkesa bazohet në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), Nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 18 tetor 2013, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 31 tetor 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI163/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI163/13, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 14 nëntor 2013, parashtruesit, Gjykata Supreme dhe Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK) u njoftuan për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 18 nëntor 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesit që të dorëzojnë dokumente shtesë.

10. Më 19 dhe 20 nëntor 2013, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë.

11. Më 25 nëntor 2013, Zyra Ligjore e KEK-ut dorëzoi komentet e saj përkitazi me kërkesën e parashtruesve.

12. Më 13 janar 2014, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të dorëzojë dokumente shtesë.

13. Më 20 janar 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë dokumentet shtesë.

14. Më 8 maj 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

15. Më 1 tetor 2004, parashtruesit themeluan marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar me KEK-un, me pagë mujore prej 296 € në muaj në vendet e punës *ndihmës manipulues.*

16. Më 2 korrik 2007, parashtruesit paditën KEK-un në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar ndërrimin e emërtimit të vendit të punës nga *ndihmës manipulues* në *manipulues të kaldajës* si dhe pagesën e dallimit të të ardhurave personale prej 41€ në muaj, për periudhën 1 dhjetor 2004 deri më 1 janar 2007.

17. Më 2 qershor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin C. nr. 268/07, përcaktoi:

> *REFUZOHET si e paafatshme kërkesëpadia e paditësve Bajram Ahmeti nga Prishtina, lagjeja " Ulpiana ",ndërtesa 13, nr. 1 e Mehmet Shaqiri nga fshati Sveçël, komuna e Podujevës me te cilën kane kërkuar ndërrimin e emërtimit te vendit te punës dhe pagesën e diferencës se te ardhurave personale prej dt. 1.12.2004 deri me dt 01.01.2007 dhe HUDHET si e palejueshme kërkesëpadia e paditësve Fahri Asllani nga fshati Stanov i Ulët, komuna e Vushtrrisë, Qazim Igrishta nga fshati Stanovc i Ulët, komuna e Vushtrrisë, Shashivar Hashani nga Obiliqi, Latif Preniqi nga Prishtina, lagjeja "Dardania", SU 113, hyrja e III-te, nr. 23 dhe Naser Dragusha nga fshati Prugovc, komuna e Prishtinës, me te cilën kanë kërkuar ndërrimin e emërtimit te vendit te punës dhe pagesën e diferencës se te ardhurave personale prej dt. 1.12.2004 deri me dt 01.01.2007.*

18. Më 4 mars 2010, parashtruesit paraqitën ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

19. Më 28 shkurt 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 270/2009, përcaktoi:

"REFUZOHEN ankesat e paditësve Bajram Ahmeti nga Prishtina, Mehmet Shaqiri nga fsh. Sveqël, Fahri Asllani dhe Qazim Igrishta nga fsh.Stanovc i Ulët, Shashivar Hashani nga Obiliqi, Latif Preniqi nga Prishtina dhe Naser Dragusha nga fsh. Prugovc si të pabazuar dhe aktvendimi i Gjykatës Komunale ne Prishtine C1.nr.268/2007 i dt. 02.06.2008 VËRTETOHET".

20. Më 20 maj 2011, parashtruesit paraqitën kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

21. Më 10 maj 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 25/2012, përcaktoi:

"Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësve paraqitur kundër aktgjykimit te Gjykatës se Qarkut Prishtine, Ac. nr. 270/2009 datë 28.02.2011 , në pjesën që ka të bëjë me ndërrimin e emërtimit të vendit të punës.

Ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i gjykatës së shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me kërkesëpadinë e paditësve për pagesën e diferencës së pagave mujore për periudhën kohore nga data 01 .02.2004 e deri më 01.01.2007, ashtu që refuzohet në këtë pjesë kërkesëpadia e paditësve si e pabazuar".

22. Në aktgjykimin e sipërpërmendur, Gjykata Supreme arsyetoi:

"...nga shkresat e lëndës del se paditësit te e paditura kanë themeluar kanë themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar prej datës 1.10.2004, në vendet e punës ndihmës manipulues, sipas kontratës së punës nr. 8992/0 datë 1.10.2004 me Naser Dragushën, kontrata nr.1223/0 me Bajram Ahmetin, kontrata nr. 3564/0 me Mehmet Shaqirin, kontrata nr. 8967/0 me Fahri Asllanin, kontrata 12310/0 me Qazim Igrishtën, kontrata nr.2099/0 me Shasivar Hashanin, kontrata nr. 2268/0 me Latif Preniqin, në të cilat kontrata për të gjithë është caktuar paga mujoren shumë prej 296 € dhe të njëjtat janë të nënshkruara nga paditësit dhe e paditura.

Paditësit me padinë e ushtruar më 02.07.2007 kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që secilit paditës t'i emërtoj vendin e punës "manipulues i kalldajve" siç e kishin edhe më parë dhe secilit veç e veç t'i paguajë ndryshimin e të ardhurave personale nga 41 € për

çdo muaj duke filluar prej 01.12.2004 e deri më 01.01.2007 me kamatë ligjore prej ditës së mospagesës e deri në pagesën definitive të gjitha në afat prej (8) tetë ditësh si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave të nevojshme ka vërtetuar se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune te e paditura në bazë të kontratave të punës të datës 1.10.2004 për vendin e punës ndihmës manipulues sipas të cilave kontrata paga mujore është caktuar në lartësi prej 296 €, të cilat kontrata janë nënshkruar nga të gjithë paditësit dhe e paditura, se të njëjtat nuk janë kundërshtuar nga ana e paditësve në kuptim të dispozitave të nenit 83 të Ligjit mbi të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, dhe ka gjetur se paditësit Mehmet Shaqiri, dhe Bajram Ahmeti, kanë humbur të drejtën në mbrojtje gjyqësore ndërsa paditësit Fahri Asllani, Qazim Igrishta, Shasivar Hashani, Latif Preniqi dhe Naser Dragusha, për shkak se të njëjtit nuk kanë shtjerrë mjetet jashtë gjyqësore për realizimin e të drejtave të tyre duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se padia e paditësve për ndryshimin e emërtimit të vendit të punës sipas kontratës është e palejueshme, dhe si të tillë e kanë hedhur poshtë ngase kjo çështje nuk është në kompetencë lëndore të gjykatave të rregullta.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale kur kanë hedhur padinë e paditësve për kompensimin e ndryshimit të pagave mujore në lartësi prej 41 €, për periudhën kohore nga data 01.10.2004 e deri më datë 01.02.2007, në kuptim të nenit 83 paragrafi 1 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga marrëdhënia e Punës, ngase sipas dispozitës së nenit 83 par. 2 të Ligjit të lart cituar është paraparë se: mbrojtja e të drejtave pranë gjykatës kompetente nuk mund të kërkohet nëse paraprakisht nuk ka kërkuar mbrojtje pranë organeve kompetente të organizatës, përveç të drejtave nga kërkesa në të holla, sepse sipas kësaj dispozite te kërkesa për pagimin e kompensimit në të holla që rrjedh nga marrëdhënia e punës nuk zbatohet dispozita e nenit 83 paragrafi 1 të ligjit të lart cituar, prandaj kjo Gjykatë ka ndryshuar aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, në pjesën që ka të bëj me kërkesëpadinë e paditësve për pagesën e diferencave të papaguara mujore për periudhën kohore prej

01.12.2004, deri më 01.01.2007, duke refuzuar kërkesëpadinë si të pabazuar. Paditësit me të padituren për periudhën kohore prej 01.12.2004 e deri më 01.01.2007 kanë punuar sipas kontratave të punës të lidhura më 01.10.2004, në kohë të pacaktuar, sipas të cilave kontrata në nenin 2 është caktuar pagesa mujore në lartësi prej 296 €, paditësit për punët e kryera sipas kësaj kontrate kanë realizuar pagat mujore nga e paditura, se nuk kishin kundërshtuar nënshkrimin e kontratave i cili fakt nuk ishte kontestues nga palët ndërgjyqës"

23. Më 10 korrik 2013, parashtruesit kërkuan nga Gjykata Supreme e Kosovës që të jepte interpretim logjik të paragrafit II të dispozitivit dhe të arsyetimit të Aktgjykimit Rev. nr. 25/2012.

24. Më 4 shtator 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. nr. 25/2012, refuzoi të pabazuar kërkesën e parashtruesve.

25. Në aktvendimin e lartpërmendur, Gjykata Supreme e Kosovës, ndër të tjera, arsyetoi:
"Gjykata Supreme e Kosovës, pas shikimit të shkresave të lëndës si dhe aktgjykimin e cekur, gjeti se kërkesa e paditësve për përmirësim dhe interpretim të logjikshëm për paragrafin II të dispozitivit të këtij aktgjykimi është e pa bazuar, nga se aktgjykimi në fjalë nuk është i përfshire me gabime teknike te përshkruara sipas dispozitës së nenit të lartë cituar, dhe se për këtë pjesë gjykata ka dhënë arsye te kuptueshme për marrjen e vendimit në kuptim të dispozitës së nenit 224.1 të LPK".

Dispozitat relevante

Ligji Nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, Neni 224.1

"224.1 Në qoftë se gjykata e revizionit konstaton se e drejta materiale është zbatuar gabimisht, me aktgjykim e aprovon revizionin e paraqitur dhe e ndryshon aktgjykimin e goditur".

Pretendimet e parashtruesve

26. Parashtruesit pretendojnë *"nuk është e qartë se në çfarë aspekti janë ndryshuar aktgjykimet e gjykatave më të ulëta kur revizioni është ushtruar pikërisht për shkak të mos pagesës së diferencës së të ardhurave personale për periudhën e theksuar në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, sepse kjo kërkesë e paditësve ka qenë e refuzuar edhe me aktgjykimet e gjykatave më të ulëta".*

27. Parashtruesit pretendojnë shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Pretendimet e Zyrës Ligjore të KEK-ut

28. Zyra Ligjore e KEK-ut, ndër të tjera, u shpreh: "*KEK Sh. a. pretendon dhe është e bindur se vendimet gjyqësore – aktgjykimet dhe aktvendimet nga Gjykata Komunale, ajo e Qarkut dhe Gjykatës Supreme të Kosovës janë të drejta, të ligjshme dhe meritore, andaj nisur nga ky parim, propozon që kërkesa të hedhet poshtë si e papranueshme*".

Vlerësimi i pranueshmërisë

29. Gjykata vëren që, në mënyrë që të jetë në gjendje të vlerësojë kërkesën e parashtruesve, së pari është e nevojshme të vlerësohet nëse ata i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

30. Përkitazi me kërkesën e parashtruesve, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

31. Gjykata, po ashtu, i referohet Nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të llogaritet që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".

32. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesit janë palë të autorizuara, kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me Nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit ligjor prej katër muajsh të përcaktuar me Nenin 49 të Ligjit.

33. Gjykata, po ashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, që përcakton:

> "(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
> ...
>
> c) kërkesa është qartazi e bazuar"

34. Përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e Kosovës qartë e ka shpjeguar raportin ndërmjet parashtruesve si punëtorë dhe KEK-ut si punëdhënës, bazuar në kontratën e themeluar me pëlqimin e dy palëve si dhe të drejtat dhe detyrimet që dalin nga kontrata e tillë; dhe për më tepër, Gjykata Supreme e Kosovës po ashtu ka dhënë vlerësim të qartë të vendimeve të gjykatave të instancës më të ulët.

35. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih rastin Akdivar kundër Turqisë, Nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65 dhe po ashtu shih rastin KI-86/11, parashtrues i kërkesës Milaim Berisha, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

36. Përveç kësaj, kërkesa nuk arrin të dëshmojë që gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

37. Fakti që parashtruesit nuk pajtohen me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit], të Kushtetutës (Shih rastin Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

38. Në këto rrethana, parashtruesit nuk i kanë mbështetur me prova pretendimet e tyre për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ata nuk tregojnë në asnjë mënyrë që gjykatat e rregullta ua kanë mohuar atyre të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

39. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në përputhje me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 8 maj 2014, njëzëri

VENDOSI

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtar raportues
Altay Suroy

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI193/13 dhe KI213/13, Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore SHKABAJ SH.P.K., Aktvendim i datës 5 maj 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 229/2012, të 10 qershorit 2013 dhe të Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 70/2013, të 12 korrikut 2013

Rastet e bashkuara, KI193/13 dhe KI213/13, vendimi i 5 majit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, mosshterimi i mjeteve juridike, mbrojtja e pronës, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar aktvendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 229/2012, të 10 qershorit 2013, dhe Rev. nr. 70/2013, të 12 korrikut 2013, me të cilat, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës janë shkelur nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E drejta për Mjete Juridike] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Parashtruesi i kërkesës i ka paraqitur dy padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë (Gjykata e tanishme Themelore) për lirimin e paluajtshmërisë dhe kompensimin e fitimit të humbur, me arsyetim se i padituri Fehmi Sahiti, pa leje dhe autorizim kishte hyrë në posedim dhe shfrytëzim të paligjshëm, dhe nuk e ka liruar paluajtshmërinë, tokën bujqësore, në vendin e ashtuquajtur "Dragodan", Komuna Kadastrale Obiliq.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese mori vendim për bashkimin e rasteve KI193/13 dhe KI213/13 sepse bëhet fjalë për objektin e njëjtë të kontestit sipas dy aktvendimeve të ndryshme me gjendjen faktike pothuajse identike.

Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. nr. 70/2013, dhe Aktvendimin Rev. nr. 229/2012, e HODHI POSHTË si të palejuar revizionin e përfaqësuesit të paditësit.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore SHKABAJ, SH.P.K., dhe duke marrë parasysh dokumentet e dorëzuara në Gjykatën Kushtetuese nga ana e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se me aktvendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 229/2012, të 10 qershorit 2013, dhe Rev. nr. 70/2013, të 12 korrikut 2013, *"ndaj aktvendimit me të cilën kjo*

gjykatë është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore në këtë çështje juridike, nuk është lejuar revizioni, sepse me këtë procedura kontestimore nuk përfundon në formë të prerë". Njëkohësisht, lëndët i janë kthyer Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për rigjykim, në mënyrë që gjykata kompetente të mund të vendosë për objektin e kontestit.

Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, në mënyrë që të mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, dhe kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së Punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI193/13 dhe KI213/13
Parashtrues
Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Shkabaj Sh.P.K.
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 229/2012, të 10 qershorit 2013 dhe
të Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 70/2013, të 12 korrikut 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga personi juridik "Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Shkabaj Sh.P.K." (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës e përfaqëson avokati z. Gafurr Elshani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës i konteston dy aktvendime të Gjykatës Supreme të Kosovës si në vijim:

    - Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 229/2012, i 10 qershorit 2013, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 15 korrik 2013, dhe

- Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 70/2013, i 12 korrikut 2013, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 23 gusht 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 229/2012, të 10 qershorit 2013, dhe Rev. nr. 70/2013, të 12 korrikut 2013, me të cilat, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën KI193/13 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 20 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën KI213/13 në Gjykatë.

7. Më 27 janar 2014, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese mori vendim për bashkimin e rasteve KI193/13 dhe KI213/13 dhe caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

8. Më 5 shkurt 2014, Gjykata Kushtetuese ia dërgoi Gjykatës Supreme të Kosovës kopjen e kërkesës dhe e njoftoi parashtruesin e kërkesës se ka filluar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së aktvendimit në rastet e bashkuara, KI193/13 dhe KI213/13.

9. Më 5 maj 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve për kërkesën KI193/13

10. Më 29 dhjetor 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë (Gjykatën e tanishme Themelore) për lirimin e paluajtshmërisë dhe kompensimin e fitimit të humbur, me arsyetimin se i padituri Azem Sallahu, pa leje dhe autorizim kishte hyrë në posedim dhe shfrytëzim të paligjshëm, dhe nuk e ka liruar paluajtshmërinë P-71914056-00161-3, parcelën e tokës bujqësore, në vendin e ashtuquajtur "Dragodan– Kodra", në sipërfaqe prej 10800 m², Komuna Kadastrale Prishtinë.

11. Më 13 tetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin C. nr. 2945/10, shpallet "*jokompetente në pikëpamje lëndore në këtë çështje juridike dhe Udhëzohet paditësja që përkitazi me këtë ta iniciojë procedurën në* Dhomën *e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës*".

12. Më 1 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2945/10, të 13 tetorit 2011, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

13. Më 24 janar 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin Ac. nr. 1432/2011, "*REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të autorizuarit te paditësit Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Shkabaj ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 2945/2010 i dt. 13.10.2011 VËRTETOHET*".

14. Më 16 mars 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Supreme për dhënien e qëndrimit juridik lidhur me kompetencën.

15. Më 27 mars 2012, Kryetari i Gjykatës Supreme në përgjigjen agj. nr. K136/2012, në kërkesën për marrjen e qëndrimit juridik lidhur me kompetencën, thekson si në vijim:

"Çështja e kompetencës është rregulluar me ligj dhe kjo Gjykatë nuk mund të marr qëndrim juridik për çdo mospajtim të palëve me vendimet gjyqësore, ju keni pas mundësi në rrugë ligjore që ta atakoni një vendim të tillë dmth. të kërkoni inicimin e procedurës për mbrojtje të ligjshmërisë, apo të paraqitni revizion nëse ligji në rastin konkret ka mundësuar një gjë të tillë e pastaj kjo Gjykatë si autoritet i fundit do të vendoste lidhur me këtë çështje. Te çështja e kompetencës , gjykata nëse konsideron se nuk ka kompetencë territoriale apo reale shpallet jo kompetente dhe lëndën ia dorëzon gjykatës për të cilën mendon se është kompetente, e nëse gjykata të cilës i është proceduar çështja, mendon se nuk është kompetencë e saj hap konflikt kompetence, te cilën e zgjidh gjykata me e lart, nga kjo rezulton se nuk është përmbushur asnjë konditë ligjore për qëndrime juridike, por kompetenca, zgjidhet nga gjykata më e lartë, në procedurë të rregullt të parashikuar me ligj".

16. Më 5 prill 2012, kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2945/10, të 13 tetorit 2011 dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1432/2011, të 24 janarit 2012, parashtruesi i kërkesës ushtron revizion për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

17. Më 10 qershor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. nr. 229/2012, "*HIDHET si i palejuar revizioni i përfaqësuesit të paditësit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC. nr. 1432/11 të datës 24.01.2012", me arsyetimin si në vijim:*

"Sa i përket revizionit të përfaqësuesit të paditësit, Gjykata Supreme e Kosovës, konkludoi se revizioni është i palejuar, ngase sipas nenit 228 par. 1 të LPK-së, palët mund të paraqesin revizion kundër aktvendimeve të formës së prerë me te cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë, me aktvendimin me të cilën kjo gjykatë është shpallur jokomepetente në pikëpamje lëndore në këtë çështje juridike, nuk është lejuar revizioni ,sepse me kët procedura kontestimore nuk përfundon në formën e prerë ".

Përmbledhja e fakteve për kërkesën KI213/13

18. Më 22 shtator 2010, në Gjykatën Komunale në Prishtinë (Gjykata e tanishme Themelore), parashtruesi i kërkesës ka paraqitur padi për lirimin e paluajtshmërisë dhe kompensimin e fitimit të humbur, me arsyetimin se i padituri Fehmi Sahiti, pa leje dhe autorizim kishte hyrë në posedim dhe shfrytëzim të paligjshëm, dhe nuk e ka liruar paluajtshmërinë P-72614055-01832, parcelën e tokës bujqësore, në vendin e ashtuquajtur "Dragodan", në sipërfaqe prej 60 ari, Komuna Kadastrale Obiliq.

19. Më 18 tetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin C. nr. 2029/10, shpallet "*jokompetente në pikëpamje lëndore në këtë çështje juridike dhe Udhëzohet paditësja që përkitazi me çështjen e cila është objekt i kërkesëpadisë mund ta iniciojë procedurën në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, në pajtim me rregullat e kësaj Dhome*".

20. Më 18 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2029/10, të 18 tetorit 2011, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

21. Më 28 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin Ac. nr. 923/2012, "*REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Shkabaj ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 2029/2010 i dt. 18.10.2011 VËRTETOHET*".

22. Më 16 mars 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Supreme për dhënien e qëndrimit juridik lidhur me kompetencën.

23. Më 27 mars 2012, Kryetari i Gjykatës Supreme, në përgjigjen agj. nr. K136/2012 ndaj kërkesës për marrjen e qëndrimit juridik lidhur me kompetencën, thekson si në vijim:

> *"Çështja e kompetencës është rregulluar me ligj dhe kjo Gjykatë nuk mund të marr qëndrim juridik për çdo mospajtim të palëve me vendimet gjyqësore, ju keni pas mundësi në rrugë*

ligjore që ta atakoni një vendim të tillë dmth. të kërkoni inicimin e procedurës për mbrojtje të ligjshmërisë, apo të paraqitni revizion nëse ligji në rastin konkret ka mundësuar një gjë të tillë e pastaj kjo Gjykatë si autoritet i fundit do të vendoste lidhur me këtë çështje. Te çështja e kompetencës , gjykata nëse konsideron se nuk ka kompetencë territoriale apo reale shpallet jo kompetente dhe lëndën ia dorëzon gjykatës për të cilën mendon se është kompetente, e nëse gjykata të cilës i është proceduar çështja, mendon se nuk është kompetencë e saj hap konflikt kompetence, të cilën e zgjidh gjykata më e lart, nga kjo rezulton se nuk është përmbushur asnjë konditë ligjore për qëndrime juridike, por kompetenca, zgjidhet nga gjykata më e lartë, në procedurë të rregullt të parashikuar me ligj".

24. Më 12 nëntor 2012, kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2029/10, të 18 tetorit 2011, dhe Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 923/2011, të 28 shtatorit 2012, parashtruesi i kërkesës ushtron revizion për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

25. Më 12 korrik 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. nr. 70/2013, "*HIDHET si i palejuar revizioni i përfaqësuesit të paditësit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC. nr. 923/12 të datës 28 shtator 2012",* me arsyetimin si në vijim*:*

"Sa i përket revizionit të përfaqësuesit të paditësit, Gjykata Supreme e Kosovës, konkludoi se revizioni është i palejuar, ngase sipas nenit 228 par. 1 të LPK-së, palët mund të paraqesin revizion kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë, me aktvendimin me të cilën kjo gjykatë është shpallur jokomepetente në pikëpamje lëndore në këtë çështje juridike, nuk është lejuar revizioni ,sepse me këtë procedura kontestimore nuk përfundon në formën e prerë ".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 229/2012, të 10 qershorit 2013 dhe

Rev. nr. 70/2013, të 12 korrikut 2013, janë shkelur nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

27. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *"Me vendimet e sipërcituara parashtruesja konsideron se i janë shkelë të drejtat në gjykim të drejtë dhe të pa anshëm, ngase palët në procedurë nuk janë trajtuar në mënyrë të barabart, dhe se gjykatat nuk kanë shqyrtuar provat dhe faktet që ka ofruar i ka ofruar Paditësi - Ndërmarrja Toka e Bujqësore Shkabaj sh.p.k dhe aq ma tepër me Aktvendimin e revizionit Rev. 229/2012 të dt. 10. 06.2013. I është shkel e drejta për mjete të jashtëzakonshëm juridik sepse dhe Gjykata në faqen 2 të arsyetimit të aktgjykimit të Revizionit gabimisht interpreton nenin 228, par. 1, sepse aktvendimi Ac. nr. 1432/2011, është formës së prerë dhe sa i përket çështjes së kontestit mbi kompetencën përfundon procedura. Në rastin konkret procedurat ne Gjykata nuk kane qenë te drejta dhe në të shumtën e rasteve janë ndikuar nga njëra tjetra pa hy dhe analizuar faktet ne mënyrë të pavarur"* .

28. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesën si në vijim:

> *"... që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të konstaton se me Aktvendimin përfundimtar të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 229/2012, të dt. 10.06.2013, dhe aktgjykimeve te ma parshme qe i kanë paraprirë të njëjtit ka shkelje te kushtetutës dhe të ligjit në aplikim, për gjykim të drejtë dhe të pa anshëm, ne dëm të ankuesit, me shpalljen jokompetente të Gjykatës Komunale në Prishtinë, edhepse me ligj një gjë e tillë i është garantuar. Te njëjtat Aktvendime të shfuqizohen dhe rasti të ri gjykohet ne mënyre te pa anshme dhe ne pajtim me provat".*

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 21.4 dhe nenit 113.7 të Kushtetutës, të cilët parashohin:

> *"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".*
>
> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

31. Si dhe nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i cili parasheh:

> *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

32. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(1) "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
> *a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar...".*

33. Duke marrë parasysh këtë, në bazë të dokumenteve të dorëzuara në Gjykatën Kushtetuese nga ana e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se me aktvendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 229/2012, të 10 qershorit 2013, dhe Rev. nr. 70/2013, të 12 korrikut 2013, "*... me aktvendimin me te cilën kjo gjykatë është shpallur jokomepetente në pikëpamje lëndore në këtë çështje juridike, nuk është lejuar revizioni, sepse me këtë procedura kontestimore nuk përfundon në formën e prerë ".* Njëkohësisht, lëndët i janë kthyer Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për rigjykim, në mënyrë që gjykata kompetente të mund të vendosë për objektin e kontestit.

34. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ky rregull

bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis* GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999).

35. Kjo gjykatë e ka zbatuar arsyetimin e njëjtë kur e mori vendimin më 27 janar 2010, për papranueshmëri në bazë të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në rastin *Universiteti AAB-RIINVEST SHPK, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, rasti nr. KI41/09 dhe vendimin e 23 marsit 2010, në rastin e *Mimoza Kusarit-Lilës kundër Komisionit Qendror Zgjedhor*, rasti nr. KI73/09.

36. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, në mënyrë që të mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, dhe kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe të rregullit 36 (1) a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 dhe nenin 21.4 të Kushtetutës, nenin 20 dhe nenin 47 të Ligjit si dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Kadri Kryeziu	Prof. Dr. Enver Hasani

KO103/14, Kërkesë nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Aktgjykim i datës 30 qershor 2014 - për vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Rasti KO103/14, vendimi i 30 qershorit 2014.

Fjalët kyçe: Presidenti i Republikës së Kosovës, interpretim kushtetues, kompetencat e Presidentit, zgjedhja e qeverisë, parti politike, koalicion.

Kërkesa është parashtruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Saj Atifete Jahjaga, në pajtim me nenin 84, paragrafi 9 dhe neni 113, paragrafi 3, duke kërkuar nga Gjykata të bëjë interpretimin e disa termave, siç janë: *parti ose koalicion që ka fituar zgjedhjet, e nevojshme për të formuar Qeverinë, sipas të njëjtës procedurë dhe shumicës në Kuvend,* që janë përdorur sipas nenit 95 të Kushtetutës, dhe të specifikohet rendi i përparësisë ndërmjet nenit 84, paragrafi 14, dhe nenit 95 të Kushtetutës ashtu siç ato lidhen me kompetencën e Presidentes për të mandatuar kandidatin për Kryeministër pas zgjedhjeve.

Gjykata gjeti se kërkesa e parashtrueses është e pranueshme pasi që ajo i plotëson të gjitha kërkesat e pranueshmërisë të cilat janë të parapara me Rregulloren e punës. Në vlerësimin e meritave të kërkesës, Gjykata konkludoi se:

- mandatari për Kryeministër caktohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës me vendim në të cilin personi i caktuar përmendet në mënyrë eksplicite;

- propozimi për emërimin duhet të rrjedhë nga partia politike ose nga koalicioni i cili do t'ia paraqesë Presidentit të Republikës emrin e personit për mandatar për Kryeministër. Formulimi i përdorur e thotë qartë se emri i mandatarit duhet të propozohet nga partia politike ose nga koalicioni i regjistruar për te marrë pjesë në zgjedhje të përgjithshme. Si rezultat i kësaj, nuk është në diskrecionin e Presidentit të Republikës që ai/ajo me vetiniciativë të propozojë kandidatin e tillë;

- partia politike e cekur në nenin 84 (14) duhet të jetë subjekt politik i regjistruar nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) dhe duhet të ketë kaluar pragun e përcaktuar nga KQZ-ja pas zgjedhjeve; termi “koalicion” në nenin 84 (14) të Kushtetutës ka të bëjë me subjektet e pranuara politike, të cilat janë certifikuar nga KQZ-ja si "koalicion

për të garuar në zgjedhjet përkatëse nën një emër" dhe që kanë kaluar pragun e përcaktuar nga KQZ-ja pas zgjedhjeve. Andaj, koalicionet, të cilat nuk janë certifikuar nga KQZ-ja, nuk kanë të drejtë, sipas nenit 84 (14), për të propozuar mandatarin për Kryeministër;

- kriteret për propozimin e qeverisë pas zgjedhjeve, të përdorura në nenin 95, paragrafin 1 janë kumulative dhe përbëjnë parakusht që Presidenti i Republikës të bëjë konsultimet e nevojshme me partinë ose me koalicionin që ka fituar shumicën e vendeve ne Kuvend.

- rregulli dhe parimet demokratike, si dhe korrektësia politike, parashikueshmëria dhe transparenca, kërkojnë që partisë politike ose koalicionit që ka fituar numrin më të madh të vendeve, si rezultat i zgjedhjeve t'i jepet mundësia të propozojë kandidatin për Kryeministër për formimin e Qeverisë;

- nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr votat e nevojshme në Kuvend, është në diskrecionin e Presidentit të Republikës që, pas konsultimeve me partitë dhe me koalicionet, të vendosë se cilës parti ose cilit koalicion do t'i jepet mandati për të propozuar kandidatin tjetër për Kryeministër.

AKTGJYKIM
në
Rastin Nr. KO103/14
Parashtrues
Presidentja e Republikës së Kosovës
Përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Saj, Atifete Jahjaga (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesja e kërkesës).

Objekti i çështjes

2. Parashtresa përmban kërkesën për vlerësim të përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

3. Objekt i çështjes janë këto pyetje që i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) nga parashtruesja e kërkesës:

   a. Definicioni i fjalës "ka fituar", si është përdorur në nenin 95, paragrafi 1, të Kushtetutës?

      i. Mbi çfarë baze përcaktohet partia politike apo koalicioni që "ka fituar" zgjedhjet sipas kësaj dispozite kushtetuese, kush e bën këtë përcaktim dhe mbi çfarë baze?

ii. *A matet atributi kushtetues i partisë politike ose koalicionit që "ka fituar" shumicën në Kuvend sipas nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, me veprimet e tyre para ose pas ditës së zgjedhjeve? A ndikon certifikimi i rezultateve në përgjigjen e kësaj pyetjeje?*

iii. *A mund të ndryshohet atributi kushtetues i partisë politike ose i koalicionit që "ka fituar" shumicën në Kuvend sipas nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, pas zgjedhjeve dhe, nëse po, si?*

iv. *Cilët janë prerogativët kushtetues të partisë politike ose të koalicionit që "ka fituar" shumicën ne Kuvend sipas nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës?*

b. *Definoni frazën "e nevojshme ne Kuvend për të formuar Qeverinë", siç është shkruar në nenin 95, paragrafi 1, të Kushtetutës?*

c. *Qartësoni frazën "sipas të njëjtës procedurë", siç është përdorur në nenin 95, paragrafi 4, të Kushtetutës?*

i. *A do të thotë kjo që kandidati duhet të propozohet në konsultim me partinë e njëjtë ose koalicionin sikur herën e parë (neni 95, paragrafi 1, i Kushtetutës) apo ky kandidat mund të propozohet në konsultim me ndonjë parti ose koalicion tjetër?*

ii. *A mundet që kandidati i propozuar herën e dytë të jetë person që nuk është anëtar i partisë me të ci!ën janë zhvilluar konsultimet sipas nenit 95, paragrafët 1 dhe 5, të Kushtetutës?*

iii. *A mundet që kandidati i propozuar sipas nenit 95, paragrafi 4, i Kushtetutës të jetë personi që nuk i takon asnjë partie politike?*

ç. *Defino frazën "shumicën në Kuvend" siç është shkruar në nenin 84, paragrafi 14, të Kushtetutës?*

i. *A nënkupton kjo frazë partinë ose koalicionin që ka 51 % të shumicës së Kuvendit ose partinë ose koalicionin që ka më së shumti deputetë në Kuvend?*

ii. Nëse përgjigja në pyetjet paraprake është që partia ose koalicioni me më se shumti deputetë në Kuvend përbënë "shumicën në Kuvend" sipas nenit 84, paragrafi 14, nëse një parti ose koalicion të dyja kane shumicën, cila ka përparësi?

iii. A dallon fraza "shumicën në Kuvend" në ndonjë mënyrë nga fraza "shumicën e Kuvendit"? [Theksi i shtuar]?

iv. Si duhet Presidentja të konfirmojë që një parti ose një koalicion përbën shumicën në Kuvend?

d. Së fundi dhe me më rëndësi, ju lutem specifikoni rendin e përparësisë ndërmjet nenit 84, paragrafi 14, dhe nenit 95 të Kushtetutës ashtu siç ato lidhen me kompetencën e Presidentes për të mandatuar kandidatin për Kryeministër pas zgjedhjeve?

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 84.9 dhe 113, paragrafët 3.1 dhe 3.5, të Kushtetutës dhe në rregullin 56.1 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 19 qershor 2014, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 20 qershor 2014, në mbështetje të rregullit 33 të Rregullores së punës, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KO103/14, e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KO103/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 20 qershor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës.

8. Të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Qeverisë në detyrë të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Qeveria në detyrë) dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Sekretari i Përgjithshëm i

Kuvendit). Këtij të fundit i është kërkuar të dorëzojë në Gjykatën Kushtetuese një kopje të *Travaux Preparatoires* (punëve përgatitore) të Kushtetutës, lidhur me nenin 84 (14) dhe me nenin 95 të Kushtetutës.

9. Po të njëjtën datë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit iu përgjigj Gjykatës, duke thënë se nuk i kishin *Travaux Preparatoires* (punët përgatitore) të Kushtetutës, lidhur me nenin 84 (14) dhe me nenin 95 të Kushtetutës.

10. Më 23 qershor 2014, Gjykata kërkoi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë: KQZ) dokumentet dhe informacionet vijuese:

    a. Vendimet e KQZ-së për certifikimin e partive politike, të organizatave joqeveritare, të kandidatëve të pavarur dhe të koalicioneve që nga zgjedhjet e para parlamentare në Kosovën e pasluftës e deri më sot;

    b. Certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve që nga zgjedhjet e para parlamentare në Kosovën e pasluftës e deri më sot; dhe

    c. Rezultati i zgjedhjeve, që nga zgjedhjet e para parlamentare në Kosovën e pasluftës e deri më sot, a i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës?

11. Më 24 qershor 2014, KQZ-ja iu përgjigj Gjykatës, duke dorëzuar dokumentet dhe informacionet e kërkuara.

12. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën për përjashtimin e tij nga seancat e këshillimeve për periudhën qershor-korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë lidhur me pretendimet e caktuara të ngritura ndaj tij.

13. Më 30 qershor 2014, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi lidhur me rastin.

Pranueshmëria e kërkesës

14. Për të qenë në gjendje të vendosë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në Rregullore të punës.

15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, që përcakton: *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar."*

16. Parashtruesi i kërkesës argumenton:

> *"...*
>
> *[...] Siç u theksua më lart, neni 84, paragrafi 9, i Kushtetutës përcakton kompetencën për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese. Kjo kompetencë e përcaktuar e Presidentes sipas dispozitës kushtetuese të lartpërmendur është e gjerë në kuptim dhe nuk i nënshtrohet asnjë rezervimi, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet specifike të renditura në nenin 113 të Kushtetutës. Andaj, mund të konstatohet se Presidentja e Kosovës mund të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese nëse një çështje e tillë është nën jurisdiksionin e Gjykatës Kushtetuese, me kushtin që këto pyetje të ndërlidhen me interpretimin e Kushtetutës ose vlerësimin e përputhshmërisë se ligjeve dhe akteve tjera me Kushtetutën, siç e parasheh neni 112 i Kushtetutës.*
>
> *Përkundër faktit që jurisdiksioni i Gjykatës Kushtetuese rregullohet posaçërisht sipas nenit 113, kufiri i jashtëm i kompetencës së Gjykatës Kushtetuese është i përcaktuar me nenin 112 të Kushtetutës, që parasheh se "Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën." [Theksi i shtuar]. Mandati që i është dhënë Gjykatës Kushtetuese për të qenë autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës, sipas nenit 112 të Kushtetutës, barte përgjegjësinë për Gjykatën Kushtetuese që jo vetëm të sigurojë përputhshmërinë e ligjeve dhe akteve tjera me Kushtetutën, por që gjithashtu të garantojë zbatim konsistent të dispozitave kushtetuese dhe të shmangë çfarëdo konflikti ndërmjet këtyre dispozitave. Duke marrë parasysh rëndësinë e mandatit të Gjykatës Kushtetuese për të siguruar konsistencën e normave kushtetuese me njëra tjetrën, Gjykata Kushtetuese është e detyruar të ushtrojë këtë funksion kurdo që një çështje rreth përputhshmërisë së normave kushtetuese i adresohet saj nga autoritetet që janë të mandatuara të zbatojnë dispozita të caktuara kushtetuese. Pikërisht, qëllimi i nenit 84, paragrafi 9, të Kushtetutës është t'i mundësojë Presidentes të referojë çështje rreth përputhshmërisë dhe konsistencës së dispozitave kushtetuese*

gjatë ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të mandatuara me Kushtetutë. Ky argument vërtetohet nga fakti që një e drejtë e ngjashme i është dhënë Qeverisë së Kosovës sipas nenit 93, paragrafi 10, të Kushtetutës. Kjo dëshmon që qëllimi i normave të lartpërmendura kushtetuese është t'i japin institucioneve, kompetencat e të cilave rrjedhin nga dhe renditen në Kushtetutë, me autoritetin për të ngritur çështje në Gjykatën Kushtetuese me qëllim që t'ua mundësojë atyre ushtrimin e funksioneve në përputhje të plotë me gjuhën dhe frymën e Kushtetutës.

Duke marrë parasysh këtë, është e qartë që kërkesa e parashtruar në Gjykatën Kushtetuese nga Presidentja e Kosovës sipas nenit 84, paragrafi 9, të Kushtetutës, mbi vlerësimin e përputhshmërisë së normave kushtetuese që lidhen me ushtrimin e mandatit të saj është e pranueshme. Një kërkesë e këtillë do të duhej të konsiderohej si e pranueshme për këto arsye: (i) Presidentja e Kosovës është e mandatuar të referoj çështje të tilla sipas nenit 84, paragrafi 9, i Kushtetutës; (ii) natyra e çështjeve është ekskluzivisht kushtetuese pasi që ato lidhen me kompetencat kushtetuese të Presidentes; dhe (iii) çështjet kanë për qëllim që të sigurojnë zbatim konsistent të kompetencave që Kushtetuta i ka dhënë Presidentes. Në lidhje më këtë, duhet theksuar se Gjykata Kushtetuese në rastin Nr. KO 98/ 11, kur ka shqyrtuar pranueshmërinë e kërkesës së bërë nga Qeveria e Kosovës sipas nenit 93, paragrafi 10 - që është identik me nenin 84, paragrafi 9, të Kushtetutës -ka vendosur që "nëse çështjet janë çështje kushtetuese atëherë Qeveria do të jetë palë e autorizuar dhe kërkesa do të jetë e pranueshme." Kjo dëshmon që Gjykata Kushtetuese e ka njohur rëndësinë e rolit aktiv që kanë palët e autorizuara për të ngritur çështje të natyrës kushtetuese që i mundëson Gjykatës Kushtetuese të ushtrojë mandatin e saj për të interpretuar Kushtetutën me qëllim të ruajtjes së konsistencës së vet. Pra, vetëm për këtë arsye, kjo kërkesë duhet të shpallet e pranueshme.

Pa paragjykim të analizës së lartpërmendur, duhet të theksohet që autoriteti i Presidentes për të parashtruar këtë kërkesë gjithashtu tërthorazi rrjedhë nga neni 113, paragrafi 3, pika 1 dhe 5, e Kushtetutës. Siç dihet, pika 1 e nenit 113, paragrafi 3, e Kushtetutës flet për konfliktin në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit, Presidentes dhe Qeverisë. Ndonëse gjuha e kësaj dispozite kushtetuese është e kufizuar në konfliktet e jashtme në ushtrimin e kompetencave të institucioneve të lartpërmendura, vlera që kërkohet të

mbrohet është zbatimi konsistent i Kushtetutës, e cila gjithashtu mund të cungohet kur ekziston një konflikt i brendshëm në ushtrimin e kompetencave kushtetuese të këtyre institucioneve. Meqë kjo kërkesë lidhet me ushtrimin e kompetencave të Presidentes për të mandatuar kandidatin për Kryeministër pas zgjedhjeve, është e qartë që një pyetje e tillë bie përbrenda vlerës që synohet të mbrohet nga neni 113, paragrafi 3, i Kushtetutës. Pra, vetëm për këtë arsye, kjo kërkesë duhet të shpallet e pranueshme.

Për më shumë, kërkesa duhet të shpallet e pranueshme sipas pikës 5 të nenit 113, paragrafi 3, të Kushtetutës meqë çështja ka për qëllim të parandalojë shkelje të Kushtetutës gjatë procesit të krijimit të institucioneve të zgjedhura në mënyrë demokratike, siç janë Kuvendi dhe Qeveria. Norma e lartpërmendur ligjore e autorizon Presidenten të ngrisë çështje se a është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit. Vlera që mbrohet nga kjo dispozite kushtetuese është zbatim i plotë i kushtetutshmërisë gjatë procesit më të rëndësishëm për secilën shoqëri demokratike, zgjedhja e institucioneve të saj përfaqësuese dhe qeverisëse. Duke marrë parasysh rolin e Presidentes si garantues i funksionimit kushtetutes të institucioneve, të mishëruar në nenin 84 të Kushtetutës, është detyrim i Presidentes të sigurojë jo vetëm që shkeljet e tilla të adresohen kurdo që ndodhin, por edhe të parandalohen kurdo që kjo është e mundur. Në këtë drejtim, mënyra më e matur për të proceduar tutje me rastin e një ballafaqimi të tille të mospërputhshmërisë direkte të dy normave kushtetuese gjatë ushtrimit të autoritetit të mandatuar nga kjo Kushtetutë është që të kërkohet udhëzim nga Gjykata Kushtetuese në përputhje me nenin 84, paragrafin 9, të Kushtetutës. Mbi këtë bazë, kjo kërkesë duhet të shpallet e pranueshme qoftë edhe vetëm për këtë arsye.
…"

17. Rrjedhimisht, parashtruesja argumenton se, në rastin konkret, janë plotësuar kriteret e specifikuara në nenin 84 (9), në nenin 113.3.1 dhe në nenin 113.3.5 të Kushtetutës.

18. Neni 84 (9) i Kushtetutës thotë:

"Neni 84 [Kompetencat e Presidentit]

Presidenti i Republikës së Kosovës…

(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese…".

19. Prandaj, në përputhshmëri me nenin 84 (9) të Kushtetutës, Presidenti i Republikës së Kosovës është i autorizuar të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese.

20. Andaj, Gjykata duhet të vlerësojë nëse çështjet e shtruara janë "çështje kushtetuese", sipas nenit 84 (9) të Kushtetutës.

21. Për të vlerësuar si duhet këtë çështje, është e nevojshme një përmbledhje e historisë faktike të rastit, që shkaktoi parashtrimin e këtyre pyetjeve në Gjykatën Kushtetuese.

Përmbledhje e fakteve lidhur me pyetjet në fjalë

22. Më 7 maj 2014, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e jashtëzakonshme plenare, vendosi për shpërbërjen e legjislaturës së katërt të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

23. Më 8 maj 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës, dekretoi zgjedhjet e parakohshme që do të mbaheshin më 8 qershor 2014.

24. Më 8 qershor 2014, u mbajtën zgjedhjet në Republikën e Kosovës.

25. Më 27 qershor 2014, KQZ-ja publikoi rezultatet e zgjedhjeve.

Konkluzioni për pranueshmërinë

26. Nuk është detyrë e Gjykatës të vlerësojë faktet e një rasti të caktuar, por faktet e lartpërmendura duket të kenë ngritur çështje kushtetuese lidhur me dy dispozitat kushtetuese, pra të nenit 84 (14) dhe të nenit 95 të Kushtetutës.

27. Rrjedhimisht, në bazë të nenit 84 (9) të Kushtetutës, Gjykata gjen se pyetjet e parashtruara nga parashtruesja e kërkesës janë të natyrës kushtetuese. Ato kanë për qëllim sigurimin e aplikimit konsistent të kompetencave të Presidentit të Republikës, të mandatuara me Kushtetutë, në pajtim me shkronjën dhe me frymën e Kushtetutës.

28. Duke marrë parasysh këto vlerësime, Gjykata konsideron se nuk ka bazë për të deklaruar kërkesën, e cila ngrit çështje të rëndësishme kushtetuese, të papranueshme ose për t'u lëshuar në baza shtesë të pranueshmërisë, të paraqitura nga parashtruesja e kërkesës.

Analiza krahasimtare

29. Para se të hyjë në analizimin e çështjeve kushtetuese, Gjykata do të bëjë një studim krahasues të dispozitave kushtetuese të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: Korniza Kushtetuese) si dhe të një varg shtetesh fqinje dhe të tjera.

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë

30. Korniza Kushtetuese, në nenin 9.1.26 dhe në nenin 9.2.4, parasheh:

> ***Kreu 9 – Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes***
>
> ***Pjesa 1: Kuvendi***
>
> ***Përgjegjësitë e Kuvendit***
>
> *9.1.26 Kuvendi ka përgjegjësitë e mëposhtme:*
>
> *(d) Miraton ose refuzon kandidatin për Kryeministër, së bashku me listën e ministrave të Qeverisë së propozuar nga kandidati për Kryeministër;*
>
> ***Pjesa 2: Kryetari i Kosovës***
>
> *9.2.4 Kryetari i Kosovës, duke u mbështetur në këtë Kornizë Kushtetuese dhe në ligjin e zbatueshëm, ushtron këto funksione:*
>
> *(b) Pas konsultimeve me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend ia propozon Kuvendit Kryeministrin e Qeverisë;*

Shqipëria

31. Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 96, parasheh:

> *1. Presidenti i Republikës, në fillim të legjislaturës, si dhe kur vendi i Kryeministrit mbetet vakant, emëron*

Kryeministrin me propozim të partisë ose koalicionit të partive, që ka shumicën e vendeve në Kuvend.

2. *Në qoftë se Kryeministri i emëruar nuk miratohet nga Kuvendi, Presidenti emëron një Kryeministër të ri brenda 10 ditëve.*

3. *Në qoftë se edhe Kryeministri i emëruar rishtas nuk miratohet nga Kuvendi, brenda 10 ditëve Kuvendi zgjedh një Kryeministër tjetër. Në këtë rast Presidenti emëron Kryeministrin e ri.*

4. *Kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri, Presidenti i Republikës shpërndan Kuvendin.*

Bullgaria

32. Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë, në nenin 99, parasheh:

1. *Pas konsultimeve me grupet parlamentare, Presidenti cakton mandatarin për Kryeministër të nominuar nga partia që mban numrin më të madh të ulëseve në Asamblenë Kombëtare për të formuar qeverinë.*

2. *Në qoftë se mandatari për Kryeministër dështon në formimin e qeverisë brenda shtatë ditësh, Presidenti do t'ia besoj këtë detyrë mandatarit për Kryeministër të nominuar nga grupi i dytë më i madh parlamentar.*

3. *Në qoftë se mandatari i ri për Kryeministër poashtu dështon në formimin e qeverisë brenda periudhës së paraparë në paragrafin paraprak, Presidenti do t'ia besojë detyrën mandatarit për Kryeministër të nominuar nga njëra prej grupeve parlamentare pakicë.*

4. *Në qoftë se konsultimet rezultojnë të suksesshme, Presidenti do të kërkojë nga Asambleja Kombëtare që të zgjedhë mandatarin për kryeministër.*

5. *Në qoftë se nuk arrihet asnjë marrëveshje për formimin e qeverisë, Presidenti do të caktojë qeveri në detyrë, të shpërbëjë Asamblenë Kombëtare dhe caktojë zgjedhjet brenda afatit të paraparë me nenin 64 paragrafi 3. Akti i Presidentit për shpërbërjen e Asamblesë Kombëtare poashtu cakton edhe datën për zgjedhjet e përgjishme.*

6. Procedura për formimin e qeverisë e përcaktuar me paragrafët paraprak më pastaj aplikohet në rastet e referuara në nenin 111 paragrafi 1.

7. Në rastet e referuara në paragrafët 5 dhe 6, Presidenti nuk shpërbën Asamblenë Kombëtare gjatë tre muajve të fundit të mandatit të saj. Në qoftë se Parlamenti dështon të formojë qeverinë brenda periudhës së paraparë, Presidenti cakton një qeveri në detyrë.

Kroacia

33. Kushtetuta e Kroacisë, në nenet 98, 110, 111 dhe 112, parasheh:

Neni 98

Presidenti i Republikës:

- *Shpall zgjedhjet për Parlamentin Kroat dhe thërret seancën e tij të parë;*
- *Shpall referendumin, në pajtueshmëri me Kushtetutën;*
- *I beson mandatin për formimin e qeverisë personit i cili, sipas ndarjes së ulëseve në Parlamentin Kroat dhe konsultimeve të mbajtura, gëzon besimin e shumicës së anëtarëve të tij;*
- *Jep falje;*
- *Jep dekorata dhe çmime të tjera të specifikuara me ligj;*
- *Kryen detyra të tjera të parapara me Kushtetutë.*

Neni 110

Anëtarët e qeverisë i propozon personi të cilit Presidenti i Republikës i ka besuar mandatin për formimin e qeverisë.

- *Menjëherë pas formimit të qeverisë, por jo më vonë se 30 ditë nga pranimi i mandatit, mandatari është i obliguar që t'i paraqesë Parlamentit Kroat qeverinë dhe programin e saj dhe të kërkojë votëbesimin.*

- *Qeveria do të marrë detyrat e saja kur të fitojë besimin e shumicës së të gjithë anëtarëve të Parlamentit Kroat.*

- *Kryeministri dhe anëtarët qeverisë do të bëjnë betimin solemn para Parlamentit Kroat. Teksti i betimit përcaktohet me ligj.*

- *Në bazë të vendimit të Parlamentit Kroat për shprehjen e besimit qeverisë së Republikës së Kroacisë, vendimin për emërimin e Kryeministrit e sjellë Presidenti i Republikës, bashkë me nënshkrimin e Presidentit të Parlamentit Kroat, dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të qeverisë e sjellë Kryeministri bashkë me nënshkrimin e Presidentit të Parlamentit Kroat.*

Neni 111

Në qoftë se mandatari dështon të formojë qeverinë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të mandatit, Presidenti i Republikës mund të vendosë për zgjatjen e afatit për jo më shumë se 30 ditë shtesë.

Në qoftë se mandatari dështon të formojë qeverinë edhe gjatë afatit shtesë, ose në qoftë se qeveria e propozuar nuk arrin të fitojë besimin e Parlamentit Kroat, Presidenti i Republikës i beson mandatin për formimin e qeverisë një personi tjetër.

Neni 112

Në qoftë se qeveria nuk formohet në pajtueshmëri me nenet 110 dhe 111 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës emëron qeverinë e përkohshme jopartiake dhe njëkohësisht shpall zgjedhjet e parakohshme për Parlamentin Kroat.

Gjermania

34. Ligji Themelor i Republikës së Gjermanisë, në nenin 63, përcakton:

Neni 63 [Zgjedhja e Kancelarit Federal]

1. *Kancelari Federal emërohet nga Bundestagu pa debatuar për propozimin e Presidentit Federal.*

2. Zgjidhet personi që merr votat e shumicës së Anëtarëve të Bundestagut. Personi i zgjedhur emërohet nga Presidenti Federal.

3. Nëse personi i propozuar nga Presidenti Federal nuk është zgjedhur, Bundestagu mund të zgjedhë një Kancelar Federal brenda katërmbëdhjetë ditësh pas votimit nga votat e më shumë se gjysmës së anëtarëve të vet.

4. Nëse brenda kësaj periudhe nuk zgjidhet Kancelari Federal, zgjedhjet e reja duhet të zhvillohen pa vonesë, në të cilat zgjidhet personi që merr numrin më të madh të votave. Nëse personi i zgjedhur merr votat e shumicës së Anëtarëve të Bundestagut, Presidenti Federal emëron atë brenda shtatë ditëve pas zgjedhjeve. Nëse personi i zgjedhur nuk merr një shumicë të tillë, atëherë brenda shtatë ditësh Presidenti Federal ose emëron atë ose shpërndan Bundestagun.

Greqia

35. Kushtetuta e Greqisë, në nenin 37, përcakton:

Neni 37

1. Presidenti i Republikës emëron Kryeministrin dhe me rekomandimin e tij emëron dhe shkarkon anëtarët e tjerë të Kabinetit dhe Nënsekretarët.

2. Lideri i partisë që ka shumicën absolute të vendeve në Parlament emërohet Kryeministër. Në qoftë se asnjë parti nuk ka shumicën absolute, Presidenti i Republikës do t'i japë liderit të partisë me një shumicë relative një mandat eksplorues në mënyrë që të përcaktojë mundësinë e formimit të një Qeverie që gëzon konfidencën e Parlamentit.

3. Nëse kjo mundësi nuk mund të përcaktohet, Presidenti i Republikës i jep mandatin eksplorues liderit të partisë së dytë më të madhe në Parlament, dhe nëse kjo dështmohet si jo e suksesshme, atëherë partisë së tretë më të madhe në Parlament. Secili mandat eksplorues mbetet në fuqi për tri ditë. Nëse të gjitha mandatet eksploruese dështmohen si jo të suksesshme, Presidenti i Republikës fton të gjithë liderët e partive, dhe në qoftë se konfirmohet pamundësia për të formuar një Kabinet që gëzon konfidencën e Parlamentit, ai

do të përpiqet të formojë një Kabinet të përbërë nga të gjitha partitë në Parlament me qëllim të mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare. Nëse kjo dështon ai do t'ia besojë Kryetarit të Gjykatës Supreme Administrative apo të Gjykatës Civile Supreme dhe Gjykatës Penale, apo të Gjykatës së Auditimit për të formuar një Kabinet si të pranuar sa më gjerësisht që është e mundur për të kryer zgjedhjet dhe shpërbën Parlamentin.

4. *Në rastet që mandati për të formuar një Kabinet ose një mandat eksplorues është dhënë në përputhje me paragrafët e lartpërmendur, nëse partia nuk ka lider ose zëdhënës të partisë, ose në qoftë se lideri apo zëdhënësi nuk është zgjedhur në Parlament, Presidenti i Republikës i jep mandatin një personi të propozuar nga grupi parlamentar i partisë. Propozimi për caktimin e mandatit duhet të ndodhë brenda tri ditëve nga dita e komunikimit të Kryetarit të Kuvendit ose zëvendësit të tij me Presidentin e Republikës përkitazi me numrin e vendeve të poseduara nga çdo secila parti në Parlament; komunikimi i sipërpërmendur duhet të ndodhë para se të jetë dhënë çfarëdo mandati.*

Maqedonia

36. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, në nenet 84 dhe 90, përcakton:

Neni 84

Presidenti i Republikës së Maqedonisë

- *Cakton mandatarin për formimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.*

Neni 90

Kryetari i Republikës së Maqedonisë është i obliguar që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e konstituimit të Kuvendit, mandatin për formimin e Qeverisë t'ia besojë kandidatit të partisë, përkatësisht të partisë/partive që ka/kanë shumicën në Kuvend.

Mandatari, në afat prej 20 ditësh nga dita e besimit të mandatit, Kuvendit ia paraqet programin dhe i propozon përbërjen e Qeverisë.

Qeverinë, me propozimin e mandatarit dhe në bazë të programit, e zgjedh Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Portugalia

37. Kushtetuta e Portugalisë, në nenin 187, përcakton:

Titulli IV - Qeveria

Kapitulli II. Formimi dhe përgjegjësitë

Neni 187 Formimi

1. Presidenti i Republikës emëron Kryeministrin pas konsultimit me partitë me vende në Kuvendin e Republikës dhe në dritën e rezultateve zgjedhore.

2. Presidenti i Republikës emëron anëtarët e mbetur të Qeverisë me propozim nga ana e Kryeministrit.

Sllovenia

38. Kushtetuta e Republikës së Sllovenisë, ne nenin 111, përcakton:

Neni 111. Zgjedhja e Kryetarit të Qeverisë

Pas konsultimit me liderët e grupeve parlamentare, Presidenti i Republikës i propozon Kuvendit Kombëtar kandidatin për Kryetar të Qeverisë.

Kryetari i Qeverisë zgjidhet nga Kuvendi Kombëtar me shumicën e votave të të gjithë deputetëve përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Kushtetutë. Votimi është i fshehtë.

Nëse kandidati i tillë nuk merr shumicën e nevojshme të votave, Presidenti i Republikës, pas përsëritjes së konsultimeve, mund të propozojë brenda katërmbëdhjetë ditësh një kandidat të ri ose të njëjtin kandidat sërish, po ashtu kandidatët mund të propozohen edhe nga grupet parlamentare ose së paku nga dhjetë deputetë. Nëse brenda kësaj periudhe janë propozuar disa kandidatë, për secilin votohet veç e veç, duke filluar me kandidatin e propozuar nga Presidenti i Republikës, dhe nëse ky kandidat nuk zgjidhet, votohet për kandidatët tjerë sipas rendit të propozimit të tyre.

Nëse nuk zgjidhet asnjë kandidat, Presidenti Republikës e shpërndan Kuvendin Kombëtar dhe thërret zgjedhje të reja, përveç nëse brenda katërdhjetë e tetë orësh Kuvendi Kombëtar me shumicën e votave të hedhura nga deputetët e pranishëm vendos të mbajë zgjedhje të reja për Kryetarin e Qeverisë, ku shumica e votave të hedhura nga deputetët e pranishëm është e mjaftueshme për zgjedhjen e kandidatit. Në rast të zgjedhjeve të tilla të reja, votohet individualisht për kandidatët sipas radhitjes së numrit të votave të fituara në votimin e mëhershëm dhe pastaj për kandidatët e rinj të propozuar para votimit të ri, ku cilido kandidat që propozohet nga Presidenti i Republikës ka përparësi.

Nëse në zgjedhjet e tilla asnjë kandidat nuk merr numrin e nevojshëm të votave, Presidenti i Republikës e shpërndan Kuvendin Kombëtar dhe thërret zgjedhje të reja.

Historiku i zgjedhjeve në Kosovë

39. Më 17 nëntor 2001, Kosova mbajti zgjedhjet e para të përgjithshme parlamentare sipas dispozitave të Kornizës Kushtetuese. LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës) fitoi 46.2 % të votave, duke marrë 47 vende në Parlament. Partia e dytë më e madhe ishte PDK-ja (Partia Demokratike e Kosovës) që fitoi 25.5 % të votave, prandaj fitoi 26 vende në Parlament, e pasuar nga Aleanca Kthimi, që fitoi 10.9 % të votave, duke marrë 22 vende në Parlament, dhe AAK (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës) që fitoi 7.8 % të votave, duke marrë 8 vende në Parlament.

40. LDK nuk arriti të merrte mbështetjen e mjaftueshme për të qeverisur vetëm. Pas këtij dështimi, LDK-ja u tërhoq nga kërkesa për të pasur postin e Kryeministrit dhe u pajtua të nominojë si mandatar për Kryeministër z. Bajram Rexhepi nga partia e dytë më e madhe, përkatësisht nga PDK-ja. Në pajtim me Kornizën Kushtetuese, neni 9.2.4 (b), Kryetari i Kosovës i propozoi Kuvendit z. Bajram Rexhepi për Kryeministër, i cili mori mbështetjen e Kuvendit në pajtim me nenin 9.1.26 (d).

41. Më 23 tetor 2004, Kosova mbajti zgjedhjet e dyta të përgjithshme parlamentare sipas dispozitave të Kornizës Kushtetuese. Në bazë të informacionit të marrë nga KQZ-ja, Gjykata vëren se LDK fitoi 45.42 % të votave, duke marrë 47 vende në Kuvend, PDK-ja fitoi 28.85 % të votave, duke marrë 30 vende në Kuvend, AAK-ja fitoi

8.39 % të votave, duke marrë 9 vende në Kuvend, dhe ORA fitoi 6.2 % të votave, duke marrë 7 vende në Kuvend.

42. LDK nuk arriti të merrte mbështetjen e mjaftueshme për të qeverisur vetëm. Pas këtij dështimi, LDK u tërhoq nga kërkesa për të pasur postin e Kryeministrit dhe u pajtua të nominojë z. Ramush Haradinaj si mandatar për Kryeministër, nga partia e tretë më e madhe, përkatësisht nga AAK-ja. Në pajtim me Kornizën Kushtetuese, neni 9.2.4 (b), Kryetari i Kosovës i propozoi Kuvendit z. Ramush Haradinaj për Kryeministër, i cili mori mbështetjen e Kuvendit në pajtim me nenin 9.1.26 (d).

43. Më 17 nëntor 2007, Kosova mbajti zgjedhjet e treta të përgjithshme parlamentare sipas dispozitave të Kornizës Kushtetuese. Në bazë të informacioneve të marra nga KQZ-ja, Gjykata vëren se PDK-ja mori 37 vende në Kuvend, ndërsa LDK-ja mori 25 vende në Kuvend.

44. Pas zgjedhjeve në vitin 2007, Kryetari i Kosovës i propozoi Kuvendit z. Hashim Thaçi për Kryeministër, i cili mori mbështetjen e Kuvendit, në pajtim me nenin 9.1.26 (d) të Kornizës Kushtetuese.

45. Më 12 dhjetor 2010, Kosova mbajti zgjedhjet e përgjithshme parlamentare sipas Kushtetutës së tanishme, me ç'rast PDK-ja fitoi 32.11 % të votave, duke marrë 34 vende në Kuvend, LDK-ja fitoi 24.69 % të votave, duke marrë 27 vende në Kuvend, dhe Vetëvendosje fitoi 12.69 % të votave, duke marrë 14 vende në Kuvend.

46. Pas zgjedhjeve në vitin 2010, Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës nominoi kandidat për Kryeministër z. Hashim Thaçi, i cili mori mbështetjen e Kuvendit më 22 shkurt 2011.

Meritat e kërkesës

Argumentet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës

47. Gjykata vëren se parashtruesja ka paraqitur argumentet në vijim:

> "*Neni 84 i Kushtetutës renditë kompetencat kushtetuese të Presidentes. Siç është evidente, shumica e këtyre kompetencave lidhen me autoritetin për të emëruar kryesuesit e institucioneve të ndryshme publike, përfshirë por duke mos u kufizuar në gjyqësorin, forcat e sigurisë dhe misionet*

diplomatike. Emëruesi i përbashkët i këtyre kompetencave të Presidentes është fakti se – përderisa vendimi i Presidentes është përfundimtar - vet akti i emërimit është më shumë formal. Kjo për shkak se aktit të emërimit nga Presidentja i paraprinë një proces gjithëpërfshirës i verifikuar nga një institucion tjetër i mandatuar nga Kushtetuta, siç janë Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial ose Qeveria.

Duke marrë parasysh këtë dhe para parashtrimit të pyetjeve specifike lidhur me përputhshmërinë e nenit 84, paragrafi 14 me nenin 95 të Kushtetutës, kërkohet që Gjykata Kushtetuese të qartësojë natyrën e kompetencave të Presidentes për të emëruar dhe/ose mandatuar zyrtarët publikë për të ushtruar kompetencat e tyre të mandatuara me Kushtetutë sipas rendit tonë kushtetues, në përgjithësi, dhe në veçanti të qartësojë emërimin e kandidatit për Kryeministër pas zgjedhjeve? Përkatësisht, në këtë rast a është formale kompetenca e Presidentes në atë se certifikon se procesi, i cili i ka paraprirë aktit të emërimit, është zhvilluar në përputhje me Kushtetutën apo është thelbësore duke i mundësuar Presidentes të ushtrojë diskrecion (të plotë) në ushtrimin e kompetencave të lartpërmendura?

Lidhur me çështjen e mospërputhshmërisë, çështje kjo e cila ka nxitur parashtrimin e kësaj kërkese, duhet të theksohet që neni 84, paragrafi 14, i Kushtetutës parasheh se Presidentja "cakton mandatarin për formimin e qeverisë pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit që përbën shumicën e Kuvendit" [Theksi i shtuar}. Në anën tjetër, neni 95, paragrafi 1, i Kushtetutës thotë "pas zgjedhjeve , Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon kandidatin për Kryeministër në konsultim me partinë politike ose koalicion që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë". Konflikti mes këtyre dy normave kushtetuese është i trefishtë. Përderisa teksti në nenin 84, paragrafi 14 i Kushtetutës është partia ose koalicioni "që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë". Mospërputhshmëria ndërmjet këtyre dy normave kushtetuese thellohet nga fakti se përderisa gjuha e nenit 84, paragrafi 1, të Kushtetutës është në kohën e tashme, gjuha në nenin 95, paragrafi 1, të Kushtetutës është në kohën e shkuar. Së fundi, përderisa gjuha sipas nenit 84, paragrafi 14, nuk përmban asnjë kualifikim, gjuha në nenin 95, paragrafi 1, kualifikohet me frazën "e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë".

Vlerësimet e Gjykatës

48. Gjykata vëren se parashtruesi kërkon vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës dhe shtron pyetjet e renditura më lart.

49. Demokracia, "*vox populi*" (zëri i popullit), kërkon zgjedhjen e atyre që do të përfaqësojnë zërin e popullit në organin legjislativ të shtetit. Në një demokraci parlamentare, ky është subjekti më i lartë drejtues i veshur me një shumëllojshmëri të kompetencave, që në të njëjtën kohë i nënshtrohet parimit të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit ndërmjet tyre. Një nga përgjegjësitë kryesore të parlamentit është që të vendosë duke votuar se kë të fuqizojë me funksione ekzekutive. Qeveria rrjedh nga fuqia mbizotëruese politike brenda parlamentit dhe i ka rrënjët në forcën politike që fiton zgjedhjet. Kjo mund të jetë një fitore absolute apo relative.

50. Siç shihet më lart, secili shtet ka dispozitat e veta juridike, të përcaktuara në Kushtetutë, në ligje ose në instrumente të tjera juridike lidhur me këto çështje.

51. Gjykata vëren se, kur dispozitat kushtetuese nuk janë të qarta, një nga mundësitë e interpretimit është që t'i kthehemi *Travaux Preparatoires* në mënyrë që të kuptojmë më mirë se si dhe pse hartuesit kanë formuluar tekstin e këtyre dispozitave kushtetuese ashtu si është. Megjithatë, përkitazi me Kushtetutën, Gjykata kishte kërkuar më parë nga Kuvendi, në Rastin KO98/11, të 20 shtatorit 2011, që të ofronte *Travaux Preparatoires* të Kushtetutës. Gjykata kurrë nuk mori përgjigje.

52. Në rastin e tanishëm, Gjykata kërkoi përsëri nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të paraqesin *Travaux Preparatoires* të Kushtetutës në lidhje me nenin 84.14 dhe me nenin 95 të Kushtetutës. Më 20 qershor 2014, Sekretari i Përgjithshëm iu përgjigj Gjykatës se ata nuk i kanë *Travaux Preparatoires* të Kushtetutës.

53. Për këtë arsye, në mungesë të *Travaux Preparatoires* të Kushtetutës, Gjykata duhet të interpretojë vetë, në përputhje me nenin 112 të Kushtetutës, se në çfarë mënyre është i autorizuar Presidenti i Republikës, sipas neneve të mësipërme të Kushtetutës, të caktojë kandidatin për Kryeministër dhe sipas cilës procedurë.

54. Neni 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] i Kushtetutës përcakton:

> *"Presidenti i Republikës së Kosovës:*
> *...*
> *cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;"*
> *...*

55. Neni 95 [Zgjedhja e Qeverisë] i Kushtetutës përcakton:

> *1. Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.*
>
> *2. Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.*
>
> *3. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.*
>
> *4. Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, Brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.*
>
> *5. Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.*
>
> *6. Anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit. Teksti i betimit rregullohet me ligj.*

56. Gjykata rithekson se juridiksioni i saj kryesor është përcaktuar në nenin 112 të Kushtetutës, që përcakton:

> "*1. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.*
>
> *2. Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saj.*"

57. Gjykata vëren se, parashtruesja, ka ngritur në kërkesë pyetje të detajuara që dalin nga nevoja, sipas saj, për vlerësim kushtetues të përputhshmërisë së nenit 84 (14) me nenin 95 të Kushtetutës. Këto nene kanë të bëjnë me kompetencat e Presidentit të Republikës, respektivisht me procedurën që duhet ndjekur për formimin e Qeverisë pas zgjedhjeve të përgjithshme. Gjykata konsideron se është e mjaftueshme të bëhet interpretimi i nenit 84 (14) në lidhje me nenin 95 të Kushtetutës.

58. Në kuadër të autoritetit të vet sipas nenit 112 të Kushtetutës, Gjykata do të bëjë interpretimin e nevojshëm. Kështu, Gjykata do të respektojë shkronjën dhe frymën e Kushtetutës dhe parimet e demokracisë dhe të qeverisjes demokratike.

Funksioni dhe roli i Presidentit të Republikës

59. Gjykata vëren se neni 83 i Kushtetutës i referohet statusit të Presidentit të Republikës me fjalët në vijim: "*Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës*".

60. Për më tepër, në pajtim me nenin 4.3 të Kushtetutës, *"[...] Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësuesi legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë"*.

61. Gjykata rikujton se mandati i Presidentit të Republikës është i pacenueshëm për të siguruar respektim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe për ta ruajtur sigurinë në rendin juridik dhe kushtetues (shih rastet KO29/12 dhe KO48/12, Amendamentet e propozuara kushtetuese të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe më 4 maj 2012, Aktgjykimi i 20 korrikut 2012).

62. Gjykata konsideron se disa nga kompetencat e Presidentit prekin shumë qartë jetën politike të vendit, sikurse ato që përmenden në

tekstin e neneve të Kushtetutës, të cilat janë objekt i çështjes së kërkesës.

63. Duke pasur parasysh kompetencat e konsiderueshme të dhëna Presidentit të Republikës në bazë të Kushtetutës, Gjykata konsideron se është e arsyeshme që publiku të marrë me mend se Presidenti i tyre, që "përfaqëson unitetin e popullit" dhe jo interesat grupore ose interesat politike partiake, do t'i përfaqësojë të gjithë ata. Çdo qytetar i Republikës ka të drejtë të sigurohet për paanshmërinë, për integritetin dhe për pavarësinë e Presidentit të tyre. Kjo, për më tepër, kur Presidenti i Republikës ushtron kompetenca politike sikurse kur bën zgjedhjen ndërmjet kandidatëve konkurrentë nga koalicione të mundshme për t'u bërë Kryeministër (rasti KI47/10, parashtrues: Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i 28 shtatorit 2010).

64. Objekti i kërkesës së tanishme, në të vërtetë, ka të bëjë me kompetencat e Presidentit të Republikës, si kreu i shtetit dhe në përfaqësim të unitetin të popullit të Republikës së Kosovës, për të caktuar mandatarin për formimin e Qeverisë, në përputhje me procedurën që duhet ndjekur për formimin e qeverisë pas zgjedhjeve të përgjithshme.

65. Meqenëse nenet 84 (14) dhe 95 të Kushtetutës janë të ndërlidhura ngushtë, Gjykata do t'i interpretojë ato së bashku.

Interpretimi i nenit 84 (14) të Kushtetutës

66. Teksti i nenit 84.14 të Kushtetutës autorizon Presidentin e Republikës të marrë pjesë në formimin e qeverisë së re. Neni numëron një sërë elementesh:

(a) Presidenti cakton mandatarin për Kryeministër;

(b) Pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit;

(c) Që përbën shumicën në Kuvend.

67. Sa i përket pikës (a) *Presidenti cakton mandatarin për Kryeministër*, Gjykata konsideron se teksti i nenit është i qartë dhe i prerë: mandatari për Kryeministër caktohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës me vendim në të cilin personi i caktuar përmendet në mënyrë eksplicite. Në lidhje me këtë, Gjykata përsërit se Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës së

Kosovës, më 18 shkurt 2011, në bazë të nenit 84 (14), të nenit 90 dhe të nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, si dhe të Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Nr. 231-2011, të 7 shkurtit 2011, nominoi *"[...] mandatarin, z. Hashim Thaçi, mandatar për Kryeministër për formimin e qeverisë së Republikës së Kosovës"*.

68. Sa i përket pikës (b) *Pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit*, Gjykata është e mendimit se propozimi për emërimin duhet të rrjedhë nga partia politike ose nga koalicioni i cili do t'ia paraqesë Presidentit të Republikës emrin e personit për mandatar për Kryeministër. Formulimi i përdorur e thotë qartë se emri i mandatarit duhet të propozohet nga partia politike ose nga koalicioni i regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhje të përgjithshme. Si rezultat i kësaj, nuk është në diskrecionin e Presidentit të Republikës që ai/ajo me vetiniciativë të propozojë kandidatin e tillë.

69. Termi "parti politike", i përmendur në nenin 84.14, është definuar në nenin 3 [Përkufizimet] dhe i referuar në nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-073, të 5 qershorit 2008, i cili parasheh:

"*Neni 3 [Përkufizimet]*

Për qëllim të këtij ligji,

[...]

"Parti politike" do të thotë një organizim i individëve të cilët janë bashkuar vullnetarisht mbi bazën e ideve, interesit dhe pikëpamjeve të përbashkëta, me qëllim të ushtrimit të ndikimit dhe pasjes së përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në zyrë publike, ose siç e përcaktuar ndryshe me legjislacionin në fuqi;

[...].

Neni 17 [Partitë Politike]

"17.1 Partia politike mund të certifikohet për pjesëmarrje në zgjedhje nëse dëshmon se regjistrimi në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2004/11 nuk është nën pezullim.

17.2 Zyra e informon KQZ-në rreth statusit të regjistrimit të secilës parti politike aplikuese para përfundimit të procedurës së certifikimit."

70. Në dritën e këtyre dispozitave, Gjykata është e mendimit se partia politike e cekur në nenin 84 (14) duhet të jetë subjekt politik i regjistruar nga KQZ-ja dhe duhet të ketë kaluar pragun e përcaktuar nga KQZ-ja pas zgjedhjeve.

71. Për më tepër, termi "koalicion", i përdorur në nenin 84 (14), i referuar në nenin 3 [Përkufizimet] dhe në nenin 18 [Koalicionet] të Ligjit për Zgjedhjet, parasheh si vijon:

"*Neni 3 [Përkufizimet]*

Për qëllim të këtij ligji:

[...]

"*Koalicioni" do të thotë koalicioni i dy ose më shumë subjekteve politike*;

[...].

"Neni 18 [Koalicionet]

18.1 Koalicioni mund të certifikohet për të garuar në zgjedhje nën një emër, me kusht që përbëhet vetëm nga partitë politike që kanë të drejtë për t'u certifikuar sipas nenit 15.4 të këtij ligji.

18.2 KQZ-ja e trajton koalicionin si një subjekt politik të vetëm nga dita kur koalicioni është certifikuar nga ajo e deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Partia politike nuk mund të tërhiqet nga koalicioni pasi që të jetë certifikuar, derisa rezultatet e zgjedhjeve të certifikohen.

18.3 Pas shpërbërjes së koalicionit, secila nga partitë politike të regjistruara të cilat kanë qenë anëtare të koalicionit janë përgjegjëse për një ndarje të të gjitha borxheve të shkaktuara nga koalicioni në përpjesëtim me marrëveshjen për koalicionin, përfshirë gjobat e papaguara të ngarkuara nga KQZ-ja apo KZAP-i.

18.4 Partia politike që është anëtare e koalicionit nuk mund të marrë pjesë si anëtare në një koalicion tjetër apo si parti politike e veçantë në të njëjtat zgjedhje.

[...]."

72. Në dritën e dispozitave të lartpërmendura, Gjykata konsideron se termi "koalicion", në nenin 84 (14) të Kushtetutës, ka të bëjë me subjektet e pranuara politike, të cilat janë certifikuar nga KQZ-ja si "koalicion për të garuar në zgjedhjet përkatëse nën një emër" dhe që kanë kaluar pragun e përcaktuar nga KQZ-ja pas zgjedhjeve. Andaj, koalicionet, të cilat nuk janë certifikuar nga KQZ-ja, nuk kanë të drejtë, sipas nenit 84 (14), për të propozuar mandatarin për Kryeministër.

73. Sa i përket pikës (c) *që përbën shumicën në Kuvend*, Gjykata vëren se, në mënyrë që votuesit të hedhin votat e tyre, partia politike ose koalicioni, i cili, sipas ligjit të lartpërmendur, është regjistruar si subjekt zgjedhor, ka emrin e vet në fletëvotim, ka marrë pjesë në zgjedhje dhe ka kaluar pragun, ka të drejtë sipas nenit 84 (14) të Kushtetutës, të propozojë personin për mandatar për Kryeministër.

74. Në këtë drejtim, në tekstin e mëtejmë, përdorimi i termave "parti politike ose koalicion", kur përmenden në lidhje me nenin 84 (14) dhe me nenin 95, paragrafi 1 dhe 4, të Kushtetutës, nënkuptohet partia politike ose koalicioni që është regjistruar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, merr pjesë si subjekt zgjedhor, është i përfshirë në fletëvotim të zgjedhjeve, e kalon pragun dhe, rrjedhimisht, fiton vende në Kuvend.

75. Kjo parti politike ose koalicion duhet të ketë shumicën në Kuvend. Sipas interpretimit të Gjykatës, "shumica" ka po të njëjtin kuptim siç aplikohet në jurisprudencën dhe në praktikën kushtetuese dhe se duhet të jetë në pajtueshmëri me parimet kushtetuese në një shoqëri demokratike. Shumica mund të jetë absolute, më shumë se gjysma e të gjitha vendeve në Kuvend, ose relative, pra më shumë vende se partitë e tjera politike ose koalicionet që janë regjistruar në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

76. Gjykata rithekson se, më 12 dhjetor 2010, Republika e Kosovës mbajti zgjedhjet e përgjithshme parlamentare në bazë të Kushtetutës aktuale. Në bazë të rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve, PDK-ja nuk kishte shumicën absolute të vendeve në Kuvend.

77. Gjykata vëren se Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës, në bazë të dispozitave kushtetuese dhe të rezultateve të zgjedhjeve, e caktoi z. Hashim Thaçin kandidat për Kryeministër nga PDK-ja, parti kjo që kishte fituar shumicën relative, pra më së shumti vende në Kuvend në krahasim me partitë e tjera politike që ishin

regjistruar në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, që kishin marrë pjesë në zgjedhje dhe që kishin kaluar pragun.

78. Për më tepër, Gjykata vëren se Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës, në Vendimin e tij për caktimin e kandidatit për Kryeministër, theksoi:

> *"II. Mandatari i nominuar z. Hashim Thaçi në afatin më të shkurt kohor, ftohet të bëjë konsultimet e nevojshme me partitë politike për të formuar koalicionin për Qeverinë e re dhe të dalë me propozim para Kuvendit Republikës së Kosovës".*

79. Si rrjedhojë, më 22 shkurt 2011, z. Hashim Thaçi mori mbështetjen si Kryeministër i Qeverisë së re me 65 vota për, 1 abstenim dhe 0 kundër, në seancën e jashtëzakonshme plenare.

80. Kriteri "që përbën shumicën në Kuvend", nga neni 84.14 i Kushtetutës, duhet lexuar në lidhje me dispozitën e nenit 95, paragrafi 1,të Kushtetutës, pra, partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend, pra numrin më të madh të vendeve.

81. Gjykata vëren se neni 95, paragrafi 1, merret me procedurën sipas së cilës Presidenti i propozon Kuvendit *"[...] kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë"*. Pra, në këtë nen mund të dallohen një sërë elementesh:

(a) Presidenti i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër;

(b) në konsultim me partinë politike ose me koalicionin;

(c) që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend;

(ç) [e nevojshme] për të formuar Qeverinë.

82. Këto elemente janë kumulative dhe përbëjnë parakusht që Presidenti i Republikës të bëjë konsultimet e nevojshme me partinë ose me koalicionin që ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend.

83. Sa i përket pikës (a) *Presidenti i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër*, Gjykata i referohet formimit të mëhershëm të Qeverisë, në vitin 2011, kur, me Vendimin e 18 shkurtit 2011, Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës, z. Jakup Krasniqi, e nominoi në Kuvend z. Hashim Thaçi mandatar për formimin e Qeverisë, në bazë të rezultateve të certifikuara, të dërguara më 8

shkurt 2011 Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës nga KQZ-ja dhe e propozoi atë, si të tillë, në Kuvend.

84. Sa i përket pikave (b) *në konsultim me partinë politike ose koalicionin* dhe (c) *që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend,* marrë si të kombinuara, Gjykata vëren se me Vendimin e lartpërmendur të Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës, kandidati i nominuar gjithashtu ftohej të bënte konsultimet e nevojshme me partitë politike për Qeverinë e re, pasi partia e tij nuk kishte shumicën absolute në Kuvend. Lidhur më këtë, Gjykata rithekson se Presidenti i Republikës mund të konsultohet vetëm me partinë politike ose me koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, qoftë shumicën absolute, qoftë relative.

85. Sa i përket pikës (ç) *[e nevojshme] për të formuar Qeverinë*, Gjykata konsideron se shprehja "[e nevojshme] për të formuar Qeverinë" do të thotë se partia politike ose koalicioni që duhet të konsultohet është ajo që ka vende të mjaftueshme në Kuvend për të formuar shumicën. Pra, se a do të ketë partia politike ose koalicioni votat e nevojshme për formimin e Qeverisë do të përcaktohet nga votimi në Kuvend.

86. Prandaj, Presidenti i Republikës nuk mund të parashikojë që partia politike ose koalicioni të cilën ai/ajo duhet ta konsultojë për nominim të mandatarit do të marrë shumicën e mjaftueshme të votave në Kuvend për të formuar Qeverinë e propozuar nga mandatari. Prandaj, shprehja *"[e nevojshme] për të formuar Qeverinë"* ka të njëjtin kuptim sikurse në nenin 84 (14) të Kushtetutës, ashtu që partia politike ose koalicioni mund të jetë vetëm ajo që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhje, respektivisht numrin më të madh të vendeve në Kuvend. Është e qartë, kjo parti ose ky koalicion ka marrë mbështetjen më të madhe nga votuesit për të qeverisur vendin.

87. Sidoqoftë, Gjykata vëren se nuk përjashtohet që partia ose koalicioni në fjalë do të refuzojë të marrë mandatin.

88. Rregulli dhe parimet demokratike, si dhe korrektësia politike, parashikueshmëria dhe transparenca, kërkojnë që partisë politike ose koalicionit që ka fituar numrin më të madh të vendeve, si rezultat i zgjedhjeve t'i jepet mundësia të propozojë kandidatin për Kryeministër për formimin e Qeverisë. Presidenti i Republikës nuk e ka diskrecionin të aprovojë ose të mos aprovojë nominimin e

mandatarit nga partia ose nga koalicioni, por duhet të sigurojë caktimin e tij/saj.

Interpretimi i nenit 95, paragrafit 4, të Kushtetutës

89. Sa i përket interpretimit të nenit 95, paragrafi 4, Gjykata vëren se kjo dispozitë e precizon procedurën sipas së cilës Presidenti i Republikës emëron kandidatin tjetër për Kryeministër, duke ndjekur të njëjtën procedurë, nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr votat e nevojshme në Kuvend. Ky nen numëron dy elemente:

(a) Presidenti emëron kandidatin tjetër;

(b) sipas së njëjtës procedurë.

90. Ky nen qëndron i heshtur në pyetjen se cila parti ose cili koalicion e propozon kandidatin e ri për Kryeministër. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, është në diskrecionin e Presidentit të Republikës që, pas konsultimeve me partitë dhe me koalicionet, të vendosë se cilës parti ose cilit koalicion do t'i jepet mandati për të propozuar kandidatin tjetër për Kryeministër.

91. Nuk duhet të përjashtohet që Presidenti i Republikës mund të vendosë t'i japë të njëjtës parti ose koalicion edhe një rast për të propozuar kandidatin tjetër, që mund të jetë i suksesshëm në formimin e Qeverisë së re, duke marrë votat e nevojshme në Kuvend.

92. Gjykata konsideron se Presidenti i Republikës duhet të vlerësojë se cila është gjasa më e madhe që një parti politike ose koalicion të propozojë kandidatin për Kryeministër, i cili do të marrë votat e nevojshme në Kuvend për formimin e Qeverisë së re.

93. Gjykata rithekson se neni 95, paragrafi 4, i Kushtetutës kërkon që të ketë një kandidat tjetër për Kryeministër, por e lë të hapur çështjen se cilës parti ose cilit koalicion do t'i jepet mandati për të propozuar kandidatin për Kryeministër.

94. Pasi që, sipas Kushtetutës, Presidenti i Republikës përfaqëson shtetin dhe unitetin e popullit, është përgjegjësi e Presidentit të ruajë stabilitetin e vendit dhe të gjejë kritere mbizotëruese për formimin e qeverisë së re, në mënyrë që të shmangen zgjedhjet.

95. Prandaj, Gjykata konkludon se dispozitat kushtetuese janë mjaftueshëm të qarta dhe në përputhshmëri me njëra-tjetrën për të çuar deri te formimi i Qeverisë së re në pajtim me vullnetin e votuesve.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 84 (9) dhe të nenit 112 të Kushtetutës, si dhe të rregullit 56.1 të Rregullores së punës, më 30 qershor 2014,

VENDOS

I. Njëzëri, TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. Me shumicë votash, TË KONSTATOJË që:

a. Nenet 84 (14) dhe 95 të Kushtetutës janë në përputhshmëri me njëri-tjetrin;

b. Përdorimi i termave "parti politike ose koalicion", kur përmenden në lidhje me nenin 84 (14) dhe me nenin 95, paragrafët 1 dhe 4, të Kushtetutës, nënkupton partinë politike ose koalicionin që është regjistruar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, merr pjesë si subjekt zgjedhor, është i përfshirë në fletëvotim të zgjedhjeve, e kalon pragun dhe, rrjedhimisht, fiton vende në Kuvend;

c. Partia ose koalicioni që ka fituar shumicën në Kuvend, siç përcaktohet në nenin 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, nënkupton partinë ose koalicionin që ka shumicën e vendeve në Kuvend, qoftë shumicën absolute, qoftë atë relative;

ç. Presidenti Republikës, në bazë të nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër të nominuar nga partia politike ose nga koalicioni që ka numrin më të madh të vendeve në Kuvend;

d. Presidenti i Republikës nuk e ka diskrecionin të refuzojë caktimin e kandidatit të propozuar për Kryeministër;

dh. Në rast se kandidati i propozuar për Kryeministër nuk merr votat e nevojshme, Presidenti Republikës, në

diskrecionin e tij/saj, në bazë të nenit 95, paragrafi 4, të Kushtetutës, emëron kandidatin tjetër për Kryeministër, pas konsultimit me partitë ose me koalicionet (e regjistruara në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme) që kanë plotësuar kriteret e lartpërmendura, pra me parti ose me koalicion që është regjistruar si subjekt zgjedhor në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, e ka emrin në fletëvotim të zgjedhjeve, ka marrë pjesë në zgjedhje dhe ka kaluar pragun;

e. Nuk përjashtohet që Presidenti i Republikës të vendosë t'i japë partisë ose koalicionit të parë, sipas nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, mundësinë të propozojë kandidatin tjetër për Kryeministër;

III. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

Rasti Nr. KO103/14
Parashtrues
Presidentja e Republikës së Kosovës
Përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84, paragrafi 14, me nenin 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

MENDIM MOSPAJTUES I GJYQTARIT ROBERT CAROLAN

Shkëlqesia e Saj, Presidentja e Republikës së Kosovës, ka kërkuar që kjo Gjykatë të qartësojë se çfarë është autoriteti dhe përgjegjësia e saj sipas Kushtetutës lidhur me emërimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Ajo, gjithashtu, kërkon nga kjo Gjykatë që të qartësojë nëse ka konflikt ndërmjet nenit 84 (14) dhe 95, paragrafi 1, të Kushtetutës, lidhur me autoritetin dhe me përgjegjësitë e saj për emërimin e Kryeministrit.
Me gjithë respektin, nuk pajtohem dhe jam kundër opinionit të shumicës së kësaj Gjykate, për arsyet si në vijim.

Si kreu i shtetit, që përfaqëson unitetin e popullit, Presidentja e Republikës është apolitike. Neni 83 i Kushtetutës parasheh:

> *Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikë së Kosovës.*

Në atë rol, kërkohet nga Presidentja që t'i propozojë Kuvendit një kandidat në mënyrë që Kuvendi ta miratojë Kryeministrin. Ky kandidat duhet të miratohet nga shumica e deputetëve në Kuvend, para se ai ose ajo të mund të emërohet nga Presidentja. Në qoftë se kandidati i emëruar nuk e ka miratimin e shumicës së deputetëve në Kuvend, ka shumë gjasa që ai ose ajo nuk do të jetë në gjendje të formojë Qeverinë, që kërkon miratimin e shumicës së deputetëve në Kuvend.
Para se ta bëj këtë propozim, Presidenti duhet së pari të konsultohet **ose** me partinë politike **ose** me koalicionin që ka fituar shumicën e

nevojshme në Kuvend, jo në zgjedhjet nacionale, për ta themeluar Qeverinë. Shih nenin 95.1 të Kushtetutës. Qeveria formohet pasi merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Shih nenin 95.3 të Kushtetutës.
Nëse kandidati i propozuar nga Presidenti miratohet me shumicën e votave të deputetëve në Kuvend, Presidenti duhet ta emërojë Kryeministër kandidatin e suksesshëm. Shih nenin 84 (14) të Kushtetutës. Nëse kandidati i propozuar nga Presidenti nga shumica e deputetëve në Kuvend nuk miratohet nga shumica e deputetëve në Kuvend, atëherë Presidenti duhet të propozojë një kandidat tjetër, sipas të njëjtës procedurë. Nëse ajo procedurë nuk rezulton me një kandidat që merr shumicën e votave të deputetëve në Kuvend, atëherë Presidenti duhet të shpallë një tjetër raund të zgjedhjeve nacionale parlamentare. Shih nenin 95.4 të Kushtetutës.

Presidenti është i autorizuar dhe i obliguar, sipas nenit 95, paragrafi 1, të Kushtetutës:

> *Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.* (theks i shtuar)

Nëse kandidati i propozuar nga Presidenti merr miratimin e shumicës së votave të deputetëve në Kuvend, Presidenti i Republikës autorizohet dhe kërkohet, sipas nenit 84 (14) të Kushtetutës:

> *cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike **ose** të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;* (theks i shtuar)

Nëse kandidati i propozuar nuk zgjidhet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit, neni 95, paragrafi 4 parasheh që Presidenti:

> *"... brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë".*

Prandaj, nenet 84 (14) dhe 95, paragrafi 1, të Kushtetutës janë në përputhshmëri dhe konsistente. Të dy nenet, neni 84 dhe 95, e drejtojnë dhe e autorizojnë Presidentin që të propozojë dhe të emërojë një kandidat për Kryeministër, që të konsultojë partinë politike **ose** koalicionin që ka shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë. Ka shumë gjasa që hartuesit e Kushtetutës kishin për qëllim që termi "partia politike ose koalicioni që përbën shumicën në Kuvend" në nenin 84 (14) e ka kuptimin e njëjtë me "partinë politike ose koalicionin

që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë" në nenin 95.1. Në të vërtetë, përpara se Presidenti të mund të emërojë Kryeministrin, në pajtim me nenin 84 (14), ai kandidat duhet të ketë marrë miratimin e partisë ose të koalicionit në Kuvend, që përbën shumicën e Kuvendit, jo të partisë politike ose të koalicionit që ka fituar zgjedhjet.

Për qëllim të interpretimit të neneve 95, paragrafi 1, dhe 84 (14), të Kushtetutës, Gjykata gjithashtu është pyetur nëse një "parti politike" ose "koalicion" duhet të ekzistojë para se të mbahen zgjedhjet parlamentare. Edhe pse ligjet për zgjedhje në Kosovë mund të vendosin disa kufizime lidhur me atë se kush ose çfarë mund të jetë një "parti politike" ose "koalicion" për qëllim të pjesëmarrjes në zgjedhje, Kushtetuta nuk ka kufizim të ngjashëm lidhur me atë nëse subjekti duhet të ekzistojë para zgjedhjeve. Për shembull, Ligji për Zgjedhje në Kosovë, Nr. 03/L-073, e definon "koalicionin" dhe "partitë politike." Ligji i lartcekur ka të bëjë me mbajtjen e zgjedhjeve dhe me atë se kush mund të merr pjesë në to, e jo me procedurën e emërimit të Kryeministrit në Kuvend.

Është me rëndësi të rikujtohet se Kushtetuta e Republikës së Kosovës është ratifikuar më 9 prill 2008 dhe ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. Ligji për Zgjedhje në Kosovë, Nr. 03/L-073, lidhur me partitë politike dhe koalicionet që dëshirojnë të marrin pjesë dhe të garojnë në zgjedhje në Kosovë, ishte nxjerrë më 5 qershor 2008, 57 ditë pas ratifikimit të Kushtetutës. Edhe Kushtetuta edhe Ligji për Zgjedhje e përdorin termin "koalicione". Nuk ka ndonjë autoritet që mund të konstatojë se termi "koalicion" ka kuptimin e njëjtë si në Kushtetutë ashtu edhe në Ligj, i cili është nxjerrë pasi është aprovuar Kushtetuta. Prandaj, do të ishte gabim të supozohej se hartuesit e Kushtetutës, me përdorimin e termit "koalicion" në Kushtetutë, kishin për qëllim që ai term të interpretohej në mënyrë të ngjashme me atë si mund të interpretohet në Ligjin për Zgjedhje. Për shembull, Ligji për Zgjedhjet kërkon që një "koalicion" mund të regjistrohet zyrtarisht në një numër të caktuar të ditëve para zgjedhjeve, në mënyrë që të lejohet të marrë pjesë dhe të garojë në zgjedhje. Kushtetuta nuk ka ndonjë kufizim të ngjashëm ose interpretim se çka përbën një "koalicion". *Merriam Webster Dictionary,* në anën tjetër, e definon përdorimin më të shpeshtë të termit "koalicion", si:

> *"një grup i njerëzve, grupe, ose vende që janë bashkuar për një qëllim të përbashkët".*

Është e arsyeshme të konkludohet se hartuesit e Kushtetutës e synonin këtë definicion, e jo atë më restriktiv në Ligjin për Zgjedhje, për të cilin ata nuk kanë mundur të dinë kur e miratuan Kushtetutën.

Ka shumë gjasa që hartuesit e Kushtetutës morën parasysh Rregulloren nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, kur ata i hartuan nenet 95 dhe 84 (14) të Kushtetutës. Kjo Rregullore kishte ekzistuar gjatë tetë vjetëve të kaluara dhe ishte korniza qeverisëse për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës. Në lidhje me emërimin e Kryeministrit, neni 9.3.8 i Kornizës Kushtetuese është udhëzues përkitazi me synimin e hartuesve të Kushtetutës aktuale. Ai në mënyrë specifike parashikon:

> *Zgjedhja e Kryeministrit dhe ministrave*
>
> *9.3.8 Pas zgjedhjeve, ose në rast se Kryeministri jep dorëheqjen apo nëse vendi i tij mbetet i lirë për arsye të tjera, Kryetari i Kosovës, pas konsultimeve me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, ia propozon Kuvendit një kandidat për Kryeministër. Kandidati i propozuar i paraqet Kuvendit një listë me ministrat e propozuar. Kryeministri bashkë me ministrat zgjidhen nga shumica e deputetëve të Kuvendit.* (Theks i shtuar).

Ashtu si Kushtetuta aktuale, Korniza Kushtetuese e autorizonte Presidentin e Kosovës që të konsultohet me jo vetëm një parti të vetme politike në Kuvend, por me parti të shumta, me koalicione dhe me grupe në Kuvend me të njëjtin qëllim që Presidenti të propozojë kandidatin për Kryeministër që kishte më shumë gjasa të zgjidhej nga shumica e anëtarëve të Kuvendit. Ashtu si Kushtetuta e tanishme, Korniza Kushtetuese nuk kërkonte që "koalicionet ose grupet" të jenë të regjistruara apo të ekzistojnë formalisht para zgjedhjeve për Kuvend, në mënyrë që të konsultohen me Presidentin e Kosovës lidhur me vendimin e tij ose të saj për të propozuar një kandidat për Kryeministër.
Në të vërtetë, praktika e mëparshme në Kosovë e emërimit të Kryeministrit ka lejuar "koalicion" formal ose joformal pas zgjedhjeve parlamentare, që është formuar qartazi për të lejuar emërimin e suksesshëm të Kryeministrit nga shumica në Kuvend. Në katër zgjedhjet e kaluara parlamentare në Kosovë, asnjë parti politike nuk fitoi shumicën absolute të vendeve në Kuvend. Në secilin prej rasteve të mëparshme, qoftë koalicion formal apo informal ishte formuar pas zgjedhjeve, në mënyrë që pastaj të lejojë që kandidati i propozuar për Kryeministër të fitojë miratimin e shumicës së nevojshme në Kuvend, për të formuar Qeverinë.

Sipas Kushtetutës, nga Kuvendi pritet që ta zgjedhë Kryeministrin me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit. Nëse Kuvendi nuk është në gjendje që ta arrijë këtë objektiv kushtetues pas dy raundeve të votimit, atëherë duhet të ketë zgjedhje parlamentare. Është e arsyeshme që të arrihet në përfundimin se zgjedhjet pasuese parlamentare, të cilat

munden ose jo të rezultojnë me një Kuvend të ri që do të jetë në gjendje të zgjedhë një Kryeministër, nuk ishin preferuar nga hartuesit e Kushtetutës. Prandaj, është mjaft e qartë se hartuesit e Kushtetutës kishin për qëllim që Presidentit t'i jepnin autorizim të gjerë për nominimin e një kandidati, i cili do të kishte mundësinë më të mirë të fitojë miratimin e shumicës së nevojshme në Kuvend, për ta formuar Qeverinë, për të maksimizuar mundësinë e zgjedhjes së suksesshme të këtij kandidati në Kuvend.

Kushtetuta kërkon që Kryeministri duhet të miratohet nga shumica në Kuvend para se ai ose ajo të mund të emërohen. Kushtetuta autorizon dhe kërkon nga Presidenti që të konsultohet **ose** me partinë kryesore politike **ose** me koalicionin në Kuvend, të nevojshëm për të formuar Qeverinë para se t'i propozohet Kuvendit një kandidat për Kryeministër. Kjo kërkesë duhet t'i maksimizojë mundësitë që kandidati i propozuar do të miratohet në mënyrë që të shmanget shpërndarja e Kuvendit dhe zgjedhjet pasuese, të cilat munden ose jo të jenë njësoj të pasuksesshme në mundësinë e formimit të një Qeverie. Hartuesit e Kushtetutës kishin për qëllim që shumica e anëtarëve të Kuvendit duhet të zgjedhin Kryeministrin e tyre. Çdo interpretim tjetër mund të çojë në situatë ku Kryeministri të mos ketë mbështetjen e anëtarëve në Kuvend, që rrjedhimisht do të rezultonte në dështimin pothuajse të sigurt të Qeverisë, që nuk do të mund të ishte synimi i hartuesve të Kushtetutës.
Shumica e kësaj Gjykate ka arritur në përfundimin e gabuar se hartuesit e Kushtetutës kishin për qëllim që shprehja "ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë", siç paraqitet <u>në nenin 95.1 të Kushtetutës</u> e ka kuptimin si "shumica që kishte fituar zgjedhjet e mëparshme", edhe pse në Kushtetutë një shprehje e tillë nuk është përdorur ose referuar ndonjëherë. Është e rëndësishme të dihet se hartuesit kishin kuptuar se në shumë raste partia politike ose koalicioni i formuar para zgjedhjeve mund të mos fitojë shumicën absolute të vendeve në Kuvend, që rezulton me pluralizëm të partive që fitojnë vende në Kuvend. Në qoftë se kjo ndodh, si në të gjitha zgjedhjet parlamentare në Kosovë deri më sot, shumica e Gjykatës nuk arrin të shpjegojë se si shprehja "e nevojshme për të formuar Qeverinë" thjesht do të thotë partia politike apo koalicioni që ka marrë më shumë vota në zgjedhjet e mëparshme, edhe pse për të formuar Qeverinë një grup i tillë do të kishte nevojë për miratim jo vetëm nga anëtarët e partisë së tyre politike ose koalicionit që mund të ketë qenë formuar para zgjedhjeve.

Shumica e Gjykatës gjithashtu konstaton se, në qoftë se kandidati i parë i propozuar nga Presidentja nuk arrin të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit, atëherë ajo duhet të përdorë një procedurë tjetër për të propozuar kandidatin tjetër për Kryeministër. Ky përfundim është

qartazi i gabuar dhe e injoron gjuhën e qartë të nenit 95.4 të Kushtetutës. Ai nen shprehimisht parasheh:

> *Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë*. (theks i shtuar)

Edhe një herë, Presidentja mund të konsultohet me këdo që ajo beson se është parti politike ose koalicion, që përbën shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.

E dorëzoi me respekt,
Robert Carolan
Gjyqtar

KI22/14, Lulzim Hoti, Aktvendim i datës 12 maj 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 237/2013, të 5 nëntorit 2013

Rasti KI22/14, vendimi i 12 majit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, supozim i pafajësisë, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit.

Parashtruesi i kërkesës, Lulzim Hoti, parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës të Kosovës, duke kontestuar Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 237/2013, të 5 nëntorit 2013, si të nxjerrë në shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], parimi i supozimit te pafajësisë dhe neni 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës. Që të dy këto parime janë shkelur ngase e tërë procedura e udhëhequr ka qenë e drejtuar me kritere personale dhe me paragjykimin e fajit.

Lidhur me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur dëshmi se procedurat relevante ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Prandaj, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48, rregullat 36 (1) c) dhe 36 (2) a) dhe d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI22/14
Parashtrues
Lulzim Hoti
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 237/2013, të 5 nëntorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Lulzim Hoti (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i fundit është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 237/2013, i 5 nëntorit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit në një datë të pacaktuar.

3. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) vëren se parashtruesi i kërkesës në formularin e kërkesës, në mënyrë të veçantë e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 232/08, të 24 majit 2010.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], parimi i supozimit të pafajësisë dhe neni 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) janë shkelur.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 6 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 6 mars 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI22/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI22/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 10 mars 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje Gjykatës Supreme dhe Ministrisë së Drejtësisë.

9. Më 12 maj 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 5 mars 2007, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë mori vendimin, me të cilin konstatoi se parashtruesi i kërkesës, e kishte shkelur rëndë *"[...] nenin 30.1 (a), (b) të Kodit të Mirësjelljes së Nëpunësve Civil, paraparë sipas Urdhëresës Administrative të*

UNMIK-ut nr. 2003/02 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001 /36 mbi Shërbimin Civilë të Kosovës, e në pajtim me hapin 4. pika 4.2.1, 4.2.2 të Udhëzimit Administrativ nr. MSHP/DASHC 2003/04, sipas nenit 4 pika 4.1, 4.2, 4.5 dhe 4.6 të Kodit të Mirësjelljes të Nëpunësve Civil nr. 01/2006 dhe sipas Kodit të Disiplinë të Shërbimit Korrektues të Kosovës PSV 9.2, Standardi i parë pika 4 nen (f), (g) (h) dhe (k), dhe standardi i katërt pika 7 nën (b), (d), (f) dhe (g). Kështu, Komisioni disiplinor ia shkëputi kontratën e punës parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Bordin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, kundër këtij vendimi.

11. Më 7 maj 2007, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të parakohshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ishte ankuar te Komisioni për Ankesa në Ministrinë e Drejtësisë. Pas kësaj, parashtruesi i kërkesës u ankua te Komisioni për Ankesa në Ministrinë e Drejtësisë.

12. Më 6 gusht 2007, Komisioni për Ankesa i Ministrisë së Drejtësisë e hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi vendimin e Komisionit disiplinor të 5 marsit 2007. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij vendimi te Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës.

13. Më 5 tetor 2007, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi vendimin e Komisionit të Ankesave të Ministrisë së Drejtësisë, të 6 gushtit 2007. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës konstatoi se *"Nga lënda shkresore e prezantuar shihet se procedura disiplinore është zbatuar në formën e paraparë. Zyrtarët e personelit duke vepruar në bazë të paraqitjes të shkeljes disiplinore dhe kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore, e kanë zbatuar procedurën e paraparë dhe rasti i është referuar Komisionit disiplinor. Vendimi i Komisionit disiplinor është i ligjshëm dhe i bazuar në gjendjen e plotë faktike, deklaratat e palëve dhe provat e prezantuara nga palët. Ankuesi nuk ka prezantuar dëshmi me të cilat do të dëshmonte se nuk e ka kryer shkeljen disiplinore e cila me Kodin e Disiplinës të Shërbimit Korrektues të Kosovës është përcaktuar shkelje e rëndë e disiplinës".*

14. Më 24 maj 2010, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktgjykimin C. nr. 232/08, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, me të cilën kishte kërkuar anulimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Gjykata Komunale

konstatoi se *"Me shikimin dhe vlerësimin e provave të administruara të përmendura më lartë është vërtetuar se me datën 25.08.2006 është iniciuar procedura disiplinore kundër paditësit, për arsye se paditësi ka pranuar cigare dhe para nga familjarët për të burgosurin A.A.. Komisioni Disiplinor me vendimin nr.44 të dt. 05.03.2007 ka konstatuar se me këto veprime paditësi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore [...]. Kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë paditësi me dt. 12.03.2007 dhe se pas kësaj Komisioni i Ankesave i Ministrisë së Drejtësisë ka marrë vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor. Paditësi procedurën e ka vazhduar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, si organ i fundit administrativ për të vendosur për këtë çështje dhe me dt.05.10.2007 ky organ merr vendimin nr.A 02281/2007, ku e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar, duke e lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Ankesave. Andaj, nga të lartcekurat gjykata erdhi në përfundim se vendimi i të padituri për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është i ligjshëm, pasi është bazuar ne vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, duke zbatuar në përpikëri procedurën disiplinore të paraparë me legjislacionin në fuqi për shërbyesit civil."* Pas kësaj, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

15. Më 25 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin Ac. nr. 572/2010, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, të 24 majit 2010. Gjykata e Qarkut konstatoi se *"Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, nuk qëndrojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2 të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkeljet tjera për të cilat pretendon ankesa. Gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, e njëjta ka dhënë arsye të bazuara e në përputhje me gjendjen në shkresat e lendës dhe provave të proceduara, arsye këto që janë të pranueshme edhe për kolegjin e kësaj gjykate".* Përafërsisht 9 (nëntë) muaj më vonë, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër këtij aktgjykimi.

16. Më 5 nëntor 2013, Gjykata Supreme (me Aktvendimin Rev. nr. 237/2013) e hodhi poshtë si të paaftashme kërkesën për revizion. Gjykata Supreme konstatoi se *"Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e kishte pranuar aktgjykimin e shkalles së dytë më 8.10.2012 dhe afati për parashtrimin e kërkesës për revizion*

kishte filluar më 9.10.2012, kur përfaqësuesi parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar aktgjykimi, dhe dita e fundit për ushtrimin e revizionit kishte qenë 7.11.2012, përderisa revizioni ishte paraqitur më 5.7.2013, d.m.th. pas afatit të lejuar […]".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën në punë dhe të drejtën e pafajësisë. Që të dy këto parime janë shkelur ngase e tërë procedura e udhëhequr ka qenë e drejtuar me kritere personale dhe me paragjykimin e fajit, i cili asnjëherë gjer më tani nuk është vërtetuar në ndonjë procedurë të rregulltë gjyqësore. Pra ndërprerja e marrëdhënies së punës është iniciuar dhe realizuar në saje të supozimit të një vepre penale e cila asnjëherë nuk është vërtetuar".*

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh se:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

20. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, që parashohin:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *[…]*
>
> *c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.*

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;

[...]

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

21. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit të kërkesës pretendon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

22. Megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të sqarojë si dhe pse janë shkelur këto të drejta kushtetuese me vendimin e kontestuar. Pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me një vendim ose përmendja e thjeshtë e neneve dhe dispozitave të Kushtetutës nuk mjaftojnë për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohet shkelja kushtetuese, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë argument bindës dhe të arsyetuar mirë në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar.

23. Gjykata thekson që nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet faktike apo juridike (ligjshmëria), që pretendohen të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç dhe deri në masën që mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu që, kjo Gjykatë nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt. Është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin KI14/13, parashtruese *Komuna e Podujevës* dhe Aktvendimi për papranueshmëri, i 12 marsit 2013).

24. Përveç kësaj, aktvendimet e Gjykatës Supreme dhe gjykatat e instancave të ulta kanë dhënë arsyetim në gjetjet e veta.

25. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, për shkak të faktit se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë në gjendje që t'i arsyetojë pretendimet e tij dhe të sigurojë dëshmi për të mbështetur pretendimet për shkelje kushtetuese me vendimin e kontestuar.

26. Prandaj, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, dhe rregullave 36 (1) c) dhe (2) a) dhe d) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të hidhet poshtë si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) c), 36 (2) a) dhe d) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 12 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 26/12, Bujar Ahmetaj, Aktvendim i datës 8 maj 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, nr. 557/2009, të 9 shkurtit 2012

Rasti KI 26/12, vendim i 8 majit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, cenim i të drejtave dhe lirive kushtetuese, vlerësim i kushtetutshmërisë, mosshterimi i mjeteve juridike.

Parashtruesi ka paraqitur kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese janë cenuar me aktgjykimet e gjykatave të rregullta të të gjitha shkallëve. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtine, P. nr. 557/2009, të 9 shkurtit 2012, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit në një datë të pacaktuar.

Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese, si në vijim:

_ Të përsëritet procedura gjyqësore dhe te konstatohet gjendja reale.

_ Të mundësohet pjesëmarrja në seancë dhe të merren faktet e prezantuara,

_ Të aplikohen dispozitat ligjore të KPK dhe LPPK

_ Të realizohet në tërësi kërkesa e KEK-ut si e pabazë duke u bazuar në LPK neni 37.

_ Te referohet aktgjykimi i prure në kundërshtim me dispozitat e PPKK neni 103 al. 2, 127 pika 3, 182 pika 2 al. i, neni 183, neni 197 pika c".
Përveqë kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata: "që vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta të ndryshohen për shkak të mungesës së provave dhe të shpall atë të pafajshëm".

Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka ushtruar ankesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë brenda afatit ligjor. Parimi i subsidiaritetit parasheh qe parashtruesi i kërkesës të shter të gjitha mundësitë procedurale ne procedurat e rregullta, në mënyre qe t'i parandaloje shkeljet e Kushtetutës, ose, nëse ka, të korrigjoje shkeljet e tilla të të drejtave themelore. Kështu që, parashtruesi i kërkesës duke dështuar për të ndërmarrë veprime procedurale në gjykatat e rregullta ne pajtim me afatet e parapara, faktikisht, mban përgjegjësinë pse rasti i tij

deklarohet i papranueshëm, meqë do te kuptohet si heqje dore nga e drejta për procedim të mëtejshëm për të kundërshtuar shkeljen. Gjykata gjithashtu konsideron se dyshimi i thjeshtë mbi perspektiven e çështjes nuk është i mjaftueshëm për të ndaluar një parashtrues kërkesë nga detyrimet e tij për t'u ankuar para organeve kompetente në kohën e duhur (shih *Whiteside kundiir Mbretiirisii sii Bashkuar,* Vendimi i 7 marsit 1994, parashtresa nr. 20357/92, DR 76, fq. 80). Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme për shkak te mosshterimit të mjeteve juridike te parapara me ligj.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI26/12
Parashtrues
Bujar Ahmetaj
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, nr. 557/2009, të 9 shkurtit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u dorëzua nga z. Bujar Ahmetaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 557/2009, të 9 shkurtit 2012, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet të jetë *"i bazuar në situatën e gabuar faktike"*. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se ai nuk ishte ftuar në seancën shqyrtuese.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese

të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën më 15 mars 2012.

6. Më 25 prill 2012, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI26/12, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI26/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

7. Më 1 mars 2013, Gjykata Komunale u njoftua lidhur me kërkesën.

8. Më 8 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmëri.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 3 gusht 2008, Korporata Energjetike e Kosovës – KEK, bëri zëvendësimin e njehsorëve elektrik, konfirmoi (letra e konfirmimit 31690, nr. 003/43) se parashtruesi i kërkesës kishte *"ndërhyrë në njehsorin elektrik dhe kështu kishte keqpërdorur energjinë elektrike"*.

10. Më 17 mars 2009, prokurori publik në Prishtinë paraqiti aktakuzë (PP. 865-11/2009) kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 252 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës.

11. Më 30 dhjetor 2010, prokurori publik paraqiti kërkesë për urdhër ndëshkimor (PP865-11/2009).

12. Më 11 janar 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin P. 557/2009, shpalli të pranueshme kërkesën e prokurorit publik komunal në Prishtinë dhe e shpalli fajtor parashtruesin nga neni 252 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës. Bazuar në kërkesën e prokurorit publik, Gjykata Komunale në Prishtinë lëshoi një urdhër ndëshkimor në shumë prej 200 eurosh.

13. Gjykata Komunale konstatoi se *"Sipas nenit 476 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, parashihet se për veprat penale për*

të cilat parashikohen dënimet me gjobë ose burgim deri në tre vite, në kërkesë të PPK-së në propozim akuzues gjykata jepë urdhër ndëshkimor pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor".

14. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë ndaj vendimit të lartpërmendur të Gjykatës Komunale. Gjykata nuk është njoftuar për përmbajtjen e ankesës meqë parashtruesi i kërkesës nuk e dorëzoi atë.

15. Më 23 shkurt 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, (Aktvendimi P. nr. 557/2009) e hodhi poshtë si të paafatshme ankesën e parashtruesit të kërkesës, të ushtruar kundër aktgjykimit për dhënien e urdhrit ndëshkimor më 11 janar 2011.

16. Më 9 mars 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi KP. nr. 56/2011), e refuzoi si të pabazuar ankesën e ushtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale, të 11 janarit 2011. Kundër këtij vendimi nuk lejohej ankesë. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër vendimit të lartpërmendur.

17. Më 9 shkurt 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë, (Aktgjykimi P. nr. 557/2009), *"konform nenit 22 par. 3 dhe nenit 445 par. 1 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës e refuzoi ankesën e paraqitur nga parashtruesi sepse nuk është e lejuar ankesa kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale të 11 janarit 2011".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese, si në vijim:

    - *"Të përsëritet procedura gjyqësore dhe të konstatohet gjendja reale.*

    - *Të më mundësohet pjesëmarrja në seancë dhe të merren faktet e prezantuara, me çka do të refuzohet aktakuza e prokurorit si dhe të refuzohet aktakuza e KEK.*

    - *Të aplikohen dispozitat ligjore të KPK dhe LPPK*

    - *Të refuzohet në tërësi kërkesa e KEK-ut si e pabazë duke u bazuar në LPK neni 37.*

- *Të referohet aktgjykimi i prurë në kundërshtim me dispozitat e PPKK neni 103 al. 2, 127 pika 3, 182 pika 2 al. i, neni 183, neni 197 pika c".*

19. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata: *"që vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta të ndryshohen për shkak të mungesës së provave dhe e shpalli atë të pafajshëm".*

Analizat e Kodit të Procedurës Penale në vende të tjera

20. Duke vendosur për kërkesën e parashtruesit, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se ai nuk ishte i pranishëm në shqyrtimin kryesor, Gjykata për krahasim, mund t'i shikojë Kodet e Procedurës Penale të vendeve të tjera në rajon, të tilla si Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Mali i Zi.

Kroacia

Neni 465

"Për veprat në juridiksionin e një gjyqtari të vetëm që vijnë në njohuri të prokurorit të shtetit në bazë të një kallëzimi të besueshëm penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë me një propozim për aktakuzë që gjykata të lëshojë një urdhër penal, duke vendosur me të një dënim ose masë të caktuar kundër të pandehurit pa mbajtur gjykim".

Bosnja

Neni 334

"Për veprat penale për të cilat ligji parashikon dënim me burg deri në pesë (5) vjet ose me gjobë si dënim kryesor, për të cilat prokurori ka mbledhur prova të mjaftueshme për të siguruar bazat për pretendimet e prokurorit se i dyshuari ka kryer veprën penale , prokurori mund të kërkojë, në aktakuzë, nga Gjykata që të lëshojë një urdhër për shqiptimin e dënimit në të cilin një dënim ose masë e caktuar do t'i shqiptohen të akuzuarit pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor".

Mali i Zi

Neni 457

"Për veprat penale të dënueshme me gjobë ose dënim me burgim për një periudhë maksimale, që nuk e kalon një vit si dënim kryesor, me propozim të prokurorit të shtetit, dhe me pëlqimin e të pandehurit, gjyqtari mund të lëshojë një urdhër për shqiptim të dënimit pa mbajtur gjykim".

Pranueshmëria e kërkesës

21. Para së gjithash, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

23. Përveç kësaj, neni 47.2 i Ligjit për Gjykatën po ashtu parasheh:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

24. Për më tepër, rregulli 36 (1) a) i Rregullores së punës, parasheh:

"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar".

25. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka ushtruar ankesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë brenda afatit ligjor.

26. Parimi i subsidiaritetit parasheh që parashtruesi i kërkesës të shter të gjitha mundësitë procedurale në procedurat e rregullta, në mënyrë që t'i parandalojë shkeljet e Kushtetutës, ose, nëse ka, të korrigjojë shkeljet e tilla të të drejtave themelore. Kështu që, parashtruesi i kërkesës duke dështuar për të ndërmarrë veprime procedurale në gjykatat e rregullta në pajtim me afatet e parapara, faktikisht, mban përgjegjësinë pse rasti i tij deklarohet i papranueshëm, meqë do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për procedim të mëtejshëm për të kundërshtuar shkeljen.

27. Gjykata gjithashtu konsideron se dyshimi i thjeshtë mbi perspektivën e çështjes nuk është i mjaftueshëm për të ndaluar një parashtrues kërkese nga detyrimet e tij për t'u ankuar para

organeve kompetente në kohën e duhur (shih *Whiteside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendimi i 7 marsit 1994, parashtresa nr. 20357/92, DR 76, fq. 80).

28. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike të parapara me ligj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) a) e 56 (2) të Rregullores së punës, më 8 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI29/14, Halit Islami, Aktvendim i datës 12 maj 2014- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 138/2013, të 11 korrikut 2013

Rasti KI29/14, vendimi i 12 majit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit

Parashtruesi i kërkesës, Halit Islami, parashtroi kërkesë në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës të Kosovës, duke kontestuar Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 138/2013, të 11 korrikut 2013, të nxjerrë me shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se punëdhënësi ia ndërpreu atij marrëdhënien e punës, duke u bazuar në supozime të pavërteta.

Lidhur me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme si e paafatshme, sepse aktvendimi përfundimtar i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 138/2013 ishte nxjerrë më 7 korrik 2013, dhe i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 12 shtator 2013, ndërsa parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 11 shkurt 2014, që është më shumë se 4 muaj nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar aktvendimi i Gjykatës Supreme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI29/14
Parashtrues
Halit Islami
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 138/2013, të 11 korrikut 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Halit Islami (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në fshatin Brainë, komuna e Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 138/2013, të 7 korrikut 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit më 12 shtator 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e

Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza ligjore

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 mars 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI29/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI29/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 10 mars 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë autorizimin për z. Ramiz Suka i cili përfaqëson atë në Gjykatë. Sidoqoftë Gjykata nuk ka marrë përgjigje deri më tani.

8. Më 10 mars 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe Qendrës së Studentëve të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë.

9. Më 12 maj 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 8 nëntor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin C. nr. 27/10, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit për kthimin në punë në Qendrën e Studentëve të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë. Gjykata Komunale konstatoi se ankesa e parashtruesit të kërkesës nuk ishte mjaft e

qartë dhe, edhe pse Gjykata kishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që ta përmirësojë dhe plotësojë ankesën, parashtruesi nuk kishte vepruar në mënyrë të tillë. Prandaj, në pajtim me nenin 102.3 të Ligjit për procedurën kontestimore, Gjykata e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës. Pas kësaj, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij aktvendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

11. Më 6 nëntor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin Ac. nr. 230/2012, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 8 nëntorit 2011. Gjykata e Qarkut konstatoi se "*Meqenëqë padia ka qen e paqartë, sepse në të nuk është përmendur vendimi se cili është qëllimi i anulimit të kërkesës, paditësit në dy raste i është kthyer padia nga ana e gjykatës së shkallës së parë në plotësim. Paditësi me parashtresat e veta nuk e ka korrigjuar kërkesëpadinë, ashtu që gjykata e shkallës së parë kishte me vepruar në të. Gjithashtu me kërkesëpadinë paditësi nuk e ka pastruar se kush është i padituri në këtë kontest, se a është ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë apo Organi i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës. se kush e ka marr vendimin përfundimtar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Si që është padia e paqartë, nga ato nuk mund të vihet në përfundim se çka konkretisht paditësi propozon. Andaj, në mënyrë të drejtë gjykata e shkallës së parë konstatoi se padia e paditësit është e paqarte, dhe se paditësi me parashtresat e veta nuk e ka korrigjuar padinë, për çka edhe ky e pranon se nuk ka vepruar sipas urdhëresave të gjykatës"*. Pas kësaj, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar revizion në Gjykatën Supreme ndaj këtij aktvendimi.

12. Më 11 korrik 2013, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Rev. nr. 138/2013, e hodhi poshtë si të palejueshëm revizionin ndaj aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Gjykata Supreme gjeti se *"Sipas dispozitës se nenit 228.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore palët mund të paraqesin revizion vetëm kundër aktvendimit të formës së prerë me të cilin përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë. Nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se revizioni në këtë çështje juridike nuk është i lejuar ngase gjykata në këtë çështje ka hedhur padinë në kuptim të nenit 102.3 të LPK, dhe sipas nenit 228.1 të LPK, procedura në këtë çështje nuk ka përfunduar në formë të prerë"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se punëdhënësi ia ndërpreu atij marrëdhënien e punës, duke u bazuar në supozime të pavërteta dhe, me këtë, është shkelur neni 49 [e Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

14. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. […]".*

16. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi, ose*
>
> *[…]".*

17. Vendimi përfundimtar i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 138/2013, është marrë më 7 korrik 2013 dhe i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 12 shtator 2013, ndërsa parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 11 shkurt 2014, që është më shumë se 4 (katër) muaj nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar aktvendimi i Gjykatës Supreme.

18. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme, sepse është e paafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit, rregullat 36 (1) b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 12 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 33/13, Abdyl Pasjaqa, Aktvendim i datës 7 maj 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 167/12, të 29 nëntorit 2012

Rasti KI 33/13, vendimi i 7 majit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesa individuale, qartazi e pabazuar, doktrina e shkallës së katërt.

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 31/2013, i 13 marsit 2013. Gjykata Komunale në Prishtinë shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për shpërdorim të mjeteve financiare të cilat i ishin besuar atij, dhe e dënoi atë me burgim prej 3 vitesh dhe 6 muajsh. Pastaj, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, e anuloi vendimin e Gjykatës Komunale dhe e ktheu rastin për rigjykim. Pas rigjykimit, Gjykata Komunale i shqiptoi të njëjtin dënim. Edhe një herë, parashtruesi parashtroi ankesë kundër aktvendimit të dytë të Gjykatës Komunale. Për herë të dytë, Gjykata e Qarkut gjeti se ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte e bazuar dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale duke liruar parashtruesin e kërkesës nga të gjitha akuzat. Në një fazë të mëvonshme, Kryeprokurori i Shtetit paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme dhe kërkoi që Aktvendimi i dytë i Gjykatës së Qarkut të anulohet dhe procedurat në këtë çështje të rishikohen. Gjykata Supreme gjeti se e drejta penale në këtë rast ishte shkelur në dobi të të pandehurit dhe pasi që ky ishte rasti - ajo vetëm konstatoi shkelje pa e ndryshuar vendimin përfundimtar.

Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese ku ai pretendoi se aktgjykimi i kontestuar kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 6 [Simbolet], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligji], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] paragrafët 2 dhe 4 dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Parashtruesi i kërkesës argumentoi se Gjykata Supreme ishte në kundërshtim me veten në arsyetimin e aktgjykimit të saj.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar. Në arsyetimin e saj, Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk e dëshmoi pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe ai nuk ofroi dëshmi se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga Gjykata Supreme - vendimi i së cilës u kontestua.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI33/13
Parashtrues
Abdyl Pasjaqa
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme,
Pkl. nr. 167/12, të 29 nëntorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Abdyl Pasjaqa, i përfaqësuar nga z. Sadri A. Godanci, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 167/12, të 29 nëntorit 2012, i cili i është dorëzuar atij në dhjetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes ka të bëjë me ankesën e parashtruesit të kërkesës se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 167/12, i 29 nëntorit 2012, është nxjerrë duke e shkelur ligjin dhe parimet kushtetuese.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së

Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 mars 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 25 mars 2013, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 7 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Nga parashtresat e parashtruesit të kërkesës, kuptohet se në fund të viteve nëntëdhjeta, ai kishte migruar në Mbretërinë e Bashkuar, ku ai kishte marrë nënshtetësinë dhe kishte takuar motrat D., përmes një shoku të tij.

9. Më 9 dhjetor 2005, me Aktgjykimin P. nr. 152/2005, Gjykata Komunale në Prishtinë e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor në pajtim me nenin 257.1 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/26 Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK), për shpërdorim të mjeteve financiare, të cilat i ishin besuar atij, duke keqpërdorur besimin e motrave D. dhe e dënoi atë me burgim me 3 (tri) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj, si dhe me pagesën e shumës së përgjithshme prej 210.347,21 eurosh.

10. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, *inter alia*, në bazë të asaj se Gjykata Komunale kishte vërtetuar faktet në mënyrë të gabuar dhe kishte shkelur dispozitat e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPPK) dhe KPPK-së.

11. Me Vendimin Ap. nr. 69/2009, të 15 marsit 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë përfundoi se ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte e bazuar, pasi që gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar nuk kishte bërë vlerësimin e plotë dhe të drejtë të të gjitha provave të administruara në seancën dëgjimore dhe nuk kishte bërë asnjë vlerësim apo analizë të provave, në

pajtim me nenin 387 të KPPPK-së. Si rezultat i kësaj, Gjykata e Qarkut e anuloi vendimin e Gjykatës Komunale dhe ia ktheu rastin të njëjtës gjykatë në rigjykim.

12. Më 25 korrik 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë, duke i marrë parasysh vërejtjet e Gjykatës së Apelit, edhe një herë e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shpërdorim të mjeteve dhe kishte shqiptuar të njëjtin dënim, si më parë.

13. Parashtruesi i kërkesës ushtroi prapë ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e cila me Vendimin Ap. nr. 69/2009, të 14 qershorit 2011, vendosi që ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte e bazuar mirë dhe në pajtim me nenin 257.1 dhe 3 të KPPK-së e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale për lirimin e parashtruesit të kërkesës nga akuza e shpërdorimit të besimit të palëve të dëmtuara. Sipas Gjykatës së Qarkut, saktësia e deklaratave të bëra nga palët e dëmtuara ishte shumë e dyshimtë dhe, duke marrë parasysh parimin se për shkak të mungesës së fakteve të mjaftueshme dhe të besueshme, duhet vendosur gjithmonë në dobi të të akuzuarit dhe, duke u bazuar në parimin "*In dubio pro reo*", gjykata e liroi parashtruesin e kërkesës nga akuza.

14. Më 15 tetor 2012, Kryeprokurori i shtetit parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë (KMLP. II. 123/12) në Gjykatën Supreme, duke kërkuar nga ajo ta anulojë Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, Ap. nr. 69/2009, të 14 qershorit 2011, dhe kthimin e çështjes në rigjykim, pasi që aktgjykimi nuk përmbante arsye për konstatimin e fakteve vendimtare, se shqyrtimi është dashur të mbahej dhe se palëve nuk u është ofruar asnjë udhëzim sa i përket mjetit juridik.

15. Parashtruesi i kërkesës iu përgjigj kërkesës së Kryeprokurorit të shtetit me propozim që kërkesa e Kryeprokurorit të refuzohet si e pabazuar dhe nëse jo, të hedhet poshtë si e paafatshme, pasi që ajo ishte parashtruar më shumë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj pas Aktgjykimit të kontestuar.

16. Më 29 nëntor 2012, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Pkl. nr. 167/2012, vendosi, *inter alia*, se "*pretendimet e Prokurorit publik se është shkelur ligji në favor të të pandehurit janë të bazuara[...]*" dhe *"Nuk qëndrojnë as pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e vonuar nga se është ushtruar pas më shumë se 16 muajve, ngase konform nenit 452 par. 2 dhe 3 të KPPK, Prokurori i shtetit nuk kufizohet me afat kohor (sikurse ky afat vlen për palët tjera nga neni i cituar), për*

ushtrimin e kësaj të drejte". Gjykata Supreme më tej vendosi se, "*[…] meqë ligji penal në rastin konkret është shkelur në favor të të pandehurit* [parashtruesit]*, kjo Gjykatë vetëm konstatoi këtë shkelje, duke mos prekur vendimin formës së prerë. […]*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Në kërkesë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur ligjin dhe parimet kushtetuese, në veçanti nenet 3, 6, 21, 24, 31 dhe par. 2 deri më 4 të nenit 102 të Kushtetutës. Sipas tij, Gjykata Supreme në arsyetimin e aktgjykimit të saj ishte në kundërthënie me vetveten, kur e aprovoi kërkesën e prokurorit publik dhe gjeti se ligji ishte shkelur në favor të parashtruesit të kërkesës, përkundër faktit se kërkesa ishte e paafatshme.

18. Prandaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të vlerësojë ligjshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës Supreme dhe të marrë një vendim brenda kompetencave të parashikuara me ligj dhe me Kushtetutë.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) të Rregullores së punës, ku theksohet se kërkesa nuk duhet të jetë qartazi e pabazuar.

21. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 167/2012, i 29 nëntorit 2012, kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 3, 16, 21, 24, 31 dhe 102, paragrafët 2 deri 4, të Kushtetutës dhe kërkoi nga Gjykata të vlerësojë ligjshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

22. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë apeli, apo gjykatë e instancës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme. Në përgjithësi, *"Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit"* (Neni 102 i Kushtetutës). Më saktësisht, roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale

(shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM]* nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

23. Për më tepër, Gjykata i referohet Aktgjykimit të GJEDNJ-së në rastin *DMD Group, A. S. kundër Sllovakisë*, kërkesa 19334/03 e 5 tetorit 2010, ku konstatohet se: "*Gjykata më tej thekson se, në parim, një shkelje e dispozitave ligjore nga një gjykatë e vendit lidhur me krijimin dhe kompetencën e organeve gjyqësore shkakton shkelje të nenit 6 § 1. Gjykata për këtë arsye mund të shqyrtojë nëse ligji i brendshëm ka qenë në pajtueshmëri në këtë drejtim. Megjithatë, duke pasur parasysh parimin e përgjithshëm se, në radhë të parë, vetë gjykatat vendore duhet t'i interpretojnë dispozitat e ligjit të vendit, Gjykata konstaton se nuk mund të vë në dyshim interpretimin e tyre përveç nëse ka pasur shkelje flagrante të ligjit vendor* (shih, *mutatis mutandis, Coëme dhe të tjerët,* të cituar më lart, § 98 në gjobë, dhe *Lavents,* cituar më lart, § 114)*"*.

24. Sa i përket rastit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata Supreme vendosi të aprovojë kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke gjetur se me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ap. nr. 69/2009, të 14 qershorit 2011, ligji është shkelur në favor të parashtruesit të kërkesës. Gjykata Supreme konstatoi: *"Meqë ligji penal në rastin konkret është shkelur në favor të të pandehurit, kjo Gjykatë vetëm e konstatoi këtë shkelje, duke mos e prekur vendimin e formës së prerë"*.

25. Prandaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme nuk e ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, me të cilin parashtruesi është liruar nga akuzat, por e ka lënë aktgjykimin në fuqi.

26. Për më tepër, sa i përket Vendimit të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur pretendimet e tija në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar dëshmi se janë shkelur të drejtat dhe liritë e tija nga ai autoritet publik.

27. Kështu, Gjykata nuk mund të konkludojë se procedurat relevante para Gjykatës Supreme ishin në çfarëdo mënyre të padrejta dhe arbitrare (shih rastin KI14/13, parashtruesi i kërkesës *Komuna e Podujevës*, Aktvendimi për papranueshmëri i 12 marsit 2013).

28. Prandaj, në rrethana të tilla, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (2) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 7 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI198/13, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendim i datës 13 mars 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. AC-II-12-0193, të 4 korrikut 2013

Rasti KI198/13, vendimi i 13 marsit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale (person juridikë), kontest pronësor, e drejta për gjykim të drejtë, kërkesë qartazi e pabazuar.

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendonte se: Aktvendimi AC-II-12-0193 i Kolegjit të Apelit i DHPGJS-së, i 5 korrikut 2013, më të cilin është hedhur poshtë ankesa e AKP-së, si e papranueshme dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Podujevë, C. nr. 144/2005, i 13 janarit 2006, përbëjnë shkeljet si në vijim: "i) Shkelje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të përcaktuar me kapitullin VII, neni 102, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilin përcaktohet se gjykatat gjykojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit, ii) Shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, (KEDNJ), nenit 6, me të cilën parashihet gjykim i drejtë dhe i paanshëm".

Në rastin konkret, parashtruesi nuk kishte paraqitur asnjë argument bindës, që do te tregonte se shkeljet e supozuara të përmendura në kërkesë, përbënin shkelje të të drejtave kushtetuese. Në këtë kontekst, Gjykata përmendi rastin Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërisë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005.

Për më tepër, Gjykata konsideroj se procedurat përkatëse të zhvilluara në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, nuk kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare dhe përkitazi me këtë i është referuar rastit Shub vs. Lithuania, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009.

Në tërësi, Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbushte kriteret e pranueshmërisë, sepse parashtruesi kishte dështuar të provojë se vendimi i kontestuar shkelte të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI198/13
Parashtrues
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. AC-II-12-0193, të 4 korrikut 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), përfaqësuar nga z. Ramush Bardiqi, zyrtar ligjor.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktvendimin nr. AC-II-12-0193 të 4 korrikut 2013, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i DHPGJS), të cilin parashtruesi e ka pranuar më 23 korrik 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit nr. AC-II-12-0193 të 4 korrikut 2013, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, përkitazi me pretendimin e parashtruesit se

aktvendimi në fjalë shkel të drejtat e tij, të garantuara me nenin 31.2 dhe 102.3 të Kushtetutës, si dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Neni 113.7 dhe neni 21.4 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 11 nëntor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. 198/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy, gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari me Vendimin nr. KSH. 198/13 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

7. Më 11 dhjetor 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 13 mars 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 13 janar 2006, Gjykata Komunale në Podujevë, mori Aktgjykimin C. nr. 144/2005), me të cilin aprovoi si të bazuar padinë e paditësit M. H. dhe detyroi të padituren, NSH Fan Besiana FA Zahir Pajaziti, që t'ia kompensojë paditësit M. H. të ardhurat personale për periudhën 1993-1999, respektivisht për 63 muaj e 17 ditë.

10. Më 1 tetor 2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) parashtroi ankesë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, për anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës

Komunale të Podujevës C. nr. 144/2005, të 13 janarit 2006, për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurave kontestimore.

11. Më 4 korrik 2013, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së mori Aktvendimin AC-II-12-0193, me të cilin hodhi poshtë ankesën e parashtruesit, për shkak të parashtrimit të saj jashtë afatit ligjor. Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJ-përmban arsyetimin si më poshtë:

"Ankesa është jashtë afatit dhe prandaj duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

Në bazë të nenit 64.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Shtojca), Kolegji i Apelit vendosi që të mos mbajë pjesën gojore të procedurës. Ankuesi në ankesën e tij nuk ka shpjeguar se kur është njoftuar me aktgjykimin e ankimuar dhe arsyen pse ankesa është parashtruar pas më shumë se 6 (gjashtë) vitesh pasi që aktgjykimi i ankimuar u bë i plotfuqishëm. Nga shkresat e lëndës është e qartë se të paditurit i është dërguar aktgjykimi i ankimuar me 19 janar 2006. Është fakt i pakontestueshëm se ankuesi nuk e ka parashtruar ankesën në DHPGJS brenda afatit ligjor kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Podujevë. Fakti se, nëse ishte njoftuar me kohë lidhur me aktgjykimin e ankimuar nuk është vërtetuar nga ankuesi dhe barra e vërtetimit bie mbi të.

Për arsye se ankesa ishe parashtruar pas më shumë se 6 (gjashtë) vitesh nga koha kur kishte skaduar afati për parashtrimin e ankesave dhe pas heqjes dorë nga e drejta për të parashtruar ankesë kundër aktgjykimit, ajo është jashtë afatit. Kolegji i Apelit vlerëson se çështja nëse kjo Gjykatë kishte juridiksion lidhur me padinë, nuk mund të paraqitet më pasi që papranueshmëria e ankesës e pengon Gjykatën që të shqyrtojë meritat e ankesës.

Njeri nga parimet themelore të ligjit është ruajtja e sigurisë ligjore për palët përmes ligjit dhe aktvendimeve gjyqësore. Aktvendimet e formës së prerë ku palët, me apo pa vetëdijen e tyre e humbin afatin për të kundërshtuar atë, apo ata heqin

dorë nga e drejta për të parashtruar ankesë, nuk mund t'i nënshtrohen ndërhyrjeve gjyqësore për t'i ndryshuar atë më vonë vetëm për faktin se pala pas afatit në një kohë të caktuar ka interes që t'i ndryshojë ato pasi që kjo shkakton pasiguri ligjore për palët e përfshira. Shqyrtimi në meritat e ankesës së parashtruar jashtë afatit do të shkelte të drejtat e palëve në procedurat për gjykim të drejtë në bazë të nenit 6 (1) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, Aktvendimi AC-II-12-0193 i Kolegjit të Apelit i DHPGJS-së, i 5 korrikut 2013, me të cilin është hedhur poshtë ankesa e AKP-së, si e papranueshme dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Podujevë, C. nr. 144/2005, i 13 janarit 2006, përbëjnë shkeljet si në vijim:

"i) Shkelje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të përcaktuar me kapitullin VII, neni 102, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilin përcaktohet se gjykatat gjykojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit.

ii) Shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, (KEDNJ), nenit 6, me të cilën parashihet gjykim i drejtë dhe i paanshëm".

[...]

"Kolegji i Apelit i DHPGJS nuk e ka trajtuar fare juridiksionin e Gjykatës Komunale në Podujevë e cila gjykatë sipas nenit 15 të Ligjit të Procedurës Kontestimore zyrtarisht do të duhej të kujdesej për kompetencën e saj lidhur me padinë, por Kolegji i Ankesave tërë arsyetimin ligjor e kishte fokusuar në afatshmërinë e ankesës.

AKP-ja konsideron se, vlerësimi i DHPGJS se ankesa e AKP-se ishte bërë jashtë afatit nuk qëndron, pasi që DHPGJSK gabimisht ka aplikuar dispozitat ligjore të Nenit 186.1 të LPK, pasi që në këtë rast është dashtë të aplikohen dispozitat e nenit 4 paragrafi 5.1 të Ligjit nr. 04/L-033 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe shkresa e AKP-se nga gjykata duhet të

trajtohet si parashtresë njoftim nga AKP-ja, e jo si ankesë e rregullt, pasi që në këtë rast Gjykata i është shmangur aplikimit të dispozitave konkrete ku decidivsht parashohin se, "çdo Aktgjykim apo Aktvendim i lëshuar nga një gjykatë e tillë në lidhje me një kërkesë, lëndë, procedurë apo rast, do të jenë të pavlefshme dhe të papërmbarueshme; ndërsa Dhoma e Posaçme, në bazë të parashtresës së një personi, apa me iniciativën vetanake, do të lëshojë një urdhër me atë fuqi". Dhe duke aplikuar këtë dispozitë gjykata ka pas bazë ligjore që të anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Podujevë me nr. 144/2005 datë 13 Janar 2006, pasi që e paditura është Ndërmarrje Shoqërore".

[...]

Për të argumentuar praktikën e shqyrtimit të ankesave për anulim të aktgjykimeve të Gjykatave Komunale nga ana DHPGJS, AKP-ja, ofron vendimin e DHPGJSK (shih: provën 5, ASC-09-0043 të dt. 11 tetor 2010).

13. Për më tepër, parashtruesi nga Gjykata Kushtetuese, kërkon të marrë aktgjykim për deklarimin e kërkesës, si të pranueshme, si dhe të anuloj aktvendimin AC-11-12-0193 të 4 korrikut 2013, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe lënda të vendoset në baza meritore nga vet Dhoma e Posaçme, sipas kompetencës lëndore.

Pranueshmëria e kërkesës

14. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

15. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 113.7 dhe nenit 21.4 të Kushtetutës, që përcaktojnë:

7. "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]

4. "Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".

1. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton se:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht…".

2. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, parashtruesi është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit ligjor prej katër (4) muajsh, siç parasheh neni 49 i Ligjit.

3. Në këtë drejtim, Gjykata, konsideron se, kërkesa e parashtruesit i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim, prandaj do të lëshohet më tuje në vlerësimin e themelësisë së kërkesës, dhe përkitazi me këtë i referohet rregullit 36 (1) c) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

36. (1) "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[…]

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.

36. (2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

4. Gjykata vëren se, parashtruesi pretendon kryesisht në shkeljen e nenit 31.2 dhe 102.3 të Kushtetutës, dhe shkeljen e dispozitave ligjore.

5. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit për shkeljen e nenit 31.2 të Kushtetutës, [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Gjykata thekson se, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ngërthen elemente të shumta dhe paraqet përbërës kyç në mbrojtjen e të drejtave themelore të individit, nga shkeljet, kushtimisht, të shkaktuara nga gjykatat a autoritetet publike me vendimet e tyre.

6. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, që qartazi përcakton se:

"Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike".

7. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) gjithashtu përcakton se:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile".

8. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk përcakton qartë, si dhe pse pretendimi për shkeljen e kësaj dispozite konkrete, përbën shkelje kushtetuese të të drejtave të tij themelore për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

9. Arsyetimi i vendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së mbështetet kryesisht në parimin e garantimit të sigurisë juridike të vendimeve gjyqësore të formës së prerë duke e arsyetuar vendimin e marrë në

harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përkitazi me rastet e natyrave të ngjashme. Në vijim, konkludimi i Kolegjit përkitazi me rastin:

> *"Njeri nga parimet themelore të ligjit është ruajtja e sigurisë ligjore për palët përmes ligjit dhe aktvendimeve gjyqësore. Aktvendimet e formës së prerë ku palët, me apo pa vetëdijen e tyre e humbin afatin për të kundërshtuar atë, apo ata heqin dorë nga e drejta për të parashtruar ankesë, nuk mund t'i nënshtrohen ndërhyrjeve gjyqësore për t'i ndryshuar atë më vonë vetëm për faktin se pala pas afatit në një kohë të caktuar ka interes qe t'i ndryshojë ato pasi që kjo shkakton pasiguri ligjore për palët e përfshira. Shqyrtimi në meritat e ankesës së parashtruar jashtë afatit do të shkelte të drejtat e palëve në procedurat për gjykim të drejtë në bazë të nenit 6 (1) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut".*

10. Për më tepër, citati i lartcekur, i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, përmban arsyetimin të gjerësishëm dhe gjithëpërfshirës edhe sa i përket fakteve të rastit dhe gjetjes së tyre.

11. Më tutje, pakënaqësia me vendimin ose thjeshtë përmendja e neneve dhe dispozitave të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme që parashtruesi të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendon në shkeljet e Kushtetutës, parashtruesi duhet të ofrojë argumente bindëse dhe të pakontestueshme për pretendimet e tij, në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar.

12. Përkitazi me pretendimin për shkeljen e nenit 102.3 të Kushtetutës, *"gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit",* Gjykata vlerëson se parashtruesi, edhe në këtë pretendim ka dështuar të argumentojë se me vendimin e kontestuar i është cenuar kjo e drejtë e garantuar me dispozitën konkrete të lartcekur të Kushtetutës, sepse i njëjti nuk ka ngritur ndonjë argument ose ndonjë dëshmi se Kolegji i Apelit të DHPSGJ-së, nuk ka respektuar dispozitat në fjalë.

13. Ndërsa sa i përket pretendimit, "*për shkeljen e dispozitave ligjore*", Gjykata vlerëson se pretendimet e tilla janë të natyrës ligjore, dhe si të tilla nuk paraqesin bazë kushtetuese për shkeljen e të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë.

14. Në fakt, Gjykata nuk shqyrton vendimet e gjykatave të rregullta për çështjet e ligjshmërisë, e as nuk shqyrton saktësinë e fakteve të

çështjes, përveç nëse ka prova bindëse se vendimet e tilla janë marrë në një mënyrë qartazi të padrejtë dhe arbitrare.

16. Detyra e Gjykatës, lidhur me shkeljet e supozuara të të drejtave kushtetuese, është që të analizojë dhe të vlerësojë nëse procedurat, në tërësinë e tyre, kanë qenë të drejta dhe në pajtueshmëri me mbrojtjen shprehimisht të përcaktuar me Kushtetutë. Pra, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt, kur i shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e instancave më të ulëta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih*, mutatis mutandis,* Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

17. Gjatë rrjedhës së procedurës në DHPGJS, vërehet qartë se, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar të gjitha mundësitë e paraqitjes së argumenteve, fakteve dhe provave, para asaj gjykate, përkitazi me shkeljen e të drejtave kushtetuese të pretenduara. Nuk është detyrë e Gjykatës të shqyrtojë vendimet e gjykatave të rregullta thjeshtë sepse parashtruesi i kërkesës nuk është ndarë i kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta.

18. Në rastin konkret, parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë argument bindës, që tregon se shkeljet e supozuara të përmendura në kërkesë, përbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

19. Për më tepër, në rastin konkret, Gjykata nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse të zhvilluara në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub vs. Lithuania, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

20. Në tërësi, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, sepse parashtruesi ka dështuar të provojë se vendimi i kontestuar shkel të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë.

21. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, Gjykata përfundon se kërkesa është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) si dhe rregullin 56 (2) të Rregullores, më 13 mars 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI212/13, Svetlana Stefanović, Aktvendim i datës 12 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së kërkesës për sqarim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, KO 108/13, të 9 shtatorit 2013

Rasti KI 212/13, vendimi i 12 majit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesa individuale, palë e paautorizuar.

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kërkesës për sqarim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, KO 108/13, të 9 shtatorit 2013. Parashtruesja në kërkesën e saj pretendon se gëzon të drejtën për të përfituar sipas Ligjit për Amnisti [Ligji Nr. 04/L-2009] dhe se edhe në rastin e saj duhet të zbatohet ky ligj.

Parashtruesja parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar sqarimin e aktgjykimit të lartpërmendur pa dhënë informata në lidhje me ndonjë procedurë ligjore apo procedura të tjera ose veprime në lidhje me ankesat e saj. Parashtruesja thjesht ka kërkuar sqarime të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese pa pretenduar ndonjë shkelje të ndonjë neni të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme sepse parashtruesja nuk është konsideruar të jetë palë e autorizuar. Në arsyetimin e saj, Gjykata Kushtetuese deklaroi se parashtruesja nuk ka artikuluar ndonjë të drejtë apo liri individuale që mund të jetë shkelur dhe as që i referohet ndonjë veprimi ose vendimi konkret të një autoriteti publik që mund të ketë cenuar të drejtat e saj themelore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese gjeti se parashtruesja e kërkesës nuk është palë e autorizuar të kërkojë sqarim apo interpretim të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI212/13
Parashtrues
Svetlana Stefanović
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
kërkesës për sqarim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese,
KO108/13, të 9 shtatorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Svetlana Stefanović (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja), nga fshati Korminjan i Epërm, komuna e Kamenicës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja nuk konteston ndonjë vendim konkret të ndonjë autoriteti publik.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa individuale e parashtrueses për sqarim të Aktgjykimit (KO108/13) të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), të 9 shtatorit 2013, lidhur me atë se i njëjti a është i aplikueshëm në gjithë territorin e Republikës së Kosovës apo në mënyrë të pjesshme.

4. Parashtruesja nuk përmend nenet e Kushtetutës që pretendon se i janë cenuar.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) si dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 19 nëntor 2013, parashtruesja ka parashtruar kërkesën e saj në Gjykatë.

7. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI212/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI212/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 15 prill 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi asaj që të dorëzojë autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.

9. Më 25 prill 2014, parashtruesja e dorëzoi në Gjykatë dokumentin e kërkuar.

10. Më 12 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 31 maj 2012, Gjykata Komunale në Kamenicë, përmes Aktgjykimit P. nr. 191/2008 dënoi parashtruesen me dënim me kusht dhe me gjobë për shkak të kryerjes së veprës penale të shmangies nga tatimi sipas nenit 249, paragrafit 1, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës.

12. Më 24 shtator 2013, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë u bë i plotfuqishëm.

13. Në një datë të panjohur për Gjykatën, Gjykata Themelore në Gjilan lëshoi propozimin për ekzekutim (Nr. Vepr. Edgj. 366/2013) të

Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë (P. nr. 191/2008, të 31 majit 2012).

14. Më 8 nëntor 2013, parashtruesja parashtroi kërkesë për dhënien e amnistisë te Gjykata Themelore në Gjilan. Parashtruesja nuk ka dorëzuar ndonjë dokument shtesë apo informatë që tregon për statusin e kërkesës së saj për amnisti.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesja në kërkesën e saj pretendon se gëzon të drejtën për të përfituar sipas Ligjit për Amnisti [Ligji nr. 04/L/2009] dhe se edhe në rastin e saj duhet të zbatohet ky ligj.

16. Parashtruesja nuk kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale (P. nr. 191/2008, të 31 majit 2012) e as të Gjykatës së Apelit, të cilin e përmend në kërkesë por nuk e ka dorëzuar në Gjykatë.

17. Parashtruesja arsyeton kërkesën e saj për sqarim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese (KO108/13, të 9 shtatorit 2013) duke pohuar se: *"Përkundër faktit se kjo vepër penale është në Ligjin për Amnisti në praktikë interpretohen në mënyra të ndryshme nga gjyqtarët dhe prokurorët, aktgjykimi i gjykatës së juaj (...) edhe pse i njëjti është i qartë, se Ligji për Amnistinë zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës, pa kurfar dallimesh".*

18. Parashtruesja i drejtohet Gjykatës me kërkesën:

> *"Të bëhet interpretimi – skjarimi i Aktgjykimit të juaj Nr. KO108/13 i datës 9.09.2013 të dhënë lidhur me ligjin për Amnistinë. A aplikohet i njëjti në territorin e tërë Republikës, apo në mënyrë parciale.*
>
> *[...]*
>
> *Kërkoj që të bëhet interpretimi i pjesës së aktgjykimit (...) i cili ka të bëjë me veprën penale Thirrja në Rezistencë (neni 411) e radhitur në aktgjykimin e përmendur nën 1.1.15, me qëndrimin e juaj nën pikën 193, sipas veprës Thirrja në Rezistencë (neni 319), sipas qëndrimit të juaj nën pikën 236 dhe sipas veprës penale, Nxitja në Rezistencë (neni 186) me qëndrimin e juaj nën pikën 263, me qëllim të mënjanimit të dilemave gjatë zbatimit të Ligjit për Amnistinë në praktikë. Edhe pse në aktgjykimin e*

përmendur nën pikën 193 keni dhënë qëndrimin e juaj të qartë".

Pranueshmëria e kërkesës

19. Para së gjithash, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Gjykata duhet në mënyrë specifike të përcaktojë nëse parashtruesja i ka plotësuar kërkesat e nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenit 47.1 të Ligjit dhe rregullit 36 (3) c) të Rregullores së punës.

21. Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".
[...]

"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

22. Neni 47.1 i Ligjit parasheh:

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik".

23. Për më tepër, rregulli 36 (3) c) i Rregullores së punës përcakton se:

"(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:
c) kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar".

24. Siç është thënë më lart, ajo çfarë parashtruesja kërkon është sqarimi i Aktgjykimit (KI108/13, të 9 shtatorit 2013) të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me atë se a është i njëjti i aplikueshëm në gjithë territorin e Republikës së Kosovës apo vetëm pjesërisht.

25. Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se parashtruesja nuk ka ngritur ndonjë pretendim për shkelje të kryer nga autoritetet publike. Në fakt, parashtruesja shprehimisht thekson se "*nuk kërkoj vlerësimin e kushtetutshmërisë*" së vendimit të marrë nga Gjykata e Apelit të cilin nuk e ka dorëzuar në Gjykatë dhe nuk e ka kontestuar kushtetutshmërinë e Aktgjykimit (P. nr. 191/2008, të 31 majit 2012) i cili tashmë ka marrë formën e prerë.

26. Gjykata më tutje vëren se parashtruesja nuk siguron informata në lidhje me ndonjë procedurë ose veprim ligjor në lidhje me ankesat e saj.

27. Sa i përket të drejtës së parashtrueses për të parashtruar kërkesë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, Gjykata konsideron se parashtruesja nuk artikulon ndonjë të drejtë apo dhe liri individuale që mund të jetë shkelur dhe as që i referohet ndonjë veprimi apo vendimi konkret të një autoriteti publik që mund të ketë cenuar të drejtat e saj themelore.

28. Në këto rrethana, Gjykata gjen se parashtruesja, në bazë të nenit 113.1 të Kushtetutës në lidhje me rregullin 36 (3) c) të Rregullores së punës, nuk është palë e autorizuar për të kërkuar sqarimin ose interpretimin e vendimit të Gjykatës.

29. Rrjedhimisht, për arsyet e cekura më lart, Gjykata gjen se parashtruesja nuk është palë e autorizuar dhe se në pajtim me rregullin 36 (3) c) kërkesa duhet hedhur poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (1) dhe 113 (7) të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, rregullin 36 (3) c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 12 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI33/14, Kamer Hajdini, Aktvendim i datës 31 mars 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 111/2013, të 24 shtatorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 21 tetor 2013, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 248/2012, të 3 shtatorit 2012, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 1327/12, të 3 prillit 2013, Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ED. nr. 201/13, te 25 qershorit 2013, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, P. nr. 568/13, të 20 gushtit 2013, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, P. nr. 16/2014, i 21 janarit 2014

Rasti KI33/14, vendimi i 31 marsit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, në të cilën ai kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-II-0069, të 22 prillit 2013.

Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimeve dhe aktvendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta, të cilat pretendohen të kenë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa) dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk është respektuar parimi i "barazisë së armëve", sepse gjykatat e rregullta i kanë aprovuar propozimet e organit të akuzës për nxjerrjen dhe administrimin e provave, ndërsa pretendohet se parashtruesit të kërkesës arbitrarisht i është mohuar kjo e drejtë; gjykata duke i refuzuar propozimet e parashtruesit të kërkesës për nxjerrjen e provave gjykatat e rregullta e kanë shkelur prezumimin e pafajësisë, kanë paragjykuar fajësinë e të akuzuarit dhe e kanë kufizuar dhe e kanë pamundësuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për tu mbrojtur nga akuzat.

Gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, Gjykata Kushtetuese konstatoi se faktet e paraqitura nga

parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkelje të të drejtave kushtetuese dhe parashtruesi i kërkesës nuk nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij. Prandaj, Gjykata konkludoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, prandaj kërkesa e tij është qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI33/14
Parashtrues
Kamer Hajdini
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 111/2013, të 24 shtatorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Kamer Hajdini, i cili aktualisht është duke e vuajtur dënimin me burgim në Qendrën Korrektuese në Smrekovnicë, Komuna e Vushtrrisë. Parashtruesi i kërkesës e ka autorizuar djalin e tij, z. Avni Hajdini, që ta përfaqësojë atë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 111/2013, të 24 shtatorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 21 tetor 2013, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 248/2012, të 3 shtatorit 2012, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 1327/12, të 3 prillit 2013, Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ED. nr. 201/13, të 25 qershorit 2013, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, P. nr. 568/13, të 20 gushtit 2013, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, P. nr. 16/2014, i 21 janarit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimeve dhe aktvendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta, të cilat pretendohen të kenë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa) dhe me nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës, nenin 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 54 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 21 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 27 shkurt 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës, Gjykatën e Apelit të Kosovës dhe Prokurorin e Shtetit për kërkesën.

7. Më 28 shkurt 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI33/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI33/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 31 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 5 mars 2012, Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë ngriti Aktakuzën (PP. nr. 565-1/2009), në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, kundër parashtruesit të kërkesës me akuzë se kishte kryer veprat penale të vrasjes në tentativë dhe mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim i armëve, siç parashihen me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK).

10. Më 20 prill 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin KA. nr. 205/12, e vërtetoi aktakuzën e Prokurorit Publik, të ngritur kundër parashtruesit të kërkesës.

11. Më 3 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin P. nr. 248/2012, e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprave penale të vrasjes në tentativë dhe mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim i armëve nga neni 146 në lidhje me nenin 20 dhe nenin 328 paragrafi 2 i KPPK-ë. Gjykata e Qarkut në Prishtinë ia shqiptoi parashtruesit të kërkesës dënimin me burgim prej 2 (dy) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj, të cilin parashtruesi do ta vuajë pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

12. Në aktgjykimin e lartcekur, Gjykata e Qarkut në Prishtinë arsyetoi:

> *"Prokuroria Publike e Qarkut në në Prishtinë, me aktakuzën PP. nr. 956-10/11 të dt.05.03.2012, e ka akuzuar Kamer Hajdinin (parashtruesi i kërkesës), për vepër penale, të vrasjes në tentativë, nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, si dhe për veprën tjetër penale mbajtja ne pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së. Lidhur me këtë qështje penale gjykata përfundoi seancën e shqyrtimit gjyqësore kryesore me dt.03.09.2012, gjate së cilës fillimishtnë ka dëgjuar të dëmtuarin L. G., dëshmitaret D. H.,e R. M.. Gjithashtu ka lexuar edhe shkresa të tjera të propozuara për tu administruar si prova gjat shqyrtimit gjyqësore si:Leximin e raportit mbi shilimin e vendit të ngjarjes të dt.16.12.2011; Shikimin e skicës së vendit të ngjarjes; Shikimi i fotodokumentacionit; Raporti i expertizës nga Laboratori i Policisë së Kosovës,i dt.26.01.2012;Raporti i expertit mjeko-ligjore i dt.17.02.2012 me fletëlëshim dhe epikrizë;Vërtetimi mbi konfiskimin e armës dhe municionit, si dhe janë shiquar edhe shkresat e tjera te lendes.,krejt këto me qëllim të gjetjes së të vërtetës.*

... Gjykata bëri vlerësimin e të gjitha deklaratave dhe provave të tjera një nga një, duke analizuar të gjitha me vëmendje dhe pas deklaratës së të dëmtuarit pasi mori dhe analizoj me kujdes deklaratën e dëshmitarëve të propozuar nga ana e akuzatorit, u pa se përveq deklaratës së tyre, edhe deklarata e të pandehurit (parashtruesit të kërkesës) ishte e drejtë, si e tillë e besueshme dhe deri diku edhe bindëse edhe për gjykatën, duke pasur parasyshë të kaluarën e palëve në këte rast të pandehurit me ish dhëndërin e tijl, tani të dëmtuarit LG, të cilët siq shihet edhe nga deklaratat e tyre, kishin pasur raporte tejet të acaruara mes vete, sidomos pas ndarjes së tani të dëmtuarit LG dhe ish bashkëshorten e tijë DH. Kjo u vërtetua edhe gjat shqyrtimit gjyqësorë.

... Gjykata megjithatë, duke analizuar me kujdes veprimet e të pandehurit, gjeti se i njëjti e ka dashur kryerjen e veprës me të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtorë.
... Nga të gjitha këto që u than si më lartë gjykata me pamëdyshje në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë dhe sipas bindjes së lirë e vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitat e aktakuzës, duke vërtetuar kështu se i akuzuari Kamer Hajdini, është penalisht përgjegjës për veprat si në dispozitivat e këtij aktgjykimi, se në veprimet e tij ekzistojnë elementet e veprave penale të përshkruara si në dispozitivat e këtij aktgjykimi, dhe se me veprimet e tijë në tërësi është plotësuar figura e veprave penale me të cilat është akuzuar, prandaj edhe e shpalli fajtorë, pasi që më parë gjeti se i njëjti në kohën e kryerjes së veprave penale ishte penalisht i përgjegjshëm dhe për këto vepra penale e dënoi me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh e 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim i njëjti do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e kuptohet duke ju llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 16.12.2011 deri më 04.09.2011 në kohën e vuajtjes së dënimit".

13. Më 4 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin P. nr. 248/2012, e liroi parashtruesin kërkesës nga paraburgimi, deri sa Aktgjykimi P. nr. 248/2012, i gjykatës së njëjtë, i 3 shtatorit 2012, të bëhet i plotfuqishëm.

14. Në një datë të pacaktuar, Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë dhe pala e dëmtuar, L. G., paraqitën ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës, duke kërkuar dënim më të ashpër për parashtruesin e kërkesës.

15. Më 3 prill 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin PAKR. nr. 1327/12, e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 248/2012 dhe i refuzoi ankesat e Prokurorit Publik të Qarkut dhe të palës së dëmtuar, L. G., si të pabazuara.

16. Më 20 maj 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër aktgjykimeve P. nr. 248/2012 dhe PAKR. nr. 1327/12, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, përkatësisht të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Parashtruesi paraqiti gjithashtu kërkesë për shtyrjen e përmbarimit të dënimit me burgim.

17. Më 27 maj 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar rishikimin e procedurës penale, P. nr. 248/2012, dhe duke propozuar shtyrjen e përmbarimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 248/2012.

18. Më 25 qershor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin ED. nr. 201/13, e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e fillimit të vuajtjes së dënimit me burgim.

19. Më 9 korrik 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin Kp. nr. 240/13, refuzoi kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës penale kundër Aktgjykimit P. nr. 248/2012, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, si të pabazuar.

20. Më 20 gusht 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin PN. nr. 568/13, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit ED. nr. 201/13, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si të pabazuar.

21. Më 26 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës ishte dërguar në vuajtje të dënimit me burgim.

22. Më 24 shtator 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pml. nr. 111/2013, e refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit P. nr. 248/2012 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 3 shtatorit 2012, dhe të Aktgjykimit PAKR. nr. 1327/2012, Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 3 prillit 2013, si të pabazuar.

23. Në aktgjykimin e lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës arsyetoi:

"Në kërkesë pretendohet se shkeljet të cilat e arsyetojnë bazueshmërinë e kërkesës janë: falsifikimi i procesverbalit (nuk ceket se cilit) nga kryetari i trupit gjykues, ndalimi-mos dhënia e procesverbaleve avokatit në fazën e ankimimit, mos vendosja për kërkesën për përjashtimin e kryetarit dhe anëtarëve të trupit gjykues dhe refuzimi i propozimeve të tij që janë bërë gjatë procedurës së shkallës së parë për nxjerrjen e provave, që ka ndikuar në vërtetimin e gabuar të fakteve relevante të çështjes penale. Propozimet për nxjerrjen e provave të cilat theksohen në kërkesë janë shikimi i vendit të ngjarjes, dëgjimi i ekspertit mjeko ligjor por edhe ekspertëve të profileve tjera (p.sh. të kirurgjisë torakale), administrimi si provë i raportit të policisë, leximi i SMS të dërguara nga LG në telefonin e DH etj

Këtë pretendim Gjykata Supreme e vlerësojë si të pabazuar. Fakti se kryetari i trupit gjykues ka bërë falsifikim ose ka keqpërdorur funksionin e vet me mos dhënien në shikim të procesverbaleve, do të mund të jenë bazë për rishikimin e procedurës penale, nëse janë plotësuar edhe kushtet tjera për këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik por nuk janë bazë për kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Kërkesa për përjashtimin e kryetarit dhe anëtarëve të trupit gjykues është bërë në fjalën përfundimtare të mbrojtësit të dënuarit, ndërsa konform nenit 42. par. 2 të KPPK që në atë kohë ka qenë fuqi (tani neni 41. par. 2. të KPPK) kërkesa për përjashtimin e gjyqtari ose gjyqtarit laik të paraparë e nenin 40. par. 3 të këtij Kodi bëhet para fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Andaj, mos vendosja për këtë kërkesë nuk ka pas ndikim në marrjen e vendimit të drejt të gjykatës së shkallës së parë.

Në anën tjetër, propozimet të cilat ceken në kërkesë e të cilat gjykata nuk i ka aprovuar, jo vetëm se kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, e për këtë bazë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë konform nenit 432. par. 2. të KPPK nuk lejohet, por janë marrë në konsideratë nga gjykata e shkallës së parë

Kështu, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 26.07.2012, del se mbrojtësi i të dënuarit të gjitha këto propozime i ka paraqitur në shqyrtimin gjyqësor dhe trupi gjykues po në atë procesverbal ka marrë aktvendim me të cilin propozimet janë refuzuar, me arsyetim se gjykata ka

administruar prova të mjaftueshme për ndriçimin e çështjes ndërsa me provat e propozuara vetëm do të përsëriteshin provat ekzistuese dhe do të zvarritej procedura penale. Andaj, gjykata propozimet i ka mare në konsideratë dhe ka dhënë arsyetim ligjor për refuzimin e tyre, ashtu që Gjykata Supreme gjenë se nuk janë të bazuara pretendimet në kërkesë se ato janë neglizhuar dhe është bërë shkelja e dispozitave të procedurës penale.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u konsiderua si e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi".

24. Më 21 janar 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin PN. nr. 16/2014, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kp. nr. 240/2013, si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës dhe të nenit 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, me arsyetim se:

- Nuk është respektuar parimi i barazisë së armëve, sepse gjykatat e rregullta i kanë aprovuar propozimet e organit të akuzës për nxjerrjen dhe administrimin e provave, ndërsa pretendohet se parashtruesit të kërkesës arbitrarisht i është mohuar kjo e drejtë;

- duke i refuzuar propozimet e parashtruesit të kërkesës për nxjerrjen e provave, gjykatat e rregullta e kanë shkelur prezumimin e pafajësisë, kanë paragjykuar fajësinë e të akuzuarit, dhe e kanë kufizuar dhe e kanë pamundësuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për t'u mbrojtur nga akuzat.

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se propozimi i tij që anëtari i personelit mjekësor të dëgjohej si dëshmitar i cili e kishte marrë të dëmtuarin në vendin e ngjarjes, ka pasur rëndësi, sepse do të vërtetohej:

- nëse i dëmtuari ka pasur në brezin e tij armë zjarri ose armë të ftohtë apo mjet tjetër, të dukshëm, brenda në pallton e tij pasi që është frikësuar i
  akuzuari;

- deklarata e të dëmtuarit L. G. se F. D. (i biri i parashtruesit të kërkesës) e kishte gjuajtur me gurë, pas plagosjes së tij nga parashtruesi i kërkesës;

- sjellja e të akuzuarit pas veprimeve të tij që dihet se ai kishte dashur të vrasë veten;

- veprimet e anëtarëve të familjes së të akuzuarit, posaçërisht të F. H. dhe D. H., të palës së dëmtuar, dëshmitarit dhe posaçërisht pendimi i menjëhershëm i parashtruesit të kërkesës.

27. Parashtruesi pretendon se dëgjimi i ekspertit të mjekësisë ligjore ishte i nevojshëm për shkak të faktit se eksperti i mjekësisë ligjore, F. B., e kishte kryer ekspertizën pa e parë fare palën e dëmtuar, L. G., dhe se ka qenë i domosdoshëm dëgjimi i ekspertit, sepse: *"ekspertiza nuk e bën përshkrimin e plotë të plagëve dhe në ekspertizë thuhet se lidhur me pasojat e përhershme nga këto dëmtime është e nevojshme të pritet deri në përfundimin e mjekimit"*.

28. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që:

    a) "Të lejojë masën e përkohshme deri në vendimin e Gjykatës për pranueshmerinë e kërkesës;

    b) Të suspendojë menjëherë zbatimin e Vendimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 113/2013 të 29 shtatorit 2013, dhe urdhrin ED. nr. 201/13 për ekzekutim të dënimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 248/12 të datës 03 shtator 2012 si dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 1327/12 të 3 prillit 2013.

    c) Ta deklarojë kërkesën të pranueshme.

    d) Në përputhje me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës rregulli 39 të urdhëroj mbajtjen e seancës dëgjimore.

e) Të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 111/2013 të 24 shtatorit 2013, Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 248/12 të 3 shtatorit 2012 si dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. Nr. 1327/12 të 3 prillit 2013".

29. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës ka deklaruar se në rastet e ngjashme, Gjykata ka nxjerrë aktvendime për pranueshmëri dhe është thirrur në praktikën gjyqësore të Gjykatës, posaçërisht rastin KI78/12, parashtrues *Bajrush Xhemajli,* Aktgjykim i 24 janarit 2013.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

32. Gjykata i referohet edhe nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".*

33. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, se ai i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, siç parashihen me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe se kërkesa është parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

34. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
...
c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar".

35. Gjykata vëren se në rastin e tanishëm, parashtruesi i kërkesës ka ngritur shumë çështje lidhur me procedurat para gjykatës së shkallës së parë dhe të Apelit; sidoqoftë, parashtruesi kishte kërkuar nga Gjykata që të krahasojë kërkesën e tij me rastin KI78/12, parashtrues i kërkesës *Bajrush Xhemajli*, aktgjykim i nxjerrë nga kjo Gjykatë, më 24 janar 2013 (në tekstin mëtejmë: rasti Xhemajli).

36. Gjykata vëren se ka disa aspekte kyçe, në të cilat kërkesa e tanishme dallon me rastin Xhemalji. Në këtë rast, Gjykata vëren se: i) parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se dëgjimi i dëshmitarëve të caktuar dhe vlerësimi i provave të caktuara ishte absolutisht i nevojshëm për të konstatuar të vërtetën, ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se dështimi për të dëgjuar disa dëshmitarë ka paragjykuar të drejtat e mbrojtjes dhe ndershmërinë e procedurës në tërësi, iii) parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se raporti i ekspertit ishte absolutisht i nevojshëm për shkak se ai përbënte bazë dominuese për dënimin e parashtruesit të kërkesës, dhe iv) parashtruesi nuk ka dëshmuar që ekspertët e përfshirë në rastin e parashtruesit janë pajtuar se ata nuk i kanë vlerësuar të gjithë faktorët e përfshirë.

37. Sa i përket paraqitjes së provave të caktuara dhe dëgjimit të dëshmitarëve të caktuar të propozuar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata konsideron se Gjykata e Qarkut ka dhënë përgjigje të gjerë dhe të plotë pothuajse në të gjitha çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës, e pasuar nga Gjykata Supreme, e cila i mbështeti arsyet e dhëna nga Gjykata e Qarkut.

38. Gjykata vëren se në rastin e parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë vlerësuar të gjitha provat e nxjerra para tyre (aktakuza e prokurorit, skicat, fotografitë, raportet balistike dhe mjekësore, dëshmitë nga dëshmitarët okularë etj) dhe për më tepër, parashtruesi i kërkesës është lejuar të komentojë të gjitha provat dhe i është dhënë mundësia për të mbrojtur rastin e tij para gjykatave të rregullta.

39. Duke marrë parasysh procedurat para gjykatave të rregullta, Gjykata konsideron se kërkesa për gjykim të drejtë, e sanksionuar në nenin 6 të Konventës, është se ajo mbulon procedurat në tërësi,

dhe çështja nëse një person ka pasur një gjykim të drejtë shikohet me anë të analizës kumulative të të gjitha fazave, jo vetëm të një incidenti të veçantë ose të një mangësie procedurale, si rezultat, mangësitë në një fazë mund të korrigjohen në një fazë të mëvonshme (shih rastin *Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr 9562/81, 9818/82, GJEDNJ, Aktgjykimi i 2 marsit 1987, paragrafi 55).

40. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta, përveç vlerësimit të të gjitha dëshmive të paraqitura para tyre dhe në interes të drejtësisë, kishin marrë parasysh rrethanat lehtësuese, si shëndetin e parashtruesit, moshën relativisht të vjetër, pendimin dhe faktin se ai nuk është shkelës serik i ligjit para se t'i shqiptohej dënimi me burgim.

41. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve. Gjykata Kushtetuese dëshiron të theksojë se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65; gjithashtu *mutatis mutandis*, shih rastin KI-86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

42. Përveç kësaj, kërkesa nuk tregon që gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave t'i vlerësojnë provat që i kanë para tyre. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (shih *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

43. Fakti që parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

44. Në këto rrethana, parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës dhe të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës, sepse faktet e paraqitura nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë se gjykatat e rregullta ia kanë mohuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me Konventë.

45. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

46. Sa i përket kërkesës së parashtruesit të kërkesës për mbajtjen e një seance dëgjimore, Gjykata i referohet rregullit 39 (1) të Rregullores së punës:

> *"Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës..."*

47. Prandaj, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për të mbajtur seancë dëgjimore refuzohet.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

48. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për vendosjen e masës së përkohshme, Gjykata i referohet nenit 116.2 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme".*

49. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 27 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik".*

50. Gjykata konsideron se një kërkesë e tillë nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me nenin 116.2 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit, që

do ta shtynte Gjykatën të vendosë masën e përkohshme; prandaj kërkesa për të vendosur masën e përkohshme refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 dhe 116.1 të Kushtetutës, neneve 47 dhe 27 të Ligjit; si dhe në pajtim me rregullat 54 dhe 56 të Rregullores së punës, më 31 mars 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. TA REFUZOJË kërkesën për mbajtjen e një seance dëgjimore;

IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

V. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Prof. Dr. Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI54/14, Hamdi Ademi, Aktvendim i datës 19 maj 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 375/2007, të 26 nëntorit 2007, dhe Aktvendimit të Këshillit të Ankesave të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, nr. 5054321, të 10 nëntorit 2005

Rasti KI 54/14, vendimi i 19 majit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest administrativ, mbrojtja sociale e të drejtave, kërkesë qartazi e pabazuar.

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendonte se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 375/2007, i 26 nëntorit 2007 dhe Aktvendimi i MPMS-së shkeli të drejtat e tij për gëzimin e pensionit për persona me aftësi të kufizuar. Parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, kërkoi që të hidhej poshtë, si i pabazuar Aktvendimi i Këshillit të Ankesave të MPMS-së nr. 5054321, i 10 nëntorit 2005, dhe qe atij t'i njihej e drejta për përfitimin e pensionit të personave me aftësi të kufizuar.

Gjykata, ne këtë rast, vërejti se vendimi përfundimtar për parashtruesin ishte Aktgjykimi A. nr. 375/2007, i 26 nëntorit 2007. Kjo do të thotë se shkelja e pretenduar e të drejtave të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me Kushtetutë, kishte ndodhur para 15 qershorit 2008, që është datë e hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe nga e cila datë Gjykata ka juridiksion kohor. Gjykata ngjashëm kishte vendosur në rastin KI100/10, Aktvendim për papranueshmëri, parashtruesi i kërkesës Eduard Thaçi (gjithashtu i njohur si Sokol Thaçi), Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Policisë së Kosovës, nr. 398-SHPK-2002, të 22 tetorit 2002.

Përfundimisht, rezultoi që kërkesa e parashtruesit nuk ishte ratione temporis në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI54/14
Parashtrues
Hamdi Ademi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 375/2007, të 26 nëntorit 2007, dhe Aktvendimit të Këshillit të Ankesave të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, nr. 5054321, të 10 nëntorit 2005

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Hamdi Ademi, nga fshati Gllamnik, komuna e Podujevës, i cili përfaqësohet nga z. Mahmut Hoti, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 375/2007, të 26 nëntorit 2007 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), dhe Aktvendimin e Këshillit të Ankesave të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, nr. 5054321, të 10 nëntorit 2005 (në tekstin e mëtejmë: Këshilli i Ankesave i MPMS-së).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 375/2007, dhe Aktvendimit të Këshillit të Ankesave të MPMS-së, nr. 5054321,

përkitazi me shkeljen e së drejtës për njohjen e statusit për pension të personave me aftësi të kufizuar.

4. Parashtruesi në kërkesën e tij nuk ka specifikuar ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Baza juridike është neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 20 dhe neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 25 mars 2014, parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata)

7. Më 2 prill 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI54/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI54/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 18 prill 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Supreme dhe MPMS-në, për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 19 maj 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 17 qershor 2005, MPMS-së, përkatësisht instanca e parë, me Vendimin nr. 5054321, refuzoi kërkesën e parashtruesit për njohjen e të drejtës për përfitimin e pensionit të personave me aftësi të kufizuar. Kjo instancë konstatoi se parashtruesi nuk i plotësonte kriteret sipas nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/40, mbi Ligjin për pensionet e personave me aftësi të kufizuar. Arsyetimi për refuzimin e kërkesës së parashtruesit ishte mbështetur në konstatimin e Komisionit mjekësor të 8 qershorit 2005, i cili kishte vlerësuar se te parashtruesi nuk ekziston kufizimi

i përhershëm i aftësisë për punë, siç parashihet me dispozitën ligjore të lartcekur.

11. Parashtruesi, kundër vendimit në fjalë, në afat ligjor ushtroi ankesë tek Këshilli i Ankesave të MPMS-së.

12. Më 10 nëntor 2005, Këshilli i Ankesave i MPMS-së, me Aktvendimin nr. 5054321, refuzoi kërkesën e parashtruesit, përkitazi me njohjen e të drejtës së pensionit për persona me aftësi të kufizuar, për arsye se parashtruesi nuk kishte ofruar dëshmi për përmbushjen e kritereve për të qenë përfitues i pensionit për persona me aftësi të kufizuar, siç përcakton neni 3 i Ligjit për pensionet e personave me aftësi të kufizuar.

13. Parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme, kundër aktvendimit të Këshillit të Ankesave të MPMS-së, duke e kontestuar ligjshmërinë e aktvendimit në fjalë, për arsye se komisionet mjekësore nuk morën parasysh faktin se gjendja e tij shëndetësore ishte e rëndë dhe se ai nuk është më i aftë për punë, për çfarë edhe gjendja faktike, sipas tij, nuk u vërtetua në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

14. Më 26 nëntor 2007, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin A. nr. 375/2007, me të cilin u refuzua padia e parashtruesit, me arsyetimin se:

[...]

"Duke pasur parasysh se komisionet mjekësore me ligj të autorizuara, kanë vërtetuar se te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar për pune, gjykata konstaton se organet administrative drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 3 të Ligjit të cekur më lart, në bazë të cilit edhe është refuzuar kërkesa e paditëses që t'i njihet e drejta në pension invalidor.
Gjykata vlerësoi theksimet e padisë dhe konstatoi se të njëjtat në këtë çështje administrative nuk kanë ndikim në vendosje tjetër, sepse me provat e administruara në vështrim të dispozitës së cekur ligjore pa mëdyshje është vërtetuar qe paditësi nuk i plotëson kushtet ligjore për njohjen e së drejtës se kërkuar, prandaj në vështrim të nenit 42 par. 2 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi".

[...]

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 375/2007, i 26 nëntorit 2007 dhe Aktvendimi i MPMS-së shkel të drejtat e tij për gëzimin e pensionit për persona me aftësi të kufizuar.

16. Parashtruesi i kërkesës kërkon, ndër të tjera, që të hidhet poshtë, si i pabazuar Aktvendimi i Këshillit të Ankesave të MPMS-së nr. 5054321, i 10 nëntorit 2005, dhe t'i njihet e drejta për përfitimin e pensionit të personave me aftësi të kufizuar.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të shqyrtoj kërkesën e parashtruesit, së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

18. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) h), i cili thotë:

> *"Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:*
>
> *h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën".*

19. Për të përcaktuar juridiksionin kohor të Gjykatës, është qenësore të identifikohet në secilin rast konkret koha e saktë e shkeljes së pretenduar. Duke vepruar ashtu, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat ankohet parashtruesi dhe shtrirjen e të drejtës kushtetuese që pretendohet se është cenuar (shih, *mutatis mutandis,* Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i Dhomës në rastin *Blečić kundër Kroacisë,* Kërkesa nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, paragrafi 82).

20. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ankohet kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 375/2007, miratuar më 26 nëntor 2007, dhe Aktvendimit të MPMS-së. Prandaj, vendimi përfundimtar për parashtruesin është Aktgjykimi A. nr. 375/2007, i 26 nëntorit 2007.

21. Kjo do të thotë se shkelja e pretenduar e të drejtave të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me Kushtetutë, ka ndodhur para 15

qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe nga e cila datë Gjykata ka juridiksion kohor.

22. Gjykata ngjashëm ka vendosur në rastin KI100/10, Aktvendim për papranueshmëri, parashtruesi i kërkesës *Eduard Thaçi* (gjithashtu i njohur si Sokol Thaçi), Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Policisë së Kosovës, nr. 398-SHPK-2002, të 22 tetorit 2002.

23. Përfundimisht, rezulton që kërkesa e parashtruesit nuk është *ratione temporis* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 36 (3) h) si dhe rregullin 56 (2) të Rregullores, më 19 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Prof. Dr. Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI225/13, Hasan Isafi dhe z. Muharrem Isafi, Aktvendim i datës 12 maj 2014 - për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 972/2013, të 18 tetorit 2013

Rasti KI225/13, vendimi i 12 majit 2014.

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, qartazi e pabazuar, e drejta e servitutit, barazia para ligjit, mbrojtja e pronës.

Parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës së Kosovës, me të cilën kontestojnë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 972/2013, të 18 tetorit 2013, me të cilin sipas pretendimit të parashtruesve së kërkesës, ishin shkelur neni 46 [Mbrojtja e Pronës], neni 24 [Barazia para Ligjit] dhe neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), për shkak të mosmarrëveshjes mbi të drejtën e pronës në mes të parashtruesve të kërkesës dhe personave të tretë.

Me 19 shtator 2007, Gjykata Komunale në Gjakovë vendosi sipas padisë së H. I. nga fshati Bec, kundër parashtruesve të kërkesës, duke vërtetuar të drejtën e servitutit të H.I. në paluajtshmërinë e caktuar. Prona gjendet në ngastrën shërbyese nr. 245/11 KK Bec, me fillim nga rruga publike që është e regjistruar si ngastër kadastrale nr. 247 KK Bec. Ajo gjykatë nxori Aktgjykimin C. nr. 43/07, i cili vërteton të drejtën e servitutit të rrugëkalimit për paditësin H. I.

Objekti i kontestit për të drejtën e servitutit në pronën e paluajtshme u finalizua më 18 tetor 2013, kur Gjykata e Apelit e Kosovës vendosi në baze të ankesës së parashtruesve të kërkesës të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, E. nr. 368/09, të 22 marsit 2013 dhe nxori Aktvendimin CA. nr. 972/2013, duke refuzuar ankesën si të pathemeltë.

Duke shqyrtuar kërkesën e parashtruesve lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. no. 972/2013, të 18 tetorit 2013, Gjykata Kushtetuese konsideron që faktet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës nuk kanë arsyetuar në asnjë mënyrë pretendimin e shkeljes së të drejtave kushtetuese dhe e parashtruesit nuk i kanë mbështetur sa duhet pretendimet e tyre. Prandaj Gjykata konkludoi se faktet e paraqitura nga parashtruesit nuk kanë arsyetuar në asnjë mënyrë pretendimin e shkeljes së të drejtave të tyre kushtetuese, prandaj kërkesa është qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI225/13
Parashtrues
Hasan Isafi dhe Muharrem Isafi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 972/2013, të 18 tetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Hasan Isafi dhe z. Muharrem Isafi, nga fshati Bec, komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të cilët me autorizim i përfaqëson znj. Shahe Isafi nga fshati Bec, komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë: përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 972/2013, të 18 tetorit 2013, të cilin parashtruesit e kërkesës pohojnë se e kanë pranuar më 2 nëntor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 972/2013, i 18 tetorit 2013, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesve, ishin shkelur neni 46 [Mbrojtja e Pronës], neni 24 [Barazia para Ligjit] dhe neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), për shkak të mosmarrëveshjes mbi

të drejtën e pronës në mes të parashtruesve të kërkesës dhe personave të tretë.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 shkurt 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 13 janar 2014, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI225/13, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI225/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 31 janar 2014, Gjykata Kushtetuese i njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi nga përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës që të plotësonin formularin zyrtar të Gjykatës për regjistrim të kërkesës.

8. Më 10 shkurt 2014, përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin zyrtar të Gjykatës për regjistrim të kërkesës.

9. Më 20 shkurt 2014, Gjykata informoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 12 maj 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues Robert Carolan, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi, i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 19 shtator 2007, Gjykata Komunale në Gjakovë vendosi sipas padisë së H. I. nga fshati Bec, kundër parashtruesve të kërkesës, duke vërtetuar të drejtën e servitutit të H. I. në paluajtshmërinë e caktuar. Prona gjendet në ngastrën shërbyese nr. 245/11 KK Bec, me fillim nga rruga publike që është e regjistruar si ngastër kadastrale nr. 247 KK Bec. Ajo gjykatë nxori Aktgjykimin C. nr. 43/07, i cili vërteton të drejtën e servitutit të rrugëkalimit për paditësin H. I. Gjykata Komunale në Gjakovë më tej theksoi:

> "*Gjykata analizoj edhe variante të tjera të paraqitura në ekspertiza ... por erdh tek përfundimi se varianti i aprovuar ka ekzistuar që nga ndarja e paraardhësve të ndërgjyqësve...*".

12. Më 3 shkurt 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë vendosi sipas ankesave të parashtruesve të kërkesës kundër Aktgjykimit C. nr. 43/07, të 19 shtatorit 2007, duke nxjerrë Aktgjykimin Ac. nr. 308/09 dhe duke refuzuar këto ankesa si të pabazuara. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata e Qarkut në Pejë më tej theksoi:

> "*Aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kurse në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, gjykata e qarkut në kuptim të nenit 368 të LPC i refuzoi ankesat e të autorizuarve të padituve, kurse aktgjykimin e atakuar e aprovoi*".

13. Më 18 mars 2009, Gjykata Komunale në Gjakovë vendosi sipas kërkesës për revizion të parashtruesve të kërkesës, me Aktvendimin C. nr. 43/07. Në atë Aktvendim, ajo i hodhi poshtë revizionet e parashtruesve të kërkesës si të palejuara me arsyetimin si në vijim:

> "*Revizionet e parashtruara nga ana të autorizuarve të padituve janë të palejuar, bazuar në nenin 382 të ish Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe Urdhëresës Administrative nr. 200110 të datës 21 qershor 2001.... për valutën e lejuar për përdorim në Kosovë ka ka qënë e paraparë vlera 1600 DM, e cila vlerë kontesti duhet të i përshtatet vlerës së shprehur në euro...".*

14. Më 9 qershor 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë, duke vepruar në bazë të ankesës së parashtruesve të kërkesës, nxori Aktvendimin Ac. nr. 194/09, dhe i refuzoi ankesat si të pabazuara duke theksuar:

"Aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kurse në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, Gjykata e qarkut në kuptim të nenit 380 al. 1 pika 2 të LPK refuzoi ankesat e të autorizuarve të paditurve kurse aktvendimin e atakuar e vërtetoi".

15. Më 10 shtator 2012, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi lidhur me revizionin e parashtruesve të kërkesës përmes Aktvendimit Rev. nr. 432/2009, duke e refuzuar si të pabazuar revizionin dhe vërtetoi Aktvendimin Ac. nr. 194/09, të 9 qershorit 2009, të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

16. Më 22 mars 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë, duke vepruar në bazë të kundërshtimit të parashtruesve të kërkesës në çështjen përmbarimore, nxori Aktvendimin E. nr. 368/09, me të cilin refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e parashtruesve të kërkesës, me të cilin është lejuar përmbarimi sipas propozimit të H. I., bazuar në Aktgjykimin C. nr. 43/07, të 19 shtatorit 2007.

17. Më 18 tetor 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës vendosi në bazë të ankesës së parashtruesve të kërkesës të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, E. nr. 368/09, të 22 marsit 2013 dhe nxori Aktvendimin CA. nr. 972/2013, duke refuzuar ankesën si të pathemeltë. Gjykata më tej theksoi:

"*Këtë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë, kolegji e vlerëson të drejtë dhe të bazuar në ligj, pasi që vendimi gjyqësor në bazë të cilit është caktuar përmbarimi, është i formës së prerë, dhe ka kaluar, afati për përmbushjen vullnetare, të obligimit të caktuarën titullin përmbarimorë sipas të cilit debitorët, kanë për detyrë të respektojnë të drejtën e servitutit të kreditorit H.I, sipas dispozitivit të aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale të Gjakovës C. Nr. 43/07të dt. 19.09.2007*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesit pretendojnë se:

"*Sipas Aktvendimeve të lartë cekura mendoj se është shkelur neni 46 i Kushtetutës së Kosovës nga pika 1, 2 dhe 3, Neni 24 pika 1 dhe 2 si dhe Neni 31 sepse palëve në rastin e parë dhe të dytë nuk u ka mundësuar që të mbrojnë pronën e vet edhe përkundër faktit se ata kanë paraqitur fakte të reja lidhur me këtë çështje...*".

19. Parashtruesit arrijnë në përfundim duke kërkuar nga Gjykata:

> *"... anulimin e vendimeve të mara nga Gjykata dhe kthimin e lëndëve në shkallën e parë për rishqyrtim dhe rivendosje dhe gjykim të drejtë dhe të paanshëm të pa ndikuar nga jashtë..."*.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të vendosë për kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesit i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë dhe specifikohen më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili përcakton që:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

Në lidhje me këto kërkesa, Gjykata vëren që parashtruesit janë persona fizikë, si dhe janë palë të autorizuara në pajtim me nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

22. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu duhet të vërtetojnë që i kanë përmbushur kërkesat e nenit 49 të Ligjit, në lidhje me dorëzimin e kërkesës brenda afatit të caktuar. Mund të shihet nga shkresat e rastit se nuk ka asnjë provë që do të kontestonte pretendimet e parashtruesve që, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 972/203, të 18 tetorit 2013, ata e kanë pranuar më 2 nëntor 2013, andaj kërkesa është dorëzuar brenda afatit prej 4 (katër) muajve, siç përcaktohet me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Në lidhje me kërkesën, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

> *"(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...], ose*
>
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*

[…], ose

(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

24. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i këtyre të fundit që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28, shih edhe Rastin nr. KI70/11, parashtruesit *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

25. Gjykata Kushtetuese mund vetëm të trajtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë sa që parashtruesit të kenë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, Kërkesa e 10 korrikut 1991).

26. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren që arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e nxjerrë nga Gjykata e Apelit e Kosovës është i qartë, si dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur që procedurat pranë gjykatave të rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, S*hub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009). Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë prezantuar argumente bindëse që do të mbështesnin shkeljet e pretenduara.

27. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës nuk kanë dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që do të vërtetonte shkeljen e të drejtave të tyre sipas Kushtetutës (shih *Vanek kundër Republikës Sllovake*, Vendimi i GJEDNJ-së lidhur me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

28. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron që faktet e prezantuara nga parashtruesit e kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkelje të të drejtave kushtetuese dhe parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 12 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI99/14 dhe KI100/14, Shyqyri Syla dhe Laura Pula, Vendim për masë të përkoheshme i datës 3 korrik 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e përzgjedhjes për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror te Shtetit

Rastet e bashkuara, KI99/14 dhe KI100/14, vendimi i 3 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesa individuale, kërkesë për masë të përkohshme, rasti *prima facie.*

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve lidhur me procedurën e përzgjedhjes për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit, gjegjësisht vendimet e KPK për nominim dhe propozimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit KPK nr. 151/2014, të 6 qershorit 2014 (z. Shyqyri Syl, KI99 / 14) dhe vendimet e KPK/ 146/2014, të 5 qershorit 2014, në lidhje me kërkesën e parashtrueses së kërkesës (znj. Laura Pula KI100/14) për rishikimin e listës përfundimtare të vlerësimit të kandidatit.

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se KPK gjatë procesit të përzgjedhjes dhe të nominimit të kandidatit për postin e Kryeprokurorit të Shtetit ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 3 [Barazia para Ligjit], Neni 7 [Vlerat] dhe nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës KI99/14, z. Shyqyri Syla kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht të pezullojë emërimin e kandidatit të propozuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në pritje të rezultatit të procedurës para Gjykatës.

Më 4 korrik 2014, Gjykata aprovoi kërkesën e parashtruesve për vendosjen e Masës së përkohshme, duke konsideruar se ekziston rasti *prima facie* dhe se parashtruesi ka paraqitur mjaft argumente bindëse që emërimi i kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit nga Presidenti i Republikës së Kosovës mund të rezultojë me dëme të pariparueshme për parashtruesin e kërkesës.

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME
në
Rastet Nr. KI99/14 dhe KI100/14
Parashtrues
Shyqyri Syla dhe Laura Pula
Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e përzgjedhjes për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Shyqyri Syla (KI99/14), Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, dhe znj. Laura Pula (KI100/14), Prokurore në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës). Parashtruesit e kërkesës ishin kandidatë në procedurën e përzgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë procedurën e përzgjedhjes për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit. Parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Syla, KI99/14) konteston Vendimin KPK nr. 151/2014 e Këshillit Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK), të 6 qershorit 2014, për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit. Në anën tjetër, parashtruesja e kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14) e konteston Vendimin KPK/146/2014, të 5 qershorit 2014, lidhur me kërkesën e saj për rishqyrtimin e listës përfundimtare me pikët e vlerësimit të kandidatëve, të 31 majit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve që kanë të bëjnë me procedurën e përzgjedhjes për nominimin e kandidatit në postin e Kryeprokurorit të Shtetit, përkatësisht Vendimit të KPK-së për nominimin dhe për propozimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit (KPK nr. 151/2014, të 6 qershorit 2014).

4. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se KPK, gjatë procesit të përzgjedhjes dhe të nominimit të kandidatit për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 3 [Barazia para Ligjit], me nenin 7 [Vlerat] dhe me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

5. Parashtruesi i kërkesës (KI99/14, z. Shyqyri Syla) kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht të pezullojë procedurën e emërimit të kandidatit të nominuar.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 (3) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 12 qershor 2014, parashtruesit e kërkesës i dorëzuan kërkesat e tyre në mënyrë individuale në Gjykatë.

8. Më 17 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI99/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI39/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 17 qershor 2014, në pajtim me rregullin 37.1 të Rregullores së punës, Kryetari urdhëroi bashkimin e kërkesës KI100/14 me kërkesën KI99/14. Me këtë urdhër, u vendos që gjyqtari raportues

dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të jenë të njëjtë, si ishte caktuar me vendimet e Kryetarit për caktimin e gjyqtarit raportues dhe të Kolegjit shqyrtues, më 17 qershor 2014.

10. Më 19 qershor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin dhe për bashkimin e kërkesave. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi KPK-së kopjet e kërkesave.

11. Më 24 qershor 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Presidentit të Republikës së Kosovës.

12. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën për përjashtimin e tij nga seancat e këshillimeve për periudhën qershor-korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë lidhur me pretendimet e caktuara të ngritura ndaj tij.

13. Më 3 korrik 2014, pasi dëgjoi gjyqtarin raportues dhe pasi diskutoi për qëndrimet e parashtruesve, të shprehura në parashtresat e tyre me shkrim, Gjykata vendosi të miratojë kërkesën për Masë të përkohshme deri në publikimin e vendimit të Gjykatës.

Përmbledhja e shkurtër e fakteve

14. Si rezultat i shpalljes së brendshme për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe të procedurës së përmbyllur të përzgjedhjes, parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Syla, KI99/14) ishte ndër tre kandidatët e ranguar më së larti dhe që iu nënshtrua procedurës së votimit për të nominuarin për Kryeprokuror të Shtetit.

15. Më 6 qershor 2014, KPK-ja nxori vendimin KPK. nr. 151/2014 për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit.

16. Më 13 qershor 2014, KPK-ja i dërgoi Presidentit të Republikës së Kosovës propozimin për emërimin e të nominuarit për Kryeprokuror të Shtetit.

17. Deri më sot, Presidenti i Republikës së Kosovës nuk ka nxjerrë dekret për emërimin e kandidatit të nominuar nga KPK-ja.

Kërkesa e parashtruesit

18. Parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Syla, KI99/14) kërkon nga Gjykata:

"Anulimin e procesit zgjedhor dhe aplikimin e masës së përkohshme për ndalimin e dekretimit".

Kërkesa për Masë të përkohshme

19. Siç u tha më lart, parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Syla, KI99/14) kërkoi nga Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, gjegjësisht të pezullojë procedurën e emërimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës të kandidatit të nominuar.

20. Gjykata, në bazë të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 2, të Kushtetutës, të nenit 27 të Ligjit dhe të rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, gjen se kemi rast *prima facie* të kërkesës dhe se parashtruesi ka paraqitur mjaft argumente bindëse që emërimi i kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit nga Presidenti i Republikës së Kosovës mund të rezultojë me dëme të pariparueshme për parashtruesin e kërkesës.

21. Prandaj, miratohet kërkesa e parashtruesit për Masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 116, paragrafi 2, të Kushtetutës, në bazë të nenit 27 të Ligjit dhe në bazë të rregullave 55 (4) dhe 56 (3) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TË MIRATOJË Masën e përkohshme;

II. TË MIRATOJË Masën e përkohshme deri në publikimin e vendimit të Gjykatës dhe jo më vonë se deri më 1 gusht 2014, nga data e nxjerrjes së këtij vendimi;

III. TË PEZULLOJË MENJËHERË procedurën e emërimit të kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit nga Presidenti i Republikës së Kosovës;

IV. T'UA KOMUNIKOJË këtë vendim palëve;

V. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI35/14, Brahim Rama, Aktvendim i datës 27 mars 2014, - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0079-A0001-A0004, të 23 janarit 2014

Rasti KI35/14, vendimi i 27 marsit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktvendimin AC-I-13-0079-A0001-A0004, të 23 janarit 2014 konstatoi se ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte e paafatshme, prandaj deklaroi ankesën të papranueshme për arsye procedurale .

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se ai ishte larguar nga vendi i tij i punës në mënyrë diskriminuese dhe se ai kishte të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku" në Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës nuk i referohet ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar sepse pretendimet dhe provat e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës nuk kanë treguar se të drejtat e tij kushtetuese ishin dëmtuar nga Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI35/14
Parashtrues
Brahim Rama
Vlerësimi kushtetues i Aktvendimit AC-I-13-0079-A0001-A0004, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 23 janarit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Cukalovic, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, Gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Brahim Rama nga fshati Stanovc, komuna e Vushtrrisë.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin AC-I-13-0079-A0001-A0004, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme), të 23 janarit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt çështjeje është vlerësimi kushtetues i vendimit të kontestuar që supozohet "*se është diskriminues ndaj parashtruesit të kërkesës sepse i mohon atij të drejtën që të realizojë një pjesë nga të ardhurat e gjeneruara nga privatizimi i NSH 'Ramiz Sadiku' në Prishtinë*".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë, Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë, Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë, Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 27 shkurt 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 mars 2014, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI35/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI35/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu (anëtarë).

7. Më 11 mars 2014, parashtruesi i kërkesës dhe Dhoma e Posaçme u njoftuan për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 27 mars 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Në një periudhë të caktuar kohore, parashtruesi i kërkesës kishte qenë i punësuar në NSH "Ramiz Sadiku" në Prishtinë.

10. Më 27 qershor 2006, NSH "Ramiz Sadiku" në Prishtinë u privatizua.

11. Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime për 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH "Ramiz Sadiku" ishte publikuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) në mars të vitit 2009 dhe afati për parashtrimin e ankesës te Dhoma e Posaçme ishte 27 marsi 2009.

12. Në një datë të panjohur, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare të publikuar nga AKP-ja.

13. Më 10 qershor 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme, me Aktgjykimin SCEL-09-0001, kishte hedhur poshtë ankesën e parashtruesit si të papranueshme.

14. Më 12 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë te Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme kundër Aktgjykimit SCEL-09-0001.

15. Më 23 janar 2014, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme, me Aktvendimin AC-I-13-0079-A0001-A0004, kishte hedhur poshtë ankesën e parashtruesit si të papranueshme për shkak se ishte e paafatshme.

16. Në aktvendimin e lartpërmendur, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme kishte arsyetuar: *"Aktgjykimin e ankimuar e kishte pranuar me datë 29 nëntor 2011, afati i fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë 30 dhjetor 2011. Ndërsa ankesa është parashtruar në Dhomën e Posaçme më datë 12 qershor 2013, rrjedhimisht ankesa ishte e paafatshme, pasi që ishte paraqitur pas më tepër se një vit e gjysmë, andaj duhet të hedhet poshtë si e papranueshme. Kolegji i Apelit për shkak të ankesës së paafatshme, nuk e ka mundësinë të marrë qëndrim ligjor lidhur me gjetjet dhe përfundimet e Trupit Gjykues të dhëna në Aktgjykimin e ankimuar lidhur me ankesën e këtij ankuesi të paraqitur ndaj listës përfundimtare".*

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon *"se është larguar nga puna në mënyrë diskriminuese dhe se duhet të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për të përfituar një pjesë prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH 'Ramiz Sadiku' në Prishtinë".*

18. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se ishte diskriminuar me vendimet e Dhomës së Posaçme.

19. Parashtruesi i kërkesës nuk i referohet ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Vlerësimi i pranueshmërisë

20. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

22. Gjykata po ashtu i referohet Nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".*

23. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me Nenin 113.7 të Kushtetutës dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit ligjor në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

24. Gjykata po ashtu merr parasysh rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, që përcakton:

> *(1) "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
> *...*
> *c) kërkesa është qartazi e bazuar".*

25. Parashtruesi në përgjithësi pretendon *"se ai gëzon të drejtën për të përfituar nga një pjesë e të ardhurave nga privatizimi i NSH 'Ramiz Sadiku'".*

26. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur ankesë jashtë afatit ligjor te Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme dhe rrjedhimisht ankesa e tij ishte hedhur poshtë si e

paafatshme; për më tepër pretendimet e ngritura dhe faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës për shkelje të dispozitave të Kushtetutës, nuk tregojnë në asnjë mënyrë se Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme ia ka mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

27. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese rithekson se roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih García Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28, shih dhe Rastin Nr. KI70/11, parashtruesit Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

28. Gjykata Kushtetuese gjithashtu thekson se vërtetimi i saktë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i gjykatave të rregullta; roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë pajtueshmëri me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih rastet KI73/13, KI102/13, KI105/13, KI106/13, KI113/13, KI130/13 - Parashtrues Hamdi Ademi dhe 6 të tjerë, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 nëntorit 2013, gjithashtu shih rastin Akdivar kundër Turqisë, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65)

29. Për më tepër, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e gjykatave të rregullta t'i vlerësojnë provat që i kanë në dispozicion. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të vlerësojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në përgjithësi, duke përfshirë mënyrën se si janë marrë provat (Shih rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

30. Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka sjellë prova se Dhoma e Posaçme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë dhe as nuk ka qartësuar saktësisht cilat të drejta dhe liri janë shkelur nga Dhoma e Posaçme.

31. Për më tepër, pakënaqësia e parashtruesit me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentueshëm për shkelje të dispozitave të Kushtetutës (shih rastin Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

32. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 47 të Ligjit dhe Rregullat 36 (1) c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 27 mars 2014, njëzëri

VENDOSI

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI41/14, Bajram Osmani, Aktvendim i datës 19 maj 2014 - kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 4984/2912 të 29 nëntorit 2013

Rasti KI41/14, vendimi i 19 majit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest civil, e drejta për gjykim të drejte, e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, kërkesë qartazi e pabazuar.

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendonte se vendimi i kontestuar, Ac. nr. 4984/2012, i 29 nëntorit 2013, shkelte të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, si dhe nenin 6 të KEDNj-së, për faktin se:" Gjykata e Apelit ka qenë e detyruar të parashtrojë në aktgjykim arsye shtesë për ndryshimin e aktvendimit të shkallës së parë dhe të merret me çështjen thelbësore, pengimin e posedimit dhe jo t'i shqyrtojë marrëdhëniet pronësore, kur vënë në dukje se ndërgjyqësit kanë pasur një oborr të përbashkët dhe në këtë mënyrë kanë qenë bashkëpronarë, kështu që, në bazë të këtij fakti, i ka ofruar paditësit mbrojtje gjyqësore në mbështetje të nenit 108 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtën e garantuar për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sipas nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".

Mirëpo pasi qe, Gjykata shqyrtoi në tërësi shkresat e lendes gjeti se, parashtruesi nuk kishte paraqitur asnjë argument bindës, që do te tregonte se atij i janë shkelur të drejtat themelore të garantuara me Kushtetutë. Në këtë kontekst Gjykata i është referuar rastit Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005.

Në tërësi, Gjykata gjeti se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbushte kriteret e pranueshmërisë, sepse parashtruesi kishte dështuar të provojë se vendimi i kontestuar i shkelte atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, Gjykata përfundoi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI41/14
Parashtrues
Bajram Osmani
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 4984/2912 të 29 nëntorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Bajram Osmani, me vendbanim në Dragash (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 4984/2012, të 29 nëntorit 2013 (në tekstin e mëtejmë: vendimi i kontestuar), të cilin parashtruesi e ka pranuar më 14 janar 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 4984/2012, të 29 nëntorit 2013, përkitazi me pretendimin e

parashtruesit për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Baza juridike kësaj kërkese është: neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 dhe 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 mars 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 1 prill 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendim nr. GJR. KI41/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu, gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI41/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 11 prill 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën e Apelit në Prishtinë dhe palën e interesuar, B. B., për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 19 maj 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 16 tetor 2012, Gjykata Komunale në Dragash, me Aktvendimin P. nr. 72/2012, refuzoi në tërësi kërkesëpadinë e B. B., me të cilën pretendonte se parashtruesi e ka penguar atë në posedimin e oborrit të përbashkët (ngastra kadastrale nr. 836, K. Z. Leshtan, në vendin e quajtur Selo - Lestane - Selo) për faktin se parashtruesi, më 29 gusht 2012, vendosi një shtyllë betoni dhe pastaj ka ngritur tarracën në gjatësi prej 5. 50 metrash dhe gjerësi prej 1.00 m, me qëllim të vazhdimit të ndërtimit të strukturave të tjera mbi të.

10. Më 29 nëntor 2011, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin Ac. nr. 4984/2012, ndryshoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale, P. nr. 72/2012, dhe konstatoi se parashtruesi ka kryer aktin e pengimit të posedimit ndaj B. B. Parashtruesi është urdhëruar që në afat prej 7 (shtatë) ditësh ta kthejë në gjendje të mëparshme të drejtën e shfrytëzimit dhe posedimit të oborrit të përbashkët, nga dita e pranimit të aktvendimit në fjalë, me kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

11. Për më tepër, Gjykata e Apelit arsyeton aktvendimin e saj si më poshtë:

[...]

"Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë Gjykata e Apelit nuk e pranon si të drejtë e të ligjshëm për shkak se aktvendimi i goditur nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara nga neni 182 par. 2, pikat b), g), j), k) dhe m), të cilat gjykata e shkallës së dytë i vëren sipas detyrës zyrtare në mbështetje të nenit 184 të LPK.

Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, e cila vihet në dyshim nga pretendimet ankimore, gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, gjë që, po ashtu, shihet sipas detyrës zyrtare nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK. Gjykata e shkallës së dytë mori këtë qëndrim juridik, për shkak se, pengimi i posedimit kryhet në dy mënyra: me anë të shqetësimit dhe me anë të marrjes së posedimit. Me rastin e shqetësimit, i padituri e pengon paditësin në posedimin e sendit apo të së drejtës, por posedimi nuk merret, përkatësisht nuk bëhet privimi nga posedimi. Nga kjo rezulton se që t'i jepet mbrojtje paditësit për shkak të pengimit të posedimit.

Nga shkresat e lëndës dhe faktet e pakontestueshme është vërtetuar se ndërgjyqësit kanë pasur një oborr të përbashkët, gjë që do të thotë se kanë qenë bashkëpronarë, prandaj, mbi këtë bazë, paditësit i ka takuar e drejta e kërkimit të mbrojtjes gjyqësore sipas nenit 108 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat

e tjera Sendore. Vendimi për shpenzimet e procedurës mbështetet në dispozitat e neneve 453 dhe 454 të LPP.
Nga sa u parashtrua, u desh që aktvendimi i goditur të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar në mbështetje të nenit 195, pika nën e), lidhur me nenin 209 par. 1, pika nën c) të LPP".

12. Më 31 janar 2014, parashtruesi, pranë Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, ka parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, me qëllim që kontesti të zgjidhet nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

13. Më 11 shkurt 2014, Zyra e Prokurorit të Shtetit, nëpërmjet parashtresës KML. C. nr. 14/14, njoftoi parashtruesin se nuk janë plotësuar kushtet për ngritje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Vendimi i kontestuar, Ac. nr. 4984/2012, i 29 nëntorit 2013, shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, si dhe nenin 6 të KEDNj-së, për faktin se:" *Gjykata e Apelit ka qenë e detyruar të parashtrojë në aktgjykim arsye shtesë për ndryshimin e aktvendimit të shkallës së parë dhe të merret me çështjen thelbësore, pengimin e posedimit dhe jo t'i shqyrtojë marrëdhëniet pronësore, kur vënë në dukje se ndërgjyqësit kanë pasur një oborr të përbashkët dhe në këtë mënyrë kanë qenë bashkëpronarë, kështu që, në bazë të këtij fakti, i ka ofruar paditësit mbrojtje gjyqësore në mbështetje të nenit 108 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtën e garantuar për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sipas nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".*

15. Parashtruesi gjithashtu ankohet kundër njoftimit KML. C. nr. 14/14, të Prokurorit të Shtetit, me të cilin iu refuzua kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, pa ndonjë arsye të veçantë dhe me këtë rast pretendon se Prokurori i Shtetit ia mohoi shfrytëzimin e këtij mjeti juridik, që çështja e tij të shqyrtohej nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Në mënyrë që të jetë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës të Gjykatës.

17. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, që përcakton:

36. (1) "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.

36. (2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin

[...]

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

18. Gjykata vëren se, parashtruesi pretendon në shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, dhe të nenit 6 të KEDNJ-së.

19. Në këtë drejtim, neni 31 i Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], përcakton:

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike".

20. Gjithashtu, neni 6 i KEDNJ-së, përcakton:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile".

21. Gjykata vëren që vendimi i kontestuar përmban arsyetim të gjerësishëm dhe gjithëpërfshirës. Në këtë kontekst, vendimi i kontestuar, siç pretendon parashtruesi, nuk është marrë me shkelje substanciale të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Gjykata e Apelit, vendimi i së cilës kontestohet, ka dhënë arsye të mjaftueshme sa u përket fakteve të rastit dhe gjetjes së tyre, për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare.

22. Nuk është e mjaftueshme që parashtruesi, në kërkesën e tij, vetëm t'i përmendë nenet a dispozitat e Kushtetutës, me të cilat pretendon shkeljen e të drejtave të tij. Pretendimi, përkitazi me shkeljen e neneve a dispozitave të Kushtetutës, duhet të jetë i argumentuar dhe i arsyetuar, në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar.

23. Detyra e Gjykatës lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese, është që të analizojë dhe të vlerësojë nëse procedurat, në tërësinë e tyre, kanë qenë të drejta dhe në pajtueshmëri me mbrojtjen shprehimisht të përcaktuar me Kushtetutë. Pra, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt, kur i shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e instancave më të ulëta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

24. Gjykata vëren se parashtruesit në gjykatën e Apelit i janë ofruar të gjitha mundësitë e paraqitjes së argumenteve, fakteve dhe provave, kundër pretendimeve të palës kundërshtare, prandaj nuk qëndron fakti se parashtruesit i është mohuar e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

25. Në rastin konkret, parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë argument bindës, që tregon se atij i janë shkelur të drejtat themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, *Vanek kundër Republikës Sllovake,* Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

26. Për më tepër, në rastin konkret, Gjykata nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse të zhvilluara në Gjykatën e Apelit, kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis, Shub vs. Lithuania,* Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

27. Në tërësi, Gjykata gjen se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, sepse parashtruesi ka dështuar të provojë se vendimi i kontestuar i shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

28. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, Gjykata përfundon se kërkesa është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d), si dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores, më 19 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Dr. Kadri Kryeziu	Prof. Dr. Enver Hasani

KI46/14, Slobodan Vujičić, Aktvendim i datës 30 qershor 2014- Kërkesë për interpretimin e nenit 57.1 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Rasti KI46/14, vendimi i 30 qershorit 2014.

Fjalët kyçe: kontroll abstrakt, interpretim, palë e paautorizuar.

Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke kërkuar nga Gjykata *"[...] meqenëse malazeztë nuk përfshihen ne Kushtetutën e Kosovës dhe i përkasin të njëjtit grup gjuhësor dhe fetar me serbet, a mundet partia 'Iniciativa qytetare e pjesëtarëve të komunitetit malazez' ('Iniciativa qytetare e pjesëtarëve të komunitetit malazez) të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare dhe të garojë për njërin nga 10 vendet e rezervuara ose të garantuara për komunitetin serb?"*.

Lidhur me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme sepse parashtruesi nuk është palë e autorizuar që të kërkojë interpretimin e dispozitave kushtetuese. Prandaj, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI46/14
Parashtrues
Slobodan Vujičić
Kërkesë për interpretimin e nenit 57.1 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Slobodan Vujičić (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prishtinë.

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës është kërkesa për interpretimin e nenit 57.1 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta]

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së

punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

4. Më 12 mars 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

5. Më 1 prill 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI46/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI46/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

6. Më 23 prill 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe e informoi Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për kërkesën.

7. Më 19 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

8. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata *"[...] meqenëse malazeztë nuk përfshihen në Kushtetutën e Kosovës dhe i përkasin të njëjtit grup gjuhësor dhe fetar me serbët, a mundet partia 'Iniciativa qytetare e pjesëtarëve të komunitetit malazez' të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare dhe të garojë për njërin nga 10 vendet e rezervuara ose të garantuara për komunitetin serb?"*.

9. Parashtruesi i kërkesës nuk ofron asnjë deklaratë të mëtejshme apo argument në mbështetje të kërkesës.

Pranueshmëria e kërkesës

10. Gjykata vëren se në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, ajo duhet të shqyrtojë kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

11. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesën përkatëse në Gjykatë.

12. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës kërkon interpretimin e mënyrës së aplikimit të dispozitës së Kushtetutës lidhur me 10 (dhjetë) vendet e garantuara për partitë, koalicionet, iniciativat e qytetarëve dhe kandidatëve të pavarur duke shpallur vetveten si përfaqësues të komunitetit serb në Kosovë.

13. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili parasheh: *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar"*.

14. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kërkon interpretimin e zbatueshmërisë së një dispozite kushtetuese lidhur me zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Dispozita kushtetuese në fjalë është neni 57.1 i Kapitullit III të Kushtetutës, i cili parashikon: *"Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute"*.

15. Parashtruesi i kërkesës veçanërisht pretendon që malazezët i përkasin së njëjtës gjuhë dhe grup fetar si të serbëve në përputhje me nenin 57.1 të Kushtetutës dhe partia e tyre "Iniciativa qytetare e pjesëtarëve të komunitetit malazez" (Gradjanska Inicijativa Pripadnika Crnogorske Zajednice) duhet të jetë në gjendje të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare dhe të konkurrojë për një prej 10 (dhjetë) vendeve të garantuara, të rezervuara për komunitetin serb.

16. Siç kuptohet nga Gjykata, për sa i përket kërkesës për interpretim në lidhje me dispozitat e Kushtetutës, nuk ka asnjë dispozitë kushtetuese që fuqizon parashtruesin e kërkesës që të referojë një kërkesë të tillë në Gjykatë. Vetëm palët e përmendura shprehimisht me Kushtetutë kanë një autorizim të tillë.

17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 93.10 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës, *"Qeveria ka këto kompetenca: mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese"*. Për më tepër, në rastin nr. KO98/11, Gjykata konstatoi se *"Sipas nenit 93 (10) të Kushtetutës, Qeveria mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese. Nëse çështjet janë çështje kushtetuese, atëherë Qeveria do të jetë palë e autorizuar dhe kërkesa do të jetë e pranueshme*". (shih rastin KO98/11, parashtrues i kërkesës: *Qeveria e Republikës së Kosovës*, Aktgjykimi i 20 shtatorit 2011; dhe shih rastin KO18/14, parashtruese e kërkesës: *Vesna Mikić dhe*

20 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktvendimi për papranueshmëri, i 11 shkurtit 2014).

18. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 84.9 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës, *"Presidenti i Republikës së Kosovës: mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese"*.

19. Pasi që parashtruesi i kërkesës është një individ, ai/ajo ka të drejtë të parashtrojë kërkesë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, individët ose personat juridikë mund të dorëzojnë kërkesë për t'i kontestuar vendimet e autoriteteve publike, që pretendohen të jenë marrë me shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Mirëpo, këtu nuk kemi të bëjmë me një rast të tillë.

20. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë për interpretimin e nenit 57.1 të Kapitullit III të Kushtetutës.

21. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës, dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 30 qershor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI27/14, Nexhmi Bërnica nga Prishtina, Aktvendim i datës 12 maj 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-09-0001, të 10 qershorit 2011

Rasti KI27/14, vendimi i 12 majit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesa individuale, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Më 10 shkurt 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke kërkuar nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Parashtruesi në kërkesë pretendon se Agjencia e Privatizimit dhe Gjykata Supreme e Kosovës e kanë cenuar të drejtën e tij për punë.

Në bazë të të dhënave nga shkresat e lëndës, Gjykata konstaton se parashtruesi e ka parashtruar kërkesën e tij më 10 shkurt 2014. Gjithashtu, Gjykata, në bazë të shkresave në dispozicion, ka vërtetuar që Aktvendimi i fundit SCEL-09-0001 i Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme i është dorëzuar parashtruesit më 15 korrik 2011, pra në bazë të kësaj, parashtruesi e ka parashtruar kërkesën e tij në Gjykatë pas kalimit të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36. (1) b) të Rregullores së punës.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së parashtruar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në seancën e 12 majit 2014, vendosi që kërkesën ta deklarojë të papranueshme sepse është dorëzuar jashtë afatit kohor të paraparë me ligj.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI27/14
Parashtrues
Nexhmi Bërnica
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-09-0001, të 10 qershorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Nexhmi Bërnica nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin SCEL-09-0001, të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Trupi Gjykues i Dhomës së Posaçme), të 10 qershorit 2011, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 15 korrik 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit, i cili pretendohet t'i ketë pamundësuar parashtruesit të realizojë të drejtat e tij në një pjesë të 20% të të ardhurave nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore "Ramiz Sadiku" (në tekstin e

mëtejmë: NSH "Ramiz Sadiku") në Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës nuk përmend konkretisht se cilat nene të Kushtetutës janë cenuar.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 shkurt 2014, parashtruesi parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 mars 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI27/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI27/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Almiro Rodrigues.

7. Më 13 mars 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 12 maj 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 27 mars 2009, parashtruesi, i pakënaqur me vendimin e Agjencisë për Privatizim (në tekstin e mëtejmë: Agjencia), e cila nuk e ka përfshirë në listën e punëtorëve me të drejtë të përfitimit të një pjese nga 20% të të ardhurave të privatizimit, parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

10. Në ankesën e tij në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, parashtruesi ka pohuar që ai ka qenë punëtor i NSH "Ramiz Sadiku", dhe që ka punuar nga viti 1980 deri në privatizimin e NSH "Ramiz Sadiku".

11. Më 15 prill 2009, Agjencia, me një shkresë dërguar Dhomës së Posaçme, u përgjigj ndaj ankesës së parashtruesit, duke pohuar që nuk ka prova që mund të mbështesin bazat juridike për pjesëmarrje të parashtruesit në ndarjen e një pjese nga 20%-shi i privatizimit.

12. Më 10 qershor 2011, Trupi Gjykues i Dhomës së Posaçme mori Aktvendimin SCEL-09-0001, me të cilin e shpalli ankesën të papranueshme. Në arsyetimin e vendimit të tij, Trupi Gjykues thekson: "*Trupi Gjykues konsideron që provat e dorëzuara nga ana e parashtruesit të ankesës nuk vërtetojnë që ka përmbushur kushtet e përcaktuara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Kështu, ankesa e tij konsiderohet e pabazuar, dhe hidhet poshtë si e pabazuar*".

13. Në përfundim të Aktvendimit SCEL-09-0001, Trupi Gjykues i Dhomës së Posaçme thekson që: „*Në bazë të nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/4, ankesa kundër këtij vendimi bëhet në formë të shkruar te Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi në kërkesën e tij pretendon që Agjencia dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës kanë cenuar të drejtën e tij për punë.

15. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me këtë kërkesë:

> „*Kërkoj që të më paguhen 17 paga mujore në shumë prej 300 Euro, me kamatë ligjore, si dhe 20% të privatizimit të NSH-së "Ramiz Sadiku" në Prishtinë*".

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, ajo së pari duhet që të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

17. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton që:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

18. Gjykata më tutje i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)".

19. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
...

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi...".

20. Në bazë të të dhënave nga shkresat e rastit, Gjykata konstaton që parashtruesi e ka parashtruar kërkesën më 10 shkurt 2014. Gjithashtu, Gjykata, në bazë të shkresave të rastit, ka vërtetuar që Aktvendimi i fundit SCEL-09-0001, i Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme i është dorëzuar parashtruesit më 15 korrik 2011, pra në bazë të kësaj, parashtruesi e ka parashtruar kërkesën e tij në Gjykatë pas kalimit të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

21. Gjykata gjithashtu përkujton që qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit si dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, është të promovojë sigurinë juridike, duke siguruar që rastet që paraqesin çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme, si dhe që vendimet e nxjerra më herët të mos jenë pafundësisht të hapura për kontestim (shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi i 25 gushtit 2005).

22. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 12 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI199/13, Sinan Rashica, Akvendim i datës 20 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 331/2011, të 11 janarit 2013

Rasti KI 199/13, vendimi i 20 majit 2014.

Fjalët kyçe: e drejta në punë, neni 49, kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushteutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tij kushtetuëse janë cenuar me aktgjykimin e gjykatave të rregullta. Parashtruesi i kerkeses pretendon se aktgjykimi i Gjykates Supreme te Kosoves" ia mohon të drejtën sipas nenit 49 të Kushtetutës për kompensim të përkohshëm të të ardhurave personale". Parashtruesi i kerkeses kerkoi nga Gjykata Kushtetuese "t'ia njohë të drejtën për kompensim të përkohshëm deri në funksionimin e fondit pensional invalidor në Kosovë"

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrusit ishte e papranushme bazuar ne Rregullit 36 të Rregullores së punës dhe Nenit 49 te ligjit e cila përcakton ""Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor" në bazë të kësajë kërkesa është e paafatshme. Gjykata vendimin e saj e arsyton duke theksuar që në keto rrethana, Gjykata vëren se aktgjykimi i kontestuar nga parashtruesi i kërkesës është i 11 janarit 2013 dhe vendimi i fundit është i 14 qershorit 2013, ndërsa kërkesa është paraqitur me 13 nentor 2013. Kërkesa e parashtruesit nuk është në pajtim me nenin 49 te Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punes pasi që ishte dorezuar me shume se 1 (një) muaj pas vendimit të kontestuar. Për shkak te arsyeve të permendura, Gjykata vendosi të hedhe poshte kërkesen si të pa prpranuëshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI199/13
Parashtrues
Sinan Rashica
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 331/2011, të 11 janarit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Sinan Rashica, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin Rev. nr. 331/2011, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), Rev. nr. 331/2011, të 11 janarit 2013, i cili i është dorëzuar atij në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet *"t'ia ketë mohuar të drejtën e punës - neni 49 i Kushtetutës"*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores

së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI199/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI199/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

7. Më 5 mars 2013, Gjykata Supreme ishte njoftuar për kërkesën.

8. Më 20 maj 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 13 shkurt 2004, Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK), e aprovoi kërkesën e parashtruesit për pension në kategorinë "A" (Nr. 43/16) në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 dhe me Statutin e Fondit Pensional të KEK-ut.

10. Në vendimin e lartcekur të KEK-ut ishte përcaktuar se pagesa e pensionit për parashtruesin e kërkesës do të fillojë më 1 shkurt 2004 dhe do të përfundojë më 29 shkurt 2009, derisa shuma e pensionit mujor do të jetë 105 euro. Për më tepër, vendimi theksonte se pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh Komisionit për shqyrtimin e kontesteve, përmes Administratës së Fondit Pensional.

11. Sipas dokumenteve të dorëzuara, nuk është paraqitur asnjë ankesë kundër këtij vendimi.

12. Pas 29 shkurtit 2009, KEK-u e ndërpreu pagesën e pensionit të parashtruesit të kërkesës, siç ishte specifikuar në marrëveshje.

13. Parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

14. Më 21 shkurt 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 362/2009) e aprovoi padinë e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës dhe e urdhëroi KEK-un të vazhdojë me pagesë deri në themelimin e Fondit Pensional Invalidor të Kosovës.

15. KEK-u ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale (Aktgjykimi C. nr. 362/2009).

16. Më 28 qershor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi Ac. nr. 497/2011) e refuzoi si të pabazuar ankesën e dorëzuar nga KEK-u dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

17. Më 20 mars 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi E. nr. 2139/11) urdhëroi përmbarimin e vendimit (Aktgjykimi C. nr. 362/2009).

18. Më 4 prill 2012, KEK-u ushtroi ankesë kundër aktvendimit të lartcekur dhe kërkoi që procedura përmbarimore të pezullohet deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Supreme të Kosovës.

19. Më 12 prill 2013, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi E. nr. 2139/11) e hodhi poshtë kërkesën për pezullimin e procedurës përmbarimore.

20. Më 10 gusht 2011, KEK-u dorëzoi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

21. Më 11 janar 2013, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 331/2011) e aprovoi revizionin e ushtruar nga KEK-u.

22. Gjykata Supreme konstatoi se*:*

> *"Gjykatat e instancës më të ulët drejtë dhe në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike por, gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Nga vendimi nr. 43/16 nga data 13.02.2004, del se paditësi vetë ka aplikuar për fitimin e pensionit në emër të kategorisë I, invaliditetit në punës në pajtim me Rregulloren e UNMIKU-ut nr. 2001/35 dhe Statutit të Fondit Pensional të KEK-ut e cila kërkesë i është miratuar nga ana e të padituërës dhe sipas këtij vendimi pagesa e pensionit ka filluar prej datës 01.02.2004 dhe përfundon më 29.02.2009, në lartësi prej 105 € në muaj. Paditësi ka mund të paraqes ankesë kundër këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit Komitetit për shqyrtimin e mospajtimeve përmes administratës së Fondit*

Pensional, por ankesë nuk ka ushtruar dhe pensionin e ka pranuar gjer më 29.02.2009. Kjo Gjykatë vlerëson se pas pagesës së pagës në afatin e paraparë në vendim, e paditura më tutje nuk ka obligim ndaj paditësit, ngase ka përmbushë obligimin ligjor i cili rrjedh nga vendimi i cekur".

23. Më 14 qershor 2013, Gjykata e Apelit e refuzoi si të pabazuar ankesën e ushtruar nga KEK-u dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale (E. nr. 2139/11, të 12 prillit 2012).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës *"ia mohon të drejtën sipas nenit 49 të Kushtetutës për kompensim të përkohshëm të të ardhurave personale. Kjo e drejtë më është njohur me Aktgjykimin C. nr. 362/2008 të 21.02.2011 dhe Aktgjykimin Ac. nr. 497/2011 të 28.06.2011".*

25. Parashtruesi i kërkesës thekson më tej se: *"arsyeja pse ai e nënshkroi dhe nuk ushtroi ankesë ndaj vendimit të KEK-ut ishte sepse KEK-u kishte premtuar se ose do të vazhdohej ose ata do të ktheheshin në punë".*

26. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Kushtetuese *"t'ia njohë të drejtën për kompensim të përkohshëm deri në funksionimin e fondit pensional invalidor në Kosovë".*

Pranueshmëria e kërkesës

27. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)".

29. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili përcakton se:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
...
b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi...".

30. Në këto rrethana, Gjykata vëren se aktgjykimi i kontestuar nga parashtruesi i kërkesës është i 11 janarit 2013 dhe vendimi i fundit është i 14 qershorit 2013, ndërsa kërkesa është paraqitur më 13 nëntor 2013. Kërkesa e parashtruesit nuk është në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës pasi që ishte dorëzuar më shumë se 1 (një) muaj pas vendimit të kontestuar.

31. Gjykata përkujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, është të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme si dhe vendimet e kaluara të mos jenë vazhdimisht të hapura për kontestim (shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi i 25 gushtit 2005).

32. Për më tepër, duke iu referuar rasteve të gjykuara nga Gjykata në lidhje me kompensim të përkohshëm për ndërprerje të punës nga ana e KEK-ut, Gjykata konsideron se në bazë të dokumenteve të paraqitura dhe procedurave të përfunduara, kjo kërkesë ndryshon nga rastet e lartcekura, pasi që marrëveshja e nënshkruar në mes të KEK-ut dhe ish-punëtorëve të tjerë të KEK-ut ka qenë deri në themelimin e Fondit Pensional Invalidor të Kosovës pa asnjë referencë të një date të përfundimit përkitazi me kërkesën e tanishme.

33. Nga kjo rrjedh se kërkesa e parashtruesit është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit, rregullat 36 (1) b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 20 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI227/13, Izjadin Shehu, Aktvendim i datës 30 qershor 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 93/2013, të 20 shtatorit 2013

Rasti KI 227/13, vendimi i 30 qershorit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr 93/2013, të 20 shtatorit 2013. Parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesë kundër Korporatës Energjetike të Kosovës, me të cilin kërkoi anulimin e njoftimit për ndërprerjen kontratës së tij të punës. Gjykata Komunale në Ferizaj e refuzoi padinë e tij si të pabazuar. Parashtruesi i kërkesës pastaj paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit e cila gjithashtu u refuzua si e pabazuar. Së fundi, Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe në këtë mënyrë vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj.

Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese ku ai pretendoi se aktgjykimi i kontestuar ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar. Në arsyetimin e saj, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës nuk në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkelje të së drejtave kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI227/13
Parashtrues
Izjadin Shehu
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 93/2013,
të 20 shtatorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Izjadin Shehu, nga Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 93/2013, të 20 shtatorit 2013, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e parashtruesit për revizion, pas aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Ferizaj dhe Gjykatës së Apelit, me të cilat u refuzua padia e tij kundër Korporatës Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK) për anulimin e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës.

3. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme iu dorëzua atij më 11 tetor 2013.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë *"shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht me nenin 3, paragrafi 2 [Barazia para ligjit], neni 24 [Barazia para ligjit] neni 31 [E*

Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ)".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatë

6. Më 16 dhjetor 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 15 janar 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kyeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 22 prill 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e informoi edhe Gjykatën Supreme lidhur me kërkesën.

9. Më 20 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 1 shkurt 2005, parashtruesi i kërkesës nënshkroi kontratë të punës me KEK-un.

11. Më 28 tetor 2008, KEK-u e njoftoi parashtruesin e kërkesës për ndërprerjen e kontratës së punës.

12. Më 15 dhjetor 2008, KEK-u paraqiti kallëzim penal (Nr. 2008MA25/2) kundër parashtruesit të kërkesës për kryerjen e veprës penale të pretenduar të vjedhjes.

13. Më 3 shtator 2009, Prokurori publik komunal (PP. Nr. 22/09) hodhi poshtë kallëzimin penal të KEK-ut kundër parashtruesit të kërkesës dhe konstatoi se: *"duke marrë parasysh gjendjen e konstatuar nga sektori i kalibrimit konsideroj se me asnjë provë*

nuk është vërtetuar dyshimi i arsyeshëm se i pandehuri ka kryer veprën penale që i vehej në barrë me kallëzimin penal dhe për këto arsye hudhet kallëzimi penal".

14. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Komunale në Ferizaj anulimin e ndërprerjes së kontratës së tij të punës, kthimin në vendin e tij të punës dhe kompensimin e të ardhurave, që dalin nga kontrata e tij e punës. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se *"njoftimi për shkëputjen e kontratës së punës është marrur duke u bazuar në nenin 11.3 pika b të ligjit themelor të punës dhe në nenin 8. 13 te rregullores së punës se KEK-ut që përfshinë vjedhje të ndonjë prone të KEK-ut -vjedhjes së energjisë elektrike, ndërsa nga vet ekspertiza e njësorit elektrik-qendrës së kalibrimit është konstatuar, se nuk ka asnjë parregullsi në brendi të këtij njësori, duke shtuar se vetëm njësori është i dëmtuar, numëruesi nuk është manipuluar (...) andaj duke u bazuar në faktin, se arsye e vetme për shkëputjen e marrëdhënies së punës ka qenë vjedhja e energjisë elektrike, ky konstatim është vërtetuar se është i pabazë nga qendra e kalibrimit të paditurit".*

15. Më 29 janar 2008, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 396/08) e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit.

16. Gjykata Komunale konstatoi:

> *"E paditura i ka përfillur dispozitat ligjore-procedurale me rastin e njoftimit të paditësit për shkëputjen e kontratës së punës" dhe "[...] edhe pse paditësi thirret në njoftimin e Prokurorisë Publike Komunale në Ferizaj, PP. nr. 22/09, të datës 03.09.2009, në bazë të cilit është hedhur kallëzimi penal ndaj paditësit Izjadin Shehu për veprën penale vjedhje (...), në aspektin civil ekziston përgjegjësia e paditësit [...].*
>
> *[...] andaj, duke marrë parasysh faktin se paditësi është kyçur me njësorin e ri në mënyrë të pa autorizuar edhe shpenzimin e energjisë e ka bërë në mënyrë të pa autorizuar që paraqet shfrytëzim i pa autorizuar i pasurisë së punëdhënësit, andaj paraqet sjellje të natyrës tepër të rendë pas së cilës do të ishte e pa arsyeshme të pritet vazhdimi i kontratës së punës (neni 11.3 pika (d) të Rreg. UNMIK-ut 2001/27), andaj gjykata konsideron si të ligjshëm njoftimin për shkëputjen e kontratës së punës nr. 949 dt. 28.10.2008, (...), si dhe vendimin nr. 7302 dt. 10.11.2008, lëshuar nga e paditura të dhënë pas ankesës të ushtruar nga paditësi".*

17. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, për shkak të shkeljeve substanciale të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të situatës faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

18. Më 6 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut (Aktvendimi Ac. nr. 558/2011) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

19. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

20. Më 20 shtator 2013, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 93/2013) vendosi *"ta refuzojë revizionin e paditësit (...) si të pabazuar"*.

21. Në arsyetimin e saj, Gjykata Supreme gjeti se *"[...] të dy gjykatat e instancave më të ulëta kanë vërtetuar drejt gjendjen faktike, kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore, të cilave u referohet paditësi, dhe të drejtën materiale, duke konstatuar se (...) kërkesëpadia është e pabazuar. Të dy aktgjykimet e goditura përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Supreme *"[...] e ka vënë në pozitë të pabarabartë vis-a-vis ndaj koleges i cili ka qenë në situatë të njëjtë, pasiqë për të njëjtën është i njëjti kolegj ka vendosur ndryshe, ashtu që parashtruesi i kërkesës ka rënë viktimë e padrejtësisë, e ky fakt vërtetohet me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 246/2013 datës 01.10.2013, me të cilin aktgjykim për të njëjtën çështje është PRANUAR revizioni ndërsa parashtruesit të kësaj kërkese i është refuzuar revizioni"*.

23. Prandaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se, Gjykata Supreme, duke refuzuar kërkesën e tij për revizion dhe *"(...) duke vendosur tërësisht ndryshe për çështje të njëjta, janë bërë shkelje të nenit 3.2 [Barazia para Ligjit], dhe 24.1 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës si dhe*

neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [në tekstin e mëtejmë: KEDNJ]".

24. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu vëren se, edhe pse ai kishte ngritur të njëjtin pretendim, *"Gjykata Supreme për të njëjtën çështje (...) ka theksuar se është shkelur ligji në dëm të paditësit edhe sa i përket aplikimit të procedurave disiplinore (...), e cila rrethanë nuk është marrë parasysh nga Gjykata Supreme kur ka vendosur për revizionin e Izjadin Shehut".*

25. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që *"të shpallë të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe ta kthejë atë në rivendosje".*

Pranueshmëria e kërkesës

26. Para së gjithash, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmërinë e kërkesës.

27. Në këtë drejtim, neni 113 i Kushtetutës parasheh:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

28. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh se *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".*

29. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës për t'i mbrojtur të drejtat e tij i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë dhe në fund, Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit i ishte dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme më 11 tetor 2013 dhe ai e ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë më 16 dhjetor 2013.

30. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion

me ligjin e aplikueshëm dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit prej 4 (katër) muajve.

31. Sidoqoftë, Gjykata gjithashtu duhet të merr parasysh nenin 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës.

Neni 48. i Ligjit

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

Rregulli 36 i Rregullores së punës

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

32. Parashtruesi i kërkesës, siç u tha më lart, ka kontestuar në Gjykatën Supreme Aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës së Qarkut, për shkak të shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

33. Ndërkohë, parashtruesi i kërkesës pretendon në Gjykatën Kushtetuese shkeljen "*e barazisë para ligjit (nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës), e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së)".*

34. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur parimin e barazisë para ligjit dhe të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm duke mos aprovuar kërkesën e tij për revizion ashtu siç bëri në rastin e fundit të kolegut të tij (Aktgjykimi Rev. nr. 246/2013, i 1 tetorit 2013).

Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjendja e tij është identike me atë të kolegut të tij.

35. Në mbështetje të pretendimit të tij, parashtruesi i kërkesës thekson se aktgjykimi i Gjykatës Supreme, i nxjerrë për çështjen e tij ndryshon nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, në një rast të mëvonshëm (Aktgjykimi Rev. nr. 246/2013, i 1 tetorit 2013) dhe argumenton se *"Po ashtu lidhur me (pa)barazinë para ligjit dhe kontradiktoritetin e gjykatave me rastin e vendosjes për të njëjtat çështje, (...) shpallë të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe lënda është kthyer në rivendosje"*. [Parashtruesi i kërkesës i referohet rastit KI120/10 të Gjykatës Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri, i 8 marsit 2013].

36. Megjithatë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme (në Aktgjykimin e kontestuar Rev. nr. 93/2013), kur ka refuzuar revizionin si të pabazuar, konstatoi se:

> *"Nga shkresat e lëndës rezulton gjithashtu se e paditura ka zhvilluar kundër paditësit një procedurë disiplinore të plotë dhe të mbështetur në ligj.*
>
> *[...]*
>
> *Në mbështetje të gjendjes së mësipërme, Gjykata Supreme i pranoi në tërësi pikëpamjet juridike të gjykatave të instancës më të ulët, aktgjykimet e të cilave nuk përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore (...) ndërsa e drejta materiale është zbatuar drejt.*
>
> *[...]*
>
> *E paditura KEK -Distrikti në Ferizaj, ka zbatuar në mënyre të plotë dhe në bazë të ligjit procedurën disiplinore ndaj paditësit, në përputhje me dispozitat e procedurës disiplinore të parashikuara me Rregulloren e punës"*.

37. Gjykata vëren më tej se Gjykata Supreme (në Aktgjykimin 246/2013) e aprovoi revizionin e kolegut të parashtruesit të kërkesës si pjesërisht të bazuar, sepse *"(...) për këto shkelje të detyrave të punës për të cilën paditësi është shpallur fajtor nuk është zhvilluar procedura disiplinore"*.

38. Në të vërtetë, Gjykata Supreme vendosi ndryshe në të dy rastet, sepse në një rast (Aktgjykimi Rev. nr. 93/2013) është respektuar

procedura disiplinore për ndërprerjen e kontratës, përderisa në rastin tjetër (Aktgjykimi Rev. nr. 246/2013) nuk është zhvilluar procedura disiplinore.

39. Parashtruesi i kërkesës i referohet rastit KI120/10 - Zyma Berisha, të Gjykatës Kushtetuese, me sa duket me qëllim që Gjykata ta deklarojë rastin e tij të pranueshëm dhe ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (Rev. nr. 93/2013), ashtu siç e bëri këtë në rastin KI120/10 të Gjykatës Kushtetuese.

40. Gjykata përkujton se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në rastin KI120/10 ishte shpallur i pavlefshëm sepse *"[...] Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë të dukshme arbitrare në rastin e parashtruesit të kërkesës, në kundërshtim me parimet e shtjelluara nga GJEDNJ-ja (...) në aktgjykimin rastin Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë [DHM], nr. 13279/05, 20 tetor 2011"*. Gjykata konstatoi se: *"aktgjykimi i Gjykatës Supreme, duke neglizhuar vlerësimin e duhur të argumenteve të parashtruesit të kërkesës përkitazi me statusin e përhershëm të punësimit, edhe pse ato ishin specifike, relevante dhe të rëndësishme, nuk i plotësoi detyrimet e Gjykatës Supreme sipas nenit 6.1 të KEDNJ-së për të plotësuar detyrimet e cekjes së arsyeve* (shih, *mutatis mutandis,* GJEDNJ, Aktgjykimi i 18 korrikut 2006, në rastin *Pronina kundër Ukrainës,* Kërkesa nr. 63566/00; shih, gjithashtu, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI40/09, *Imer Ibrahimi dhe 48 punonjës të tjerë të KEK-ut,* gjegjësisht "Aktgjykimi i KEK-ut I".

41. Sidoqoftë, bazuar në dokumentet e dorëzuara dhe procedurat e përfunduara, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme nuk ka vepruar në mënyrë arbitrare në rastin e parashtruesit të kërkesës dhe ka ofruar vlerësim të drejtë të argumenteve të tij.

42. Për më tepër, në rastin KI120/10, Gjykata vëren se të shtatë rastet ishin identike, përderisa Gjykata nuk është e bindur se të dy rastet e kësaj kërkese janë identike, sepse faktet e këtyre rasteve janë të ndryshme, siç ishte vërejtur nga Gjykata Supreme.

43. Për më tepër, Gjykata përkujton parimet e përgjithshme që vlejnë për rastet e vendimeve kundërthënëse të gjykatave supreme vendore në situatat dukshëm të ngjashme. Në rastin e *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, nr. 13279/05 të 20 tetorit 2011, Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së ka theksuar, *inter alia*:

> *"50. […] përveç në rast të arbitraritetit të dukshëm, nuk është roli* i *Gjykatës që të vërë në pikëpyetje interpretimin e të drejtës vendore nga gjykatat shtetërore* (shih, *mutatis mutandis, Adamsons kundër Letonisë,* nr. 3669/03, para. 118, 10 maj 2007). *Ngjashëm, në këtë kuptim, parimisht nuk është funksioni i saj që të krahasojë vendimet e ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse janë nxjerrë në procedura dukshëm të ngjashme; gjykata duhet të respektojë pavarësinë e atyre gjykatave* (shih *Engel dhe të tjerët kundër Holandës,* 8 qershor 1976, para. 103, Seria A nr. 22; *Gregorio de Andrade kundër Portugalisë,* nr. 41537/02, para. 36, 14 nëntor 2006;".

44. Përveç kësaj, Gjykata përkujton se parimi kyç që duhet zbatuar në rastet e dallimeve të vendimeve të Gjykatës Supreme në rastet apo rrethanat dukshëm të ngjashme konsiston në përcaktimin nëse ekzistojnë "*dallime të thella dhe të kahershme"* në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme (shih *Nejdat Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, Nr. 13279/05, para. 53).

45. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, vendimi i Gjykatës Supreme në bazë të revizionit krahasohet me vetëm një vendim të Gjykatës Supreme, që ishte nxjerrë 10 (dhjetë) ditë më vonë. Është e vështirë të kuptohet se si, në bazë të vetëm një vendimi të vetëm të Gjykatës Supreme, mund të konkludohet që ka "*dallime të thella dhe të kahershme"* në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, të cilat cenojnë parimin e sigurisë juridike dhe si pasojë, cenojnë të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të mishëruara në Kushtetutë dhe në KEDNJ.

46. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme i ishte përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljet substanciale të procedurës kontestimore dhe zbatimit të së drejtës materiale, duke konstatuar që *"[…] të dy gjykatat e instancave më të ulëta kanë vërtetuar drejt gjendjen faktike, kanë zbatuar drejt të drejtën materiale, duke konstatuar së kërkesëpadia e tij është e pabazuar".*

47. Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë me aktgjykimin e Gjykatës Supreme në përgjigjen ndaj pretendimeve të bëra nga parashtruesi i kërkesës është i qartë, i argumentuar dhe i drejtë.

48. Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i këtyre të fundit që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale

(shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28, shih edhe Aktvendimi për papranueshmëri në rastin nr. 70/11, *parashtruesit e kërkesës Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

49. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të trajtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, 10 korrik 1991).

50. Gjykata konsideron se procedurat para gjykatave të rregullta, duke përfshirë ato para Gjykatës Supreme, kanë qenë të drejta dhe të argumentuara (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

51. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih*, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë,* Vendimi i GJEDNJ-së, nr. 53363/99, i 31 majit 2005) dhe nuk qartësoi se si nenet e referuara të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së e mbështesin pretendimin e tij, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 48. të Ligjit.

52. Si përmbledhje, pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive të tij nuk janë të mbështetura dhe të dëshmuara dhe prandaj janë qartazi të pabazuara.

53. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konsideron se në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe (2) b), kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit, rregullat 36 (1) c), 36 (2) b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 30 qershor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigue

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI99/14 dhe KI100/14, Shyqyri Syla and Laura Pula, Aktgjykim i datës 3 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetuetshmërisë së Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e përzgjedhjes për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit.

Rastet e bashkuara, KI99/14 dhe KI100/14, vendimi i 3 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesa individuale, kërkesë për masë të përkohshme, shterimi i mjeteve juridike, mosdiskriminim, e drejta për një gjykim të drejtë.

Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, përkatësisht te Vendimit te Këshillit Prokurorial të Kosovës për emërimin dhe propozimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit KPK nr. 151/2014, të 6 qershorit 2014, z. Shyqyri Syla, dhe Vendimin KPK/146/2014, të 5 qershorit 2014, lidhur me kërkesën e parashtrueses, znj. Laura Pula, për rishqyrtimin e listës përfundimtare të vlerësimit të kandidatit.

Më 27 mars 2014, KPK-ja publikoi shpallje të brendshme për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit. Parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Syla, KI99/14) ishte ndër tre kandidatët e parë, ndërsa parashtruesja e kërkesës (znj. Laura Pula, KII00/14) ishte renditur e pesta dhe, për këtë arsye, nuk i nënshtrohej procedurës së mëtejshme te përzgjedhjes. Më 6 qershor 2014, Paneli i KPK-së, i përbërë nga 7 (shtatë) anëtarë, mbajti procedurën e fshehtë të votimit dhe, me 4 (katër) vota, zgjodhi kandidatin në postin e Kryeprokurorit te Shtetit. Parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Syla, KI99/14) mori 3 (tri) vota dhe, në këtë mënyrë, nuk u zgjodh kandidat për Kryeprokuror të Shtetit. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Këshilli Prokurorial i Kosovës, gjatë procesit të zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, kishte shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht me nenin 3 [Barazia para Ligjit], me nenin 7 [Vlerat] dhe me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Më 4 korrik 2014, Gjykata aprovoi kërkesën e parashtruesve për vendosjen e Masës së përkohshme, duke konsideruar se ekziston rasti *prima facie* dhe se parashtruesi ka paraqitur mjaft argumente bindëse që emërimi i kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit nga Presidenti i

Republikës së Kosovës mund të rezultojë me dëme të pariparueshme për parashtruesin e kërkesës.
Në rastin e parashtruesit të kërkesës (z. Shyqyri Syla, KI 99/14), Gjykata konstatoi se këto rrethana shërbejnë në mënyrë objektive për të arsyetuar frikën e parashtruesit se, KPK-së, gjatë procedurave të votimit për kandidatin për Kryeprokuror të Shtetit, duke përfshirë një anëtar i cili ishte gjithashtu kandidat për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, i kishte munguar shfaqja e paanësisë së nevojshme. Kështu, Gjykata konsideron se anëtari që ishte kandidat për postin e Kryeprokurorit të Shtetit duhej të ishte përjashtuar nga procedurat e votimit dhe të nominimit dhe duhej te ishte zëvendësuar me një anëtar tjetër.

Në rastin e parashtrueses së kërkesës (znj. Laura Pula, KI 100/14), edhe pse ka shfaqje që ngrenë pyetje serioze se parashtruesja mund të ketë qenë e diskriminuar për shkak të gjinisë së saj në procedurën e testimit, Gjykata konstaton se ajo nuk ka dëshmuar që ka qenë e diskriminuar në procedurën e testimit për shkak të gjinisë, domethënë, parimi i lartpërmendur i mosdiskriminimit nuk është shkelur.

Lidhur me të drejtën për procedurë të drejtë, Gjykata konsideron se dështimi i KPK-së në vendimin e tij, KPK nr. 146/2014, të 5 qershorit 2014, që të pranojë rregullat e veta të përcaktuara dhe që të sigurojë një arsyetim të qartë ne lidhje me aspektet thelbësore të argumentit faktit dhe ligjor procedural, është në kundërshtim me të drejtën për një procedurë të drejtë,

Në përfundim, Gjykata vlerëson se procedura e përzgjedhjes dhe e nominimit, e kryer nga KPK-ja, përbënte shkelje të së drejtës për procedurë të drejtë dhe të paanshme, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së. Kështu, Gjykata konsideron se tërë procedura e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit duhet të përsëritet pa paragjykuar rezultatin e asaj procedure te përsëritur.

AKTGJYKIM
në
Rastet Nr. KI99/14 dhe KI100/14
Parashtrues
Shyqyri Syla dhe Laura Pula
Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Shyqyri Syla (KI99/14), Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, dhe znj. Laura Pula (KI100/14), Prokurore në Zyrën e Prokurorit të Shtetit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës). Parashtruesit e kërkesës ishin kandidatë në procedurën e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë procedurën e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit. Parashtruesi z. Shyqyri Syla, KI99/14, konteston Vendimin KPK nr. 151/2014 të Këshillit Prokurorial të Kosovës, të 6 qershorit 2014, për emërimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit. Në anën tjetër, parashtruesja e kërkesës, znj. Laura Pula, KI100/14, konteston Vendimin KPK/146/2014, të 5 qershorit 2014, lidhur me kërkesën e saj për rishqyrtimin e listës përfundimtare me pikët e vlerësimit të kandidatëve, të 31 majit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, përkatësisht të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për emërimin dhe propozimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit (KPK nr. 151/2014, të 6 qershorit 2014), z. Shyqyri Syla, dhe Vendimin KPK/146/2014, të 5 qershorit 2014, lidhur me kërkesën e parashtrueses, znj. Laura Pula, për rishqyrtimin e listës përfundimtare të vlerësimit të kandidatit.

4. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Këshilli Prokurorial i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK), gjatë procesit të zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, kishte shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 24 [Barazia para Ligjit], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

5. Përveç kësaj, parashtruesi z. Shyqyri Syla, kërkesa KI99/14, kërkoi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht të pezullojë procedurën e emërimit të kandidatit të propozuar, në pritje të rezultatit të procedurës në Gjykatë.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56.1 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 12 qershor 2014, parashtruesit e kërkesës i dorëzuan kërkesat e tyre në mënyrë individuale në Gjykatë.

8. Më 13 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës (KI99/14, z. Shyqyri Syla) dorëzoi në Gjykatë kopjen e ankesës së tij, të ushtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative.

9. Më 17 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI99/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari me Vendimin KSH. KI39/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

10. Më 17 qershor 2014, në pajtim me rregullin 37.1 të Rregullores së punës, Kryetari urdhëroi bashkimin e kërkesës KI100/14 me kërkesën KI99/14. Me këtë urdhër, u vendos që gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të mbeten të njëjtë sikur ishte caktuar me vendimet (GJR. KI99/14 dhe KSH. KI99/14) e Kryetarit për caktimin e gjyqtarit raportues dhe të Kolegjit shqyrtues, më 17 qershor 2014.

11. Më 19 qershor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës lidhur me regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi dhe i dërgoi KPK-së kopjet e kërkesave.

12. Më 19 qershor 2014, parashtruesja e kërkesës (KI100/14, znj. Laura Pula) dorëzoi në Gjykatë informata shtesë dhe argumente.

13. Më 24 qershor 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Presidentit të Republikës së Kosovës.

14. Më 24 qershor 2014, KPK-ja dorëzoi në Gjykatë dokumentet lidhur me procesin e përzgjedhjes.

15. Më 26 qershor 2013, gjyqtari Kadri Kryeziu njoftoi me shkrim Gjykatën për mospjesëmarrjen e tij në seancat e këshillimeve për periudhën qershor-korrik 2014, duke pritur vendimin e Gjykatës përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.

16. Më 3 korrik 2014, Gjykata vendosi të miratojë kërkesën për Masë të përkohshme.

17. Të njëjtën ditë, Gjykata mbajti këshillimet dhe votoi për rastin.

Përmbledhja e fakteve

18. Më 27 mars 2014, KPK-ja publikoi shpallje të brendshme për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit.

19. Më 11 prill 2014, KPK-ja nxori Vendimin KPK nr. 90/2014 për caktimin e Panelit të KPK-së për shqyrtimin preliminar. Të njëjtën

ditë, KPK-ja nxori vendimin KPK nr. 91/2014 për caktimin e Komisionit të KPK-së për rikonsiderim.

20. Më 17 prill 2014, Paneli i KPK-së për shqyrtim preliminar, pas shqyrtimit të kërkesave dhe të dokumenteve të dorëzuara nga nëntë (9) kandidatë, vendosi që vetëm gjashtë (6) kandidatë i kishin përmbushur kriteret për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, siç parashihet me ligjin në fuqi.

21. Më 25 prill 2014, Komisioni për rikonsiderim, pas shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga dy (2) kandidatë që nuk ishin përzgjedhur gjatë procesit të shqyrtimit preliminar, vendosi t'i miratojë kërkesat e tyre dhe të shpallë listën prej tetë (8) kandidatëve të kualifikueshëm për procedurat e mëtejshme të përzgjedhjes.

22. Nga 29 deri më 31 maj 2014, u mbajt procesi i intervistimit të këtyre tetë (8) kandidatëve.

23. Më 31 maj 2014, KPK-ja publikoi listën me rezultatet përfundimtare të vlerësimit për secilin kandidat. Në pajtim me dispozitat e Rregullores për kriteret dhe për procedurën e nominimit dhe të propozimit për emërim të Kryeprokurorit të Shtetit (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja), tre kandidatët më të suksesshëm ishin kualifikuar për procedurën e votimit të fshehtë.

24. Parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Syla, KI99/14) ishte ndër tre kandidatët e parë, ndërsa parashtruesja e kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14) ishte renditur e pesta dhe, për këtë arsye, nuk i nënshtrohej procedurës së mëtejshme të përzgjedhjes.

25. Parashtruesja e kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14) paraqiti kërkesë për rishqyrtim në KPK.

26. Në kërkesën e saj për rishqyrtim, parashtruesja e kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14), pretendonte se janë shkelur procedurat në aspektin e dhënies së pikëve të kandidatëve. Parashtruesja e kërkesës ka theksuar se, për konceptdokumentin e dorëzuar, njëri prej anëtarëve i kishte dhënë pesë (5) pikë, ndërsa, duke iu referuar tabelës së pikëve të vlerësimit, e cila është pjesë përbërëse e Rregullores, kërkohej të jepeshin jo më pak se dhjetë (10) pikë.

27. Më 5 qershor 2014, KPK-ja me vendimin KPK/146/2014, e refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga parashtruesja e kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14).

28. KPK-ja, në vendimin e tij për refuzimin e kërkesës së parashtrueses për rishqyrtim, kishte konstatuar si në vijim:

> *"KPK konstatoi se tabela në faqen 30 të Rregullores edhe pse është pjesë integrale e Rregullores e njëjta ka shërbyer vetëm si tabelë orientuese gjatë vlerësimit dhe jo kornizë determinuese për caktimin e mënyrës së poentimit nga secili anëtar i KPK-së".*

29. Më 6 qershor 2014, Paneli i KPK-së, i përbërë nga 7 (shtatë) anëtarë, mbajti procedurën e fshehtë të votimit dhe, me 4 (katër) vota, zgjodhi kandidatin në postin e Kryeprokurorit të Shtetit. Parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Syla, KI99/14) mori 3 (tri) vota dhe, në këtë mënyrë, nuk u zgjodh kandidat për Kryeprokuror të Shtetit.

30. Një nga 7 (shtatë) anëtarët e KPK-së, që votuan për kandidatin për Kryeprokuror të Shtetit, ishte gjithashtu një kandidat në procedurën e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit. Ky anëtar është zgjedhur si një kandidat në listën përfundimtare prej tetë (8) kandidatëve, të 25 prillit 2014, por nuk ishte zgjedhur si kandidat në listën përfundimtare prej 3 (tre) kandidatëve të renditur në pozitën më të lartë të 31 majit 2014, që i ishin nënshtruar votimit të fshehtë nga ana e Panelit të KPK-së. Bazuar në dosjen e procedurës përzgjedhëse, të paraqitur nga KPK-ja, duket se ky kandidat, i cili është anëtar i KPK-së, nuk ishte anëtar i Panelit për shqyrtimin preliminar të KPK-së dhe të Komisionit për rikonsiderim të KPK-së.

31. Të njëjtën ditë, KPK-ja nxori vendimin KPK nr. 151/2014 për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit.

32. Më 12 qershor 2014, KPK-ja i dërgoi Presidentit të Republikës së Kosovës propozimin për emërimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit.

33. Më 13 qershor 2014, kundër vendimit KPK nr. 151/2014 për nominimin dhe për propozimin e kandidatit në postin e Kryeprokurorit të Shtetit, të 6 qershorit 2014, parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Syla, KI99/14) paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative.

34. Deri më sot, Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk nxori ndonjë dekret për emërimin e kandidatit të propozuar të KPK-së për postin e Kryeprokurorit të Shtetit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

35. Siç u tha më lart, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Këshilli Prokurorial i Kosovës, gjatë procesit të zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, kishte shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 3 [Barazia para Ligjit], me nenin 7 [Vlerat] dhe me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

1. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës (z. Shyqyri Syla, KI99/14)

36. Parashtruesi i kërkesës pretendon si në vijim:

> *"Më 06.06.2014, është mbajtur mbledhja e Këshillit Prokurorial të Kosovës,ku është votuar për kandidatin për Kryeprokuror të Shtetit. Në këtë mbledhje ka marrë pjesë dhe votuar edhe kandidati [...] për Kryeprokuror të Shtetit, por nuk ka hyrë në garë në treshen e parë.*
>
> *Konsideroj se votimi i këtij kandidati ka pasur konfikt interesi, pastaj ka pasur arbitraritet, meqenëse nuk ka marrë pjesë në vlerësimin e dokumentacionit të kandidatëve, e as në intervistimin e tyre, dhe pa pasur njohuri fare, vetëm ka hudhur votën e tij, duke vënë kandidatët në pozitë të pabarabartë".*

37. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

> *"Anulimin e procesit zgjedhor dhe aplikimin e masës së përkohshme për ndalimin e dekretimit".*

2. Pretendimet e parashtrueses së kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14)

38. Parashtruesja e kërkesës pretendon se KPK-ja nuk ka vepruar në pajtim me Rregulloren për kriteret dhe për procedurat për propozimin dhe emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

39. Në këtë drejtim, ajo konstaton si në vijim: "*Prandaj këtu shtrohet pyetja e parimit së sigurisë juridike sepse kandidatët nuk kanë pritur që poentimi mund të ndryshojë prej asaj çka është përcaktuar me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e nominimit dhe propozimit për emërim te Kryeprokurorit te shtetit*".

40. Lidhur me pretendimet e saj për shkeljen e të drejtave të saj kushtetuese, të garantuara me nenet 3, 7 dhe 24 të Kushtetutës, parashtruesja gjithashtu i referohet dispozitave të Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe thekson si në vijim:

> *"Se nuk është respektuar barazia gjinore konstatohet se ndër të gjithë 8 (tetë) kandidatët për kryeprokuror vetëm unë jam kandidate femër. Sipas konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, parashihet se diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor pengon pjesëmarrjen e grave në të njëjtat kushte me burrat në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, pengon ngritjen e mirëqenies së shoqërisë dhe të familjes dhe vështirëson më tepër zhvillimin e potencialeve të grave në shërbimin te atdheut të tyre dhe njerëzimit.*
>
> *Sipas nenit 2 pika "q' të kësaj konvente thuhet se: dënohet diskriminimi ndaj grave në të gjitha format dhe se shtetet nuk duhet të ndërmarrin asnjë veprim ose praktikë diskriminuese ndaj grave dhe të sigurojnë që autoritet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me këtë detyrim.*
>
> *Bazuar në këtë konsiderojmë se është shkelur edhe neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës-Deklarata universale për të drejtat e njeriut pika 6-konkretisht konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas".*

41. Sa i përket shterimit të mjeteve juridike, parashtruesja e kërkesës pretendon si në vijim:

> *"Për më tepër ligji për KPK-në nuk parasheh ndonjë dispozitë ligjore lidhur me ankesat kundër vendimit të KPK-së. Duhet theksuar se mungesa e mjetit juridik për të apeluar vendimet e KPK -së në shkallë të dytë është konstatuar edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë në Kosovë, dhe krijimi i mundësisë së apelimit është edhe rekomandim i Komisionit të*

Venecias për Kosovën, të cilët kanë sugjeruar që një gjë e tillë të përfshihet gjatë plotësimit dhe ndryshimit të ligjit për KPK-në dhe KGJK-në".

Dispozitat ligjore relevante lidhur me emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit

I. Neni 109 [Prokurori i Shtetit], paragrafi 7 i Kushtetutës

*Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçarë, pa mundësi riemërimi***.**

II. Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës Nr. 03/l-224

Neni 5 [Përbërja dhe Përzgjedhja e Anëtarëve të Këshillit]

1. Këshilli përbëhet nga nëntë (9) anëtarë të cilët janë shtetas të Republikës së Kosovës, pesë (5) nga të cilët janë prokurorë.

2. Nga pesë (5) prokurorët që shërbejnë si anëtarë të Këshillit përfshihen:

2.1. Kryeprokurori i Shtetit;

2.2. një (1) prokuror nga Prokuroria Speciale që zgjidhet nga prokurorët që shërbejnë në atë zyrë;

2.3. një (1) prokuror nga Prokuroria e Apelit që zgjidhet nga prokurorët që shërbejnë në atë zyrë, dhe

2.4. dy (2) prokurorë nga Prokuroria Themelore që zgjidhen nga prokurorët që shërbejnë në atë zyrë.

3. Anëtarët jo-prokurorë të Këshillit emërohen nga Këshilli bazuar në një listë prej së paku pesë (5) kandidatësh për secilën pozitë të dërguar nga organet relevante dhe kjo përfshin:

3.1. një (1) anëtar nga Oda e Avokatëve të Kosovës i cili ka specializuar në të drejtën penale, me anë të propozimit të Këshillit Ekzekutiv të Odës së Avokatëve;

3.2. një (1) profesor nga fakultetet juridike të Republikës së Kosovës sipas propozimit të Departamentit për Arsim të Lartë apo të autoritetit relevant që lidhet me arsimin e lartë;

3.3. një (1) përfaqësues nga shoqëria civile me përgatitje të lartë profesionale dhe me njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut.

[...]

Neni 20 [Emërimi i Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve]

1. Këshilli bën nominimin e Kryeprokurorit të Shtetit nga radhët e Prokurorëve dhe ai emërohet nga Presidenti për një mandat shtatë (7) vjeçare, pa mundësi riemërimi.

2. Këshilli emëron Kryeprokurorët për të gjitha njësitë e tjera të Prokurorit të Shtetit. Çdo prokuror i cili është subjekt i kualifikimeve të përcaktuara me Ligjin mbi Prokurorët e Shtetit ka të drejtë të propozohet për postin e Kryeprokurorit.

3. Kryeprokurori emërohet nga Këshilli për një periudhë katër (4) vjeçare, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat shtesë.

4. Në mënyrë që të sigurohet se Prokurori i Shtetit pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës, Këshilli përpiqet të sigurojë që anëtarët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë të emërohen në role menaxhuese.

5. Nëse një kandidat i propozuar për Kryeprokuror është anëtar i Këshillit, ai apo ajo nuk mund të merr pjesë në shqyrtime apo votimin për emërimin e Kryeprokurorit.

6. Këshilli autorizohet të largojë një Kryeprokuror nga ajo pozitë, në pajtim me vlerësimet e performansës të ndërmarra në përputhje me ligjin e zbatueshëm, ose me rastin e konstatimit të sjelljes kriminale, keq-menaxhimit, jo-kompetencës, apo dështimit në kryerjen e detyrave të pozitës.

[...]

III. Rregullorja për kriteret dhe për procedurën e nominimit dhe të propozimit për emërim të Kryeprokurorit të Shtetit

Neni 9 [Paneli i KPK-së për Shqyrtimin Preliminar]

1. KPK-ja do të themelojë Panelin për Shqyrtimin Preliminar të aplikacioneve për Kryeprokuror të shtetit, në këtë përbërje:

1.1 Një anëtar i KPK-së; kryetar;

1.2 Një prokuror nga Prokuroria e Apelit, i cili nuk ka aplikuar për KPSH; dhe

1.3 Një prokuror nga PSRK-ja, i cili nuk ka aplikuar për KPSH.

2. Paneli ka kompetencë dhe përgjegjësi vetëm për shqyrtimin e aplikacioneve për KPSH, nëse të njëjtat plotësojnë kriteret e parapara me nenin 3 paragrafi 1,2,3 dhe 4 dhe neni 4 të kësaj rregulloreje.

3. Paneli brenda 7 ditëve shqyrton aplikacionet dhe përpilon listën e kandidatëve të cilët plotësojnë kriteret për KPSH.

4. Kandidatët të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret për KPSH do të njoftohen me shkrim. Njoftimi duhet të përfshijë edhe informatën për të drejtën e kandidatit për të parashtruar kërkesë për ri-konsiderim tek Komisioni për ri-konsiderim në afat prej 5 ditëve nga dita e pranimit të njoftimit.

5. Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret për KPSH do të njoftohen me shkrim.

6. Njoftimi i lidhur me paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni do të publikohet në dy gjuhët zyrtare n ueb faqen e PSH-së dhe KPK-së. Kandidatët do të njoftohen përmes email-it zyrtar dhe mesazhit telefonik. Konfirmimi për pranimin e njoftimit është i obligueshëm nga të gjithë kandidatët për KPSH.

Neni 10 [Komisioni për ri-konsiderim]

1. KPK-ja themelon Komisionin për ri-konsiderim, me kompetencë dhe përgjegjësi për shqyrtimin e kërkesave për ri-konsiderim ndaj vendimeve të panelit të KPK-së për shqyrtim preliminar të aplikacioneve të kandidatëve për KPSH.

2. Komisioni për ri-konsiderim është në këtë përbërje:

2.1 Kryeprokurori i Shtetit, kryetar;

2.2 Një prokuror nga PA i cili nuk ka aplikuar për KPSH; dhe
2.3 Një prokuror nga PSRK i cili nuk ka aplikuar për KPSH.
3. Komisioni brenda 5 ditëve nga dita e skadimit të afatit për pranim të kërkesave për ri-konsiderim do të marrë vendim për çdo kërkesë të pranuar.

4. Lidhur me vendimin e Komisionit, do të informohen kandidatët të cilët kanë paraqitur kërkesë për ri-konsiderim, si dhe anëtarët e KPK-së.

5. Vendimet e Komisionit publikohen në ueb faqe të KPK-së dhe PSH-së.më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit.

Neni 12 [Komisioni për vlerësim, intervistim dhe votim]

1. Anëtarët e KPK-së, të cilët nuk përjashtohen sipas paragrafit 5 të nenit 20 të ligjit për KPK-në, e përbëjnë komisionin për vlerësim, intervistim dhe votim për KPSH..

Neni 13 [Vlerësimi i kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit]

1. Vlerësimi i kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit do të përfshijë: Integritetin personal, profesional dhe moral, i cili bazohet në:

1.1 Vlerësimin e performancës për tri vitet e fundit;
1.2 Informatat e pranuara nga AKK,
1.3 Informatat e pranuara nga NJIF;
1.4 Informatat e pranuara nga AKI;
1.5. Të dhënat lidhur me masat eventuale disiplinore ndaj kandidatëve dhe informacionet nga ZPD-ja nëse ndaj ndonjë kandidati janë duke u zhvilluar hetime disiplinore.

1. Obligohet Kryeprokurori i shtetit që të kërkoj informatat nga paragrafi 1, pikat 1.2; 1.3; 1.4 dhe 1.5 të këtij neni, për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për KPSH. Këto informata vendosen në dosjen e kandidatit dhe në to kanë qasje anëtarët e KPK-së.

2. Informatat nga paragrafi 1, pika 1.2; 1.3; 1.4 dhe 1.5 të këtij neni, për kandidatët të cilët eliminohen nga Paneli dhe Komisioni për ri-konsiderim i dorëzohen Kryeprokurorit të ardhshëm.

Neni 16 [Poentimi i kandidatëve]

1. Poentimi i kandidatëve bëhet në formulët me numër 2 dhe 3.

2. Çdo anëtar i KPK-së i poenton kandidatët sipas formularëve 2 dhe 3;

3. Poenat e të gjithë anëtarëve të KPK-së mblidhen në një formular të vetëm për çdo kandidat.

4. Pas poentimit të kandidatëve, KPK-ja bën renditjen e kandidatëve sipas poenave të fituara gjatë procesit të vlerësimit dhe intervistimit, duke renditur tre kandidatët më së shumti poena.
5. Çdo anëtar i KPK-së, mund t'a poentojë një kandidat me më së shumti 100 (njëqind) poena, si në vazhdim:

5.1 Për dokumentin e vetë-vlerësimit një kandidat mund të poentohet me më së shumti 20 (njëzet) poena;
5.2 Për koncept dokumentin një kandidat mund të poentohet me më së shumti 30 (tridhjetë) poena;
5.3 Për intervistën me gojë një kandidat mund të poentohet me më së shumti 20 (njëzet) poena;
5.4 Për integritetin një kandidat mund të poentohet me më së shumti 30 (tridhjetë) poena.

6. Tre (3) kandidatët me më së shumti poena, do t'i nënshtrohen procesit të votimit të fshehtë nga anëtarët e KPK-së.

7. Kandidati i cili nuk hynë në listën e tre (3) kandidatëve për votim në KPK, brenda tre (3) ditëve pas njoftimit, mund të kërkoj nga KPK-ja të ri-konsiderojë kërkesën e tij vetëm mbi bazën nëse konsideron se ka pasur shkelje procedurale në zbatimin e kësaj rregulloreje.

8. Njoftimi nga paragrafi 7, i këtij neni bëhet me shkrim dhe i bashkëngjitet një kopje e poentimit të përgjithshëm të kandidatit..

9. Kandidatët të cilët nuk janë renditur ndër tre (3) të parët me më së shumti poena, kanë të drejtë të kenë qasje në dokumentin e vlerësimit të tij për të verifikuar poentimin. Mirëpo, kandidati nuk ka të drejtë qasje në identitetin e anëtarit të KPK-së i cili ka bërë vlerësimin dhe poentimin individual.

10. KPK-ja në afat prej shtatë (7) ditësh pas pranimit të kërkesës së kandidatit për të verifikuar poentimin, do të vendosë nëse kërkesa pranohet apo refuzohet dhe njofton me shkrim kandidatin për marrjen e vendimit.

Neni 17 [Procesi i votimit për kryeprokuror të shtetit]

1. Tre (3) kandidatët e parë, të cilët marrin më së shumti poena, do të hyjnë në procesin e votimit të fshehtë.

2. Votimi i tre (3) kandidatëve të parë të renditur sipas poenave bëhet me vota të fshehta nga anëtarët e KPK-së, duke përjashtuar anëtarin e KPK-së nëse ai është njëri prej tre kandidatëve për të cilin do të votohet.

3. Nëse votimi i fshehtë rezulton me barazim, votimi i fshehtë do të përsëritet vetëm për kandidatët që kanë marrë vota të barabarta, deri në votimin në të cilin një kandidat merr votat e nevojshme për KPSH.

4. Kandidati i cili në votimin e fshehtë fiton më së shumti vota nga anëtarët e KPK-së do të propozohet për emërim për kryeprokuror të shtetit tek Presidenti i Republikës së Kosovës.

5. Propozimi për emërim nënshkruhet nga Kryetari i KPK-së. Propozimi për emërim duhet të jetë i arsyetuar me shkrim, duke përfshirë gjithë procesin e nominimit të kandidatit të propozuar për emërim për Kryeprokuror të shtetit.

6. Propozimi për emërim të kandidatit për KPSH nga KPK-ja, i dërgohet Presidentit të shtetit, jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e marrjes së vendimit..

7. Mbledhja dhe votimi i fshehtë i KPK-së, mbahet i hapur për publikun, por KPK-ja mund të votojë për të mbyllur pjesën e mbledhjes gjatë të cilës diskutohen meritat e kandidatëve për KPSH.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

42. Para së gjithash, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

43. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7, të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

44. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuara, në pajtim me nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

45. Gjykata i referohet edhe neneve 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

> *"48. Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*
>
> *49. Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".*

46. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
> *a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar;*
> *b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; ose*

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".

47. Siç u theksua më lart, parashtruesit e kërkesës e kontestojnë procedurën e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit. Në këtë drejtim, parashtruesja e kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14) në mënyrë specifike e konteston Vendimin KPK nr. 146/2014 të Komisionit të KPK-së për rikonsiderim (KPK nr. 146/2014, e 5 qershorit 2014), ndërsa parashtruesi (z. Shyqyri Syla, KI99/14) e konteston Vendimin e KPK-së, KPK nr. 151/2014, e 6 qershorit 2014, për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit.

48. Gjykata vëren se dispozitat e ligjit në fuqi, Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nuk parashikojnë asnjë mjet juridik kundër vendimeve të kontestuara nga parashtruesit e kërkesës.

49. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë të obliguar t'i shterin " *[...] mjetet juridike që janë të qasshme, për të siguruar kompensim lidhur me ankesat e tyre dhe që ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses. Baza e mjetit juridik në të drejtën vendore duhet të jetë e qartë"* (Shih rastin *Scavuzzo-Hager dhe të tjerët kundër Zvicrës*, Kërkesa nr. 41773/98, GJEDNJ, 7 shkurt 2006).

50. Megjithatë, Gjykata vëren se, edhe në qoftë se ka mjete juridike, në rastin e parashtruesit nuk janë dëshmuar si efikase. Për më tepër, duke marrë parasysh specificitetin e procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe domosdoshmërinë që kjo të bëhet në kohën e duhur, Gjykata është e mendimit që nuk ka mjete juridike për shterim.

51. Në këtë drejtim, duke iu referuar rasteve të gjykuara nga Gjykata në lidhje me procedurën e emërimit dhe të riemërimit të prokurorëve, në mënyrë të veçantë duke iu referuar rastit nr. KI114/10 *Vahide Badivuku*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, *i 8 majit 2011,* Gjykata konsideron se, në bazë të rrethanave të çështjes dhe të procedurave të përfunduara, kjo kërkesë ndryshon nga rasti i lartpërmendur për arsyet vijuese:

52. Së pari, para hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatat, Nr. 03/L-199, procedura për konflikte administrative kundër akteve administrative përfundimtare është iniciuar në Gjykatën Supreme. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të lartpërmendur për Gjykatat (1 janar 2013), procedura e konfliktit administrativ rregullohet si më poshtë:

Neni 14 [Departamenti për çështje Administrative i Gjykatës Themelore]

"1. Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj.
2. Të gjitha çështjet në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj nuk parashihet ndryshe".

53. Së dyti, Gjykata vëren se ekziston vetëm një pozitë për Kryeprokuror të Shtetit, si, për shembull, në krahasim me pozitat e shumta për emërimin dhe për riemërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Kështu, Gjykata është e vetëdijshme se ka pranuar disa aplikacione prej gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët nuk janë riemëruar. Rasti i tanishëm, megjithatë, është faktikisht ndryshe. Së pari, për shkak se në ato raste të tjera ka pasur pozita të shumta dhe gjykatat e rregullta mund të kenë korrigjuar aplikacionet, në qoftë se shkelja është dëshmuar muaj më vonë. Së dyti, në rastin konkret, nuk duket se ka kohë të mjaftueshme për ndonjë gjykatë tjetër ta adresojë këtë mjet juridik para emërimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

54. Gjykata kështu konstaton se parashtruesit nuk kanë në dispozicion mjete juridike për të shteruar para se të vazhdojnë me pretendimet e tyre për shkelje kushtetuese.

55. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu konstaton se parashtruesit kishin dorëzuar kërkesat e tyre në Gjykatë brenda afatit kohor prej 4 (katër) muajsh.

56. Më tej, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë treguar se cilat të drejta kushtetuese u janë shkelur dhe ata i kontestojnë vendimet konkrete (KPK nr. 146/2014, të 5 qershorit 2014, dhe KPK nr. 151/2014, të 6 qershorit 2014).

57. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesat janë të pranueshme.

Meritat e rastit

58. Parashtruesit e kërkesës kryesisht pretendojnë se vendimet e kontestuara, të nxjerra gjatë procedurës së zgjedhjes për postin e

Kryeprokurorit të Shtetit, kishin shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], me nenin 7 [Vlerat] dhe me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

59. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet dispozitave të lartpërmendura të Kushtetutës:

Neni 3 [Barazia para Ligjit]

1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 7 [Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.
2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të

femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit

seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

60. Sa i përket të drejtave që kërkohen nga parashtruesit e kërkesës, Gjykata rikujton se *"është mjeshtër i karakterizimit që duhet dhënë në ligj për faktet e rastit dhe nuk është i lidhur me karakterizimin e dhënë nga parashtruesi i kërkesës ose një qeveri. Ankesa karakterizohet nga faktet e pretenduara në të dhe jo thjesht nga bazat ligjore apo argumentet në të cilat mbështetet"*. (Shih *mutatis mutandis Rasti Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Kërkesa nr. 38155/02, ECHR, Aktgjykimi i 2 nëntorit 2010, par. 23).

61. Prandaj, Gjykata do të analizojë ankesat e parashtruesve bazuar në faktet e pretenduara dhe në provat e bashkangjitura në to, lidhur me pretendimet e tyre të shkeljes së të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

62. Në këtë drejtim, Gjykata do të vlerësojë zbatueshmërinë e kritereve të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, në lidhje me procedurën e zgjedhjes të kryer nga KPK-ja.

63. Neni 31 i Kushtetutës përcakton:

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".

64. Përveç kësaj, nenin 6.1 i KEDNJ-së përcakton:

> *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile".*

65. Gjykata i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

66. Gjykata vëren se, në rastin e parashtrueses së kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14), Vendimi për refuzimin e kërkesës së saj për rikonsiderim (KPK/146/2014, i 5 qershorit 2014) është nxjerrë nga Komisioni për rikonsiderim, i themeluar nga KPK-ja në bazë të dispozitave të mësipërme juridike në fuqi. Vendimi për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit (KPK nr. 151/2014, i 6 qershorit 2014) është nxjerrë nga 7 (shtatë) anëtarë të KPK-së, pas një votimi të fshehtë.

67. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se KPK-ja, si organ i themeluar me Kushtetutë, gjatë procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së.

68. Rrjedhimisht, Gjykata do t'i shqyrtojë meritat e secilit pretendim të parashtruesve të kërkesës.

1. Meritat e rastit të parashtruesit të kërkesës z. Shyqyri Syla, Kërkesa KI99/14

69. Duke iu referuar procedurës së zgjedhjes në rastin e parashtruesit, Gjykata rikujton se parashtruesi ishte ndër tre kandidatët më të suksesshëm, të cilët ishin të kualifikueshëm për të hyrë në procedurë të mëtejshme të përzgjedhjes, përkatësisht në procedurë të votimit të fshehtë të KPK-së.

70. Si pasojë, më 6 qershor 2014, KPK-ja, e përbërë nga 7 (shtatë) anëtarë, zhvilloi procedurën e fshehtë të votimit, me ç'rast kandidati për postin e Kryeprokurorit të Shtetit ishte zgjedhur me 4 (katër) vota nga 7 (shtatë). Parashtruesi i kërkesës kishte marrë 3 (tri) vota dhe, në këtë mënyrë, nuk ishte zgjedhur kandidat për Kryeprokuror të Shtetit.

71. Gjykata më tej përkujton se 1 (një) nga 7 (shtatë) anëtarët e KPK-së, që votuan për kandidatin për Kryeprokuror të Shtetit, ishte gjithashtu kandidat në procedurën e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit. Ky anëtar, si kandidat, është përzgjedhur në listën përfundimtare prej 8 (tetë) kandidatëve të 25 prillit 2014, por nuk ishte përzgjedhur në listën përfundimtare prej 3 (tre) kandidatëve të renditur në pozitën më të lartë, që i ishin nënshtruar votimit të fshehtë nga Paneli i KPK-së.

72. Bazuar në faktet e mësipërme, parashtruesi i kërkesës e konteston Vendimin e KPK-së për emërimin e kandidatit për postin e Kryeprokurorit të Shtetit (KPK nr. 151/2014, e 6 qershorit 2014), dhe pretendon:

> *"Konsideroj se votimi i këtij kandidati ka pasur konfikt interesi, pastaj ka pasur arbitraritet, meqenëse nuk ka marrë pjesë në vlerësimin e dokumentacionit të kandidatëve, e as në intervistimin e tyre, dhe pa pasur njohuri fare, vetëm ka hudhur votën e tij, duke vënë kandidatët në pozitë të pabarabartë".*

73. Gjykata konsideron se KPK-ja, gjatë procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, është dashur të përmbushë parimet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 6 të KEDNJ-së dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë që të sigurojë procedurë të zgjedhjes transparente, të drejtë dhe objektive, të bazuar në barazi.

74. Përkitazi me atë nëse KPK-ja kishte përmbushur garancinë procedurale, duke përfshirë shfaqjen e "paanshmërisë", Gjykata më tutje i referohet praktikës gjyqësore të vendosur të GJEDNJ-së. Në rastin *Wettstein*, KEDNJ-ja konstatoi se ekzistenca e paanshmërisë për qëllimet e nenit 6, paragrafi 1, duhet të përcaktohet në bazë të: *"(i) një testi subjektiv, ku duhet të ketë kujdes për bindjen personale dhe sjelljen e një gjyqtari të caktuar - përkatësisht, nëse gjyqtari kishte ndonjë paragjykim personal ose anshmëri në një çështje të caktuar; dhe (ii) një testi objektiv, që do të thotë duke vërtetuar nëse gjykata vetë dhe, në mesin e aspekteve të tjera, përbërja e tij, ofroi garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në lidhje me paanshmërinë e saj"* (Shih, *mutatis mutandis,* ndër autoritete të tjera, rasti *Wettstein kundër Zvicrës*, Kërkesa Nr. 33958/96, ECHR, par. 42).

75. Në këtë drejtim dhe në mënyrë të veçantë duke iu referuar rëndësisë dhe natyrës së pozitës së Kryeprokurorit të Shtetit, Gjykata vëren se edhe shfaqjet e paanshmërisë mund të jenë të një rëndësie të veçantë (Shih, *mutatis mutandis,* rasti *De Cubber kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 9186/80, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 tetorit 1984, par. 26). Çështje e rëndësishme këtu është besimi, të cilin një autoritet publik, në një shoqëri demokratike, siç është KPK-ja, gjatë procesit të zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, duhet ta bartë në publik, si dhe besimi i publikut në personin e zgjedhur si Kryeprokuror të Shtetit.

76. Sipas mendimit të Gjykatës, këto rrethana shërbejnë në mënyrë objektive për të arsyetuar frikën e parashtruesit se, KPK-së, gjatë procedurave të votimit për kandidatin për Kryeprokuror të Shtetit, duke përfshirë një anëtar i cili ishte gjithashtu kandidat për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, i kishte munguar shfaqja e paanësisë së nevojshme. Kështu, Gjykata konsideron se anëtari që ishte kandidat për postin e Kryeprokurorit të Shtetit duhej të ishte përjashtuar nga procedurat e votimit dhe të nominimit dhe duhej të ishte zëvendësuar me një anëtar tjetër.

77. Në bazë të asaj që u tha më sipër, Gjykata konstaton se, në këtë rast, ka pasur shkelje të së drejtës për procedurë të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së.

78. Për më tepër, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të merret më tej me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 3, 7 dhe 24 të Kushtetutës, posaçërisht pasi ajo ka gjetur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së.

1.Meritat e rastit të parashtrueses znj. Laura Pula, Kërkesa KI100/14

79. Gjykata vëren se, në bazë të listës së 31 majit 2014, me rezultatet përfundimtare të vlerësimit për secilin kandidat të publikuar nga KPK-ja, parashtruesja e kërkesës ishte renditur e pesta dhe për këtë arsye nuk i ishte nënshtruar procedurave të votimit dhe të nominimit. Pas publikimit të kësaj liste, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim në KPK.

80. Në kërkesën e saj për rishqyrtim, parashtruesja pretendonte se njëri nga anëtarët e Panelit i kishte dhënë 5 (pesë) pikë për konceptdokumentin që ajo kishte dorëzuar, ndërsa duke iu referuar

tabelës së pikëve të vlerësimit, e cila është pjesë përbërëse e Rregullores, kërkohej që të jepeshin jo më pak se 10 (dhjetë) pikë.

81. Rrjedhimisht, më 5 qershor 2014, KPK-ja, me vendimin e saj KPK/146/2014, e refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga parashtruesja e kërkesës, duke konstatuar si në vijim:

> *"KPK, konstatoi se tabela në faqen 30 të Rregullores edhe pse është pjesë integrale e Rregullores e njëjta ka shërbyer vetëm si tabelë orientuese gjatë vlerësimit dhe jo kornizë determinuese për caktimin e mënyrës së poentimit nga secili anëtar i KPK-së".*

82. Në këtë drejtim, parashtruesja pretendon si në vijim:

> "*Prandaj këtu shtrohet pyetja e parimit së sigurisë juridike sepse kandidatët nuk kanë pritur që poentimi mund të ndryshojë prej asaj çka është përcaktuar me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e nominimit dhe propozimit për emërim te Kryeprokurorit te shtetit".*

83. Bazuar në këtë, parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e parimit të sigurisë juridike.

84. Gjykata rikujton se ky parim është i mishëruar në mënyrë të qartë me një nga të drejtat themelore të mbuluara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, përkatësisht e drejta për gjykim të drejtë. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parimi i sigurisë juridike është në rrezik në qoftë se detyrimet ligjore nuk respektohen plotësisht. Gjykata rikujton se ky parim gjithashtu duhet të garantohet gjatë procesit të zgjedhjes të zhvilluar nga të gjitha autoritetet publike. Prandaj, KPK-ja, gjatë procesit të përzgjedhjes dhe të emërimit, ishte e nevojshme të mbante të njëjtat standarde për secilin kandidat.

85. Gjykata vëren se KPK-ja ka pranuar që shtojca e lartpërmendur me procedurën e vlerësimit është pjesë përbërëse e Rregullores. Prandaj, Gjykata konsideron se aneksi në mënyrë të qartë përcakton metodën e vlerësimit, duke siguruar pikët minimale dhe maksimale për konceptdokumentet dhe për komponentët e tjerë të vlerësimit gjatë procedurës së zgjedhjes. Prandaj, KPK-ja, duke injoruar rregullat e veta të përcaktuara, krijon një situatë të karakterizuar me supozim të arbitraritetit.

86. Rrjedhimisht, vendimit të lartpërmendur të KPK-së, me të cilin kërkesa e parashtrueses për rishqyrtim refuzohet, i mungon edhe arsyetimi i qartë. E drejta për një vendim të arsyetuar i ka rrënjët në një parim më të përgjithshëm të mishëruar në KEDNJ, që mbron një individ nga arbitrariteti. Në këtë drejtim, *"Vendimi duhet të përmbajë arsyet që janë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur aspekteve thelbësore të argumentit faktik dhe juridik material ose procedural të palës"* (Shih, *mutatis mutandis,* rasti *Torija kundër Spanjës*, Kërkesa nr. 18390/91, GJEDNJ, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, para. 30).

87. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata konstaton se ka shkelje të së drejtës për procedurë të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

88. Përkitazi me pretendimin e parashtrueses për shkeljen e parimit të mosdiskriminimit, Gjykata vëren se, sipas Kushtetutës, një nga vlerat sipas të cilave rendi kushtetues i Republikës së Kosovës është ndërtuar në parimin e mosdiskriminimit. Në këtë drejtim, Republika e Kosovës duhet të *"sigurojë barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat e tjera të jetës shoqërore"*.

89. Gjykata vëren se parimi i lartpërmendur, që është i mishëruar në Kushtetutë, përkatësisht në nenet 3,7 dhe 24, duhet të garantohet përgjatë tërë procedurës së zgjedhjes në institucionet e Republikës së Kosovës.

90. Përkitazi me rastin konkret, parashtruesja (znj. Laura Pula, KI100/14) ishte e vetmja parashtruese femër që dorëzoi "konceptdokumentin", si pjesë e procedurave të testimit dhe të vlerësimit. Në këtë drejtim,parashtruesja pretendon:

> *"Se nuk është respektuar barazia gjinore konstatohet se ndër të gjithë 8 (tetë) kandidatët për kryeprokuror vetëm unë jam kandidate femër. Sipas konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, parashihet se diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor pengon pjesëmarrjen e grave në të njëjtat kushte me burrat në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, pengon ngritjen e mirëqenies së shoqërisë dhe të familjes dhe vështirëson më*

tepër zhvillimin e potencialeve të grave në shërbimin te atdheut të tyre dhe njerëzimit.

Sipas nenit 2 pika "q' të kësaj konvente thuhet se: dënohet diskriminimi ndaj grave në të gjitha format dhe se shtetet nuk duhet të ndërmarrin asnjë veprim ose praktikë diskriminuese ndaj grave dhe të sigurojnë që autoritet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me këtë detyrim.

91. Edhe pse ka shfaqje që ngrenë pyetje serioze se parashtruesja mund të ketë qenë e diskriminuar për shkak të gjinisë së saj në procedurën e testimit, Gjykata konstaton se ajo nuk ka dëshmuar që ka qenë e diskriminuar në procedurën e testimit për shkak të gjinisë. Domethënë, parimi i lartpërmendur i mosdiskriminimit nuk është shkelur.

92. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata konsideron se dështimi i KPK-së në Vendimin e tij, KPK nr. 146/2014, të 5 qershorit 2014, që të pranojë rregullat e veta të përcaktuara dhe që të sigurojë një arsyetim të qartë në lidhje me aspektet thelbësore të argumentit faktit dhe ligjor procedural, është në kundërshtim me të drejtën për një procedurë të drejtë.

93. Në këtë mënyrë, Gjykata konsideron se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe me nenin 24 të Kushtetutës.

Përfundim

94. Në përfundim, Gjykata vlerëson se procedura e përzgjedhjes dhe e nominimit, e kryer nga KPK-ja, përbën shkelje të së drejtës për procedurë të drejtë dhe të paanshme, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së. Kështu, Gjykata konsideron se tërë procedura e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit duhet të përsëritet pa paragjykuar rezultatin e asaj procedure të përsëritur.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 3 korrik 2014, njëzëri,

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesat të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së;

III. TË ANULOJË vendimet e kontestuara KPK nr. 146/2014 dhe KPK nr. 151/2014 të KPK për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit;

IV. TA URDHËROJË KPK-në që ta përsëritë procedurën e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, në pajtim me këtë aktgjykim, pa paragjykuar rezultatin e asaj procedure të përsëritur;

V. TA URDHËROJË KPK-në që, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, të dorëzojë në Gjykatën Kushtetuese informata për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij aktgjykimi;

VI. T'UA KOMUNIKOJË këtë vendim palëve;

VII. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

VIII. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI216/13, Agron Vula, Aktvendim i datës 23 janar 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 22/2011, të 3 qershorit 2013, me kërkesën për masë të përkohshme

Rasti KI216/13, vendimi i 23 janarit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, masë e përkohshme.

Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, por edhe me vendimet gjyqësore të gjykatave të instancës më të ulët, i janë shkelur këto të drejta të njeriut: neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], neni 49 [E Drejta për Punë dhe Ushtrim të Profesionit] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] i Kushtetutës; neni 6 [E Drejta për Proces të Rregullt Gjyqësor] dhe neni 13 [E Drejta për Zgjedhje Efektive] i KEDNJ-së, si dhe [E Drejta e Pronës] e Protokolli 1 të KEDNJ-së.

Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se Gjykata duhet të aplikojë masën e përkohshme të ndalimit të ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. 22/2011, sepse ai është diskriminues dhe antikushtetues.

Parashtruesi nuk ka ofruar argumente mbi natyrën e shkeljes, nuk i ka sqaruar rrethanat në të cilat ajo eventualisht ka ndodhur, nuk ka specifikuar përmasat e shkeljes apo pasojat kushtetuese dhe, në fakt, ai vetëm ka bashkëngjitur me kërkesë vendimet gjyqësore lidhur me rastin dhe ka potencuar se vendimi i KPMK-së, si i tillë çfarë është, është dashur të implementohet, edhe pse ai për këtë çështje ka hapur edhe kontest gjyqësor, që ka përfunduar si i pavaforshëm për parashtruesin.

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe të rregullit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 23 janar 2014, njëzëri deklaron kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar dhe Gjykata nuk gjen arsye ta aplikojë masën e përkohshme dhe si e tillë ajo refuzohet.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI216/13
Parashtrues
Agron Vula
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 22/2011, të 3 qershorit 2013, me kërkesën për masë të përkohshme

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Agron Vula, nga Gjakova, i përfaqësuar nga avokati z. Teki Bokshi, nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 22/2011, i 3 qershorit 2013, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 27 gusht 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin u refuzua si i pabazuar revizioni i parashtruesit të kërkesës dhe me të cilin aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, të cilat e kishin refuzuar padinë e parashtruesit për kompensim të dëmit, çmohen si të bazuara në ligj dhe si të tilla mbesin në fuqi.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës në tetor të vitit 2009, kishte parashtruar kërkesën e parë në Gjykatë me të njëjtat argumente dhe fakte, dhe Gjykata me Aktvendimin KI57/09, të 17 gushtit 2011, këtë kërkesë e kishte shpallur të papranueshme për shkak se ishte e parakohshme duke konstatuar se çështja për të cilën është parashtruar kërkesa ishte akoma në procedurë para gjykatave të rregullta

6. Më 22 nëntor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e dytë në Gjykatë.

7. Më 3 dhjetor 2013, me Vendimin GJR. KI216/13, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Ćukalović.

8. Më 11 dhjetor 2013, Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Supreme dhe Komunën e Gjakovës për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 26 dhjetor 2013, Gjykata ka pranuar përgjigje me shkrim nga Komuna e Gjakovës me të cilën janë bashkëngjitur edhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 151/10, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme për revizion, Rev. 22/2011.

10. Më 8 janar 2014, Gjykata ka pranuar një "sqarim me shkrim" nga parashtruesi, lidhur me kërkesën e tij ku ka përsëritur argumentet tashmë të theksuara në kërkesën e tij duke ia shtuar edhe disa kopje të artikujve të botuara në gazetën "Koha ditore", që kanë të bëjnë me vendimet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me zbatimin e vendimeve të KPMK-së.

11. Më 23 janar 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Sa i përket procedurës kontestimore

12. Parashtruesi i kërkesës, Agron Vula, kishte statusin e shërbyesit civil në Komunën e Gjakovës, dhe mbante pozitën e shefit të preventivës dhe hulumtimit të zjarrit në njësinë profesionale të zjarrfikësve, e cila ishte pjesë e Komunës.

13. Më 19 gusht 2003, me Aktvendimin 12 Nr. 01-139, të nxjerrë nga kryeshefi ekzekutiv i Komunës, ai ishte suspenduar me pagesë nga detyra deri në përfundimin procedurës për konstatimin e përgjegjësisë, apo papërgjegjësisë disiplinore që do të hapej ndaj tij.

14. Sipas shkresave nga lënda, kjo procedurë disiplinore nuk është zhvilluar asnjëherë dhe i pakënaqur me këtë aktvendim, parashtruesi i kërkesës ka filluar procedurën kontestimore në gjykatat e rregullta, e cila ka kaluar nëpër dy faza kyçe.

15. Faza e parë e procedurës kontestimore kishte filluar në Gjykatën Komunale në Gjakovë, dhe ka përfunduar me Aktgjykimin Rev. nr 10/2006, të 25 tetorit 2006, dhe këto vendime gjyqësore parashtruesi i kërkesës nuk i ka bashkëngjitur në kërkesë.

16. Më 7 prill 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë ka nxjerrë Aktvendimin C. nr. 121/09, me të cilin ka lejuar përsëritjen e procedurës të përfunduar në mënyrë të plotfuqishme në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 113/05, të 29 shtatorit 2005.

17. Sipas arsyetimit të këtij aktvendimi, element bazë për lejimin e përsëritjes së procedurës është vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, i cili ka vendosur për të njëjtën çështje juridike dhe ky fakt i ri duhet të merret parasysh.

18. Më 23 shator 2009, Gjykata Komunale në Gjakovë ka nxjerrë Aktgjykimin C. nr. 555/07, me të cilin e ka detyruar Komunën e Gjakovës që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë në emër të kompensimit ½ e të ardhurave personale në shumën që ai i kishte realizuar sa ka qenë në marrëdhënie pune të rregullt te punëdhënësi, për periudhën 1 shtator 2003 deri më 30 tetor 2004, ndërsa shumën e plotë të të ardhurave personale prej 242.66 €, derisa të ekzistojnë kushtet ligjore.

19. Më 22 tetor 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë nxori Aktgjykimin Ac. nr. 151/10, me të cilin ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, C. nr. 555/07, dhe çështjen juridike e gjykoi në atë mënyrë që e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.

20. Më 3 qershor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Rev. nr. 22/2011, me të cilin refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, Ac. nr. 151/2010.

21. Gjykata Supreme e Kosovës, në arsyetimin e Aktgjykimit për revizion, ka theksuar në mes të tjerash se "*Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale,kur është konstatuar se padia e paditësit është e pabazuar,ngase me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës A.02.158/2005, datë 25.02.2008 nuk është vendosur në mënyrë meritore lidhur me çështjen e marrëdhënies së punës së paditësit,nga se çështja i është kthyer të paditurës në vendosje në procedurë administrative*".

Sa i përket procedurës administrative dhe përmbarimore

22. Paralelisht me procedurën e ndjekur në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës kishte ndjekur edhe procedurën administrative duke iu drejtuar me ankesë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (KPMK), i cili ishte organ kompetent për të shqyrtuar ankesat e shërbyesve civilë.

23. Më 25 shkurt 2008, KPMK-ja, duke vendosur sipas ankesës së parashtruesit, nxori Vendimin A 02 158/2005, me të cilin pjesërisht aprovoi ankesën e parashtruesit duke konstatuar se ka pasur shkelje të procedurave të parapara me aktet juridike që rregullojnë shërbimin civil dhe sidomos të procedurave të konstatimit të përgjegjësisë të shërbyesit civil dhe me këtë vendim e ka obliguar organin punëdhënës, Komunën e Gjakovës, që në afat prej 15 ditësh të zhvillojë procedurën disiplinore sipas rregullave në fuqi ndaj parashtruesit të kërkesës. (Sqarim: vendimi i KPMK-së në hyrje ka prapashtesën e vitit 2005, e në fund të vitit 2007 dhe kështu edhe referohet në vendimet gjyqësore njëherë më 2005, e njëherë më 2007, por në esencë është i njëjti vendim).

24. Më 30 korrik 2009, Gjykata Komunale në Gjakovë ka lejuar përmbarimin e vendimit të KPMK-së nëpërmjet klauzolës së Aktvendimit E. nr. 1268/09.

25. Më 30 dhjetor 2009, Gjykata Komunale në Gjakovë nxjerr Aktvendimin E. nr. 1268/09, me të cilin ka aprovuar prapësimin e parashtruar nga Komuna e Gjakovës ndaj Aktvendimit E. nr. 1268/09, të 30 korrikut 2009, dhe ka anuluar të gjitha veprimet e kryera të aktvendimit të atakuar.

26. Në arsyetimin e këtij aktvendimi, Gjykata Komunale kishte potencuar se vendimi i KPMK-së në këtë rast kishte të bënte me një obligim procedural të organit të punësimit, e që është zhvillimi i procedurës disiplinore dhe nuk kishte të bënte me asnjë detyrim monetar, andaj sipas Ligjit për procedurën përmbarimore, ai nuk paraqiste titull ekzekutiv.

27. Më 22 tetor 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë ka nxjerrë Aktvendimin Ac.nr 139/10, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe e ka vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, E. nr. 1268/09, të 30 dhjetorit 2009.

28. Ndër të tjera, në arsyetimin e këtij Aktvendimi, Gjykata e Qarkut ka theksuar se *"vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë sepse aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestime nga neni 182 paragrafi 2 pika (b)(k)(j)(k)dhe (m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore"*.

Pretendimet e parashtruesit për shkeljet kushtetuese

29. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, por edhe me vendimet gjyqësore të gjykatave të instancës më të ulët, i janë shkelur këto të drejta të njeriut: neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], neni 49 [E Drejta për Punë dhe Ushtrim të Profesionit] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] i Kushtetutës; neni 6 [E Drejta për Proces të Rregullt Gjyqësor] dhe neni 13 [E Drejta për Zgjedhje Efektive] i KEDNJ-së, si dhe [E Drejta e Pronës] e Protokolli 1 të KEDNJ-së.

30. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar më tej se Gjykata Kushtetuese në raste të ngjashme ka vendosur t'i deklarojë si të pranueshme kërkesat e parashtruesve, duke theksuar veçanërisht Aktgjykimin e kësaj Gjykate, KI55/11, të parashtruesit F. P., dhe rastet e parashtruesve E. K. (KI04/12) e V. M. (KI129/11) kur ka

obliguar autoritetet publike kompetente që vendimet e KPMK-së t'i zbatojnë.

31. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se Gjykata duhet të aplikojë masën e përkohshme të ndalimit të ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. 22/2011, sepse ai është diskriminues dhe antikushtetues.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës të Gjykatës.

33. Lidhur me këtë, i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës ku përcaktohet:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

34. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se kërkesa KI216/13 është dorëzuar në Gjykatë nga një individ, është parashtruar brenda afatit 4-mujor të paraparë me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si dhe pas shterjes së mjeteve juridike në dispozicion, andaj i plotëson kushtet formale për t'u shqyrtuar në Gjykatën Kushtetuese.

35. Duke bërë vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren që parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 22/2011, me të cilin iu refuzua revizioni si i pabazuar për shkaqet e paraqitura në arsyetimin e Aktgjykimit për revizion.

36. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se përkundër pohimit të parashtruesit të kërkesës se atij me këtë Aktgjykim i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, sipas neneve 21, 31, 32, 49 dhe 54, si dhe të drejtat e njeriut të parapara me KEDNJ, sipas nenit 6.13 dhe Protokollit të parë, ai nuk ka paraqitur fakte që do ta çonin Gjykatën në përfundim se shkeljet e pretenduara vërtet kanë ndodhur. Parashtruesi nuk ka ofruar argumente mbi natyrën e shkeljes, nuk i ka sqaruar rrethanat në të cilat ajo eventualisht ka ndodhur,nuk ka specifikuar përmasat e shkeljes apo pasojat

kushtetuese dhe, në fakt, ai vetëm ka bashkëngjitur me kërkesë vendimet gjyqësore lidhur me rastin dhe ka potencuar se vendimi i KPMK-së, si i tillë çfarë është, është dashur të implementohet, edhe pse ai për këtë çështje ka hapur edhe kontest gjyqësor, që ka përfunduar si i pavaforshëm për parashtruesin.

37. Gjykata më tej konstaton se për sa i përket procedurës kontestimore, parashtruesi në fakt është i pakënaqur me rezultatin përfundimtar të rastit të tij në gjykata dhe nuk ka paraqitur fakte që do të argumentonin parregullsinë e procesit gjyqësor në aspektin e të drejtave të njeriut dhe as fakte që do të dëshmonin për parregullsi procedurale tej mase arbitrare që do të kishin për pasojë shkeljen e të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e faktit dhe me këtë rast rithekson se konstatimi i gjendjes faktike të drejtë dhe të plotë është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, *mutatis mutandis,* i. a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65).

38. Lidhur me kërkesën e parashtruesit, i cili i referohet praktikës së mëhershme gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe pretendimit të tij përngjashmërinë e rastit të tij me rastet KI55/11, KI04/12 e KI129/11, Gjykata thekson se këto raste dallojnë në disa aspekte nga njëri-tjetri.
39. Derisa në Aktgjykimin e rastit KI55/11, në paragrafin 17, Gjykata kishte konstatuar se "më *25 qershor 2008, KPM-ja e miratoi ankesën dhe urdhëroi punëdhënësin që ta kthente në punë parashtruesin e kërkesës"* (Vendimi Nr. 49/08) dhe, me këtë rast, pra, në mënyrë përfundimtare, këshilli kishte vendosur me vendim për statusin juridik të shërbyesit civil në organin e punësimit (Gjykata konstatoj të njëjtat fakte edhe në rastet KI04/12 – paragrafi 10 i Aktgjykimit dhe KI129/11, paragrafi 18 i Aktgjykimit), ndërsa në rastin KI216/13, Këshilli nuk kishte vendosur për statusin përfundimtar të shërbyesit civil, por kishte aprovuar një pjesë të kërkesës së tij dhe kishte urdhëruar një veprim procedural të zhvillimit të procedurës disiplinore, e i cili në kushte të zbatimit të tij, do të përfundonte me një vendim final të organit të punësimit dhe këtë fakt të cilin e kishin konstatuar edhe gjykatat e rregullta në procedurë kontestimore.

40. Sikur Këshilli të kishte aprovuar në tërësi ankesën e parashtruesit dhe ta obligonte organin e punësimit që parashtruesin ta kthejë në punë, atëherë edhe Gjykata Kushtetuese do të mbështetej në

praktikën e saj gjyqësore të mëhershme, por në një proces administrativ të papërfunduar me një vendim meritor përfundimtar, Gjykata nuk mund të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, apo të nenit 6 të KEDNJ-së. GJEDNJ-ja, në rastin Barbera, Meeseque dhe Jibardo kundër Spanjës (Aktgjykimi A nr. 146, i 6 dhjetorit 1988), ka mbajtur po këtë qëndrim duke konstatuar se *"lëshimet dhe mangësitë eventuale procedurale të cilat paraqiten në një fazë të procesit mund të korrigjohen në fazat e mëvonshme të procesit, andaj parimisht nuk është e mundur që të konstatohet nëse procesi është i rregullt deri sa ai të mos ketë përfunduar*".

41. Për më tepër çështja e vendimit të KPMK në rastin e parashtruesit ishte objekt shqyrtimi edhe në gjykatat e rregullta në procedurë kontestimore ndërsa në rastet e përmendura nga parashtruesi vendimi i KPMK-ishte vetëm objekt i ekzekutimit në procedurë ekzekutive pa kaluar fare për vlerësim në gjykatat e rregullta.

42. Në këto rrethana, parashtruesi i kërkesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje të Kushtetutës me aktin e autoritetit publik", andaj Gjykata, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika d, gjen se kërkesën duhet ta hedhë poshtë si qartazi të pabazuar.

43. Meqenëse kërkesa në tërësi është e papranueshme, atëherë Gjykata nuk gjen arsye ta aplikojë masën e përkohshme dhe si e tillë ajo refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe të rregullit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 23 janar 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI53/14, N.P.T "Llabjani" Klinë, Aktvendim i datës 13 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 22/2013, të 13 nëntorit 2013

Rasti KI53/14, vendimi i 13 majit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, *prima facie,* qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i kontestuar përbën shkelje të Kushtetutës, KEDNJ-së dhe Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (siç është përmendur në paragrafin 3 të këtij Aktvendimi) dhe kërkon nga Gjykata që ta anulojë aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka ngritur shkeljen e pretenduar kushtetuese në Gjykatën Supreme të së drejtës së saj të garantuar për barazi para ligjit dhe së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Për më tepër, parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk ka paraqitur fakte në Gjykatë se si ka ndodhur shkelja e pretenduar e dispozitës kushtetuese dhe në cilën fazë të procedurës gjyqësore. Përveç kësaj, ai nuk ka dëshmuar se aktgjykimet dhe aktvendimet e kontestuara përbënin elemente të mundshme arbitrare, apo se ai kishte marrë trajtim jo të barabartë gjatë procedurave.

Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar pretendimet e tij dhe as nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie*, që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 13 maj 2014, njëzëri deklaron kërkesën te papranueshme si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI53/14
Parashtrues
N.P.T "Llabjani", Klinë
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 22/2013, të 13 nëntorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është NTP "Llabjani" nga Klina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), që përfaqësohet nga z. Sahit Bibaj, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 22/2013, i 13 nëntorit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 16 dhjetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], me nenin 24 [Barazia para Ligjit], paragrafi 2, me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) si dhe me nenin 10 [E drejta e barabartë për

gjykim të drejtë dhe publik] të Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut.

Baza juridike

4. Neni 113.7 në lidhje me nenin 21.4 të Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 mars 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 2 prill 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI53/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

7. Më 23 prill 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 13 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në vitin 2006, parashtruesi i kërkesës nënshkroi dy kontrata për kryerjen e punëve ndërtimore, në emër të Shoqatës Aksionare Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK), të cilat duhet të kryheshin sipas kushteve të parapara me projekt të përgjithshëm dhe kontratë. Kompania e kontraktuar do të kompensohej për punën e kryer me vlerën monetare, të përcaktuar në kontratë.

10. Sipas parashtruesit të kërkesës, gjatë ekzekutimit të punëve në terren, u paraqit nevoja për kryerjen e punëve ndërtimore shtesë. Pasi që kjo nuk ishte paraparë me projekt ose me kontratën bazë, ishte marrë pëlqimi nga organi mbikëqyrës i PTK-së (komisionit) për t'i përfunduar punët shtesë. Përkundër disa padive, të

dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, ai nuk u kompensua nga PTK-ja.

11. Më 20 qershor 2008, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme), kundër debitorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) SH. A. në Prishtinë për pagesë lidhur me punën e kryer shtesë, në shumë prej 87, 504.90 €.

12. Më 31 korrik 2008, Dhoma e Posaçme, me Aktvendimin SCC-08-200, ia përcolli rastin Gjykatës Ekonomike të Qarkut të Kosovës në Prishtinë që të vendosë lidhur me padinë.

13. Më 13 tetor 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin II. C. nr. 228/2009, e refuzoi padinë, si të pabazuar.

14. Në arsyetim të aktgjykimit, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë konstatoi:

> *"Me dispozitën e nenit 630 të LMD-ës, është paraparë se kontrata për ndërtimin duhet të jetë në formë të shkruar, përndryshe ndërtimi i kanalizimit kabllor telefonik në Istog dhe në lagjen Dobrajë në Deçan si dhe punët e kryera të pa parapara dhe shtesë për ndërtimin e kanalizimit kabllovik telefonik në Pejë dhe në Deçan, jashtë kontratave të lartcekura, ka për pasojë kryerjen e punëve të pa kontraktuara të bëra në rrezik të paditësit, dhe së këndejmi, kontrata që nuk është në formë të shkruar nuk krijon efekte juridike dhe për investimet e bëra nuk mundë të kërkohet mbrojtje juridiko-gjyqësore. Po ashtu në dispozitën e nenit 633 te LMD-ës, është paraparë se për çdo ndryshim nga projekti ndërtimor respektivisht nga punët e kontraktuara, kryesi i punëve duhet ta ketë pëlqimin me shkrim nga porositësi i punëve".*

15. Më 18 mars 2010, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme, për shkak të "*shkeljes së rëndë të dispozitave të procedurës civile dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale*".

16. Më 14 maj 2013, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme nxori Aktvendimin AC-II-12-0163, duke e shpallur veten jokompetent për shqyrtimin e ankesës, të ushtruar nga parashtruesi i kërkesës, dhe e procedoi rastin në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

17. Më 18 qershor 2013, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ae. nr. 508/2012) e refuzoi si të pabazuar ankesën e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, ndërsa vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II. C. nr. 228/2009, të 13 tetorit 2009.

18. Gjykata e Apelit konstatoi:

> "*Mbështetur në këtë gjendje të çështjes, Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave të nevojshme, krejt dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe, në bazë të gjendjes së tillë të vërtetuar, i ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe te drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar".*

19. Më 23 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

20. Më 13 nëntor 2013, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin E. Rev. nr. 22/2013, refuzoi si të pabazuar revizionin e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës.

21. Gjykata Supreme konstatoi:

> "*Nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dyte drejt kane zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i kontestuar përbën shkelje të Kushtetutës, KEDNJ-së dhe Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (siç është përmendur në paragrafin 3 të këtij Aktvendimi) dhe kërkon nga Gjykata që ta anulojë aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Para se ta gjykojë kërkesën, Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të

kërkesës, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

25. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte parashtruar nga një person juridik brenda afatit kohor prej 4 (katër) muajve, siç parashihet me ligj, dhe se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

26. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *[...]*
> *(c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...]*
>
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose [...]*
>
> *(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

27. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit e Gjykatës Supreme Rev. nr. 22/2013, të 13 nëntorit 2013, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe trajtimit jo të barabartë të palëve nga gjykata gjatë procedurave gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës deklaron se për këtë shkak aktgjykimi i kontestuar kishte shkelur *"të drejtën e saj të garantuar për barazi para ligjit dhe për gjykim të drejtë "*.

28. Sa i përket ankesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi i kërkesës duhet të ngrejë shkeljen e pretenduar kushtetuese në gjykatat e

rregullta, që në radhë të parë të sigurojë respektimin e të drejtave themelore të mishëruara në Kushtetutë.

29. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka ngritur shkeljen e pretenduar kushtetuese në Gjykatën Supreme të së drejtës së saj të garantuar për barazi para ligjit dhe së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

30. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk ka paraqitur fakte në Gjykatë se si ka ndodhur shkelja e pretenduar e dispozitës kushtetuese dhe në cilën fazë të procedurës gjyqësore. Përveç kësaj, ai nuk ka dëshmuar se aktgjykimet dhe aktvendimet e kontestuara përbënin elemente të mundshme arbitrare, apo se ai kishte marrë trajtim jo të barabartë gjatë procedurave.

31. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme e refuzoi revizionin sepse "*[...]nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë drejt kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar*". Sidoqoftë, parashtruesi i kërkesës nuk shpjegon në mënyrë të saktë pse dhe si vendimi se "*kontrata që nuk është në formë të shkruar nuk krijon efekte juridike dhe për investimet e bëra nuk mundë të kërkohet mbrojtje juridiko-gjyqësore",* ia kishte shkelur të drejtën e saj të barazisë para ligjit dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, apo paraqiste ndonjë lloj tjetër të diskriminimit.

32. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 22/2013, si dhe aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta kishin ofruar përshkrim të gjerë dhe të plotë të fakteve të rastit dhe kishin dhënë arsye të shumta për gjetjet e tyre ligjore në përgjigjen ndaj pretendimeve të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës. Prandaj, Gjykata konstaton se procedurat në gjykatat e instancave më të ulëta kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara mirë (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë,* Nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

33. Lidhur me këtë, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, par. 28. Shih gjithashtu rastin nr.

70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

34. Gjykata mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë, sa që procedurat, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

35. Si përmbledhje, Gjykata nuk mund të gjej argumente dhe dëshmi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 22/2013, i 13 nëntorit 2013, ishte nxjerrë në mënyrë qartazi të padrejtë dhe arbitrare.

36. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar pretendimet e tij dhe as nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie,* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës, KEDNJ-së dhe protokolleve të saj apo Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut.

Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 13 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI57/14, Besianë Gashi, Aktvendim i datës 7 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nr. 03/1586, të 20 shtatorit 2013

Rasti KI57/14, vendimi i 7 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit

Parashtruesja e kërkesës, Besianë Gashi, parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës të Kosovës, duke kontestuar Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nr. 03/1586, të 20 shtatorit 2013, si të nxjerrë me shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke zbatuar Ligjin për punësimin e shërbyesve civilë, ka shkelur të drejtën e saj të punës. Ajo në mënyrë specifike pretendon se Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke shkelur procedurat e shpalljes së konkursit dhe shkarkimin e saj pa bazë, ka shkelur nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

Lidhur me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme për shkak të mos-shterimit, sepse parashtruesja e kërkesës mund të kishte ushtruar ankesë në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave brenda afatit prej 30 ditësh. Megjithatë, parashtruesja e kërkesës asnjëherë nuk paraqiti ankesë kundër këtij vendimi. Në çdo rast, kërkesa e parashtruese është e paafatshme sepse vendimi i kontestuar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nr. 03/1586, i 20 shtatorit 2013 i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 1 tetor 2013, ndërsa parashtruesja parashtroi kërkesën e saj në Gjykatë më 28 mars 2014 d.m.th. pas periudhës katër mujore të lejuar me nenin 49 të Ligjit.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI57/14
Parashtrues
Besianë Gashi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nr. 03/1586, të 20 shtatorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesja e kërkesës është znj. Besianë Gashi, me vendbanim në Obiliq.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nr. 03/1586, të 20 shtatorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 1 tetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili pretendohet t'i ketë shkelur parashtrueses së kërkesës të drejtat e saj të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 mars 2014, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 3 prill 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI57/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI57/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 22 prill 2014, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

8. Më 19 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 30 janar 2013, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka shpallur konkurs për vendin e lirë të punës, zyrtar për informim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

10. Më 17 prill 2013, Këshilli Gjyqësor i Kosovës e njoftoi parashtruesen e kërkesës se ajo ishte përzgjedhur për vendin e lirë të punës.

11. Më 25 prill 2013, parashtruesja e kërkesës e nënshkroi akt emërimin, i cili ishte për një kohë të pacaktuar. Ajo është dashur të fillojë punën më 2 maj 2013.

12. Më 1 tetor 2013, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës e njoftoi parashtruesen e kërkesës se kontrata e saj do të përfundonte më 1 tetor 2013, sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, më 10 shtator 2013, nxori një vendim, me të cilin ishte anuluar konkursi për pozitën e zyrtares për informim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, pas ankesës së një kandidati tjetër, që kishte aplikuar për të njëjtën pozitë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke zbatuar Ligjin për punësimin e shërbyesve civilë, ka shkelur të drejtën e saj të punës. Ajo në mënyrë specifike pretendon se Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke shkelur procedurat e shpalljes së konkursit dhe shkarkimin e saj pa bazë, ka shkelur nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

14. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës pretendon se *"[...] KGJK [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] ka bërë shkelje të të drejtës sime në punë për vetë faktin se më ka emëruar parakohshëm me emërim të përjetshëm në këtë pozitë, dhe kështu unë si palë e tretë ne konfliktin midis KPMSCH dhe KGJK jam dëmtuar si rezultat i pakujdesisë së punëdhënësit tim. Po të mos ishte pakujdesia e shumëfishtë e KGJK-së, duke filluar me shpalljen e gabuar të konkursit e duke pasuar me emërimin tim të parakohshëm, unë nuk do të kisha as pritje dhe as bazë ligjore për të kërkuar që të vazhdoj punën në pozitën e përzgjedhur. Në momentin e nënshkrimit të aktemërimit të përjetshëm, kur unë edhe kam hequr dorë nga pozita paraprake, e drejta ime në punë në këtë pozitë është garantuar nga KGJK. Shkarkimi im nga kjo pozitë do te mund të behej vetëm nëse unë do të dështoja në kryerjen e detyrave të mia, apo shkeljeve të tjera siç parashihen me ligj. Kësisoj, mungesa e ndonjërës nga këto baza ligjore, dëshmon për mungesën e bazës ligjore për të më shkarkuar mua nga kjo pozitë. Prandaj, për shkak të këtyre dy hapave rëndues të KGJK-së, për shkak të shkeljeve të vazhdueshme të ligjit në fuqi, mua me është shkelur e drejta në punë, e garantuar me nenin 43 të Kushtetutës".*

15. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu deklaron se ajo nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sepse,

pretendohet, *"[...]se këto mjete nuk do të ishin mjete efektive në këtë rast, për dy arsye kryesore: dyshim i bazuar se Gjykatat e rregullta nuk mund të jenë të pavarura për të vendosur në mënyrë objektive një rast kundër punëdhënësit te tyre; dhe zvarritja e mundshme e procedurave dhe ekzekutimit të vendimit eventual kundër KGJK-së si rezultat i mungesës së kësaj pavarësie"*.

16. Parashtruesja e kërkesës pretendon se *"[...] duke qenë se pala kundërshtare në këtë mosmarrëveshje është Këshilli Gjyqësor i Kosovës- i vetmi punëdhënës dhe mbikëqyrës i të gjithë gjyqtarëve dhe gjykatave në Republikën e Kosovës, kjo e bën të pamundur që unë të kem gjykim të drejtë dhe të paanshëm në çfarëdo gjykate të rregullt në Kosovë, përveç Gjykatës Kushtetuese"*. Parashtruesja e kërkesës pretendon se *"[...]e para, të gjithë gjyqtarët e Republikës së Kosovës, përveç ata të Gjykatës Kushtetuese, kandidojnë pranë, përzgjidhen dhe propozohen për emërim vetëm nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës- pala kundërshtare ne këtë rast. E dyta, ndonëse gjyqtarët kanë emërime të përjetshme, performanca e tyre mbikëqyret nga KGJK dhe ndaj tyre mund të ushtrohen një sere masash disciplinore të cilat mund të çojnë deri në shkarkimin e tyre. Dhe e fundit, në rast të ndërmarrjes të çfarëdo mase ndëshkuese kundër një gjyqtari nga vetë KGJK, po i njëjti gjyqtar nuk ka ndonjë mënyrë efikase dhe efektive për të kundërshtuar punëdhënësin e vet, për po të njëjtat arsye qe u thanë më lartë"*.

17. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës pretendon se *"Gjykatat e rregullta në Kosovë janë të njohura për tejzgjatje të procedurave në çështjet civile të çfarëdoshme. Duke e patur parasysh varësinë e drejtpërdrejtë nga KGJK, tendenca për të zvarritur këtë procedurë do të jetë akoma më e madhe në këtë rast"*.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses së kërkesës, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse ajo i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Sa i përket kërkesës së tanishme, Gjykata vëren se, më 1 tetor 2013, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës njoftoi parashtruesen e kërkesës se kontrata e saj do të ndërpritej menjëherë. Në bazë të këtij vendimi, parashtruesja e kërkesës mund të kishte ushtruar

ankesë në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh. Megjithatë, parashtruesja e kërkesës asnjëherë nuk paraqiti ankesë kundër këtij vendimi.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafit 7 të Kushtetutës, cili përcakton se:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

21. Gjykata i referohet edhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

22. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar, …"*

23. Arsyeja për ekzistimin e rregullit të shterimit është që t'iu lejojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë këtu edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar apo rregulluar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin që rendi juridik i Kosovës ofron mjete efektive juridike për mbrojtje kundër shkeljeve të të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih Aktvendimin për papranueshmëri, *AAB-RIINVEST Universiteti SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999).

24. Gjykata gjithashtu rikujton se në përputhje me parimin e subsidiaritetit, parashtruesja e kërkesës është e obliguar që të shterojë të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, siç parashihet me nenin 113.7 dhe dispozitat e tjera ligjore, siç u

përmend më lart. Prandaj, parashtruesja e kërkesës mund të kishte ushtruar ankesë në pajtim me mjetin juridik të parashikuar në vendimin e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

25. Për shkak se parashtruesja e kërkesës nuk ushtroi ankesë ndaj vendimit të pafavorshëm të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ajo nuk i ka shteruar të gjitha mjetet e saj efektive juridike siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, si një prej disa parakushteve të cilat ajo duhet t'i plotësojë para se kërkesa e saj të mund të konsiderohet e pranueshme.

26. Gjykata gjithashtu konsideron se dyshimi i thjeshtë i parashtrueses se gjykata ose gjykatat nuk mund të jenë të drejta, të paanshme apo të pavarura në rastet e tyre personale, nuk është i mjaftueshëm për të përjashtuar parashtruesen e kërkesës nga detyrimet e saj për t'u ankuar para organeve kompetente në kohën e duhur (shih *Whiteside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendimi i 7 marsit 1994, parashtresa nr. 20357/92, DR 76, f. 80 dhe parashtruesi *Gazmend Tahiraj,* Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri, i 22 majit 2012). Në të vërtetë, nëse atyre gjykatave do t'u ishte dhënë mundësia për të shqyrtuar rastin dhe nëse nuk do të kishin vepruar në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe në mënyrë të pavarur, parashtruesja e kërkesës do të kishte pasur mundësinë për të referuar një shkelje të tillë në Gjykatën Kushtetuese.

27. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet efektive sipas ligjit të Kosovës, në mënyrë që Gjykata të procedojë me pretendimin e saj për kushtetutshmërinë e vendimit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

28. Rrjedh se kërkesa është e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

29. Edhe nëse parashtruesja e kërkesës do t'i kishte shteruar të gjitha mjetet e saj efektive juridike, e edhe nëse vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ndaj të cilit ajo ankohet do të ishte mjeti juridik i saj përfundimtar në dispozicion për të shteruar të drejtat e saj ligjore, edhe atëherë kërkesa e saj do të ishte e papranueshme për shkak se ajo është paraqitur në këtë Gjykatë pas periudhës 4 (katër) mujore, të lejuar me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Për shkak se parashtruesja nuk i ka shteruar të gjitha

mjetet e saj efektive juridike, Gjykata nuk mund të konkludojë se kjo kërkesë nuk është parashtruar me kohë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 47 dhe 49 të Ligjit dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 7 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI05/14, Bejtullah Sogojeva, Aktvendim i datës 19 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 396/2012, të 11 shtatorit 2013.

Rasti KI05/14, vendimi i 19 majit 2014.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Sipas parashtruesit të kërkesës, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në Institutin e Mjekësisë së Punës në Obiliq, si koordinator i komerciales, deri më 15 gusht 2006. Atë ditë i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës, pasi që ai pretendohet të ketë arritur moshën e plotë të pensionimit.

Sipas parashtruesit të kërkesës, në librezën e tij të punës, gabimisht thuhej se ai ishte lindur më 15 mars 1941, përderisa ai në të vërtetë ishte lindur më 15 gusht 1942. Kështu, punëdhënësi i tij kishte llogaritur gabimisht moshën e tij të pensionimit dhe, si pasojë, ai ishte i detyruar të pensionohej një vit përpara se të arrinte moshën e pensionimit.

Është e qartë nga pretendimet e parashtruesit të kërkesës, të përmbledhura më lart, se parashtruesi i kërkesës vetëm konteston nëse gjykatat e rregullta kanë zbatuar ligjin në fuqi. Parashtruesi i kërkesës më tej nuk pajtohet me gjetjet faktike të Gjykatës Supreme në lidhje me rastin e tij.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 19 maj 2014, njëzëri deklaron se kërkesa është qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI05/14
Parashtrues
Bejtullah Sogojeva
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 396/2012, të 11 shtatorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bejtullah Sogojeva, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 396/2012, të 11 shtatorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 18 dhjetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin, sipas parashtruesit të kërkesës, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 49 [E Drejta e

Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 17 janar 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 31 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI05/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI05/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 12 shkurt 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 19 maj 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në Institutin e Mjekësisë së Punës në Obiliq, si koordinator i komerciales, deri më 15 gusht 2006. Atë ditë i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës, pasi që ai pretendohet të ketë arritur moshën e plotë të pensionimit.

10. Sipas parashtruesit të kërkesës, në librezën e tij të punës, gabimisht thuhej se ai ishte lindur më 15 mars 1941, përderisa ai në të vërtetë ishte lindur më 15 gusht 1942. Kështu, punëdhënësi i tij kishte llogaritur gabimisht moshën e tij të pensionimit dhe, si pasojë, ai ishte i detyruar të pensionohej një vit përpara se të arrinte moshën e pensionimit.

11. Më 15 gusht 2006, parashtruesi i kërkesës kishte iniciuar procedurë civile në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Pas kësaj, më 8 dhjetor 2008, Gjykata Komunale nxori Aktgjykimin Cl. nr. 161/2007 dhe e aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Punëdhënësi i parashtruesit të kërkesës, si i paditur në procedurë, ishte obliguar t'ia kompensonte parashtruesit të kërkesës të ardhurat personale vjetore dhe shpenzimet e procedurës.
12. I padituri paraqiti me kohë ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 8 dhjetorit 2008, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

13. Më 15 shtator 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin Ac. nr. 569/2009 dhe prishi aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Komunale. Kështu, rasti ishte kthyer në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

14. Më 22 prill 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin (C. nr. 2360/09) dhe e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi.

15. Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Komunale në Prishtinë ishte vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 24 janarit 2012 (Ac. nr. 1356/2011).

16. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 24 janarit 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ai pretendonte se aktgjykimi i kontestuar ishte nxjerrë me shkelje të Ligjit për procedurën kontestimore.

17. Më 11 shtator 2013, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 396/2013 dhe refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

18. Në arsyetim të aktgjykimit të Gjykatës Supreme thuhej, *inter alia, "[N]ga shkresat e lëndës, e këte nuk e konteston as paditësi,i del se në dosjen e punës tek i padituri, ku paditësi ka punuar ka qenë libreza e tij e punës dhe certifikata e lindjes nga të cilat vërtetohet se paditësi është i lindur më 15 mars 1941 dhe se mbi këto prova... i pushon marrëdhënia e punës... pasi që ai ka plotësuar kushtet për pensionim. Vendimi i komisionit të përhershëm për shqyrtimin e ankesave në Departamentin e gjendjes civile, sipas kërkesës së paditësit për korrigjimin e datës së lindjes është marrë*

më datë 09.02.2007, gjegjësisht gati 1 vit pas marrjes së vendimit për pensionim".

19. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme gjeti se në rastin civil të parashtruesit të kërkesës, faktet e rastit ishin vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë si dhe nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*në veprimet e lartcekura eshte shkelur parimi i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm dhe se e drejta e punës..., sepse asnjë nga gjykatat... bazuar në dokumentacion...u vërtetua se parashtruesi i kërkesës ishte lindur më 15 gusht 1942 dhe... më 1941*".

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Është e qartë nga pretendimet e parashtruesit të kërkesës, të përmbledhura më lart, se parashtruesi i kërkesës vetëm konteston nëse gjykatat e rregullta kanë zbatuar ligjin në fuqi. Parashtruesi i kërkesës më tej nuk pajtohet me gjetjet faktike të Gjykatës Supreme në lidhje me rastin e tij.

23. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka përdorur të gjitha mjetet juridike në dispozicion, të përcaktuara me Ligjin për procedurën kontestimore dhe se Gjykata Supreme ka marrë parasysh dhe u është përgjigjur ankesave të tij në çështjet e ligjit.

24. Gjykata rithekson që nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [ECHR] 1999-1, shih edhe Aktvendimi për papranueshmëri në rastin nr. KI70/11,

parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011).

25. Gjykata më tej vëren se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, nr. 5503/ 02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

26. Rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh se "*Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 19 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Prof. Dr. Ivan Čukalović	Prof. Dr. Enver Hasani

KI43/14, Rexhep Kuqi dhe z. Milazim Kuqi, Aktvendim i datës 26 qershor 2014 – Vlerësimi i Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 203/2013, të 24 dhjetorit 2013

Rasti KI43/14, vendimi i 26 qershorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, mbrojtja e pronës, ekspropriimi, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 203/2013, të 24 dhjetorit 2013, me të cilin është zgjidhur kontesti juridiko-pronësor i krijuar shkaku i kërkesës së parashtruesit që Komuna e Suharekës t'ia kompensoj kundërvlerën monetare për pronën e eksproprijuar.

Parashtruesi i kërkesës konsideron se me këtë rast atij i janë shkelur të drejtat kushtetuese nga nenet 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse nuk e ka pranuar kompensimin për pronën e eksproprijuar, ashtu që me padi kërkon të detyrohet Komuna e Suharekës t'ju paguajë kompensimin për paluajtshmërinë e eksproprijuar me Aktvendimin nr. 03-3/1039/64, të 19 shkurtit 1964.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesve Rexhep Kuqi dhe Milazim Kuqi, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AC. nr. 3435/2012 i 13 majit 2013, dhe Aktvendimi i Gjykatës Supreme në Prishtinë, Rev. nr. 2013/2013 i 24 dhjetorit 2013, në arsyetimet e tyre shpjegojnë në detaje arsyet për zbatimin e rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale dhe u japin përgjigje pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, të cilat parashtruesi i ka cekur si bazë për paraqitjen e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

Gjykata e pranoi arsyetimin e Gjykatës Supreme të Kosovës se nga Aktvendimi për caktimin dhe vlerësimin e kompensimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar, nr. 1039/64 të datës 21.02.1964, del se paraardhësit të propozuesit, ish pronarit Bejtullah Kuçit nga Suhareka, i është caktuar kompensimi për paluajtshmërinë e eksproprijuar në lartësi prej 155.358.- dinarë, i cili aktvendim është marrë në prezencën e palëve, të cilët nuk kanë parashtruar asnjë vërejtje në vlerësimin e komisionit, ashtu që njëjti nga dita e marrjes ka qenë i formës së prerë, dhe i ekzekutueshëm.

Prandaj, Gjykata konkludoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese, ashtu që kërkesa e tij është qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI43/14
Parashtrues
Rexhep Kuqi dhe Milazim Kuqi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 203/2013, të 24 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Rexhep Kuqi dhe z. Milazim Kuqi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), me banim në komunën e Suharekës, të cilët në Gjykatën Kushtetuese përfaqësohen nga avokati z. Zef Delhysa nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 203/2013, të 24 dhjetorit 2013, të cilin përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës e kishte pranuar më 29 janar 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 203/2013, të 24 dhjetorit 2013, i cili sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, kishte shkelur nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 mars 2014, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 1 prill 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI43/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI43/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 22 prill 2014, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi Gjykatën me shkrim lidhur me kërkesën e tij për përjashtim nga seanca për periudhën qershor – korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë për pretendimet e ngritura kundër tij.

9. Më 26 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI43/14, e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu si anëtar të Kolegjit shqyrtues dhe në vend të tij caktoi gjyqtarin Enver Hasani.

10. Më 26 qershor 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues Robert Carolan, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Arta Rama-Hajrizi, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 19 shkurt 1964, Kuvendi Komunal i Suharekës, me Aktvendimin nr. 03-3/1039/64, e eksproprijoi një pjesë të parcelës kadastrale nr. 24, me kulturë pemishte të klasës së parë, në sipërfaqe prej 0.10.15 ha, në vendin e quajtur "Varoshica", sipas fletës poseduese 161 ZK Suharekë.
12. Më 22 maj 2003, parashtruesit e kërkesës paraqitën padi në Gjykatën Komunale në Suharekë, me të cilën kërkonin që e paditura, Komuna e Suharekës, të detyrohet të paguajë kompensimin për paluajtshmërinë e eksproprijuar me Aktvendimin nr. 03-3/1039/64, të 19 shkurtit 1964.

13. Më 26 tetor 2005, Gjykata Komunale në Suharekë, me Aktgjykimin C. nr. 77/03, e miratoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës dhe e obligoi të padituren, Komunën e Suharekës, t'ua paguajë parashtruesve të kërkesës kompensimin në vlerë prej €396.950,00, ose t'ua kthejë në pronësi paditësve të njëjtën, pas largimit të objektit ekzistues (Ndërtesën e Zjarrfikësve) dhe që kjo paluajtshmëri të evidentohet në emër të paditësve si pronarë.

14. Më 3 mars 2006, Gjykata e Qarkut në Prizren, duke vendosur sipas ankesës të së padituresë, Komunës së Suharekës, me Aktvendimin Ac. nr. 504/05, e prishi aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen e ktheu në rigjykim.

15. Më 16 maj 2006, në procedurën e përsëritur, Gjykata Komunale në Suharekë e plotësoi procedurën e provave me dëgjimin e dy dëshmitarëve dhe me Aktgjykimin C. nr. 59/06, të 16 majit 2006, e miratoi kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës si të bazuar dhe e detyroi të padituren, Komunën e Suharekës, t'ua paguajë atyre shumën prej €396,950.00, ose t'ua kthejë të njëjtën paluajtshmëri të eksproprijuar, ose në pamundësi të kësaj t'ua kompensojë me një vend tjetër përkatës.

16. Më 19 mars 2007, Gjykata e Qarkut në Prizren, duke vendosur sipas ankesës të së padituresë, Komunës së Suharekës, me Aktvendimin Ac. nr. 299/06, të 19 marsit 2007, e prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë, C. nr. 59/06, të 16 majit 2006, dhe ia ktheu çështjen së njëjtës gjykatë në rigjykim, me urdhëresën që çështja të shqyrtohet nga një kolegj tjetër.

17. Më 14 janar 2010, Gjykata Komunale në Suharekë, me gjyqtarin tjetër individual, nxori Aktvendimin C. nr. 79/2007, të 14 janarit 2010, me të cilin hodhi poshtë padinë e parashtruesve të kërkesës si të palejuar, me arsyetimin se *„kjo padi nuk hyn në kompetencë të procedurës kontestimore dhe se procedura duhet të vazhdohet në procedurën jokontestimore"*.

18. Më 12 prill 2012, në procedurën jokontestimore, Gjykata Komunale në Suharekë, me Aktvendimin ND. nr. 70/11, miratoi si të bazuar propozimin e parashtruesve të kërkesës dhe urdhëroi si në vijim:

> *"... II. DETYROHET shfyrtzuesi i palujtshmeris se eksproprijuar Komuna e Suharekës qe trashegimtarve të pronarit të më parshëm Rexhep Kuqi dhe Milazim Kuqi nga Suhareka me nga 1/2, të pjesës ideale ne emer te kompenzaimii plr palujtshmerin e marrur ne eksproprijim tua kompenzoi me palujtshmeri si me lartl, te njejten tua dorzoi ne posedim dhe shfrytzim të lirë dhe te lejoj regjistrimin e tyre si pronar prane Zyres Katastrale në Suharekë, krejte ket ne afat prej 15 ditesh pas plotefuqishmeris se ketij aktvendimi..."*.

19. Komuna e Suharekës me kohë ushtroi ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Suharekë, Nd. nr. 70/11, të 12 prillit 2012.

20. Më 13 maj 2013, Gjykata e Apelit në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 3435/2012, ndryshoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Suharekë, Nd. nr. 70/2011, të 12 prillit 2012, dhe theksoi si në vijim:

> *"REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve Rexhep dhe Milazim Kuqi nga Suhareka, me të cilën kanë kërkuar të detyrohet e paditura Komuna e Suharekes, që të lirojë nga objekti ekzistues (Shtepia e Zjarrfikësve), t'iu kthej në posedim dhe pronësi pasurinë e eksproprijuar në vitin 1964, pjesë nga ngastra kadastrale nr. 2026 (dikur nr. 24), në sipërfaqe prej 0.10,15 ha, që evidentohet në Fletën poseduese 161 ZK Suharekë, Komuna e Suharekës, ose në pamundësi të kësaj t'iu kompensoj shumën 369.975,00 €, si kundërvlerë e pasurisë së*

ekspropriuar, ose t'iu kompensojë këtë pasuri me paluejtshmeri tjetër të përshtatshme, si E PABAZUAR".

21. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac. nr. 3435/2012, të 13 majit 2013, parashtruesit e kërkesës ushtruan revizion me kohë për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac. nr. 3435/2012, i 13 majit 2013, si i paligjshëm, dhe të vërtetohet Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Suharekë, Nd. nr. 70/2011, i 12 prillit 2012.

22. Më 24 dhjetor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. nr. 203/2013, hodhi poshtë si të pabazuar revizionin e parashtruesve të kërkesës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 3435/2012, të 13 majit 2013, me arsyetimin si në vijim:

"... Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, dhe të drejtën materiale, kur ka ndryshuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka refuzuar propozimin e propozuesit për caktimin e kompensimit për palujtshmërinë e ekspropriuar. Aktvendimi i gjykatës së shkallës së dyte përmban arsye të mjaftueshme për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje të cilat arsye janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë, sepse nga aktvendimi i komisionit për caktimin dhe vlerësimin e kompensimit për palujtshmërinë e ekspropriuar, Nr.1039/64 të datë 21.02.1964 del se paraardhësit të propozuesve ish pronarit Bejtullah Kuçit nga Suhareka, i është caktuar kompensimi për palujtshmërinë e ekspropriuar në lartësi prej 155.358.-dinarë, i cili aktvendim është marrë në prezencën e palëve,të cilët nuk kanë parashtruar asnjë vërejtje në vlerësimin e komisionit vlerësues dhe i njëjti nga dita e marrjes ka qenë i formës së prerë,dhe i ekzekutueshëm...".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"... me këtë çështje juridike tre Gjykatat pra ish Gjykata e Qarkut ne Prizren, Gjykata e Apelit*

e Kosovës në Prishtinë si dhe Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, interpretojnë në mënyrë të ndryshme por gjithsesi këto dyjat te fundit, në mënyrë të gabuar të drejtën materiale në damë të propozuesve, duke ia ja cenuar të njëjtëve të drejtë e mbrojtjes gjyqësore si një të drejt të garantuar me Kushtetutë si dhe me Ligjin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, përkatësisht duke e shkelur të drejtën e tyre për një gjykim të drejt dhe efektiv në kundërshtim me neni 46 al. 3 si dhe neni 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me neni 190 al. 3 LPK, duke ja pa mundësuar propozuesve si paditës në rastin konkret shqyrtimin e drejtëpërsëdrejtë nëGjykatë si pal[në procedurë".

24. Bazuar në atë që u tha në këtë kërkesë, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që:

"1. Kërkesa e parashtruesve të shpallet e pranueshme".

"2. Të shpallen të pavlefshme dhe atë Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë AC. Nr. 3435/20 12 dt. 13.05.20 13 si dhe Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev .nr 20 13/2013 dt. 24.12.2013".

"3. Ta kthejë Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AC. 3435/2012 dt. 13.05.2013 për rishqyrtim në pajtueshmëri me vendimin e kësaj gjykate".

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesve, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

27. Gjykata i referohet nenit 48. të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

28. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

„(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
...
b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

29. Pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve për shkelje lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr 30544/96, par. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1990-1).

30. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac. nr. 3435/2012, i 13 majit 2013, dhe Aktvendimi i Gjykatës Supreme në Prishtinë, Rev. nr. 2013/2013, i 24 dhjetorit 2013, në arsyetimet e tyre shpjegojnë në detaje arsyet për zbatimin e rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale dhe u japin përgjigje këtyre pohimeve të parashtruesve të kërkesës.

31. Gjykata Kushtetuese thekson se parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese (shih *Vanek kundër Republikës Sllovake*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

32. Në këtë rast, parashtruesve të kërkesës u janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesin rastin e tyre dhe të kontestojnë interpretimin e ligjit për të cilin konsiderojnë se është i pasaktë, para Gjykatës Komunale në Suharekë, Gjykatës së Qarkut në Prizren, Gjykatës së Apelit në Prishtinë dhe para Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata

Kushtetuese nuk gjeti se procedurat përkatëse, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

33. Përfundimisht, kushtet për pranueshmëri nuk janë përmbushur në këtë kërkesë. Parashtruesit e kërkesës kanë dështuar të theksojnë dhe të mbështesin me dëshmi se me vendimin e kontestuar u janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.

34. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 26 qershor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. Dr. Enver Hasani

KI71/14, Asllan Bahtiri, Aktvendim i datës 26 qershor 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AA. nr. 404/2013, të 4 marsit 2014

Rasti KI71/14, vendimi i 26 qershorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, qartazi e pabazuar, mënyra e vlerësimit, lista e përfituesve të banesave.

Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kërkuar vlerësimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AA. nr. 404/2013, të 4 marsit 2014. Parashtruesi i kërkesës konsideron se me këtë rast atij i janë shkelur të drejtat kushtetuese nga neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Më 4 shkurt 2012, parashtruesi i kërkesës kishte aplikuar në konkursin e publikuar lidhur me ndarjen e banesave në Komunën e Prishtinës, të cilat Komuna i jep në shfrytëzim dhe me qira për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: UÇK). Komisioni për dhënien e banesave në shfrytëzim dhe me qira i Komunës së Prishtinës për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së, kishte shpallur në tabelën e shpalljeve listën e përfituesve të banesave, në të cilën nuk ishte radhitur parashtruesi i kërkesës. Të gjitha vendimet e komisioneve dhe gjykatave më të ulëta janë vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AA. nr. 404/2013, të 4 marsit 2014.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Asllan Bahtiri, Gjykata Kushtetuese, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, nga shkresat e lëndës konkludoi se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje administrative, A. nr. 1332/2012, i 1 tetorit 2013, dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AA. nr. 404/2013, i 4 marsit 2014, në arsyetimet e tyre shpjegojnë në detaje arsyet për zbatimin e rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale, si dhe mënyrën e vlerësimit sipas Rregullores në procesin e ndarjes së banesave dhe u japin përgjigje këtyre pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.

Për arsye të lartcekura, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse para gjykatave të rregullta, në çfarëdo mënyrë, kanë qenë të padrejta apo arbitrare. Prandaj, Gjykata konkludoi se kërkesa është qartazi i pabazuar sepse faktet e paraqitura në asnjë

mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI71/14
Parashtrues
Asllan Bahtiri
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AA. nr. 404/2013, të 4 marsit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Asllan Bahtiri (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AA. nr. 404/2013, të 4 marsit 2014, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 14 prill 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AA. nr. 404/2013, të 4 marsit 2014, i cili sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, kishte shkelur nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 prill 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 maj 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI71/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI71/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 23 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën lidhur me kërkesën e tij për përjashtimin e tij nga seancat e këshillimeve për periudhën qershor – korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë për pretendimet e ngritura kundër tij.

9. Më 26 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI71/14, e zëvendësoi gjyqtaren Snezhana Botusharova kryesuese të Kolegjit shqyrtues dhe në vendin e saj caktoi gjyqtarin Altay Suroy. Me të njëjtin vendim, Kryetari i Gjykatës e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu si anëtar të Kolegjit shqyrtues dhe në vend të tij caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova.

10. Më 26 qershor 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues Robert Carolan, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 4 shkurt 2012, parashtruesi i kërkesës kishte aplikuar në konkursin e publikuar lidhur me ndarjen e banesave në Komunën e Prishtinës, të cilat Komuna i jep me qira për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: UÇK).

12. Më 18 maj 2012, Komisioni për dhënien e banesave me qira i Komunës së Prishtinës për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së, kishte shpallur në tabelën e shpalljeve listën e përfituesve të banesave, në të cilën nuk ishte radhitur parashtruesi i kërkesës.

13. Më 21 maj 2012, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë me numër 02.360-4965/1, kundër *"Listës prioritare"* të publikuar në tabelën e shpalljeve.

14. Më 2 korrik 2012, me Vendimin e shkallës së dytë të Komisionit për shqyrtimin e ankesave, nr. 02-360-4965/2012, të 2 korrikut 2012, është refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës dhe është vërtetuar vendimi i komisionit të shkallës së parë për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve përfituese të banesave të dedikuara për familjet e dëshmorëve dhe të invalidëve.

15. Më 12 nëntor 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi për anulimin e Vendimit administrativ të shkallës së dytë të Komisionit për shqyrtimin e ankesave, nr. 02-360-4965/2012, të 2 korrikut 2012.

16. Më 1 tetor 2013, duke vendosur lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, me Aktgjykimin A. nr. 1332/2012, të 1 tetorit 2013, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi i së padituri, Komunës së Prishtinës – Komisionit për ndarjen e banesave, nr. 02-360-4965/2012, të 2 korrikut 2012, me arsyetimin si në vijim:

> *"... Nga dëshmitë e nxjerra nga Komisioni gjatë vizitës së paditësit si dhe dëshmive të dorzuara në aplikacion, kanë konstatuar se i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet për ndarje të banesës dhe se nuk ka marre numër të mjaftueshëm të pikëve*

nga shkaku se është vetëm një anëtarë dhe nuk ka arrit pikët e mjaftueshme për tu ranguar në listën e fituesve të banesave...”

17. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, A. nr. 1332/2012, të 1 tetorit 2013, parashtruesi i kërkesës me kohë ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.

18. Më 4 mars 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me Aktgjykimin AA. nr. 404/2013, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, A. nr. 1332/2012, të 1 tetorit 2013, me arsyetimin si në vijim:

“... Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërsi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të ligjit për konfliktin administrativ, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 49 të LKA-së. Sa i përket pretendimeve ankimore të paditëses se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të s paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkalles së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së...”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “*i është shkelur e drejta në mbrojtje gjyqësore të të drejtave nga neni 54 i Kushtetutës, sepse gjykatat nuk kanë vlerësuar drejtë kërkesën e ankuesit“*.

20. Në bazë të tërë asaj që është paraqitur në këtë kërkesë, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që:

“Të vlerësohet që i është shkelur e drejta në ndarjen e banesës, si nga Komuna e Prishtinës, ashtu edhe nga gjykatat“.

“Nuk është respektuar Rregullorja dhe nuk është vlerësuar ligjshmëria nga gjykatat“.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

23. Gjykata i referohet edhe nenit 48. të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

24. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *„(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *...*
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

25. Pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale dhe të Rregullores së Komunës lidhur me mënyrën e vlerësimit, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis*

mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr 30544/996, par. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

26. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, A. nr. 1332/2012, i 1 tetorit 2013, dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AA. nr. 404/2013, i 4 marsit 2014, në arsyetimet e tyre shpjegojnë në detaje arsyet për zbatimin e rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale si dhe mënyrën e vlerësimit sipas rregullores në procesin e ndarjes së banesave dhe u japin përgjigje këtyre pretendimeve të parashtruesve të kërkesës.

27. Gjykata Kushtetuese thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih *Vanek kundër Republikës Sllovake*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

28. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë, para Komisionit të Komunës së Prishtinës për ndarjen e banesave, Komisionit për shqyrtimin e ankesave, Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064, i 30 qershorit 2009).

29. Përfundimisht, kushtet për pranueshmëri nuk janë përmbushur në këtë kërkesë. Parashtruesi i kërkesës ka dështuar të theksojë dhe të mbështesë me dëshmi pretendimet se me aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.

30. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 26 qershor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. Dr. Enver Hasani

KI184/13, 12/14,KI 16/14,KI 17/14,KI 24/14,KI 25/14, Korporata Energjetike e Kosovës, Aktvendim i datës 8 maj 2014, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 379/11, të 2 majit 2013, Rev. nr. 192/13, të 3 tetorit 2013, Rev. nr. 244/13, të 8 tetorit 2013, Rev. nr. 192/13, të 3 tetorit 2013, Rev. nr. 246/13, të 1 tetorit 2013, Rev. nr. 271/13, të 31 nëntorit 2013

Rastet e bashkuara, KI184/13, KI12/14, KI16/14, KI17/14, KI24/14, KI25/14, vendimi i 8 majit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale,mohimi i të drejtave të garantuara me nenet 31 dhe 102.3 të Kushtetutës Kosoves, kërkesa është qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës konteston aktgjykimet e Gjykatës Supreme: Rev. nr. 379/11, te 2 majit 2013, Rev. nr. 192/13, të 3 tetorit 2013, Rev. nr. 244/13, të 8 tetorit 2013, Rev. nr. 192/13, të 3 tetorit 2013, Rev. nr. 246/13, të 1tetorit 2013, Rev. nr. 271/13, të 31 nentorit 2013.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Kosovës ,duke pohuar se i janë shkelur të drejtat e tij Kushtetuese, konkretisht nenet 31 dhe 102.3. Përveq kësaj, parashtruesi i kërkesës thekson se bazuar ne dispozitat e nenit 113.7dhe 21.4 te Kushtetutes se Republikes se Kosoves ka të drejtë ligjore që të kerkojë të shqyrtohet ligjshmëria e një vendimi i autoriteteve publike, pasi të jenë shterrur të gjitha mjetet juridike, andaj kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës që pas shqyrtimit të kërkesës të njejtën ta aprovojë si të bazuar duke anuluar Aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës të cekura më lartë.

Gjykata vërenë se parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon: a) shkeljen e parimit të sigurisë juridike, b) shkeljen e nenëve 31 dhe 102.3 të Kushtetutës,dhe c) shkeljen e dispozitave ligjore.

Si rezultat i kësaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i ploteson kushtet e pranueshmerisë, pasi që parashtruesi i kerkesës nuk ka arritur të dëshmojë pretendimin e tij dhe të paraqesë dëshmi përcjellëse për shkeljen e pretenduar kushtetuese me vendimet e kontestuara, prandaj, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullorës së punës, kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të hidhet poshtë si qartazi e pabazuar.

Si përmbledhje, Gjykata arsyeton vendimin e sajë duke konsideruar se parashtruesi i kërkesës nuk argumenton dhe nuk dëshmon se Gjykata Supreme duke gjykuar "në bazë të ligjeve që nuk ishin në fuqi", pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.Për shkak të arsyeve të përmendura më lartë Gjykata vendosi të hedh poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastet Nr.
KI184/13, KI12/14, KI16/14, KI17/14, KI24/14, KI25/14
Parashtrues
Korporata Energjetike e Kosovës
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 379/11, të 2 majit 2013, Rev. nr. 192/13, të 3 tetorit 2013, Rev. nr. 244/13, të 8 tetorit 2013, Rev. nr. 192/13, të 3 tetorit 2013, Rev. nr. 246/13, të 1 tetorit 2013, Rev. nr. 271/13, të 31 nëntorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me seli në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës i konteston vendimet vijuese të Gjykatës Supreme në Kosovë:

KI184/13, Rev. nr. 379/11, të 2 majit 2013
KI12/14, Rev. nr. 192/13, të 3 tetorit 2013
KI16/14, Rev. nr. 244/13, të 8 tetorit 2013
KI17/14, Rev. nr. 192/13, të 3 tetorit 2013

KI24/14, Rev. nr. 246/13, të 1 tetorit 2013
KI25/14, Rev. nr. 271/13, të 31 nëntorit 2013

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, përkitazi me shkeljet e pretenduara të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës.

4. Rasti i tanishëm është identik me rastet në vijim tashmë të vendosura nga Gjykata Kushtetuese:

   a) Rasti nr. KI185/13, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2014;

   b) Rasti nr. KI186/09, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 shkurtit 2014.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Ndërmjet 28 tetorit 2013 dhe 10 shkurtit 2014, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi kërkesat individualisht në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 31 tetor 2013, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 2 dhjetor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës KI184/13 dhe kërkoi nga ai autorizimin. Të njëjtën ditë, Gjykata Supreme dhe pala e tretë R. GJ. u njoftuan për regjistrimin e kërkesës, me një kopje të kërkesës.

9. Më 13 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi më tej dokumente shtesë në lidhje me kërkesën KI184/13.

10. Më 10 shkurt 2014, Kryetari urdhëroi bashkimin e kërkesave (KI184/13, KI12/14, KI16/14, KI17/14, KI24/14 dhe KI25/14).

11. Më 19 mars 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesave KI12/14, KI16/14, KI17/14, KI24/14 dhe KI25/14 dhe kërkoi autorizimin, të cilin parashtruesi i kërkesës nuk e ka dorëzuar ende. Të njëjtën ditë, Gjykata Supreme ishte informuar për regjistrimin e kërkesës.

12. Të njëjtën ditë, në pajtim me rregullin 37 të Rregullores së punës, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për bashkimin e kërkesave.

13. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim ndaj vendimit për bashkimin e kërkesave.

14. Më 25 prill 2014, palët e treta, H. M., E. Q., A. M., N. H. dhe M. N. u njoftuan për regjistrimin e kërkesës.

15. Më 8 maj 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Në data të paspecifikuara, R. GJ., H. M., E. Q., A. M., N. H. dhe M. N. (në tekstin e mëtejmë: punëmarrësit) kishin iniciuar procedurë gjyqësore për një kontest pune kundër parashtruesit të kërkesës, si punëdhënës.

17. Punëmarrësit ishin të punësuar te punëdhënësi me kontratë pune në kohë të pacaktuar (p.sh. në rastin e punëmarrësit të parë R. GJ., Kontrata e punës nr. 11642/0, e 1 nëntorit 2008) derisa njëra palë ta shkëputë kontratën.

18. Parashtruesi i kërkesës shqiptoi një vërejtje përfundimtare me shkrim (p.sh. në rastin e punëmarrësit të parë R. GJ., procesverbali nr. 531, i 25 marsit 2010) ndaj punëmarrësve, *"për shkak të*

mospërmbushjes së performancës" për një periudhë të caktuar kohore.

19. Parashtruesi i kërkesës njoftoi punëmarrësit (p.sh. në rastin e punëmarrësit të parë R. GJ. Vendimi nr. 971, i 17 qershorit 2010) se kontrata e punës do të shkëputej *"për shkak të mospërmbushjes së kënqashme të detyrave të punës, të parapara me nenin 11.1 (11.1 ç), 11.4(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/28 për Ligjin themelor të punës në Kosovë dhe nenit 8.1, 8,2 dhe 8.3, 8.4 (a) të Rregullores për muajin tetor 2010".*

20. Drejtori i Divizionit të Furnizimit (p. sh., në rastin e punonjësit të parë R. GJ., Vendimi nr. 972, i 15 qershorit 2010 dhe Vendimi nr. 167, i 28 qershorit 2010) e refuzoi kërkesën e punëmarrësve për shqyrtim të sërishëm të shkëputjes së kontratës së tyre të punës.

21. Punëmarrësit paraqitën padi në Gjykatën Komunale, duke argumentuar se vendimet ishin të paligjshme dhe duke kërkuar anulimin e tyre.

22. Gjykata Komunale (p.sh. në rastin e parashtruesit të parë R. GJ., Vendimi C. nr. 334/10, i 18 majit 2011) e refuzoi si të pabazuar padinë e punëmarrësve.

23. Punëmarrësit ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut, *"për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të situatës faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale".*

24. Gjykata e Qarkut në Pejë (p.sh. në rastin e parashtruesit të parë, R. GJ., Ac. nr. 255/2011) vërtetoi vendimet e Gjykatës Komunale dhe i refuzoi ankesat e punëmarrësve. Gjykata e Qarkut arsyetoi se:

> *"[A]ktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 pika 2 të LPK-së, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, për shkak të të cilëve do të ishte e pamundur të vlerësohej ligshmërinë e tij, dispozitivi i të cilit aktgjykim është i qartë, i kuptueshëm, diapozitivi nuk është në kundërshtim me vetveten, apo me arsyet e përmendura në aktgjykim, si dhe ai përfshin arsye të mjaftueshme dhe ligjore për faktet*

vendimtare për të vendosur në këtë çështje juridike. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale".

25. Punëmarrësit paraqitën revizion në Gjykatën Supreme *"për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të instancës ma të ulët ashtu që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit [punëmarrësit] si të bazuar ose të njëjtit të prishen dhe çështja të kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim"* .

26. Gjykata Supreme e Kosovës (p. sh. në rastin e parashtruesit të parë, R. GJ., Rev. nr. 379/2011, të 2 majit 2013) i aprovoi si të bazuara kërkesat e revizionit të punëmarrësve dhe i ndryshoi aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë. Gjykata Supreme arsyetoi si në vijim:

"Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas
nenit 215 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se: Revizioni është i bazuar.
. . .
Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e vërtetuar faktike e çështjes, ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik i gjykatave të instancës ma të ulet nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm nga se sipas vlerësimit të kësaj gjykate mbi gjendje e tillë te vërtetuar faktike gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur të dy gjykatat kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar dhe si të tillë e kanë refuzuar, për të cilën arsye u deshtë që të pranohet revizioni i paditësit si i bazuar, të ndryshohen aktgjykimet e goditura, dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e instancës ma të ulët gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale kur kane gjetur se vendimi i të
paditurës [parashtruesi i kërkesës] për shkëputjen e kontratës së punës është i ligjshëm, nga se provat që gjinden në shkresa të lëndës dhe atë Njoftimi mbi shkëputjen e kontratës së punës, (p. sh. në rastin e parashtruesit të parë R. GJ Rev. Nr. 379/2011 të 2 majit 2013) nuk rezulton se e paditura [parashtruesi i kërkesës] para marrjes së vendimeve të kundërshtuara ka vepruar në kuptim të nenit 8.4 (a),(b) të Rregullores nr. 3 Për operacionet e distriktit të KEK-ut, sipas të cilës dispozite është paraparë se Menaxheri i Distriktit do të aranzhoj një takim me punonjësin në fjalë me qëllim të paraqitjes me shkrim të njoftimit për largimi nga puna të punonjësit dhe të jap shpjegim verbal për arsyet e largimit. Nëse punonjësi është njoftuar rreth takimit dhe nuk merr pjesë, Menaxheri i Distriktit mund të vendos njoftimi në tabelën e njoftimeve publike të zyrës së distriktit,kurse veprimi i tillë do të konsiderohet si njoftim me qëllim të shkëputjes së kontratës së punës,sipas pikës (b) të njëjtit nen është paraparë se nëse punonjësi është anëtarë i Sindikatës,ai ka të drejtë të ketë një përfaqësues të sindikatës prezent në takim. Po ashtu e paditura [parashtruesi i kërkesës] me rastin e marrjes së njoftimit mbi shkëputjen e marrëdhënies së punës, nuk ka vepruar në kuptim të nenit 11.5 (b) të Rregullores 2001/27 Për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë.

Gjykatat e instancës ma të ulet gabimisht kanë aplikuar të drejtë materiale kur aktgjykimet e tyre i mbështesin në faktin e vërtetuar përmes procesverbalit mbi takimin e menaxherit të distriktit me punëmarrësin (p.sh. në rastin e parashtruesit të parë R. GJ., Procesverbali nr. 531 të datës 25.03.2010), sepse nga ky procesverbal rezulton se ky takim ka të bëjë me dorëzimin e vërejtjes së fundit me shkrim të datës 25.03.2010,në kuptim të nenit 8.3 dhe nuk ka të bëjë me obligimet e të paditurës [parashtruesit të kërkesës] te parapara me nenin 8.4(a) dhe (b) të Rregullores së lartë cituar

të paditurës. Pasi që në rastin e tanishëm, kontrata e punës i është shkëputur paditësit [punonjësit] për shkak të rezultateve jo të kënaqshme të punës për muajin tetor 2010, ai është dashur ta respektojë nenin 8.4 a) dhe b) të Rregullores së lartpërmendur.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi si të bazuara pretendimet e parashtruesit [të punësuarit] të parashtruara me revizion se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale për shkëputjen e kontratës së punës, nga se për këto shkelje e paditura [parashtruesi] nuk ka udhëhequr procedurë disiplinore, sepse në bazë të dispozitave të nenit 112 të Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës të Kosovës nr. 12/1989, i cili Ligj ka qenë në aplikim në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, deri me hyrjen në fuqi të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-212 në muajin dhjetor të vitit 2010, i cili ligj me dispozitën e nenit 99.1 shfuqizon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin themelor të punës në Kosovë, Ligjin për Marrëdhëniet e Punës të KSAK të Kosovës, të vitit 1989 dhe Ligjin e punës të vitit 1977 me amendamentet përkatëse, është paraparë se organet e autorizuara kanë për detyrë të paraqesin kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore, brenda tetë ditësh pasi të marrin vesh për shkeljen e detyrave të punës, ose për ndonjë shkelje tjetër të disiplinës së punës dhe për kryesin, ndërsa sipas dispozitës së nenit 113 paragrafi 2 është paraparë se para se t'i shqiptoj masën disiplinore largim nga puna organi punë- drejtues respektivisht punëtori i caktuar me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta, ka për detyrë të merr në pyetje punëtorin.

Nga neni 11 i Kontratës së punës e lidhur mes paditësit [punëmarrësi] si punëmarrës dhe të paditurit [parashtruesi i kërkesës] si punëdhënës është përcaktuar se kontrata e punës ndërpritet sipas neneve 67, 68,69 dhe 70 të Ligjit të Punës në Kosovë, Marrëveshjes Kolektive dhe Rregullores së punës së KEK-ut.

Sipas nenit 24 të kontratës së përgjithshme kolektive është paraparë se komisionin disiplinor e emëron punëdhënësi, gjegjësisht organi kompetent me aktin e përgjithshëm të punëdhënësit, ndërsa e paditura [parashtruesi] me

Rregulloren mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të nxjerrë më 10.10.2006. Me pjesën II të kësaj rregullore janë përcaktuar në mënyrë të detajuar dispozitat për zbatimin e procedurës disiplinore, e cila Rregullore nuk është lënë jashtë fuqie me Rregulloren nr. 3 të 30.11.2009. Po ashtu me asnjë dispozitë të Rregullores nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, nuk është lënë jashtë fuqie Ligji Mbi Marrëdhëniet e Punës nr. 12/1989 i KSAK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, nga arsyet e cekura si dhe të dhënat të cilat gjenden në shkresa të lëndës gjeti së kërkesëpadia e paditësit (të punësuarit) është në tërësi e bazuar edhe për shkak se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, u deshtë që të dy aktgjykimet e atyre gjykatave të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditësit si e tillë të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi pretendon se *"Gjykata ka gjykuar në bazë të ligjeve që nuk kanë qenë në fuqi, andaj aktgjykimi i saj është i paligjshëm dhe i padrejtë dhe si i tillë duhet të prishet. KKEK Sh. a është në dijeni që Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk vepron si shkallë IV, por ka juridiksion kushtetues që ta prishë-anulojë çdo akt juridik të cilit do organ, në qoftë se gjen se ka shkelje të dispozitave ligjore dhe atyre kushtetuese, e që për rastin konkret nuk është fare kontestuese se janë shkelur dispozitat ligjore duke aplikuar ligjet dhe aktet e tjera që nuk kanë qenë në fuqi".*
28. Kështu, parashtruesi i kërkesës pretendon se, vendimi i kontestuar ia shkel atij të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 31 dhe 102.3 të Kushtetutës, si rezultat i shkeljes së nenit 214 paragrafit 2 të Ligjit për procedurën kontestimore.

29. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës thekson se *"bazuar në dispozitat e nenit 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka të drejtë ligjore që të kërkojë të shqyrtohet ligjshmëria e një vendimi të autoriteteve publike, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike, andaj kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës që pas shqyrtimit të kërkesës të njëjtën ta aprovojë si të bazuar duke anuluar Aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës,*

Rev. nr. 379/11, të 2 majit 2013, Rev. nr. 192/13, të 3 tetorit 2013, Rev. nr. 244/13, të 8 tetorit 2013, Rev. nr. 192/13, të 3 tetorit 2013, Rev. nr. 246/13, të 1 tetorit 2013, Rev. nr. 271/13, të 31 nëntorit 2013".

30. Për më tepër, në bazë të dokumenteve të dorëzuara, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Një vendim i gjykatës nuk mund të jetë i ligjshëm, i paanshëm dhe i drejtë kur zbatohen dispozitat e ligjit i cili nuk ishte në fuqi. Nëse parimi i gjykimit në bazë të ligjeve më të favorshme për palën ishte kushtetues pa respektuar aspektin e kohës, atëherë në sistemin ligjor dhe kushtetues të vendit do të ishte krijuar konfuzion dhe pasiguri ligjore".*

31. Kështu, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Aplikimi i gabuar i të drejtës materiale nga ana e gjykatës, rezulton me shkelje të drejtave të punëdhënësit të garantuara me Kushtetutë që të jetë i barabartë para ligjit, parim ky i garantuar me dispozitat e nenit 24 të Kushtetutës, si dhe shkelje të Drejtave dhe Lirive Themelore të sanksionuara me dispozitat e nenit 21.4 të Kushtetutës duke ia imponuar me Aktgjykim punëdhënësit që kontratën e punës në kohë të caktuar ta shndërroj në kohë të pacaktuar, në kushtet e ekonominë e lirë të tregut e sanksionuar me dispozitat e nenit 10 të Kushtetutës".*

32. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Gjykata Supreme e Kosovës për çështje identike që kane të bëjnë me shkëputje të kontratës së punës në kohë të caktuar ka qëndrime diametralisht të kundërta ku herë i zbaton dispozitat e nenit 112 dhe 113 të Ligjit mbi marrëdhënie pune të Kosovës GZ. E KSA Kosovës nr. 12/89 e herë të Ligjit Themelor të punës në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001 /27".*

33. Për të mbështetur pretendimin e tij, parashtruesi i kërkesës i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 379/11, të 2 majit 2013, në rastin e punonjësit të parë, R. GJ., ku Gjykata Supreme ka aplikuar dispozitat e nenit 112 dhe 113.2 të Ligjit për marrëdhëniet e punës të Kosovës (Krahina Autonome Socialiste e Kosovës, nr. 12/89), ndërsa në një rast tjetër, Aktgjykimi Rev. nr. 310/12, i 22 prillit 2013, Gjykata Supreme konsideron se dispozitat e nenit 11.1 dhe 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27 janë zbatuar drejt.

34. Parashtruesi i kërkesës më tej thekson *"Se cilat dispozita aplikohen pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Punës në Kosovë,*

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001127 sa i përket marrëdhënies së punës me qëndrimin e vet juridik e ka qartësuar të gjitha gjykatat e qarkut, edhe ajo në Pejë me te gjitha Aktgjykimet që i përkasin kësaj lëmie, por edhe me Aktgjykimin Ac. Nr. 176109, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. nr. 106/2010, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktgjykimin ASC-09-00 14 dt. 26 maj 2011 […]".

35. Prandaj, parashtruesi i kërkesës konkludon duke pyetur:

a. *"Pse Gjykata Supreme e Kosovës për 12 vite me radhë i ka zbatuar dispozitat e Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, kurse në vitin 2013 ka ndërruar qëndrim dhe ka vendos qe të zbatohen dispozitat ligjore të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës të KSA Kosovës, Gazeta Zyrtare nr. 12/89[…]?";*

b. *"[…] a nuk janë shkel të drejtat kushtetuese të gjithë atyre palëve deri në vitin 2013 që rastet e tyre janë vendos sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27";*

c. *"A nuk krijohet një pasiguri juridike me vendime kontradiktore të gjykatës për çështje identike?";*

d. *"A është krijuar pasiguria juridike?";*

e. *"A nuk krijohet pa barazi para ligjit, a nuk janë shkel parimet kushtetuese, Pabarazia para ligjit i paraparë me dispozitat e nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pasi me aktgjykimet e gjykatës supreme për çeshtje identike (materia e njëjtë) për dike vendoset pozitivisht e për dike negativisht".*

Pranueshmëria e kërkesës

36. Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 113 dhe 21 të Kushtetutës.

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
(...)
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]
(...)
4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

38. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parashikon se:

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

39. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh edhe rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, që parashikojnë:

"36 (1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.

36 (2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

40. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon: a) shkeljen e parimit të sigurisë juridike, b) shkeljen e neneve 31 dhe 102.3 të Kushtetutës, dhe c) shkeljen e dispozitave ligjore.

41. Gjykata, para se të hyjë në pretendimet e parashtruesit, rithekson se ajo ka vendosur në disa raste të kontesteve të punës, përkatësisht KI26/09, KI39/09, KI70/10 dhe KI25/10.

42. Në rastin KI26/09 (shih rastin KI26/09, parashtrues i kërkesës *Ekrem Gashi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 14 dhjetorit 2010), parashtruesi i kërkesës pretendonte se aktgjykimi i Gjykatës Supreme, i 24 janarit 2006, kishte shkelur të drejtat e tij kushtetuese sepse e aprovoi kërkesën e punëdhënësit dhe i ndryshoi vendimet e Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, ashtu që padia e parashtruesit të kërkesës ishte refuzuar si e pabazuar. Arsyetimi juridik i Gjykatës Supreme është i bazuar në faktin se njoftimi ku deklarohen arsyet për ndërprerjen e kontratës së punës për punonjësin ishte i mjaftueshëm dhe në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut (2001/27), e cila shfuqizoi të gjithë legjislacionin që nuk ishte në përputhje me të. Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte e papranueshme, sepse nuk ishte *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën.

43. Në rastin KI39/09 (shih rastin KI39/09, parashtrues i kërkesës *Avni Kumnova*, Aktgjykimi i 3 nëntorit 2011), parashtruesi i kërkesës pretendonte se aktgjykimi Gjykatës Supreme, i 27 majit 2009, i kishte shkelur të drejtat e tij kushtetuese sepse Gjykata Supreme gjeti se gjykatat e shkallës më të ulët kishin aplikuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar, pasi që, me rastin e zbatimit të nenit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27, punëdhënësi duhet vetëm të njoftojë me shkrim se e ka ndërmend të ndërpresë kontratën e punës dhe se një njoftim i tillë duhet të përfshijë arsyet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Gjykata Supreme konsideroi se "*në bazë të dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë",* ishte paraparë që ndërprerja e kontratës së punës mund të bëhet pa obligim për të iniciuar procedura disiplinore, dhe se punëdhënësi ishte i obliguar vetëm të njoftojë të punësuarin rreth qëllimit të tij për të ndërprerë kontratën e punës në rastet e rënda të sjelljes së keqe, ose të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave

nga i punësuari, dhe se një njoftim i tillë duhet të përfshinte arsyet për një largim të tillë, ashtu siç ka vepruar Ibër-Lepenci. Gjykata Kushtetuese gjeti se nuk ishte shkelur e drejta kushtetuese e parashtruesit të kërkesës.

44. Në rastin KI70/10 (shih rastin KI70/10, parashtruesja e kërkesës *Fatime Kabashi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 3 nëntorit 2011), parashtruesja e kërkesës pretendonte se aktgjykimi i Gjykatës Supreme, i 27 majit 2009, i kishte shkelur të drejtat e saj kushtetuese sepse më 30 qershor 2010, Gjykata Supreme anuloi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe asaj Komunale dhe refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazë, duke deklaruar se gjykatat e instancës më të ulët kishin gjykuar gabimisht situatën faktike si dhe kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale (Rev. I. nr. 28/2010). Sipas mendimit të Gjykatës Supreme, parashtruesja e kërkesës ka munguar nga puna pa autorizim, edhe pse ishte informuar një ditë para se të refuzohej kërkesa e saj për pushim pa pagesë. Në lidhje me të drejtën materiale, Gjykata Supreme rithekson se Rregullorja e UNMIK-ut 2001/36 dhe Udhëzimi Administrativ 44/2004 ishin në fuqi në vend të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27. Gjykata Kushtetuese e deklaroi kërkesën të papranueshme, sepse parashtruesja e kërkesës as nuk e ka arsyetuar ankesën e saj lidhur me shkeljet e pretenduara dhe as nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

45. Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimit të sigurisë juridike, sepse Gjykata Supreme për çështje identike për dikë vendos pozitivisht, e për dikë negativisht, Gjykata rithekson se, në rastin KI25/10 (shih rastin KI25/10, parashtrues i kërkesës Agjencia e Privatizimit e Kosovës, Aktgjykimi i 31 marsit 2011), Gjykata konstatoi se:

> *"...*
> *57. Për më tepër, Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, dispozitat e te cilit do të kenë përparësi ndaj te gjitha dispozitave ligjore në Kosovë, në Aneksin V [Sistemi i Drejtësisë], neni 1.1, qartazi përcakton se "Gjykata Supreme do te sigurojë zbatim te njëtrajtshëm te ligjit duke vendosur mbi ankesat në përputhshmëri me ligjin". Dhoma e Posaçme, si pjesë e Gjykatës Supreme është e obliguar ta respektojë këtë dispozitë.*

58. Përfundimisht, neni 145 [Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm] përcakton se "Legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amendamentohet në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë". Si interpretues përfundimtar i Kushtetutës, Gjykata konsideron se legjislacioni i zbatueshëm në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute përfshinë rregulloret e UNMIK-ut dhe vendimet administrative të nxjerra nga PSSP-ja para 15 qershorit 2008. Ne pajtim me nenin 145, rregulloret dhe udhëzimet administrative të tilla, si dhe legjislacioni tjetër do të vazhdojnë të zbatohen vetëm për aq sa janë në pajtim me Kushtetutën derisa te shfuqizohen, zëvendësohen apo ndryshohen në pajtim me Kushtetutë".
…"

46. Megjithatë, Gjykata vëren se, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi i kërkesës duhet të ngrejë shkeljen e pretenduar kushtetuese në gjykata të rregullta, në radhë të parë për të siguruar respektimin e të drejtave themelore të mishëruara në Kushtetutë.

47. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka ngritur në Gjykatën Supreme shkeljen e pretenduar kushtetuese të qëndrimeve parimore jo të harmonizuara për çështjet identike dhe zbatimi i tyre nga Gjykata Supreme në lidhje me çështjet identike, duke vendosur për dikë pozitivisht dhe për dikë negativisht, e që, sipas parashtruesit të kërkesës, do të krijonte pasiguri juridike.

48. Gjykata vëren më tej se, më 28 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës i dërgoi një letër Kryetarit të Gjykatës Supreme, duke kërkuar harmonizimin e qëndrimeve parimore në çështjet identike. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Kryetari i Gjykatës Supreme që të "*na sugjeroni se cilat veprime duhet të ndërmerr KEK-u për të riparuar pasojat e shkaktuara me aktgjykimin e lartpërmendur*". Megjithatë, kjo kërkesë duhej të ishte ngritur nga parashtruesi i kërkesës gjatë procedurës së shqyrtimit të çështjes dhe jo pasi është nxjerrë aktgjykimi i Gjykatës Supreme, gjegj. më 2 maj 2013.

49. Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar si dhe pse vendimi i kontestuar, *"duke zbatuar akte tjera, të cilat nuk ishin në fuqi",* kishte shkelur të drejtën konkrete kushtetuese.

50. Gjykata rikujton se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm përfshin një numër të elementeve dhe përbën komponentët kyçë në mbrojtjen e të drejtave themelore individuale nga shkeljet e mundshme të kryera nga gjykatat ose autoritetet publike me vendimet e tyre.

51. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike."*

52. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNJ) gjithashtu parasheh se:

> *"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile (...), çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme."*

53. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk shpjegon saktësisht si dhe pse pretendimi i "*zbatimit të akteve tjera që nuk ishin në fuqi"* e dëshmon shkeljen kushtetuese të të drejtave të tij themelore për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës vetëm konkludon se "*për rastin e tanishëm nuk është aspak kontestuese se dispozitat ligjore ishin shkelur me zbatimin e akteve tjera që ishin në fuqi*".

54. Për më tepër, citati i lartcekur i aktgjykimeve të Gjykatës Supreme tregon se vendimi i kontestuar ofroi arsyetim të gjerë dhe gjithëpërfshirës të fakteve të rastit dhe të gjetjeve të tij.

55. Për më tepër, pakënaqësia me aktgjykimin apo thjesht përmendja e neneve apo dispozitave të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për parashtruesin e kërkesës për të ndërtuar një pretendim për

shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkeljet e Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një argument bindës dhe të arsyetuar mirë në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar.

56. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk argumenton dhe nuk dëshmon se Gjykata Supreme duke gjykuar *"në bazë të ligjeve që nuk ishin në fuqi*", pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.

57. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkeljen e nenit 102.3 të Kushtetutës, i cili përcakton se *"gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit"*. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka sjellë ndonjë argument apo nuk paraqitur ndonjë provë se Gjykata Supreme nuk e ka respektuar dispozitën në fjalë. Prandaj, Gjykata gjen se parashtruesi edhe një herë nuk e ka argumentuar shkeljen e të drejtave të tilla, siç parashihen me Kushtetutë, në nenin e lartpërmendur 102. 3 të Kushtetutës.

58. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon "*shkelje të dispozitave ligjore"*. Gjykata konsideron se ato pretendime janë të natyrës ligjore. Prandaj, Gjykata gjen se ato nuk paraqesin asnjë bazë kushtetuese për shkelje të të drejtave themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutë.

59. Në të vërtetë, Gjykata as nuk i shqyrton vendimet e gjykatave të rregullta për çështje të ligjshmërisë, dhe as nuk e shqyrton saktësinë e fakteve, përveç nëse ka dëshmi të qarta dhe bindëse se ato vendime janë marrë në mënyrë qartazi të padrejtë apo arbitrare.

60. Për më tepër, nuk është detyrë e Gjykatës të vendosë nëse Gjykata Supreme i ka shqyrtuar argumentet e parashtruesve në mënyrë të duhur me rastin e zgjidhjes së çështjeve ligjore. Kjo mbetet ekskluzivisht juridiksion i gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

61. Është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse, gjatë procedurave të gjykatave të rregullta, gjykatat kanë shkelur ndonjë të drejtë themelore të garantuar me Kushtetutë.

62. Si përmbledhje, Gjykata nuk mund të vërejë se sipas argumenteve dhe provave, aktgjykimet e kontestuara të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 379/11, i 2 majit 2013, Rev. nr. 192/13, i 3 tetorit 2013, Rev. nr. 244/13, i 8 tetorit 2013, Rev. nr. 192/13, i 3 tetorit 2013, Rev. nr. 246/13, i 1 tetorit 2013, Rev. nr. 271/13, i 31 nëntorit 2013, ishin nxjerrë në mënyrë qartazi të padrejtë dhe arbitrare (shih aktvendimet për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Rasti KI185/13, i 10 shkurtit 2014, dhe Rasti KI186/13, i 18 shkurtit 2014).

63. Si rezultat i kësaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë pretendimin e tij dhe të paraqesë dëshmi përcjellëse për shkeljen e pretenduar kushtetuese me vendimet e kontestuara.

64. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të hidhet poshtë si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (2) b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 8 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. Dr. Enver Hasani

KI30/14, Zymrije Haxhimusa, Ekrem Abazi, Ferinaze Isufi, Avdullah Hoxha dhe Hyzri Delolli, Aktvendim i datës 26 qershor 2014 - Vlerësimin e kushtetutshmërisë së njoftimit të Ministrisë së Administratës Publike të Republikës së Kosovës, Nr. 4278, të 29 gushtit 2013

Rasti KI30/14, vendimi i 26 qershorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest administrativ, e drejta në punë dhe ushtrim të profesionit, pamundësia e kandidimit, mosshterje e mjeteve juridike.

Ne ketë rast, parashtruesit e kërkesës kërkonin regjistrimin e tyre në sistemin e pagave, si nëpunës, nga ana e MAP-it, meqë pretendonin se pa të drejtë ishin hequr nga lista e pagave nga muaji janar 2014. Me këtë veprim parashtruesit pretendonin se u është shkelur e drejta për punë dhe për paga, si dhe e drejta për zgjedhje dhe për t'u zgjedhur.

Megjithatë, Gjykata konstatoi se parashtruesit e kësaj kërkese kishin dështuar të provojnë se i kanë shteruar mjetet efektive juridike në dispozicion, sipas ligjit në fuqi.

Në këtë kontekst, parashtruesit para se të dorëzonin kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese, do të duhej shteruar të gjitha mundësitë në procedurë administrative, përkatësisht të kërkonin zgjidhjen e çështjes së tyre brenda MAP-it dhe më pas në gjykatën kompetente, përkatësisht në Departamentin për çështje Administrative.

Për arsyen e lartcekur, Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesve nuk i përmbushte kriteret procedurale për pranueshmëri, pasi që parashtruesit nuk i kishin shteruar mjetet efektive juridike të parapara me ligj.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI30/14
Parashtrues
Zymrije Haxhimusa, Ekrem Abazi, Ferinaze Isufi, Avdullah Hoxha dhe Hyzri Delolli
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së njoftimit të Ministrisë së Administratës Publike të Republikës së Kosovës, Nr. 4278, të 29 gushtit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Zymrije Haxhimusa, me vendbanim në fshatin Doganaj, komuna e Ferizajt; z. Ekrem Abazi, me vendbanim në Viti; znj. Ferinaze Isufi, me vendbanim në Prishtinë; z. Avdullah Hoxha, me vendbanim në fshatin Pleshinë, komuna e Ferizajt; dhe z. Hyzri Delolli, me vendbanim në fshatin Zaskok, komuna e Ferizajt (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë njoftimin e Ministrisë së Administratës Publike, nr. 4278, të 29 gushtit 2013 (në tekstin e mëtejmë: MAP).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së njoftimit të MAP-it, nr. 4278, të 29 gushtit 2013, përkitazi me pretendimet e parashtruesve për shkelje të nenit 45. 1 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]; nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]; dhe nenit 73 [Pamundësia e Kandidimit] të Kushtetutës, si dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit procedural, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit material.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); neni 20 dhe 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 shkurt 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 mars 2014, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI30/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI30/14, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Prof. dr. Enver Hasani.

7. Më 4 mars 2014, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë.

8. Më 8 prill 2014, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ta plotësimin e saj me dokumentacion relevant.

9. Më 22 prill 2014, parashtruesit dorëzuan formularin e plotësuar, por nuk kanë bashkëngjitur asnjë dokument relevant.

10. Më 23 prill 2014, Gjykata, për regjistrimin e kërkesës, njoftoi MAP-in, respektivisht sekretarin e përhershëm dhe kërkoi dokumente shtesë.

11. Më 28 prill 2014, MAP-i dorëzoi dokumente shtesë, përkitazi me rastin në fjalë.

12. Më 26 qershor 2014, Gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoj me shkrim Gjykatën, për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor - korrik 2014, derisa Gjykata të vendos, përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.

13. Më 26 qershor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Parashtruesit e kësaj kërkese, në zgjedhjet e fundit lokale, të organizuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), janë zgjedhur anëtarë të kuvendeve komunale, në komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës. Parashtruesit njëkohësisht punojnë si nëpunës civilë në institucione të ndryshme të Republikës së Kosovës.

15. Më 29 gusht 2013, MAP-i me njoftimin, nr. 4278, të 29 gushtit 2013, i kishte informuar të gjithë nëpunësit civilë, përkitazi me të drejtat dhe obligimet sipas Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, të cilët kushtimisht do të dëshironin të kandidonin në zgjedhjet komunale të vitit 2013, të organizuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Republikën e Kosovës.

16. Më 2 dhjetor 2013, parashtruesit, pas përfundimit të zgjedhjeve, janë kthyer në vendet e tyre të punës dhe kanë pranuar pagën mujore për muajin dhjetor. Më pas, siç pohojnë të njëjtët, MAP-i i largoi nga lista e pagave për muajin janar 2014, për shkak të zgjedhjes së tyre si asambleistë të kuvendeve komunale, në komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë që të futen në sistemin e pagave, si nëpunës nga ana e MAP-it, meqë pretendojnë se pa të drejtë janë hequr nga lista e pagave nga muaji janar 2014. Me këtë veprim parashtruesit pretendojnë se u është shkelur e drejta për punë dhe për paga, si dhe e drejta për zgjedhje dhe për t'u zgjedhur.

18. Parashtruesit pretendojnë se largimi i tyre nga lista e pagave për muajin janar 2014 është i paligjshëm. Ata mëtojnë: *"ne parashtruesit e ankesës kemi marr pjese në zgjedhjet e fundit lokale, të cilat u organizuan nga KQZ, në territorin e Republikës*

së Kosovës dhe jemi zgjedhur këshilltarë komunal, dhe ne u përkasim subjekteve të ndryshme politike, por në vendet e punës ku në punojmë, verbalisht na është kumtuar se MAP, na ka larguar nga lista e pagave për muajin janar, pasi qe ne jemi zgjedhur asamblistë komunal, me arsyetimin se ne duhet të heqim dorë nga vendet e punës, ku kemi qenë dhe jemi të punësuar deri me tani".

19. Për më tepër pohojnë: *"shkeljet esenciale të dispozitave procedurale konsistojnë në faktin se, zgjedhjet e fundit lokale janë mbajtur sipas Ligjit Nr. 03/L-072, i cili ligj vlen vetëm për shërbyes civil në Komuna, dhe ne jemi certifikuar nga KQZ-ja. Pra sipas dispozitave të këtij Ligji dorëheqje nga puna duhet të japin vetëm shërbyesit civil qe janë te punësuar në Kuvende Komunale të cilët janë në konflikt interesi. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2010 MAP-Nr. 01/2010 MAPL, neni 2. paragrafi 1, paragrafët prej 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, kur kësaj t'i shtohet edhe Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 17.4, i cili nen thotë, citojmë: Shërbyesit civil, qe janë zgjedhur në zgjedhjet Komunale dhe qendrore kanë të drejtë të aplikojnë dhe të konkurrojnë me kandidatë te tjerë për cilëndo pozitë të lirë në shërbimin civil".*

20. Parashtruesit pohojnë se edhe para këtyre zgjedhjeve lokale kanë qenë të zgjedhur si asambleistë komunalë për disa mandate radhazi, prandaj kërkojnë që edhe tani t'u mundësohet ushtrimi i këtij funksioni, dhe po ashtu të vazhdojnë të punojnë si nëpunës civilë në administratën qendrore.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata para së gjithash vlerëson nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret procedurale të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregulloren e punës të Gjykatës.

22. Parashtruesit në rastin konkret janë persona fizikë, të cilët kërkesën e tyre e bazojnë në nenin 113.7 të Kushtetutës.

23. Në këtë drejtim, neni 113 paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton që:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të*

garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

24. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se, parashtruesit e kërkesës ankohen ndaj vendimit të MAP-it, me të cilin pretendojnë se padrejtësisht janë hequr nga lista e pagave për muajin janar 2014. Parashtruesit janë zgjedhur asambleistë komunalë në komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës dhe janë certifikuar nga KQZ-ja. Ata pretendojnë se heqja e tyre nga lista e pagave në vendet ku kanë punuar është në kundërshtim me ligjin dhe nuk vlen për të njëjtit, por vetëm për shërbyesit civilë të cilët janë në konflikt interesi sipas ligjit.

25. Megjithatë, Gjykata konstaton se parashtruesit e kësaj kërkese kanë dështuar të provojnë se i kanë shteruar mjetet efektive juridike në dispozicion, sipas ligjit në fuqi.

26. Në këtë kontekst, parashtruesit para se të dorëzonin kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese, do të duhej shteruar të gjitha mundësitë në procedurë administrative, përkatësisht të kërkonin zgjidhjen e çështjes së tyre brenda MAP-it dhe më pas në gjykatën kompetente, përkatësisht në Departamentin për çështje Administrative.

27. Gjykata dëshiron të theksojë se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës, apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Ndryshe, parashtruesi është përgjegjës kur rasti i tij/saj shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse ai ose ajo dështon t'i shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo nëse dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Republikës së Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike, përkitazi me shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë (shih, Aktvendimin për papranueshmëri, rasti KI142/13, i 22 tetorit 2013, *Fadil Maloku, kundër Vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës Nr. 686-2013,* të 6 shtatorit 2013).

28. Nga arsyet e shtjelluara më lart, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, pasi që parashtruesit nuk i kanë shteruar mjetet efektive juridike të parapara me ligj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 47.2 të ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) a) të Rregullores, më 26 qershor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI88/14, Medija Smailji, Aktvendim i datës 2 korrik 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ca. nr. 3875/2012, të 31 janarit 2014

Rasti KI88/14, vendimi i 2 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, propozimi për përsëritjen e procedurës, e drejta për punë, përsosja profesionale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesja e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ca. nr. 3875/2012, të 31 janarit 2014, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtrueses së kërkesës *"i është mohuar e drejta për punë"*. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës kërkoi nga Gjykata që të mos zbulohet identiteti i saj.

Parashtruesja e kërkesës, si mjeke specialiste e mjekësisë fizikale dhe e rehabilitimit, gjatë vitit 2001, me qëllim të zhvillimit profesional, e regjistroi subspecializimin në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd. Parashtruesja e kërkesës, nga punëdhënësi i saj, Shtëpia e Shëndetit në Prizren, kërkoi që të aprovojë mungesën nga puna për periudhën e zhvillimit profesional, por kjo kërkesë e parashtrueses së kërkesës ishte refuzuar. Parashtruesja e kërkesës është përpjekur të realizoi të drejtën e saj me anë të gjyqit.

Parashtruesja e kërkesës pretendoi se Gjykata e Apelit e Kosovës gabimisht i ka llogaritur afatet në lidhje me datën kur e ka parashtruar kërkesën për përsëritjen e procedurës. Parashtruesja e kërkesës konsideron që si datë e aplikueshme është dashur të merret data kur ajo e ka parashtruar kërkesën në Zyrën e gjyqtarit të EULEX-it në Prishtinë, dhe thekson si në vijim: *"... kështu që isha e bindur se propozimi për përsëritjen e procedurës do t'i dërgohet Gjykatës Komunale të Prizrenit, gjë që nuk u bë, duke u shkelur kështu Kushtetuta dhe ligji."*

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtrueses Medija Smailji, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ca. nr. 3875/2012, të 31 janarit 2014, në arsyetimin e tij në detaje shpjegon arsyet e refuzimit të kërkesës për përsëritjen e procedurës dhe jep përgjigje në të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me afatet ligjore.

Prandaj, Gjykata konkludoi se faktet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të

drejtave kushtetuese, ashtu që kërkesa e saj është qartazi e pabazuar. Njëkohësisht, Gjykata Kushtetuese e refuzoi kërkesën e parashtrueses për moszbulimin e identitetit të saj si të pabazuar, sepse nuk është ofruar asnjë dokument dhe informacion që do të mbështeste arsyet për moszbulimin e identitetit të parashtrueses së kërkesës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI88/14
Parashtrues
Medija Smailji
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ca. nr. 3875/2012, të 31 janarit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Medija Smailji (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), me vendbanim të përhershëm në komunën e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ca. nr. 3875/2012, të 31 janarit 2014, të cilin parashtruesja e kërkesës e ka pranuar më 7 shkurt 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ca. nr. 3875/2012, të 31 janarit 2014, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, *“i është mohuar e drejta për punë”*.

4. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të mos zbulohet identiteti i saj.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 maj 2014, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI88/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI88/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

8. Më 11 qershor 2014, Gjykata e informoi parashtruesen e kërkesës dhe Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën lidhur me kërkesën e tij për përjashtimin e tij nga seancat e këshillimeve për periudhën qershor – korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë për pretendimet e ngritura kundër tij.

10. Më 2 korrik 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares raportuese Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plot papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesja e kërkesës, si mjeke specialiste e mjekësisë fizikale dhe e rehabilitimit, gjatë vitit 2001, me qëllim të zhvillimit profesional, e regjistroi subspecializimin në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd.

12. Parashtruesja e kërkesës, nga punëdhënësi i saj, Shtëpia e Shëndetit në Prizren, kërkoi që të aprovojë mungesën nga puna për periudhën e zhvillimit profesional, por kjo kërkesë e parashtrueses së kërkesës ishte refuzuar.

13. Shtëpia e Shëndetit në Prizren, me Vendimin e Komisionit disiplinor, nr. 13/15, të 23 janarit 2001, largoi parashtruesen e kërkesës nga puna, ndërsa me Vendimin e drejtorit, nr. 3/61, të 27 nëntorit 2001, u refuzua kërkesa e parashtrueses për t'ia njohur të drejtën e saj për pushim pa pagesë.

14. Parashtruesja e kërkesës, me padinë e paraqitur në Gjykatën Komunale në Prizren, kërkoi që të anulohen si të paligjshme Vendimi i Komisionit disiplinor i Shtëpisë së Shëndetit në Prizren, nr. 13/15, të 23 janarit 2001, dhe Vendimi i drejtorit, nr. 3/61, i 27 nëntorit 2001.

15. Më 24 maj 2005, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktgjykimin P. nr. 64/2005, e refuzoi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës, me të cilën kërkoi që të kthehet në vendin e punës specialist i fiziatrisë, që t'i kompensohen të ardhurat personale që nuk i janë paguar si dhe t'i njihet dhe t'i lejohet pushimi pa pagesë.

16. Më 11 nëntor 2005, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Gž. nr. 340/2005, e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe e aprovoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, P. nr. 64/2005, të 24 majit 2005.

17. Më 21 qershor 2006, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 15/2006, e refuzoi revizionin e parashtrueses së kërkesës, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Gž. nr. 340/2005, të 11 nëntorit 2005.

18. Më 5 qershor 2009, parashtruesja e kërkesës paraqiti propozim për përsëritjen e procedurës pranë Zyrës së EULEX-it në Prizren.

19. Më 22 shkurt 2010, gjyqtari i EULEX-it, në përgjigje Ref. JC/EJU/PrzDC/061/vk/09, e njoftoi parashtruesen e kërkesës si më poshtë:

> *"... dëshirojmë të theksojmë se gjyqtarët e EULEX-it, janë kompetent për rastet të cilat ende nuk janë vendosur nga gjykatat në Kosovë. Me keqardhje, çështja juaj nuk hynë në këtë juridiksion sepse ajo është përfunduar me dt. 21.06.2006. Andaj, gjyqtarët e EULEX-it të Gjykatës së Qarkut në Prizren nuk do të ndërmarrin kurrfarë veprimi."*

20. Më 6 mars 2012, parashtruesja e kërkesës paraqiti propozim për përsëritjen e procedurës në Gjykatën Komunale në Prizren.

21. Më 3 korrik 2012, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktvendimin P. nr. 64/2005, e hodhi poshtë propozimin për përsëritjen e procedurës kontestimore të përfunduar me Aktgjykimin e formës së prerë, P. nr. 64/2005.

22. Më 16 korrik 2012, parashtruesja e kërkesës ushtroi ankesë, me të cilën ka kërkuar që Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prizren, P. nr. 64/2005, i 3 korrikut 2012, të prishet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në përsëritje të procedurës.

23. Më 31 janar 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me Aktvendimin Ca. nr. 3875/2012, e hodhi poshtë propozimin e parashtrueses së kërkesës për përsëritjen e procedurës së përfunduar në Gjykatën Komunale në Prizren, me Aktgjykimin P. nr. 64/2005, të 24 majit 2005, i cili e mori formën e prerë prej 11 nëntorit 2005, me arsyetimin e mëposhtëm:

> *"Nga informacionet e EULEX-it, (Referenca e dt. 22 .02.2010) rezulton se gjyqtarët e EULEX-it, e kanë informuar paditësen se çështja e ngritur nga ajo në bazë të propozimit për përsëritjen e procedurës nuk është kompetencë e Gjykatës së EULEX-it, dhe se në këtë drejtim ajo nuk do të ndërmerr kurrfarë veprimi."*
>
> *"Me nenin 234.3 të LPK-së, është përcaktuar: "Pas kalimit të afatit prej 5 vjetësh nga dita kur vendimi bëhet i formës së prerë, propozimi për përsëritjen e procedurës nuk mund të paraqitet ... ". Në rastin konkret propozimi për përsëritjen e*

procedurës i referohet gjetjes së fakteve dhe provave të reja (dëgjimit të dëshmitares) e që përfaqësojnë bazë për përsëritjen e procedurës konform nenit 232 g) të LPK, Kolegji vlerëson se propozimi për përsëritjen e procedurës i paraqitur nga pala paditëse është jashtë afatit ligjor sepse nga data 11.11.2005 kur aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.64/2005 është bërë i formës së prerë e deri me dt. 06.03.2012 kur paditësja e ka paraqitur propozimin në gjykatën komunale në Prizren, kanë kaluar më tepër se 5 vite."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit e Kosovës gabimisht i ka llogaritur afatet në lidhje me datën kur e ka parashtruar kërkesën për përsëritjen e procedurës. Parashtruesja e kërkesës konsideron që si datë e aplikueshme është dashur të merret data kur ajo e ka parashtruar kërkesën në Zyrën e gjyqtarit të EULEX-it në Prishtinë, dhe thekson si në vijim:

"...kështu që isha e bindur se propozimi për përsëritjen e procedurës do t'i dërgohet Gjykatës Komunale të Prizrenit, gjë që nuk u bë, duke u shkelur kështu Kushtetuta dhe ligji".

"Prandaj është e pabazuar pikëpamja e Gjykatës së Apelit se propozimi për përsëritje të procedurës është paraqitur pas skadimit të afatit prej 5 vjetësh nga dita kur aktgjykimi kishte marrë formë të prerë, duke përmendur datën 06.3.2012, edhe pse është fakt i pamohueshëm se në datën 19.2.2009 kam paraqitur propozim për përsëritje të procedurës, pasi kisha marrë vesh se mjekëve të tjerë të Shtëpisë së Shëndetit të Prizrenit u ishte mundësuar si mungesa me pagesë, ashtu edhe mungesa pa pagesë, pra, në rastin konkret nuk kishte kaluar afati prej 5 vjetësh".

25. Në bazë të asaj që u tha në këtë kërkesë, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese si më poshtë:

"Mua më është mohuar e drejta për punë, e cila garantohet me Kushtetutë. Gjithë këto vite bëjë pyetjen se si është e mundur që për shkak të përsosjes profesionale më bëhet e pamundur të

punoj, prandaj ju drejtohem Juve me këtë propozim – që të konstatoni se propozimi për përsëritje të procedurës është parashtruar brenda afatit dhe që aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me ligjin dhe me konventat ndërkombëtare.“

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesja i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me lig”.

28. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.“

29. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

„(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se

...

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese “.

30. Duke marrë parasysh pretendimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me mënyrën e gabuar të llogaritjes së afateve nga ana e

Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrtohen vendimet e marra nga ana e gjykatave të rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ 1999-I).

31. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit në Kosovë, Ca. nr. 3875/2014, i 31 janarit 2014, në arsyetimin e tij në detaje shpjegon arsyet e refuzimit të kërkesës për përsëritjen e procedurës dhe jep përgjigje në të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me afatet ligjore.

32. Gjykata Kushtetuese thekson që parashtruesja e kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të saj kushtetuese. (shih, *Vanek kundër Republikës Sllovake,* vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).

33. Në këtë rast, parashtrueses së kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesë rastin e saj dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron së është i pasaktë, para Gjykatës Komunale në Prizren, Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe para Gjykatës Themelore në Prizren dhe Gjykatës së Apelit të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në ndonjë mënyrë, kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

34. Përfundimisht, kushtet për pranueshmëri nuk janë plotësuar në këtë kërkesë. Parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të tregojë dhe të mbështesë pretendimet se me aktvendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj kushtetuese.

35. Nga kjo rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës.

36. Sa i përket kërkesës së parashtrueses për moszbulimin e identitetit të saj, Gjykata e refuzon atë si të pabazuar, sepse nuk është ofruar

asnjë dokument dhe informacion që do të mbështeste arsyet për moszbulimin e identitetit të parashtrueses së kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, neneve 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën e parashtrueses për moszbulimin e identitetit së saj;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. paragrafi 4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. Dr. Enver Hasani

KO119/14, Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vendim për masë të përkohshme i datës 23 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001 të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014.

Rasti KO103/14, vendimi i 23 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: deputetët e Kuvendit, interpretimi kushtetues, procedura, zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit, partia politike, koalicioni, masë e përkohshme

Kërkesa është parashtruar nga 30 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilët kontestojnë Vendimin Nr. 05-V-001 të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Kuvendi) si për përmbajtjen ashtu edhe për procedurën e ndjekur gjatë seancës konstituive të Kuvendit, të mbajtur më 17 korrik 2014.

Parashtruesit e kërkesës kërkuan nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, konkretisht të pezullojë procesin konstituiv të Kuvendit deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"Masa e përkohshme është në interes publik sepse mungesa e saj mund të shkaktojë një dëm të pakthyeshëm në funksionimin e institucioneve të Republikës së Kosovës si dhe demokracisë në Republikën e Kosovës"*.

Sa i përket kërkesës për Masë të përkohshme, Gjykata vërejti se kërkesa ishte *prima facie* e pranueshme, pasi është dorëzuar nga më shumë se 10 deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda tetë ditësh nga data e miratimit të vendimit nga Kuvendi, si për përmbajtjen ashtu edhe për procedurën e ndjekur. Prandaj, janë plotësuar kërkesat nga neni 113, paragrafi 5 i Kushtetutës.

Prandaj, Gjykata, në pajtim me nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 2 i Kushtetutës, neni 27 i Ligjit dhe rregulli 55 (4) i Rregullores së punës, gjeti se parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur argumente të mjaftueshme bindëse për miratimin e kërkesës për Masë të përkohshme.

Rrjedhimisht, Gjykata, pa paragjykuar rastin në merita, miratoi kërkesën për Masë të Përkohshme.

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME
në
Rastin nr. KO119/14
Parashtrues
Xhavit Haliti dhe 29 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001 të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga 30 (tridhjetë) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Hashim Thaçi, Xhavit Haliti, Hajredin Kuçi, Enver Hoxhaj, Arsim Bajrami, Memli Krasniqi, Margarita Kadriu-Ukelli, Zenun Pajaziti, Elmi Reçica, Rafet Rama, Ganimete Musliu, Selvije Halimi, Safete Hadërgjonaj, Bekim Haxhiu, Flora Brovina, Fadil Beka, Xhevahire Izmaku, Agim Aliu, Sala Berisha-Shala, Agim Çeku, Besim Beqaj, Raif Qela, Naim Fetahu, Blerta Deliu-Kodra, Mexhide Mjaku-Topalli, Adem Grabovci, Azem Syla, Nuredin Lushtaku, Nezir Çoçaj dhe Kadri Veseli (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës). Në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), parashtruesit e kërkesës e kanë autorizuar z. Xhavit Halitin për t'i përfaqësuar ata.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Vendimin Nr. 05-V-001 të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi) për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si për përmbajtjen, ashtu edhe për

procedurën e ndjekur përkitazi me procesin e konstituimit të Kuvendit, më 17 korrik 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata i kushtetutshmërisë së vendimit të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit, me të cilin z. Isa Mustafa u zgjodh Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e procedurës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç është aplikuar gjatë seancës konstitutive të Kuvendit, të mbajtur më 17 korrik 2014, duke pretenduar se ka shkelje të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës e Kuvendit).

5. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se procedura e e konstituimit të Kuvendit nuk është zhvilluar në pajtim me nenin 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës dhe me Kreun III [Konstituimi i Legjislaturës së Kuvendit] të Rregullores së punës të Kuvendit që përcakton procedurën që duhet ndjekur për konstituimin e Kuvendit.

6. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, konkretisht të pezullojë procesin konstituiv të Kuvendit deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"Masa e Përkohshme është në interes të publikut, sepse mungesa e saj mund të shkaktojë një dëm të pakthyeshëm në funksionimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe demokracinë në Republikën e Kosovës"*.

Baza juridike

7. Parashtruesit e bazojnë kërkesën në nenin 113.5 të Kushtetutës; në nenet 27, 42 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullat 54, 55 dhe 56.3 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 18 korrik 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.

9. Më 21 korrik 2014, në mbështetje të rregullit 33 të Rregullores së punës, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KO119/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KO119/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

10. Gjykata, po ashtu, i referohet njoftimit me shkrim nga gjyqtari Kadri Kryeziu, të 26 qershorit 2014, për përjashtimin e tij nga seancat e këshillimeve për periudhën qershor-korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë lidhur me pretendime të caktuara të ngritura ndaj tij.

11. Më 21 korrik 2014, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës.

12. Të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Presidentes së Republikës së Kosovës, Qeverisë në detyrë të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Qeveria në detyrë), deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit). Këtij të fundit i është kërkuar të dorëzojë në Gjykatë një kopje të transkriptit nga mbledhja konstituive e mbajtur më 17 korrik 2014.

13. Më 23 korrik 2014, pas dëgjimit të gjyqtarit raportues dhe pas diskutimit lidhur me kërkesën për masë të përkohshme të paraqitur nga parashtruesit e kërkesës, Gjykata vendosi të miratojë kërkesën për Masë të përkohshme deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

Përmbledhje e shkurtër e fakteve

14. Më 7 maj 2014, Kuvendi, në seancë të jashtëzakonshme, vendosi për shpërndarjen e legjislaturës së katërt të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

15. Më 8 maj 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës dekretoi zgjedhjet e parakohshme që do të mbaheshin më 8 qershor 2014.

16. Më 8 qershor 2014 u mbajtën zgjedhjet në Republikën e Kosovës.

17. Më 27 qershor 2014, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë: KQZ) publikoi rezultatet e zgjedhjeve.

18. Më 4 korrik 2014, KQZ-ja certifikoi rezultatet e zgjedhjeve.

19. Më 7 korrik 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës vendosi që mbledhja konstitutive të mbahet më 17 korrik 2014.

20. Më 12 korrik 2014, Kryesia e Kuvendit nga legjislatura e mëparshme, mbajti mbledhjen e saj me qëllim përgatitjen e rendit të ditës për mbledhjen konstitutive.

21. Më 17 korrik 2014, Kuvendi mbajti seancën konstituive, të kryesuar nga anëtarja më e vjetër e Kuvendit, znj. Flora Brovina (në tekstin e mëtejmë: Kryesuesja) dhe e ndihmuar nga anëtarja më e re e Kuvendit, znj. Teuta Rugova. Kryesuesja ndoqi këtë procedurë:

    a. Kryesuesja kërkoi nga përfaqësuesit e partive politike të nominonin përfaqësuesit e tyre përkatës për Komisionin ad hoc për verifikimin e kuorumit dhe mandateve të deputetëve;

    b. Komisioni ad hoc i raportoi Kuvendit duke konfirmuar se 120 deputetë ishin të pranishëm në sallë dhe, në bazë të listës së rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve, verifikoi mandatet e Deputetëve;

    c. Kryesuesja kërkoi nga deputetët që të votonin raportin e Komisionit ad hoc që u miratua nga 117 deputetë që votuan për dhe me asnjë votë kundër;

    ç. Kryesuesja kërkoi nga deputetët që të betoheshin, gjë të cilën ata e bënë;

    d. Kryesuesja, në bazë të raportit të Komisionit ad hoc, kërkoi nga përfaqësuesi i partisë politike PDK që të propozonte kandidatin për Kryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe nga tri partitë më të mëdha politike që të propozonin kandidatët e tyre për Nënkryetarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

dh. Kryesuesja e vuri në votim kandidatin e partisë politike PDK, me ç'rast përfaqësuesit e partive politike LDK, VV, AAK, Nisma dhe Lista Srpska braktisën sallën; dhe

e. Kryesuesja e shpalli seancën të përfunduar deri në njoftimin tjetër, sepse nuk kishte kuorum, pra vetëm 47 deputetë ishin të pranishëm.

22. Pastaj, edhe pse seanca konstitutive e Kuvendit zyrtarisht ishte përfunduar nga Kryesuesja, partitë politike LDK, AAK, NISMA, VV dhe deputetët nga pakica serbe (gjithsej 83 deputetë) u kthyen në sallën e Kuvendit ku anëtarja më e re e Kuvendit, deputetja znj. Teuta Rugova, kryesoi mbledhjen me 83 deputetë të pranishëm për të votuar mocionin e paraqitur nga LDK, AAK, Nisma dhe VV duke ndërruar Kryesuesen, deputeten Flora Brovina. Mocioni u miratua me 82 vota për. Me atë rast, deputetja Milka Vuliq, anëtarja e dytë më e vjetër e Kuvendit dhe anëtare e Listës Srpska e vazhdoi kryesimin e mbledhjes që çoi deri te Vendimi Nr. 05-V-001, me të cilin Isa Mustafa u zgjodh Kryetar i Kuvendit me 65 vota për, nga 83 deputetë të pranishëm.

Argumentet e paraqitura nga parashtruesit

23. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se *"Konstituimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur pas zgjedhjeve të mbajtura më 8 qershor 2014, paraqet një rëndësi të madhe për Deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës si dhe ndikon drejtpërdrejtë edhe në formimin e institucioneve tjera demokratike duke përfshirë edhe Qeverinë"*.

24. Megjithatë, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se *"Gjatë përgatitjes për mbledhjen konstituive të legjislaturës së V-të të Kuvendit dhe gjatë mbajtjes se kësaj mbledhje ka pasur shkelje të Kushtetutës dhe Rregullores së Punës së Kuvendit. Gjatë mbledhjes, me datën 12.07.2014, nga kryesuesi i mbledhjes Kryetari i Kuvendit nga legjislatura e mëparshme, z. Krasniqi, pati tejkalim të kompetencave të tij që dalin jashtë mandatit të përcaktuara në Kushtetutë, gjegjësisht interpretimit të tij për Grupin më i madh parlamentar gjegjësisht sipas ish-kryetarit 'Grupi Parlamentar' i formuar me 47 deputetë gjatë procesit të regjistrimit të deputetëve të Legjislaturës së V-të, duhet të ulet në qendër dhe si rrjedhojë ky Grup Parlamentar duhet edhe të*

propozojë Kryetarin e Kuvendit. Sidoqoftë, duke marrë parasysh që 'Grupi Parlamentar LDK-AAK-NISMA' nuk janë certifikuar si Grupi më i madh parlamentar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, siç është përcaktuar në Nenin 15 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / nr. 31 / 15 qershor 2008), veprimi i Kryetarit të Kuvendit nga Legjislatura e IV, që ka autorizuar bashkimin në një Grup Parlamentar të deputetëve të LDK-së, AAK-së dhe NISMA, pa u certifikuar si Grupi më i madh parlamentar, para konstituimit të Legjislaturës së V-të të Kuvendit të Republikës së Kosovës përbën shkelje të Kushtetutës se Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 64 (1) dhe Nenit 67 si dhe Nenit 15 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / nr. 31 /15 qershor 2008). Gjithashtu, veprimet e Kryetarit të Kuvendit nga legjislatura IV, bien ndesh edhe me praktikat e deritanishme që konfirmohen me Transkriptin nga Mbledhja e Kryesisë së Kuvendit me përfaqësuesit e partive parlamentare, të mbajtur më 10.02.2011".

25. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i datës 17 korrik 2014 (Nr. 05-V00 I), për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe procedurën përgatitore e ndjekur në lidhje me procesin e konstituimit të Kuvendit, nuk është në përputhje me Dispozitat e Nenit 67 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në bazë të nenit 67.2 të Kushtetutës, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. K)103/14 të parashtruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së Nenit 84 (14) (Kompetencat e Presidentit) me nenin 95 (Zgjedhja e Qeverisë) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Nr. Ref: AGJ 671/14, 1 korrik 2014), Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar i cili ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend dhe zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit".*

26. Kësisoj, në bazë të neneve të lartpërmendura, neneve 64 dhe 67 të Kushtetutës, Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO103/14, të shkeljes së pretenduar, që pretendohet të ketë ndodhur gjatë procedurës përgatitore për seancën konstituive të Kuvendit dhe gjatë seancës konstituive të mbajtur më 17 korrik 2014, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të përgjigjet në këto çështje:

a. *Të vlerësohet kushtetutshmëria e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës të datës 17.07.2014 (nr. 05-V-001) nëse Kryetari i Kuvendit është propozuar nga grupi më i madh parlamentar sipas nenit 67.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*

b. *Të sqarohet cili është Grupi më i madh parlamentar, që është përcaktuar në Nenin 67 (Paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenin 12 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës (29 prill 2010) gjegjësisht a është Grupi Parlamentar që ka fituara në zgjedhjet për Kuvendin të datës 8 qershor 2014 apo grupimi i cili është formuar gjatë regjistrimit të deputetëve dhe si rrjedhojë: Kush ka të drejtë të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit në mbledhjen Konstituive të Kuvendit?*

c. *Të sqarohet a ka pasur shkelje të Kushtetutës nga Kryetari i Kuvendit nga legjislatura e mëparshme, sipas nenit 67.7. Cilat janë kompetencat e Kryetarit të Kuvendit nga legjislatura e mëparshme gjatë mbledhjes përgatitore të datës 12.07.2014?*

ç. *Pas mbylljes zyrtare të mbledhjes konstituive a ka pas të drejtë që të shkarkohet Kryesuesja e Seancës dhe të vazhdohet me mbajtjen e mbledhjes pa u ftuar anëtarët si dhe duke marrë parasysh këtë dhe hapat që kanë pasuar me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarit të Kuvendit a ka pasur gjatë mbajtjes së mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës a ka pasur shkelje të Kushtetutës dhe Rregullores së Punës së Kuvendit?*

Kërkesa për Masë të përkohshme

27. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, me të cilën pezullohet procesi konstitutiv i Kuvendit deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"Masa e Përkohshme është në interes të publikut, sepse mungesa e saj mund të shkaktojë një dëm të pakthyeshëm në funksionimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe demokracinë në Republikën e Kosovës".*

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 2, të Kushtetutës, që përcakton: *"Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar,*

derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme".

29. Gjithashtu, Gjykata i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, që parashikon:

> *"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; dhe*
>
> *[...]*
>
> *Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".*

30. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkesa është *prima facie* e pranueshme, pasi është dorëzuar nga më shumë se 10 (dhjetë) deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda 8 (tetë) ditësh nga data e miratimit të vendimit nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur. Prandaj, janë plotësuar kërkesat nga neni 113, paragrafi 5, i Kushtetutës.

31. Prandaj, Gjykata, në bazë të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 2, të Kushtetutës, në bazë të nenit 27 të Ligjit, dhe në bazë të rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, gjen se parashtruesit e kërkesës kanë paraqitur argumente të mjaftueshme bindëse për miratimin e kërkesës për Masë të përkohshme.

32. Rrjedhimisht, Gjykata, pa paragjykuar rastin në merita, miraton kërkesën për Masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 116, paragrafi 2 i Kushtetutës, në bazë të nenit 27 të Ligjit dhe në bazë të rregullit 55 (4) dhe 56 (3) të Rregullores së punës.

VENDOS

I. TË MIRATOJË Masën e përkohshme;

II. TË MIRATOJË Masën e përkohshme deri në publikimin e vendimit përfundimtar dhe jo më vonë se 18 shtator 2014 nga nxjerrja e këtij vendimi;

III. TË PEZULLOJË MENJËHERË Vendimin për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 17 korrik 2014;

IV. Kuvendi duhet të përmbahet nga çdo veprim deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës;

V. T'UA KOMUNIKOJË këtë vendim palëve;

VI. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI38/14, Gani Balaj, Aktvendim i datës 26 qershor 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, AC-II-12-0165, të 10 tetorit 2013

Rasti KI38/14, vendimi i 26 qershorit 2014.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, jashtë afatit.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se "Kooperativa Bujqësore *"Përparimi" [...] e ka mbajt arbitrarisht këtë pjesë duke cenuar ligjet në fuqi nga neni 9 dhe 10 të Ligjit të RSFJ me Nr. 6/1980, i aplikueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24 të 12 dhjetorit 1999".*

Parashtruesi më tej pretendon se "[...] bazuar në Ligjin Nr. 6/1980 të RSFJ-së mbi marrëdhëniet juridiko pronësore, neni 37 parasheh "*Mbrojtja e të drejtës së pronës së paluajtshme për parashtrimin e padisë në Gjykatë nuk parashkruhet*". Bazuar në këtë, parashtruesi i kërkesës konsideron se prona ishte okupuar në mënyrë arbitrare nga Komuna dhe se ky ligj është shkelur pa kurrfarë baze juridike.

Gjykata konkludon se kërkesa është jashtë afatit dhe në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b), ajo duhet të deklarohet e papranueshme.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit, me rregullin 36 (1) b) dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 26 qershor 2014, njëzëri deklaron kërkesën të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI38/14
Parashtrues
Gani Balaj
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, AC-II-12-0165, të 10 tetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Gani Balaj, me vendbanim në fshatin Irzniq, komuna e Deçanit (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi i kërkesës) dhe i përfaqësuar nga z. Hasan Shala, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme), AC-II-12-0165, të 10 tetorit 2013, i cili i është dorëzuar atij në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se *"[...] i janë shkelë të*

drejtat themelore të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut (Neni 3 i Konventës)".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 mars 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 1 prill 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 7 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë dokumente shtesë:

   a. Autorizimin për z. Hasan Shala;

   b. Fletëkthesën që tregon datën e dorëzimit të Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme, AC-II-12-0165;

   c. Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme, SCC-07-0425, të 10 dhjetorit 2007.

8. Më 7 maj 2014, Gjykata ua dërgoi Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) nga një kopje të kërkesës.

9. Më 22 maj 2014, parashtruesi i kërkesës iu përgjigj Gjykatës dhe dorëzoi autorizimin dhe Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme, SCC-07-0425, të 20 nëntorit 2007. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar në Gjykatë fletëdërgesën lidhur me datën e dorëzimit të Aktgjykimit AC-II-12-0165, sepse ajo është në Gjykatën Supreme.

10. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi Gjykatën me shkrim për përjashtimin e tij nga seancat e këshillimeve për periudhën qershor – korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë lidhur me pretendime të caktuara të ngritura kundër tij.

11. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI38/14, e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu me gjyqtarin Ivan Čukalović, si anëtar i Kolegjit shqyrtues.

12. Më 26 qershor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Dhomën e Posaçme për të vërtetuar pronësinë mbi pronën.

14. Më 10 dhjetor 2007, Dhoma e Posaçme (Aktvendimi SCC-07-0425) e drejtoi rastin në Gjykatën Komunale në Deçan. Ky aktvendim nuk ishte dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës.

15. Më 23 mars 2009, Gjykata Komunale në Deçan (Aktgjykimi C. nr. 93/07) e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës për vërtetimin e pronësisë mbi pronën, si të pabazuar. Gjykata Komunale konstatoi se *"Me nenin 33 të Ligjit mbi Mardhënjet Themelore Juridiko Pronësore është percaktuar se në bazë të punës së vlefshme juridike fitohet e drejta e pronësisë në palujtshmëri në librin publik ose në mënyrë tjetër përkatëse të përcaktuar me ligj [...]"*. Më tutje thuhet se *"[...] "Palujtshmëria tani kontestuese figuron në emër të të paditurës që nga viti 1956 me reambulim, gjersa padit[si edhe pas aeroinqizirnit si pretendues i të drejtës pronësore në palujtshmërin tani kontestuese, ka pasur afatin e mjaftueshëm kohor që ta kontestoj aeroinqizimin të cilën gjë edhe ne afatin kohor nuk e ka bere"*. Gjykata Komunale konkludon se "*Bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike, [...] se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar[...]"*. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër këtij aktgjykimi.

16. Më 10 tetor 2013, Dhoma e Posaçme (Aktgjykimi AC-II-12-0165) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Deçan. Dhoma e Posaçme konstatoi se:

"Kolegji i Ankesave [Dhoma e Posaçme] konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Deçan nuk është marrë me asnjë shkelje procedurale, për të cilat pretendon paditësi, andaj si i tillë ai është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe Kolegji i Ankesave e vërteton. Me këtë aktgjykim, gjykata ka bërë konstatimin e plotë të gjendjes faktike, me aq sa i është afruar nga paditësi me kërkesëpadi dhe me parashtresat tjera me radhë, sepse barra e të provuarit, konform nenit 7 të LPK-së, bie mbi paditësin.

Me ankesën e tij, paditësi nuk ka afruar ndonjë prove bindëse për kundërshtimet e tij, pos parafrazimit të atyre qe ishin thënë në kërkesëpadi.

Gjykata me këtë aktgjykim ka vërtetuar se prona kontestuese për një kohë të gjatë është në pronësi shoqërore, që do të thotë se pronare e kësaj prone është e paditura. Nëse ka pasur ndonjë cenim të të drejtës eë pronës, ashtu siq pretendon paditësi, nga e paditura, paditësi këtë ka mund ta parashtroj para organeve gjyqësore edhe me herët, por këtë nuk e ka bere asnjëherë, deri ne ngritjen e padisë, më 18 tetor 2007. Kjo heshtje për pengesat eventuale, ka pasojë edhe humbjen e mundësisë për ta kërkuar një të drejtë, edhe nëse ajo ekziston. Në bazë të nenit 268 të Ligjit të Punës së Bashkuar(Gaz. Zyrt e RFSJ-së, 53/65), "nëse pasuria e paluajtshme është bere pasuri publike pa bazë ligjore, mund të ngritet padi për kthimin e saj brenda 5 vjetësh, nga data kur është mësuar për te, por jo më shumë se 10 vjet nga ajo ditë".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Kooperativa Bujqsore "Përparimi" [...] e ka mbajtë arbitrarisht këtë pjesë duke cenuar ligjet në fuqi nga neni 9 dhe 10 të Ligjës së RSFJ me Nr. 6/1980, i aplikueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24 të 12 dhjetorit 1999".*

18. Parashtruesi më tej pretendon se *"[...] bazuar në Ligjin Nr. 6/1980 të RSFJ-së mbi marrëdhëniet juridiko pronësore, neni 37 parasheh "Mbrojtëja e të drejtës së pronës së paluajtshme për parashtrimin e padisë në Gjykatë nuk parashkruhet".* Bazuar në këtë, parashtruesi i kërkesës konsideron se prona ishte okupuar në

mënyrë arbitrare nga Komuna dhe se ky ligj është shkelur pa kurrfarë baze juridike.

19. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Gjykata e shkalles se dytë, Kolegji i Dhomës së Posaqme i ka përsëritur të njëjtat cenime të Ligjes sikurse ajo e shkalles së parë sepse, pa mbajtje të shqyrtimit kryesor dhe pa kërkuar prova plotsuese nga pala paditëse e ka vendosur këtë qështje, kështu që paditësit nuk i është dhen mundësija që plotësisht ta argumentoi kerkesëpadinë para Kolegji të Dhomës së Posaqme të Gjykates Supreme të Kosoves. Aktgjykimi i Dhomës së Posaqme si gjykatë e shkalles se II-të është kontradiktor me arsyetimin e vet, kur e legjitimon dhe e vërteton aktgjykimin e atakuar me te njëjtat cenime të Ligjes të cilat i ka shkaktuar Gjykata e shkalles I-rë ne Deçan"*.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh se *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor […]"*.

22. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) b) i Rregullores së punës parasheh se *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi"*.

23. Gjykata vëren se Aktgjykimi i fundit, AC-II-12-0165, i Dhomës së Posaçme, ishte nxjerrë më 10 tetor 2013 dhe i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës në një datë të pacaktuar, ndërsa parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 3 mars 2014. Parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar në Gjykatë dëshmi se kur i ishte dorëzuar atij aktgjykimi i Dhomës së Posaçme. Prandaj, kjo Gjykatë e konsideron datën e publikimit të vendimit 10 tetorin 2013, si datë të dorëzimit të vendimit te parashtruesi i kërkesës.

24. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është e paafatshme dhe në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b), ajo duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit, me rregullin 36 (1) b) dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 26 qershor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI42/14, PTK-SHA, Prishtinë, Aktvendim i datës 19 maj 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 238/2013, të 7 nëntorit 2013, me kërkesë për aplikimin e Masës së përkohshme.

Rasti KI42/14, vendimi i 19 majit 2014.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi të pabazuar, kërkesa për masë të përkohshme.

Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se aktgjykimi i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë sipas nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenit 46 (E drejta e pronës dhe të drejtat e garantuara me KEDNJ), nenit 6 (E drejta për proces të rregullt) dhe nenit 1 të Protokollit shtesë (Mbrojtja e pronës).

Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata aplikimin e masës së përkohshme, me të cilën Gjykata Supreme e Kosovës do të obligohej të mos shqyrtojë lëndët eventuale me objekt të njëjtë shqyrtimi që mund të vijnë në të ardhmen, derisa të merret vendimi lidhur me këtë kërkesë nga Gjykata Kushtetuese, sepse përndryshe do të cenohej rëndë interesi publik.

Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese apo të drejte të garantuar me KEDNJ, andaj nuk mund të konstatohet se ka cenim të të drejtave të njeriut me vendimin e kontestuar dhe në përputhje me rregullin 36 paragrafi 2 pika b, gjeti se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar.

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe të rregullit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 19 maj 2014, njëzëri deklaron kërkesën të papranueshme si dhe refuzon kërkesën për mase te përkohshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI42/14
Parashtrues
PTK-SHA, Prishtinë
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 238/2013, të 7 nëntorit 2013, me kërkesë për aplikimin e Masës së përkohshme

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Shoqëria Aksionare – Post-Telekomi i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PTK-SHA, Prishtinë), të cilën e përfaqëson z. Lulzim Sokoli, menaxher për çështje legale dhe administratë në PTK.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 238/2013, i 7 nëntorit 2013, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 3 janar 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), sipas nenit 31 (E Drejta për një Proces të Rregullt), lidhur me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

(KEDNJ), nenit 46 e drejta në pronë, si dhe e drejta në pronë sipas nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Neni 113.7 lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 7 mars 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 1 prill 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI42/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI42/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 22 prill 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 19 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 13 dhjetor 2011, parashtruesi ka marrë vendimin për zvogëlimin e të gjitha shpenzimeve operacionale duke përfshirë edhe shpenzimet për personelin në masën prej 20%. Në sektorët e punës ku është zbatuar vendimi, detyrimisht ka ndikuar në uljen e pagave të punëtorëve të parashtruesit. Ky vendim, sipas parashtruesit, ishe marrë në bazë të kërkesës së pronarit të të gjitha aksioneve të ndërmarrjes - Qeverisë së Kosovës, të 7 dhjetorit 2011.

10. Më 11 maj 2012, M. Sh., i punësuar te parashtruesi PTK-SHA – Prishtinë, i goditur nga vendimi i punëdhënësit, ka paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Pejë, duke kontestuar vendimin për ndryshimin e gradës së kategorizimit në punë nga grada 7 në

gradën 6 dhe uljen e pagës së tij së bashku me benificionet që i takonin me pagën si bonuset dhe pagesa e trustit.

11. Më 19 mars 2013, Gjykata Themelore në Pejë ka nxjerrë Aktgjykimin C. nr. 364/12, me të cilin padinë e paditësit M. SH. e ka aprovuar tërësisht si të bazuar.

12. Në arsyetimin e aktgjykimit, në mes të tjerash, Gjykata Themelore e Pejës ka theksuar: *"Gjykata duke vendosur lidhur me ligjshmërinë e vendimit te kontestuar me te cilin vendim paditësit i është ulur grada e te ardhurave personale nga grada 7 ne gradën 6 gjykata duke u mbështetur ne dispozitat e neni 10.1,2, pika 2. I, 10.3, 10.5, II, 55, 56 te Ligjit te Punës me Nr. 03/L-2012, e lidhur me nenin 5 te kontratës se punës, e lidhur me datën 20.10.2011, gjykata erdhi ne përfundim se vendimi i kontestuar është ne kundërshtim me dispozitat ligjore ne fuqi dhe ne kundërshtim me neni 5 te kontratës se punës".*

13. Gjykata Themelore më tej ka potencuar: "*Gjykata konstaton se marrëdhënia e punës është marrëdhënie juridike-kontraktuese ku palët me rastin e lidhjes se një kontrate te tille duhet te respektojnë kushtet e kontratës si tërësi për çka ne rastin konkret gjykata konstaton se kontrata e punës e lidhur ne mese te paditësit dhe te paditurës është lidhur duke u respektuar te gjitha kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës siç janë aftësia punese e palëve kontraktuese, pajtimi i vullnetit te palëve, lënda-objekti i kontratës dhe baza e kontratës"dhe* në këtë drejtim kjo gjykatë gjithashtu ka gjetur se*" konstaton se kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës ka mundur te ndryshohet vetëm me vullnetin e shprehur të të dyja palëve dhe se e paditura nuk ka mundur t'i ndryshoj kushte t e kontratës vetëm me shprehjen e njëanshme te vullnetit te saj".*

14. Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës në afatin ligjor ka bërë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

15. Më 12 korrik 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës nxori Aktgjykimin Ac. nr. 1447/13, me të cilin pranohet ankesa e parashtruesit, ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C. nr. 364/12, i 19 marsit 2013, në atë mënyrë që ankesa e paditësit M. SH. refuzohet si e pabazuar.

16. Duke kontestuar arsyetimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Gjykata e Apelit, në mes të tjerash ka theksuar: ” *Kjo gjykatë ka vlerësuar përfundimin* e *këtillë te gjykatës* se *shkallës* se *parë dhe ka gjetur* se *një vendim dhe qëndrim* i *tille juridik nuk mund te pranohet* si i *drejte dhe* i l*igjshëm nga se, sipas vlerësimit te kësaj gjykate, mbi gjendjen* e *tille faktike gabimisht është zbatuar* e *drejta materiale, kur ajo, gjykata* e *shkollës* se *parë, ka gjetur* se *kërkesëpadia* e *goditësit është* e *bazuar.”*

17. Gjykata e Apelit, më tej, duke arsyetuar aktgjykimin e saj, ka potencuar:

> “*Kjo,* veç *tjerash edhe për faktin* se e *paditura ka vepruar në përputhje të plotë* me *vendimin* e *aksionarit – Qeverisë* së *Republikës* së *Kosovës, përkatësisht të Ministrisë* se *Zhvillimit Ekonomik,* e *cila kishte rekomanduar reduktimin* e *shpenzimeve për personelin* e se *goditurës (PTK-se), duke u bazuar në politikat* e *brendshme, ne pajtim* me *to* si *dhe ne pajtim* me *planin* e *biznesit për vitin* 2012, si *kundër edhe vendimit te bordit të drejtorëve* të *datës* 13. 12.2011, e me *qellim te uljes se shpenzimeve te stafit ne maksimum* 20% *të të hyrave te përgjithshme,* e *krejt kjo u muar vesh duke iu referuar vendimit te aksionarit - Ministrisë* së *Zhvillimit Ekonomike te datës* 06.12.2011 *etj”.*

18. Më 17 nëntor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas revizionit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nga M. SH. nxori Aktgjykimin Rev. nr. 238/2013, me të cilin ia pranoi revizionin paditësit dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1447/13, të 12 korrikut 2013, duke vendosur që në fuqi të mbetet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C. nr. 364/12, i 19 marsit 2013.

19. Në arsyetim të aktgjykimit, “*Gjykata Supreme i ka vlerësuar si të bazuara thëniet e revizionit se aktgjykimi i goditur është ne kundërshtim me nenin 55 par. 1 të Ligjit te punës (Gazeta zyrtare 03-L-212 -te RK) ku është përcaktuar se i punësuari ka të drejtë ne pagë e cila caktohet me kontratë të punës e ne pajtim me ketë Ligj, kontratën, kolektive dhe aktin e brendshëm te punëdhënësit. Paga e paditësit sipas kontratës se punës ka qene në gradën 7-të dhe ulja nën ketë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe ligjit”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se aktgjykimi i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë sipas nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenit 46 (E drejta e pronës dhe të drejtat e garantuara me KEDNJ), nenit 6 (E drejta për proces të rregullt) dhe nenit 1 të Protokollit shtesë (Mbrojtja e pronës).

21. Parashtruesi i mbështet pretendimet e tij për shkeljet e dispozitave kushtetuese dhe të KEDNJ-së në argumentet vijuese:

Shkelja e pretenduar e nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ

E drejta për një proces të rregullt dhe të paanshëm, sipas parashtruesit të kërkesës, me aktgjykimin e kontestuar i është shkelur, sepse Gjykata Supreme ka dhënë një arsyetim tërësisht kontradiktor me arsyetimin e dhënë në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, dhe se kjo çmuarje tërësisht e kundërt e gjendjes faktike dhe e aplikimit të së drejtës materiale nga dy gjykata kanë rezultuar me shkeljen e pretenduar të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, sepse sipas parashtruesit, është cenuar njëra nga garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së, e drejta në vendim të arsyetuar.

Parashtruesi më tej ka kërkuar nga Gjykata që prej – Qeverisë së Kosovës, si pronare e Aksioneve të PTK-së, të kërkojë sqarim zyrtar nëse kërkesa e saj për ulje të shpenzimeve operative për 20% i referohet edhe uljes së shpenzimeve për personelin.

Shkelja e pretenduar e nenit 46 të Kushtetutës lidhur me nenin 1 të protokollit shtesë të KEDNJ

E drejta e pronës, e garantuar me Kushtetutë dhe me Protokollin shtesë të KEDNJ-së, sipas pohimeve të parashtruesit, është shkelur, sepse *"arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme e Kosovës nuk korrespondon me gjendjen reale të fakteve"*. Aktgjykimi i kontestuar në mënyrë të paligjshme dhe arbitrare parashtruesen e ka privuar nga prona e saj.

22. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata aplikimin e masës së përkohshme, me të cilën Gjykata Supreme e Kosovës do të obligohej të mos shqyrtojë lëndët eventuale me objekt të njëjtë shqyrtimi që mund të vijnë në të ardhmen, derisa të merret vendimi lidhur me këtë kërkesë nga Gjykata Kushtetuese, sepse përndryshe do të cenohej rëndë interesi publik.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës të Gjykatës.

24. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

25. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
> *c) Kërkesa është qartas e bazuar*

26. Në vlerësimin e pretendimeve të ngritura nga parashtruesi, Gjykata vëren që ai e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 238/2013, të 17 nëntorit 2013, me të cilin Gjykata vendosi lidhur me revizionin e parashtruar nga M. SH., një punëtor i parashtruesit.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe të KEDNJ-së lidhur me rastin

27. Gjykata me këtë rast përkujton se Kushtetuta e Kosovës dhe KEDNJ-ja, në dispozitat e kontestuara nga parashtruesi, përcaktojnë:

> *Neni 31 i Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]*
>
> *1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

[...]

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

[...]

Neni 6 .1 i KEDNJ

E drejta për një proces të rregullt

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Neni 1 i Protokollit shtesë i KEDNJ-së, Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cënojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

28. Për të vendosur në mënyrë meritore lidhur me kërkesën, Gjykata gjithashtu merr parasysh dispozitat e Ligjit për gjykatat, 2010/03-L-199, të dekretuar më 9 gusht 2010, ku është përcaktuar se:

Neni 21, Gjykata Supreme

1. Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë dhe ka jurisdikcion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

[...]

dhe

Neni 22, Kompetencat e Gjykatës Supreme

1.3. përcakton qëndrimet parimore dhe mendimet juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës.

[...]

29. Duke vlerësuar kushtetutshmërinë e aktgjykimit të kontestuar në prizmën e pretendimeve për shkelje kushtetuese dhe fakteve që kanë mbështetur këto pretendime, duke i krahasuar këto fakte me përmbajtjen e dispozitave si më sipër, Gjykata konstaton se nuk gjeti argumente që të kenë ndodhur shkelje të dispozitave kushtetuese dhe të KEDNJ-së, aq më tepër kur këto pretendime që janë mbështetur në "*konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*" në argumente të zbatimit të ligjshmërisë dhe jo kushtetutshmërisë si dhe në pakënaqësinë evidente lidhur me rezultatin final të procesit gjyqësor.

30. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se përshkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, dhe konstatimi se ato janë shkelur, pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, pa përcaktuar rrethanat, pa specifikuar veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me gjykimin e drejtë e të paanshëm, nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së lidhur me një proces të rregullt dhe të paanshëm.

31. Gjykata më tej konstaton se ajo nuk është gjykatë e faktit, nuk gjykon si gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk është thjesht një instancë gjyqësore më tepër. Gjykata në parim nuk gjykon faktin

nëse gjykatat e rregullta drejt dhe në mënyrë të plotë e kanë konstatuar gjendjen faktike. Për Gjykatën, janë thelbësore çështjet prej ekzistimit të të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të të drejtave kushtetuese dhe jo çështjet qartazi ligjore që kryesisht kanë qenë fakte të paraqitura nga parashtruesi (shih, *mutatis mutandis, i. a., Akdivar kundër Turqisë,* 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

32. Lidhur me si më sipër, Gjykata thekson se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të rregullt të vendosin për renditjen e rëndësisë së provave dhe të çmojnë se cila provë në vështrim të zbatimit të drejtë të ligjit në fuqi ka përparësi, sikur që në rastin konkret pa dyshim se i ka takuar Gjykatës Supreme të vendosë sa është i drejtë qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë apo i asaj të Apelit dhe këtë ta sanksionojë me vendim të saj përfundimtar gjyqësor.

33. Kjo aq më tepër kur merret parasysh se Kushtetuta e Kosovës, në nenin 103.2, ka përcaktuar se Gjykata Supreme është autoriteti më i lartë gjyqësor, ndërsa Ligji për gjykatat, Gjykatës Supreme i ka dhënë kompetencë "*zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës"* dhe rrjedhimisht edhe unifikimin e praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta.

34. Në këtë drejtim, Gjykata nuk gjeti se arsyetimet e ndryshme të gjykatave të dy instancave gjyqësore kanë rezultuar me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse aktgjykimi përfundimtar i Gjykatës Supreme ka përmbyllur vlerësimin edhe të gjendjes faktike, edhe të aplikimit të ligjshmërisë, dhe në asnjë mënyrë gjykata nuk ka mundur të gjejë që të jetë shkelur *e drejta për një vendim të arsyetuar* si një nga garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së e të drejtës për gjykim të rregullt e të paanshëm.

35. Për më tepër, Gjykata rikujton se GJEDNJ-ja, gjatë praktikës së vet gjyqësore, ka vlerësuar se detyrimi që ka një gjykatë vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Detyrimi për të arsyetuar vendimin varet nga natyra e vendimit në fjalë. Kur Gjykata Supreme nuk pranon një ankesë për shkak se nuk është parashtruar baza ligjore e çështjes, kërkesat e nenit 6 të Konventës mund të plotësohen me një arsyetim shumë të kufizuar (shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet *Marini kundër Shqipërisë*, 18 dhjetor 2007 §105 dhe *Mishgjoni kundër Shqipërisë,* 7 dhjetor 2010).

36. Gjykata, më tej, në përgjigje të pretendimit për shkelje të së drejtës së pronës, konstaton se nuk mund të gjejë fakte se parashtruesi është privuar nga prona në mënyrë arbitrare, përkundrazi çështja kontestuese në mes të palëve është zgjidhur nga një "*gjykatë e themeluar me ligj*" dhe në një proces gjyqësor të paraparë me ligj, andaj një vendim gjyqësor i nxjerrë në kushte të tilla nuk mund të cilësohet nga kjo gjykatë si arbitrar, aq sa të jetë tregues i shkeljes së pretenduar.

37. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese apo të drejte të garantuar me KEDNJ, andaj nuk mund të konstatohet se ka cenim të të drejtave të njeriut me vendimin e kontestuar dhe në përputhje me rregullin 36 paragrafi 2 pika b, gjeti se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar.

Kërkesa për Masë të përkohshme

38. Duke marrë parasysh faktin se kërkesa në tërësi shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar, Gjykata gjeti se kjo kërkesë duhet refuzuar, sepse aplikimi i kësaj mase në formën çfarë është kërkuar nga parashtruesi, do të mbetej jolëndor dhe tërësisht i pabazë.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe të rregullit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 19 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI45/14, Faton Sefa, Aktvendim i datës 1 korrik 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 60/2013, të 13 nëntorit 2013.

Rasti KI 45/14, vendim i 1 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, cenim i të drejtave dhe lirive kushtetuese neni 31, 46, 49, 53 dhe 102, kërkesa e papranueshme.

Parashtruesi Z. Faton Sefa ka parashtruar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 60/2013, të 13 nëntorit 2013, si të marrë me shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim te Drejtë dhe të Paanshëm], neni 46 [Mbrojtja e Pronës], neni 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit], neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]. Parashtruesi pretendon se shkëputja e kontratës së punës së tij ishte në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/27, sepse ai kurrë nuk kishte pasur takim me ndërmarrjen dhe me shkëputjen e marrëdhënies së punës nuk ishte saktësuar cilat dispozita ligjore ishin shkelur nga ai.

Sa i përket çështjes së pranueshmërisë së Kërkesës, Gjykata theksoi që në bazë të gjuhës së përdorur në nenin 113.7, kërkesa ishte e papranueshme. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme e kishte arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme Aktvendimin e saj (Rev. nr. 60/2013), kur e kishte refuzuar revizionin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës. Prandaj, Gjykata nuk mund të konstatojë se procedurat përkatëse kishin qenë në ndonjë mënyrë të pa drejta apo arbitrare. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka siguruar dëshmi shtesë se të drejtat dhe liritë themelore të tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI45/14
Parashtrues
Faton Sefa
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 60/2013,
të 13 nëntorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Faton Sefa, me vendbanim në Gjakovë, i përfaqësuar nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 60/2013, të 13 nëntorit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 13 dhjetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), respektivisht neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 46 [Mbrojtja e Pronës], neni 49 [E Drejta e

Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit], neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të

4. Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), respektivisht neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe neni 1 (Mbrojtja e Pronës) i Protokollit 1.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 11 mars 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën KI45/14 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 1 prill 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

8. Më 7 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta dorëzojë autorizimin dhe të sigurojë disa sqarime lidhur me kërkesën, respektivisht, marrëdhënien me kërkesat e mëparshme KI75/12 dhe KI37/13. Të njëjtën ditë, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 16 maj 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi autorizimin, pa ofruar ndonjë sqarim shtesë.

10. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi Gjykatën me shkrim për përjashtimin e tij nga këshillimet për periudhën qershor – korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë lidhur me pretendime të caktuara, të ngritura kundër tij.

11. Më 1 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI45/14, e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu me gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi, si anëtare të Kolegjit shqyrtues.

12. Më 1 korrik 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Baza faktike e kërkesës KI45/14 është e njëjtë me atë të kërkesave KI75/12 dhe KI37/13, gjithashtu të dorëzuara në Gjykatë nga parashtruesi i kërkesës.
14. Shumica e fakteve kanë të bëjnë me çështjen e ndërprerjes së kontratës së punës më 18 gusht 2006 në mes të ndërmarrjes "Hidrosistemi Radoniqi" në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Ndërmarrja) dhe parashtruesit të kërkesës.

15. Kjo çështje ishte objekt i shqyrtimit në procedura administrative dhe gjyqësore në gjykatat e rregullta, respektivisht deri më 2 maj 2012.

16. Më 2 maj 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 106/2010) e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion. Gjykata Supreme konstatoi se *"[...] marrëdhënia e punësimit të paditësit është ndërprerë në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligjin në fuqi, andaj çdo pretendim në revizion mbi këtë bazë është i papranueshëm".*

17. Sidoqoftë, në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën për përsëritje të procedurës së përfunduar me Aktgjykimin Ac. nr. 176/2009 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 9 shkurtit 2010.

18. Në ndërkohë, më 13 gusht 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën KI75/12, duke e kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, i cili pretendohej t'i ketë injoruar shkeljet procedurale në komisionin disiplinor.

19. Më 13 dhjetor 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë (Aktvendimi KAC. nr. 6/2012) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për përsëritje të procedurës në Gjykatën e Qarkut në Pejë, të përfunduar me Aktgjykimin Ac. nr. 176/2009 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 9 shkurtit 2010. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme.

20. Ndërkohë, më 15 janar 2013, Gjykata e deklaroi kërkesën KI75/12 të papranueshme, si qartazi të pabazuar (shih Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin KI75/12, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 106/2010, të 2 majit 2012).

21. Më 13 mars 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën KI37/13, duke kërkuar rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese në Rastin KI75/12, me pretendimin se Gjykata nuk i ka shqyrtuar dëshmitë shtesë, të dorëzuara prej tij.

22. Më 31 maj 2013, Gjykata Kushtetuese e deklaroi kërkesën KI37/13 të papranueshme, sepse Gjykata tashmë ka vendosur për rastin në kërkesën KI75/12 (shih Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI37/13, Kërkesë për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. KI75/12, të 15 janarit 2013).

23. Më 13 nëntor 2013, Gjykata Supreme (Aktvendimi Rev. nr. 60/2013) e refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, KAC. Nr. 6/2012, të 13 dhjetorit 2012. Gjykata Supreme konstatoi se *"gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejt kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se propozimi për përsëritjen e procedurës është i pabazuar nga se fakti gjegjësisht prova në të cilën paditësi e ka mbështetur propozimin për përsëritjen e procedurës, nuk paraqet provë të re në bazë të së cilës për palën mund të merrej vendim më i favorshëm po të ishte përdorur në procedurat e mëparshme".*

24. Referenca në faktet e përshkruara më lart dhe vendimet e cituara janë marrë nga kërkesat e mëparshme, KI75/12 dhe KI37/13, pasi që sqarimet shtesë nuk ishin siguruar nga parashtruesi i kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Si në kërkesat e mëparshme të dorëzuara në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimet e gjykatave të rregullta ishin marrë me shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, sepse edhe Gjykata e Qarkut në Pejë, e edhe Gjykata Supreme, pretendohet t'i kenë injoruar shkeljet procedurale në procedurën disiplinore.

26. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se shkëputja e kontratës së punës së tij ishte në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/27, sepse ai kurrë nuk kishte pasur takim me ndërmarrjen dhe me shkëputjen e marrëdhënies së punës nuk ishte saktësuar cilat dispozita ligjore ishin shkelur nga ai.

27. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *"të shqyrtojë se me provat e ekzaminuara para gjykatës së shkallës së parë, ajo Gjykatë në mënyrë të drejte ka vepruar, ka aplikuar ligjin dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe se procedurat para Gjykatës së shkallës së parë në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkese në atë fazë të procedurës të ketë pasur gjykim të drejtë, për kundër shkeljeve të parimeve të tilla nga Gjykata e Qarkut në Pejë dhe Gjykata Supreme e Kosovës ne Procedurën e revizionit"*.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

30. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (3) e) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*
>
> *(...)*
>
> *e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri;*

31. Gjykata vëren se shkëputja e kontratës është objekti i përbashkët i çështjes së tri kërkesave, të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, edhe pse janë dy aktgjykime të Gjykatës Supreme, njëri për revizion (Aktgjykimi Rev. nr. 106/2010) dhe tjetri për përsëritjen e procedurës (Aktvendimi Rev. nr. 60/2013).

32. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e ri në baza kushtetuese dhe nuk ka siguruar dëshmi shtesë se të drejtat dhe liritë themelore të tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

33. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme e kishte arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme Aktvendimin e saj (Rev. nr. 60/2013), kur e kishte refuzuar revizionin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës. Prandaj, Gjykata nuk mund të konstatojë se procedurat përkatëse kishin qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* Vendim i GJEDNJ-së për papranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

34. Gjykata më tej vëren se në kërkesën KI45/13, parashtruesi nuk ka bërë ndonjë referencë në kërkesat e dorëzuara më parë, përkatësisht kërkesat KI75/12 dhe KI37/13, që tashmë janë vendosur nga Gjykata. Një sjellje e tillë nuk është në pajtim me të drejtën e individit për peticion, sipas standardeve juridike evropiane (shih, *mutatis mutandis*, *Hadrabova dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri nr. 42165/02 dhe nr. 466/03, të 25 shtatorit 2007)·

35. Për më tepër, Gjykata përsërit se parashtruesi i kërkesës është i obliguar që ta njoftojë Gjykatën për të gjitha rrethanat relevante në lidhje me kërkesën dhe të mos mbajë ndonjë informatë që ka në dijeni. Përndryshe, ruajtja apo vënia e Gjykatës në lajthitje, mund të ngrejë çështjen e keqpërdorimit të së drejtës për peticion.

36. Gjykata më tej vëren se lidhur me kërkesat KI75/12 dhe KI37/13, parashtruesi i kërkesës e kishte pasur rastin të njoftohej me procedurën e Gjykatës. Për më tepër, vendimet e Gjykatës për papranueshmërinë e kërkesave të tij të mëparshme do të duhej ta kishte vetëdijesuar atë se kërkesa KI45/13 në thelb ka të bëjë me të njëjtin objekt të çështjes, tanimë të shqyrtuar nga Gjykata në kërkesat KI75/12 dhe KI37/13 dhe se nuk është paraqitur asnjë informatë e re dhe e rëndësishme.

37. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se një vendim lidhur me çështjen në fjalë tanimë është nxjerrë nga Gjykata dhe parashtruesi i kërkesës nuk ka siguruar bazë të mjaftueshme për një vendim të ri.

38. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme (shih Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI75/12, të 2 majit 2012, dhe Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI37/13, të 15 janarit 2013).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, rregullin 36 (3) e) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 1 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. Dr. Enver Hasani

KI81/14, Avni Zogaj, Aktvendim i datës 2 korrik 2014 – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 28/2014, të 2 prillit 2014

Rasti KI81/14, vendimi i 2 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, zbutja e jashtëzakonshme e dënimit, vepër penale, dënimi, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 28/2014, të 2 prillit 2014, me të cilin, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës *"e drejta e tij për zbutje të dënimit i është humbur"*.

Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, me propozim që *"kërkesa të aprovohet dhe aktgjykimi i formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës, AP. nr. 212/2006 të 27 shtatorit 2006, të ndryshohet dhe të dënuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë"*. Më 2 prill 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Pzd. nr. 28/2014, e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, të shqiptuar me Aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës, AP. nr. 212/2006 të 27 shtatorit 2006.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Avni Zogaj, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 28/2014, i 2 prillit 2014, në arsyetimin e tij, shpjegon në detaje arsyet për refuzimin e kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe u jep përgjigje të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.

Prandaj, Gjykata konkludoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese, ashtu që kërkesa e tij është qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI81/14
Parashtrues
Avni Zogaj
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 28/2014, të 2 prillit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Avni Zogaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili është duke e vuajtur dënimin me burg në Qendrën Korrektuese në Dubravë, komuna e Istogut.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 28/2014, të 2 prillit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 28/2014, të 2 prillit 2014, me të cilin, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, "*e drejta e tij për zbutje të dënimit duke u thirrur në ligj, i është humbur nga gjyqtarët dhe prokurorët*".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 8 maj 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI81/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI81/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

7. Më 11 qershor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën lidhur me kërkesën e tij për përjashtimin e tij nga seancat e këshillimeve për periudhën qershor – korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë për pretendimet e ngritura kundër tij.

9. Më 2 korrik 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares raportuese Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 6 shkurt 2006, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin P. nr. 61/2004, e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale të vrasjes dhe mbajtjen në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe i shqiptoi dënim unik prej 17 (shtatëmbëdhjetë) vjetësh burgim.

11. Më 27 shtator 2006, me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, AP. nr. 212/2006, aprovohet pjesërisht ankesa e parashtruesit të kërkesës dhe ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. nr. 61/2004, i 6 shkurtit 2006, lidhur me vendimin për dënim, ashtu që parashtruesit të kërkesës iu shqiptua dënimi unik prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjetësh burgim.

12. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, me propozim që "*kërkesa të aprovohet dhe aktgjykimi i formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës, AP. nr. 212/2006 të 27 shtatorit 2006, të ndryshohet dhe të dënuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë*".

13. Më 2 prill 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Pzd. nr. 28/2014, e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, të shqiptuar me Aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës, AP. nr. 212/2006, të 27 shtatorit 2006, me arsyetimin si në vijim:

> *"Disa nga rrethanat e cekura për kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit si ajo se është familjar, mbajtës i vetëm i familjes, baba i dy fëmijëve njeri prej të cilëve është me aftësi të kufizuara, se për fëmijët përkujdeset nëna e të dënuarit e cila ka probleme shëndetësore, kanë qenë të njohura për gjykatat. Rrethana e re e pretenduar në kërkesë se kujdestarja-gjyshja e fëmijëve është në gjendje të vështërsuar shëndetësore si dhe udhëzimi për hulumtime diagnostike, nuk vërtetojnë gjendjen e paqëndrueshme shëndetësore e as paaftësinë e saj që të jetë kujdestare e fëmijëve të djalit të saj të dënuarit Avni Zogaj. Rrethana e re e pretenduar në kërkesë, gjendja shëndetësore e kujdestares së fëmijëve Rahime Zogaj dhe pamundësia e saj për përkujdesjen ndaj fëmijëve, nuk është e natyrës së tillë që konform dispozitës së nenit 429 të KPPK, të merret si bazë për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë, çka do të thotë se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i bazuar".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"për të katërtën herë më refuzohet kërkesa për zbutje të dënimit, është më se e saktë se*

realisht e saktësisht ekzistojnë rrethana të reja për zbutje të dënimi, gjykatësit dhe prokurorët e shtetit janë të thirrur që të mbrojnë ligjin për të cilin janë betuar para shtetit dhe para zotit, por jo që të shkelin ligjin vetëm se një qytetar si unë e ka thyer ligjin është dënuar duke u thirrur në ligj nga ana e gjykatësve dhe prokurorve dhe ma humbin të drejtën për zbutje të dënimit duke u thirrur në po të njëjtin ligj.“

15. Duke u bazuar në çka është thënë në kërkesë, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që *“të shiqoni lëndën, të shiqoni faktet, ankesat, propozimet, refuzimet dhe të shifni se a egziston betimi i dhënë përzemërsisht (mendohet në gjyqtarë dhe prokurorë), apo është sipërfaqësorë”.*

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

18. Gjykata i referohet gjithashtu nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

19. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

„(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

...

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

20. Pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit për shkelje lidhur me *"humbjen e së drejtës së tij për zbutje të dënimit duke u thirrur në ligj nga gjyqtarët dhe prokurorët",* Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr 30544/996, par. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1990-I).

21. Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd. nr. 28/2014, i 2 prillit 2014, në arsyetimin e tij, shpjegon në detaje arsyet për refuzimin e kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe u jep përgjigje të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.

22. Gjykata Kushtetuese thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih *Vanek kundër Republikës Sllovake*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

23. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë para Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse, në çfarëdo mënyre kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064, i 30 qershorit 2009).

24. Përfundimisht, kushtet për pranueshmëri nuk janë përmbushur në këtë kërkesë. Parashtruesi i kërkesës ka dështuar të tregojë dhe të dëshmojë se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.

25. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI90/14, Rrahim Preteni, Aktvendim i datës 2 korrik 2014, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 1067/13, të 17 janarit 2013

Rasti KI 90/14, vendimi i 2 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest civil, e drejta në punë, kërkesë qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit, me Aktvendimin e saj, Ac. nr. 1067/2013, të dhënë në procedurë përmbarimore, ka shkelur të drejtën e tij për kthimin në vendin e punës. E gjithë kjo, për faktin se e njëjta refuzoi lejimin e përmbarimit të Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001, që ishte aprovuar me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 273/2002, të 7 majit 2002 dhe me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 142/2001, të 26 prillit 2002. Ai pretendonte se Gjykata e Apelit, refuzimin e lejimit të propozimit për përmbarim e bazoi në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 80/2002, me të cilin u aprovua revizioni i ABK-së dhe u refuzua kërkesëpadia e parashtruesit. Sipas parashtruesit, Gjykata e Apelit e refuzoi propozimin e parashtruesit për përmbarim edhe përkundër faktit se aktvendimi i gjykatës së instancës së parë ishte bërë i plotfuqishëm dhe përfundimtar.

Pas vlerësimit te pretendimeve te parashtruesit, Gjykata konsideroi se, pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, nuk paraqesin bazë të mjaftueshme kushtetuese për aprovimin e kërkesës së tij, si të pranueshme. Për më tepër, Gjykata nuk mund të vepronte si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me aktvendimin e nxjerrë nga Gjykata e Apelit. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Përkitazi me këtë, Gjykata mutatis mutandis iu referua rastit Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, § 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1. Gjykata, gjithashtu konsideroj se procedurat e zhvilluara në Gjykatën e Apelit nuk ishin të njëanshme, të padrejta apo arbitrare.

Si përmbledhje, Gjykata konkludoi se, kërkesa e parashtruesit, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe të rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, ishte qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI90/14
Parashtrues
Rrahim Preteni
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 1067/13, të 17 janarit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Rrahim Preteni, me vendbanim në fshatin Melenicë, komuna e Mitrovicës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 1067/13, të 17 janarit 2013 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), të cilin e ka pranuar më 3 shkurt 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1067/13, të 17 janarit 2013, me të cilin parashtruesi pretendon se i është shkelur e drejta në punë.

Baza juridike

4. Baza juridike për këtë rast është: neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 dhe 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 maj 2014 parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 10 maj 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI90/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI90/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 10 qershor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe po ashtu informoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kësaj kërkese.

8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese për periudhën qershor-korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.

9. Më 26 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI90/14, zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu, si gjyqtar raportues të rastit, dhe në vend të tij caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi.

10. Më 2 korrik 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Faktet në procedurë civile

11. Më 25 qershor 2001 Gjykata Komunale në Mitrovicë (Aktgjykimi, C. nr. 22/2001) aprovoi, si të bazuar, kërkesëpadinë e parashtruesit, të ngritur kundër të padituritAutoriteti Bankar i Kosovës, dega në Mitrovicë (në tekstin e mëtejmë: ABK). Me këtë aktgjykim është detyruar ABK-ja që ta kthejë parashtruesin në

vendin e punës dhe t'ia kompensojë pagat e humbura, prej 31 gushtit 2000 deri në ditën e kthimit të tij në punë.

12. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, ABK-ja, në afat ligjor, ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

13. Më 26 prill 2002, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë (Aktgjykimi, AC. nr. 142/2001) e refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruar nga ABK-ja dhe e vërtetoi në tërësi aktgjykimin e gjykatës së instancës së parë.

14. ABK-ja, kundër aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, ka ushtruar revizion në Gjykatën Supreme.

15. Më 26 nëntor 2002, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Rev. nr. 80/2002) e aprovoi revizionin e ushtruar nga ABK-ja dhe i ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, për faktin se të njëjtat në mënyrë të gabuar aplikuan ligjin material.

16. Më 28 janar 2003, parashtruesi, kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme, në të njëjtën gjykatë, ushtroi kërkesë për përsëritjen e procedurës, për shkak të mosmarrjes parasysh të fakteve relevante të kërkesëpadisë së tij dhe për shkak të vendosjes së rastit pa zhvilluar seancë shqyrtuese.

17. Më 22 maj 2007, Gjykata Supreme (Aktvendimi, PPC. nr. 2/2006), refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për përsëritjen e procedurës. Refuzimin e kërkesës për përsëritjen e procedurës, gjykata në fjalë e kishte arsyetuar duke u bazuar në faktin se e njëjta kishte vendosur me revizion në bazë të nenit 391 të LPK-së, sipas të cilit nen, gjykata për revizion vendos pa zhvilluar seancë shqyrtuese.

Faktet në procedurë përmbarimore

18. Më 23 maj 2002, parashtruesi, në cilësinë e kreditorit, në Gjykatën Komunale në Mitrovicë, ushtroi propozim për përmbarimin e Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001.

19. Më 7 qershor 2002, Gjykata Komunale në Mitrovicë (Aktvendimi, E. nr. 273/2002), aprovoi propozimin e parashtruesit për përmbarimin e Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001,

me të cilin u detyrua ABK-ja (debitori) që ta kthejë në punë parashtruesin dhe t'ia kompensojë të gjitha pagat e humbura, nga dita e largimit deri në kthimin definitiv të tij në vendin e punës.

20. Më 17 qershor 2002, ABK-ja ushtron kundërshtim kundër Aktvendimit E. nr. 273/2002, me të cilin u lejua përmbarimi i Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001.

21. Më 12 korrik 2002, Gjykata Komunale në Mitrovicë (Aktvendimi, E. nr. 273/2002) refuzoi, si të pabazuar, kundërshtimin e ushtruar nga ABK-ja.

22. Më pas, ABK-ja, kundër Aktvendimit E. nr. 273/2002, të 12 korrikut 2002, në afat ligjor, ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, duke kërkuar pezullimin e Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001, të gjykatës së instancës së parë.

23. Më 17 qershor 2005, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë (Aktgjykimi, Ac. nr. 91/2002), refuzoi ankesën e ABK-së për pezullimin e përmbarimit të Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001 dhe e vërtetoi Aktvendimin E. nr. 273/2001, me të cilin u lejua përmbarimi i Aktgjykimit C. nr. 22/2001, i së njëjtës gjykatë.

24. Më 24 janar 2013, parashtruesi, në cilësinë e kreditorit, ushtroi urgjencë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, duke kërkuar përmbarim të dhunshëm të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 273/2002, të 7 majit 2002 dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 142/2001, të 26 prillit 2002.

25. Më 19 shkurt 2013, Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktvendimi E. nr. 594/2009), duke u bazuar në Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 273/2002, të 7 majit 2002, dhe në Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 142/2001, të 26 prillit 2002, lejoi përmbarimin e Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001, me të cilin parashtruesi fitoi të drejtën për kthim në punë dhe për kompensim të pagave të humbura.

26. ABK-ja, kundër Aktvendimit E. nr. 594/2009, të 19 shkurtit 2013, ushtroi kundërshtim në të njëjtën gjykatë, duke u bazuar në faktin se Gjykata Supreme me revizion i kishte ndryshuar aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët.

27. Më 29 mars 2013, Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktvendimi E. nr. 594/2009) aprovoi kundërshtimin e ushtruar nga ABK-ja, duke arsyetuar se akti juridik i cili pretendohet, si titull ekzekutiv për përmbarim, nuk e kishte fituar plotfuqishmërinë e tij në mënyrë përfundimtare, për faktin se Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 80/2002, të 26 nëntorit 2002, i ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, duke e refuzuar kështu kërkesëpadinë e parashtruesit për kthimin e tij në punë dhe për kompensimin e pagave të humbura.

28. Më 4 prill 2013, parashtruesi, kundër Aktvendimit E. nr. 594/2009, të 29 marsit 2013, të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.

29. Më 17 janar 2014, Gjykata e Apelit në Prishtinë (Aktvendimi Ac. nr. 1067/2013) e refuzoi si të pabazuar, ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, E. nr. 594/2009, të 29 marsit 2013.

30. Për më tepër, Gjykata e Apelit arsyeton vendimin e saj si në vijim:

> *"Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të kreditorit, se ekzistojnë aktgjykimet e plotfuqishme të Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut me të cilat është lejuar përmbarimi i propozuar, mirëpo nuk sqaron ndonjë fakt tjetër i cili do të ishte me rendësi qe kjo çështje përmbarimore të prishet ose të ndryshohet në favor të kreditorit, atëherë të gjitha këto i refuzoi si të pa bazuara. Meqë në rastin konkret ekzistojnë aktgjykimet e instancës me të lartë gjyqësore në vend, pra Gjykatës Supreme të Kosovës, sipas të cilave paditësit në rastin konkret kreditorit, i është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, ku ka qenë vendosur në favor të tij dhe është refuzuar edhe propozimi i tij për përsëritje të procedurës, atëherë rezulton se, në situatën konkrete nuk ekziston titull ekzekutiv përmbarimi i të cilit kërkohet, meqë aktgjykimet e instancave më të ulëta janë ndryshuar në dëm të kreditorit dhe se kthimi i tij në vendin e punës në procedurë përmbaruese është i pa mundur.*
>
> *Megjithatë, gjykata e shkalles së parë në situata të tilla kur e aprovon prapësimin, varësisht nga rrethanat e rastit e*

përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera, kjo decidivishtë është përcaktuar me dispozitën e nenit 57 par. 1 lidhur me paragrafin 3 të LPP, mirëpo, në situatën e krijuar edhe sikur aktvendimi i atakuar të prishet bazuar në këtë dispozitë, kolegji vlerëson se gjendja faktike nuk mund të ndryshohet dhe kreditori nuk mund të realizoj kërkesën e tij.

Kështu që qëndrimin juridik të gjykatës së shkalles së parë lidhur me këtë çështje, në tërësi e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, si qëndrim të drejtë dhe të ligjshëm, ndërsa pretendimet e kreditorit i refuzon si të pa bazuara në prova konkrete. Edhe pse kreditori nuk e ka goditur aktvendimin e atakuar për ndonjë shkelje esenciale të procedurës, megjithatë gjykata e shkalles së dytë aktvendimin e atakuar e vlerësoi edhe ne këtë aspekt dhe konstatoi se aktvendimi i tillë nuk është përfshirë me ndonjë shkelje esenciale të procedurës nga dispozita e nenit 182 par. 2 lidhur me nenin 194 të LPK te cilat gjykata i vështron sipas detyrës zyrtare, e të cilat shkelje do te ndikonin në drejtëshmerine dhe ligjshmërinë e aktvendimit të atakuar".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit, me Aktvendimin e saj, Ac. nr. 1067/2013, të dhënë në procedurë përmbarimore, ka shkelur të drejtën e tij për kthimin në vendin e punës. E gjithë kjo, për faktin se e njëjta refuzoi lejimin e përmbarimit të Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001, që ishte aprovuar me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 273/2002, të 7 majit 2002 dhe me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 142/2001, të 26 prillit 2002.

32. Ai pretendon se Gjykata e Apelit, refuzimin e lejimit të propozimit për përmbarim e bazoi në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 80/2002, me të cilin u aprovua revizioni i ABK-së dhe u refuzua kërkesëpadia e parashtruesit. Sipas parashtruesit, Gjykata e Apelit e refuzoi propozimin e parashtruesit për përmbarim edhe përkundër faktit se aktvendimi i gjykatës së instancës së parë ishte bërë i plotfuqishëm dhe përfundimtar.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës së Gjykatës.

34. Përkitazi me këtë kërkesë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

35. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) c) i Rregullores së punës, parasheh se:

> *(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *[...]*
>
> *c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.*

36. Për më tepër, rregulli 36 (2) i Rregullores së punës parasheh që:

> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*
>
> *[...]*
>
> *d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

37. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata e Apelit shkeli të drejtën e tij për kthimin në punë, për shkak se refuzoi propozimin për përmbarimin e Aktgjykimit C. nr. 22/2001, të 25 qershorit 2001, edhe përkundër

faktit që me Aktvendimin E. nr. 273/2002 të Gjykatës Komunale në Mitrovicë i është lejuar përmbarimi dhe i cili ishte bërë i plotfuqishëm dhe përfundimtar, pas refuzimit të ankesës së ABK-së nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë.

38. Sa i përket pretendimit të parashtruesit, se vendimi i gjykatës së instancës së parë ishte bërë i formës së prerë pas vërtetimit të aktvendimit të saj nga gjykata e instancës së dytë, në procedurë përmbarimore, Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, në procedurë përmbarimore, nuk mund të konsiderohen si çështje e gjykuar, përderisa kundër vendimeve të gjykatave të instancës më të ulët, në procedurë të rregullt civile, palët e pakënaqura ushtrojnë ankesë në instancë më të lartë gjyqësore, siç është rasti konkret, me revizionin e ushtruar në Gjykatën Supreme, nga ABK-ja.

39. Megjithatë, aktvendimi i Gjykatës së Apelit është i qartë, i kuptueshëm dhe përmban një arsyetim të gjerësishëm dhe gjithpërfshirës dhe bazohet në një aktgjykim të vendosur nga Gjykata Supreme, e cila ndryshoi vendimet e gjykatave të instancës më të ulët. Natyrisht, është e kuptueshme që Gjykata Supreme, si instancë më e lartë e gjyqësorit të rregullt, ka juridiksion për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve të nxjerra nga gjykatat e instancës më të ulët, nëse vendimet tyre kontestohen nga pala a palët, siç është rasti konkret (shih, arsyetimin e aktvendimit të Gjykatës së Apelit, në paragrafin 29 të këtij dokumenti).

40. Prandaj, Gjykata konsideron se, pretendimet e parashtruesit për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, nuk paraqesin bazë të mjaftueshme kushtetuese për aprovimin e kërkesës së tij, si të pranueshme.

41. Për më tepër, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me aktvendimin e nxjerrë nga Gjykata e Apelit. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, § 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

42. Gjykata, në rastin konkret, nuk mund të konsiderojë që procedurat e zhvilluara në Gjykatën e Apelit kanë qenë të njëanshme ose në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis,*

Shub vs. Lithuania, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

43. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se, kërkesa e parashtruesit, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe të rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 36 (1) c), rregullin 36 (2) b) dhe d), si dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores, më 2 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KO59/14, Hilmi Hoxha, Aktvendim i datës 26 qershor 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 29.2 dhe 38.2 të Kodit të Procedurës Penale dhe të neneve 11.1 dhe 39.2 të Ligjit për gjykatat

Rasti KO59/14, vendimi i 26 qershorit 2014.

Fjalët kyçe: konflikti i juridiksionit territorial të gjykatave për përgjegjësi penale, Ligjit për Gjykatat, Kodin e Procedurës Penale.

Kërkesa është bazuar në nenin 113.8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 51 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121. Parashtruesi i kërkesës është z. Hilmi Hoxha, i cili është paraqitur si kryetar i trupit gjykues të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 29.2 dhe 38.2 të KPP-së dhe të neneve 11.1 dhe 39.2 të Ligjit për gjykatat Nr. 03/L-199, për shkak të konfliktit të pretenduar lidhur me juridiksionin territorial të gjykatave për përgjegjësi penale.

Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se nenet 11.1 dhe 39.2 të Ligjit për gjykatat, Nr. 03/L-199 "janë në konflikt me Kodin e Procedurës Penale", përkatësisht me nenet 29.2 dhe 38.2, me të cilat parashihet juridiksioni territorial i gjykatave. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se ekziston "pasiguria individuale" në vendimet për juridiksionin territorial.
Parashtruesi i kërkesës shpreh "pasiguri në lidhje me kushtetutshmërinë e nenit 11 par. 1 dhe nenit 39 par. 2 të Ligjit për Gjykatat, për caktimin e kompetencës territoriale të lëndëve konkrete".
Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Kushtetuese "qartësimin e kushtetutshmërisë që përcakton juridiksionin incidental në lëndën konkrete penale".

Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës, gjyqtari Hilmi Hoxha, informoi se nuk ka vendim gjyqësor, të nxjerrë nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë ose nga trupi gjykues i Krimeve të Rënda, me të cilin kërkohet nga Gjykata Kushtetuese vlerësimi i pajtueshmërisë kushtetuese të dispozitave të kontestuara ligjore. Gjykata konkludoi se Kushtetuta (neni 102) dhe Ligji për Gjykatat (neni 3) bën dallim në mes të "gjykatave" dhe "gjyqtarëve". Nga ana tjetër, e drejta krahasuese, neni 113.8 i Kushtetutës, Ligji për Gjykatën Kushtetuese (neni 51) dhe Rregullorja e punës (rregulli 75), kur kanë të bëjnë me kontrollin incidental, gjithmonë i referohen një "gjykate". Kështu, Gjykata konsideron se kërkesa e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës (një

gjyqtar) nuk mund të merret si kërkesë e parashtruar nga një “gjykatë”, siç përcaktohet në legjislacionin e përmendur më lart dhe, më saktësisht, në nenin 113.8 të Kushtetutës.

Rrjedhimisht, Gjykata konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për paraqitjen e kërkesës dhe, për këtë arsye, kërkesën e hodhi poshtë si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KO59/14
Parashtrues
Hilmi Hoxha
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së
neneve 29.2 dhe 38.2 të Kodit të Procedurës Penale
dhe të
neneve 11.1 dhe 39.2 të Ligjit për gjykatat

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar dhe nënshkruar nga z. Hilmi Hoxha, i cili është paraqitur si kryetar i trupit gjykues të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e disa dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejmë: KPP) dhe të Ligjit për gjykatat.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 29.2 dhe 38.2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), si dhe të neneve 11.1 dhe 39.2 të Ligjit për gjykatat Nr. 03/L-199, për shkak

të konfliktit të pretenduar, lidhur me juridiksionin territorial të gjykatave për përgjegjësi penale.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113. 8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 51 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 31 mars 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 1 prill 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 3 prill 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të qartësojë dhe të plotësojë kërkesën, duke iu përgjigjur pyetjeve vijuese:

   a) Cila është çështja e përputhshmërisë së këtyre dispozitave ligjore me Kushtetutën?

   b) Cila dispozitë ligjore nuk është në përputhje?

   c) Çfarë është e pasigurt në lidhje me përputhshmërinë e ligjeve të kontestuara me Kushtetutën?

   d) Si varet vendimi i gjykatës në pritje të rastit nga përputhshmëria e ligjeve në fjalë me Kushtetutën?

   e) A ekziston ndonjë vendim i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe/ose të panelit të tij për krime të rënda, që kërkon vlerësimin e përputhshmërisë kushtetuese të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale dhe të Ligjit për Gjykatat?

8. Më 3 prill 2014, Gjykata gjithashtu kërkoi nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë, të dorëzojë:

a) shkresat e lëndës PKR Nr. 317/2013 që është në shqyrtim nga Gjykata Themelore në Gjakovë;

b) çfarëdo vendimi të Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe/ose të panelit të tij për krime të rënda, që ngre ose kërkon vlerësimin e përputhshmërisë kushtetuese të dispozitave të mësipërme të Kodit të Procedurës Penale dhe të Ligjit për Gjykatat me Kushtetutën,

c) komentet lidhur me kërkesën, nëse ka;

9. Më 15 prill 2014, parashtruesi i kërkesës iu përgjigj pyetjeve të bëra nga Gjykata dhe i dorëzoi shkresat e lëndës PKR Nr. 317/2013.

10. Më 7 maj 2014, Gjykata kërkoi më tej nga Gjykata Themelore në Gjakovë të informojë nëse Kryetari i Gjykatës dhe/ose kryetari i trupit gjykues për Krime të Rënda kishte marrë ndonjë vendim, me të cilin kishte kërkuar vlerësimin e pajtueshmërisë kushtetuese me ligjet e kontestuara dhe, nëse ka, ta dërgojë një kopje.

11. Më 27 maj 2014, Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë iu përgjigj pyetjeve të bëra nga Gjykata.

12. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën, për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor– korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë, përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.

13. Më 26 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI59/14, e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu me gjyqtarin Ivan Čukalović si anëtar të Kolegjit shqyrtues.

14. Më 26 qershor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 17 shkurt 2004, Prokuroria Publike e Qarkut në Pejë kishte akuzuar (Aktakuza PP nr. 68/2004) të pandehurin për veprat

penale të vrasjes në tentativë si dhe për veprën penale të mbajtjes pa autorizim të armëve dhe municionit.

16. Më 20 tetor 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë (Aktgjykimi, P. nr. 154/10) e shpalli të akuzuarin fajtor dhe e dënoi atë për veprat penale sipas aktakuzës.

17. Më 16 prill 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendim PAKR. nr. 899/2012) e aprovoi ankesën e avokatit mbrojtës të të akuzuarit, e anuloi Aktgjykimin (P. nr. 154/2010, të 20 dhjetorit 2011) të Gjykatës së Qarkut në Pejë, dhe e ktheu rastin për rigjykim në Gjykatën Themelore në Pejë.

18. Në ndërkohë, më 22 korrik 2010, është nxjerrë Ligji për gjykatat Nr. 03/L-199. Neni 43 (Hyrja në fuqi) parasheh se *"Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2011 për nenet 29, 35, 36, 38 dhe 40, kurse për nenet e tjera fillon të zbatohet nga 1 janari 2013"*.

19. Në pajtim me këtë ligj, ishte themeluar Gjykata e re Themelore në Gjakovë dhe sipas nenit 39.2, të gjitha lëndët të cilat deri më 31 dhjetor 2012 nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë, duhet të trajtohen si lëndë të Gjykatës Themelore, e cila ka juridiksionin territorial përkatës që nga 1 janari 2013.

20. Më 22 tetor 2013, Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore në Pejë (Aktvendim P. Nr. 270/13) "*shpallet inkompetente në pikëpamje territoriale"* për të gjykuar lëndën penale dhe ia dërgoi lëndën Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

21. Më 23 tetor 2013, kryetari i trupit gjykues i Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Gjakovë parashtroi kërkesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës territoriale me propozim që Gjykata Themelore në Pejë të shpallet kompetente në pikëpamje territoriale, për të vendosur në lëndën penale.

22. Më 25 tetor 2013, Gjykata e Apelit vendosi (Aktvendim PN. nr. 670/2013) se:

> *"Kompetente për të gjykuar në çështjen penale sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Pejë, PP. Nr. 68/04, të datës 17.02.2004, e ushtruar kundër të akuzuarit Engjëll Përkolaj për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale,*

vrasje në tentativë nga neni 30 alineja 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me nenin 19 të LPJ si dhe veprën penale të mbajtjes pa autorizim të armës dhe municionit nga neni 8.3 që ndëshkohet sipas nenit 8.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/7 "për autorizimin e përdorimit të armëve në Kosovë" është Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti për krime të rënda".

23. Më 15 janar 2014, kryetari i trupit gjykues të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Gjakovë, parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

24. Më 28 janar 2014, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi (Aktvendim PML. nr. 16/2014) ta hedhë poshtë si të papranueshme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, duke arsyetuar si në vijim:

"Për më tepër, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ka paraqitur një gjyqtar-kryetar i trupit gjykues, subjekt ky i cili nuk ka autorizim ligjor që të paraqes këtë mjet juridik, sepse konform dispozitës së nenit 433. par.1. të KPPK kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqesë Kryeprokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij e pas vdekjes së të pandehurit kërkesën mund të paraqesin personat e paraparë me nenin 424. par.1. të këtij Kodi".

25. Më 14 prill 2014, parashtruesi i kërkesës iu përgjigj pyetjeve të bëra nga Gjykata, si në vijim:

a) "nenet e KPP-së," janë dispozita ligjore në përputhshmëri me Kushtetutën, ndërsa neni 39 i Ligjit për Gjykatat, është dispozitë ligjore që bie ndesh me nenet e cekura të KPP-së";
b) "dispozitat juridike të Kushtetutës nuk janë të kontestuar por ndoshta është ndryshimi i imi kur e kam bërë kërkesën lidhur me Kushtetutshmërinë e neneve, 29 par. 2, nenit 38 par. 2, te KPP-së, (...) është dashtë të theksohet ligjshmëria e neneve te KPP-së të cekura më lartë".

c) "Neni 39 par. 2 i Ligjit për Gjykatat, jam i mendimit se nuk është nen i cili përcakton kompetencën territoriale të lëndëve konkrete penale, por caktimi i kompetencës territoriale të secilës lëndë konkrete penale duhet të bazohet në nenin 29 par. 2 dhe nenin 38 par 2 të KPP-së".

d) "Vendimi i Gjykatës në pritje të rastit varet shumë për arsye se (...), të gjitha këto lëndë dërgohen në Gjykatën Themelore në Gjakovë vetëm me një shkresë të thjeshtë duke u thirrur ne nenin 39 par. 2 të Ligjit për Gjykatat, pa vendim mbi shpalljen in kompetence territoriale, dhe është ngarkesë e veçantë për Gjykatën Themelore në Gjakovë, e cila Gjykatë ka vetëm 3 Gjyqtarë të krimeve të rënda ose gjithsej 12 Gjyqtarë".

e) "Nuk ka vendim të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, apo të panelit të kësaj Gjykate për krime të rënda, që ka kërkua vlerësimin e përputhshmërisë Kushtetuese të Dispozitave Përkatëse të Kodit të Procedurës Penale të Ligjit për Gjykatat".

26. Më 14 prill 2014, parashtruesi i kërkesës i bashkëngjiti shkresat e lëndës PKR. nr. 317/2013, *"meqenëse me këtë lëndë ka qenë i ngarkuar Kryetari i Trupit Gjykues, e jo Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë".*

27. Më 27 maj 2014, Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë informoi se "*se nuk është marrë vendim me të cilin kërkohet vlerësim i pajtueshmërisë kushtetuese të neneve 29 (2) dhe 38 (2) të Kodit të Procedurës Penale, si dhe të neneve 11 (1) dhe 39 (2) të Ligjit për Gjykatat nr. 03/L-199, as nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë e as nga gjyqtari kryesues i panelit të krimeve të rënda".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se nenet 11.1 dhe 39.2 të Ligjit për gjykatat, Nr. 03/L-199 "*janë në konflikt me Kodin e Procedurës Penale",* përkatësisht me nenin 29.2 dhe nenin 38.2, me të cilat parashihet juridiksioni territorial i gjykatave.

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon *"pasigurinë individuale"* në vendimet për juridiksionin territorial. Ai më tutje thekson se:

"Në çdo takim, seminar, apo në kolegje, kame kundërshtua mënyrën e përcjelljes së lëndëve penale, dhe jane mundua (...) me e sensibilizua këtë çështje mirëpo mendimi ime ka has në veshe të shurdhët".

30. Parashtruesi i kërkesës shpreh *"pasiguri në lidhje me kushtetutshmërinë e nenit 11 par. 1 dhe nenit 39 par. 2 të Ligjit për Gjykatat, për caktimin e kompetencës territoriale të lëndëve konkrete".*

31. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata *"qartësimin e Kushtetutshmërisë që përcakton juridiksioni incidental në lëndën konkrete penale".*

Dispozita relevante të Kushtetutës për gjykata

Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]

1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat.

(...)

3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.

4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.

Dispozitat relevante të Ligjit për gjykatat Nr. 03 L-199

Neni 3

1. Gjykatat e themeluara me këtë ligj gjykojnë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.

2. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik, përfshirë edhe organet publike.

Neni 11.1

1. Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.

Neni 12

1. Departamentet në vijim themelohen brenda Gjykatave Themelore me qëllim të ndarjes së çështjeve sipas natyrës së tyre:
...
1.3. Departamenti për Krimet e Rënda që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore;

2. Secila Gjykatë Themelore ka Kryetarin e Gjykatës, i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe punën e Gjykatës Themelore. Secila degë e Gjykatave Themelore ka një (1) Gjyqtar Mbikëqyrës që i përgjigjet Kryetarit të Gjykatës Themelore përkatëse për punën e degës.

Neni 15

2. Të gjitha çështjet në Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore gjykohen nga trupi gjykues prej tre (3) gjyqtarëve profesionist, nga të cilët njëri duhet të jetë kryesues i trupit gjykues.

Neni 39.2

2. Të gjitha lëndët të cilat më 31 dhjetor të vitit 2012 janë lëndë të shkallës së parë të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Qarkut, Gjykatës Ekonomike të Qarkut, Gjykatës Komunale apo Gjykatave Komunale për Kundërvajtje dhe nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë, më 1 janar të vitit 2013 trajtohen si lëndë të Gjykatës Themelore e cila ka juridiksionin territorial përkatës.

Dispozitat relevante të Kodit të Procedurës Penale Nr. 04/L-123

Neni 29.2

2. Kur një vepër penale është kryer ose është tentuar të kryhet apo pasojat e saj janë shkaktuar në territorin e më shumë se

një gjykate ose në kufijtë e atyre territoreve, kompetente është ajo gjykatë e cila e para e ka filluar procedurën gjyqësore si përgjigje në kërkesën e prokurorit të autorizuar, por nëse procedura nuk është filluar, atëherë kompetente është gjykata në të cilën së pari është dorëzuar kërkesa për fillimin e procedurës".

Neni 38.2

2. Pasi aktakuza të merr formë të prerë, gjykata nuk mund të shpall veten jokompetente në pikëpamje territoriale dhe palët nuk mund të paraqesin kundërshtim për shkak të mungesës së kompetencës territoriale.

Historiku i së drejtës krahasuese

32. Para se të lëshohemi në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konsideron se është e domosdoshme të merret parasysh historiku i së drejtës krahasuese dhe i praktikës gjyqësore.

33. Gjykata vëren se një numër i madh i shteteve evropiane parasheh të ashtuquajturën *"procedurën paraprake të vendosjes"*: një gjykatë e rregullt e ngritë çështjen paraprake në Gjykatën Kushtetuese kur ka dyshime në atë nëse një ligj është në përputhje me Kushtetutën.

34. Procedura paraprake e vendosjes është gjithashtu e njohur si kërkesë gjyqësore, qasje e tërthortë individuale, kontroll konkret, kontroll i tërthortë apo kontroll incidental i kushtetutshmërisë. Duket se komuniteti juridik kosovar është më shumë i familjarizuar me termin kontrolli incidental i kushtetutshmërisë.

35. Në këtë mënyrë, gjykatat e rregullta të shumicës së shteteve janë të autorizuara të parashtrojnë kërkesë për kushtetutshmërinë e legjislacionit. Kjo ekziston në Shqipëri, Armeni, Belgjikë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Republikën Çeke, Hungari, Itali, Maqedoni, Rumani, Slloveni, Spanjë, Turqi etj. Megjithatë, në disa shtete si në Bullgari, Greqi dhe Letoni, vetëm gjykatat më të larta janë të autorizuara për inicimin e kontrollit incidental në gjykatat kushtetuese.
36. Nga ana tjetër, në Gjermani, të gjitha panelet kompetente të të gjitha gjykatave në të gjitha rastet kanë të drejtë të shfrytëzojnë

kërkesën gjyqësore, në pajtim me nenin 100.1 të Ligjit Themelor. Gjykata Federale Kushtetuese gjithashtu kryen shqyrtimin *ex officio*.

37. Në pajtim me nenin 100.1 të Ligjit Themelor, të gjitha panelet kanë të drejtë të shfrytëzojnë kërkesën gjyqësore. Pastaj, shumica e anëtarëve të panelit duhet të votojnë që të ngrenë çështjen. Kërkesa duhet të nënshkruhet nga gjyqtarët të cilët votojnë në favor të kërkesës dhe duhet të shoqërohet nga një deklaratë për dispozitën ligjore në fjalë, dispozitën e Ligjit Themelor të implikuar, dhe për masën e cila është e nevojshme, që një vendim kushtetues të zgjidhë një kontest.

38. Gjykata Federale Kushtetuese do ta hedhë poshtë rastin nëse gjyqtarët referues tregojnë më pak se një bindje të vërtetë se një ligj apo dispozitë e ligjit është jokushtetuese ose nëse rasti mund të vendoset pa zgjidhjen e çështjes kushtetuese.

39. Në Hungari, në pajtim me nenin 24.2 b) të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese *"shqyrton menjëherë por jo më vonë se tridhjetë ditë çfarëdo pjese të legjislacionit, të aplikuar në rastin e veçantë për pajtueshmëri me Ligjin Themelor sipas propozimit të ndonjë gjyqtari"*.

40. Sipas Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë, gjykatat e rregullta duhet të iniciojnë procedurën në Gjykatën Kushtetuese, në qoftë se në rastin në procedurë e sipër, ato duhet të aplikojnë rregullat ligjore ose instrumente të tjera ligjore të administratës publike të cilat ato i konsiderojnë jokushtetuese.

41. Procedurë e ngjashme ekziston edhe në Turqi. Në të vërtetë, neni 152 i Kushtetutës së Turqisë, thekson si në vijim:

> *Nëse një gjykatë e cila është duke e gjykuar një rast, konstaton se ligji ose dekreti që ka fuqinë e ligjit, i cili do të aplikohet, është jo kushtetues, ose në qoftë se ajo është e bindur për seriozitetin e një pretendimi për jo kushtetutshmëri, të paraqitur nga njëra prej palëve, do të shtyjë shqyrtimin e rastit, deri sa Gjykata Kushtetuese të vendosë për këtë çështje.*
> *Nëse gjykata nuk është e bindur për seriozitetin e kërkesës së antikushtetuese, një pretendim i tillë së bashku me aktgjykimin kryesor do të vendoset nga autoriteti kompetent të apelit.*

Nëse gjykata nuk është e bindur për seriozitetin e pretendimit për jo-kushtetutshmëri, një pretendim i tillë së bashku me aktgjykimin kryesor do të vendoset nga organi kompetent i apelit.

Gjykata Kushtetuese vendos për çështjen dhe bën publik vendimin e saj brenda pesë muajve nga pranimi i pretendimit. Në qoftë se asnjë vendim nuk nxirret brenda kësaj periudhe, gjykata e gjykimit do ta përfundojë rastin sipas dispozitave ekzistuese ligjore. Megjithatë, në qoftë se vendimi për meritat e çështjes merr formë të prerë, gjykata e gjykimit është e detyruar ta respektojë atë.

Nuk do të ngrihet asnjë pretendim për jokushtetushmëri në lidhje me të njëjtën dispozitë ligjore deri sa të kalojnë dhjetë vjet pas publikimit në Gazetën Zyrtare të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin hidhet poshtë kërkesa sipas meritave.

42. Përveç kësaj, neni 156 i Kushtetutës së Sllovenisë parasheh:

Nëse një gjykatë, e cila vendosë për një çështje e konsideron jokushtetues një ligj të cilin duhet ta aplikojë, duhet ta ndërprenë procedurën dhe të ngre procedurën para Gjykatës Kushtetuese. Procedura në gjykatë mund të vazhdojë pasi Gjykata Kushtetuese ta nxjerrë vendimin e saj.

43. Më saktësisht, Akti i posaçëm (i 6 janarit 1989) në Gjykatën Kushtetuese të Belgjikës parashikon:

Neni 27

§ 1. Pyetje paraprake do t'i referohen Gjykatës Kushtetuese nga komunikimi i një kopjeje të vërtetuar të origjinalit të vendimit të referuar, të nënshkruar nga kryetari dhe sekretari i gjykatës.

§ 2 Vendimi i tillë përmban dispozitat e statutit, dekretin ose rregullin e përmendur në nenin 134 të Kushtetutës në lidhje me çështjen e ngritur; kur është e nevojshme, ai gjithashtu

specifikon se cilat nene të Kushtetutës ose të ligjeve të veçanta janë të rëndësishme në këtë drejtim. Gjykata Kushtetuese, megjithatë, mund të riformulojë çështjen e ngritur paraprake.

Neni 28

Gjykata e cila e parashtroi çështjen paraprake dhe çdo gjykatë tjetër, e cila nxjerrë aktgjykim për çështjen e njëjtë, duhet t'i përmbahet vendimit të nxjerrë nga Gjykata Kushtetuese në zgjidhjen e mosmarrëveshjes lidhur me pyetjen e ngritur, të bërë në nenin 26.

Neni 29

§ 1 . Nuk do të ketë asnjë mjet juridik kundër një vendimi të një gjykate të ligjit për aq sa ajo i referohet një çështjeje në Gjykatën Kushtetuese për një vendim paraprak.
§ 2 . Çdo vendim, me të cilin një gjykatë refuzon për ta ngritur një çështje për një vendim paraprak duhet të përmbajë arsyen e refuzimit. Nuk ka mjet juridik të veçantë kundër vendimit të një gjykate që refuzon për të ngritur një çështje të tillë .

Neni 30

Vendimi për ta ngritur një çështje në Gjykatën Kushtetuese për një vendim paraprak ka efektin e pezullimit të procedurës dhe afateve kohore për procedura dhe periudhat e parashkrimit nga data e këtij vendimi deri në datën në të cilën vendimi i Gjykatës Kushtetuese i komunikohet gjykatës së ligjit, e cila kishte ngritur çështjen paraprake. Një kopje e vendimit i dërgohet palëve.

44. Gjykata konsideron se është një përmbledhje e drejtë e pikëpamjes krahasuese nëse thuhet se në shumicën e shteteve evropiane, gjykatat e rregullta mund ta shfrytëzojnë kërkesën gjyqësore. Pastaj një vendim për ngritjen e çështjes kushtetuese, duhet të nxirret, të votohet dhe të nënshkruhet. Kërkesa duhet të nënshkruhet nga gjyqtarët të cilët kishin votuar në favor të kërkesës dhe duhet të shoqërohet nga një deklaratë për dispozitën ligjore në fjalë, dispozitën e implikuar të Kushtetutës, dhe masën e

cila është e nevojshme, që një vendim kushtetues të zgjidhë një kontest. Përveç kësaj, vendimi i nënshkruar sipas rregullit nga gjyqtari ose gjyqtarët, i drejtohet Gjykatës Kushtetuese nga Kryetari i gjykatës ose nga sekretari.

Pranueshmëria e kërkesës

45. Gjykata tani shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës, përkatësisht nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar.

46. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar dhe nënshkruar kërkesën, "*në pajtim me nenin 113 pika 8 të Kushtetutës së Kosovës"*, i gatshëm "*të referoim pyetjen ne lidhur me Kushtetutshmërinë e këtyre neneve - Ligjeve të cekura me lartë dhe kërkoim qartësimin e Kushtetutshmërisë që përcakton juridiksioni incidental në lëndën konkrete penale"*.

47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *(...)*
>
> *8. Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë".*

48. Gjykata i referohet edhe nenit 51 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të*

kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

2. Kërkesa do të specifikoj cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.

49. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe rregullit 75 [Parashtrimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, ex officio, ose me kërkesë të njërës palë të përfshirë në lëndë.

(2) Kërkesa duhet të theksojë përse vendimi i Gjykatës varet nga çështja e përputhshmërisë së ligjit me Kushtetutë. Dosja, e cila shqyrtohet nga Gjykata, duhet t'i bashkëngjitet kërkesës.

(3) Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë për të iniciuar procedurën në pajtim me dispozitat e nenit 113.8 të Kushtetutës, pavarësisht nëse një palë e përfshirë në lëndë ka kontestuar kushtetutshmërinë e dispozitës përkatëse ligjore".

50. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 113.8 të Kushtetutës si bazë juridike për paraqitjen kërkesës.

51. Gjykata rikujton se deri më tani ka pasur vetëm një rast të dorëzuar në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, (shih rastin Gjykata Kushtetuese KO04/11, Aktgjykimi i 6 marsit 2012).

52. Në atë rast, seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme ka shqyrtuar dorëzimin e një kërkese për vlerësimin e kushtetutshmërisë, në përputhje me nenin 113.8 të Kushtetutës.

53. Kërkesa është dorëzuar në Gjykatë në emër të Gjykatës Supreme, nga kryetari i saj, z. Fejzullah Hasani.

54. Në fillim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, gjyqtari Hilmi Hoxha, informoi se nuk ka vendim gjyqësor, të nxjerrë nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë ose nga trupi gjykues i Krimeve të Rënda, me të cilin kërkohet nga Gjykata Kushtetuese

vlerësimi i pajtueshmërisë kushtetuese të dispozitave të kontestuara ligjore.

55. Gjykata vëren se Kushtetuta (neni 102) dhe Ligji për gjykatat (neni 3) bën dallim në mes të *"gjykatave"* dhe *"gjyqtarëve"*. Nga ana tjetër, e drejta krahasuese, neni 113.8 i Kushtetutës, Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (neni 51) dhe Rregullorja e punës (rregulli 75), kur kanë të bëjnë me kontrollin incidental, gjithmonë i referohen një *"gjykate"* .

56. Kështu, Gjykata konsideron se kërkesa e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës nuk mund të merret si kërkesë e parashtruar nga një "gjykatë", siç përcaktohet në legjislacionin e përmendur më lart dhe, më saktësisht, në nenin 113.8 të Kushtetutës.

57. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për paraqitjen e kërkesës dhe, për këtë arsye, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, nenin 51 të Ligjit dhe rregullin 75 (2) të Rregullores së punës, më 26 qershor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË KTHEHEN shkresat e lëndës në Gjykatën Themelore në Gjakovë

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. Dr. Enver Hasani

KI58/14, Shefqet Hasimi, Aktvendim i datës 1 korrik 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, KA. nr. 89/2014, të 6 shkurtit 2014

Rasti KI58/14, vendimi i 1 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, e papranueshme, qartazi e pabazuar.

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, të 6 shkurtit 2014, përmes te cilit ishte vërtetuar Aktvendimi i 20 janarit 2014 i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktvendimit të lartcekur e kishte shpallur parashtruesin e kërkesës përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes në komunikacion.

Parashtruesi nuk specifikon në kërkesën e tij cilat të drejta dhe liri i janë shkelur dhe çfarë dispozitë kushtetuese në veçanti mbështet kërkesën e tij.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar sepse kërkesa nuk është arsyetuar *prima facie* dhe parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI58/14
Parashtrues
Shefqet Hasimi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit,
KA. nr. 89/2014, të 6 shkurtit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Shefqet Hasimi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, KA. nr. 89/2014, i 6 shkurtit 2014, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, KA. nr. 89/2014, të 6 shkurtit 2014, përmes të cilit ishte vërtetuar aktvendimi, Nr. regj. 53490/13, i 20 janarit 2014 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Kundërvajtje (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore në Prishtinë). Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktvendimit të lartcekur e kishte shpallur parashtruesin e kërkesës përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes në komunikacion.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113. 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 31 mars 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 3 prill 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI58/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI58/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

7. Më 28 prill 2014, Gjykata Kushtetuese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën e Apelit.

8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese për periudhën qershor-korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë lidhur me pretendimet e caktuara të ngritura ndaj tij.

9. Më 1 korrik 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 23 gusht 2013, Stacioni Policor Jugu në Prishtinë, në Gjykatën Themelore në Prishtinë kishte ushtruar kërkesë për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të kryerjes së kundërvajtjes (mosvënie e rripit të sigurisë) në shkelje të nenit 198, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 02/ L- 70 për sigurinë në komunikacion.

11. Më 23 shtator 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi Nr. regj. 53490/13) e kishte shpallur parashtruesin e kërkesës

përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes (drejtimi i automjetit pa rrip të sigurisë) sipas nenit 198, paragrafi 1 të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor (në tekstin e mëtejmë: LSKRR), dhe e kishte gjobitur me gjobë në shumën prej 35 (tridhjetë e pesë) euro.

12. Kundër aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit.

13. Më 6 nëntor 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendimi KA. Nr. 1155/2013) aprovoi ankesën e parashtruesit si të bazuar dhe abrogoi Aktvendimin Nr. regj. 53490/13, të 23 shtatorit 2013, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke ia kthyer gjykatës së shkallës së parë lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

14. Gjykata e Apelit konstatoi se Gjykata Themelore në Prishtinë parashtruesin e kishte shpallur përgjegjës vetëm për kryerjen e kundërvajtjes sipas nenit 198, paragrafi 1 të LSKRR-së, drejtimin e automjetit pa rrip të sigurisë, ndërsa për dy kundërvajtjet e tjera, përkatësisht drejtimin e automjetit pa i ndezur dritat dhe për sjellje të pahijshme ndaj zyrtarit policor, Gjykata e lartcekur nuk kishte marrë asnjë vendim. Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit vendosi që Gjykata Themelore në Prishtinë duhet të procedojë me plotësimin e procedurës dhe të vendosë lidhur me të gjitha kundërvajtjet.

15. Më 5 dhjetor 2013, parashtruesi, te Kryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë, paraqiti kërkesë për përjashtimin e gjyqtares nga procedura kundërvajtëse duke pohuar se e njëjta gjatë procedurës ishte treguar e njëanshme.

16. Më 20 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës Themelore refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.

17. Më 20 janar 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi Nr. regj. 53490/13) shpalli parashtruesin e kërkesës përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes në komunikacion, sipas nenit 198, paragrafi 1 i LSKRR-së, drejtimi i automjetit pa rrip të sigurisë. Kjo Gjykatë, më tej, pezulloi procedurën kundërvajtëse ndaj parashtruesit përkitazi me kundërvajtjen sipas nenit 122, paragrafi 1 të LSKRR-së (drejtimi i automjetit pa ndezjen e dritave), ndërsa përkitazi me sjelljen e pahijshme ndaj zyrtarit policor, konstatoi se ky veprim nuk cilësohet si kundërvajtje, duke e shënuar si vërejtje për sjellje të parashtruesit.

18. Kundër aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës, me pretendimin për aplikim të gabuar të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të procedurës së kundërvajtjes, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.

19. Më 6 shkurt 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi KA. nr. 89/2014) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Nr. regj. 53490/13, të 20 janarit 2014.

20. Gjykata e Apelit konstatoi si në vijim:

> *[...]*
>
> *"Kolegji vlerësoj se gjykata e shkallës së parë, gjatë zbatimit të procedurës kundërvajtëse, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, përkatësisht aplikim të gabuar të së drejtës materiale. kurse gjoba e shqiptuar ndaj të pandehurit Shefqet Hasimi, konform të nenit 7 të LK-së, në shumë prej 35 (tridhjetë e pesë) €, konsiderohet se është caktuar sipas shkallës së përgjegjësisë, peshës së veprës së kryer dhe rrethanave nën të cilat është kryer vepra kundërvajtëse, andaj edhe ne këtë drejtim nuk ka baze ligjore për ndryshimin e aktvendimit të goditur."*

21. Më 26 shkurt 2014, kundër aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë (Nr. regj. 53490/13, të 20 janarit 2014) dhe të Gjykatës së Apelit (KA. nr. 89/2014, të 6 shkurtit 2014), parashtruesi i kërkesës, në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, parashtroi kërkesë për inicimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

22. Më 5 mars 2014, Prokurori i Shtetit, në njoftimin e tij, KMLP. I. Nr. 2/14, konsideroi se nuk ka bazë ligjore për inicimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit

23. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës si në vijim:

> *"Me ketë kërkesë drejtuar gjykatës kushtetuese të Kosovës me marrjen e Aktvendimeve në shkelje të Kushtetutës, duke shkelur të drejtën e qytetarit që para gjykatës të trajtohem të barabart para ligjit dhe Kushtetutës, e jo në Diskriminimin,*

dhe në shkelje brutale të ligjit, duke aplikuar Ligjin, i cili në rastin e shqiptimit të dënimit nuk ka asnjë provë se unë Shefqet Hasimi, Zyrtar në Ministrinë e Drejtësisë me datën 09.07.2013 kam ra në kundërshtim me ligjin. Kolegjit i propozoj që të shqyrton me kujdes të veçantë në mënyrë që të konstatohet se ka shkelje të Ligjit, Kushtetutës e në veçanti kur kolegji i gjykatës së apelit vendos dy herë për të njëjtën çështje."

24. Parashtruesi, në kërkesën e tij, nuk saktëson se cilat të drejta dhe liri i janë cenuar dhe cila dispozitë kushtetuese në veçanti mbështet kërkesën e tij.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

27. Gjykata gjithashtu merr parasysh nenin 48 të Ligjit që parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

28. Ashtu siç u cek më lart, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që të konstatojë se *[...]"Kolegjit i propozoj që të shqyrton me kujdes të veçantë në mënyrë që të konstatohet se ka shkelje të Ligjit, Kushtetutës e në veçanti kur kolegji i gjykatës së apelit vendos dy herë për të njëjtën çështje".*

29. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë nuk thekson se cila e drejtë i është shkelur dhe cili nen i Kushtetutës mbështet kërkesën e tij.

30. Gjykata, po ashtu, ripërsërit se Gjykata Kushtetuese nuk mund ta zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave

të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, ashtu edhe të asaj materiale (shih rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

31. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të cituar në paragrafin 28, Gjykata vëren që arsyetimi i dhënë me aktvendimin e Gjykatës së Apelit është i qartë, si dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

32. Për më tepër, parashtruesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që do të vërtetonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë (shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovake*, GJEDNJ, Nr. 53363/99, Vendimi i 31 majit 2005). Parashtruesi nuk saktësoi se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë mbështesin pretendimin e tij, ashtu siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

33. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2) a) dhe d) të Rregullores së punës që parasheh: *"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse: a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie; dhe d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij"*.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) a) dhe d) e me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 1 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI66/14, Ruhan Sadiku, Zymrije Hyseni, Ramadan Palushi, Xhevat Haziri, Mehdi Dibra dhe Aziz Hashani, Aktvendim i datës 3 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 210/13, të 18 dhjetorit 2013

Rasti KI66/14, vendimi i 3 korrikutt 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest civil, e drejta për gjykim të drejtë, e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, kërkesë qartazi e pabazuar.

Në këtë rast, parashtruesit e kërkesës pretendonin se "Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 210/2013, i 18 dhjetorit 2013, është i njëanshëm, i padrejtë dhe arbitrar për arsyet si në vijim: a). Njëanshmëria, padrejtësia dhe arbitrariteti procedural. Përkundër faktit se çështja e gjykuar res judicata është parim themelor absolut dhe paraqet prezumim procedural negativ qe përjashton mundësinë e rigjykimit për të njëjtën çështje njëherë të gjykuar, e sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme merret se ndërprerja e marrëdhënies së punës (ka ndodhur) për shkak të privatizimit, edhe për kundër faktit se ky kundërshtim njëherë është refuzuar me vendim të plotfuqishëm, si fakt i "lindur", një fakt i rilindur apo i ringjallur, sepse ai fakt është shuar se ekzistuari me vendimin e formës se prerë E. nr. 1248/2007 pa asnjë bazë tjetër ligjore, paraqet njëanshmëri, arbitraritet dhe padrejtësi procedurale. b) Njëanshmëria dhe arbitrariteti procedural ka shkaktuar edhe njëanshmërinë dhe padrejtësinë materiale në dem të paditësve me ndryshim të aktgjykimeve të gjykatave të instancave me të ulëta" [...].

Në rastin konkret, Gjykata nuk konsideroi që procedurat në Gjykatën Supreme, ishin të njëanshme ose në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Ne kete kontekst Gjykata iu referua mutatis mutandis, rastit Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009.

Gjykata më tej konsideroi se pretendimi për shkelje, i bazuar në mosrespektim të vendimit të formës së prerë dhe të detyrueshëm ishte i pabazuar, pasi që faktet dhe argumentet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës nuk shpjegonin në mënyrë logjike dhe nuk dëshmonin në mënyrë të arsyeshme se Gjykata Supreme shkeli parimet res judicata.

Si përmbledhje, Gjykata, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës konkludoi se kërkesa e parashtruesve ishte qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI66/14
Parashtrues
Ruhan Sadiku, Zymrije Hyseni, Ramadan Palushi, Xhevat Haziri, Mehdi Dibra dhe Aziz Hashani
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 210/13, të 18 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: z. Ruhan Sadiku nga fshati Llugaxhi, komuna e Lipjanit; znj. Zymrije Hyseni nga fshati Prelez, komuna e Ferizajt; z. Ramadan Palushi nga Ferizaj; z. Xhevat Haziri nga Ferizaj; z. Mehdi Dibra nga Ferizaj dhe z. Aziz Hashani nga Ferizaj. Parashtruesit përfaqësohen nga z. Halil Ilazi, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 210/13, të 18 dhjetorit 2013, të cilin e kanë pranuar më 15 janar 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë, me të cilin pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat

kushtetuese të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31, paragrafi 1 dhe 2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]; nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt Gjyqësor] si dhe nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

Baza juridike

4. Baza juridike është: neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 prill 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 16 maj 2014, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.

8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën, për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor - korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë, përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.

9. Më 30 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu me gjyqtarin Ivan Čukalović, si anëtar të Kolegjit shqyrtues.

10. Më 3 korrik 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 27 mars 2004, Kompania Publike e Transportit të Udhëtarëve "Kosovatrans" (në tekstin e mëtejmë: "Kosovatrans") vendosi që parashtruesit e kërkesës t'i dërgojë në pushim me pagesë prej 50% (Vendimi nr. 46).

12. Më 30 dhjetor 2005, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktgjykimi: C. nr. 250/05) vendosi që: i) ta aprovojë si të bazuar, kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës dhe e anuloi si të kundërligjshëm vendimin e "Kosovatrans"-it, për dërgimin e tyre në pushim me pagesë prej 50% të të ardhurave personale; ii) ta detyrojë "Kosovatrans"-in që t'i kthejë parashtruesit në vendet e tyre të punës, me të gjitha të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës; iii) ta detyrojë "Kosovatrans"-in që parashtruesve të kërkesës t'ua kompensojë pagat e humbura prej 1 prillit 2004 deri më 30 dhjetor 2005, me kamatë në lartësi prej 4%, të llogaritur prej 30 dhjetorit 2005 deri me pagesën përfundimtare; ta detyrojë "Kosovatrans"-in që parashtruesve të kërkesës t'ua paguajë dëmin në lartësinë e mëditjeve për periudhën prej 1 prillit 2004 deri më 30 dhjetor 2005, me të njëjtën kamatë në lartësi prej 4%, prej 30 dhjetorit 2005 deri me pagesën përfundimtare; dhe v) ta detyrojë "Kosovatrans"-in që parashtruesve të kërkesës t'ua kompensojë shpenzimet e kontestit.

13. "Kosovatrans"-i ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale.

14. Më 1 nëntor 2006, Gjykata e Qarkut (Aktgjykimi: Ac. nr. 168/2006), vendosi që: I) ta refuzojë si të pabazuar ankesën e "Kosovatrans"-it, në paragrafin I, II dhe në pjesën e paragrafit III të aktgjykimit që ka të bëjë me kompensimin e dëmit për të ardhurat personale të papaguara, për periudhën prej 1 prillit 2004 deri më 30 dhjetor 2005; II) ta vërtetojë paragrafin V të aktgjykimit; III) ta prishë paragrafin III të Aktgjykimit, në pjesën që ka të bëjë me lartësinë e kamatës prej 4%, që do të llogaritet prej 30 dhjetorit 2005 deri me pagesën përfundimtare: dhe IV) ta anulojë kërkesën në paragrafin IV.

15. Më 5 dhjetor 2006, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj (C. nr. 250/2005, të 30 dhjetorit 2005).

16. Më 20 dhjetor 2006, Gjykata Komunale lejoi përmbarimin dhe e urdhëroi "Kosovatrans"-in që t'i kthejë parashtruesit e kërkesës në

vendet e tyre të punës dhe t'ua kompensojë pagat e papaguara prej 2 prillit 2004 gjer më 30 dhjetor 2005.

17. Më 19 shkurt 2007, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) parashtroi kërkesë për shtyrjen e përmbarimit për shkak të privatizimit të një pjese të "Kosovatrans"-it.

18. Më 23 prill 2007, Gjykata Komunale (Aktvendimi E. nr. 1348/06), refuzoi kërkesën e AKM-së, dhe e përsëriti detyrimin e "Kosovatrans"-it, që t'i kthejë parashtruesit në vendet e tyre të punës, me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

19. Më 27 shtator 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi: Ac. nr. 448/2007) e refuzoi si të pabazuar ankesën e AKM-së dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, E. nr. 134/2006, të 23 prillit 2007.

20. Më 19 nëntor 2007, Gjykata Komunale konkludoi (E. nr. 1348/2006, shënim zyrtar) se *"Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj C. Nr. 250/05 i 30.12.2005 është përmbaruar në tërësi, ashtu që [parashtruesit e kërkesës) janë kthyer në punë dhe janë futur në lokalet e debitorit"*.

21. Më 7 maj 2009, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktgjykimi C. nr. 676/06) vendosi që: i) ta aprovojë kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës dhe ta obligojë "Kosovatrans"-in që parashtruesve të kërkesës t'ua paguajë pagat e papaguara për periudhën prej 1 janarit 2006 deri më 30 prill 2009, dhe ii) ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, sipas të cilës "Kosovatrans"-i është i detyruar të paguajë për triskat e ushqimit për periudhën prej 1 prillit 2004 deri më 30 prill 2009.

22. Më 10 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi Ac. nr. 881/2009) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi ankesën e "Kosovatrans"-it.

23. "Kosovatrans"-i dhe AKP-ja ushtruan revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të shkallës së dytë, për shkak të shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

24. Më 18 dhjetor 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 210/2013) vendosi që: I) ta pranojë revizionin e "Kosovatrans"-it; II) t'i ndryshojë aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Ferizaj (C. nr. 676/2006 të 7 majit 2009) dhe të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë

(Ac. nr. 881/2009 të 10 majit 2012) ashtu që kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës lidhur me detyrimin e "Kosovatrans"-it që t'u kompensojë parashtruesve të kërkesës pagat e papaguara për periudhën prej 1 janarit 2006 deri më 30 prill 2009 është refuzuar si e pabazuar; dhe III) mosshqyrtimin e pjesës së mbetur të aktgjykimeve.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se "*Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 210/2013, i 18 dhjetorit 2013, është i njëanshëm, i padrejtë dhe arbitrar për arsyet si në vijim*:

> *a). Njëanshmëria, padrejtësia dhe arbitrariteti procedural. Përkundër faktit se çështja e gjykuar res judicata është parim themelor absolut dhe paraqet prezumim procedural negativ qe përjashton mundësinë e rigjykimit për të njëjtën çështje njëherë të gjykuar, e sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme merret se ndërprerja e marrëdhënies së punës (ka ndodhur) për shkak të privatizimit, edhe për kundër faktit se ky kundërshtim njëherë është refuzuar me vendim të plotfuqishëm, si fakt i "lindur", një fakt i rilindur apo i ringjallur, sepse ai fakt është shuar se ekzistuari me vendimin e formës se prerë E. nr. 1248/2007 pa asnjë bazë tjetër ligjore, paraqet njëanshmëri, arbitraritet dhe padrejtësi procedurale.*
>
> *b) Njëanshmëria dhe arbitrariteti procedural ka shkaktuar edhe njëanshmërinë dhe padrejtësinë materiale në dem të paditësve me ndryshim të aktgjykimeve të gjykatave të instancave me të ulëta".*

26. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme kishte shkelur "*nenin 31.1 dhe 2 (E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenin 22 (Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), nenit 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 par 1 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenit 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore".*

27. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu i referohen Aktgjykimit të Gjykatës në Rastin KI08/09, të nxjerrë më 17 dhjetor 2010.

28. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që *"ta ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, ashtu që revizioni i ushtruar nga paditësi të refuzohet si i pabazuar".*

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

31. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) c) dhe 36 (2) d) i Rregullores së punës, parasheh që:

> *(2) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *[...]*
>
> *c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*
>
> *c) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*
>
> *[...]*
>
> *d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

32. Parashtruesit pretendojnë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 210/13, i 18 dhjetorit 2013, është i njëanshëm, i padrejtë dhe arbitrar, për shkak se gjykata në fjalë i ndryshoi vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, të cilat ishin të formës së prerë dhe të detyrueshme, *res judicata*.

33. Gjykata vëren se "Kosovatrans"-i kishte të drejtë të ushtrojë revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimeve të gjykatave të instancave më të ulëta.

34. Gjykata konsideron se një vendim i gjykatës së instancës më të ulët nuk mund të konsiderohet i formës së prerë dhe i detyrueshëm, përderisa palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër tij në instancë më të lartë gjyqësore, siç është rasti konkret.

35. Gjykata më tej vëren se, Gjykata Supreme shqyrtoi çështjet, e ngritura në revizion duke dhënë arsye të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse.

36. Në të vërtetë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme kishte vlerësuar drejt situatën procedurale, duke theksuar:

> *"[...]*
>
> *Më datën 14.08.2006., që do të thotë para se është marrë aktgjykimi i shkallës së dytë Ac. Nr. 168/2006 dhe para se lënda është dërguar për rigjykim, përmes Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit është bërë privatizimi i të paduruës ["Kosovatrans"-i], si pasojë e së cilës një numri të madhe të punëtorëve, në mesin e tyre edhe paditësve, iu është përfunduar punësimi. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit për këtë i ka informuar punëtorët - edhe të padituri dhe ky fakt po ashtu në mes palëve nuk është kontestuese. Si pasojë e kësaj ka lindur pamundësia ligjore që paditësit të kthehen në vendet e tyre të punës, përkundër nxjerrjes së konkluzionit të gjykatës së shkallës së parë E. nr. 1348/2006 të datës 19.11.2007. më të cilin paditësit kthehen në punë te e paditura, për tu ekzekutuar aktgjykimi i parë i kësaj gjykate C. Nr. 250/2005 i datës 30.12.2005. Paditësit nuk kanë ushtruar kundërshtim kundër njoftimeve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 14.08.2006, edhe pse këtë të drejt ligjore e kanë pas".*

37. Më saktësisht, Gjykata Supreme theksoi:

> *"Gjykata komunale në Ferizaj sërish ka gjykuar çështjen e cila me aktgjykimin e Gjykatës së qarkut në Prishtinë Ac. nr. 168/2006 të datës 01.11.2006. është kthyer në rigjykim, për të vendosur vetëm në pjesën e cila është kthyer në rigjykim, pra, lidhur me kamatën dhe kompensimin e shujtës. Mirëpo, duke ngelur pranë kërkesëpadisë për shujtën, paditësit kanë ndryshuar, kërkesëpadinë duke prezantuar padinë e ndryshuar me shkrim më datën 29.02.2008. ashtu që i tërë objekti i shqyrtimit dhe i vendosjes me aktgjykimin e ri në pjesën e aprovimit të kërkesëpadisë, ka qenë kompensimi i të ardhurave nga puna për periudhën 2006.-2009., siç me detaisht u përshkrua më lartë".*

38. Gjykata Supreme konstatoi:

> *"... nga provat e administruara del se më datën 14.08.2006. është bërë privatizimi i të paditurës si tërësi dhe në shkresat e lëndës gjenden informatat zyrtare të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të dërguara paditësve në të cilat thuhet se pasoja e shitjes së aseteve të paditurës është përfundimi i punësimit të tyre, ndërsa kërkesat e punëtoreve lidhur me pagat do të shqyrtohen në procedurat e likuidimit.*
> *Janë të bazuara edhe pretendimet në revizion (e) se dërgimi i paditësve në pushim me pagesë prej 50 % të ardhurave nuk është i ndërlidhur me përfundimin e punësimit të tyre për shkak të privatizimit të paditurës, e cila paraqet bazë tërësisht tjetër për ndërprerjen e marrëdhënies se punës Vendimi që të padiurve iu ndërpritet marrëdhënia e punës nuk është marrë nga e paditura por nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit".*

39. Përfundimisht, Gjykata Supreme gjeti se "*e drejta materiale nuk është aplikuar drejt, për çka aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët u ndryshuan si në dispozitiv".*

40. Gjykata konsideron se Aktgjykimi (C. nr. 250/05) i Gjykatës Komunale në Ferizaj, i 30 dhjetorit 2005, i cili pretendohet të jetë bërë i formës së prerë dhe i detyrueshëm, nuk e prek Aktgjykimin (C. nr. 676/06) të gjykatës së njëjtë, të 7 majit 2009, i cili është objekt i revizionit të kontestuar të Gjykatës Supreme. Këto aktgjykime janë të ndërlidhura, por ato janë të ndara dhe të ndryshme.

41. Përveç kësaj, Aktgjykimi i 30 dhjetorit 2005 ka të bëjë me të ardhurat personale të parashtruesve të kërkesës, për periudhën prej 1 prillit 2004 deri më 30 dhjetor 2005, përderisa Aktgjykimi i 7 majit 2009, që ka të bëjë me të ardhurat personale të parashtruesve të kërkesës për periudhën prej 1 janarit 2006 deri më 30 prill 2009.

42. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë shpjeguar dhe dëshmuar si dhe pse konstatimi i Gjykatës Supreme se, "*e drejta materiale nuk ishte aplikuar drejt nga gjykatat e instancës më të ulët*" është i njëanshëm, i padrejtë dhe arbitrar, gjegjësisht ka shkelur parimet e *res judiciata*.

43. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës e bazojnë arsyetimin e tyre në praktikën gjyqësore të Gjykatës, përkatësisht duke pretenduar se rasti i tyre është i ngjashëm me KI08/09 (Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2010).

44. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se rrethanat faktike të rastit KI08/09 nuk janë të ngjashme me ato të parashtrueseve të kërkesës. Në të vërtetë, në rastin KI08/09, Gjykata konstatoi shkelje lidhur me mospërmbarimin e vendimit të shkallës së parë, i cili u bë i formës së prerë, sepse nuk ishte ushtruar asnjë ankesë kundër tij: në rastin e parashtruesve të kërkesës, palët e pakënaqura, siç u cek më lart, me legjitimitet të plotë, ushtruan revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët.

45. Prandaj, rrethanat e rastit të parashtruesve janë dukshëm të ndryshme nga rrethanat e Rastit KI08/09, kështu që parashtruesit e kërkesës nuk mund t'i referohen atij, për ta mbështetur pretendimin e tyre. Për më tepër, Gjykata thekson se në Rastin KI09/09, *"Dhoma e Posaçme, e kishte refuzuar ankesën e AKM-se, duke thëne se (...), AKM ka dorëzuar (...) duke ofruar argumente të detajuara qe ekskluzivisht merreshin me meritat e aktgjykimit te lëshuar në janar 2002. Sipas Dhomës se Posaçme, ishte e qarte se AKM po përpiqej të ankohej ndaj aktgjykimit të vitit 2002. Për me tepër, Gjykata Komunale ishte kompetente për të vendosur për padinë e janarit 2002, dhe se ky aktgjykim nuk ishte ankimuar e rrjedhimisht ishte bërë i formës së prerë (res judicata)..."*.

46. Përveç kësaj Dhoma e Posaçme vlerësoi se AKM-ja, *"që ishte themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 të datës 13*

qershor 2002, që do të thotë se është themeluar pasi qe vendimi i Gjykatës Komunale i datës 11 janar 2002 u bë res judicata…".

47. Për më tepër, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me aktgjykimin e nxjerrë nga Gjykata Supreme. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato dëshmi (shih, rasti *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Nr. 13071/87 Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

48. Në rastin konkret, Gjykata nuk konsideron që procedurat në Gjykatën Supreme, kanë qenë të njëanshme ose në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

49. Gjykata Kushtetuese më tej konsideron se pretendimi për shkelje, i bazuar në mosrespektim të vendimit të formës së prerë dhe të detyrueshëm është i pabazuar, pasi që faktet dhe argumentet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës nuk shpjegojnë në mënyrë logjike dhe nuk dëshmojnë në mënyrë të arsyeshme se Gjykata Supreme ka shkelur parimet *res judicata*.

50. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë për shqyrtim të mëtejmë të shkeljeve të tjera të pretenduara, siç janë të përmbledhura dhe të përfshira në pretendimin e parashtruesve për shkelje të të drejtave për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe për mjete efektive.

51. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesve është qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) c) 36 (2) b) dhe d); dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI52/14, Rasić Verica, Aksić Rašić Danijela, Aksić Dosta, Arsić Dragica, Bečelić Danica, Bulatović Rade, Cvejić (Mariković) Vesna, Furunović (llić) Dušanka, Galić Svetislav, Joksimović (Drašković) Jasmina, Joksimović Malina, Jovanović Milena, Kilibarda Branislav, Kilibarda (Arsić) Zlatana, Krivokapić Staljinka, Lekić Božidar, Lekić Duško, Maksimović Živko, Marinković Svetislav, Marinković Zoran, Micić Rodoljub, Milanović Vasna, Milošević Darko, Milovanović Nebojša, Milovanović Radovan, Milovanović Zlatija, Mitrović Bačević Dušanka, Nedeljković Stana, Novaković Dragoljub, Novaković Nikola, Novaković Zdenka, Ognjenović Miloslavka, Pavić Biserka, Stamenković-Janković Jasmina, Stojanović Desanka, Stojković (Nikolić) Vidosava, Trajković Zoran, Vasić Siniša dhe Kovačević Marija, Aktvendim i datës 3 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-12-0012, të 24 tetorit 2013

Rasti KI52/14, vendim i 3 korrikut 2014

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar, mos shterimi i mjeteve juridike

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktgjykimin AC-I-12-0012 të 24 tetorit 2013 refuzoi kërkesën e parashtruesve për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së "SLOGA".

Parashtruesit e kërkesës pretenduan se u është shkelur e drejta e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në dëm të tyre.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike për një parashtrues të kërkesës, ndërsa kërkesa e parashtruesve të tjerë u deklarua e papranueshme si qartazi e pabazuar. Gjykata Kushtetuese konstatoi se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Kolegjit të Ankesave është i qartë, gjithëpërfshirës dhe i drejtë.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI52/14
Parashtrues
Rasić Verica, Aksić Rašić Danijela, Aksić Dosta, Arsić Dragica, Bečelić Danica, Bulatović Rade, Cvejić (Mariković) Vesna, Furunović (llić) Dušanka, Galić Svetislav, Joksimović (Drašković) Jasmina, Joksimović Malina, Jovanović Milena, Kilibarda Branislav, Kilibarda (Arsić) Zlatana, Krivokapić Staljinka, Lekić Božidar, Lekić Duško, Maksimović Živko, Marinković Svetislav, Marinković Zoran, Micić Rodoljub, Milanović Vasna, Milošević Darko, Milovanović Nebojša, Milovanović Radovan, Milovanović Zlatija, Mitrović Bačević Dušanka, Nedeljković Stana, Novaković Dragoljub, Novaković Nikola, Novaković Zdenka, Ognjenović Miloslavka, Pavić Biserka, Stamenković-Janković Jasmina, Stojanović Desanka, Stojković (Nikolić) Vidosava, Trajković Zoran, Vasić Siniša dhe Kovačević Marija
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit AC-I-12-0012 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të 24 tetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga: Rasić Verica, Aksić Rašić Danijela, Aksić Dosta, Arsić Dragica, Bečelić Danica, Bulatovic Rade, Cvejić (Mariković) Vesna, Furunović (llić) Dušanka, Galić Svetislav, Joksimović (Drašković) Jasmina, Joksimović Malina, Jovanović Milena, Kilibarda Branislav, Kilibarda (Arsić) Zlatana, Krivokapić Staljinka, Lekić Božidar, Lekić Duško, Maksimović Živko, Marinković Svetislav, Marinković Zoran, Micić Rodoljub, Milanović Vasna, Milošević Darko, Milovanović Nebojša, Milovanović Radovan, Milovanović Zlatija, Mitrović Bačević

Dušanka, Nedeljković Stana, Novaković Dragoljub, Novaković Nikola, Novaković Zdenka, Ognjenović Miloslavka, Pavić Biserka, Stamenković-Janković Jasmina, Stojanović Desanka, Stojković (Nikolić) Vidosava, Trajković Zoran, Vasić Siniša dhe Kovačević Marija (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të cilët përfaqësohen nga z. Slavko D. Aničić, avokat nga Beogradi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin ASC-I-12-0012 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave), të 24 tetorit 2013, i cili u ishte dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 22 nëntor 2013.

3. Aktgjykimi u ishte dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 22 nëntor 2013. Parashtruesja e kërkesës, Stamenković-Janković Jasmina nuk ishte përmendur në atë aktgjykim.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'ua ketë mohuar parashtruesve të kërkesës të drejtën në 20% nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore HTP "SLOGA" nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: SLOGA).

5. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me vendimin e kontestuar u ishin shkelur të drejtat e tyre, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe neni 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 21 mars 2014, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 2 prill 2014, Kryetari, caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Kadri Kryeziu.

9. Më 14 maj 2014, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS).

10. Më 23 maj 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës, Stamenković-Janković Jasmina, që t'i sqarojë disa aspekte të procedurës së ankesave në DHPGJS.

11. Më 13 qershor 2014, parashtruesja e kërkesës, Stamenković-Janković Jasmina njoftoi se nuk ka vendim të Kolegjit të Ankesave lidhur me rastin e saj.

12. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën, për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor - korrik 2014, derisa Gjykata të vendos, përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.

13. Më 30 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu me gjyqtarin Ivan Čukalović si anëtar të Kolegjit shqyrtues.

14. Më 3 korrik 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 24 nëntor 2005, kishte filluar procesi i privatizimit të SLOGËS.

16. Më 5 gusht 2009, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) e publikoi listën përfundimtare të të punësuarve që kishin realizuar të drejtën në 20% të të ardhurave nga privatizimi i SLOGËS.

17. Më 26 gusht 2009, parashtruesit e kërkesës ushtruan ankesë në DHPGJS kundër vendimit, sipas të cilit është publikuar lista përfundimtare e punëtorëve me të drejtë në të ardhura nga privatizimi.

18. Më 23 dhjetor 2011, trupi gjykues i DHPGJS-së (Aktgjykimi SCEL-09-0023) i refuzoi kërkesat e parashtruesve, duke konsideruar se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë plotësuar kushtet e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, sepse shkëputja e marrëdhënies së punës së parashtruesve të kërkesës kishte ndodhur para 9 qershorit 1999.

19. Trupi gjykues i DHPGJS-së arsyetoi se:

> *"Sa i përket kritereve të parapara me ligj se i punësuari ka qenë në marrëdhënie të punës së paku tri vjet para privatizimit, Gjykata merr parasysh dëshmitë në renditjen vijuese: 1) të dhënat e punonjësit nga libri amzë, 2) të dhënat nga libri i punës së paditësit, 3) formularët e ashtuquajtur M1-M2 (formularin e sigurimit), ku përcaktohet fillimi dhe fundi i marrëdhënies së punës me NSH, dhe arsyet për ndërprerjen e sigurimit (dhe rrjedhimisht ndërprerja e marrëdhënies së punës), 4) certifikata e lëshuar nga Arkivi i Komunës së Prishtinës, që tregon kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës me NSH, 5) certifikata e lëshuar nga Bordi i Fondit Pensional të Kosovës, e cila parasheh kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës me NSH, 6) vendimet tjera dhe certifikata e NSH lidhur me marrëdhënien e punës së ankuesit me NSH, dhe vendimet për emërim në vendin e punës, për pushim vjetor, për caktimin e pagës, dhe kështu me rradhë".*

20. Më saktësisht, trupi gjykues i DHPGJS-së e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës, Biserka Pavić, me arsyetimin *"se ajo ka pasur pension invalidor, para privatizimit të SLOGËS.*

21. Në maj të vitit 2012, parashtruesit e kërkesës ushtruan ankesë kundër Aktgjykimit të trupit gjykues, *"për shkak të fakteve të gabuara, shkeljes së ligjit material dhe procedural".*

22. Më 24 tetor 2013, Kolegji i Ankesave (Aktgjykimi AC-I-12-0012) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi aktgjykimin e trupit gjykues.

23. Sidoqoftë, me Aktgjykimin e Kolegjit të Ankesave (AC-I-12-0012) nuk ishte shqyrtuar ankesa e parashtrueses së kërkesës,

Stamenković-Janković Jasmina. Edhe pse ajo parashtroi ankesën së bashku me parashtruesit e tjerë, Aktgjykimi i Kolegjit të Ankesave fare nuk e përmend as situatën e saj, e as emrin e saj.

Ligji i aplikueshëm

"RREGULLORE NR. 2003/13 MBI TRANSFORMIMIN E SË DREJTËS PËR PËRDORIMIN E PRONËS SË PATUNDSHME NË PRONËSI SHOQËRORE

Neni 10

Të drejtat e të punësuarve

10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilit pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qënë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"qëndrimi i mësipërm i këtyre kolegjeve– se parashtruesve të kësaj ankese u ka pushuar puna më 9.6.1999 – vjen si pasojë e vlerësimit jo mjaft të kujdesshëm dhe të pandërgjegjshëm të provave të administruara dhe vlerësimit të gabuar të rezultatit të të gjithë procedurës së zhvilluar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, që është haptazi në kundërshtim me provat e tjera që kanë vlerë më të madhe argumentimi, gjë që çon në nxjerrjen e përfundimit se kjo Gjykatë ka shkelur me vetëdije të drejtën e garantuar me Kushtetutë të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm (neni 31), në këtë rast, në dëm të parashtruesve të kësaj ankese".*

25. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se *"me Aktgjykimin SCEL-09-0023, të 23.12.2011 dhe Aktgjykimin AC-I-12-2012 të 24.10.2013 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në pjesën që kontestohet me këtë kërkesë, janë shkelur dispozitat e nenit 22 dhe nenit 31, lidhur me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe dispozita e nenit 6 (1) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, duke ua mohuar atyre të drejtën e pjesës së tyre në çmimin e shitblerjes së realizuar*

me shitjen e NSH - NHT "Sloga" në Prishtinë, të parashikuar nga dispozita e nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, datë 9 maj 2003".

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

28. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47.2 dhe 48. të Ligjit, i cili parasheh:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

29. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) a) dhe c) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar;

...

c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

30. Gjykata rikujton se vendimi i kontestuar nuk i është përgjigjur ankesës së parashtrueses së kërkesës, Stamenković-Janković Jasmina. Në këtë mënyrë, për shkak të një lëshimi të Kolegjit të Ankesave nuk është marrë asnjë vendim përfundimtar lidhur me ankesën e saj.

31. Gjykata e konsideron atë lëshim relevant për qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, pasi nuk ka vendim përfundimtar të Kolegjit të Ankesave në lidhje me ankesën e parashtrueses Stamenković-Janković Jasmina.

32. Gjykata konsideron se lëshimi i Kolegjit të Ankesave është çështje e ligjshmërisë dhe nuk është detyrë e Gjykatës që t'i korrigjojë gabimet e natyrës së tillë të gjykatave të rregullta. (Shih, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI104/13, parashtrues i kërkesës *Adem Maloku,* Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit ASC-11-0069 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, para 33).

33. Prandaj, parashtruesja e kërkesës, Stamenković-Janković Jasmina nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, të parapara me ligj, duke përfshirë kërkesën në Kolegjin e Ankesave me qëllim të nxjerrjes së një vendimi, sipas ankesës së saj.

34. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih, Aktvendimin për papranueshmëri: Universiteti *AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, i 21 janarit 2012, dhe *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

35. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme lidhur me parashtruesen e kërkesës, Stamenković-Janković Jasmina.

36. Sa u përket parashtruesve të kërkesës, Gjykata rikujton se ata pretendojnë se Kolegji i Ankesave nuk i ka vlerësuar dëshmitë e paraqitura në mënyrë mjaft të kujdesshme dhe të ndërgjegjshme dhe i ka vlerësuar gabimisht rezultatet e procedurave në tërësi, dhe për këtë arsye i ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë.

37. Gjykata vëren se Kolegji i Ankesave, për t'iu përgjigjur pretendimeve të ankesës, i mori parasysh të gjitha kushtet e përcaktuara me ligj që u mundësojnë të punësuarve të kenë të drejtë në pjesën e 20% nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore SLOGA.

38. Gjykata vëren më tej se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Kolegjit të Ankesave është i qartë, i kuptueshëm dhe i drejtë.

39. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk e kanë mbështetur pretendimin dhe as nuk kanë dëshmuar se Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme ua ka mohuar të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë.

40. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se është roli i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih*, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28; shih edhe rastin Nr. KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

41. Gjykata Kushtetuese thekson se konstatimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, shih edhe rastin Nr. KI86/11, parashtrues *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

42. Përveç kësaj, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me ato të gjykatave të rregullta, dhe si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë provat para vetes. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e

rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato prova (shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

43. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk e kanë arsyetuar pretendimin se ekziston e drejta për një pjesë të të ardhurave, edhe pas shkuarjes në pension të moshës/invalidor.

44. Për më tepër, fakti i thjeshtë se parashtruesit e kërkesës janë të pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të dispozitave të Kushtetutës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

45. Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkelje të të drejtave kushtetuese. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe (2) d) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe e papranueshme.

46. Në përgjithësi, kërkesa është e papranueshme, sepse parashtruesja e kërkesës, Stamenković-Janković Jasmina nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj dhe parashtruesit e tjerë nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetues, nenet 47.2 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) a) c) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI39/14, Bujar Spahiu, Aktvendim i datës 3 korrik 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 215/2013, të 9 dhjetorit 2013

Rasti KI 39/14, vendimii 3 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesa individuale, qartazi e pabazuar

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr 31/2013, të 13 marsit 2013. Parashtruesi i kërkesës ishte dënuar me 2 vjet burgim dhe me gjobë pasi u shpall fajtor për kryerjen e veprës penale të "posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike". Pasi Aktgjykimi i Gjykatës Supreme u bë i formës së prerë, parashtruesi i kërkesës filloi vuajtjen e dënimit të tij. Derisa ishte duke vuajtur dënimin e tij, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Themelore në Prizren për rishikimin e procedurës penale në rastin e tij. Gjykata Themelore në Prizren e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit ndërsa Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e refuzuan ankesën e tij respektivisht mbrojtjen e ligjshmërisë.

Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese me pretendimin se Aktgjykimi i kontestuar kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] paragrafi 6, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar. Në arsyetimin e saj, Gjykata Kushtetuese gjeti se gjykatat e rregullta kishin arsyetuar mirë vendimet e tyre dhe se argumentet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës ngrenë çështje të "*ligjshmërisë*" e jo të "*kushtetutshmërisë*". Për më tepër, Gjykata deklaroi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese në të cilat ai thirret.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI39/14
Parashtrues
Bujar Spahiu
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Pml. nr. 215/2013, të 9 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bujar Spahiu (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prizren, i përfaqësuar nga nëna e tij, znj. Ajshe Spahiu.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 215/2013, të 9 dhjetorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 13 janar 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 215/2013, të 9 dhjetorit 2013. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar dhe i vërtetoi aktvendimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore në Prizren, me të cilat i ishte refuzuar kërkesa e tij për përsëritje të procedurës penale.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 mars 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 1 prill 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI39/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari me Vendimin Nr. KSH. KI39/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

7. Më 22 prill 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor - korrik 2014, derisa Gjykata të vendos përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.

9. Më 3 korrik 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 6 shkurt 2012, Prokuroria Publike e Qarkut e akuzoi (PP. nr. 358/2012) parashtruesin e kërkesës, me dyshimin e kryerjes së veprës penale të "Blerjes, Posedimit, Shpërndarjes dhe Shitjes së Paautorizuar të Narkotikëve të Rrezikshëm dhe Substancave Psikotropike", në pajtim me nenin 229, paragrafin 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK).

11. Më 19 qershor 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin e saj, P. nr. 52/2012, e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor pas

pranimit të fajësisë për kryerjen e veprës penale, për të cilën ai ishte akuzuar. Gjykata e Qarkut e dënoi atë me 2 (dy) vjet burgim dhe me gjobë.

12. Momentalisht, parashtruesi i kërkesës është duke e vuajtur dënimin me burgim, i cili ishte vërtetuar dhe ishte bërë i formës së prerë me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 440/2012, të 1 nëntorit 2012.

13. Më 9 shtator 2013, gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Themelore në Prizren, për përsëritjen e procedurës penale, duke pretenduar se gjykata e instancës së parë [Gjykata e Qarkut në Prizren, Aktgjykimi P. nr. 52/2012, i 19 qershorit 2012] e kishte gjykuar rastin duke e bazuar vendimin e saj në prova, të cilat ishin marrë në mënyrë të paligjshme dhe në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK).

14. Më 8 tetor 2013, Gjykata Themelore në Prizren, me Aktvendimin e saj, PK. nr. 56/2013, e refuzoi kërkesën e parashtruesit për rishikim të procedurës, si të pabazuar, dhe theksoi:

> *"Kolegji shqyrtues ka konstatuar se pretendimet e të autorizuarit të gjykuarit [parashtruesi i kërkesës], [...] se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje ligjore dhe kjo bazuar në raportin policorë të dt. 22.11.2011, nr. 2011-DHTNS-O58 ku sipas përmbajtjes se të njëjtit Gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e bazon në prova të cilat janë siguruar në mënyrë të paligjshme dhe në kundërshtim me dispozitat e KPPK-së [Kodi i përkohshëm penal i Kosovës], nuk ka bazë ligjore në nenin 423 paragrafi 1 të KPP-së, për lejimin e rishikimit të procedurës penale, sepse faktet në të cilat mbështetet kërkesa e të autorizuarit për lejimin e rishikimit të procedurës nuk ofrojnë arsye për lejimin e rishikimit të kësaj procedure penale.*
>
> *Kolegji shqyrtues ka konstatuar se i dënuari-gjykuari Bujar Spahiu vullnetarisht e ka pranuar fajësisë në kuptim të dispozitave të KPPK-së, i cili pranim i fajësisë është bërë pas konsultimit të hollësishëm me mbrojtësin e tij, po ashtu i dënuari ka deklaruar se e ka kuptuar natyrën si dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se lidhur me deklarimin për pranimin e fajësisë ose jo i dënuari është udhëzuar me kohë para se të deklarohet dhe se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe çdo prove tjetër".*

15. Më 14 tetor 2013, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke kërkuar nga ajo që ta aprovojë kërkesën e tij për përsëritjen e procedurës penale. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendoi se: *"pasi që provat e mbledhura që janë siguruar nga ana e Policisë janë siguruar pa urdhër të Gjyqtarit të procedurës paraprake e që paraqet shkelje të dispozitës së nenit 246 paragrafi 1. të KPP, prandaj edhe aktgjykimi është i paligjshëm".*

16. Më 28 tetor 2013, Gjykata e Apelit (me Aktvendimin PN. nr. 668/2013) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, dhe konstatoi se:

> *"Gjykata e shkallës së parë [...] vlerësoj pretendimet nga kërkesa dhe në mënyrë të rrjedhshme ka dhënë arsye të mjaftueshme se kërkesa për rishikimin e procedurës penale të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë nuk ka bazë ligjore, pasi që mbrojtja e të akuzuarit* [parashtruesit të kërkesës] *nuk ka ofruar argumente bindëse që i mbështesin kërkesën e tillë, ashtu siç kërkohet me dispozitat e nenit 423 paragrafi 1 të KPP, dhe me këtë rast Gjykata e shkallës së parë në mungesë të bazës ligjore është dashtë ta hedhë kërkesën, konform dispozitës së nenit 426 paragrafi 1 të KPP.*
>
> *Mbrojtësi i të dënuarit* [parashtruesit të kërkesës] *në ankesën e tij nuk ka paraqitë prova të reja në kuptim të nenit 423 paragrafi 1 të KPP me të cilat do të provohet se aktgjykimi është mbështetur në dokument të falsifikuar ose në deklarim të rremë të dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit, se aktgjykimi është pasojë e veprës penale të kryer nga gjyqtari ose personi që ka ndërmarrë veprimet hetimore, zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja të cilat vetë ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetoj pafajësinë e personit të dënuar.*
> *[...]."*

17. Më 18 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke pretenduar se vendimet e Gjykatës Themelore në Prizren dhe të Gjykatës së Apelit përmbajnë shkelje të ligjit dhe shkelje thelbësore të dispozitave procedurale. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se:

"[...] Gjykata fare nuk ka shqyrtuar kërkesën e të gjykuarit [parashtruesit të kërkesës] *për rishikim të procedurës nuk ka vlerësuar pretendimet e mbrojtjes dhe me e rëndësishmja është se i gjykuari edhe pse ka pranuar fajësinë, pranimi i fajësisë nga i Gjykuari nuk është dashur të pranohet nga Gjykata konform nenit 315 paragrafi 1 pika 3 e KPPK-së ngase [...] Gjykata ka për obligim që zyrtarisht të kujdeset që pranimi i fajit të jetë i mbështetur në faktet e çështjes qe përmban aktakuza, në mbështetje me provat dhe materialet e prezantuara nga Prokurori dhe ne çdo provë tjetër".*

18. Më 9 dhjetor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pml. nr. 215/2013 [aktgjykimi i kontestuar], refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, duke konstatuar që:

"[...] edhe sikur të ishin të sakta pretendimet e tilla e që në rastin konkret janë të pabazuara, ngase pranimi i fajësisë ishte i mbështetur në të gjitha aspektet në normën ligjore qe ka rregulluar çështjen e pranimit të fajësisë , kjo nuk mund të jetë bazë ligjore për rishikimin e procedurës penale , ngase sipas dispozitës së nenit 423 të KPPK-së, në mënyrë eksplicite janë përcaktuar rastet kur mund të lejohet rishikimi i procedurës penale në favor të pandehurit, në rastin konkret nuk është përmbushur asnjë konditë ligjore nga ky nen që do justifikonte lejimin e rishikimit , dmth. gjykatat e instancave më të ulëta drejt kanë vepruar kur kanë refuzuar kërkesën për rishikimin e procedurës penale ndaj të pandehurit [parashtruesit të kërkesës], *për këto arsye kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë rezulton të jetë e pabazuar".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 215/2013, të 9 dhjetorit 2013, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë dhe duke mos aprovuar kërkesën e tij për përsëritje të procedurës penale, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], paragrafi 6, neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike].

20. Lidhur me shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij, sipas nenit 30, paragrafi 6 i Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se ai: "*është detyruar ta pranojë fajsinë, i detyruar dhe nën kërcnimin e*

Policisë, e kjo rrethanë nuk është marrë fare parasyshë nga ana e Gjykatës".

21. Sa i përket shkeljes së pretenduar të të drejtave të tij, sipas nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës deklaron se: "*[...] refuzimi i kërkesës për rishikimin e procedurës penale [...] është i paligjshëm dhe në kundërshtim me parimet kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës neni 31 par. 2, për një gjykim të drejtë dhe te paanshëm".*

22. Lidhur me shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij, sipas nenit 32 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës deklaron se: "*Refuzimi i kërkesës për rishikimin e procedurës penale është në kundërshtim me dispozitat e nenit 427 dhe 423 të KPPK-së, pasi që edhe pse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për rishikimin e procedurës penale Gjykata ka refuzuar këtë kërkesës, kjo në kundërshtim me nenin 32 të Kushtetutës [...]*".

23. Në përmbledhjen e pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës thekson: *"... e tërë procedura penale ishte e përfshirë me shkelje ligjore, ndërsa aktgjykimi bazohej në prova të paligjshme që cenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut ngase ndaj të gjykuarit [parashtruesit të kërkesës] është ushtruar kontrollë dhe bastisje, pastaj sekuestrim i sendeve në kundërshtim me ligjin, pa urdhëresë të Gjykatës sipas nenit 423 paragrafi 2 nënparagrafi 1.1 i Kodit të Pocedurës Penale të Kosovës që kanë qenë në fuqi, as kjo provë dhe asnjë vendim i Gjykatës nuk mund të bazohet në këto prova siq nuk mund të bazohet as pranimi i fajsisë".*

24. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata*: "[...] që vendimet e Gjykatës së (Qarkut) Themelore në Prizren P. nr. 52/2012 të datës 19.06.2012, aktvendimin PK. nr. 56/2012 të datës 08.10.2013, aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Pn. të datës nr. 668/2013 të dates 28.10.2013 dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 215/2013 të dates 09.12.2013, ti shpallë nul për shkak se janë të përfshira me shkelje ligjore dhe me shkelje të të drejtave elementare të të gjykuarit [parashtruesi i kërkesës] Bujar Spahiu të garantuara me nenet 30, 31 dhe 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".*

Dispozitat relevante të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale lidhur me ankesën e parashtruesit të kërkesës

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (UNMIK/REG/2003/25 i 6 korrikut 2003)

Neni 229 [Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike]

[...]

(2) Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton ose dërgon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë ose substanca psikotrope me qëllim shpërndarjeje, shitjeje ose oferte për shitje dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në tetë vjet.

[...]

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës (UNMIK/REG/2003/26 i 6 korrikut 2003)

Neni 315

(1) Kur i pandehuri pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës sipas nenit 314, paragrafi 4 i këtij Kodi, gjyqtari përcakton nëse:

1) I pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;

2) Pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i pandehuri ka mbrojtës;

3) Pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezentuara nga prokurori për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori ose i pandehuri dhe

4) Nuk ekziston asnjë nga rrethanat nga neni 316, paragrafi 1 deri në 3 i këtij Kodi.

(2) Duke vlerësuar pranimin e fajësisë së të pandehurit, gjyqtari mund të kërkojë mendimin e prokurorit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

(3) Kur gjyqtari nuk pajtohet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1 i këtij neni, ai procedon me seancën e konfirmimit sikur pranimi i fajësisë të mos ishte bërë.

(4) Kur gjyqtari pajtohet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1 i këtij neni, ai merr aktvendim me të cilin pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe vepron sipas nenit 316.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (Nr. 04/L-123 i 13 dhjetorit 2012)

Neni 423 [Rishikimi i procedurës penale të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë]

1. Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm nëse:

1.1. provohet se aktgjykimi është mbështetur në dokument të falsifikuar ose në deklarim të rremë të dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit;

1.2. provohet se aktgjykimi është pasojë e veprës penale të kryer nga gjyqtari ose personi që ka ndërmarrë veprimet hetimore;

1.3. zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat vetë ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimin e tij sipas një dispozite më të butë penale;

1.4. personi për të njëjtën vepër është gjykuar disa herë ose kur disa persona janë dënuar për vepër të njëjtë të cilën ka mund ta kryejë vetëm një person ose disa prej tyre; ose

1.5. në rastin e dënimit për vepër penale në vazhdim ose vepra tjera penale të cilat sipas ligjit përfshijnë disa veprime të njëjta ose të ndryshme, zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja që tregojnë se i dënuari nuk ka kryer veprimin që është përfshirë në veprën penale

për të cilën ai është dënuar dhe ekzistimi i fakteve të tilla do të ishte me ndikim vendimtar në caktimin e dënimit.

2. Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm në favor të të pandehurit, përveç nëse vërtetohet që rrethanat nga paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të këtij neni janë pasojë e veprës penale të kryer nga i pandehuri ose personi që vepron në emër të tij kundër një dëshmitari, eksperti, përkthyesi, prokurori të shtetit ose gjyqtari apo të 172 afërmve të tyre, me ç'rast procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet kundër të pandehurit. Rishikimi i procedurës penale kundër të pandehurit lejohet vetëm brenda pesë (5) vjetëve nga koha e shpalljes së aktgjykimit të formës së prerë.

3. Në rastet nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. dhe 1.2. ose paragrafi 2. i këtij neni, me aktgjykim të formës së prerë duhet vërtetuar se personat e tillë a janë shpallur fajtor për veprat penale përkatëse. Kur procedura kundër këtyre personave nuk mund të zbatohet për shkak se kanë vdekur ose ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, faktet nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. dhe 1.2. ose paragrafi 2. i këtij neni mund të vërtetohen edhe me prova të tjera.

Neni 426 [Baza dhe procedura për hedhjen e kërkesës për rishikim të procedurës penale]

1. Gjykata me aktvendim hudh kërkesën kur në bazë të saj dhe shkresave të procedurës së mëparshme vërteton se:

1.1. kërkesën e ka parashtruar personi i paautorizuar;

1.2. nuk ka bazë ligjore për rishikim të procedurës;

1.3. faktet dhe provat në të cilat mbështetet kërkesa janë paraqitur në kërkesën e mëparshme për rishikim të procedurës e cila është refuzuar me aktvendim të formës së prerë;

1.4. faktet dhe provat nuk ofrojnë aryse për lejim të rishikimit të procedurës; ose

1.5. parashtruesi i kërkesës për rishikim të procedurës nuk ka vepruar sipas nenit 425, paragrafit 2. të këtij Kodi.

2. Kur gjykata nuk e hudh kërkesën, kopja e kërkesës i dërgohet prokurorit të shtetit ose palës kundërshtare, e cila ka të drejtë që brenda tetë (8) ditëve të përgjigjet në kërkesë. Pasi gjykata të merr përgjigje në kërkesë ose kur kalon afati për paraqitjen e përgjigjes, kryetari i kolegjit shqyrtues 173 urdhëron gjurmimin dhe shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura në kërkesë dhe në përgjigje.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Para së gjithash, në mënyrë që të jetë në gjendje ta gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) dhe 36 (2) b) të Rregullores së punës, që parashohin:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se

: [...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...]"

27. Siç u përmend më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 215/2013, është marrë me shkelje të nenit 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], paragrafi 6, të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

28. Gjykata vëren se në procedurën e ankesës, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme përkitazi me kërkesën për rishikim të procedurës penale, i arsyetuan vendimet e tyre duke iu referuar dispozitave të ligjit në fuqi. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se ajo që parashtruesi ngre është çështje e ligjshmërisë dhe jo e kushtetutshmërisë.

29. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme në përgjigjen ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të ligjit dhe për shkelje substanciale të dispozitave procedurale, që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata e Apelit, kur kjo e fundit e refuzoi ankesën e tij për rishikim të procedurës penale. Gjykata Supreme theksoi që: "*sipas dispozitës së nenit 423 të KPPK-së, në mënyrë eksplicite janë përcaktuar rastet kur mund të lejohet rishikimi i procedurës penale në favor të pandehurit, në rastin konkret nuk është përmbushur asnjë konditë ligjore nga ky nen që do justifikonte lejimin e rishikimit, dmth. gjykatat e instancave më të ulëta drejt kanë vepruar kur kanë refuzuar kërkesën për rishikimin e procedurës penale […]*".

30. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

31. Gjykata Kushtetuese më tej thekson se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011). Thjeshtë fakti se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë. Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës i ishin ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e tij në gjykatat e rregullta.

32. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).

33. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se arsyetimi lidhur me kërkesën për rishikimin e procedurës penale në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave,

Gjykata gjeti se procedurat në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Themelore nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

34. Për arsyet e mësipërme, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të së drejtës kushtetuese, në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës.

35. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) c), 36 (2) b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese Prof. Dr. Enver Hasani

KI03/14, Afrim Terpeza, Aktvendim i datës 2 korrik 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 214/2013, të 12 dhjetorit 2013

Rasti KI 03/14, vendimi i 2 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 214/2013, të 12 dhjetorit 2013. Gjykata Komunale e dënoi parashtruesin e kërkesës me 6 muaj burgim për kryerjen e veprës penale të "rrezikimit të rendit publik". Pas një ankese të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata e Qarkut e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe e ktheu rastin për rigjykim. Pas rigjykimit, Gjykata Komunale e dënoi parashtruesin e kërkesës me të njëjtin dënim. Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e refuzuan ankesën e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe vërtetuan vendimin e fundit të Gjykatës Komunale.

Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me pretendimin se Aktgjykimi i kontestuar kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 30 [Të drejtat e të Akuzuarit] paragrafët 2 dhe 5, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] paragrafët 4 dhe 6, nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 106 [Papajtueshmëria] paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Parashtruesi i kërkesës pretendoi edhe shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me nenin 7 dhe 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar. Gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata Kushtetuese i ka ndarë pretendimet e parashtruesit të kërkesës në tri pika kryesore:

A) Gjykata Komunale nuk e kishte udhëzuar për të drejtën për mbrojtje;

B) Parashtruesi i kërkesës nuk kishte pasur mundësinë t'u parashtrojë pyetje dëshmitarëve, ekspertëve apo palëve të dëmtuara; dhe

C) Gjykata Supreme nuk e shqyrtoi mundësinë e shqiptimit të një dënimi alternativ

Në lidhje me pretendimet nën A), Gjykata Kushtetuese deklaroi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte pretenduar shkelje të tillë para gjykatave të rregullta. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të së drejtës për të pasur mbrojtës, të cilën duhet shqyrtuar.

Në lidhje me pretendimet nën B), Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesi i kërkesës duhet t'u kishte ofruar mundësinë gjykatave te rregullta për t'i shqyrtuar këto ankesa te veçanta dhe nëse është e nevojshme t'i korrigjojë ato në përputhje me juridiksionin dhe kompetencat ligjore.Në fund, në lidhje me pretendimet nën C), Gjykata Kushtetuese vlerësoi se argumentet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë dhe se ai nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI03/14
Parashtrues
Afrim Terpeza
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 214/2013,
të 12 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Afrim Terpeza, nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga z. Sevdali Zejnullahu.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 214/2013, të 12 dhjetorit 2013, me të cilin refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, pas aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe të Gjykatës së Apelit. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme iu dorëzua atij më 15 dhjetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë *"shkelur të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 3 [Barazia Para Ligjit], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia Para Ligjit], nenin 30, paragrafët 2 dhe 5 [Të Drejtat e të Akuzuarit], neni 31, paragrafi 4 dhe 6 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të*

Paanshëm], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe neni 106, paragrafi 2 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë:KEDNJ) dhe nenin 7 dhe 10 të Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).”

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 janar 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 30 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kyeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 10 shkurt 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu njoftoi me shkrim Gjykatën për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese për periudhën qershor - korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.

9. Më 2 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës, zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu me gjyqtarin Ivan Čukalović, si anëtar i Kolegjit shqyrtues.

10. Më 2 korrik 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 29 janar 2008, Gjykata Komunale (Aktgjykimi P. nr. 962/2007), e dënoi parashtruesin e kërkesës me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj për kryerjen e veprës penale të rrezikimit të trafikut publik.

12. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale, për shkak të vlerësimit jo të drejtë të rrethanave lehtësuese dhe atyre veçanërisht lehtësuese dhe propozoi që *"(...) pasi ta shqyrtoj aktgjykimin e shkallës së parë, në kuptim të nenit 415 par 1 të KPPPK-së, të njëjtin ta ndryshoj në pikëpamje të vendimit mbi dënimin, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim me kusht"*.

13. Më 18 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut (Aktgjykimi AP. nr. 319/2008), e anuloi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe e ktheu rastin në rigjykim.

14. Më 16 qershor 2011, pas rigjykimit, Gjykata Komunale (P. nr. 1940/2011) e dënoi parashtruesin e kërkesës me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj.

15. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi, duke propozuar që "[...] *gjykata e shkallës së dytë (...) aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarin ta liroj nga akuza, apo ta dënoj me dënim me kusht"*.
16. Më 5 qershor 2013, Gjykata e Apelit (PA1. nr. 780/12) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

17. Gjykata e Apelit konstatoi se *"[...] se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, se është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Në prani të gjitha këtyre rrethanave nuk ka pasur vend që të akuzuarit ti shqiptohet ndonjë dënim më i butë, apo dënim me kusht siç pretendon mbrojtësi i të akuzuarit"*.

18. Më 18 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, duke argumentuar që *"[...] të gjitha kushtet janë përmbushur në mënyrë kolegji i kësaj Gjykate (Gjykatës Supreme) ta ndryshojë vendimin dhe ta zëvendësoj me gjobë dënimin me burgim apo dënime tjera alternative"*.

19. Më 2 dhjetor 2013, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 214/2013), vendosi *"ta refuzoj si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë",* duke konstatuar se *"Pretendimet e të gjykuarit për shkelje të ligjit penal nuk qëndrojnë"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi (P. nr. 1940/2011, i 16 qershorit 2011), i nxjerrë nga Gjykata Komunale, kishte shkelur të drejtat e tij "[...] *ku është zhvilluar procedura nuk është udhëzuar për të drejtën për të patur mbrojtës, që e cila garantohet me kushtetutë dhe me Kodin Penal*".

21. Parashtruesi i kërkesës më tutje thekson se *"asnjëherë nuk i është dhënë mundësia që të parashtroj pyetje ndaj dëshmitarëve ekspertit dhe të dëmtuarve"* që pretendohet të ketë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës deklaron se "[...] *eksperti i komunikacionit kurrë nuk ka marrë pjesë në seancë [...] dhe kjo shkeli të drejtën time të parashtroj pyetje, [...] dhe në pjesën hyrëse të Aktgjykimit nuk është potencuar se pse ai nuk ka marrë pjesë*".

22. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme "[...] *asnjëherë nuk e kishte shqyrtuar mundësinë e dënimit alternativ [...]* dhe kështu kishte shkelur të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe DUDNJ.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Para së gjithash, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmërinë e kërkesës.

24. Në këtë drejtim, neni 113 i Kushtetutës parasheh:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*
>
> *[...]*
>
> *"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

25. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh se *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".*

26. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar mbrojtje të të drejtave të tij në gjykatën e shkallës së parë

dhe të dytë dhe në fund, në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme më 15 dhjetor 2013 dhe ai e parashtroi kërkesën e tij në Gjykatë më 9 janar 2014.

27. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të aplikueshëm dhe kërkesa është dorëzuar brenda afatit kohor prej 4 (katër) muajve.

28. Megjithatë, Gjykata duhet të marrë parasysh nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës.

Neni 48 i Ligjit

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Rregulli 36 i Rregullores së punës

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".

"(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

29. Parashtruesi i kërkesës, siç është thënë më lart, e kontestoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, në Gjykatën Supreme, për shkelje të Ligjit penal dhe të Ligjit të procedurës penale.

30. Ndërkohë, parashtruesi i kërkesës i kishte ngritur tri pretendime në Gjykatën Kushtetuese, përkatësisht:

A) Aktgjykimi (P. nr. 1940/2011, i 6 qershorit 2011) i Gjykatës Komunale i kishte shkelur të drejtat e tij, sepse ai nuk e kishte udhëzuar për të drejtën për të pasur mbrojtës;

B) të drejtat e tij ishin shkelur, sepse ai nuk kishte pasur mundësinë t'u parashtrojë pyetje dëshmitarëve, ekspertëve apo palëve të dëmtuara;

C) Aktgjykimi (Pml. nr. 214/2013, i 12 dhjetorit 2013), i Gjykatës Supreme i kishte shkelur të drejtat e tij, sepse nuk kishte shqyrtuar mundësinë e shqiptimit të dënimit alternativ.

A) Gjykata Komunale nuk e kishte udhëzuar për të drejtën për mbrojtës

31. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ishte përfaqësuar nga një avokat, vetëm në procedurën e mbajtur në Gjykatën Komunale (Aktgjykimi P. nr. 962/2007, i 29 janarit 2008). Sidoqoftë, pas asaj date, pasi rasti është kthyer për rigjykim, parashtruesi i kërkesës përfaqësohej gjithmonë nga një avokat në procedurë.

32. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk kishte pretenduar në gjykatat e rregullta shkeljen e të drejtës së tij për të pasur mbrojtës.

33. Prandaj, Gjykata konkludon se nuk ka pasur shkelje të së drejtës për të pasur mbrojtës, të cilën duhet shqyrtuar.

B) Parashtruesi i kërkesës nuk kishte pasur mundësinë t'u parashtrojë pyetje dëshmitarëve, ekspertëve apo palëve të dëmtuara

34. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk kishte pretenduar shkelje të të drejtave të tij për parashtrimin e pyetjeve ndaj dëshmitarëve, ekspertëve apo palëve të dëmtuara. Ai vetëm pohoi se kushtet për të zëvendësuar dënimin me burg me një dënim alternativ janë përmbushur. Prandaj, Gjykata Supreme nuk mundi t'i marrë në konsiderim pretendimet e tilla.

35. Gjykata rikujton se një nga parimet themelore të vlerësimit kushtetues, është parimi i subsidiaritetit. Në kontekstin e veçantë të Gjykatës Kushtetuese, do të thotë që detyra për të siguruar respektimin e të drejtave të parashikuara nga Kushtetuta, u takon në radhë të parë autoriteteve vendore gjyqësore, dhe jo drejtpërsëdrejti apo menjëherë Gjykatës Kushtetuese (shih, *Scordino kundër Italisë*, nr. 1, [DHM], § 140),

36. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës duhet t'u kishte ofruar mundësinë gjykatave të rregullta për t'i

shqyrtuar këto ankesa të veçanta dhe nëse është e nevojshme t'i korrigjojë ato në përputhje me juridiksionin dhe kompetencat ligjore.

C) Gjykata Supreme nuk e shqyrtoi mundësinë e shqiptimit të një dënimi alternativ

37. Gjykata vëren se Gjykata Supreme e adresoi ankesën parashtruesit të kërkesës, duke shpjeguar se *"Dispozitat e Kodit Penal dhe atë të nenit 47 dhe 48 të KPK, parashikojnë mundësinë e gjykatës por jo edhe obligimin që të dënuarit t'i zëvendësohet dënimi me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj me gjobë apo me urdhër për pune në dobi të përgjithshme, por nuk parashikojnë detyrimin e gjykatës për të vepruar ashtu. Këto dy dispozita [...], nuk lejojnë mundësi të interpretimit në mënyrë si gabimisht e ka bërë i gjykuari nga se shumë qartë rregullon kushtet e zëvendësimit të dënimit të shqiptuar me burg dhe se kjo është mundësia të cilën e ka vetëm gjykata e shkallës së parë [...]".*

Sa i përket pretendimit për shqiptimin e dënimit të kushtëzuar përpos thirrjes në dispozitën e nenit 51 dhe 52 të KPK, dhe përshkrimit te këtyre dy dispozitave të cilat i rregullojnë kushtet e shqiptimit të dënimit me kusht në kërkesë fare nuk arsyetohet kjo kërkesë.
[...]"

38. Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata Supreme iu përgjigj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përkitazi me dënimin me burgim, duke konstatuar se *"janë vlerësuar te gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 dhe 74 të KPK, dhe se ato janë të konstatuara në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë. [...] Andaj, nuk qëndron pretendimi në kërkesë përgjoja mbi vlerësimin e rrethanave rënduese nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë siç pa bazë pretendohet në kërkesë, por në kuadër të këtyre rrethanave janë vlerësuar edhe rrethanat lehtësuese por edhe ato rënduese të cilat me të drejtë elaborohen në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë".*

39. Gjykata konsideron se arsyetimi i ofruar me Gjykatën Supreme në përgjigjen ndaj pretendimeve të bëra nga parashtruesi i kërkesës, në lidhje me vendimin për dënim, është i qartë, i arsyetuar dhe i drejtë.

40. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të trajtojë gabimet e fakteve apo ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

41. Gjykata Kushtetuese gjithashtu rithekson që nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, KEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28, shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

42. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta në përgjithësi dhe të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, 10 korrik 1991).

43. Gjykata konsideron se procedura në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme, kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, KEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

44. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, Vendimi i GJEDNJ-së, nr. 53363/99, i 31 majit 2005) dhe se ai nuk saktësoi se nenet e përmendura të Kushtetutës, KEDNJ-së dhe DUDNJ-së mbështesin pretendimin e tij, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 48 të Ligjit.

45. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës as nuk ka sqaruar me saktësi se si dhe pse mohimi nga Gjykata Supreme i zëvendësimit të dënimit të tij me burgim me një dënim alternativ përbën shkelje të të drejtave dhe lirive të tij individuale, të garantuara me Kushtetutë dhe as që i ka paraqitur faktet për arsyetimin e pretendimit për një shkelje të tillë.

46. Si përmbledhje, pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive të tij janë të paargumentuara dhe të padëshmuara.

47. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konsideron se, në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe (2) b), kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit, rregullat 36 (1) c), 36 (2) b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 2 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI117/12/A, KI119/12/A, KI121/12/A, KI138/12, Fatmire Berisha, Musa Pllana dhe Ismije Pllana, Vesel Bardhi, Ramë Berisha dhe Dragica Stanojević, Aktvendim i datës 11 shkurt 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 130/12, të 17 shtatorit 2012, Ac. nr. 1070/2012, të 2 majit 2013, Ac. nr. 138/12, të 9 korrikut 2012, Ac. nr. 1068/2012, të 2 majit 2013.

Rastet e bashkuara, KI117/12/A, KI119/12/A, KI121/12/A, KI138/12, vendimi i 11 shkurtit 2014.

Fjalë kyçe: Kërkesa individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ata kanë punuar në NSH "Qyqavica", në Vushtrri deri më 1991, kur forcat serbe i dëbuan me forcë nga puna dhe i diskriminuan.

Parashtruesit pretendojnë se ishin shkelur të drejtat e tyre, të garantuara me Kushtetutë, sepse ata kanë të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së "Qyqavica" si formë e kompensimit për pagat e tyre prej vitit 1991 deri më 1999. Parashtruesit thirren në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Gjykata vëren se parashtruesit nuk e kanë mbështetur pretendimin e tyre në baza kushtetuese dhe nuk kanë ofruar prova se të drejtat dhe liritë themelore u janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, rregullin 36 (1) a) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 19 nëntor 2013, njëzëri deklaron kërkesën të papranueshme si qartazi të pa bazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr.
KI117/12, KI118/12, K119/12, KI121/12, KI124/12, KI125/12
Parashtrues
Fatmire Berisha, Musa Pllana dhe Ismije Pllana, Vesel Bardhi, Ramë Berisha dhe Dragica Stanojević
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri të Republikës së Kosovës, C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesat u dorëzuan nga parashtruesit si në vijim:
   KI117/12 Fatmire Berisha, me vendbanim në Mitrovicë;
   KI118/12 Musa dhe Ismije Pllana, me vendbanim në Vushtrri;
   KI119/12 Vesel Bardhi, me vendbanim në Vushtrri;
   KI121/12 Ramë Berisha, me vendbanim në Vushtrri;
   KI124/12 Dragica Stanojević, me vendbanim në Vushtrri dhe
   KI125/12 Zlatana Nikić, me vendbanim në Vushtrri.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit në kërkesë ankohen për mospërmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri të Republikës së Kosovës, C. nr. 215/06 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale në Vushtrri), të 3 korrikut 2006, i cili është pranuar nga parashtruesit në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale në Vushtrri.

Baza juridike

4. Kërkesat bazohen në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesit i dorëzuan kërkesat e tyre ndërmjet 20 nëntorit 2012, dhe 31 dhjetorit 2012.

6. Më 1 janar 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI117/12, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI117/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 19 prill 2013, kërkesat iu komunikuan Gjykatës Themelore në Vushtrri (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

8. Më 16 janar 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese nxori Vendimin (KI117/12, KI118/12, KI119/12, KI121/12, KI124/12 dhe KI125/12), për bashkimin e kërkesave.

9. Më 22 nëntor 2013, në pajtim me rregullin 37 të Rregullores së punës, Gjykata i informoi parashtruesit për bashkimin e kërkesave.

10. Parashtruesit nuk kanë paraqitur asnjë kundërshtim kundër vendimit për bashkimin e kërkesave.

11. Më 11 shkurt 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesit ishin punonjës në Ndërmarrjen shoqërore "Çyçavica" deri në vitin 1992.

13. Në bazë të dokumenteve të dorëzuara, bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006, NSH "Çyçavica" në Vushtrri ishte urdhëruar t'ua rikthejë të gjitha të drejtat e pagave për periudhën nga viti 1992 deri më 1999, me një kamatë prej 4.5% në vit, që nga 29 qershori 2005 deri në pagesën përfundimtare për të gjithë parashtruesit. Pasi që nuk është ushtruar asnjë ankesë kundër tij, vendimi mori formën e prerë më 15 shtator 2006. Megjithatë, ai kurrë nuk u përmbarua.

14. Parashtruesit e parashtruan kërkesën në Gjykatën Komunale në Vushtrri për përmbarimin e aktgjykimit të mëparshëm të Gjykatës Komunale, C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006.

15. Më 5 tetor 2006, Gjykata Komunale në Vushtrri vendosi për përmbarimin e Aktgjykimit C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006 (p. sh., Vendimi E. nr. 845/06, i 5 tetorit 2006, në rastin e parashtrueses së parë, Fatmire Berisha). Llogaria e NSH "Çyçavica" ishte bllokuar dhe "Banka e Re e Kosovës", dega në Vushtrri, ishte urdhëruar t'ua paguajë parashtruesve shumën e specifikuar së bashku me kamatën e caktuar.

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesit pretendojnë se ata kanë punuar në NSH "Çyçavica" në Vushtrri deri në vitin 1991, kur forcat serbe i dëbuan me forcë nga puna dhe i diskriminuan.

17. Parashtruesit pretendojnë se ishin shkelur të drejtat e tyre, të garantuara me Kushtetutë, sepse ata kanë të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Çyçavica" si një formë e kompensimit për pagat e tyre për periudhën nga viti 1991 deri më 1999.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesve, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të

përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Sa i përket kërkesës së parashtruesve, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) h), i cili përcakton si në vijim: "*Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën".*

20. Për ta përcaktuar juridiksionin kohor të Gjykatës, është me rëndësi të identifikohet, në secilin rast specifik, koha e saktë e shkeljes së pretenduar. Me këtë rast, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat parashtruesit ankohen si dhe përmasën e së drejtës kushtetuese që pretendohet të jetë shkelur (shih, *mutatis mutandis,* Aktgjykimi i Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Rastin *Blečić kundër Kroacisë,* Kërkesa Nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, para. 82).

21. Gjykata vëren se parashtruesit ankohen për moskompensimin e pagave të tyre prej vitit 1992 deri më 1999. Në këtë drejtim, parashtruesit pretendojnë se ka pasur shkelje për shkak të mospërmbarimit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006.

22. Kjo do të thotë se shkelja e pretenduar e të drejtës së parashtruesve, e garantuar me Kushtetutë, kishte ndodhur para 15 qershorit 2008, gjegjësisht datës kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta, nga e cila datë Gjykata ka juridiksion kohor.

23. Për më tepër, në lidhje me rastet e gjykuara nga Gjykata sa i përket pezullimit të procedurës përmbaruese, konkretisht në lidhje me rastin Nr. KI08/09, Sindikata e pavarur e punonjësve të Fabrikës së çelikut - IMK Ferizaj, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2010, Gjykata konsideron se në bazë të dokumenteve të parashtruara dhe të procedurave të përfunduara, kjo kërkesë ndryshon nga rasti i sipërpërmendur.

24. Gjykata thekson se në fakt ajo është kompetente për shqyrtimin e fakteve të rastit konkret sa i përket pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën, vetëm për aq sa ato kanë ndodhur pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata mund t'i marrë parasysh faktet, që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, për aq sa mund të konsiderohet se ato kanë krijuar një situatë që shtrihet përtej asaj date, apo që mund të jetë me rëndësi për t'i kuptuar faktet të cilat kanë ndodhur pas asaj date.

25. Lidhur me siç u tha më sipër, në rastin konkret gjendja dallon nga rasti Nr. KI08/09, Sindikata e pavarur e punonjësve të Fabrikës së çelikut - IMK Ferizaj, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2010. Përkatësisht, Gjykata vëren se parashtruesit nuk kanë bërë asnjë përpjekje që Aktgjykimi i tyre të përmbarohet, pasi që ata kanë pritur 6 (gjashtë) vjet para se të parashtrojnë kërkesat e tyre në Gjykatë. Dhe duke supozuar që parashtruesit nuk kanë pasur mjete efektive juridike sikurse pretendohet, Gjykata vëren se ata kanë qenë të njoftuar për këtë shumë kohë para muajve nëntor/dhjetor 2012, periudhë kjo kur ata i kanë parashtruar kërkesat e tyre, për dallim nga rasti KI08/09 të cilët e kanë parashtruar kërkesën e tyre më 3 mars 2009, dmth. brenda afatit kohor prej 4 (katër) muajve pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, siç përcaktohet në nenin 56 (Rastet paraprake) të Ligjit.

26. Gjithashtu, parashtruesit është dashur që në mënyrë bindëse të tregojnë se ka pasur përparim të vazhdueshëm dhe konkret përgjatë 10 (dhjetë) viteve të kaluara, që do të mund ta arsyetonte vonesën në parashtrimin e kërkesës në Gjykatë.

27. Nga kjo rrjedh se kërkesa e parashtruesve nuk është *ratione temporis* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullat 36 (3) h) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 shkurt 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikoj këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI208/13, Rexhep Kabashi, Aktvendim i datës 8 maj 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ACI-13-0094-A0001, të 30 tetorit 2013

Rasti KI 208/13, vendimi i 8 majit 2014.

Fjalët kyçe: shkelje e dispozitave kushtetuese, nene 24, 31, 32, kërekesë individuale, palë e pa autorizuar.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushteutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese janë cenuar me aktgjykimin e gjykatave të rregullta. Parashtrusi kishte parashtruar nje kerkese per mbrojtje te ligjshmerise së Dhomes së Posaçme të Gjykates Supreme(DHPGJS), dhe parashtrusi pohoi se aktvendimi i DHPGJS-se eshte marre me shkelje te dispozitave te Kushtetutes, shkeljes së dispozitë të nenev 31,32,24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrusit ishte e papranushme bazuar ne Rregullit 36 (3) c) të Rregullores së punës per shkak qe ishte konsideron qe kerkesa nuk eshte parashtruar ne menyre teligjshme, si dhe që parashtruesi nuk është pale e autorizuar sipas kushteve të percaktuara me nenin 113,paragrafet 1dhe 7 te Kushtetutes. Gjykata konsideron se nuk duket qe te kete ndonje arsye pse M. J., B. J., T. J.,R. J. dhe 1. J. nuk kanë mundur të parashtrojne kërkese në këtë gjykate në emrin e tyre, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike dhe brenda afatit prej 4 (kater) muajve, nga data në të cilen janë dorëzuar aktvendimet e Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-se. Individet kanë të drejte të parashtrojnë kërkese në këtë gjykate, pa ndermjetesim të paleve të treta, sipas kushteve të nenit 113.7 te Kushtetutes. Për shkak te arsyeve të permendura, Gjykata vendosi të hedhe poshte kërkesen si të pa prpranuëshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI208/13
Parashtrues
Rexhep Kabashi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ACI-13-0094-A0001, të 30 tetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Rexhep Kabashi, Prokuror i Shtetit në Zyrën e Prokurorit të Shtetit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi ka parashtruar kërkesën në lidhje me rastet e M. J., B. J., T. J., R. J. dhe I. J. dhe konteston Aktvendimin ACI-13-0094-A0001 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS), të 30 tetorit 2013. Data e dorëzimit të aktvendimit të kontestuar te parashtruesi nuk është e njohur.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit ACI-13-0094-A0001, të DHPGJS-së, të 30 tetorit 2013. Aktvendimi i lartpërmendur i DHPGJS-së e ka hedhur poshtë si të palejueshme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga parashtruesi.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) si dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 18 nëntor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

6. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI208/13, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI208/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 7 shkurt 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Gjykata gjithashtu i kërkoi parashtruesit t'i qartësojë disa aspekte dhe ta plotësojë kërkesën e tij. Të njëjtën ditë, DHPGJS-ja u njoftua për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 11 shkurt 2014, parashtruesi e dorëzoi në Gjykatë kërkesën e plotësuar.

9. Më 8 maj 2014, Kolegji shqyrtues pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 9 gusht 2013, parashtruesi kishte parashtruar një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në DHPGJS, ndaj Gjykatës Supreme të Kosovës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 1738/2007, të 19 korrikut 2007, Aktvendimit të trupit gjykues të DHPGJS-së, SCA-08-0041, të 27 dhjetorit 2011, si dhe të Aktvendimit të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, AC-I-12-0055, të 30 prillit 2013, duke pretenduar që këto vendime të lartpërmendura janë marrë me shkelje të dispozitave ligjore.

11. DHPGJS-ja konsideron që:

"Kolegji i ankesave konsideron që në bazë të nenit 10, paragrafi 14 të Ligjit nr. 04/l-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHP), të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Dhomës së Posaçme janë të prera dhe të plotfuqishme dhe nuk i nënshtrohen ankesës. Përveç kësaj, Ligji për Dhomën e Posaçme dhe Shtojca e tij nuk ofrojnë mjete të tjera juridike të jashtëzakonshme kundër atyre aktgjykimeve apo aktvendimeve të Kolegjit të Ankesave (mjete të jashtëzakonshme nuk parashihen as me Rregulloren e UNMIK-ut 2008/4 e as me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2008/ 6)".

12. Për më tepër, DHPGJS-ja konsideron që:

"Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e parashtruar nga Prokurori i Shtetit sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) në emër të një pale mund të vlejë si mjet i jashtëzakonshëm juridik kundër një vendimi të prerë të gjykatave të instancës më të ulët, por jo kundër një vendimi përfundimtar të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, sepse siç u përmend më lart, neni 10.14 i Ligjit e parandalon këtë mundësi".

[...]

"Kështu, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, si mjet i jashtëzakonshëm, nuk mund të parashtrohet kundër atyre vendimeve, dhe si e tillë, u hodh poshtë si e palejueshme".

Pretendimet e parashtruesit

13. Parashtruesi pretendon që aktvendimi i DHPGJS-së është marrë me shkelje të dispozitave të Kushtetutës:

"- Shkeljes së dispozitës së nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe lidhur me nenin 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për gjykim të drejtë dhe të paanshëm;

- Shkeljeve të dispozitës së nenit 32 të Kushtetutës se Republikës së Kosovës e drejta për mjete juridike si dhe lidhur me nenin 8 të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut; dhe

- Shkeljës së dispozitës së nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës barazia para ligjit dhe lidhur me nenin 7 të Deklaratës Universale mbi të drejtat e njeriut".

14. Në këtë drejtim, parashtruesi kërkon si në vijim:

"Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet qe lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ACI.-13-0094AOOO1 të dt. 30.10.2013 të prishet (anulohet) dhe Kolegji i Apelit i kësaj Dhome të detyrohet që Kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë KMLC. nr. 58/2011 të dt. 25.06.2013 të paraqitur për Gjykatën Supreme të Kosovës kundër aktgjykimit të fuqisë së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 738/2007 të dt. 19.11.2007 aktvendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit SCA-08-0041 të dt. 27.12.2012 dhe kundër aktvendimit të po të njëjtës gjykatë AC-I-12-0055 të dt.30.04.2013 T'IA DORËZOJ Gjykatës Supreme të Kosovës si gjykatë ekskluzivisht kompetente për të vendosur për mjetet e jashtëzakonshme juridike".

15. Në lidhje me kriteret e pranueshmërisë, parashtruesi pretendon si në vijim:

"Prokurori i Shtetit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës në kuptim të dispozitës së nenit 113 par.7 dhe lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës pretendon se e ka të drejtën t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ACI-13-0094-A-001 të dt. 30.10.2013, nga vet fakti se Prokurori i Shtetit është autoriteti i vetëm ligjor me ligj i autorizuar i cili në kuptim të dispozitave të nenit 245 të LPK-së (Ligji nr.03-L-0006 i dt.30.06.2008) ngrit kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë me të cilat vendime janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të palëve dhe në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje të lirive dhe të drejtave të palës së paditur KBI (Kosova Export) në Fushë-Kosovë, të drejtat dhe interesat e të së cilëve i mbron Prokurori i Shtetit, pasi qe palët nuk e kanë një të drejtë të këtillë. Ne rastin konkret Prokurori i Shtetit duke i mbrojtur të drejtat dhe interesat e palëve, e ka

cilësinë e palës procedurale me ligj në kuptim të dispozitës së nenit 73.1 dhe 73.2 të LPK-së. Atëherë, në qoftë së Prokurori i Shtetit është palë në procedure, në kuptim të dispozitave të nenit 113 par.7 dhe lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës e ka të drejtën që në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës të ngre çështjet e ligjshmërisë së vendimeve gjyqësore të formës së prere".

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata vëren se, për të gjykuar ankesën e parashtruesit, është e domosdoshme të vlerësojë nëse ai i ka plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë si dhe të specifikuara më tutje me Ligj dhe me Rregullore të punës.

17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

18. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (3) c) të Rregullores së punës:

"Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

[...]

c) kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar".

19. Kështu, Gjykata konsideron që së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesi është palë e autorizuar në kuptimin e dispozitave ligjore të përmendura më lart.

20. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën në lidhje me rastet e M. J., B. J., T. J., R. J. dhe I. J. kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 1738/2007, të 19 korrikut 2007, aktvendimeve të trupit gjykues të DHPGJS-së, SCA-08-0041, të 27 dhjetorit 2011, si dhe të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, AC-I-12-0055, të 30 prillit 2013.

21. Në rastin konkret, parashtruesi ka theksuar në lidhje me kërkesën, inter alia:

[...]

"Prokurori i Shtetit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës në kuptim të dispozitës së nenit 113 par.7 dhe lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës pretendon se e ka të drejtën t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ACI-13-0094-A-001 të dt. 30.10.2013, nga vet fakti se Prokurori i Shtetit është autoriteti i vetëm ligjor me ligj i autorizuar i cili në kuptim të dispozitave të nenit 245 të LPK-së (Ligji nr.03-L-0006 i dt.30.06.2008) ngrit kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë…".

22. Mirëpo, pasi një individ mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, neni 113.7 përcakton që:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

23. Gjykata konsideron se nuk duket që të ketë ndonjë arsye pse M. J., B. J., T. J., R. J. dhe I. J. nuk kanë mundur të parashtrojnë kërkesë në këtë gjykatë në emrin e tyre, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike dhe brenda afatit prej 4 (katër) muajve, nga data në të cilën janë dorëzuar aktvendimet e Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së. Individët kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë në këtë gjykatë, pa ndërmjetësim të palëve të treta, sipas kushteve të nenit 113.7 të Kushtetutës.

24. Andaj, Gjykata konsideron që kërkesa nuk është parashtruar në mënyrë të ligjshme, si dhe që parashtruesi nuk është palë e autorizuar sipas kushteve të përcaktuara me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, dhe me rregullin 56 (2) b) të Rregullores së punës, në Seancën e mbajtur më 8 maj 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI68/14, Fahri Rexhepi, Aktvendim i datës 3 korrik 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit ASC-II-0035, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 23 nëntorit 2012

Rasti KI68/14, vendimi i 3 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, e paafatshme.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës kishte shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si të paafatshme, sepse parashtruesi nuk e kishte dorëzuar kërkesën e tij brenda afateve ligjore të përcaktuara me Ligj dhe të specifikuara më tej në Rregullore të punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI68/14
Parashtrues
Fahri Rexhepi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit ASC-II-0035 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
të 23 nëntorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Fahri Rexhepi nga fshati Tenezhdoll, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin ASC-II-0035 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave), të 23 nëntorit 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 9 janar 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit ASC-II-0035 të Kolegjit të Ankesave, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, dhe i

pamundësoi të realizojë të drejtën në një pjesë të 20% nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore „Ramiz Sadiku“ (në tekstin e mëtejmë: NSH “Ramiz Sadiku“) në Prishtinë.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 8 prill 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 maj 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI68/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI68/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 26 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS) për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 3 korrik 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 5 mars 2010, parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), e cila nuk e kishte përfshirë në listën përfundimtare të punonjësve, të cilët e kanë realizuar të drejtën në pjesën e 20% nga privatizimi, ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

10. Më 24 shkurt 2011, trupi gjykues i Dhomës së Posaçme nxori Aktvendimin SCEL-09-0001-C1175, me të cilin e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në arsyetimin e vendimit të tij, trupi gjykues theksoi:

"Kolegji i Ankesave konsideron se duke pasur parasysh që ankesa ishte ushtruar më tepër se tre muaj pas afatit për parashtrimin e ankesave (afati ligjor për paraqitjen e ankesës kishte skaduar më 27 mars 2009.) (...) nuk ekziston mundësia e kthimit në gjendje të mëparshme dhe ankesa të konsiderohet e afatshme. Prandaj, ankesa hidhet poshtë si e papranueshme".

11. Më 23 nëntor 2012, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së, me Aktvendimin ASC-II-0035, e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e trupit gjykues, SCEL-09-001-C1175.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon se:

"Vendimet dhe urdhërat e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të kundërligjshme, sepse sipas meje gjithherë kam ushtruar ankesat ndaj këtij vendimi dhe urdhëri, mirëpo gjithherë janë refuzuar,me arsyetim se kërkesa është ushtruar pas afatit".

13. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën:

"Kërkoj që Gjykata Kushtetuese të merr Vendim të drejtë dhe të detyrojë Dhomën e Posaçme që të merr Aktvendim dhe mua të më sistemojë në listën e punëtorëve 20% nga privatizimi".

Pranueshmëria e kërkesës

14. Gjykata vëren se që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

16. Gjykata i referohet edhe nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)".*

17. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
> *...*
>
> *b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi ...".*

18. Në bazë të të dhënave në shkresat e lëndës, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e kishte parashtruar kërkesën e tij më 8 prill 2014. Gjykata, në bazë të shkresave në dispozicion, kishte konstatuar se Aktvendimi i Kolegjit të Ankesave, ASC-II-0035, i 23 nëntorit 2012, i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 9 janar 2013, prandaj, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë pas skadimit të afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

19. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështjet e Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005).

20. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI62/14, Rexhep Haziri, Vendim i datës 3 korrik 2014- Vlerësim i kushtetutshmërisë së listës përfundimtare Fi-64/90 të punëtorëve të kualifikuar për kompensim nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku" nga Prishtina, të publikuar nga Agjencia e Privatizimit të Kosovës, më 27 mars 2009

Rasti KI62/14, vendimi i 3 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, heqje e kërkesës nga lista.

Pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës ishte që AKM-ja dhe menaxhmenti i NSH "Ramiz Sadiku" në Prishtinë ia bënë atij të pamundur për të marrë një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së në fjalë.

Gjykata Kushtetuese vendosi ta heqë kërkesën nga lista sepse parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar një kërkesë të paqartë dhe të pakuptueshme dhe parashtruesi nuk kishte sqaruar dhe saktësuar kërkesën e tij, përkundër kërkesës nga Gjykata për ta bërë këtë.

VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA
në
Rastin Nr. KI62/14
Parashtrues
Rexhep Haziri
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së listës përfundimtare Fi-64/90 të punëtorëve të kualifikuar për kompensim nga privatizimi i NSH „Ramiz Sadiku“ nga Prishtina, të publikuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit e Kosovës, më 27 mars 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Rexhep Haziri (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga fshati Kaçandoll, komuna e Mitrovicës, i cili përfaqësohet nga z. Ismail Haziri nga Vushtrria.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston listën përfundimtare të punëtorëve, Fi-64/90, të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), e cila është e publikuar më 27 mars 2009.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është realizimi i së drejtës në 20% nga privatizimi i NSH „Ramiz Sadiku“ (në tekstin e mëtejmë: NSH „Ramiz Sadiku“). Parashtruesi i kërkesës nuk i përmend konkretisht nenet e Kushtetutës, të cilat janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113. 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 prill 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI62/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI62/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 21 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta dorëzojë në Gjykatë vendimin përkatës (kopjen e vërtetuar) dhe të specifikojë cili nga vendimet e dorëzuara i shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe në cilën pjesë.

8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën, për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor-korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.

9. Më 30 qershor 2014 Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI62/14, zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu, si gjyqtar raportues, dhe në vend të tij caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi.

10. Më 2 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi përgjigjen me shkrim, së cilës nuk ia bashkëngjiti asnjë vendim relevant të autoriteteve publike ose të gjykatave të rregullta dhe ai nuk saktëson si dhe cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë janë shkelur në rastin e tij, por ai vetëm përsërit të njëjtat pretendime nga kërkesa fillestare.

11. Më 3 korrik 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 2 prill 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, duke përdorur formularin për dorëzimin e kërkesave. Përkitazi me përmbledhjen e fakteve, ai deklaroi se ai ishte punonjës i NSH „Ramiz Sadiku“ për më shumë se 11 vjet, nga viti 1978 deri më 1990. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, përkundër kërkesave të parashtruara që emri i tij të përfshihej në listën përfundimtare të punonjësve të kualifikuar për 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH „Ramiz Sadiku“, ato ishin refuzuar me arsyetimin se kjo e drejtë nuk u takon punonjësve, të cilët nuk kanë punuar 3 (tri) vjet pas luftës.

13. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi: shënimet për sigurim pensional dhe invalidor, vendimin e Bashkësisë Komunale të Punësimit, kopjen e librezës së punës, një kopje të deklaratës së punonjësit të NSH "Ramiz Sadiku" dhe autorizimin për përfaqësuesin ligjor.

14. Më 21 maj 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës ta plotësojë dhe ta qartësojë kërkesën e tij. Në njoftim, parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar se nëse nuk i dorëzon informatat dhe dokumentet e kërkuara, Gjykata nuk do të jetë në gjendje ta shqyrtojë kërkesën.

15. Më 2 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi përgjigjen me shkrim, së cilës nuk i bashkëngjiti asnjë dokument shtesë dhe sqarim, por ai vetëm përsëriti kërkesat e tij nga kërkesa fillestare.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon:

> *„Unë mendoj se është bërë shkelje e Kushtetutës lidhur me të drejtën materiale të mospagesës së 20% me rastin e privatizimit të NSH “Ramiz Sadiku” sepse edhe unë kam qenë punëtor dhe kontribut dhënës në këtë ndërmarrje që nga viti 1978 e gjerë 1990”.*

17. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

„Kërkoj nga Gjykata Kushtetuese që të vërtetoj shkeljen e ligjeve të Kushtetutës, pasi që nuk më është mundësuar në asnjë mënyrë të kërkoj pagesën e 20% nga mjetet e shitjes së NSH „Ramiz Sadiku"Prishtinë, nga ana e mbikëqyrësve dhe nga Komisioni, dhe as nga ish-AKM-ja."

18. Parashtruesi i kërkesës kërkon më tej nga Gjykata:

„Ju informoj që publikisht të informohet opinioni për shkeljet ligjore nga drejtuesit e NSH "Ramiz Sadiku" Prishtinë dhe çdo organi që është potencuar në këtë kërkesë lidhur me shkeljen e ligjeve dhe kushtetutshmërisë".

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

21. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

22. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 29 (2) të Rregullores së punës, Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve, i cili parasheh:

"(...)

(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe: (a) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën; (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka; (c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor, nëse ka; (d) emrin dhe

adresën e palës, ose të palëve kundërshtare, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe (h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës

(3) Kërkesës i bashkëngjiten kopjet e çfarëdo dokumenti relevant për të mbështetur atë. Nëse vetëm disa pjesë të dokumentit janë të rëndësishme, atëherë, sipas nevojës, duhet të bashkëngjiten vetëm pjesët e tilla".

23. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest".

24. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar një kërkesë të paqartë dhe të pakuptueshme. Për më tepër, ai nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim që të sqarojë dhe të saktësojë kërkesën e tij, përkundër kërkesës nga Gjykata për ta bërë këtë.

25. Në të vërtetë, procedurat në Gjykatën Kushtetuese janë kundërthënëse për nga
natyra. Prandaj, parashtruesi i kërkesës duhet t'i dëshmojë pretendimet (duke i ofruar Gjykatës dëshmitë e nevojshme faktike) dhe gjithashtu argumentet ligjore (për të shpjeguar pse dhe si, sipas tij, janë shkelur dispozitat e Kushtetutës). Gjykata është përgjegjëse për vërtetimin e fakteve; përderisa parashtruesi duhet t'i ofrojë Gjykatës informatat dhe dokumentet e nevojshme përcjellëse.

26. Para së gjithash, nga ajo që u tha më lart, nuk është detyrë e Gjykatës që të
ndërtojë rastin në emër të parashtruesit të kërkesës. Përkundrazi, kjo duhet bërë nga parashtruesi i kërkesës, i cili duhet ngritur çështjen në Gjykatë, në pajtim me të gjitha kriteret për pranueshmërinë e kërkesës.

27. Gjykata rikujton se parashtruesit të kërkesës i është dërguar një shkresë, duke e paralajmëruar se nëse ai nuk i siguron informatat dhe dokumentet e kërkuara, Gjykata nuk do të jetë në gjendje ta shqyrtojë kërkesën. Gjykata më tej theksoi se parashtruesi i

kërkesës në përgjigjen e tij nuk kishte ofruar dokumente të nevojshme për shqyrtim, duke përfshirë listën përfundimtare të punonjësve me të drejtë të kompensimit nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku", të publikuar me numër Fi-64/90.

28. Nga ajo që u tha më lart, Gjykata konsideron se kërkesa e lartpërmendur nuk e kalon pragun minimal që të konsiderohet si kërkesë. Për më tepër, Gjykata më tej konsideron se është e ligjshme të supozohet se parashtruesi nuk është më i interesuar për procedim të mëtejmë të kërkesës së tij (shih rastin KI143/13, *parashtruesi i kërkesës Nebih Sejdiu,* Vendimi për heqjen e kërkesës nga lista, i 24 prillit 2014, gjithashtu *mutatis mutandis* shih rasin *Starodub kundër Ukrainës,* Nr. 5483/02, ECHR, Vendimi i 7 qershorit 2005).

29. Gjykata konsideron që kjo kërkesë nuk përfaqëson një rast ose një kontest dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 32 (4) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA HEQË kërkesën nga lista;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Arta Rama-Hajrizi	Prof. Dr. Enver Hasani

KO119/14 - Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i datës 21 gusht 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001 të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014.

Rasti KO119/14, vendimi i 21 gushtit 2014.

Fjalët kyçe: deputetët e Kuvendit, interpretimi kushtetues, procedura, zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit, partia politike, koalicioni, masë e përkohshme.

Kërkesa është parashtruar nga 30 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilët kontestojnë Vendimin Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Kuvendi) si për përmbajtjen ashtu edhe për procedurën e ndjekur gjatë seancës konstituive të Kuvendit, të mbajtur më 17 korrik 2014.

Parashtruesit parashtruan kërkesën bazuar në nenin 113.5 të Kushtetutës, duke pretenduar se gjatë përgatitjes për mbledhjen konstituive të Kuvendit ka pasur shkelje të Kushtetutës, sepse kryesuesi i mbledhjes, Kryetari i Kuvendit nga legjislatura e mëparshme, z. Krasniqi, tejkaloi kompetencat e tij të përcaktuara me Kushtetutë, gjegjësisht interpretimin e tij për grupin më të madh parlamentar. Parashtruesit e kërkesës më tej pretenduan se Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i 17 korrikut 2014 (Nr. 05-V-001), për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe procedurën përgatitore të ndjekur në lidhje me procesin e konstituimit të Kuvendit, nuk është në përputhje me dispozitat e nenit 67 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilat parashihet se Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar, i cili ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend dhe zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Më 23 korrik 2014, Gjykata miratoi kërkesën e parashtruesve për masë të përkohshme, duke pezulluar zbatimin e vendimit të kontestuar, deri në nxjerrjen e vendimin përfundimtar nga Gjykata për këtë çështje.

Gjykata gjeti se kërkesa e parashtruesve është e pranueshme pasi ajo i plotëson të gjitha kërkesat e pranueshmërisë të cilat janë të parapara me Rregulloren e punës. Në vlerësimin e meritave të kërkesës, Gjykata arriti në përfundim se Vendimi nr. 05-V-001, i 17 korrikut 2014, është

jokushtetues si për nga procedura e ndjekur, ashtu edhe për nga përmbajtja pasi nuk ishte grupi më i madh parlamentar ai që propozoi Kryetarin e Kuvendit dhe, rrjedhimisht, është i pavlefshëm; dhe se Seanca konstituive e Kuvendit, e cila filloi më 17 korrik 2014 nuk është realizuar plotësisht, konkretisht nuk janë zgjedhur Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit. Rrjedhimisht, Kuvendi duhet ta përfundojë seancën konstituive, duke zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët në pajtim me nenin 67 (2), në lidhje me nenin 64 (1) të Kushtetutës dhe me Kreun III të Rregullores së punës që zbaton këto nene dhe këtë Aktgjykim.

AKTGJYKIM
në
Rastin Nr. KO119/14
Parashtrues
Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga këta 30 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Hashim Thaçi, Xhavit Haliti, Hajredin Kuçi, Enver Hoxhaj, Arsim Bajrami, Memli Krasniqi, Margarita Kadriu-Ukelli, Zenun Pajaziti, Elmi Reçica, Rafet Rama, Ganimete Musliu, Selvije Halimi, Safete Hadërgjonaj, Bekim Haxhiu, Flora Brovina, Fadil Beka, Xhevahire Izmaku, Agim Aliu, Sala Berisha-Shala, Agim Çeku, Besim Beqaj, Raif Qela, Naim Fetahu, Blerta Deliu-Kodra, Mexhide Mjaku-Topalli, Adem Grabovci, Azem Syla, Nuredin Lushtaku, Nezir Çoçaj dhe Kadri Veseli (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës). Parashtruesit e kërkesës e kanë autorizuar z. Xhavit Halitin për t'i përfaqësuar ata në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Vendimin Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi), si për përmbajtjen, ashtu edhe për

procedurën e ndjekur gjatë seancës konstituive të Kuvendit, më 17 korrik 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit, më 17 korrik 2014, me të cilin z. Isa Mustafa u zgjodh Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e procedurës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ashtu siç është aplikuar gjatë seancës konstituive të Kuvendit, të mbajtur më 17 korrik 2014, duke pretenduar se ka pasur shkelje të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe të Rregullores së punës të Kuvendit.

5. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës kërkuan nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme për pezullimin e Seancës Konstituive të Kuvendit, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Parashtruesit e kërkesës pretendonin se *"Masa e Përkohshme është në interes të publikut, sepse mungesa e saj mund të shkaktojë një dëm të pakthyeshëm në funksionimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe demokracinë në Republikën e Kosovës"*.

Baza juridike

6. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.5 të Kushtetutës, në nenet 42 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56.1 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 18 korrik 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.

8. Më 21 korrik 2014, në mbështetje të rregullit 33 të Rregullores së punës, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendim Nr. GJR. KO119/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KO119/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga

gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Ćukalović.

9. Më 21 korrik 2014, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi nga një kopje të kërkesës Presidentes së Republikës së Kosovës, Qeverisë në detyrë të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Qeveria në detyrë) dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit. Këtij të fundit i është kërkuar të dorëzojë në Gjykatë një kopje të transkriptit nga seanca konstituive e mbajtur më 17 korrik 2014 dhe t'u ofrojë nga një kopje të kërkesës KO119/14 secilit deputet në mënyrë që atyre t'u mundësohet t'i dorëzojnë Gjykatës komentet lidhur me kërkesën.

10. Më 23 korrik 2014, Gjykata miratoi kërkesën e parashtruesve për Masë të përkohshme *"[...] deri në publikimin e vendimit përfundimtar dhe jo më vonë se 18 shtator 2014 nga nxjerrja e [...]"* vendimit për Masë të përkohshme.

11. Më 29 korrik 2014, 67 deputetë të Kuvendit dorëzuan komentet e tyre në lidhje me kërkesën KO119/14.

12. Më 30 korrik 2014, një kopje të komenteve të 67 deputetëve të Kuvendit, Gjykata ia dërgoi parashtruesve të kërkesës, të cilët nuk dorëzuan ndonjë koment.

13. Më 30 korrik 2014, deputeti z. Arsim Bajrami dorëzoi komentet e tij në lidhje me kërkesën KO119/14.

14. Më 31 korrik 2014, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ia dorëzoi Gjykatës dokumentet e kërkuara.

15. Më 4 gusht 2014, 5 deputetë të Kuvendit e njoftuan Gjykatën se i mbështesin komentet e 67 deputetëve të Kuvendit.

16. Të njëjtën datë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës komentet e deputetëve të Kuvendit në lidhje me rastin KO119/14.

17. Më 19 gusht 2014, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi në rastin e gjyqtarit Kadri Kryeziu, me ç'rast Gjykata vendosi:

> *TË QORTOJË gjyqtarin Kadri Kryeziu për shkeljen e nenit 1 dhe 4 të Kodit të mirësjelljes për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese; dhe,*

TË PËRJASHTOJË gjyqtarin Kadri Kryeziu nga pjesëmarrja në seancat shqyrtuese për të gjitha kërkesat e ardhshme të Gjykatës Kushtetuese, ku përfshihen partitë politike apo individët në parti politike, apo nga çdo rast tjetër që ka kontekst politik, ku, inter alia, një palë mund të paraqitet para Gjykatës, siç është: Presidenti i Republikës së Kosovës, Kuvendi, Qeveria, Avokati i Popullit dhe komunat.

18. Rrjedhimisht, gjyqtari Kadri Kryeziu nuk ka marrë pjesë në procedurë dhe në vendimmarrje të Gjykatës për rastin KO119/14.

19. Më 21 gusht 2014, Gjykata mbajti seancë dëgjimore publike.

20. Në të njëjtën ditë, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi në këtë rast, ndërsa gjyqtari raportues, gjyqtari Robert Carolan, kërkoi të zëvendësohej, sepse ai ishte pakicë. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, në mbështetje të rregullave 60 (1) dhe 44 (4) të Rregullores së punës, e zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtarin Almiro Rodrigues si gjyqtar raportues (Vendimi Nr. GJR. KO119/14). Rrjedhimisht, gjyqtarja Snezhana Botusharova u caktua anëtare e Kolegjit shqyrtues (Vendimi Nr. KSH. KO119/14).

Përmbledhje e fakteve

21. Më 7 maj 2014, Kuvendi, në seancë të jashtëzakonshme, vendosi për shpërndarjen e Kuvendit.

22. Më 8 maj 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës dekretoi zgjedhjet e parakohshme për t'u mbajtur më 8 qershor 2014.

23. Më 8 qershor 2014, u mbajtën zgjedhjet në Republikën e Kosovës.

24. Më 27 qershor 2014, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë: KQZ) publikoi rezultatet e zgjedhjeve.

25. Më 4 korrik 2014, KQZ-ja certifikoi rezultatet e zgjedhjeve.

26. Më 7 korrik 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës vendosi që seanca konstituive e Kuvendit të mbahet më 17 korrik 2014.

27. Më 8 korrik 2014, ish-Kryetari i Kuvendit nga legjislatura IV, ftoi në një takim të përbashkët Kryesinë e Kuvendit nga legjislatura IV, si dhe udhëheqësit e partive parlamentare, me qëllim të përgatitjes së seancës konstituive të legjislaturës V. Në ftesën për takim ishin të bashkëngjitura materialet nga KQZ-ja, përkatësisht njoftimi për

rezultatet e certifikuara të zgjedhjeve, Vendimi i KQZ-së Nr. 1579-2014, i 4 korrikut 2014, për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, si dhe lista e kandidatëve të zgjedhur për Kuvend.

28. Më 11 korrik 2014, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe NISMA e informuan ish-Kryetarin e Kuvendit nga legjislatura IV që deputetët e subjektit politik LDK-AAK-NISMA kanë vendosur të formojnë grupin parlamentar LDK-AAK-NISMA.
29. Më 12 korrik 2014, ish-Kryetari dhe Kryesia e legjislaturës IV mbajtën takimin me qëllim të përgatitjes së propozim-rendit të ditës për seancën konstituive.

30. Propozim-rendi i ditës për seancën konstituive të Kuvendit, përmbante këto çështje:

    a. Formimi i Komisionit *ad hoc* për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve të deputetëve;

    b. Dhënia e betimit të deputetëve të Kuvendit;

    c. Njoftimi për formimin e grupeve parlamentare; dhe

    ç. Zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit.

31. Më 17 korrik 2014, Kuvendi mbajti seancën konstituive të kryesuar nga deputetja më e vjetër e Kuvendit, znj. Flora Brovina, (në tekstin e mëtejmë: Kryesuesja) dhe e ndihmuar nga deputetja më e re e Kuvendit, znj. Teuta Rugova.

32. Kryesuesja hapi seancën konstituive të Kuvendit dhe pastaj kërkoi nga partitë politike që secila të propozojnë nga një anëtar për Komisionin *ad hoc* për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) propozoi deputetin z. Memli Krasniqi, LDK-AAK-NISMA propozoi deputetin z. Armend Zemaj, Vetëvendosje propozoi deputeten znj. Albulena Haxhiu, Lista Srpska propozoi deputeten znj. Jelena Bontić, Kosovo Demokratik Tyrk Partisi e propozoi deputeten znj. Müfera Şinik, Koalicioni VAKAT propozoi deputetin z. Duda Balje, Progresivna Demokratska Stranska propozoi deputeten znj. Emilija Redžepi, Partia Liberale Egjiptiane e propozoi z. Etem Arifi, Kosovaki Nevi Romani Partia propozoi deputetin z. Kujtim Paqaku. Kjo përbërje e Komisionit *ad hoc* për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve u votua dhe u miratua nga të gjithë 120 deputetët.

33. Komisioni *ad hoc* paraqiti raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve dhe verifikoi kuorumin e seancës konstituive të Kuvendit, bazuar në listën e rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve sipas renditjes në vijim:

a. PDK - 37 deputetë
b. LDK - 30 deputetë
c. VV - 16 deputetë
ç. AAK - 11 deputetë
d. Srpska Lista - 9 deputetë
dh. NISMA - 6 deputetë
e. Kosovo Demokratik Tyrk Partisi - 2 deputetë
ë. Koalicija Vakat - 2 deputetë
f. Progresivna Demokratska Stranka - 1 deputet
g. Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës - 1 deputet
gj. Nova Demokratska Stranka - 1 deputet
h. Partia Liberale Egjiptiane - 1 deputet
i. Partia e Ashkalinjëve për Integrim - 1 deputet
j. Koalicija za Gora - 1 deputet
k. Kosovaki Nevi Romani Partia - 1 deputet

34. Pas kësaj, Kryesuesja deklaroi se që të gjithë 120 deputetët ishin të pranishëm dhe vuri në votim raportin e Komisionit *ad hoc* për verifikimin e kuorumit dhe mandatave, ku 44 deputetë votuan "për", ndërsa pjesa tjetër e deputetëve nuk votuan as "kundër", e as nuk abstenuan. Pastaj, Kryesuesja bëri një pauzë.

35. Pas pauzës, Kryesuesja zhvilloi një tjetër raund të votimit. Kryesuesja deklaroi se që të gjithë 120 deputetët ishin të pranishëm dhe se, nga ata deputetë të pranishëm, 117 deputetë votuan "për" raportin e Komisionit *ad hoc*.

36. Kryesuesja kërkoi nga deputetët e pranishëm dhënien e betimit, gjë të cilën ata e bënë.

37. Sa i përket pikës 3 të rendit të ditës – Formimi i grupeve parlamentare – Kryesuesja deklaroi se ajo dhe deputetja më e re e Kuvendit nuk kishin kompetenca formale në lidhje me atë pikë dhe se ato ishin aty vetëm falë moshës së tyre. Prandaj, ajo theksoi se formimi i grupeve parlamentare duhet të bëhet pas pikës 4 të rendit të ditës, pas zgjedhjes së Kryetarit dhe të nënkryetarëve të Kuvendit.

38. Kryesuesja vazhdoi me rendin e ditës për seancën konstituive të Kuvendit, duke kërkuar nga PDK-ja që të propozojë kandidatin për

Kryetar të Kuvendit dhe nga duke kërkuar nga tri partitë më të mëdha politike që t'i propozojnë kandidatët e tyre për nënkryetarë të Kuvendit. PDK-ja propozoi deputetin z. Agim Aliu kandidat për Kryetar të Kuvendit, kurse LDK-ja propozoi deputetin z. Isa Mustafa kandidat për Kryetar të Kuvendit. Partitë e tjera politike nuk propozuan kandidatë të tyre për nënkryetarë të Kuvendit. Kur Kryesuesja e vuri në votim kandidimin e PDK-së z. Agim Aliun, partitë politike në vijim: LDK, VV, AAK, NISMA dhe Lista Srpska e lëshuan sallën e Kuvendit. Me kërkesë të saj, u numëruan deputetët e mbetur. Të pranishëm ishin 47 deputetë. Kësisoj, Kryesuesja e shpalli seancën të mbyllur deri në njoftimin tjetër me shkrim, sepse më nuk kishte kuorum.

39. Pastaj, edhe pse seanca konstituive e Kuvendit zyrtarisht ishte pezulluar nga Kryesuesja deri në njoftimin tjetër me shkrim, LDK, AAK, NISMA, VV dhe Lista Srpska u kthyen në sallën e Kuvendit dhe filluan një mbledhje. Deputetja më e re e Kuvendit, znj. Teuta Rugova, e kryesoi mbledhjen dhe kërkoi nga 83 deputetët e pranishëm të votojnë mocionin e paraqitur nga LDK, AAK, NISMA dhe VV për zëvendësimin e Kryesueses, deputetes znj. Flora Brovina. Mocioni u miratua me 82 vota "për". Rrjedhimisht, deputetja e dytë për nga mosha, deputetja znj. Milka Vulić, mori kryesimin e mbledhjes.

40. Znj. Milka Vulić kërkoi nga LDK, AAK dhe NISMA të propozojnë një kandidat për Kryetar të Kuvendit dhe kërkoi nga tri partitë politike më të mëdha që secila të propozojë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit. LDK, AAK dhe NISMA propozuan deputetin z. Isa Mustafa kandidat për Kryetar të Kuvendit, ndërsa VV propozoi deputetin z. Glauk Konjufca kandidat për nënkryetar të Kuvendit dhe Grupi 6+ propozoi kandidatë për nënkryetar të Kuvendit, mbi bazën e rotacionit, deputetët: znj. Duda Balje, z. Müfera Şinik, z. Danush Ademi dhe z. Kujtim Paqaku. Partitë e tjera politike deklaruan se kandidatët e tyre për nënkryetarë të Kuvendit do t'i propozojnë në një fazë të mëvonshme.

41. Znj. Milka Vulić i vuri kandidatët në votim, me ç'rast z. Isa Mustafa u zgjodh Kryetar i Kuvendit me 65 vota "për", nga gjithsej 83 deputetë të pranishëm. Z. Glauk Konjufca nga VV u zgjodh nënkryetar me 82 vota "për", ndërsa znj. Duda Balje, znj. Müfera Şinik, z. Danush Ademi dhe z. Kujtim Paqaku nga Grupi 6+ u zgjodhën nënkryetarë, mbi bazën e rotacionit, me 82 vota "për".

Argumentet e paraqitura nga parashtruesit

42. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"Gjatë përgatitjes për Mbledhjen Konstituive të legjislaturës së V-të të Kuvendit dhe gjatë mbajtjes se kësaj mbledhje ka pasur shkelje të Kushtetutës dhe Rregullores së Punës së Kuvendit. Gjatë mbledhjes, me datën 12.07.2014, nga kryesuesi i mbledhjes, Kryetari i Kuvendit nga legjislatura e mëparshme, z. Krasniqi, pati tejkalim të kompetencave të tij që dalin jashtë mandatit të përcaktuara në Kushtetutë, gjegjësisht interpretimit të tij për Grupin më të madh parlamentar gjegjësisht sipas ish-kryetarit "Grupi Parlamentar" i formuar me 47 deputetë gjatë procesit të regjistrimit të deputetëve të Legjislaturës së V-të, duhet të ulet në qendër dhe si rrjedhojë ky Grup Parlamentar duhet edhe të propozojë Kryetarin e Kuvendit. Sidoqoftë, duke marrë parasysh që "Grupi Parlamentar LDK-AAK-NISMA" nuk janë certifikuar si Grupi më i madh parlamentar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, siç është përcaktuar në Nenin 15 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / nr. 31 / 15 qershor 2008), veprimi i Kryetarit të Kuvendit nga Legjislatura e IV, që ka autorizuar bashkimin në një Grup Parlamentar të deputetëve të LDK-së, AAK-së dhe NISMA, pa u certifikuar si Grupi më i madh parlamentar, para konstituimit të Legjislaturës së V -të të Kuvendit të Republikës së Kosovës përbën shkelje të Kushtetutës se Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 64 (1) dhe Nenit 67 si dhe Nenit 15 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / nr. 31 /15 qershor 2008). Gjithashtu, veprimet e Kryetarit të Kuvendit nga legjislatura IV, bie ndesh edhe me praktikat e deritanishme që konfirmohen me Transkriptin nga Mbledhja e Kryesisë së Kuvendit me përfaqësuesit e partive parlamentare, të mbajtur më 10.02.2011."*

43. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i datës 17 korrik 2014 (Nr. 05-V00 I), për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe procedurën përgatitore të ndjekur në lidhje me procesin e konstituimit të Kuvendit, nuk është në përputhje me Dispozitat e Nenit 67 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në bazë të nenit 67.2 të Kushtetutës, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. KO 103/14 të parashtruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, përkitazi me vlerësimin e*

përputhshmërisë së Nenit 84 (14) (Kompetencat e Presidentit) me nenin 95 (Zgjedhja e Qeverisë) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Nr. Ref: AGJ 671/14, 1 korrik 2014), Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar i cili ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend dhe zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit."

44. Kësisoj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të përgjigjet në këto çështje:

a. Të vlerësohet kushtetutshmëria e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës të datës 17.07.2014 (nr. 05-V-001) nëse Kryetari i Kuvendit është propozuar nga grupi më i madh parlamentar sipas nenit 67.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

b. Të sqarohet cili është Grupi më i madh parlamentar, që është përcaktuar në Nenin 67 (Paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenin 12 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës (29 prill 2010) gjegjësisht a është Grupi Parlamentar që ka fituara në zgjedhjet për Kuvendin të datës 8 qershor 2014 apo grupimi i cili është formuar gjatë regjistrimit të deputetëve dhe si rrjedhojë: Kush ka të drejtë të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit në mbledhjen konstituive të Kuvendit?

c. Të sqarohet a ka pasur shkelje të Kushtetutës nga Kryetari i Kuvendit nga legjislatura e mëparshme, sipas nenit 67.7. Cilat janë kompetencat e Kryetarit të Kuvendit nga legjislatura e mëparshme gjatë mbledhjes përgatitore të datës 12.07.2014?

ç. Pas mbylljes zyrtare të mbledhjes konstituive a ka pas të drejtë që të shkarkohet Kryesuesja e Seancës dhe të vazhdohet me mbajtjen e mbledhjes pa u ftuar anëtarët si dhe duke marrë parasysh këtë dhe hapat që kanë pasuar me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarit të Kuvendit a ka pasur gjatë mbajtjes së mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës a ka pasur shkelje të Kushtetutës dhe Rregullores së Punës së Kuvendit?

Komentet e paraqitura nga 67 deputetë të Kuvendit

45. Më 29 korrik 2014, 67 deputetë, përfaqësuar nga z. Bajram Gecaj, parashtruan komentet e tyre në lidhje me kërkesën KO119/14.

46. Sa i përket pranueshmërisë së kërkesës, 67 deputetët pretendojnë që parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në bazë të nenit 131.5 të Kushtetutës, për arsye se *"[...] shkeljet e pretenduara të Parashtruesve janë çështje të parapara me Rregulloren e Kuvendit ose përcaktuara me Vendimin e Kryesisë së Kuvendit, por jo çështje të rregulluara me Kushtetutë". 67* deputetët argumentojnë se Gjykata ka marrë qëndrim në Rastin Nr. KO29/11 dhe në Rastin Nr. KO108/13 *"[...] ku, Gjykata nuk ka pranuar të interpretojë çështje të parapara me Rregulloren e Kuvendit, por vetëm ato të parapara me Kushtetutë".*

47. Në këtë drejtim, 67 deputetët pretendojnë që:

    a. nocionin "grupi më i madh parlamentar" *"[...] e përkufizon Rregullorja e Kuvendit në Shtojcën nr. 1 të saj. Rrjedhimisht, në përputhje me qëndrimin e qartë të kësaj Gjykate që nuk lëshohet në interpretime të çështjeve të parapara me ligje ose në rregullore, as në rastin konkret, Parashtruesit e Kërkesës nuk mund të kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese interpretimin e çështjeve që rregullohen me Rregulloren Kuvendit dhe jo me Kushtetutë, respektivisht, interpretim të përkufizimit të dhënë në Shtojcën 1 të Rregullores së Kuvendit. [...]"* dhe *"Përkufizimi i termit "grup parlamentar" është çështje politike, sepse lidhet ngushtë me vullnetin politik të deputetëve të Kuvendit të Kosovës për të rregulluar, nëpërmes Rregullores së Kuvendit, procedurat e funksionimit të këtij institucioni si dhe veprimtarisë së tyre si deputetë."*

    b. Vendimi i Kryesisë së Kuvendit nuk është çështje kushtetuese dhe nga rasti Nr. KO115/13 *"Është qëndrim i qartë i kësaj Gjykate se nuk merret me interpretimin e vendimeve të Kryesisë së Kuvendit apo të trupave tjerë të Kuvendit, por vetëm me vendime të votuara nga deputetët në Seancë".*

48. Në rastin konkret, LDK-AAK-NISMA kanë formuar një grup të përbashkët parlamentar bazuar në ngjashmëritë programore të tyre dhe kanë ushtruar të drejtat e tyre si grupe parlamentare, duke propozuar kandidatin për Kryetar të Kuvendit, në përputhje me nenin 67 (2) të Kushtetutës.

49. Sipas mendimit të 67 deputetëve, parashtruesit e kërkesës në asnjë mënyrë nuk precizojnë se si mund të paraqesin shkelje kushtetuese pretendimet e tyre. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar sqarime, që nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

50. Sa i përket meritave të kërkesës, 67 deputetët pretendojnë se kërkesa është e pabazuar, sepse *"Të dy kërkesat esenciale të Kushtetutës [dmth. Neni 67.2 i Kushtetutës], pra propozimi nga grupi më i madh parlamentar dhe votimi nga shumica e deputetëve të Kuvendit, janë plotësuar në rastin konkret. Të gjitha çështjet e tjera janë çështje të rregulluara me Rregulloren e Kuvendit"*.

51. Sa i përket nocionit "grup parlamentar", 67 deputetët konsiderojnë se ky nocion nuk përcaktohet në Kushtetutë, por në Rregulloren e punës të Kuvendit, Shtojca 1 [Përkufizimi i shprehjeve të përdorura në këtë Rregullore], ku thuhet si vijon: *"grupim i së paku 5 për qind, përkatësisht i 6 deputetëve të Kuvendit, që i kanë njoftuar Kryetarin dhe Kryesinë e Kuvendit për qëllimin e tyre të veprojnë si grup parlamentar*." Ata, po ashtu, i referohen nenit 20 (1) të Rregullores së punës, ku përcaktohet që *"Deputetët mund të formojnë Grup Parlamentar sipas përkatësisë së tyre partiake ose të përcaktimeve programore*", ndërsa paragrafi 2 parasheh se *"deputeti ka të drejtë të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në një grup parlamentar, të tërhiqet nga grupi, ta formojë një grup të ri parlamentar, t'i bashkëngjitet një grupi tjetër ose të veprojë si deputet i pavarur. Për secilin rast deputeti është i obliguar që, për vendimin e tij, ta njoftojë me shkrim Kryetarin e Kuvendit"*.

52. Lidhur me këtë, 67 deputetët pretendojnë se *"Më datë 8 korrik 2014, Grupi prej 47 deputetëve formuan grupin parlamentar LDK, AAK, NISMA duke u bazuar në përcaktimet programore dhe për këtë, në përputhje me nenin 20 të Rregullores, e njoftuan Kryetarin dhe Kryesinë e Kuvendit, që ishte në detyrë, në përputhje me nenin 8 të Rregullores së Kuvendit. Në asnjë mënyrë nuk mund të kontestohet formimi i grupeve parlamentare para mbajtjes së seancës konstituive, për arsye se nëse i referohemi nenit 8 (3) të Rregullores, shihet qartë se grupet mund të*

formohen edhe para seancës konstituive. Ky qëndrim është edhe në përputhje me nenin 70 (2) të Kushtetutës […]" dhe *"Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare janë certifikuar me dt. 4 korrik 2014 nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërkaq seanca konstituive është mbajtur më 17 korrik 2014. Bazuar në këtë, deputetët, të cilëve tashmë u kishte filluar mandati 13 ditë para seancës konstituive, kishin të drejtë dhe liri për t'u bashkuar në grupe parlamentare edhe para seancës konstituive. Formimi i grupeve parlamentare edhe para seancës konstituive dëshmohet edhe me precedente të mëhershme të praktikës parlamentare. Në legjislaturën IV të Kuvendit të Kosovës, certifikimi i rezultateve ishte bërë më 7 shkurt 2011, ndërkaq Grupi parlamentar 6+ e kishte dorëzuar listën e deputetëve të grupit të tyre parlamentar (që bashkonte parti të ndryshme që kishin garuar ndaras në zgjedhje), më 9 shkurt 2011, ndërsa seanca konstituive u mbajt më 21 shkurt 2011".*

53. Në anën tjetër, 67 deputetët theksojnë se parashtruesit e kërkesës po ashtu gabimisht konstatojnë që grupi parlamentar është sinonim me nocionin "parti ose koalicion". Sipas mendimit të tyre, "grupi më i madh parlamentar" nuk përcaktohet nga partia politike apo koalicioni, por nga vullneti i lirë i deputetëve për t'u bashkuar qoftë bazuar në përkatësinë politike, qoftë në atë programore, siç përcaktohet në Rregulloren e Kuvendit.

54. Sa i përket kërkesës së parashtruesve të kërkesës që Gjykata të sqarojë se a ka pasur shkelje të Kushtetutës nga Kryetari i legjislaturës së mëparshme gjatë takimit përgatitor të 12 korrikut 2014, 67 deputetët pretendojnë se Gjykata nuk ka kompetenca të shqyrtojë vendimet e Kryesisë së Kuvendit, por vetëm vendimet e marra në seancë nga shumica e deputetëve. Sipas mendimit të tyre, *"[…] ky ka qenë Vendim i Kryesisë, pa asnjë votë kundër, pra i marrë me konsensus dhe me kuorum të mjaftueshëm për të marrë vendime. Duke marrë këtë vendimi, Kryesia ka vepruar në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit, sepse, siç u sqarua më sipër, Kryesia e legjislacionit të mëparshëm vazhdon mandatin deri në zgjedhjen e Kryetarit të legjislaturës së re, përfshirë këtu edhe marrjen e vendimeve rreth Seancës Konstituive".*

55. Për më tepër, sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës se ka pasur shkelje me rastin e zëvendësimit të Kryesueses, 67 deputetët argumentojnë që kjo *"[…] nuk është një çështje me të cilën duhet të merret Gjykata, pasi që është e përcaktuar me Rregulloren e punës së Kuvendit dhe jo me Kushtetutë. Është e*

qartë që të gjitha rregullat e përfshirë [në Rregulloren e punës së Kuvendit], që ndër të tjera përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e deputetëve, vlejnë për çdo seancë. Pra, nga momenti i dhënies së betimit, deputetët kanë pasur të drejtë t'i gëzonin të drejtë të shfrytëzojnë të gjitha të drejtat, përfshirë të drejtën për të kërkuar fjalën, për të votuar pro e kundër, për të kërkuar vazhdimin e seancës, për të kërkuar pauzë, për të paraqitur mocione apo për ta ndërruar Kryesuesen, në përputhje me dispozitat e parapara në Rregullore".

56. Gjashtëdhjetë e shtatë deputetët pretendojnë se ata kanë kërkuar zëvendësimin e Kryesueses në përputhje me Rregulloren e punës së Kuvendit, në dritën e asaj që vijon:

a. *"[...] përkundër vendimit të Kryesisë që në ulëset e mesme të ulen deputetët e Grupit Parlamentar LDK AAK NISMA, deputetët e PDK-së kishin uzurpuar këto ulëse. Në emër të Grupit Parlamentar LDK AAK NISMA, deputetja Vjosa Osmani kërkoi fjalën nga kryesuesja për të kundërshtuar këtë shkelje, por Kryesuesja e Seancës nuk ia dha fjalën. [...] Të njëjtin kundërshtim, rreth shkeljes së Vendimit të Kryesisë sa i përket ulëseve në Kuvend, e shprehi edhe deputeti Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes. Përkundër këtij kundërshtimi, Kryesuesja e Seancës nuk reagoi për ta rregulluar shkeljen e Vendimit të Kryesisë të datës 12 korrik 2014."*

b. *"[...] Kryesuesja e seancës ka tentuar ta ndërpres seancën, përkundër vullnetit të deputetëve (mbi 2/3 të tyre) për ta vazhduar atë. Ajo dhe deputetët e tjerë të PDK-së u larguan nga salla, ndërkaq mbi 2/3 e deputetëve qëndruan në sallë, me kërkesën që seanca të vazhdojë. Në momentin që Zëvendësja e Kryesueses, Teuta Rugova, ka kërkuar të verifikohet kuorumi dhe pastaj të vazhdohet seanca, duke ftuar deputeten tjetër më të vjetër, meqë znj. Flora Brovina refuzonte të udhëhiqte seancën, Flora Brovina është rikthyer në sallë dhe ka uzurpuar ulësen e Kryesueses, duke mos lejuar as vazhdimin e seancës, as diskutime, as votim e asnjë veprim tjetër. Ajo kështu ka mbajtur peng mbi 2/3 e deputetëve të Kuvendit, duke iu përgjigjur vetëm kërkesës së PDK-së që seanca të mos vazhdohej."*

c. *"Pika e tretë e rendit të ditës, e cila përcaktonte njoftimin rreth formimit të grupeve parlamentare, u kalua në mënyrë arbitrare nga Kryesuesja e seancës [...]"* sepse *"[...] nëse askush në seancë nuk ka kundërshtime për Rendin e Ditës në fillim të seancës, ai Rend konsiderohet i miratuar dhe nuk mund të ndryshohet më (neni 42.2 i Rregullores së Kuvendit). Për çdo shmangie nga ky Rregull dhe nga Rregullorja e Kuvendit kërkohen 2/3 e votave të deputetëve të pranishëm (Neni 84 i Rregullores së Kuvendit), por një votim i tillë nuk ka ndodhur fare."*

ç. *"Kur arriti të pika e katërt e rendit të ditës, në përputhje me skenarin e përgatitur nga Sekretariati në lidhje me mbarëvajtjen e seancës, ajo ishte e obliguar që fjalën t'ia jap grupit më të madh parlamentar, dmth. grupit LDK-AAK-NISMA, që të propozojë Kryetarin e Kuvendit, në bazë të Kushtetutës (Neni 67.2), të Rregullores së punës së Kuvendit (Neni 8 dhe 12), të përfundimit të Kryesisë, dhe të skenarit të përgatitur nga Sekretariati i Kuvendit. Megjithatë, ajo i shkeli të gjitha këto dokumente, dhe se pari ia dha fjalën grupit parlamentar të PDK-së me vetëm 37 deputetë, për dallim nga grupi parlamentar LDK-AAK-NISMA me 47 deputetë."*

57. Në fund, 67 deputetët *"Në përputhje me Rregullin 39 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese [...] kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese që të urdhërojë mbajtjen e Seancës dëgjimore, meqë kjo është më se e nevojshme për të qartësuar provat e kësaj lënde, veçanërisht të transkriptit të seancës konstituive të Kuvendit. Një Seancë dëgjimore është esenciale, sepse Transkripti bëhet bazuar në deklarimet e dhëna me mikrofon të hapur me urdhër të Kryesueses së Seancës, përderisa Kryesuesja ka hapur mikrofonin vetëm për deputetet e partisë së saj (PDK) dhe nuk i ka hapur mikrofonin deputetëve të tjerë parashtrues të këtyre Komenteve, por ata janë deklaruar në Kuvend pa mikrofon dhe kanë kërkuar vazhdimisht që të mbahet procesverbal mekanik për shkak të këtyre rrethanave bllokuese nga Kryesuesja e Seancës, Flora Brovina. Për më tepër, ka nevojë që palët (përfaqësuesit e grupeve parlamentarë në Kuvend dhe Sekretaria e Administrata e Kuvendit) të paraqesin qëndrime e tyre jo vetëm për transkriptin, por edhe për dokumente dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e Seancës*."

Komentet e paraqitura nga deputeti i Kuvendit, z. Arsim Bajrami

58. Më 30 korrik 2014, deputeti z. Arsim Bajrami parashtroi komentet e tij në Gjykatë në lidhje me Kërkesën KO119/14. që janë përmbledhur si në vijim:

    a. "*Përfundimi i Kryesisë së legjislaturës së mëparshme (datë 12.07.2014) për ndarjen e vendeve në Kuvend, i nënshkruar nga Kryetari i legjislaturë së mëparshme z. Jakup Krasniqi, është në kundërshtim të drejtpërdrejte me Nenin 64.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse sipas këtij vendimi ndarja e ulëseve në Kuvend nuk u bë në bazë të votave të fituara gjatë zgjedhjeve për Kuvendin, por në bazë të numrave dhe koalicioneve paszgjedhore, që nuk ishin të regjistruara në KQZ, sipas Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme nr. O31L-073 , nenit 15 dhe 18. Pashmangshëm, përmes mënyrës së ndarjes së vendeve, është shkelur edhe praktika e deritashme parlamentare, por njëherit edhe vullneti i sovranit që ishte transmetuar gjate zgjedhjeve […]*".

    b. "*Në mbledhjen e datës 12 Korrik 2014, Kryesia e legjislaturës së mëparshme qëllimisht e ka injoruar faktin se asnjë nga deputetet e legjislaturës së pestë, përfshirë edhe ata te grupimit paszgjedhor LDK-AAK-NISMA nuk e kanë dhënë betimin solemn dhe rrjedhimisht nuk e gëzojnë të drejtën juridike dhe kushtetuese që ta ushtrojnë funksionin e tyre si deputetë. Edhe pse mandati i deputetit fillon me ditën e certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve (neni 70.2), deputeti i zgjedhur nuk mund ta ushtrojë detyrën e deputetit para konstituimit të Kuvendit, gjegjësisht dhënies së betimit. Kjo është arsyeja pse në rregulloren e punës, sekuenca e ngjarjeve në seancën konstituive fillon me përgatitjet për seancë (neni 8), verifikimi i mandatit (neni 9), dhënia e betimit (neni 10) dhe zgjedhja e organeve të Kuvendit (neni 12). Po ashtu, kjo është arsyeja pse neni 70.3 e saktëson se mandati i deputetit shpallet i pavlefshëm nëse deputeti nuk e bën betimin.*"

    c. *"[…] se në ditën e konstituimit, nocioni "grup parlamentar" reflekton vetëm vullnetin e shprehur në zgjedhje dhe të gjitha partitë apo koalicionet e*

certifikuara, duhet të ulen sipas forcës politike, ashtu siç e kanë rezultatin nga zgjedhjet."

ç. *"Vetëm pasi që deputeti ta bëjë betimin dhe të përmbushen procedurat e parapara për zgjedhjen e Kryetarit dhe të Kryesisë së re të Kuvendit (neni 12 me referencë në nenin 8 të Rregullores), deputetët janë të lirë të lëvizin dhe për ketë lëvizje duhet të informojnë me shkrim Kryesinë e re të Kuvendit (neni 20.2); Grupimi paszgjedhor LDK-AAK-NISMA ka të drejtë të bashkohet në një grup të përbashkët vetëm pas seancës konstituive. Si të tillë, të njëjtit nuk kanë qenë grupi më i madh parlamentar në seancën konstituive të datës 17 Korrik 2014, andaj sipas nenit 67.2 të Kushtetutës, nuk kanë pasur dhe nuk kanë të drejtën ta propozojnë kandidatin për kryetar të kuvendit".*

d. *Përveç kësaj, deputeti z. Arsim Bajrami, i referohet Rregullores së punës së Kuvendit të Sllovenisë, Serbisë, Austrisë, Republikës Çeke, Maqedonisë, Shqipërisë, Portugalisë, Bullgarisë dhe Malit të Zi, duke argumentuar që "[...] lëvizja e deputetëve dhe grupet e reja parlamentare krijohen vetëm pas seancës konstituive [...]."*

Komentet e paraqitura nga deputetja e Kuvendit, znj. Luljeta Veselaj-Gutaj

59. Më 4 gusht 2014, deputetja znj. Luljeta Veselaj-Gutaj parashtroi komentet e saj në Gjykatë në lidhje me kërkesën KO119/14, *"Kontestoi procedurën e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit të Kosovës z. Isa Mustafa gjatë seancës konstituive të Kuvendit, të mbajtur më 17 korrik 2014, ku ka shkelje të nenit 67. Konstituimi i kuvendit nuk është zhvilluar në pajtim me nenin 67 (Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve), paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës dhe me Kreun III (Konstituimi i Legjislaturës së Kuvendit) të Rregullores së punës së Kuvendit".*

Komentet e paraqitura nga deputetët e Grupit 6+ të Kuvendit

60. Më 4 gusht 2014, deputetët e Grupit 6+ parashtruan komentet e tyre në Gjykatë në lidhje me kërkesën KO119/14, duke pretenduar se ata kanë marrë pjesë gjatë konstituimit të Kuvendit dhe se vendimet e miratuara gjatë seancës konstituive të Kuvendit janë marrë në përputhje me Kushtetutën.

Komentet e paraqitura nga deputeti i Kuvendit, z. Etem Arifi

61. Më 4 gusht 2014, deputeti z. Etem Arifi parashtroi komentet e tij në Gjykatë në lidhje me kërkesën KO119/14, duke theksuar që ai ka marrë pjesë në konstituimin e Kuvendit dhe se mendimi i tij gjatë seancës konstituive është bazuar në vullnetin e tij të lirë pa asnjë presion.

Komentet e paraqitura nga deputeti i Kuvendit, z. Veton Berisha

62. Më 4 gusht 2014, deputeti z. Veton Berisha parashtroi komentet e tij në Gjykatë në lidhje me kërkesën KO119/14, duke theksuar se ai ka marrë pjesë në seancën konstituive të Kuvendit dhe se mendimi i tij gjatë seancës konstituive është bazuar në vullnetin e tij të lirë pa asnjë presion, si dhe është bazuar në njohurinë e tij për krijimin e institucioneve, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Seanca dëgjimore publike

63. Më 21 gusht 2014 Gjykata mbajti seancë dëgjimore publike, ku të pranishme ishin këto palë dhe të përfaqësuara në mënyrë të rregullt:

    a. Për parashtruesit e kërkesës: deputeti z. Arsim Bajrami;
    b. Për respondentët/palët që janë përgjigjur:

        i. LDK, deputetja znj. Vjosa Osmani;
        ii. VV, deputetja znj. Albulena Haxhiu;
        iii. AAK, z. Ardian Gjini;
        iv. Lista Srpska, deputetja znj. Milka Vulić;
        v. NISMA, deputetja znj. Valdete Bajrami;
        vi. Kosovo Demokratik Tyrk Partisi, deputeti z. Mahir Yagcilar;
        vii. Progresivna Demokratska Stranska, deputeti z. Nenad Rasić;
        viii. Nova Demokratska Stranka, deputetja znj. Emilija Rexhepi;
        ix. Partia Liberale Egjiptiane, deputeti z. Veton Berisha;
        x. Partia e Ashkalinjëve për Integrime, deputeti z. Etem Arifi; dhe

xi. Kosovaki Nevi Romani Partia, deputeti z. Kujtim Paqaku.

64. Gjatë seancës dëgjimore, këto palë morën fjalë:

a. Për parashtruesit e kërkesës: deputeti z. Arsim Bajrami;
b. Për respondentët/palët që janë përgjigjur:
   i. LDK, AAK dhe NISMA, deputetja znj. Vjosa Osmani dhe z. Ardian Gjini; dhe
   ii. VV, deputetja znj. Albulena Haxhiu.

65. LDK-ja dhe VV-ja i paraqitën Gjykatës dokumente shtesë.

66. Gjykata dëgjoi parashtresat verbale të palëve lidhur me kërkesën.

Pranueshmëria e kërkesës

67. Gjykata, së pari, shqyrton nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

68. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, që përcakton: *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar*".

69. Përkitazi me këto kërkesa, Gjykata vëren se parashtruesit kanë ngritur kërkesën e tyre në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, që përcakton si në vijim:

> *"Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur."* [**versioni serbisht dallon prej versioneve anglisht dhe shqip**]

70. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 42 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:*
>
> > *1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetushmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.

71. Përveç emrave dhe nënshkrimeve të deputetëve që parashtruan kërkesën, ata kanë cekur edhe: vendimin e kontestuar, dispozitat relevante të Kushtetutës, si dhe provat që mbështesin kërkesën.

72. Sa i përket vendimit të kontestuar, Gjykata vëren se parashtruesit kontestojnë Vendimin nr. 05-V-001, për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit.

73. Sa i përket afatit kohor, Gjykata vëren se Vendimi nr. 05-V-001, për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, i votuar nga 83 deputetë të Kuvendit, është miratuar më 17 korrik 2014 dhe se kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 18 korrik 2014. Rezulton që kërkesa është parashtruar brenda afatit prej 8 (tetë) ditësh, siç është paraparë me Kushtetutë.

74. Gjykata konkludon se janë përmbushur kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara në nenin 113.5 të Kushtetutës dhe në nenin 42 të Ligjit.

75. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje të rëndësishme kushtetuese lidhur me seancën konstituive të Kuvendit dhe prandaj nuk ka bazë për ta shpallur atë të papranueshme, apo për të hyrë në analizimin e bazave shtesë të pranueshmërisë të dorëzuara nga parashtruesit e kërkesës.

Studimi krahasimtar

76. Para se të hyjë në analizimin e rastit, Gjykata do të kryejë një studim krahasimtar të dispozitave relevante kushtetuese të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: Korniza Kushtetuese) dhe të një numri të vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera.

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 2001

77. Në nenet 9.1.7, 9.1.8 dhe 9.1.9, Korniza Kushtetuese përcakton:

Kryesia e Kuvendit

9.1.7 Kuvendi do të ketë Kryesinë e përbërë prej tetë deputetëve të Kuvendit të cilët do të zgjedhën si vijon:

(a) Dy anëtarë do të emërohen nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet parlamentare;

(b) Dy anëtarë do të emërohen nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e dytë me radhë sa i përket numrit të votave në zgjedhjet parlamentare;;

(c) Një anëtar do të emërohet nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e tretë me radhë sa i përket numrit të votave në zgjedhjet parlamentare;

(d) Një anëtar do të emërohet nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e katërt me radhë sa i përket numrit të votave në zgjedhjet parlamentare;

(e) Një anëtar do të emërohet nga radhët e atyre deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive, të cilat janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin serb dhe

(f) Një anëtar do të emërohet nga radhët e atyre deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive, të cilat janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin joshqiptar dhe joserb. Metoda për emërimin e këtij anëtari të mëvonshëm do të caktohet nga deputetët e Kuvendit që u përkasin komuniteteve të njëjta.

9.1.8 Kuvendi i miraton këto emërime me anë të një vote formale.

Kryetari i Kuvendit

9.1.9 Anëtari i Kryesisë, partia ose koalicioni i të cilit ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet për Kuvend do të jetë Kryetar i Kuvendit.

Shqipëria

78. Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 67 dhe në nenin 75, përcakton:

Neni 67

1. Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e porsazgjedhur jo më parë se data e përfundimit të mandatit të Kuvendit paraardhës, por jo më vonë se 10 ditë pas mbarimit të këtij mandati. Kur Kuvendi paraardhës është shpërndarë para mbarimit të mandatit, Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e ri jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.

2. Në rast se Presidenti i Republikës nuk e ushtron këtë kompetencë, Kuvendi vetëmblidhet në ditën e dhjetë të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 75

1. Kuvendi zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e vet.

2. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve.

79. Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në nenin 6 dhe në nenin 15, përcakton:

Neni 6 – Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit

1. Kandidati për Kryetar të Kuvendit propozohet nga të paktën 15 deputetë. Një deputet nuk mund të mbështesë më shumë se një kandidat. Propozimi bëhet me shkrim, përmban nënshkrimet përkatëse dhe paraqitet në Sekretarinë e Përkohshme të Kuvendit.

2. Kryetari i Kuvendit zgjidhet pa debat dhe me votim të fshehtë, me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar, vijohet me një raund të dytë, ku votohet për dy kandidaturat që kanë marrë më shumë vota.

3. Votimi organizohet publikisht dhe drejtohet nga një komision votimi, i përbërë prej 5 deputetësh, që pasqyron, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Kuvendit. Anëtari më i vjetër në moshë kryen edhe detyrën e kryetarit të komisionit të votimit dhe shpall rezultatin e votimit.

4. Drejtuesi i seancës fton menjëherë Kryetarin e Kuvendit të zërë vendin e tij.

Neni 15 – Formimi i grupeve parlamentare

1. Deputetët mund të formojnë grupe parlamentare sipas përkatësisë partiake ose orientimit politik.

2. Për krijimin e një grupi parlamentar kërkohet një minimum prej 7 deputetësh. Çdo deputet mund të jetë anëtar vetëm i një grupi parlamentar. Një deputet që largohet nga grupi parlamentar, mund t'i bashkohet një grupi tjetër parlamentar vetëm pas gjashtë muajve nga data e largimit.

3. Kur numri i deputetëve të një grupi parlamentar bie nën numrin e parashikuar nga pika 2 e këtij neni, grupi pushon së ekzistuari.

4. Brenda 3 ditëve nga data e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit, çdo deputet deklaron me shkrim se në cilin grup parlamentar bën pjesë. Vetëm deputetët që nuk bëjnë deklarimin e mësipërm ose që nuk i përkasin asnjë grupi parlamentar mund të formojnë grup të përzier.

5. Çdo deputet ka të drejtë të largohet nga grupi parlamentar. Për këtë ai duhet t'i paraqesë një deklaratë me shkrim kryesisë së grupit dhe të njoftojë me shkrim Byronë e Kuvendit.

6. Deputetët që zgjidhen gjatë legjislaturës, brenda 3 ditëve nga kryerja e betimit, bëjnë deklarimin me shkrim se cilit grupi parlamentar i përkasin.

Bullgaria

80. Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë, në nenin 75 dhe në nenin 76, përcakton:

Neni 75

Kuvendi i posa zgjedhur thirret në seancën e parë nga Presidenti i Republikës brenda një muaji pas zgjedhjes së tij. Nëse Presidenti nuk e bënë një gjë të tillë, ai thirret nga ana e një të pestës së deputetëve të Kuvendit.

Neni 76

1. Seanca e parë e Kuvendit hapet nga deputeti më i vjetër i pranishëm.

2. Në seancën e parë, deputetët japin betimin si në vijim:

> *"Betohem se në emër të Republikës së Bullgarisë se do të zbatojë Kushtetutën dhe ligjet e vendit dhe se të gjitha veprimet e mia do të udhëhiqen nga interesat e popullit. Betohem."*

3. Kuvendi zgjedh në të njëjtën seancë Kryetarin dhe Nënkryetarët e tij.

81. Rregullorja e Punës së Kuvendit Kombëtar të Bullgarisë, në Kapitullin II dhe në Kapitullin IV, përcakton:

Kapitulli Dy

KONSTITUIMI I KUVENDIT DHE NDRYSHIMET NË ORGANIN E KRYESIMIT

Neni 3

(1) Seanca e parë e Kuvendit hapet nga ana e deputetit më të vjetër të pranishëm. Deputeti në fjalë e kryeson atë derisa Kuvendi të zgjedhë Kryetarin e vet.

(2) Deputetët e Kuvendit e japin betimin në pajtim me nenin 76, paragrafi 2 i Kushtetutës i cili dokumentohet përmes nënshkrimit individual të betimit me shkrim.

Neni 4

(1) Nën kryesimin e deputetit më të vjetër, debatet mbahen ekskluzivisht për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit si dhe në zgjedhjen e vet tij.

(2) Në seancën e parë të Kuvendit, deputetët e miratojnë rregulloren e punës në lidhje me kushtet dhe rregullat e zgjedhjes së Kryetarit dhe Nënkryetarëve të Kuvendit.

Neni 5

(1) Kryetari dhe Nënkryetarët e Kuvendit mund të shkarkohen nga pozita para skadimit të mandatit sipas kushteve në vijim:

1. me kërkesë të tij/saj;

2. përmes një mocioni më shkrim nga jo më pak se një e treta e të gjithë deputetëve, kur ai/ajo objektivisht nuk është në gjendje të përmbush detyrat e tij/saj apo, në mënyrë të vazhdueshme, keqpërdorë autoritetin e tij/saj apo nëse dështon në kryerjen e detyrave të punës brenda kompetencave të tij/saj.

3. përmes një mocioni me shkrim nga një grup parlamentar i formuar nga ana e një partie apo koalicioni parlamentar i cili e ka nominuar atë.

(2) Nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen nga pozitat para skadimit të mandatit kur e lëshojnë grupin parlamentar i cili i ka nominuar apo me shkarkim nga ai grup.

(3) Në rastet nga pika 1 e paragrafit 1 dhe 2, shkarkimi bëhet pa debat apo votim.

(4) Në rastet nga pika 2 dhe 3 e paragrafit 1, mocioni duhet vënë në votim gjatë seancës së parë pas datës së parashtrimit duke lejuar një dëgjim të personit në fjalë. Mocioni do të konsiderohet të jetë paraqitur nëse mbështetet nga më shumë se gjysma e deputetëve të pranishëm në Kuvend.

(5) Në rast të shkarkimit sipas paragrafit 1 dhe 2, brenda 14 ditësh pas miratimit të vendimit, sipas kushteve të përcaktuara në rregulloren e punës, duhet bërë zgjedhjen e re e cila miratohet nga ana e Kuvendit. Deri në mbajtjen e zgjedhjes së re për Kryetar të Kuvendit, ky i fundit kryesohet nga ana e Nënkryetarit të nominuar nga ana e partisë apo koalicionit të përfaqësuar parlamentar i/e cila e ka nominuar atë.

Neni 6

Kuvendi zgjedh 8 Sekretarë nga mesi i deputetëve.

Neni 7

Në seancën vijuese, Kuvendi zgjedh Komisionet e Përhershme.

Kapitulli Katër

GRUPET PARLAMENTARE

Neni 12.

(1) Deputetët e Kuvendit mund të formojnë grupe parlamentare.

(2) Grupi parlamentar duhet të përbëhet nga së paku 10 (dhjetë) deputetë.

(3) Nëse anëtarët e një grupi parlamentar dështojnë të plotësojnë numrin e kërkuar, atëherë grupi pushon së ekzistuari.

(4) Kur një grup parlamentar pushon së ekzistuari, nënkryetari i zgjedhur nga ky grup duhet të shkarkohet nga detyra para skadimit të mandatit. Shkarkimi duhet të shpallet në seancën e parë të mundshme pa diskutim ose votim.

Neni 13.

(1) Secili grup parlamentar duhet t'i dorëzojë Kryetarit të Kuvendit një vendim për themelimin e grupit dhe një listë të udhëheqësve dhe të anëtarëve, të nënshkruar nga të gjithë anëtarët.

(2) Grupet parlamentare, udhëheqësit e tyre dhe çdo ndryshim në përbërjen e tyre duhet të regjistrohet në një regjistër të posaçëm të Kuvendit.

(3) Kryetari i Kuvendit duhet të shpallë grupet parlamentare të regjistruara dhe udhëheqësit e tyre në seancën plenare. Çdo ndryshim në përbërjen e një grupi parlamentar duhet të kumtohet nga ana e Kryetarit të Kuvendit në seancën plenare.

(4) Të gjithë ndihmësit e përhershëm të një grupi parlamentar duhet të emërohen nga personeli i Kuvendit. Me kërkesë të

cilitdo grup përkatës parlamentar, numri i zyrtarëve të tillë duhet të miratohet nga ana e Kryetarit të Kuvendit në raport prej 1:10 me numrin e anëtarëve të tij, por jo më pak se 2 për secilin grup parlamentar.

Neni 14.

(1) Deputetët e Kuvendit nuk mund të jenë anëtarë të më shumë se një grupi parlamentar.

(2) Mandati i anëtarëve të grupit parlamentar, fillimi dhe përfundimi i tij, dhe të drejtat e detyrat e anëtarëve të grupit duhet të caktohen nga ana e grupit parlamentar përkatës në pajtim me dispozitat e kësaj Rregullore.

(3) Deputeti i kuvendit mund të japë dorëheqje nga grupi i tij/saj parlamentar duke i dorëzuar dorëheqjen në formë të shkruar udhëheqësit të grupit parlamentar dhe Kryetarit të Kuvendit i cili do ta njoftojë Kuvendin në seancën plenare.

(4) Me dorëheqjen nga anëtarësia në grupin parlamentar apo me shkarkim nga ai, deputeti do të humbasë vendin e tij/saj në Komisionet e Përhershme si përfaqësues i grupit parlamentar përkatës, në delegacionet e Kuvendit dhe pozitat tjera të zgjedhura në Kuvend.

(5) Deputeti i cili ka dhënë dorëheqje nga grupi parlamentar apo është përjashtuar nga grupi, do të jetë anëtar i Kuvendit pa u anëtarësuar në asnjë grup parlamentar.

(6) Anëtarët e Parlamentit të Evropës nga Republika e Bullgarisë mund gjithashtu të marrin pjesë në punën e Grupeve Parlamentare pa të drejtë vote dhe në pajtim me regjistrimin e partisë apo koalicionit pranë Komisionit Qendror Zgjedhor, nga lista e të cilëve ata janë zgjedhur.

Kroacia

82. Kushtetuta e Kroacisë, në nenin 73, përcakton:

Neni 73
[...]

Parlamenti i Kroacisë konstituohet në seancën e parë me zgjedhjen e Kryetarit të tij nga shumica e deputetëve të pranishëm.

83. Rregullorja e punës e Parlamentit të Kroacisë, në Pjesën e dytë, përcakton:

Pjesa e dytë

Konstituimi i Parlamentit, Fillimi i Mandatit të Deputetëve, Pezullimi dhe Ndërprerja e Mandatit të Deputetëve në Parlament

Neni 4

Presidenti i Republikës thërret Seancën e parë Konstituive të Parlamentit.

Deri në zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit, seanca përkohësisht kryesohet nga ana e Kryetarit të Parlamentit nga mandati i kaluar, apo, nëse ai/ajo nuk ka pasur mundësi të merr pjesë, nga ana e deputetit më të vjetër të pranishëm në Parlament.

Deri në zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit, kryesuesi i përkohshëm ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e Kryetarit të Parlamentit lidhur me kryesimin e seancës.

Parlamenti konstituohet me zgjedhjen e Kryetarit në seancën e parë në të cilën janë të pranishëm shumica e deputetëve.

Pas zgjedhjes së Kryetarit të Parlamentit, ky i fundit e merr kryesimin.

Me konstituimin e Parlamentit, këndohet himni kombëtar i Kroacisë.

Neni 5

Gjatë Seancës Konstituive, Parlamenti zgjedh edhe anëtarët për Komisionin për Kredenciale dhe Privilegje.

Përveç Kryetarit të Parlamentit dhe Komisionit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, gjatë Seancës Konstituive të Parlamentit mund të zgjidhen edhe Nënkryetari i Parlamentit, Sekretari i Parlamentit dhe Sekretari i Seancës së Parlamentit,

Komisioni i Zgjedhjeve, Emërimeve dhe Administratës si dhe grupet tjera punuese.

Së paku 1/3 e deputetëve të zgjedhur të Parlamentit, gjatë Seancës Konstituive, kanë të drejtë që të paraqesin propozimet për zgjedhjen e organeve të përmendura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni.

Gjermania

84. Ligji Themelor i Republikës së Gjermanisë, në nenin 40, përcakton:

Neni 40 [Kryesia – Rregullorja e punës]

1. Bundestagu zgjedh Kryetarin, Nënkryetarin dhe sekretarinë. Ai miraton rregulloren e punës.

85. Rregullorja e punës e Bundestagut Gjerman përcakton:

Rregulli 1

Mbledhja konstituive

(1) Mbledhja e parë e Bundestagut të porsazgjedhur thirret nga ana e Kryetarit në largim dhe mbahet jo më vonë se ditën e trembëdhjetë pas zgjedhjes (neni 39 i Ligjit Themelor).

(2) Në mbledhjen e parë të Bundestagut, deputeti më i vjetër i Bundestagut, apo nëse ai/ajo nuk pranon, atëherë deputeti më i vjetër i radhës e merr Kryesimin deri sa Kryetari i ri apo njëri nga Nënkryetarët nuk e merr pozitën.

(3) Kryetari sipas moshës duhet të emërojë deputetët e Bundestagut që do të veprojnë si Sekretariat i përkohshëm. Pas kësaj, do të lexohen emrat e deputetëve të Bundestagut.

(4) Pas vërtetimit të kuorumit, bëhet zgjedhja e Kryetarit, Nënkryetarëve dhe Sekretarive.

Rregulli 2

Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve

(1) Bundestagu, përmes votimit të fshehtë dhe të ndarë (Rregulli 49), e zgjedh Kryetarin dhe Nënkryetarët për mandatin elektoral. Çdo grup parlamentar në Bundestagun Gjerman do të përfaqësohet në Kryesi me të paktën një Nënkryetar.

(2) Zgjedhet personi që merr votat e shumicës së deputetëve të Bundestagut. Nëse gjatë votimit të parë nuk merret shumica e votave, për votimin e dytë mund të propozohen kandidatë të ri. Nëse edhe më tej nuk është marr shumica e votave të deputetëve të Bundestagut, mbahet një votim i tretë. Nëse në votimin e tretë është vetëm një kandidat, ai/ajo zgjidhet nëse merr shumicën nga votat e hedhura. Kur ka disa kandidatë, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e tretë; zgjidhet personi që merr shumicën e votave. Në rast të barazimit, Kryetari në cilësinë e kryesuesit me short bënë tërheqjen e emrit për të vendosur se cili nga dy kandidatët do të zgjidhet.

(3) Votimet tjera që përfshijnë një kandidat të pasuksesshëm gjatë votimit të tretë lejohen vetëm me marrëveshjen e arritur nga Pleqësia. Nëse pas procedimit të pasuksesshëm sipas paragrafit (2) propozohen kandidatë të ri, atëherë fillohet përsëri me procedurën e zgjedhjes sipas paragrafit (2).

Rregulli 10

Formimi i grupeve parlamentare

(1) Grupet parlamentare paraqesin bashkimin e jo më pak se pesë përqind të deputetëve të Bundestagut dhe se anëtarët e tyre duhet t'i përkasin të njëjtës parti apo partive të cilat, për shkak të qëllimeve të ngjashme politike, nuk garojnë mes njëra tjetrës në ndonjë Land. Kur deputetët e Bundestagut formojnë një grup të tillë mbi baza të tjera nga ato të përmendura në fjalinë e parë të këtij paragrafi, njohja e tyre si një grup parlamentar kërkon pëlqimin e Bundestagut.

(2) Formimi i grupeve parlamentare, emërimi i tyre dhe emrat e kryesuesve, anëtarëve dhe të ftuarve duhet që në formë të shkruar t'i komunikohen Kryetarit.

(3) Grupet parlamentare mund të pranojnë të ftuar të cilët, pa llogaritur forcën politike të grupit, duhet të merren parasysh gjatë shpërndarjes së posteve (Rregulli 12).

(4) Deputetët e Bundestagut të cilët dëshirojnë të formojnë një grup por që nuk mund ta arrijnë numrin e caktuar minimal për të pasur statusin e një grupi parlamentar, mund të njihen si një grupim. Paragrafët (2) dhe (3) duhet të vlejnë për ato mutatis mutandis.

(5) Grupet punuese të përbashkëta teknike të krijuara nga ana e grupeve parlamentare nuk prekin numrin e posteve në të cilat grupet parlamentare kanë të drejtë në përputhje me fuqinë relative politike të tyre.

Greqia

86. Kushtetuta e Greqisë, në nenin 65, përcakton:

Neni 65

1. Përmes miratimit të Rregullores së vet të punës, Parlamenti përcakton mënyrën e vet të lirë dhe demokratike të punës; kjo rregullore duhet të miratohet nga ana e Plenumit siç përcaktohet në nenin 76 dhe me urdhrin nga Kryetari publikohet në Gazetën Zyrtare.

2. Parlamenti nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe anëtarët e tjerë të Kryesisë të përcaktuar me Rregulloren e punës.

3. Kryetari dhe nënkryetarët zgjidhen në fillim të çdo legjislature. Kjo dispozitë nuk vlen për Kryetarin dhe Nënkryetarët të zgjedhur nga seanca e parë e Parlamentit të Pestë Revizionar. Me rekomandimin e pesëdhjetë deputetëve, Parlamenti mund t'i jap vërejtje Kryetarit apo ndonjë anëtari të Kryesisë e me këtë të ndërpres mandatin e tij .

87. Rregullorja e Parlamentit Helenik përcakton:

Kryesia
(nenet 6 – 12 të Rregullores së Punës)

Kryesia përbëhet nga:

- *Kryetari i Parlamentit Helenik*
- *shtatë (7) Nënkryetarë*
- *tre (3) Dekanë*

- *gjashtë (6) Sekretarë*

Tipar themelor i Kryesisë është përbërja e saj shumë-partiake. Për rrjedhojë, Nënkryetari i parë, i dytë dhe i tretë, dy nga Dekanët dhe katër nga Sekretarët i përkasin partisë qeverisëse; Nënkryetari i katërt, një Dekan dhe një Sekretar i takojnë partisë më të madhe opozitare; Nënkryetari i pestë dhe një Sekretar janë anëtarë të partisë së dytë opozitare më të madhe; Nënkryetari i gjashtë i përket partisë së tretë më të madhe opozitare dhe Nënkryetari i shtatë i përket asaj të katërt. Një anëtar i Kryesisë që duhet patjetër të jetë deputet i zgjedhur, nuk mund të jetë anëtar i Kabinetit (Ministër apo Nënsekretar). Nëse një anëtar i Kryesisë pajtohet të merr detyra ministrore apo si nënsekretar, atëherë ai/ajo ipso facto duhet të jap dorëheqje nga pozita.

Kryetari dhe Nënkryetarët zgjidhen në fillim të secilës legjislaturë për gjatë gjithë mandatit të saj. Mandatet e Dekanëve dhe Sekretarëve zgjasin aq *kohë sa zgjatë periudha e rregullt e seancës së fundit për të cilin janë zgjedhur.*

Maqedonia

88. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, në nenin 63 dhe në nenin 67, përcakton:

Neni 63

Deputetët në Kuvend zgjidhen për periudhë kohore prej katër vitesh. Mandatin e deputetëve e verifikon Kuvendi. Mandati fillon të rrjedhë nga seanca konstituive e Kuvendit. Kuvendi i porsazgjedhur mblidhet në seancën konstituive më së voni 20 ditë pas zgjedhjeve të mbajtura. Seancën konstituive e thirr Kryetari i Kuvendit nga përbërja e mëparshme. Në qoftë se seanca konstituive nuk thirret në afatin e paraparë, deputetët vetë mblidhen dhe e konstituojnë Kuvendin në ditën e njëzetenjëtë nga dita e përfundimit të zgjedhjeve. Zgjedhjet për deputetë në Kuvend mbahen në 90 ditët e fundit të mandatit të përbërjes së vjetër të deputetëve ose brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e shpërndarjes së Kuvendit. […]

Neni 67

Kuvendi nga radha e deputetëve e zgjedh Kryetarin dhe një ose më shumë nënkryetarë, me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. […]

89. Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, në Kapitullin II, përcakton:

II. KONSTITUIMI I KUVENDIT

1. Mbledhja Konstituive e Kuvendit dhe verifikimi i mandatit të deputetëve

Neni 9

Nëse mbledhjen e parë të Kuvendit nuk e thërret Kryetari në largim, mbledhja mbahet në ditën e 21 nga dita e përfundimit të zgjedhjeve, në orën 10.00, ndërkaq të njëjtën e thërret deputeti i zgjedhur më i vjetër në moshë, nëse edhe ai refuzon ta thërrasë, kjo e drejtë i kalohet deputetit të zgjedhur të radhës për nga mosha, deri në deputetin e zgjedhur, i cili do të pajtohet që ta thërrasë mbledhjen e parë.

Deputeti i cili e ka thërritur mbledhjen e parë, kryeson me mbledhjen e Kuvendit (kryesuesi), derisa Kryetari i sapozgjedhur ose njëri prej nënkryetarëve nuk e merr detyrën.

Neni 10

Kryesuesi me mbledhjen e parë cakton dy prej deputetëve të zgjedhur, të cilët sipas nevojës e zëvendësojnë në kryesimin me mbledhjen.

Kryesuesi me apelin e deputetëve të zgjedhur e përcakton numrin e pranishëm të deputetëve të zgjedhur.

Kuvendi mund të konstituohet nëse në mbledhje janë të pranishëm shumica e deputetëve të zgjedhur.

Pasi të konfirmohet kuorumi, zgjidhet kryetari dhe anëtarët e Komisionit Verifikues të Kuvendit (në tekstin e më tejmë: Komisioni Verifikues).

Neni 11

Mandatin e deputetëve, me propozim të Komisionit Verifikues, Kuvendi e verifikon në Mbledhjen Konstituive.

Neni 12

Kuvendi e zgjedh Komisionin Verifikues në Mbledhjen Konstituive, me propozimin e kryesuesit.

Komisioni Verifikues përbëhet prej kryetarit dhe katër anëtarëve, nga radhët e deputetëve të cilët u takojnë partive të ndryshme politike të përfaqësuara në Kuvend.

Neni 13

Në bazë të raportit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për zgjedhjen e çdo deputeti, Komisioni Verifikues i paraqet Kuvendit raport me shkrim me propozim për verifikimin e mandatit të çdo deputeti veças.

Neni 14

Kuvendi e shqyrton dhe e voton në tërësi raportin e Komisionit Verifikues.

(2) Nëse Komisioni Verifikues e konteston zgjedhjen e deputetit të caktuar, i propozon Kuvendit që ta shtyjë verifikimin e mandatit të tij. Për çdo propozim të tillë Kuvendi debaton dhe vendos veças.

Neni 15

Kuvendi mund ta shtyjë verifikimin e mandatit të deputetit dhe me konkluzion të kërkojë që Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve t'i kryejë shqyrtimet e nevojshme për shkak të kontrollimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së zgjedhjes së zbatuar dhe brenda afatit prej 30 ditësh për këtë ta njoftojë Kuvendin.

Neni 16

Deri në marrjen e njoftimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, deputeti, verifikimi i mandatit i të cilit është shtyrë, nuk ka të drejtë të marrë pjesë në seancat e Kuvendit.

Neni 17

Verifikimin e mandatit të deputetëve, të cilët janë bërë deputetë nga lista e kandidatëve për mandatin e mbetur, Kuvendi e bën në mbledhjen e parë të radhës në bazë të raportit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndërsa me propozim të Komisionit për Çështje të Rregullores, Mandatit dhe Imunitetit.

Neni 18

Me verifikimin e mandatit, deputeti fiton të drejta dhe detyra të përcaktuara me Kushtetutë, me ligj dhe me këtë Rregullore.

Neni 19

Deputetit të cilit i është verifikuar mandati, i lëshohet legjitimacion dhe kartelë për votim elektronik.

Në legjitimacion evidentohet e drejta e imunitetit dhe të drejta të tjera që mund të realizohen në bazë të funksionit deputet.

Rregullat më të përafërta për përmbajtjen, formën dhe mënyrën e lëshimit të legjitimacioneve të deputetëve, si dhe për evidencën e legjitimacioneve të lëshuara i miraton Kryetari i Kuvendit.

Për lëshimin e legjitimacioneve dhe për evidencën e legjitimacioneve të lëshuara kujdeset Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

2. Zgjedhja e Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve

Neni 20

Kuvendi në Mbledhjen Konstituive, me propozimin e së paku dhjetë deputetëve, zgjedh Komisionin për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve.

Në Komision sigurohet përfaqësim përkatës i deputetëve të partive politike të përfaqësuara në Kuvend.

3. Zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit

Neni 21

Kuvendi nga radhët e deputetëve zgjedh Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit.

Numrin e nënkryetarëve e përcakton Kuvendi me propozim të Kryetarit të Kuvendit. Nënkryetarët zgjidhen nga radhët e deputetëve, të cilët u takojnë partive të ndryshme politike të përfaqësuara në Kuvend.

Njëri nga nënkryetarët zgjidhet nga radhët e deputetëve, të cilët i takojnë partisë politike të përfaqësuar në Kuvend, që është parti më e madhe opozitare.

Neni 22

Kandidat për Kryetar të Kuvendit mund të propozojë Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve ose së paku 20 deputetë.

Një deputet mund të jetë propozues vetëm i një kandidati për Kryetar të Kuvendit.

Neni 23

Propozimet e kandidatëve për Kryetar të Kuvendit paraqiten me shkrim në seancën e Kuvendit dhe përmbajnë emrin dhe mbiemrin e kandidatit me të dhëna biografike dhe arsyetim, si dhe emrat dhe mbiemrat e deputetëve të cilët paraqesin propozimin dhe nënshkrimet e tyre.

Radhitja e kandidatëve për Kryetar të Kuvendit përcaktohet sipas rendit alfabetik të mbiemrave të tyre.

Neni 24

Me votimin për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit udhëheq kryesuesi.

Nëse Kuvendi vendos që Kryetari i Kuvendit të zgjidhet me votim të fshehtë, kryesuesit gjatë zgjedhjes i ndihmojnë Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe tre deputetë, të cilët i zgjedh Kuvendi me propozim të kryesuesit nga radhët e deputetëve, të cilët u takojnë partive të ndryshme politike të përfaqësuara në Kuvend.

Neni 25

Deputeti ka të drejtë të votojë vetëm për njërin nga kandidatët e propozuar për Kryetar të Kuvendit. Nëse deputeti voton për më shumë kandidatë për Kryetar të Kuvendit, votimi i tij konsiderohet i pavlefshëm.

Neni 26

Për Kryetar të Kuvendit zgjidhet kandidati, i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Nëse për Kryetar propozohet një kandidat dhe nëse gjatë votimit të parë nuk e fiton shumicën e nevojshme të votave, përsëritet e tërë procedura zgjedhore.

Nëse për Kryetar propozohen dy kandidatë, dhe nëse në votimin e parë asnjëri nga kandidatët nuk e fiton shumicën e nevojshme të votave, votimi përsëritet.

Nëse për Kryetar të Kuvendit propozohen tre ose më shumë kandidatë, votimi përsëritet për dy kandidatët, të cilët kanë fituar numër më të madh të votave në votimin e parë.

Nëse mes kandidatëve me numër më të madh votash ka kandidatë me numër të njëjtë të votave, votimi përsëritet për të gjithë kandidatët me numër më të madh të votave.

Në qoftë se edhe në votimin e përsëritur asnjëri nga kandidatët nuk e fiton numrin e mjaftueshëm të votave, përsëritet e tërë procedura zgjedhore.

Neni 27

Dispozitat e kësaj Rregulloreje, që kanë të bëjnë me propozimin e kandidatëve dhe zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, zbatohen edhe gjatë propozimit të kandidatëve dhe zgjedhjes së nënkryetarëve të Kuvendit.

Neni 28

Për Nënkryetar të Kuvendit zgjidhet kandidati, i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Nëse për Nënkryetar propozohen më shumë kandidatë nga numri i cili zgjidhet, ndërsa nuk është zgjedhur numri i parashikuar, do të përsëritet votimi për zgjedhjen e atij numri

të nënkryetarëve të cilët nuk janë zgjedhur edhe atë në mes kandidatëve, të cilët kanë fituar numër më të madh të votave.

Në qoftë se edhe gjatë votimit të përsëritur nuk zgjidhet numri i parashikuar i nënkryetarëve, përsëritet procedura për zgjedhjen e atyre nënkryetarëve të cilët nuk janë zgjedhur.

Nëse propozohen aq kandidatë sa është e nevojshme të zgjidhen, ndërsa nuk është zgjedhur numri i parashikuar, përsëritet e tërë procedura zgjedhore për atë numër të nënkryetarëve të cilët nuk janë zgjedhur

2. Grupet parlamentare

Neni 33

Në Kuvend themelohen grupe të deputetëve.
Grupin e deputetëve e përbëjnë së paku pesë deputetë, të cilët i takojnë njërës, apo më shumë partive politike.

Deputeti mund të jetë anëtar vetëm i një grupi të deputetëve.

Grupi i deputetëve cakton koordinator të grupit të deputetëve dhe deri në dy zëvendës.

Grupi i deputetëve, Kryetarit të Kuvendit i paraqet listë të nënshkruar nga secili anëtar i grupit, nga koordinatori dhe zëvendësi i tij.

Grupi i deputetëve ka të drejtë në ndihmë profesionale dhe të drejtën të shfrytëzojë hapësirë të veçantë, në proporcion me numrin e deputetëve.

Për ndryshimin e përbërjes së grupit të deputetëve, koordinatorit dhe zëvendësit të tij njoftohet Kryetari i Kuvendit, i cili për këtë i njofton deputetët.

Portugalia

90. Kushtetuta e Portugalisë, në nenet: 140, 173 dhe 180, përcakton:

Neni 149 Zonat zgjedhore

1. Deputetët zgjidhen për zonat zgjedhore të cilat, gjeografikisht, përcaktohen me ligj. Me ligj mund të krijohen

zona zgjedhore plurinominale dhe uninominale dhe të përkufizohet natyra dhe komplementariteti i tyre, në atë mënyrë që të sigurohet që votat të shndërrohen në ulëse në përputhje me sistemin e përfaqësimit proporcional dhe duke përdorur rregullën e d'Hondt-it për mesataren – më të lartë.

2. Me përjashtim të zonës zgjedhore kombëtare, nëse ka të tillë, numri i deputetëve për secilën zonë zgjedhore plurinominale në territorin e Portugalisë duhet të jetë proporcional me numrin e qytetarëve të regjistruar me të drejtë vote.

Neni 173 Seanca pas zgjedhjeve

1. Kuvendi i Republikës së duhet të mblidhet në ditën e tretë pas llogaritjes së rezultateve të përgjithshme të zgjedhjeve apo, në rast të zgjedhjeve të organizuara për shkak se një legjislaturë po e përfundon mandatin dhe se dita e tretë në fjalë bie para përfundimit të mandatit të legjislaturës në fjalë, në ditën e parë të legjislaturës vijuese.

2. Në rast se ajo datë bie kur Kuvendi nuk është në përbërje të plotë, seanca duhet mbajtur për qëllimet e nenit 175.

Neni 180 Grupet parlamentare

1. Deputetët e zgjedhur nga secila parti ose koalicion i partive mund të formojnë grup parlamentar.

2. Secili grup parlamentar ka të drejtat në vijim:

a. Të marrë pjesë në komisionet e Kuvendit në raport me numrin e deputetëve tij dhe të emërojë përfaqësuesit e vet në komisione të tilla;

b. Të konsultohet për krijimin e rendit të ditës dhe të apelojë gjatë seancës Plenare kundër rendit të tillë të ditës;

c. Të iniciojë mbajtjen e debateve urgjente për çështjet me interes publik urgjent ku duhet të merr pjesë Qeveria;

d. Gjatë secilës seancë legjislative, të ngrit mbajtjen e dy debateve për çështjet e politikave të përgjithshme apo sektoriale duke ftuar Qeverinë për pjesëmarrje në Kuvend;

e. Të kërkojë nga Komisioni i Përhershëm që të ndërmerrë hapat për thirrjen e seancës Plenare;

f. Të iniciojë formimin e komisioneve parlamentare hetimore;

g. Të iniciojë ligje;

h. Të paraqesë mocione për refuzimin e Programit Qeveritar;

i. Të paraqesë mocione për mosbesim ndaj Qeverisë;

j. Të informohen rregullisht dhe drejtpërdrejtë nga ana e Qeverisë për situatën dhe mbarëvajtjen e çështjeve kryesore me interes publik.

3. Secili grup parlamentar ka të drejtë të disponojë me vendet ku do të punojë në selinë e Kuvendit, së bashku me stafin teknik dhe administrativ të zgjedhur prej tij, siç përcaktohet me ligj.

4. Deputetëve që nuk i përkasin asnjë grupi parlamentar u sigurohet një minimum i të drejtave dhe garancive të përcaktuara me Rregulloren e punës.

91. Rregullorja e punës e Kuvendit të Portugalisë, në Kapitullin II, përcakton:

KAPITULLI II

Grupet parlamentare

Neni 6
Formimi i grupeve parlamentare

1- Deputetët e Kuvendit të Republikës, të zgjedhur nga secila parti ose koalicion i partive mund të formojnë grup parlamentar.

2- Secili grup parlamentar formohet duke i dorëzuar Kryetarit të Kuvendit një njoftim, të nënshkruar nga deputetët e Kuvendit të Republikës, të cilët e përbëjnë grupin parlamentar dhe ky njoftim duhet të përmbajë emrin e grupit, Kryetarin e grupit dhe nënkryetarin, nëse ekziston.

3- Grupet parlamentare e njoftojnë Kryetarin e Kuvendit për çdo ndryshim në përbërjen e grupit apo në udhëheqësin e tij.

4- Njoftimi i referuar në paragrafët e mësipërm (2) dhe (3) duhet te publikohet ne Gazetën Zyrtare.

Neni 13
Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit

1 – Propozimet për Kryetar të Kuvendit të Republikës duhet të nënshkruhen nga të paktën një e dhjeta dhe nga më së shumti një e pesta e të gjithë deputetëve.

2 – Propozimet i dorëzohen Kryetarit në detyrë së paku dy orë para momentit kur bëhet zgjedhja.

3 – Zgjedhja bëhet gjatë seancës së parë plenare të secilës legjislaturë.

4 – Kryetar i Kuvendit zgjidhet kandidati që merr një shumicë absolute të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës gjatë ushtrimit të plotë të mandatit të tyre.

5 – Nëse asnjë kandidat nuk merr atë numër të votave, duhet që menjëherë të mbahet votimi i dytë vetëm për dy kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave dhe që nuk i kanë tërhequr propozimet e tyre.

6 – Nëse nuk zgjidhet asnjë kandidat, procesi fillon nga e para.

Sllovenia

92. Kushtetuta e Sllovenisë, në nenin 84, përcakton:

Neni 84 Kryetari i Kuvendit Kombëtar

Kuvendi Kombëtar ka një kryetar i cili zgjidhet më shumicën e votave të të gjithë deputetëve.

93. Rregullorja e punës së Kuvendit Kombëtar të Sllovenisë, në Kapitullin II, përcakton:

II. KONSTITUIMI I KUVENDIT KOMBËTAR

Neni 9

Kuvendi konstituohet gjatë seancës së parë në të cilën konfirmohet zgjedhja e më shumë se gjysmës së deputetëve.

Neni 10

(1) Jo më vonë se pesë ditë nga seanca e parë e Kuvendit, Kryetari në detyrë i Kuvendit thërret takimin me udhëheqësit e përkohshëm të grupeve të deputetëve dhe deputetëve nga komunitetet kombëtare për të përcaktuar draft rendin e ditës së seancës së parë, renditjen e ulëseve të deputetëve në sallën e kuvendit, grupet parlamentare anëtarët e të cilave do të bartin pozitën e kryesuesve dhe zëvendës kryesuesve në Komisionin për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërime dhe numrin a anëtarëve të këtij komisioni që i përkasin grupeve të caktuara parlamentare dhe mundësisht edhe përcaktimi i grupeve deputetëve anëtarët e të cilave do të bartin pozitën e kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit në grupet tjera punuese si dhe numrin e anëtarëve të atyre grupeve punuese që i përkasin grupeve të caktuara deputetëve.

(2) Në pritje të formimit të Këshillit të Kryetarit të Kuvendit Kombëtar, udhëheqësit e përkohshëm të grupeve të deputetëve dhe dy deputetë nga komunitetet kombëtare, vendosin për propozimet nga pika e parë, e dytë dhe e katërt e paragrafit gjashtë të nenit 21 të kësaj Rregullore të Punës dhe mund të propozojnë një kandidat për Sekretar të Përgjithshëm të Kuvendit Kombëtar.

(3) Rendi i ulëseve të deputetëve në sallë përcaktohet përmes marrëveshjes mes grupeve të deputetëve. Nëse nuk arrihet ndonjë marrëveshje, rendi i ulëseve përcaktohet në atë mënyrë që ulëset e deputetëve në mesin e ulëseve të lira deputetëve përcaktohen nga grupet e deputetëve sipas rendit nga grupi më i madh deri tek grupi më i vogël e deputetëve. Grupeve të deputetëve me numër të njëjtë të anëtarëve, përmes shortit paraprak, iu përcaktohet renditja e ulëseve të deputetëve.

Neni 11

(1) Deri në formimin e grupeve të deputetëve, në përputhje me nenin 16 të kësaj Rregullore të punës, grupet parlamentare përbëhen nga deputetët e zgjedhur në Kuvend nga lista e njëjtë

e kandidatëve, deputetëve të zgjedhur nga lista e votuesve dhe deputetëve që përfaqësojnë komunitetet kombëtare. Përbërja e grupeve të deputetëve është e përcaktuar mbi bazën e raportit për rezultatet e zgjedhjeve.

(2) Jo më vonë se tri ditë pas publikimit të raportit për rezultatet e zgjedhjeve, përfaqësuesit e listave i dërgojnë emrat e udhëheqësve të përkohshëm të grupeve të deputetëve nga paragrafi paraprak te Kryetari në detyrë i Kuvendit Kombëtar.

Neni 12

(1) Përgatitjet për seancën e parë të Kuvendit janë përgjegjësi e Kryetarit në detyrë të Kuvendit.

(2) Udhëheqësit e përkohshëm të grupeve të deputetëve e informojnë Kryetarin në detyrë të Kuvendit për kandidatët e propozuar për Kryetar, Nënkryetar dhe anëtarë të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërime.

(3) Drafti i rendit të ditës së seancës së parë përfshin emërimin e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërime, konfirmimin e zgjedhjes së deputetëve dhe zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe mund të përfshijë edhe zgjedhjen e Nënkryetarëve të Kuvendit dhe emërimin e kryesuesve dhe zëvendëskryesuesve të grupeve punuese si dhe emërimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

(4) Deri në zgjedhjen e Kryetarit, seancën e parë të Kuvendit e kryeson deputeti më i vjetër.

Neni 13

(1) Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërime shqyrton raportin e rezultateve të zgjedhjeve, konfirmimin e deputetëve të zgjedhur dhe çdo ankesë të kandidatëve apo përfaqësuesve të listës së kandidatëve.

(2) Kuvendi Kombëtar vendos për konfirmimin e zgjedhjes së deputetëve mbi bazën e raportit të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërime lidhur me vlerësimin dhe konfirmimin e zgjedhjeve dhe përmbajtjen dhe pranueshmërinë e çfarëdo

ankese nga kandidatët apo përfaqësuesit e listës së kandidatëve.

(3) Kuvendi Kombëtar, në mënyrë kolektive, vendos për konfirmimin e zgjedhjeve që nuk janë të kontestuara dhe për secilën zgjedhje të kontestuar veç e veç.

(4) Një deputet, zgjedhja e të cilit ende kontestohet nuk mund të votojë për konfirmimin e zgjedhjes së tij.

(5) Duke vendosur për një zgjedhje të kontestuar, konsiderohet se Kuvendi ka vendosur edhe për çdo ankesë të parashtruar pranë Kuvendit nga ana e një kandidati ose përfaqësuesi të listës së kandidatëve.

Neni 14

Pas konfirmimit të këtyre zgjedhjeve, Kuvendi Kombëtar zgjedh Kryetarin e Kuvendit Kombëtar.

Neni 15

Nëse gjatë seancës së parë Kuvendi dështon në zgjedhjen e Nënkryetarëve të Kuvendit Kombëtar dhe në emërimin e kryesuesve dhe zëvendës kryesuesve të grupeve punuese dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit Kombëtar, ky i fundit duhet t'i zgjedh apo emëron ata jo më vonë se 30 ditë pas konstituimit të tij.

Neni 16

Deputetët formojnë grupet të deputetëve në pajtim me nenin 29 të kësaj Rregulloreje të punës jo më vonë se shtatë ditë pas konstituimit të Kuvendit Kombëtar.

Neni 17

Dispozitat e nenit 13 të kësaj Rregulloreje të punës vlejnë mutatis mutandis edhe për procedurën e konfirmimit të zgjedhjes së një deputeti që e zëvendëson një deputet mandati i të cilit ka skaduar apo një deputet mandati i të cilit është ndërprerë për shkak të zgjedhjes së tij Kryeministër apo është emëruar për ministër.

Baza relevante juridike për kërkesën

94. Neni 67 (1 - 3) [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] i Kushtetutës parasheh:

> *"1. Kuvendi i Kosovës, nga radhët e veta, zgjedh Kryetarin dhe pesë (5) nënkryetarë.*
> *2. Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*
> *3. Tre (3) nënkryetarët e propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit."*

95. Neni 64 (1) [Struktura e Kuvendit] i Kushtetutës parasheh:

> *"Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin."*

96. Kreu III i Rregullores së punës të Kuvendit parasheh si në vijim:

> *"KREU III - Konstituimi i Legjislaturës së Kuvendit*
>
> *Neni 7*
> *Mbledhja konstituive e legjislaturës së Kuvendit*
>
> *Mbledhjen konstituive të legjislaturës së Kuvendit e thërret Presidenti i Republikës së Kosovës brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultatit të zgjedhjeve.*
>
> *Neni 8*
> *Përgatitja e mbledhjes konstituive e legjislaturës së Kuvendit*
>
> *1. Përgatitjet për mbledhjen konstituive të legjislaturës së Kuvendit janë përgjegjësi e Kryetarit nga legjislatura e mëparshme.*
>
> *2. Kryetari dhe Kryesia, jo më pak se pesë ditë para mbajtjes së mbledhjes konstituive të legjislaturës së Kuvendit thërrasin*

mbledhje të përbashkët me kryetarët e partive, që kanë fituar vende në Kuvend, për ta përgatitur propozimin e rendit të ditës për mbledhjen konstituive të legjislaturës së Kuvendit, për t'i caktuar vendet e deputetëve, përkatësisht të forcave politike në sallë, sipas fuqisë politike që kanë, sipas numrit të deputetëve të secilës forcë politike.

3. Nëse dy apo më shumë grupe parlamentare kanë numër të njëjtë të deputetëve, atëherë renditja e tyre në sallë bëhet me short.

4. Rendi i ditës i mbledhjes konstituive të legjislaturës duhet ta përfshijë formimin e Komisionit të përkohshëm për verifikimin e kuorumit, të mandateve, zgjedhjen e kryetarit dhe të pesë (5) nënkryetarëve të Kuvendit.

Neni 9
Kryesimi i mbledhjes konstituive të legjislaturës së Kuvendit

1. Punimet e mbledhjes konstituivet të legjislaturës së Kuvendit, deri në zgjedhjen e Kryetarit dhe të nënkryetarëve të Kuvendit, i udhëheq deputeti më i vjetër, i ndihmuar nga deputeti më i ri, sipas moshës.

2. Nëse deputeti, përkatësisht deputetët nga paragrafi 1 e këtij neni, mungojnë në mbledhjen konstituive ose e refuzojnë kryesimin e mbledhjes, atëherë angazhohen deputetët të cilët, sipas moshës, vijnë menjëherë pas tyre.

3. Kryesuesi i mbledhjes konstituive të legjislaturës së Kuvendit, pas hapjes së mbledhjes dhe paraqitjes së rendit të ditës, kërkon nga partitë politike të përfaqësuara në Kuvend ta caktojnë nga një përfaqësues në Komisionin e përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve.

4. Komisioni i përkohshëm e shqyrton dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve, ia paraqet Kuvendit raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit dhe e verifikon kuorumin në mbledhjen konstituive të legjislaturës së Kuvendit.

Neni 10

Betimi i deputetëve

1. Pas verifikimit të mandateve, deputetët betohen solemnisht. Teksti i deklaratës është:

"Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Betohem!".

Deklaratën e betimit e lexon kryesuesi i mbledhjes. Deputetët betohen, duke e shqiptuar në fund të deklaratës, fjalën "Betohem!". Secili deputet e nënshkruan deklaratën e betimit.

2. Deputeti, që mungon në mbledhjen konstituive të legjislaturës, kur bëhet betimi, betimin e bën në mbledhjen e parë të radhës.

Neni 11

Mandati i Kuvendit

1. Kuvendi zgjidhet me mandat katërvjeçar. Mandati fillon nga mbledhja konstituive, e cila mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.

2. Mandati i Kuvendit mund të vazhdohet vetëm në rastet e parapara sipas nenit 66, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Neni 12

Zgjedhja e Kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit

1. Në mbledhjen konstituive të Legjislaturës IV, Kuvendi nga radhët e veta i zgjedh Kryetarin dhe nënkryetarët. Kryetari dhe nënkryetarët e përbejnë Kryesinë e Kuvendit.

2. Kryesuesi i mbledhjes konstituive kërkon nga grupi më i madh parlamentar ta propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit. Kryetari i Kuvendit zgjidhet me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit.

3. Kryesuesi i mbledhjes konstituive të legjislaturës kërkon nga tri grupet më të mëdha parlamentare ta propozojnë nga një kandidat për nënkryetarë të Kuvendit, të cilët zgjidhen me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit.

4. Në përbërje të Kryesisë dhe në trupat e tjerë të punës të Kuvendit respektohet përbërja gjinore e Kuvendit.

5. Kryesuesi i mbledhjes konstituive të legjislaturës kërkon nga deputetët që mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb dhe nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera, që nuk janë shumicë, ta propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit. Nënkryetarët, sipas kësaj pike, zgjidhen me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit.

6. Kryesuesi i mbledhjes konstituive të legjislaturës e shpall rezultatin e votimit për zgjedhjen e Kryetarit dhe të nënkryetarëve të Kuvendit. Kryetarin e sapozgjedhur të Kuvendit e fton ta zërë vendin e tij.".

97. Gjykata vëren se, lidhur me seancën e parë të thirrur pas zgjedhjeve parlamentare, versioni anglisht i Kushtetutës përdor termin "seancë konstituive" (neni 66, paragrafët 1 dhe 3 [Zgjedhja dhe Mandati] i Kushtetutës) ndërsa Rregullorja e punës e Kuvendit përdor termin "inauguration of the Assembly" (inaugurimi i Kuvendit) (titulli i Kreut III) dhe "inaugural session" (seancë inaugurues) (nenet 7, 8 dhe 9). Versioni shqip i Kushtetutës përdor shprehjen "seancë konstituive" (neni 66, paragrafi 1 dhe 3 [Zgjedhja dhe Mandati] i Kushtetutës), kurse Rregullorja e punës e Kuvendit përdor "KONSTITUIMI I LEGJISLATURËS" (titulli i Kreut III) dhe "konstituive e legjislaturës" (nenet 7, 8 dhe 9)". Gjykata konsideron se shprehja "constitutive session" (seancë konstituive) shërben më mirë për qëllime të qartësisë. Prandaj, Gjykata e ka përdorur dhe do të përdorë termin kushtetues "Seancë konstituive", që do të thotë seanca e parë e thirrur pas zgjedhjeve parlamentare.

Meritat e kërkesës

98. Parashtruesit e kërkesës ankohen se procedura e ndjekur nga 83 deputetë për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit ishte në kundërshtim me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], , të Kushtetutës, dhe me Kreun III

[Konstituimi i Legjislaturës së Kuvendit] të Rregullores së punës të Kuvendit. Pra, sipas këndvështrimit të parashtruesve, vendimi i 83 deputetëve, me të cilin z. Isa Mustafa u zgjodh Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, është jokushtetues.

99. Gjykata vëren se kërkesa ka të bëjë me zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit sipas nenit 67 (2) [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës. Kjo dispozitë përcakton se *"Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit"*.

100. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të vlerësojë faktet e rastit të veçantë, por të vlerësojë nëse pretendimet e lartpërmendura kanë ngritur apo jo çështje kushtetuese sipas dispozitës përkatëse kushtetuese. Rrjedhimisht, në rastin e tanishëm, Gjykata do të merret vetëm me çështje të natyrës kushtetuese të ngritura në bazë të nenit 67 (2) të Kushtetutës dhe në bazë të dispozitave të tjera të ndërlidhura.

101. Gjykata vëren se, në rastet e mëparshme, kur është bërë fjala për interpretimin e dispozitave kushtetuese, ka kërkuar shumë herë që t'i dorëzohen *Travaux Preparatoires,* në mënyrë që të njihet me qëllimin e hartuesve të Kushtetutës. Rezultati gjithmonë ka qenë që *Travaux Preparatoires* të Kushtetutës nuk janë në dispozicion. Për pasojë, Gjykata ka vendosur që, në mungesë të *Travaux Preparatoires* të Kushtetutës, duhet ta bëjë interpretimin vetë (Shih, për shembull, rastin KO103/14, *Presidentja e Republikës së Kosovës përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 1 korrikut 2014).

102. Prandaj, Gjykata nuk mund të arrijë në përfundime lidhur me qëllimet e hartuesve të Kushtetutës dhe nuk mund të spekulojë se çfarë kanë dashur të thonë ata. Për më tepër, çfarëdo krahasimi ose çfarëdo marrje e argumenteve nga Korniza Kushtetuese e Kosovës e vitit 2001 vështirë se është relevante. Korniza Kushtetuese ka qenë në fuqi deri më 15 qershor 2008 për të rregulluar një situatë tjetër. Më 9 prill 2008, u miratua Kushtetuta e re moderne dhe zbatohet në shtetin e pavarur të Republikës së Kosovës nga 15 qershori 2008.

103. Rrjedhimisht, Gjykata do të bëjë interpretimin e nevojshëm të nenit 67 (2) [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës.

104. Si vërejtje paraprake, Gjykata vëren se, për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe për formimin e Qeverisë, Kushtetuta përdor shprehje të ndryshme për të njëjtin realitet. Shprehje të ndryshme konkretisht janë: *Vendet* (...) *ndahen (...) në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara (...) në zgjedhjet (...)* [(Neni 64 (1) i Kushtetutës], *grupi më i madh parlamentar* [Neni 67 (2) i Kushtetutës], *partia politike ose koalicioni, që përbën shumicën e Kuvendit* [Neni 84 (14) i Kushtetutës], *partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën në Kuvend* [Neni 95 (1) i Kushtetutës].

105. Duke marrë parasysh këtë, Gjykata do të mbështetet në nenin 64 (1) [Struktura e Kuvendit] të Kushtetutës. Ky nen parasheh: *"Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin".*

106. Gjykata vëren se nenet e lartpërmendura 64 (1) dhe 67 (2) të Kushtetutës janë bazë juridike për strukturimin dhe konstituimin e Kuvendit dhe Kreu III i Rregullores së punës të Kuvendit shërben si mjet dhe si mekanizëm procedural për implementimin e këtyre dispozitave kushtetuese.

107. Në këtë drejtim, Gjykata vëren, së pari, se Rregullorja e punës për zhvillimin e seancës konstituive të Kuvendit u miratua më 29 prill 2010; ajo është në fuqi dhe duhet të aplikohet, përfshirë edhe në raport me rendin e ditës.

108. Së dyti, Gjykata vëren se qëllimi i seancës konstituive të Kuvendit është ndërtimi i legjislaturës së re pas zgjedhjeve, me ndihmën procedurale të Kryetarit të legjislaturës së mëparshme, mandati i së cilës kishte përfunduar para se të mbaheshin zgjedhjet e reja parlamentare. Kuvendi ndërtohet nëpërmjet verifikimit dhe konfirmimit të mandatit të deputetëve, dhënies së betimit nga deputetët dhe nëpërmjet zgjedhjes së Kryetarit dhe të nënkryetarëve të Kuvendit (Shih nenin 8, paragrafi 4, nenin 10 dhe nenin 12 të Rregullores së punës të Kuvendit).

109. Së treti, Gjykata vëren se seanca konstituive e Kuvendit nuk mund të konsiderohet se është realizuar plotësisht, nëse Kuvendi nuk e ka zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e tij.

110. Gjykata konsideron më tej se Kryesuesja që e kryeson seancën konstituive, edhe pse nuk është e zgjedhur, ajo është e obliguar me Kushtetutë dhe me Rregullore të punës të Kuvendit, për të realizuar Seancën konstituive.

111. Me qëllim të vlerësimit se a ka qenë kushtetuese zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit, Gjykata do të interpretojë kuptimin e "grupit më të madh parlamentar", sipas nenit 67 (2) të Kushtetutës. Ky interpretim është i rëndësisë kruciale pasi ka të bëjë me atë se kush mund të propozojë Kryetarin e Kuvendit.

112. Gjykata vëren se nenit 67 (2) të Kushtetutës i paraprin neni 64 (1) i Kushtetutës. Që të dy dispozitat janë të ndërlidhura dhe duhet të merren parasysh së bashku.

113. Kushtetuta, në nenin 64 (1), përcakton se, me rastin e strukturimit të Kuvendit, vendet duhet të ndahen në proporcion me numrin e votave të fituara në zgjedhjet për Kuvend. Ndarja bëhet ndërmjet partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në proporcion me rezultatet në zgjedhje parlamentare. Kjo do të thotë se partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur u jepet ai numër i vendeve, barazuar me mandate të deputetëve, që korrespondon proporcionalisht me votat që kanë fituar në zgjedhje, duke pasur parasysh se këto parti, koalicione, iniciativa qytetare dhe kandidatë të pavarur kanë kaluar pragun. Kushtetuta i jep prioritet rezultateve të zgjedhjeve si kriter. Kjo vlen për parti dhe për koalicione që janë regjistruar si të tilla për të marrë pjesë në zgjedhje, si dhe për iniciativa qytetare dhe për kandidatë të pavarur.

114. Gjykata rithekson se *"përdorimi i termeve 'parti politike ose koalicion' kur përmenden në lidhje me nenin 84 (14) dhe nenin 95 paragrafi 1 dhe 4 të Kushtetutës nënkuptohet partia politike ose koalicioni që është regjistruar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, merr pjesë si subjekt zgjedhor, është i përfshirë në fletëvotim të zgjedhjeve, e kalon pragun dhe, kësisoj fiton vende në Kuvend"* (Shih rastin KO103/14, *Presidentja e Republikës së Kosovës përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 1 korrikut 2014).

115. Për më tepër, Gjykata vendosi që *"[...] partia politike ose koalicioni mund të jetë vetëm ajo që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhje, respektivisht numrin më të madh të vendeve në Kuvend."* (*Shih rastin KO103/14, Presidentja e Republikës së Kosovës përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 1 korrikut 2014*).

116. Rrjedhimisht, grupi më i madh parlamentar, sipas nenit 67 (2) të Kushtetutës, duhet të konsiderohet partia, koalicioni, iniciativa qytetare dhe kandidatë të pavarur që kanë më shumë vende në Kuvend, në kuptim të nenit 64 (1) të Kushtetutës, se çdo tjetër parti , koalicion, iniciativë qytetare dhe kandidatë të pavarur që kanë marrë pjesë si të tillë në zgjedhje. Ky grup duhet ta propozojë Kryetarin e Kuvendit, duke respektuar dispozitat e nenit 67 (2) të Kushtetutës. Kjo është ajo që parasheh Kushtetuta si grup parlamentar dhe, aq më tepër, që kjo është *de facto* në pajtim me praktikën parlamentare në shtetet demokratike.

117. Një argument shtesë është se grupi parlamentar, në kuptimin më të ngushtë të fjalës (*in stricto sensu*), dhe sipas Rregullores së punës të Kuvendit e Shtojcave të saj, mund të regjistrohet vetëm pas konstituimit të Kuvendit, pra, pas zgjedhjes së Kryetarit dhe të nënkryetarëve të Kuvendit.

118. Në momentin e thirrjes së seancës konstituive të Kuvendit, grupi parlamentar përbëhet nga kandidatë që janë zgjedhur anëtarë të Kuvendit në fletëvotimin e partisë, tëkoalicionit, të iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur që janë regjistruar për zgjedhje, kanë marrë pjesë në to, e kanë kaluar pragun ligjor dhe kanë fituar vende në proporcion me numrin e votave të vlefshme të fituara në zgjedhjet për Kuvend.

119. Në rastin e tanishëm, Kryesuesja e seancës konstituive, më të drejtë ia dha mundësinë grupit më të madh parlamentar të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit, pasi që, sipas listës së rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve, partia e cila ishte e para në renditje i kishte 37 deputetë. Rrjedhimisht, po t'i ishte dhënë mundësia ndonjë partie tjetër, ndonjë koalicioni tjetër, ndonjë iniciative tjetër qytetare dhe kandidatëve të tjerë të pavarur, do të ishte jokushtetuese.

120. Gjykata vëren se, sipas transkriptit, pas pezullimit të seancës konstituive për shkak të mungesës së kuorumit, një grup i deputetëve thirri një mbledhje për të parashtruar mocion për zëvendësimin e Kryesueses dhe ata zgjodhën Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit.

121. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e kësaj procedure dhe rezultatin e saj. Duke marrë parasysh interpretimin e lartpërmendur në bazë të nenit 67 (2), në lidhje me neni 64 (1), dhe në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit, Gjykata gjen se kjo mbledhje e kontestuar nuk është në pajtim me kërkesat kushtetuese që një seancë konstituive të konsiderohet kushtetuese. Kështu, kjo mbledhje nuk duhet të konsiderohet seancë konstituive.

122. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se vendimi, si rezultat i kësaj mbledhjeje, nuk korrespondon me një vendim të marrë, sipas nenit 67 (2) të Kushtetutës, gjatë seancës konstituive dhe, nga grupi më i madh parlamentar. Për pasojë, Vendimi Nr. 05-V-001, i votuar nga 83 deputetë të Kuvendit për zgjedhjen e z. Isa Mustafës Kryetar të Kuvendit, i 17 korrikut 2014, është i pavlefshëm.

123. Gjykata rithekson se zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit dhe e deputetëve është parakusht që Kuvendi të fillojë të funksionojë si organ legjislativ. Kjo kërkon nga të gjithë deputetët që të jenë të pranishëm dhe të votojnë, në mënyrë që të konstituojnë Kuvendin. Në rastin KO29/11, Gjykata vendosi që *"[...]'Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit [...]". Për më tepër, lidhur me obligimin e tyre si deputetë, neni 74 [Ushtrimi i funksionit] i Kushtetutës siguron: "deputetët e Kuvendit të Kosovës do të ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe sipas Kushtetutës, ligjeve dhe Rregullores së punës së Kuvendit."* (Shih, Rasti KO29/11, *Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë në kërkesën për Vlerësim të kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, të datës 22 shkurt 2011,* Aktgjykim i 30 marsit 2011).

124. Për më tepër, Gjykata rikujton se votimi në Kuvend mund të bëhet në mënyra të ndryshme: duke votuar "për", "kundër" ose duke abstenuar; me votim të hapur ose me votim të fshehtë; apo në çfarëdo mënyre tjetër (Shih paragrafin 4 të nenit 51 [Kuorumi dhe votimi në mbledhjet e Kuvendit], të Rregullores së punës të Kuvendit).

125. Gjykata konsideron se mënyrat e ndryshme të votimit kanë për qëllim të sigurojnë shprehjen demokratike dhe të pavarur të vullnetit të deputetëve dhe të sigurojnë të drejtat e deputetëve në mënyrë që ata t'u përmbahen obligimeve të tyre.

126. Gjykata vëren se askund në Kushtetutë nuk parashihet që dështimi në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit do të shkaktonte mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare.

127. Është e drejtë dhe detyrë e të gjithë deputetëve të Kuvendit që të gjejnë mënyrën për të zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët të Kuvendit, në pajtim me dispozitat kushtetuese në lidhje me Rregulloren relevante të Kuvendit dhe të bëjnë Kuvendin funksional.

128. Në konstituimin e Kuvendit, të gjithë deputetët duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë si të dëshirojnë, në mënyrë të hapur ose të fshehtë, të votojnë "për", "kundër" ose të abstenojnë, dhe nuk mund të lirohen nga të vepruarit kështu.

129. Gjykata rithekson se vendimi i saj është bazuar në objektin e çështjes së kërkesës, siç është përmendur në paragrafët 3 dhe 4 të këtij aktgjykimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.5 të Kushtetutës, në bazë të nenit 42 dhe të nenin 43 të Ligjit, dhe në bazë të rregullit 56.1 të Rregullores së punës, më 21 gusht 2014,

VENDOSI

I. njëzëri, të DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. me shumicë votash, TË KONSTATOJË, që:

a. mbledhja dhe procedura e ndjekur pas pezullimit të seancës konstituive, më 17 korrik 2014, nga Kryesuesja, për shkak të mungesës së kuorumit, kanë shkelur nenin 67 (2), në lidhje me nenin 64 (1), të Kushtetutës dhe Kreun III të Rregullores së punës që zbaton këto nene;

b. Vendimi Nr. 05-V-001, i 17 korrikut 2014, është jokushtetues, si për nga procedura e ndjekur, ashtu edhe për nga përmbajtja, pasi nuk ishte grupi më i madh parlamentar ai që propozoi Kryetarin e Kuvendit dhe, rrjedhimisht, është i pavlefshëm;

c. Seanca konstituive e Kuvendit, që ka filluar më 17 korrik 2014, nuk është realizuar plotësisht, konkretisht nuk janë zgjedhur Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit. Rrjedhimisht, Kuvendi duhet ta përfundojë seancën konstituive, duke zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët në pajtim me nenin 67 (2), në lidhje me nenin 64 (1), të Kushtetutës dhe me Kreun III të Rregullores së punës që zbaton këto nene dhe në pajtim me këtë aktgjykim;

III. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

Rasti Nr. KO119/14
Parashtrues
Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

MENDIM MOSPAJTUES I GJYQTARIT ROBERT CAROLAN

Përfundimi dhe arsyetimi i shumicës, në këtë rast, është i gabuar për arsye se keqinterpreton gjuhën specifike të Kushtetutës. Po ashtu, përpiqet gabimisht të përgjigjet në pyetje që Gjykata Kushtetuese nuk ka autoritet të përgjigjet. Duke vepruar në këtë mënyrë, është arritur në përfundimet e gabuara në lidhje me faktet e rastit, me ligjin e zbatueshëm dhe me Rregulloren e punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
Përkitazi me zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, më 17 korrik 2014, parashtruesit e kërkesës i drejtojnë Gjykatës pyetjet në vijim:

a. *Nëse Kryetari i Kuvendit është propozuar nga "grupi më i madh parlamentar" sipas nenit 67.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës?*

b. *Kush ka të drejtë të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit në mbledhjen konstituive të Kuvendit? A është partia politike ose koalicioni që ka fituar më së shumti vota në zgjedhjet për Kuvendin të datës 8 qershor 2014, apo grupimi i cili është formuar gjatë regjistrimit të deputetëve?*

c. *A e ka shkelur Kushtetutën Kryetari i Kuvendit nga legjislatura e mëparshme gjatë mbledhjes përgatitore të datës 12.07.2014 për mbledhjen konstituive të Kuvendit më 17 korrik 2014?*

d. *Gjatë mbajtjes së mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës a ka pasur shkelje të Kushtetutës dhe Rregullores së punës së Kuvendit?*

Vlerësimi i pranueshmërisë

Kërkesa është parashtruar në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës. Neni 113.5 përcakton:

> *Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.*

Kushtetuta në mënyrë specifike kufizon se çfarë pyetjesh mund të kërkojnë deputetët e Kuvendit që të interpretohen nga Gjykata. Këto pyetje kufizohen qoftë lidhur me ligjet apo me vendimet e Kuvendit dhe jo lidhur me veprime të tjera në Kuvend, ose me veprimet e deputetëve ose të zyrtarëve individualë në Kuvend.

Përderisa kjo kërkesë konteston nëse vendimi i Kuvendit me të cilin u zgjodh z. Isa Mustafa Kryetar i Kuvendit përputhej me nenin 67 të Kushtetutës, ajo është e pranueshme dhe kjo Gjykatë ka autoritetin t'i përgjigjet asaj pyetjeje. Pasi kjo pjesë e kërkesës konteston një vendim të Kuvendit dhe kërkon nga kjo Gjykatë interpretimin e termit të përdorur në Kushtetutë, kjo kërkesë është e pranueshme në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës.

Çështjet e tjera të ngritura në kërkesë kontestojnë nëse Kryetari i Kuvendit ose Kryesuesja e Kuvendit kanë vepruar në përputhje me Kushtetutën në procesin procedural që përfundimisht ka rezultuar me zgjedhjen e z. Mustafa Kryetar i Kuvendit. Meqë ai aspekt i kërkesës nuk konteston një vendim të Kuvendit, por më tepër veprimet e një zyrtari të Kuvendit, parashtruesit e kërkesës nuk kanë kompetenca në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës të kërkojnë nga kjo Gjykatë që të interpretojë atë çështje. Shih, *Ardian Gjini dhe njëmbëdhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,* KO115/13, 16 dhjetor 2013. Prandaj, ajo pjesë e kërkesës është e papranueshme dhe Gjykata, në bazë të Kushtetutës, nuk ka autoritet t'i përgjigjet asaj pyetjeje.

Kërkesa gjithashtu konteston nëse veprimi i një numri të caktuar të deputetëve të Kuvendit, më 17 korrik 2014, përputhej me ligjin e zbatueshëm ose me Rregulloren e punës së Kuvendit. Për shembull, kërkesa pretendon se seanca e Kuvendit ishte shtyrë kur z. Mustafa ishte zgjedhur Kryetar i Kuvendit. Deputetët që janë përgjigjur pretendojnë se Kuvendi ishte ende në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme në seancë kur z. Mustafa ishte zgjedhur dhe se Kryesuesja e Kuvendit, në atë moment, në mënyrë të parregullt dhe të paligjshme, u përpoq ta shtyjë seancën e Kuvendit. Pasi Kushtetuta nuk e shtjellon kur dhe si mund të shtyhen seancat e Kuvendit, kjo Gjykatë nuk ka autoritet të vendosë për të dy çështje: atë faktike dhe procedurale në kontest ndërmjet palëve në këtë çështje. Për shembull, neni 50 (2) i Rregullores së punës të Kuvendit, kërkon që mocionet për ta shtyrë mbledhjen e Kuvendit duhet të miratohen nga të paktën një grup parlamentar. Mund të shtrohet pyetja se a ka vepruar Kryesuesja në përputhje me atë rregull më 17 korrik 2014. Ai kontest zgjidhet në mënyrë të rregullt, qoftë nga Kuvendi ose nga ndonjë forum i ngjashëm juridik, e jo nga Gjykata Kushtetuese. Pasi këto pretendime nuk janë kontestime kushtetuese, Gjykata nuk ka autoritet t'i përgjigjet asaj pyetjeje. Prandaj, ai aspekt i kërkesës, është gjithashtu i papranueshëm.

Vlerësimi i meritave të kërkesës

Gjatë mbledhjes konstituive të Kuvendit, më 17 korrik 2014, Kryesuesja e Kuvendit kërkoi nga partia më e madhe në Kuvend, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që të propozojë kandidatin për t'u zgjedhur Kryetar i Kuvendit. Një përfaqësues i PDK-së atëherë propozoi z. Agim Aliu për atë pozitë. Z. Aliu, megjithatë, kurrë nuk u zgjodh Kryetar i Kuvendit nga ana e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Më pas, për pozitën e Kryetarit të Kuvendit, nga një grupim i partive politike: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Vetëvendosja (VV) dhe lëvizja politike NISMA, u propozua z. Isa Mustafa. Kur u votua, z. Isa Mustafa u zgjodh duke marrë 65 vota, më shumë së shumica e nevojshme për t'u zgjedhur Kryetar i Kuvendit.

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se partia e tyre politike, me 37 deputetë në Kuvend, është "grupi më i madh parlamentar" në Kuvend, sepse partia e tyre politike ka fituar më së shumti vota popullore në zgjedhjet e 8 qershorit 2014.

Deputetët që janë përgjigjur e që përfaqësojnë një koalicion të formuar më 8 qershor 2014, që përbëhet nga 47 deputetë, pretendojnë së ata janë "grupi më i madh parlamentar" në Kuvend.

Si parashtruesit e kërkesës, ashtu edhe deputetët që janë përgjigjur, pajtohen se Kryetari i Kuvendit duhet të propozohet nga "grupi më i madh parlamentar". Ata gjithashtu pajtohen se Kryetari i Kuvendit duhet të zgjedhet me votën e shumicës së deputetëve të Kuvendit. Prandaj, çështja kushtetuese e paraqitur me këtë kërkesë, është se kush është i autorizuar të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit të ri kur të formohet. Përgjigja kushtetuese ndaj asaj pyetjeje varet nga domethënia kushtetuese e termit "grupi më i madh parlamentar" ashtu siç përdoret në nenin 67 (2) të Kushtetutës.

> Neni 67 (2) i Kushtetutës përcakton:
>
> *Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit*. (Me theks të shtuar)

Kur neni 67 (2) i Kushtetutës u miratua më 9 prill 2008, ka shumë të ngjarë që hartuesit e Kushtetutës ishin në dijeni të nenit 9.1.9 të Kornizës Kushtetuese të Kosovës, të miratuar përafërsisht tetë vjet më herët, më 15 maj 2001. Ajo, në mënyrë specifike përcakton:

> *Kryetari i Kuvendit*
>
> *9.1.9 Anëtari i Kryesisë, partia ose koalicioni i të cilit ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet për Kuvend do të jetë Kryetar i Kuvendit*. (Me theks të shtuar)

Korniza Kushtetuese qartazi përcakton se Kryetari i Kuvendit do të jetë deputet i një partie apo koalicioni që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet për Kuvend. Kur hartuesit e Kushtetutës hartuan nenin 67, ata, në veçanti, refuzuan atë dispozitë të Kornizës Kushtetuese, duke kërkuar që kandidati për Kryetar të Kuvendit të propozohet nga partia më e madhe parlamentare, e jo nga partia apo nga koalicioni që ka marrë më së shumti vota popullore në zgjedhjet e fundit. Për dallim nga Korniza Kushtetuese, e cila thjesht kishte paraparë që një deputet ose një koalicion që ka numrin më të madh të votave në zgjedhje duhet të jetë Kryetar i Kuvendit, hartuesit e Kushtetutës kërkuan që Kryetari i Kuvendit duhet gjithashtu të jetë i zgjedhur nga vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit. Për shkak se hartuesit e Kushtetutës në mënyrë specifike kundërshtuan gjuhën në Kornizën Kushtetuese dhe pasi Kushtetuta tani kërkon që kandidati i propozuar për Kryetar të Kuvendit

duhet gjithashtu të jetë i zgjedhur nga vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit, është e qartë se hartuesit e Kushtetutës kanë pasur për qëllim që "grupi më i madh parlamentar" në Kuvend nuk ishte partia apo koalicioni që ka marrë numrin më të madh të votave popullore në zgjedhjet e mëparshme, por grupi më i madh në Kuvend që do të mund të zgjedhte me sukses Kryetarin.

Çështja kushtetuese në këtë kërkesë dallon nga çështja kushtetuese e vendosur në aktgjykimin e kësaj Gjykate në kërkesën e *Presidentes së Republikës,* KO103/14, të 1 korrikut 2014. Në atë rast, Gjykata ka interpretuar një nen tjetër të Kushtetutës dhe ka interpretuar kuptimin kushtetues të termit "partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën në Kuvend". Në këtë kërkesë, kërkohet nga Gjykata të interpretojë kuptimin kushtetues të termit "grupi më i madh parlamentar", që është një term tjetër kushtetues. Për dallim nga partitë dhe nga koalicionet, grupet parlamentare nuk garojnë në zgjedhje politike, por mund të formohen pavarësisht prej zgjedhjeve nga ana e deputetëve individualë të Kuvendit. Praktika e formimit të një grupi parlamentar shpesh ndodh pas, e jo para zgjedhjeve. Për dallim nga kërkesa KO103/14, në të cilën nga kjo Gjykatë është kërkuar të interpretohet kuptimi i termit "partia ose koalicioni më i madh" në nenet 95 dhe 84 të Kushtetutës, në këtë kërkesë, kërkohet nga Gjykata që të interpretojë një term tjetër të caktuar dhe një nen tjetër të caktuar të Kushtetutës që ka të bëjë me zgjedhjen e një zyrtari tjetër të caktuar në Qeverinë e Kosovës. Nëse hartuesit e Kushtetutës kanë pasur qëllim që termi "grupi më i madh parlamentar" të ketë domethënien e njëjtë me termin "partia politike ose koalicioni", ashtu siç është përdorur në nenin 95 të Kushtetutës, ata do të mund ta përdornin atë gjuhë të njëjtë në nenin 67 të Kushtetutës. Fakti se ata nuk e kanë bërë këtë, qartazi do të thotë se ata kanë pasur për qëllim një tjetër domethënie.

Fakti se hartuesit e nenit 67 të Kushtetutës, për dallim nga Korniza Kushtetuese e mëparshme, në mënyrë të qartë kanë përcaktuar se kandidati i propozuar për Kryetar të Kuvendit duhet gjithashtu të zgjedhet nga shumica e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, në mënyrë të qartë demonstron se ata kanë pasur për qëllim që grupi në Kuvend, i cili ka pasur shansin më të mirë për zgjedhjen e një personi për t'u bërë Kryetar, grupi më i madh parlamentar, jo partia politike ose koalicioni që mund të përbëhet vetëm nga një pakicë e deputetëve të tërë Kuvendit, do të kishte të drejtë dhe obligim për të propozuar një kandidat për Kryetar. Në fakt, nëse personi i propozuar për Kryetar të Kuvendit nuk mund të fitojë votat e së paku shumicës së deputetëve të Kuvendit, Kuvendi do të detyrohej të funksiononte pa një zyrtar të tij me rëndësi thelbësore, për të kryer punët zyrtare, siç janë: caktimi i agjendës së Kuvendit, thirrja dhe kryesimi i seancave të Kuvendit dhe nënshkrimi

i akteve të miratuara nga Kuvendi. Shih nenin 67.7 të Kushtetutës. Në ato rrethana, sipas të gjitha gjasave, Qeveria do të mund të shpërbëhej, në pajtim me nenin 82 të Kushtetutës, thjesht me një votë të suksesshme të "mosbesimit". Një rezultat të tillë nuk kanë mundur ta synojnë hartuesit e nenit 67 të Kushtetutës.

Në lidhje me faktet e kësaj kërkese, është e pakontestueshme se z. Agim Aliu ishte propozuar nga ana e partisë më të madhe politike në Kuvendin e Kosovës për t'u bërë Kryetar, por zgjedhja e tij për atë post dështoi, sepse ai kurrë nuk mori votat e shumicës së (61) deputetëve të Kuvendit. Prandaj, meqë z. Isa Mustafa ishte propozuar nga grupi më i madh parlamentar në Kuvend, i cili përbëhej prej 47 deputetëve, për t'u zgjedhur Kryetar i Kuvendit, pasi kandidati tjetër nuk ishte zgjedhur nga Kuvendi dhe për shkak se ai, më 17 korrik 2014, u zgjodh nga më shumë se shumica e deputetëve të Kuvendit, vendimi i Kuvendit për të zgjedhur z. Mustafa Kryetar të Kuvendit ishte në përputhje me Kushtetutën.

Dorëzoi me respekt,
Robert Carolan
Gjyqtar

KI75/14, Tefik Dedinca, Vendim i datës 1 korrik 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së një vendimi të paspecifikuar të një autoriteti të paspecifikuar publik

Rasti KI75/14, vendimi i 1 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, heqje e kërkesës nga lista.

Pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës ishte se ai është i pafajshëm, pa shpjeguar pse apo pa iu referuar ndonjë dispozite kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese vendosi ta heqë kërkesën nga lista sepse parashtruesi e kishte dorëzuar një kërkesë të paqartë dhe të pakuptueshme dhe parashtruesi i kërkesës nuk kishte arritur të sqarojë dhe të saktësojë kërkesën e tij, përkundër kërkesës nga Gjykata për ta bërë këtë.

VENDIM PËR HEQJEN E KËRKESËS NGA LISTA
në
Rastin Nr. KI75/14
Parashtrues
Tefik Dedinca
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së një vendimi të paspecifikuar të një autoriteti të paspecifikuar publik

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Tefik Dedinca, shtetas i Republikës së Shqipërisë, i cili është duke e vuajtur dënimin në burgun e Dubravës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk e konteston asnjë vendim të autoritetit publik.

Objekti i çështjes

3. Kërkesa nuk ka objekt të çështjes dhe është e palexueshme dhe e paqartë.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 22 prill 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI75/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI75/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 27 maj 2014, parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar për regjistrimin e kërkesës dhe atij i ishte kërkuar që ta plotësojë dhe ta qartësojë kërkesën e tij.

8. Më 3 qershor 2014, parashtruesit të kërkesës i ishte kërkuar prapë që ta plotësojë dhe ta qartësojë kërkesën e tij.

9. Më 6 dhe 16 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës u përgjigj, duke dorëzuar në Gjykatë formularin e kërkesës.

10. Më 1 korrik 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga kërkesa mund të konstatohet se parashtruesi i kërkesës është shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe se tani ai është duke vuajtur dënimin në burgun e Dubravës.

12. Më 6 dhe 16 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës ishte përgjigjur duke dorëzuar një formular të kërkesës, i cili në pjesën më të madhe është i palexueshëm dhe i pakuptueshëm dhe nuk ia bashkëngjiti asaj dokumentet relevante.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Për arsye se kërkesa është e palexueshme dhe e paqartë, është e pamundur të kuptohen pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë.

14. Pak fjali që mund të lexohen në kërkesë janë: *"Jam i pafajshëm deri në vdekje ... torturë fizike dhe mendore..."*.

Pranueshmëria e kërkesës

15. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

17. Gjykata i referohet rregullit 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(...)*
>
> *(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe: (a) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën; (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka; (c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor, nëse ka; (d) emrin dhe adresën e palës, ose të palëve kundërshtare, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe (h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës*
>
> *(3) Kërkesës i bashkëngjiten kopjet e çfarëdo dokumenti relevant për të mbështetur atë. Nëse vetëm disa pjesë të dokumentit janë të rëndësishme, atëherë, sipas nevojës, duhet të bashkëngjiten vetëm pjesët e tilla"*.

18. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest"*.

19. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar një kërkesë të palexueshme, të paqartë dhe të pakuptueshme dhe për më tepër, ai nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim që ta sqarojë dhe ta saktësojë kërkesën e tij, përkundër kërkesës nga Gjykata për ta bërë këtë.

20. Përveç kësaj, parashtruesit të kërkesës i është dërguar një shkresë, duke e paralajmëruar se nëse ai nuk i siguron informatat dhe dokumentet përkatëse, Gjykata këtë do ta kuptojë se ai nuk është më i interesuar për procedim të mëtejmë të kërkesës së tij. Gjykata vëren më tej se parashtruesi i kërkesës paraqiti vetëm një formular, kryesisht të palexueshëm dhe të pakuptueshëm të kërkesës, pa ia bashkëngjitur asnjë dokumentacion relevant.

21. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se "kërkesa" e lartpërmendur nuk e kalon pragun minimal që të konsiderohet si kërkesë. Për më tepër, Gjykata më tej konsideron se është legjitime të supozohet se parashtruesi nuk është më i interesuar për procedim të mëtejmë të kërkesës së tij (shih rastin KI143/13, Parashtruesi i kërkesës *Nebih Sejdiu,* Vendimi për heqjen e kërkesës nga lista, i 24 prillit 2014, gjithashtu *mutatis mutandis* shih rastin *Starodub kundër Ukrainës,* Nr. 5483/02, GJEDNJ, Vendimi i 7 qershorit 2005).

22. Gjykata konsideron se kjo kërkesë nuk paraqet rast apo kontest dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 32 (4) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, më 1 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA HEQË kërkesën nga lista;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI47/14, Mustaf Zejnullahu, Aktvendim i datës 26 qershor 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 89/2013, të 8 tetorit 2013

Rasti KI47/14, vendimi i 26 qershorit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. nr. 89/2013 të 8 tetorit 2013 e refuzoi pretendimin e parashtruesit për pronësi mbi ngastrën kontestuese kadastrale në Komunën e Ferizajt.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se gjykatat e rregullta në Kosovë kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar sepse kërkesa nuk arriti të dëshmojë se gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo në mënyrë të padrejtë. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta janë të arsyetuara mirë, sepse ato adresojnë pretendimet kryesore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI47/14
Parashtrues
Mustaf Zejnullahu
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 89/2013, të 8 tetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Mustaf Zejnullahu nga Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 89/2013, të 8 tetorit 2013, i cili i ishte dorëzuar më 15 nëntor 2013, lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 361/2011, të 13 nëntorit 2011, dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 305/02, të 19 janarit 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të gjykatave të rregullta të Kosovës, të cilat pretendohet *"t'i kenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën për mbrojtje të pronës së tij"*.

4. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 14 mars 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 1 prill 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI47/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI47/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 8 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës i është dorëzuar Gjykatës Supreme të Kosovës.

9. Më 26 qershor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 12 shtator 2008, Komuna e Ferizajt kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Ferizaj, në mënyrë që ta detyrojë parashtruesin e kërkesës që ta lirojë dhe t'ia kthejë Komunës së Ferizajt në posedim paluajtshmërinë në vendin e quajtur "Saraishte".

11. Më 19 janar 2011, Gjykata Komunale në Ferizaj, me Aktgjykimin C. nr. 305/02: i) e aprovoi padinë e Komunës së Ferizajt si të bazuar në ligj, ii) vërtetoi se parashtruesi i kërkesës në mënyrë të kundërligjshme dhe pa bazë ligjore është duke e ushtruar posedimin faktik të paluajtshmërisë (ngastra kadastrale nr. 486/4), pronë e Komunës së Ferizajt, iii) e obligoi parashtruesin e kërkesës që t'ia kthejë në posedim Komunës së Ferizajt

paluajtshmërinë e përmendur, dhe iv) e refuzoi në tërësi kundërpadinë e parashtruesit të kërkesës, në të cilën pretendonte se ai e kishte fituar posedimin mbi paluajtshmërinë, në bazë të parashkrimit ose të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm të paluajtshmërisë si kërkesë alternative.

12. Më 13 nëntor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 361/201, vendosi si në vijim:

> *"REFUZOHET ankesa e të padituve- kundërpaditësve NT "MODA" në Ferizaj me pronarë Mustafë Zejnullahu, nga Ferizaji, si e PATHEMELTË, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 305/02 i dt. 19.01.2011, VËRTETOHET".*

13. Më 8 tetor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 89/2013, përcaktoi:

> *"REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës-kundërpaditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AC. nr. 36 1/2011 datë 13. 11 .2012".*

14. Në aktgjykimin e lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës arsyetoi më tej:

> *Nga shkresat e lëndës del se paditësja-kundërpaditura me padi kërkon dorëzimin të paluajtshmërive të regjistruara si ngastër kadastrale 486/4 dhe 586/1 e që këto paluajtshmëri në vitin 1983 i janë dhënë në shfrytëzim organizatës Kontraktuese "Univerzal" (në tekstin e mëtejmë: OK "Univerzal") në Ferizaj për ushtrimin e veprimtarisë së konfeksionit, ndërsa në periudhën prej vitit 1990 gjer në hyrjen e forcave të NATO-s në Kosovë, këto janë shfrytëzuar nga regjimi serb për vendosjen e refugjateve serb. Pas mbarimit të luftës në Kosovë, i padituri Mustafë Zejnullahu ka hyrë në posedim të kësaj paluajtshmërie. Pronari i paditurës- kundërpaditëses Mustafë Zejnullahu pretendon se këto paluajtshmëri i ka marrë në shfrytëzim me kompensim dhe në bazë të parashkrimit fitues ka filluar të drejtën e pronësisë në këto paluajtshmëri.*
> *Duke marrë parasysh këtë gjendje të vërtetuar faktike gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë aprovuar kërkesëpadinë e paditëses-kundërpaditurës dhe kanë refuzuar kërkesën nga kundërpadia e të paditurës-kundërpaditëses. Kjo nga arsyeja se të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm në këto ngastra kontestuese nga ana e të ushtrimit të veprimtarisë të ndërmarrjes kontraktuese*

në fjalë.

Në periudhën prej 1990 gjer në përfundim të luftës në Kosovë, është shfrytëzuar nga regjimi serb për vendosjen e refugjatëve serb dhe pas mbarimit të luftës ne posedim të saj ka hyrë pronari i paditurës-kundërpaditëses Mustafë Zejnullahu, në të cilën ushtron veprimtarinë e NT "Moda". Kjo paluajtshmëri në evidencën kadastrale evidencohet si pronësi shoqërore në emër të paditësit. Në bazë të nenit 20 të Ligjit Themelor mbi marrëdhëniet pronësore-juridike është përcaktuar se baza për përfitimin e pronësise është ligji, puna juridike dhe trashëgimia. Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, e paditura-kundërpaditësja nuk kanë asnjë nga këto baza të fitimit të pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese.

Paluajtshmëria kontestuese është dhënë në shfrytëzim të përhershëm NK "Univerzal" e jo NT "Moda", prandaj eshtë vlerësimi i drejtë i gjykatave të instancës me të ultë se nuk ka kontinuitet juridik në mes të NK "Univerzal" dhe NT "Moda" dhe se kjo e fundit është subjekt i ri juridik.

Janë të pabazuara thëniet e revizionit të paditurës-kundërpaditëses se paditësja të gjitha ndryshimet qe i ka bërë ne kadastër sa i përket paluajtshmërive kontestuese i ka bërë në bazë të Bordit të drejtorëve dhe të njëjtin Gjykata Supreme e Kosovës e ka anuluar, nuk ka ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike, nga arsyeja se tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nga pronësia shoqërore bëhet me ankand publik dhe në bazë të nenit 9 të Ligjit mbi qarkullimin c paluajtshmërive të Kosovës ("Fletorja Zyrtare KSAK 45/81,29/86 dhe 28/88) është përcaktuar se kontrata mbi tjetërsimin e paluajtshmërisë kontestuese nga pronësia shoqërore kundër dispozitës në fjalë është nule. Te e paditura-kunderpaditësja në asnjë bazë juridike nuk është bartë e drejta e pasurisë në paluajtshmërinë kontestuese por e drejta e shfrytëzimit dhe atë në NK "Univerzal" e cila si subjekt juridik nuk ekziston më.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur parimin e barazisë së armëve, se procedurat janë vonuar, dhe se pretendimet e tij kryesore nuk janë marrë parasysh.

16. Parashtruesi i kërkesës i ka bashkëngjitur edhe këto vendime: Vendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut, St. nr. 1/88, të 24 dhjetorit 1991, Vendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut, SA. nr. 1/88, të 29 shtatorit 1988, Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pr. nr. 414/88, të 29 korrikut 1988, Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pr. nr. 571/89, të 7 qershorit 1989, Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 251/2002, të 16 dhjetorit 2004, Aktgjykimin A. nr. 1336/89 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 15 marsit 1990, Vendimin 01. nr. 463-22 të Komunës së Ferizajt, të 28 shtatorit 1983, Vendimin 04. nr. 464-12/84 të Komunës së Ferizajt, të 21 dhjetorit 1984, Vendimin 05 nr. 351-436-83 të Komunës së Ferizajt, të 26 dhjetorit 1984.

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta në Kosovë kanë shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa), dhe nenin 7 (Barazia para ligjit), nenin 10 (E drejta për gjykim të drejtë) dhe 17 (Mbrojtja e pronës) të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

20. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse*

kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".

21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe ka paraqitur kërkesën brenda afateve ligjore të përcaktuara me nenin 49 të Ligjit.

22. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
...

(c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".

23. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë dhënë: i) shpjegime koherente në lidhje me vazhdimësinë juridike të personave juridikë, ii) bazën ligjore për fitimin e pronës, dhe iii) u janë përgjigjur çështjeve kyçe të çështjes juridike, të cilat pretendimet e parashtruesit të kërkesës i bëjnë të pabazuara.

24. Për më tepër, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit lidhur me shkeljen e barazisë së armëve dhe vonesës së procedurave janë ngritur nga ai për herë të parë në këtë gjykatë dhe jo në gjykatat e rregullta. Për më tepër, Gjykata konsideron se një periudhë kohore prej 3 (tri) vjetësh për zhvillimin dhe përfundimin e procedurave gjyqësore në tri shkallë të gjykatave të rregullta kompetente nuk i bën ato të tepruara dhe si të tilla ato nuk çojnë në shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës.

25. Sa u përket vendimeve të tjera të bashkëngjitura nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se ato ishin nxjerrë sipas një sistemi të ndryshëm juridik, në rrethana të ndryshme dhe në një kohë kur Gjykata nuk kishte juridiksion kohor dhe si të tilla janë *ratione temporis* në papajtueshmëri me Kushtetutën, e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008.

26. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve, dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "*gjykatë e shkallës së katërt*" (shih, *Akdivar kundër*

Turqisë, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, gjithashtu *mutatis mutandis* shih, rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

27. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo në mënyrë të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me ato të gjykatave të rregullta, dhe si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë provat para vetes. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato prova (shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

28. Fakti se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë në vetvete një pretendim të argumentueshëm për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës (shih rastin *MezoturTiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

29. Në këto rrethana, parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë se gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

30. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 26 qershor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI40/14, Valon Haskaj, Aktvendim i datës 26 qershor 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, KZZ. nr. 187/2013, të 8 nëntorit 2013

Rasti KI40/14, vendim i 26 qershorit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në rastet penale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, qartazi e pabazuar.

Me Aktgjykimin të Gjykatës Supreme të 8 nëntorit 2013 ishte vendosur të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe t'i shqiptohet parashtruesit të kërkesës një dënim më i rëndë me burgim.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimet e Gjykatës Supreme i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e te Drejtave] te Kushtetutës, dhe me nenin 8 [E Drejta ne Mjete Efektive], me nenin 10 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe Publik] të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, si dhe me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Parashtruesi i kërkesës nuk shpjegon si dhe pse ishin shkelur nenet e lartcekura me aktgjykimet e Gjykatës Supreme. Ai më tutje pretendon shkelje të dispozitave të ligjit penal.

Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e Gjykatës Supreme, në përgjigjen ndaj të gjitha pretendimeve të bëra nga parashtruesi i kërkesës, është i qartë dhe i arsyetuar mirë, për me tepër, arsyetimi i dhënë mbulon pretendimet e bëra nga parashtruesi i kërkesës në bazë të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar sepse faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese, në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës dhe ai nuk ka dëshmuar në mënyrë te mjaftueshme pretendimin e tij.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI40/14
Parashtrues
Valon Haskaj
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, KZZ. nr. 187/2013, të 8 nëntorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Valon Haskaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili është duke e vuajtur dënimin në burgun e Dubravës, në afërsi të Istogut. Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga z. Živojin Jokanović, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston aktgjykimin e Gjykatës Supreme, KZZ. nr. 187/2013, të 8 nëntorit 2013. Parashtruesi i kërkesës nuk kishte sqaruar se kur i ishte dorëzuar atij Aktgjykimi i fundit i Gjykatës Supreme (KZZ. nr. 187/2013, i 8 nëntorit 2013).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme, KZZ. nr. 187/2013, të 8 nëntorit 2013. Me Aktgjykimin Kz. nr. 328/2012, të 17 tetorit 2012, Gjykata Supreme vendosi ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe të shqiptojë një dënim më të rëndë me burg, ndërsa me Aktgjykimin KZZ. nr. 187/2013, të 8 nëntorit 2013, Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 mars 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 1 prill 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI40/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI40/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues) Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 25 prill 2014, Gjykata e informoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 14 maj 2014, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën Supreme.

9. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor - korrik 2014, derisa Gjykata të vendos përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.

10. Më 26 qershor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë (Kt. nr. 154-1/2011, të 7 qershorit 2011), parashtruesi i kërkesës është akuzuar për kryerjen e veprave penale vijuese: rrëmbim, detyrim dhe mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve.

12. Më 24 shkurt 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi K. nr. 313/2011), shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor dhe e dënoi atë me burgim unik prej 7 (shtatë) vjetësh.

13. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, Prokurori Publik i Qarkut dhe parashtruesi i kërkesës ushtruan ankesë në Gjykatën Supreme. Prokurori publik i Qarkut i propozoi Gjykatës Supreme ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe parashtruesit t'i shqiptohet dënim më i rëndë. Nga ana tjetër, në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK) dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

14. Më 17 tetor 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Kz. nr. 328/2012) miratoi ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut dhe e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

15. Gjykata Supreme, me aktgjykimin e lartcekur vendosi më tej që të ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe e dënoi parashtruesin e kërkesës me dënim unik të burgimit në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vjetësh.

16. Gjykata Supreme arsyetoi vendimin e saj për miratimin e ankesës së prokurorit të Qarkut si në vijim:

> *"[...] kjo gjykatë gjen që janë të bazuara pretendimet ankimore të Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë, që dënimet e dhëna për të akuzuarit janë tepër të buta. Me individualizimin e dënimit ndaj kryesit të caktuar të veprës, përmes procesit të peshimit të dënimit, pesha e veprës penale relativizohet, si dhe në këtë rast duhet marrë parasysh që me lartësinë e dënimit të arrihet qëllimi i dënimit, i cili sipas udhëzimeve ligjore duhet të jetë shprehje e baraspeshës mes kërkimit që të akuzuarit t'i mundësohet risocializimi përmes edukimit, si dhe kërkimit të publikut që dënimi i tillë, me peshën e saj, të ketë karakter të përgjithshëm parandalues, përmbajtjes nga kryerja e veprave penale.*

17. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkeljen e dispozitave të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK), dhe shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale. Në kërkesën e tij, parashtruesi i propozoi Gjykatës Supreme që ta

ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe të shqiptojë një dënim më të butë.

18. Më 29 tetor 2013, Prokurori i Shtetit, në pajtim me parashtresën KMPL. II Nr. 134/2013, propozoi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohej si e pabazuar.

19. Më 8 nëntor 2013, Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe të përgjigjes së Prokurorit të Shtetit, me Aktgjykimin e saj, KZZ. nr. 187/2013, vendosi ta refuzojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimet e Gjykatës Supreme i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, dhe me nenin 8 [E Drejta në Mjete Efektive], me nenin 10 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe Publik] të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ), si dhe me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ). Parashtruesi i kërkesës nuk shpjegon si dhe pse ishin shkelur nenet e lartcekura me aktgjykimet e Gjykatës Supreme. Ai më tutje pretendon shkelje të dispozitave të ligjit penal.

21. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës si në vijim:

> *"Thelbi i kërkesës është që të vlerësohet kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e aktgjykimeve të përmendura, e sidomos aktgjykimit përfundimtar të Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin është ndryshuar edhe aktgjykimi i shkallës së parë në pjesën e tij të vendimit, si dhe janë përforcuar dënimet. Me këtë kërkesë kërkohet që ajo gjykatë të vërtetojë që në rastin konkret ka ndodhur një shkelje e rëndë e të drejtës kushtetuese, si dhe instrumenteve ndërkombëtare, zbatimin e drejtpërdrejtë të të cilëve e parasheh edhe vetë Kushtetuta e Kosovës, shkelje të ligjit penal në fuqi në kohën e kryerjes së veprës së pretenduar, në dëm të të gjykuarit.*
> *Prandaj kërkojmë që Gjykata Kushtetuese të anulojë aktgjykimet e kontestuara dhe të urdhërojë rigjykimin, si dhe*

të pezullojë ekzekutimin e tyre deri në vendimin e gjykatave të rregullta.
Në këtë kërkesë nuk është përfshirë vepra penale në lidhje me posedimin dhe pronësinë e armës sipas nenit 328, sepse ajo vepër është amnistuar".

Pranueshmëria e kërkesës

22. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

24. Përveç kësaj, neni 49. i Ligjit parasheh se: *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor*".

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit. Gjykata gjithashtu vëren se vendimi i kontestuar ishte marrë më 8 nëntor 2013, dhe se parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 4 mars 2014.

26. Sidoqoftë, Gjykata i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".

(2) "Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.

[...], ose

(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

27. Parashtruesi i kërkesës, siç u tha më lart, i kontestoi aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë në Gjykatën Supreme për shkelje të ligjit penal dhe shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale.

28. Në kërkesën e tij në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se aktgjykimet e Gjykatës Supreme i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, dhe me nenin 8 [E drejta për mjete efektive] dhe me nenin 10 [E drejta për gjykim të drejtë dhe publik] të DUDNJ-së, si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, si dhe dispozitat e KPK-së dhe KPPK-së.

29. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk shpjegon si dhe pse të drejtat e lartcekura të garantuara me Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare ishin shkelur me aktgjykimet e Gjykatës Supreme.

30. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës i konteston aktgjykimet e Gjykatës Supreme duke iu referuar dispozitave të Kodit Penal të Kosovës dhe duke përfunduar si në vijim:

"[...] assesi nuk mëton të kontestojë autorizimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, që në të gjitha rastet e zbatimit të ligjit të paraqesë kuptimet e veta, interpretimet juridike e të tjera, por në këtë rast, me të vërtetë, gjykata ndoshta është kapluar nga rëndësia e vlerës së mbrojtur, por gjithsesi me një dënim tejet të rreptë dhe kualifikimi i tillë është larguar nga zbatimi strikt i ligjit".

31. Prandaj, Gjykata gjen se çështja e ngritur nga parashtruesi i kërkesës, është çështje e ligjshmërisë, jo e kushtetushmërisë.

32. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

33. Gjykata Kushtetuese më tej thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, rasti *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, të parashtruesve të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011). Fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e tij, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte pasur mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tij në gjykatat e rregullta.

34. Për më tepër, siç u tha më lart, Gjykata vëren se arsyetimi në Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti se procedurat në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe në Gjykatën Supreme nuk kishin qenë të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

35. Për më tepër, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e Gjykatës Supreme, në përgjigjen ndaj të gjitha pretendimeve të bëra nga parashtruesi i kërkesës, është i qartë dhe i arsyetuar mirë. Për më tepër, arsyetimi i dhënë mbulon pretendimet e bëra nga parashtruesi i kërkesës në bazë të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale.

36. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese, në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës dhe ai nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

37. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me rregullin 36 (2) b) e (d), dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 26 qershor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI95/14, N.P.P. Adriatik Commerce, Aktvendim i datës 3 korrik 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 30/2013, të 9 dhjetorit 2013

Rasti KI 95/14, vendimi i 3 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale (person juridikë), kontest civil, e drejta për gjykim të drejtë, kërkesë qartazi e pabazuar.

Në këtë rast, parashtruesi pretendonte se Gjykata Supreme shkeli të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, për shkak se nuk e ftoi të autorizuarin e saj që të merrte pjesë në seancën shqyrtuese, me rastin e shqyrtimit të mjetit të jashtëzakonshëm juridik (revizionit). Po ashtu, pohon se, as nga Gjykata e Apelit nuk ishte ftuar që të merrte pjesë në seancën shqyrtuese, me rastin e shqyrtimit të ankesës së ushtruar kundër aktgjykimit të gjykatës së instancës së parë, në mënyrë që t'i mundësohej komentimi i fakteve dhe provave të ngritura në këtë çështje civile. Me këtë fakt, parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur parimi i barazisë së armëve në procedurë, para atyre gjykatave.

Gjykata pas vlerësimit në tërësi të rastit, gjeti se pretendimet e parashtruesit për shkeljet të së drejtës për gjykim të drejtë nga Gjykata Supreme nuk ishin të bazuara, sepse parashtruesi nuk kishte argumentuar si dhe pse Gjykata Supreme, shkeli të drejtën e tij për gjykim të drejtë. Sa i përket pretendimit të parashtruesit se rasti i tij ishte i ngjashëm me aktgjykimin nr. KI108/10 të kësaj Gjykate, Gjykata konsideroi se rrethanat faktike dhe ato procedurale të rastit të parashtruesit dukshëm ndryshonin nga rasti në të cilin ishte thirrur parashtruesi.

Gjykata, në këtë rast, nuk konsideroj se procedurat e zhvilluara në Gjykatën Supreme, vendimi i së cilës kontestohej, ishin të njëanshme ose në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Në këtë kontekst Gjykata mutatis mutandis iu referua rastit Shub vs. Lithuania, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009.

Si përmbledhje, Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesit, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, ishte qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI95/14
Parashtrues
N.P.P. "Adriatik - Commerce"
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
E. Rev. nr. 30/2013, të 9 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është N.P.P. "Adriatik - Commerce", me seli në fshatin Velekincë, komuna e Gjilanit, e cila përfaqësohet nga z. Muhamet Shala, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 30/2013, të 9 dhjetorit 2013, të cilin pohon se e ka pranuar më 3 shkurt 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 30/2013, të 9 dhjetorit 2013, me të cilin parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat kushtetuese, të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] si dhe me nenin 6.1 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Baza juridike e kësaj kërkese është neni 113.7, dhe neni 21.4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 20 dhe neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 26 maj 2014, parashtruesi parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI95/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI95/14, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Prof. dr. Enver Hasani (anëtar).

7. Më 10 qershor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën, për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor - korrik 2014, derisa Gjykata të vendos, përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.

9. Më 3 korrik 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi ishte në marrëdhënie detyrimore me kompaninë e sigurimeve “Siguria” në Prishtinë (polica e sigurimit 1500047, me nr. serik 00059, 5 janar 2007), për sigurimin e pronës nga zjarri dhe nga rreziqet e tjera.

11. Më 10 qershor 2007, prona e parashtruesit, Fabrika e sfungjerëve, u përfshi nga zjarri, duke shkaktuar dëme materiale në dy nga pesë sektorët e kësaj fabrike.

12. Më 4 janar 2008, parashtruesi iu drejtua kompanisë së sigurimeve "Siguria", me një kërkesë, në formë të shkruar, për kompensimin e dëmit që i është shkaktuar nga zjarri. Kërkesa e parashtruesit për zhdëmtimin e dëmit material është bërë në bazë të policës së sigurimeve nr. 1500047, me nr. serik 00059, të 5 janarit 2007. Mirëpo, sipas pohimeve të të autorizuarit të parashtruesit, kompania e sigurimeve "Siguria" nuk e përmbushi obligimin e saj për kompensimin e dëmit.

13. Më 4 shkurt 2008, parashtruesi ushtroi kërkesëpadi në Gjykatën Komunale të Gjilanit, por gjykata e kishte shpallur veten jokompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia kishte dërguar Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

14. Më 19 nëntor 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin II. C. nr. 127/2008, e refuzoi, si të pabazuar, kërkesëpadinë e parashtruesit, me të cilën kishte kërkuar zhdëmtimin e dëmit material, duke kërkuar edhe aplikimin e kamatës ligjore, nga dita e parashtrimit të kërkesëpadisë, deri në pagesën definitive të vlerës së dëmit të shkaktuar.

15. Parashtruesi, kundër aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material.

16. Më 8 maj 2013, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin Ac. nr. 85 /2012, duke refuzuar, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike në Prishtinë, II. C. nr. 127/2008, të 19 nëntorit 2009.

17. Për më tepër, arsyetimi i refuzimit të kërkesëpadisë së parashtruesit nga Gjykata e Apelit:

> *"Për faktin se me asnjë prove nuk është vërtetuar se çka e shkaktoi zjarrin në lokalet afariste të paditësit nuk është krijuar baza juridike për shpërblimin e dëmit material e as për fitimin e humbur. Paditësi ka qenë i obliguar qe, pas shpërthimit të zjarrit të bëjë sigurimin e provave, përmes gjykatës kompetente, me angazhimin e ekspertit përkatës ashtu qe në bazë të atyre provave, të vërtetohet me pa mëdyshje gjendja faktike. Paditësja as në procedurën e shkallës së parë, e as në procedurën ankimore nuk ka ofruar prova më të cilat do të kishte provuar bazueshmërinë e kërkesëpadisë.*

Sipas dispozitës së nenit 221 të LPK-së, është parapare se, nëse gjykata në bazë të provave të administruara nuk mund të vërtetoi me siguri ndonjë fakt, ajo do të konkludoi me zbatimin e rregullave të barrës së të provuarit, e në rastin konkret barrën e provave për bazueshmërinë e padisë e ka paditësi".

18. Parashtruesi, kundër Aktgjykimit Ac. nr. 85 /2012 të Gjykatës së Apelit, paraqiti revizion në Gjykatën Supreme, duke kërkuar sërish zhdëmtimin e dëmit material dhe kompensimin e fitimit të humbur, të shkaktuar nga shpërthimi i zjarrit në fabrikën e sfungjerëve.

19. Më 9 dhjetor 2013, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin E. Rev. nr. 30/2013, me të cilin refuzoi në tërësi revizionin e ushtruar nga parashtruesi i kërkesës.

20. Për më tepër, Gjykata Supreme refuzimin e revizionit e arsyeton si më poshtë:

"Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejtë kur ka gjetur se ankesa e paditësit është e pabazuar, kur e ka refuzuar si te tillë dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Në aktgjykimin e cekur ajo ka dhëne arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykate.

Thëniet e cekura në revizion se gjykata ka bërë shkelje te dispozitave të procedurës kontestimore meqë diapozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin dhe kontradiktor, se nuk janë zbatuar rregullat juridiko-civile dhe nuk është bërë vërtetimi i drejtë i argumenteve dhe provave relevante, të cilat kanë ndikuar qe gjykata të bie një aktgjykim pa bazë dhe pa mbështetje ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës, i vlerësoi si të pabazuara, ngase, ne revizion nuk është cekur se ne cilën pjese të aktgjykimit pretendohet se dispozitivi është ne kundërshtim me arsyetimin, ndërsa lidhur me vlerësimin e provave Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e instancës me të ulët në mënyrë të drejtë kanë vlerësuar faktin se deri te zjarri nuk ka ardhur nga poçi elektrik, siç pretendon paditësi, të cilin konstatim e ka dhënë eksperti i elektroteknikes M.V., i cili ka përjashtuar mundësinë se shkaktar i zjarrit ka qene nxehtësia e lejuar prej poçit elektrik, i cili mendimin e vet e ka mbështetur edhe në bazë te eksperimentit të dëshmuar.

Faktin e cekur në revizion se gjykata nuk ka marre për bazë raportin e Drejtorisë për Siguri Publike dhe Emergjence-Sektori i Preventives dhe Zbulimeve të Zjarrit, të cilët kanë konstatuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me element te qëllimshëm, duke përjashtuar faktorin njeri, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi, por e njëjta nuk ka pasur ndikim për të vendosur ndryshe, ngase, nuk është vërtetuar se çka ka qene shkaktar i zjarrit në lokalet afariste të paditësit, ndërsa në bazë të nenit 319 par. 1 të LPK, secila pale ndërgjyqëse ka për detyre të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, ndërsa sipas par. 2 të nenit të cekur është paraparë se të provuarit përfshijnë të gjitha faktet qe janë me rendësi për dhënien e vendimit. Zjarri ka ndodhur me date 10.6.2007, ndërsa padia ne Gjykatën Komunale ne Gjilan, është paraqitur me 22.2.2008, ndërsa Gjykata Ekonomike e Qarkut padinë e ka pranuar me 11.04.2008, andaj, sigurimi i provave ka qene i nevojshëm, ngase me nenin 379 te LPK është parapare një mundësi e tille në rastet kur sigurimi i provës ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet marrja e saj, e te cilën mundësi paditësi nuk e ka shfrytëzuar, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se qëndrimi juridik i gjykatave të instancës me te ulet, se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar është i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj edhe pretendimet e revizionit se e drejta materiale është zbatuar ne mënyrë te gabuar është vlerësuar si i pabazuar".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme shkeli të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, për shkak se nuk e ftoi të autorizuarin e saj që të merrte pjesë në seancën shqyrtuese, me rastin e shqyrtimit të mjetit të jashtëzakonshëm juridik (revizionit). Po ashtu, pohon se, as nga Gjykata e Apelit nuk ishte ftuar që të merrte pjesë në seancën shqyrtuese, me rastin e shqyrtimit të ankesës së ushtruar kundër aktgjykimit të gjykatës së instancës së parë, në mënyrë që t'i mundësohej komentimi i fakteve dhe provave të ngritura në këtë çështje civile. Me këtë fakt, parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur parimi i barazisë së armëve në procedurë, para atyre gjykatave.

22. Parashtruesi pretendon se Gjykata mund ta aplikojë aktgjykimin e saj, në rastin KI108/10, *Fadil Selmanaj*, të 6 tetorit 2011.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës së Gjykatës.

24. Në rastin konkret, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, që parasheh: "*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

25. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) c) dhe 36 (2) d) i Rregullores së punës parasheh:

36 (1) "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.

36 (2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...]

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

26. Parashtruesi në këtë rast pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 30/2013, i 9 dhjetorit 2013, shkel të drejtën e tij kushtetuese të garantuar me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] si dhe me nenin 6.1 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.

27. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Gjykata konsideron se parashtruesi në aspektin kushtetues nuk argumenton me prova,

si dhe pse, që Gjykata Supreme ia cenoi këtë dispozitë konkrete të Kushtetutës.

28. Gjykata Supreme, në mënyrë të gjerësishme ka arsyetuar vendimin e saj, duke iu përgjigjur ankesës së parashtruesit në të gjitha çështjet që janë ngritur para saj (shih arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 30/2013, në paragrafin 17, të këtij dokumenti).

29. Sa i përket pretendimit të parashtruesit se rasti konkret është i ngjashëm me aktgjykimin e vet, në rastin KI108/10, Gjykata konsideron se rrethanat faktike dhe ato procedurale të rastit të parashtruesit dukshëm ndryshojnë nga rasti në të cilin thirret parashtruesi. Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një çështje civile, e cila është zgjidhur nga Gjykata Ekonomike e Qarkut. Kjo e fundit i ka ftuar palët ndërgjyqëse që t'i ofrojnë provat e tyre, gjatë shqyrtimit kryesor të çështjes dhe i ka dëgjuar ato. Mirëpo, parashtruesi, duke mos qenë i kënaqur me rezultatin e vendimit, shfrytëzoi mjetin e rregullt juridik, të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit, e cila vërtetoi në tërësi vendimin e gjykatës së instancës së parë. Parashtruesi, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, shfrytëzon edhe mjetin e jashtëzakonshëm juridik (revizionin), por që edhe Gjykata Supreme ia refuzoi kërkesëpadinë me revizion.

30. Në aktgjykimin e saj, KI108/10, parashtruesi i kërkesës ishte palë, sipas procedurës administrative dhe e kishte fituar rastin në KPMK. Komuna e Mitrovicës kishte iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Supreme, kjo e fundit kishte vendosur në favor të Komunës së Mitrovicës, duke e ndryshuar Vendimin Nr. 02 (285) 2008, të KPMK-së, pa e njoftuar palën e interesuar, e cila është afektuar direkt me vendimin e Gjykatës Supreme.

31. Për më tepër, një paragraf i shkëputur nga aktgjykimi i saj, në rastin KI108/10: *"Në të vërtetë, komuna e Mitrovicës ngriti padi në Gjykatën Supreme, në rastin në të cilin parashtruesi tashme ishte palë. Prandaj, parashtruesi nuk mund të mos këtë fare dijeni për atë padi, kryesisht për shkak se padia ndikon shumë në përcaktimin e të drejtave të tij civile. Ky konkluzion konfirmohet në nenin 16 të Ligjit mbi konfliktet administrative, i cili thotë qe, "personi i tretë, të cilit, anulimi i aktit administrativ te kontestuar, do t'i sjelltë dëm direkt (personi i interesuar) ka në kontest pozitën e palës"*.

32. Siç mund të vërehet, kemi të bëjmë me raste në rrethana tërësisht të ndryshme faktike dhe procedurale. Parashtruesi, që nga fillimi

deri në fund e kishte cilësinë e palës paditëse, në procedurë të rregullt, ndërsa kompania e sigurimeve "Siguria", cilësinë e palës së paditur. Prandaj, pretendimet e parashtruesit se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme morën vendime duke ia mohuar parashtruesit mundësinë e komentimit të fakteve dhe provave, të bashkëngjitura në ankesë dhe revizion, nuk mund të konsiderohet si shkelje e së drejtës për gjykim të drejtë dhe barazisë së armëve, përderisa parashtruesit i janë dhënë të gjitha mundësitë e kontestimit të përgjigjeve në ankesë, të ushtruara nga pala e paditur, kompania e sigurimeve "Siguria".

33. Për më tepër, Gjykata, në rastin konkret, nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me aktgjykimin e nxjerrë nga Gjykata Supreme. Është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, § 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

34. Gjykata, në rastin konkret, nuk mund të konsideroj që, procedurat në Gjykatën Supreme, vendimi i së cilës kontestohet, kanë qenë të njëanshme ose në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis, Shub vs. Lithuania,* Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

35. Prandaj, Gjykata gjeti se, parashtruesi, as nuk e ka mbështetur dhe as nuk e ka dëshmuar pretendimin e tij për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

36. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë logjike dhe praktike për shqyrtim të mëtejmë të shkeljeve të tjera të pretenduara, të cilat janë të përmbledhura dhe të përfshira në pretendimin për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

37. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d), si dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores, më 3 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI67/14, Muharrem Sopa, Aktvendim i datës 1 korrik 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 59/2013, të 23 tetorit 2013

Rasti KI67/14, vendimi i 1 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se aktgjykimi i Gjykatës Supreme ia ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], duke theksuar se kjo e drejtë mbrohet edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Parashtruesi ka kërkuar që Gjykata t'i anulojë të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta dhe ta aprovojë si të bazuar kërkesën e tij.

Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e së drejtës kushtetuese për gjykim të drejtë e të paanshëm, andaj nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar dhe në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika b, prandaj ajo gjeti se kërkesën duhet ta refuzojë si qartazi të pabazuar dhe ta deklarojë të papranueshme.

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe të rregullit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 1 korrik 2014, njëzëri deklaron kërkesën të papranueshme dhe si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI67/14
Parashtrues
Muharrem Sopa
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 59/2013, të 23 tetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Muharrem Sopa nga Suhareka.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 59/2013, i 23 tetorit 2013, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 5 dhjetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se ia ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Kosovës, sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i

Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 prill 2014, parashtruesi e dërgoi përmes postës kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 prill 2014, Kryetari, me Vendimin NR. GJR. KI67/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

7. Më 23 maj 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës autorizimin për përfaqësuesin e tij dhe vendimet gjyqësore që mungonin në dokumentacionin e paraqitur nga parashtruesi. Në afatin e kërkuar, Gjykata nuk mori ndonjë përgjigje nga parashtruesi i kërkesës.

8. Më 23 maj 2014, Gjykata Supreme u njoftua për regjistrimin e kërkesës dhe iu dërgua një kopje e kërkesës.

9. Më 23 maj 2014, Gjykata i dërgoi Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, njoftimin për regjistrimin e kërkesës, duke kërkuar me këtë rast edhe dokumentacionin shtesë lidhur me rastin.

10. Më 28 maj 2014, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, dokumentacion shtesë të kërkuar mbi bazën e të cilit u vërtetua data e pranimit të aktgjykimit të Gjykatës Supreme nga parashtruesi i kërkesës.

11. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu njoftoi me shkrim Gjykatën për mospjesëmarrjen e tij në seancat shqyrtuese për periudhën qershor-korrik 2014, duke pritur vendimin e Gjykatës përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.
12. Më 1 korrik 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 13 tetor 2000, Gjykata Komunale në Suharekë nxori Aktgjykimin C. nr. 85/2000, me të cilin padinë e parashtruesit, të

paraqitur së bashku me kolegun e tij të punës, J. B., për kthim në vendin e punës këshilltar pedagogjik në Komunën e Suharekës, e ka refuzuar si të pabazuar.

14. Më 2 prill 2001, Gjykata e Qarkut në Prizren nxori Aktvendimin Ac. nr. 100/2000, me të cilin aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit dhe kolegut të tij të punës, J. B., prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë, C. nr. 85/2000, dhe lëndën e ktheu në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

15. Më 14 maj 2002, Gjykata Komunale në Suharekë, me Aktgjykimin C. nr. 205/202, përsëri e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit, me arsyetimin e mungesës së legjitimitetit pasiv të palës së paditur – Komunës së Suharekës.

16. Më 18 dhjetor 2003, Gjykata e Qarkut në Prizren përsëri e aprovoi ankesën e të autorizuarit të parashtruesit dhe prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë, C. nr. 205/2002, duke e kthyer lëndën për rivendosje prapë në gjykatën e shkallës së parë.

17. Më 25 tetor 2011, Gjykata Komunale në Suharekë nxori Aktgjykimin C. nr. 153/06, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e paraqitur nga parashtruesi dhe nga paditësi i dytë, J. B., për kthim në punë në Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Suharekës.

18. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, në pjesën që i dedikohet parashtruesit të kërkesës, Gjykata Komunale ka theksuar: "*Gjykata ne bazë te provave te administruara gjeti se kërkespadija e paditësit te pare duhet te refuzohet si e pabazuar dhe se vendimi i te paditures mbi ndërprerjen e mardhenjes se punës, nuk është i kundërligjshëm pasi qe janë plotësuar kushtet nga neni 75 parag. 2 pika 3 i Ligjit mbi te drejtat themelore nga mardhenja e punës (i aplikushem sipas rregullores se UNMIK-ut) ku thuhet se puntorit mardhenja e punes i nderpritet pa pëlqimin e tij nese nga puna ka munguar5 dite pa nderprer*".

19. Më 5 nëntor 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin Ac. nr. 528/2011, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e përbashkët të parashtruesit dhe J. B. dhe ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë, C. nr. 153/06, të 25 tetorit 2011 duke "*i pranuar në tërësi konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas ankesës së paditësve*".

20. Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës civile dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

21. Më 22 tetor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës për revizion, nxori Aktgjykimin Rev. nr. 59/2013, me të cilin e refuzoi si të pabazuar revizionin e paraqitur nga parashtruesi, duke theksuar, ndër të tjera, në arsyetimin e aktgjykimit se *"gjykatat e instancës më të ulët, ne baze te gjendjes faktike te vërtetuar drejt dhe në mënyrë te plotë, i kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe te drejtën materiale kur kane gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, meqë Drejtoria e Arsimit e Komunës së Suharekës është themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 dhe se e njëjta nuk ka pasur bazë ligjore ti bartë obligimet e Entit Pedagogjik, pasi që i njëjti organ në sistemin e ri arsimor nuk ekziston e as vendi i punës këshilltar pedagogjik pran kësaj drejtorie"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se aktgjykimi i Gjykatës Supreme ia ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], duke theksuar se kjo e drejtë mbrohet edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

23. Parashtruesi ka kërkuar që Gjykata t'i anulojë të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta dhe ta aprovojë si të bazuar kërkesën e tij.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

25. Lidhur me këtë i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

26. Gjykata konstaton se vendimi i fundit lidhur me rastin është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 59/2013, i 22 tetorit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 5 dhjetor 2013, ndërsa parashtruesi kërkesën e dërgoi përmes postës në Gjykatë, më 2 prill 2014, që do të thotë se ai e ka dorëzuar kërkesën në Gjykatë në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës dhe brenda afatit të parashikuar me nenin49 të Ligjit.

27. Gjykata vëren që parashtruesi e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 59/2013, të 22 tetorit 2013, me të cilin iu refuzua si e pabazuar kërkesa për revizion e paraqitur kundër Aktvendimit Ac. nr. 528/2011 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 5 nëntorit 2012, por në të njëjtën kohë kërkon nga Gjykata edhe anulimin e të gjitha vendimeve të tjera gjyqësore të nxjerra para këtij aktgjykimi.

28. Sa u përket pretendimeve të parashtruesit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, me aktgjykimin përfundimtar të gjykatës Supreme, Gjykata përkujton se neni 31 i Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] përcakton:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".*
> *[...]*

29. Lidhur me sa u tha më sipër, Gjykata thekson se parashtruesi vetëm ka potencuar shkeljen e kësaj dispozite kushtetuese, por nuk ka ofruar asnjë provë të vetme për mënyrën dhe për natyrën e shkeljes së saj. Gjykata konsideron se vetëm përshkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës dhe pretendimi se ato janë shkelur, pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, pa përcaktuar rrethanat, pa specifikuar veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me gjykimin e drejtë e të paanshëm, nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së lidhur me një proces të rregullt dhe të paanshëm.

30. Gjykata, duke bërë shqyrtimin e kërkesës së parashtruesit dhe të fakteve të paraqitura me kërkesën, gjeti se në të gjitha fazat e procesit gjyqësor, ankesat e parashtruesit kanë qenë të karakterit ligjor dhe asnjëherë e në asnjë fazë të natyrës kushtetuese apo të shkeljes eventuale të të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë, të cilat për herë të parë janë ngritur në Gjykatën Kushtetuese, gjë që Gjykatën e shpie të konkludojë se në të vërtetë parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin përfundimtar të gjykimit të rastit të tij.

31. Gjykata më tej konstaton se ajo nuk është gjykatë e faktit, nuk gjykon si gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk është thjesht një instancë më tepër gjyqësore. Gjykata në parim nuk gjykon faktin nëse gjykatat e rregullta drejt dhe në mënyrë të plotë e kanë konstatuar gjendjen faktike, apo nëse si në rastin konkret punësimi i parashtruesit ishte ndërprerë në bazë ligjore apo joligjore, sepse kjo është kompetencë e gjykatës së rregullt. Për Gjykatën janë thelbësore çështjet prej ekzistimit të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të të drejtave kushtetuese dhe jo çështjet qartazi ligjore që kryesisht kanë qenë fakte të paraqitura nga parashtruesi (shih, *mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë,* 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

32. Megjithatë Gjykata vëren se lidhur me pretendimet e parashtruesit, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj qartë kishte theksuar se*"kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar ,sepse Drejtoria e Arsimit e Komunës së Suharekës është themeluar bazuar në rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 dhe ajo nuk kishte bazë ligjore për të transferuar obligimet e Institutit pedagogjik*". Në këto rrethana Gjykata konstaton se aktgjykimi është i arsyetuar mirë dhe nuk bëhet fjalë për asnjë lloj arbitrariteti.

33. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë që parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë që të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të dispozitave të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis,* Aktgjykimi i GJEDNJ-së, kërkesa Nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* ose aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese, rasti KI128/12, i 12 korrikut 2013, i parashtruesit *Shaban Hoxha*, në kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011).

34. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e së drejtës kushtetuese për gjykim të drejtë e të

paanshëm, andaj nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar dhe në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika b, prandaj ajo gjeti se kërkesën duhet ta refuzojë si qartazi të pabazuar dhe ta deklarojë të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe të rregullit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 1 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve, dhe ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI06/14, Olga Petrović, Svetolik Patrnogić, Vesna Dejanović dhe Miroslava Ivanović, Aktvendim i datës 4 korrik 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Pc. Nr. 559/10 të 18 shtatorit 2013

Rasti KI06/14, vendimi i 4 korrikut 2014.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, mos shterrje e mjeteve juridike, palë e paautorizuar

Parashtruesit pretendojnë se aktgjykimi i kontestuar ishte nxjerrë me shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në veçanti nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] së Kushtetutës. Parashtruesit gjithashtu pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përveç kësaj, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme.

Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) a) dhe 36 (3) c) të Rregullores së punës vendosi që të deklarojë kërkesën e tre parashtruesve të parë si të papranueshme për shkak të mos shterrjes së mjeteve juridike të parapara me ligj si dhe të deklarojë kërkesën e parashtruesit të katërt si të papranueshme sepse ishte parashtruar nga një palë e paautorizuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI06/14
Parashtrues
Olga Petrović, Svetolik Patrnogić, Vesna Dejanović dhe Miroslava Ivanović
Vlerësimi i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Pc. Nr. 559/10,
të 18 shtatorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Olga Petrović, Svetolik Patrnogić, Vesna Dejanović me vendbanim në Kragujevc, Republika e Serbisë dhe Miroslava Ivanović me vendbanim në Roscoe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
2. Parashtruesja e parë (znj. Olga Petrović), në bazë të autorizimit për shitje të pronës në pronësi të parashtrueses së katërt (znj. Miroslava Ivanović) deklaroi se ishte përfaqësuese ligjore e parashtrueses së katërt të kërkesës.

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, Pc. nr. 559/10, të 18 shtatorit 2013, i cili pretendohet t'i jetë dorëzuar përfaqësuesit të përkohshëm të

parashtruesve të kërkesës, të caktuar *ex officio* nga Gjykata Themelore në Ferizaj, në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Pc. nr. 559/10, të 18 shtatorit 2013.

5. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë me shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në veçanti neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

6. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës kërkuan nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që të shqiptoj, masë të përkohshme, "*duke urdhëruar Zyrën Komunale Kadastrale në Ferizaj që t'ia shlyejë të drejtën e pronësisë I. B. mbi ngastrën kadastrale numër P-72217092-02323-0, KK Ferizaj, në sipërfaqe të përgjithshme 1917 m² dhe ta vendosë gjendjen paraprake, përkatësisht ta bëjë regjistrimin e së drejtës pronësore të Julijana Patrnogić*".

Baza juridike

7. Neni 113. 7 i Kushtetutës, neni 22. i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 20 janar 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatë.

9. Më 31 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI06/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues.

10. Më 31 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI06/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

11. Më 10 shkurt 2014, Gjykata Kushtetuese i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës. Në letrën e njëjtë, u kërkua nga parashtruesit e kërkesës që të dorëzojnë në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës dhe aktgjykimin e kontestuar. Për më tepër, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e parë e kërkesës (znj. Olga Petrović) të dorëzojë autorizimin për përfaqësim të parashtrueses së katërt (znj. Miroslava Ivančić) në Gjykatën Kushtetuese.

12. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Themelore në Ferizaj lidhur me kërkesën.

13. Më 10 shkurt 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme në pritje të rezultatit përfundimtar të kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata, në pajtim me nenin 27 të Ligjit dhe rregullat 55 (4) dhe 56 (3) të Rregullores së punës, vendosi që ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.

14. Më 5 mars 2014, parashtruesit e kërkesës, Olga Petrović, Svetolik Paternogić dhe Vesna Dejanović, dorëzuan formularin e plotësuar të kërkesës dhe kopjen e aktgjykimit të kontestuar. Megjithatë, parashtruesja e parë (znj. Olga Petrović) nuk e dorëzoi autorizimin për parashtruesen e katërt (znj. Miroslava Ivančić).

15. Më 19 maj 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri mori vendim për shtyrjen e seancës shqyrtuese dhe të kërkojë nga Gjykata Themelore në Ferizaj të dorëzojë në Gjykatë shkresat e lëndës Pc. Mo 599/10.

16. Më 2 qershor 2014, Gjykata pranoi shkresat e lëndës Pc. Mo 599/10 nga Gjykata Themelore në Ferizaj.

17. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën, për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor - korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë, përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.

18. Më 1 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI06/14 e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu me gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese.

19. Më 4 korrik 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

20. Më 23 tetor 2000, paraardhësja e parashtruesve të kërkesës Julijana Patrnogić arriti marrëveshje me B. I. për çmimin e blerjes së pronës së paluajtshme, të evidentuar në ngastrën kadastrale (Nr. P 72217092-02323-0) në Ferizaj.

21. Më 5 shkurt 2008, paraardhësja e parashtruesve të kërkesës Julijana Patrnogić nënshkroi autorizimin në zyrën e noterit në Tetovë, Republika e Maqedonisë, duke e autorizuar A. I. që ta shfrytëzojë, shesë dhe t'ua transferojë pronën e paluajtshme palëve të treta.

22. Më 26 prill 2011, Gjykata Themelore në Kragujevc, Serbi, nxori Aktvendimin nr. 0-517/10 dhe 0-518/10 dhe konfirmoi, *inter alia,* se trashëgimia e së ndjerës Julijana Patrnogić konsiston në pronën e paluajtshme në Ferizaj, në sipërfaqe prej 1, 46.71 ha. Me të njëjtin aktvendim, 22 familjarë, duke përfshirë edhe katër parashtruesit e kërkesës, u shpallën trashëgimtarë të së ndjerës Julijana Patrnogić. Në këtë aktvendim ishin shënuar qartë adresat e 22 trashëgimtarëve të së ndjerës Juliana Patrnogić, duke përfshirë edhe katër parashtruesit e kërkesës.

23. Në një datë të pacaktuar, B. I. paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Ferizaj duke kërkuar njohjen e pronës së paluajtshme të regjistruar në ngastrën (Nr- P 72217092-02323-0) në Ferizaj, me sipërfaqe prej 00.19,17 ari që pretendohet ta ketë blerë nga Julijana Patrnogić në mars 1992. Palët e paditura në këtë procedurë pronësore ishin të 22 trashëgimtarët e së ndjerës Julijana Patrnogić, duke përfshirë katër parashtruesit e kërkesës.

24. Më 29 korrik 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj, nxori Aktvendimin C. nr. 559/10 për emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm Ilmi Piraj, për shkak të mungesës së pretenduar të adresës postare të 22 trashëgimtarëve të së ndjerës Julijana Patrnogić, duke përfshirë të katër parashtruesit e kërkesës.

25. Më 18 shtator 2013, u mbajt shqyrtimi kryesor publik në prani të përfaqësuesit të përkohshëm të parashtruesve të kërkesës, z. Ilmi Piraj, avokat nga Ferizaj.

26. Të njëjtën ditë, Gjykata Themelore në Ferizaj nxori Aktgjykimin e kontestuar, (C. Nr. 559/10), dhe e aprovoi kërkesëpadinë për njohje të së drejtës pronësore të B. I.. Parashtruesit e kërkesës dhe 18 trashëgimtarët e tjerë të së ndjerës Julijana Patrnogić ishin detyruar t'i lejojnë B. I. ta regjistrojë të drejtën pronësore në librat përkatës kadastralë në Ferizaj.

27. Në arsyetimin e Aktgjykimit të kontestuar thuhej se "*gjykata ka vërtetuar faktin se në mes palëve që nga shitblerja e paluajtshmërisë lëndore, në vitin 1992, deri tan në mes palëve ndërgjyqëse nuk kishte fakte kontestuese, se paditësi i ka paguar në tërësi trashëgimlënëses së të paditurve çmimin e kontraktuar, ndërsa trashëgimlënësja e të paditure po të njëjtin vit i ka dorëzuar në posedim të qetë paditësi dhe se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të mbajtjes në kuptim të nenit 28 al. 4 të Ligjit Bazë mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore….*".

28. Në arsyetimin e Aktgjykimit të kontestuar thuhej se përfaqësuesi i përkohshëm *"i caktuar të paditurve për shkak të mungesës së adresës së të njëjtëve, ka deklaruar fillimisht se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë, ndërsa pas administrimit të provave në fjalën e tij të fundit ka deklaruar se në bazë të provave të administruara me shkrim mendoj se e gjithë procedura e shitblerjes është bërë në mënyrë ligjore nga se shitblerja gjegjësisht marrëveshja për shitblerje është bërë në vitin 2008 ku edhe është bërë pagesa e çmimit të paluajtshmërisë".*

29. Më 27 nëntor 2013, noteri Nexhat Sh. Qorroli e informoi avokatin Miloš Petković nga Shtrpci, si përfaqësues të autorizuar të trashëgimtarëve ligjorë të së ndjerës Julijana Patrnogić, lidhur me sa vijon: *"udhëzimi në procedurën kontestimore është i domosdoshëm, duke pasur parasysh se noteri ka konstatuar se lidhur me pronën e paluajtshme, që është lëndë e trashëgimisë, është duke u zhvilluar procedura kontestimore dhe gjykata ka marrë aktgjykim me të cilin ia ka njohur të drejtën e pronësisë Izet Bajramit nga fshati Greme, mbi ngastrën kadastrale numër P-72217092-02323-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1917 m². Sipas aktgjykimit të gjykatës janë bërë edhe ndryshimet në operatin kadastral në Komunën e Ferizajt"***.**

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"procedura e zhvilluar, e cila ka përfunduar... nga Gjykata Themelore në Ferizaj ka shkelur rregullat e procedurës, sepse nuk ua ka dërguar padinë të padituve për të dhënë përgjigje dhe as u ka dërguar atyre thirrje për të marrë pjesë në shqyrtimin e zhvilluar para gjykatës, por, duke mos respektuar procedurat, u ka caktuar atyre një përfaqësues të përkohshëm, ndonëse është e qartë se paditësi i kishte të njohura të gjitha të dhënat lidhur me të padituri, pra edhe adresat e tyre"*.

31. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se adresat e tyre ishin shënuar në aktvendimin e Gjykatës Themelore në Kragujevc, së cilës i referohet aktgjykimi i kontestuar "*kështu që është e qartë se ky veprim i palës paditëse, i përfaqësuesit të përkohshëm të të padituve dhe i gjykatës ka qenë i kundërligjshëm dhe ka pasur për qëllim që parashtruesit të kërkesës dhe trashëgimtarëve të tjerë t'u bëhet e pamundur mbrojtja e të drejtave dhe interesave të tyre pronësore para gjykatës"*.

32. Parashtruesit e kërkesës pohojnë më tej se ata nuk kishin mundur të krijojnë kontakte me përfaqësuesin e përkohshëm, i cili nuk u ishte përgjigjur thirrjeve të tyre telefonike dhe porosive elektronike.

33. Prandaj, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se është shkelur e drejta e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës si dhe të drejtat e tyre pronësore, të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

35. Sa i përket kërkesës së tanishme, Gjykata përkujton se përderisa të tre parashtruesit e parë të kërkesës (znj. Olga Petrović, z. Svetolik Patrnogić dhe znj. Vesna Dejanović) dorëzuan në Gjykatë

formularët e plotësuar të kërkesës dhe një kopje të aktgjykimit të kontestuar, parashtruesja e parë e kërkesës (znj. Olga Petrović) nuk e dorëzoi autorizimin për parashtruesen e katërt (znj. Miroslava Ivančić).

a) Pranueshmëria e kërkesës së dorëzuar nga tre parashtruesit e parë të kërkesës

36. Sa i përket të tre parashtruesve të parë të kërkesës (znj. Olga Petrović, z. Svetolik Patrnogić dhe znj. Vesna Dejanović) Gjykata vëren se, në bazë të nenit 232 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Republikës së Kosovës (2009/03-L-006, i 29 korrikut 2008), parashtruesit kishin të drejtë të parashtrojnë kërkesë për përsëritje të procedurës. Neni 232.1 i Ligjit për procedurën kontestimore thotë si në vijim:

> *"Procedura e përfunduar me aktgjykim dhe aktvendim të formës së prerë të gjykatës mund të përsëritet sipas propozimit të palës:*
>
> *a) në qoftë se palës me veprim të kundërligjshëm, e sidomos në rast të mos thirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore";*

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, i cili përcakton se:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

38. Gjykata i referohet edhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

39. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me*

Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar, ose".

40. Arsyeja për ekzistimin e rregullit të shterimit është që t'iu lejojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë këtu edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar apo rregulluar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin që rendi juridik i Kosovës ofron mjete efektive juridike për mbrojtje kundër shkeljeve të të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih Aktvendimin për papranueshmëri, *AAB-RIINVEST Universiteti SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999).

41. Gjykata gjithashtu rikujton se në përputhje me parimin e subsidiaritetit, parashtruesit e kërkesës janë të obliguar që të shterojnë të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, siç parashihet me nenin 113.7 dhe me dispozitat e tjera ligjore, siç u përmend më lart. Prandaj, parashtruesit e kërkesës duhet të kishin parashtruar kërkesë, siç është e përcaktuar si më lart.

42. Prandaj, parashtruesit e kërkesës, duke mos proceduar më tej me kërkesë në pajtim me afatet e parapara, mbajnë përgjegjësinë që rasti i tyre të deklarohet i papranueshëm, meqë do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për procedim të mëtejshëm për të kundërshtuar shkeljen e të drejtave kushtetuese. (shih rastin KI16/12, parashtrues *Gazmend Tahiraj*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri, i 22 majit 2012).

43. Gjykata gjithashtu konsideron se dyshimi i thjeshtë mbi perspektivën e çështjes nuk është i mjaftueshëm për të ndaluar parashtruesit e kërkesës nga detyrimet e tyre për t'u ankuar para organeve kompetente në kohën e duhur (shih *Whiteside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendimi i 7 marsit 1994, parashtresa nr. 20357/92, DR 76, fq. 80 dhe rasti KI16/12, parashtrues *Gazmend Tahiraj,* Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri, i 22 majit 2012).

44. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet efektive sipas ligjit të Kosovës, në mënyrë që Gjykata të procedojë me pretendimin e tyre për kushtetutshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj.

b) Pranueshmëria e kërkesës së dorëzuar nga parashtruesi i parë i kërkesës në emër të parashtruesit të katërt

45. Sa i përket kërkesës së parashtruar nga parashtruesja e parë e kërkesës (znj. Olga Petrović) në emër të parashtrueses së katërt të kërkesës (znj. Miroslava Ivančić), Gjykata i referohet rregullit 36 (3) c), i cili parasheh:

> *"(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*
>
> *c) kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar;".*

46. Gjykata vëren se znj. Miroslava Ivančić e kishte autorizuar parashtruesen e parë (znj. Olga Petrović) që "*ta shesë pjesën time të bashkëpronësisë që përbën 1/6 e kësaj paluajtshmërie të regjistruar në fletën poseduese numër 491, KK Ferizaj...*". Megjithatë, znj. Ivančić nuk e kishte autorizuar parashtruesen e parë (znj. Olga Petrović) për ta përfaqësuar atë në Gjykatën Kushtetuese.

47. Rrjedhimisht, sa i përket parashtrueses së katërt (znj. Ivančić), kërkesa është dorëzuar nga një palë e paautorizuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) a) dhe 36 (3) c) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 4 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën e tre parashtruesve të parë të kërkesës (znj. Olga Petrović, z. Svetolik Patrnogić dhe znj. Vesna Dejanović) të papranueshme për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj;

II. TA DEKLAROJË kërkesën e parashtrueses së katërt të kërkesës (Miroslava Ivančić) të papranueshme për shkak se ishte dorëzuar nga një palë e paautorizuar;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI31/14, Luan Ramadani, Aktvendim i datës 3 korrik 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. Nr. 222/2013, të 24 dhjetorit 2013

Rasti KI31/14, vendimi i 3 korrikut 2014.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

Parashtruesi pretendon se ka pasur trajtim të pabarabartë të palëve në procedurën gjyqësore, pasi që provat e propozuara prej tij nuk janë marrë parasysh. Ai më tej pretendon se ka pasur shkelje të të drejtave të tij, pasi që në rastin e tij nuk është aplikuar ligji më i favorshëm, në kundërshtim me nenin 3 të Kodit Penal.

Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjeshtë konteston nëse gjykatat e rregullta e kanë zbatuar drejt ligjin më të favorshëm penal të aplikueshëm në rastin e tij, gjë që është çështje e ligjshmërisë.

Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar saktësisht dhe nuk ka dëshmuar se si dhe pse i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se rastit i ka munguar paanshmëria, ose që procedurat kanë qenë të padrejta.

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 korrik 2014, njëzëri deklaron se kërkesa është qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI31/14
Parashtrues
Luan Ramadani
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Pml. Nr. 222/2013, të 24 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Luan Ramadani, me vendbanim në Lipjan.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 222/2013, të 24 dhjetorit 2013, i cili i është dorëzuar atij më 8 janar 2014.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 mars 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 13 mars 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai ta dorëzojë kopjen e Aktgjykimit PA1 nr. 712/2012 të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, të 19 prillit 2013. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk iu përgjigj kërkesës.

8. Më 13 mars 2014, Gjykata ia dërgoi kopjen e kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën, për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor-korrik 2014, derisa Gjykata të vendos lidhur me pretendime të caktuara të ngritura ndaj tij.

10. Më 3 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu me gjyqtarin Ivan Čukalović si anëtar të Kolegjit shqyrtues.

11. Më 3 korrik 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 11 mars 2011, Gjykata Komunale në Lipjan (Aktgjykimi P. nr. 102/2010) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e

veprës penale të rrezikimit të sigurisë në punë, nga neni 186, par. 2 lidhur me par. 3 dhe 4, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK) dhe e dënoi me një 1 (një) vjet burgim.

13. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të lartcekur.

14. Më 19 prill 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi PA1 nr. 712/2012) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

15. Parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të shkallës së parë dhe të dytë, për shkak të shkeljes së ligjit penal. Parashtruesi pretendoi, *inter alia,* se *"Shkelja e ligjit penal bëhet tani edhe me aplikimin e nenit 186 të Kodit Penal të më parëm, duke u aplikuar dhe zbatuar në kohen kur ajo vepër tanimë nuk përben vepër penale".*

16. Më 24 dhjetor 2013, Gjykata Supreme (Aktgjykimi i kontestuar, Pml. nr. 222/2013) e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë.

17. Në arsyetim të këtij aktgjykimi, thuhej, *inter alia*, se *"...pretendimet e mbrojtësit se sipas dispozitave të kodit të ri penal kjo vepër penale nuk ekziston, nuk qëndrojnë për faktin se kjo vepër penale nuk është dekriminalizuar për faktin se sipas dispozitave të vjetra ka qenë e përfshirë në kapitullin XVII ku janë përfshirë veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës, ndërsa në kodin e ri penal, kjo vepër është zhvendosur në kapitullin XXIX ku janë përfshirë vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe të pasurisë dhe, është inkriminuar sipas nenit 367 te KPK".*

18. Gjykata Supreme theksoi më tej se "*Ligji Penal, i cili ishte i aplikueshëm në kohën e kryerjes së vepres penale, respektivisht par. 4 të nenit 186 të KPK parashikon "nëse vepra penale nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni ka shkaktuar lëndim të rëndë të një apo më shumë personave, për veprën nga paragrafi 1 dhe 2 kryerësi dënohet me burgim deri në pesë vjet, ndërsa për veprën penale nga paragrafi 3 dënohet me burgim deri në tre vjet". Ndërsa, paragrafi 5 të nenit 367 të Kodit të ri Penal, parashikon "nëse vepra penale nga paragrafi 3 të këtij neni rezulton me lëndim të rëndë të një apo më shume personave ose me dëm*

substancial pasuror, kryerësi dënohet me burgim deri në 5 vjet".

19. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstatoi se në rastin penal të parashtruesit të kërkesës *"nuk ka dyshim se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë drejtë kanë aplikuar ligjin i cili ishte në fuqi, e që është më i favorshëm për të gjykuarin, sepse siç u tha lartë ligji i ri për këtë vepër parashikon dënimin me të ashpër…".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës. Ai pretendon se ka pasur trajtim të pabarabartë të palëve në procedurën gjyqësore, pasi që provat e propozuara prej tij nuk janë marrë parasysh. Ai më tej pretendon se ka pasur shkelje të të drejtave të tij, pasi që në rastin e tij nuk është aplikuar ligji më i favorshëm, në kundërshtim me nenin 3 të Kodit Penal.

21. Në mbështetje të pretendimit të tij, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi një ekstrakt të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Pkl. nr. 11/2004), të 10 dhjetorit 2004, me të cilin Gjykata Supreme kishte aprovuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke vërtetuar se në rast të ndryshimit të ligjit të aplikueshëm në rastin e tanishëm, duhet të aplikohet ligji më i favorshëm për kryesin. Rrjedhimisht, në atë rast specifik, Gjykata Supreme e ndryshoi cilësimin juridik.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit që parashikon:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

24. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
> ...
> *c) kërkesa është qartazi e bazuar".*

25. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjeshtë konteston nëse gjykatat e rregullta e kanë zbatuar drejt ligjin më të favorshëm penal të aplikueshëm në rastin e tij, gjë që është çështje e ligjshmërisë.

26. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmëria) që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

27. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar saktësisht dhe nuk ka dëshmuar se si dhe pse i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

28. Lidhur me këtë, Gjykata e ripërsërit se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1; shih gjithashtu Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI70/11, të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011).

29. Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike, të parapara me Ligjin e procedurës penale, duke ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit të shkallës së dytë.

30. Për më tepër, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme mori parasysh argumentet e parashtruesit të kërkesës dhe në të vërtetë i ishte përgjigjur në mënyrë të qartë ankesave të tij në pikat e kontestuara të ligjit.

31. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se rastit i ka munguar paanshmëria, ose që procedurat kanë qenë të padrejta (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, GJEDNJ, Vendim përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009)·

32. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, Gjykata gjen se kërkesa është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. Dr. Enver Hasani

KI54/12, Mustafë Xhekaj, Aktvendim i datës 11 mars 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. nr. 376/2009, të 23 shkurtit 2011

Rasti KI 54/12, vendimi i 11 marsit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, cenim i të drejtave dhe lirive kushtetuese, kërkesë për mos zbulimin e identitetit të tij, kërkesa e paafatshme.

Parashtruesi ka paraqitur kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese janë cenuar me aktgjykimet e gjykatave të rregullta të të gjitha shkallëve. Më 14 janar 2008, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Aktgjykimin P. nr. 94/2006, gjeti parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje sipas nenit 147 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës. Gjykata e dënoi parashtruesin e kërkesës me tetëmbëdhjetë (18) vjet burgim, duke përfshirë kohën e kaluar ne paraburgim. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë I ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 64 te KPK, të cilat ndikojnë në shqiptimin e llojit dhe lartësisë së dënimit". Parashtruesi pretendon se atij i është bërë padrejtësi nga ana e *"Gjyqësorit të Kosovës"* pasi që ai është "i *pafajshëm"* dhe ishte dënuar duke u bazuar në një gjykim të padrejtë dhe të pandashëm. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që të mos zbulohet identiteti i tij.

Gjykata vëren se aktgjykimi që kontestohet nga parashtruesi I kërkesës, është i 23 shkurtit 2011, kurse kërkesa ishte dorëzuar me 11 qershor 2012. Kërkesa e parashtruesit nuk është në përputhje me nenin 49 te Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës pasi qe ishte dorëzuar pas më shumë se një (1) viti nga data e vendimit të kontestuar. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajve, sipas nenit 49 te Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, është që të promovoj siguri ligjore, duke siguruar se rastet që ngrenë çështje që kanë të bëjnë me Kushtetutën, trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestua. Konstatohet se kërkesa e parashtruesit është e paafatshme. Përveç kësaj, parashtruesi nuk ka ofruar bazë të mjaftueshme dhe dëshmi që do ta mbështesnin kërkesën e parashtruesit që identiteti i tij të mos zbulohet. Prandaj, Gjykata e refuzon si te pabazuar kërkesën për të mos zbuluar identitetin e tij.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI54/12
Parashtrues
Mustafë Xhekaj
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Ap. nr. 376/2009, të 23 shkurtit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u dorëzua nga z. Mustafë Xhekaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), me vendbanim në Drenas.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin Ap. nr. 376/2009, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), të 23 shkurtit 2011, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet të jetë "*i padrejtë*".

4. Për më tepër, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që të mos zbulohet identiteti i tij.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese Nr. 03. L/121(në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 11 qershor 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

7. Më 4 korrik 2012, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI54/12, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI54/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Enver Hasani.

8. Më 11 shtator 2012, Gjykata Supreme u njoftua lidhur me kërkesën.

9. Më 11 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 14 janar 2008, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Aktgjykimin P. nr. 94/2006, gjeti parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje sipas nenit 147 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës. Gjykata e dënoi parashtruesin e kërkesës me tetëmbëdhjetë (18) vjet burgim, duke përfshirë kohën e kaluar në paraburgim. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur në Gjykatën Supreme.

11. Më 23 shkurt 2011, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Ap. nr. 376/2009, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, të 14 janarit 2008, duke vlerësuar se *"gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje penale dhe në mbështetje të kësaj gjendjeje faktike drejt e ka aplikuar edhe ligjin penal dhe duke vlerësuar aktgjykimin përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 64*

të KPK, të cilat ndikojnë në shqiptimin e llojit dhe lartësisë së dënimit".

Pretendimet e parashtruesit

12. Parashtruesi pretendon se atij i është bërë padrejtësi nga ana e *"Gjyqësorit të Kosovës"* pasi që ai është *"i pafajshëm"* dhe ishte dënuar duke u bazuar në një gjykim *"të padrejtë dhe të pandershëm".*

Pranueshmërisa e kërkesës

13. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

14. Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)".*

15. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
> *...*
> *b) dhe kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi...".*

16. Në këto rrethana, Gjykata vëren se aktgjykimi që kontestohet nga parashtruesi i kërkesës, është i 23 shkurtit 2011, kurse kërkesa ishte dorëzuar më 11 qershor 2012. Kërkesa e parashtruesit nuk është në përputhje me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës pasi që ishte dorëzuar pas më shumë se një (1) viti nga data e vendimit të kontestuar.

17. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që ngrenë çështje që kanë të bëjnë me Kushtetutën, trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe se vendimet e mëparshme

nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih rastin O'Loughlin dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005).

18. Konstatohet se kërkesa e parashtruesit është e paafatshme.

19. Përveç kësaj, parashtruesi nuk ka ofruar bazë të mjaftueshme dhe dëshmi që do ta mbështesnin kërkesën e parashtruesit që identiteti i tij të mos zbulohet.

20. Prandaj, Gjykata e refuzon si të pabazuar kërkesën për të mos zbuluar identitetin e tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 mars 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI65/14, Bajram Santuri, Aktvendim i datës 1 korrik 2014- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 791/13, të 23 shtatorit 2013; i Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, P. nr. 43/10, të 31 tetorit 2012; i Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012; i Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 247/08, të 15 shkurtit 2010; i Njoftimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ZDP/12/ZP/910, të 29 nëntorit 2012; dhe i Njoftimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të 21 janarit 2011

Rasti KI65/14, vendimi i 1 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, mosshterimi, e paafatshme, person i paautorizuar.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi shkeljen e të drejtës pronësore, së drejtës për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm dhe të drejtës për përfitime të pensionit pa iu referuar ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme për tri arsye procedurale: të mosshterimit të mjeteve juridike, të paafatshme dhe personit të paautorizuar në varësi të procedurave të ndryshme që ishin zhvilluar tek autoritetet publike të Republikës së Kosovës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI65/14
Parashtrues
Bajram Santuri
Vlerësimi kushtetues i Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 791/13, të 23 shtatorit 2013; i Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, P. nr. 43/10, të 31 tetorit 2012; i Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012; i Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 247/08, të 15 shkurtit 2010; i Njoftimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ZDP/12/zp/910, të 29 nëntorit 2012; dhe i njoftimit të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, të 21 janarit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Cukalovic, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Bajram Santuri nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 791/13, të 23 shtatorit 2013; Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, P. nr. 43/10, të 31 tetorit 2012; Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012; Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 247/08, të 15 shkurtit 2010; Njoftimin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ZDP/12/zp/910, të 29 nëntorit 2012; dhe njoftimin e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, të 21 janarit 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt çështjeje është vlerësimi kushtetues i vendimeve të kontestuara që *"supozohet se janë të padrejta për shkak se parashtruesit i kanë mohuar të drejtën në pronë"*.

4. Në këtë drejtim, nuk referohet për shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 1 prill 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 11 dhe 24 prill 2014, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

8. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI65/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI65/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani (anëtarë).

9. Më 22 maj 2014, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, nga një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Themelore në Prizren, Gjykatës Themelore në Gjilan, Gjykatës së Apelit të Kosovës, Zyrës së Prokurorit Disiplinor dhe Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale.

10. Më 1 korrik 2014, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Në këtë kërkesë, parashtruesi ngre çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtën në pronë, hetim disiplinor ndaj gjyqtarëve, padi për pengim të posedimit, propozim akuzë subsidiare dhe pension invalidor që janë zhvilluar në procedura të ndryshme në gjykata dhe organe të tjera të instancave të ndryshme dhe në periudha kohore të ndryshme. Në të gjitha vendimet dhe dokumentet e tjera të përmbajtura në këtë kërkesë, parashtruesi paraqitet në cilësinë e paditësit subsidiar, palës së paditur, e në disa të tjera nuk është palë ndërgjyqëse.

12. Më 15 shkurt 2010, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktvendimin C. nr. 247/08, hodhi poshtë të palejuar padinë e paditësve MS, TS dhe NSH për vërtetimin e nulitetit të kontratës dhe dorëzimit të paluajtshmërisë në posedim kundër të padituve KBI "Progres-Export" dhe G. K.

13. Më 21 janar 2011, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale njoftoi parashtruesin e kërkesës se *"sipas të gjitha ligjeve që janë fuqi dhe trajtohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ju njoftojmë se ju nuk mund të jeni shfrytëzues i pensionit invalidor sepse ju jeni shfrytëzues i pensionit të parakohshëm në Suedi siç e keni cekë dhe në kërkesë e për të gëzuar pensionin invalidor nuk duhet të jeni shfrytëzues i pensioneve të jashtme"*.

14. Më 25 shtator 2012, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktvendimin C. nr. 47/2000, pezulloi procedurën juridike kontestimore të parashtruesit kundër të padituve Komuna e Prizrenit dhe D. D.

15. Më 31 tetor 2012, Gjykata Komunale në Gjilan, me Aktvendimin P. nr. 43/10, hodhi poshtë propozim akuzën subsidiare të paraqitur nga parashtruesi kundër të pandehurve E. GJ., M. P., N. SH. dhe T. S., të akuzuar për vepra penale falsifikim i dokumenteve zyrtare nga neni 348 paragrafi 1 dhe falsifikim i dokumenteve nga neni 332 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së.

16. Më 29 nëntor 2012, Zyra e Prokurorit Disiplinor, me Njoftimin ZPD/12/zp/910, informoi parashtruesin se nuk kishte bazë ligjore për të hapur hetim disiplinor për sjellje të pahijshme dhe zvarritje gjyqësore ndaj gjyqtarit të Dhomës së Posaçme të ngarkuar me rastin e tij.

17. Më 13 shkurt 2013, Gjykata Themelore në Prizren, me Aktvendimin C. nr. 830/09, hodhi poshtë të palejuar padinë e paditësve M. S., Z. S., B. S. dhe N. SH. kundër parashtruesit si palë e paditur për shkak të pengim posedimit.

18. Më 23 shtator 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin CA. nr. 791/13, miratoi si të bazuara ankesat e palëve ndërgjyqësore, e prishi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C. nr. 830/09, të 13 shkurtit 2013, dhe lëndën ia ktheu së njëjtës gjykatë për rivendosje.

Pretendimet e parashtruesit

19. Përkitazi me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 247/08, të 15 shkurtit 2010, parashtruesi pretendon: *"[...] si duket zvarritjet janë edhe po bëhen me qëllim sepse kanë kaluar 15 vite të pas luftës dhe 50 vitet e sistemit të kaluar kur me dhunë e kërcënime kanë uzurpuar pasurinë tonë që i kanë kërcënuar për nënshkrimin e kontratës me KBI Progres [...]".*

20. Përkitazi me njoftimin e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, të 21 janarit 2011, parashtruesi pretendon: *"Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale më ka informuar se nuk mund të jem shfrytëzues i pensionit invalidor sepse unë jam shfrytëzues i pensionit të Suedisë, ndërsa nuk e ka marrë për bazë që edhe në Kosovë kam punuar 10-15 vite si arsimtar [...] dhe këtë të drejtë më ka përkufizuar me këtë përgjigje gjysmake dhe jo të rregullt [...]".*

21. Përkitazi me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012, parashtruesi pretendon: *"pse i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë-nuk është shkruar arsyeja për palën e pakënaqur dhe në këtë pezullim kamuflohet padia kundër ish Komunës së Prizrenit [...]".*

22. Përkitazi me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, P. nr. 43/10, të 31 tetorit 2012, parashtruesi pretendon: *"për shkak të parregullsisë së punës së Gjykatës Komunale që nuk i ka kryer hetimet si duhet edhe më vonë nuk e dërgon ankesën time në Gjykatën e Qarkut edhe e zvarritin procesin me qëllim duke dërguar informatat që nuk duhet administratori ta kryen punën e gjyqtarit [...]".*

23. Përkitazi me Njoftimin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ZPD/12/zp/910, të 29 nëntorit 2012, parashtruesi, ndër të tjera,

pretendon: *"[...] nga kjo shkresë e Zyrës së Prokurorisë Publike del një numër tjetër SCA-11/19 që për herë të parë po e dëgjoi nga kjo shkresë dhe më herët ka qenë numri AC 664/10 që është bartur nga C. nr. 99/07 e kjo është formuar nga revizioni 46/05 ...edhe të gjithë këta numra po i përziejnë një lëndë të trashëgimisë sonë 207 ari tokë për të na i ri uzurpuar sikurse që na kanë uzurpuar nga sistemi i vjetër [...]"*.

24. Përkitazi me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 791/13, të 23 shtatorit 2013, parashtruesi pretendon: *"ne jemi ankuar nëpërmjet Gjykatës Themelore po ashtu edhe kemi dhënë përgjigje në ankesën e palës kundërshtare që në këtë aktvendim CA. nr. 791/13 dhe si provë po e ngjisim dokumentin ku në asnjë vend nuk përmenden ankesat e mija as përgjigja ime kundër ankesës së palës kundërshtare"*.

Vlerësimi i pranueshmërisë

25. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, së pari është e nevojshme të shqyrtojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

26. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

27. Gjykata i referohet nenit 47 të Ligjit, që përcakton:

> *"Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

28. Gjykata po ashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".

29. Gjykata, po ashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) b) dhe (3) c) të Rregullores së punës, që përcakton:

(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

(a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi;

(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

c) kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar;

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi ka zhvilluar procedura të ndryshme në periudha kohore të ndryshme dhe si rrjedhojë ato do të vlerësohen veç e veç.

Pretendimet për Aktvendimin CA.nr.791/13 të Gjykatës së Apelit të Kosovës të 23 shtatorit 2013

31. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit për Aktvendimin CA. nr. 791/13, të 23 shtatorit 2013, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjykata vëren se lënda është kthyer për rivendosje në Gjykatën Themelore në Prizren, çka nënkupton se kjo pjesë e kërkesës është e parakohshme për shkak se nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike siç përcaktohet me Nenin 113.7 të Kushtetutës.

32. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih rastin KI34/11,

parashtrues Sami Bunjaku, Aktvendimi për papranueshmëri, i 8 dhjetorit 2011).

33. Rrjedhimisht kjo pjesë e kërkesës është e papranueshme për shkak të mos shterjes së mjeteve juridike siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës.

Pretendimet për Aktvendimin C.nr.47/2000 të Gjykatës Komunale në Prizren të 25 shtatorit 2012, Aktvendimin P. nr. 43/10 të Gjykatës Komunale në Gjilan të 31 tetorit 2012, Njoftimin ZPD/12/zp/910 të Zyrës së Prokurorit Disiplinor të 29 nëntorit 2012, Njoftimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të 21 janarit 2011

34. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit për: i) Aktvendimin C. nr. 47/2000, të 25 shtatorit 2012, të Gjykatës Komunale në Prizren, ii) Aktvendimin P. nr. 43/10, të 31 tetorit 2012, të Gjykatës Komunale në Gjilan, iii) Njoftimin ZPD/12/zp/910, të 29 nëntorit 2012, të Zyrës së Prokurorit Disiplinor dhe iv) njoftimin e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, të 21 janarit 2011, Gjykata vëren nga dokumentet e përmbajtura në kërkesë se parashtruesi nuk është ankuar ndaj vendimeve dhe njoftimeve të kontestuara në gjykatat dhe organet e tjera kompetente brenda afateve prekluzive të përcaktuara sipas ligjit në fuqi në Kosovë.

35. Gjykata vëren se vendimet dhe njoftimet e lartpërmendura datojnë nga vitet 2011 dhe 2012, gjersa kërkesa është dorëzuar në Gjykatë më 1 prill 2014, përkatësisht në një afat kohor prej 2 dhe 3 vitesh, çka është e papajtueshme me afatin katërmuajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

36. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor katër (4) mujor, sipas Nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005, dhe *mutatis mutandis* shih rastin nr. KI140/13, *parashtrues Ramadan Cakiqi,* Aktvendimi për papranueshmëri, i 3 marsit 2014).

37. Gjykata përsërit se Neni 49 i Ligjit dhe rregulli 36 (1) b) i Rregullores së punës, kërkojnë që parashtruesit, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike, t'i dorëzojnë kërkesat e tyre brenda periudhës prej katër (4) muajsh të afatit ligjor, nga dita kur është pranuar vendimi përfundimtar i gjykatës.

38. Rrjedhimisht kjo pjesë e kërkesës është e papranueshme për shkak se është paraqitur jashtë afatit ligjor katër (4) mujor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

Pretendimet për Aktvendimin C. nr. 247/08 të Gjykatës Komunale në Prizren të 15 shkurtit 2010

39. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit për Aktvendimin C. nr. 247/08, të 15 shkurtit 2010, të Gjykatës Komunale në Prizren, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ishte palë ndërgjyqëse në atë procedurë.

40. Rrjedhimisht, kjo pjesë e kërkesës është e papranueshme për shkak se është dorëzuar nga një palë e paautorizuar siç përcaktohet me rregullin 36 (3) c) të Rregullores së punës.

41. Duke marrë parasysh gjithçka që u shtjellua më sipër, Gjykata deklaron kërkesën të papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) a) b) dhe (3) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 56 të Rregullores së punës, më 1 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI56/14, Beqir Zhushi, Aktvendim i datës 26 qershor 2014- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-11-0069, të 22 prillit 2013

Rasti KI56/14, vendimi i 26 qershorit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, e paafatshme.

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktgjykimin ASC-11-0069, të 22 prillit 2013 refuzoi kërkesën e parashtruesit për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku" në Prishtinë.

Parashtruesi i kërkesës u ankua se ai ishte larguar nga puna në mënyrë diskriminuese dhe se ai ka të drejtë për një pjesë të të ardhurave. Parashtruesi nuk iu referua ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si të paafatshme, sepse parashtruesi nuk e kishte parashtruar kërkesën e tij brenda afateve ligjore të përcaktuara me Ligj dhe të specifikuara më tej në Rregullore të punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI56/14
Parashtrues
Beqir Zhushi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-11-0069, të 22 prillit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Beqir Zhushi nga Vushtrria (në tekstin e mëtejmë, parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin ASC-11-0069 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme) të 22 prillit 2013, që atij i është dorëzuar më 29 prill 2013, në lidhje me Aktgjykimin SCEL-09-0001 të Dhomës së Posaçme të 10 qershorit 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara që supozohet *" se parashtruesit të kërkesës padrejtësisht i kanë mohuar të drejtën e tij në realizimin e një pjese të të ardhurave nga 20% i privatizimit të NSH 'Ramiz Sadiku' në Prishtinë".*

4. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës nuk i referohet shkeljes së ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 27 mars 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 3 prill 2014, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin Nr. GJR. KI56/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI56/14 caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu (anëtarë).

8. Më 19 maj 2014, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dorëzua Dhomës së Posaçme.

9. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor - korrik 2014, derisa Gjykata të vendos përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.

10. Më 26 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI56/14, zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu, si anëtar të Kolegjit shqyrtues, dhe në vend të tij caktoi gjyqtarin Robert Carolan.

11. Më 26 qershor 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi ishte punëtor i NSH “Ramiz Sadiku” në Prishtinë nga viti 1977 deri më 1990.

13. NSH "Ramiz Sadiku" u privatizua më 27 qershor 2006.

14. Më 23 mars 2009, parashtruesi kishte paraqitur një ankesë brenda afatit në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), me ç'rast kishte kërkuar të përfshihej në listën e punëtorëve që kishin të drejtë në një pjesë të të hyrave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku" në Prishtinë.

15. Më 10 qershor 2011, trupi gjykues i Dhomës së Posaçme kishte vendosur që të refuzonte ankesën e parashtruesit si të pabazuar duke konsideruar se provat e dorëzuara nga parashtruesi nuk i përmbushin kërkesat e nenit 10.4 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut 2003/13.

16. Më 18 korrik 2011, parashtruesi u ankua në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme kundër aktgjykimit të lartpërmendur të trupit gjykues.

17. Më 22 prill 2013, Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme kishte vërtetuar aktgjykimin e trupit gjykues dhe kishte refuzuar ankesën e parashtruesit si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi kërkon nga Gjykata: *"... të më njihet e drejta në 20% të përcaktuar sipas provave lidhur me stazhin e punës si dhe lidhur me arsyet e largimit tim nga puna të natyrës diskriminuese nga pushteti i dhunshëm dhe diskriminues i Republikës së Serbisë me masat e dhunshme në organizatën ku unë kam punuar".*

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, ajo së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës së Gjykatës.

20. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

21. Gjykata po ashtu i referohet nenit 49 të Ligjit që përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".*

22. Gjykata po ashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës që përcakton:

> *(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *(...)*
>
> *b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi;*

23. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i kontestuar është i datës 22 prill 2013 që parashtruesit i është dorëzuar më 29 prill 2013. Kërkesa është dorëzuar në Gjykatë më 27 mars 2014, pra 7 (shtatë) muaj jashtë afatit ligjor prej 4 (katër) muajve të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

24. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit është e paafatshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 26 qershor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI220/13, Hysen Çeku, Aktvendim i datës 7 shkurt 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Ac. nr. 4952/2012, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 27 majit 2013

Rasti KI220/13, vendimi i 7 shkurtit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, *prima facie*, qartazi e *p*abazuar.

Parashtruesi pretendon se aktgjykimi i kontestuar përbën shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit], të nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe i Instrumenteve Ndërkombëtare], të nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës "t'i vlerësojë shkeljet nga autoritetet publike" në aktgjykimet e kontestuara dhe "të njëjtit të anulohen si jokushtetuese dhe joligjore".

Gjykata nuk mund të gjejë argumente dhe dëshmi se Aktgjykimi i kontestuar, Ac. nr. 4952/2012, i Gjykatës së Apelit të Kosovës, i 27 majit 2013, është nxjerrë në mënyrë qartazi të padrejtë dhe arbitrare.

Gjykata konkludon se parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe protokollet e tij ose me Deklaratën Universale për të Drejta të Njeriut.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 7 shkurt 2014, njëzëri deklaron se kërkesa është e papranueshme dhe qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI220/13
Parashtrues
Hysen Çeku
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Ac. nr. 4952/2012, të Gjykatës së Apelit të Kosovës,
të 27 majit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Hysen Çeku, nga fshati Fusha e Pejës, komuna e Pejës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), i përfaqësuar nga z. Bashkim Latifi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi Ac. nr. 4952/2012, i Gjykatës së Apelit të Kosovës, i 27 majit 2013, me të cilin refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetohet Aktgjykimi C. nr. 297/12, i Gjykatës Komunale në Pejë, i 4 dhjetorit 2012. Aktgjykimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtruesit më 5 nëntor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e parashtruesit, të garantuara me nenin 3 (Barazia para Ligjit), me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe i Instrumenteve Ndërkombëtare], me nenin 24 [Barazia para Ligjit]

dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) dhe me Deklaratën Universale për të Drejta të Njeriut, pa i saktësuar nenet konkrete të këtyre dy dokumenteve.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 5 janar 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kueshtetuese.

6. Më 8 janar 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy, Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 6 shtator 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 7 shkurt 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Pejë, duke kërkuar nga Drejtoria e Arsimit të Komunës së Pejës që t'ia paguajë parashtruesit një shumë të caktuar me rastin e pensionimit të tij.

10. Më 4 dhjetor 2012, Gjykata Komunale, me Aktgjykimin C. nr. 297/12, e refuzoi kërkesëpadinë si të pabazuar. Ky aktgjykim nuk i është bashkëngjitur kërkesës.

11. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, për shkak të *"shkeljeve* thelbësore *të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale"*.

12. Më 27 maj 2012, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin Ac. nr. 4952/2012, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar se *"kontrata e përgjithshme kolektive është lidhur dhe e njëjta fillon të zbatohet që nga 1 2005, sikurse* është *përcaktuar me nenin 64 të kontratës. Në bazë të nenit 43 punëtori ka të drejtë në shpërblimin jubilar për 10 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit vlerën e një page bazë, për 20 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit vlerën e një page bazë"*.

13. Për më tepër, Gjykata e Apelit deklaroi se "*në bazë të nenit 90, par. 4 të Ligjit të punës* saktësisht *përcaktohet se Marrëveshja kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3 vjet, ndërsa në bazë të paragrafit 5 të Ligjit të njëjte Marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen kolektive"*.

14. Përfundimisht, Gjykata e Apelit konkludoi se "*Në rastin konkret, është vërtetuar bindshëm* dhe *sigurt se kontrata e përgjithshme kolektive ka skaduar më 1 janar 2008 dhe më tutje nuk është vazhduar, kështu që nuk prodhon efekt juridik në këtë çështje konkrete"*.

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi pretendon se aktgjykimi i kontestuar përbën shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit], të nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe i Instrumenteve Ndërkombëtare], të nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

16. Parashtruesi pretendon se, *"Në rastin konkret, gjykatat, e kanë ngatërruar bazën* juridike *të kërkesëpadisë duke e trajtuar si kategori në proceduarat për realizimin e të drejtave nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/35 mbi pensionet në Kosovë, sepse baza juridike e kërkesëpadisë është në të drejtat e punëtorëve të cilat bazohen në dispozitën e nenit 55.1 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës"*.

17. Për më tepër, parashtruesi pretendon se "*gjykatat është dashur të gjykojnë pa asnjë ndikim, duke e respektuar hierarkinë e akteve juridike, e cila përcaktohet me dispozitën e nenit 4 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, të cilat paraqesin burim të* drejtave *të punëtorëve të cilat janë: Ligji i Punës, Kontrata Kolektive, Akti i*

Brendshëm i Punëdhënësit dhe Kontrata e Punës, e të cilat duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit të punës".

18. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës *"t'i vlerësojë shkeljet nga autoritetet publike"* në aktgjykimet e kontestuara dhe *"të njëjtit të anulohen si jokushtetuese dhe joligjore".*

Pranueshmëria e kërkesës

19. Para së gjithash, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmërinë e kërkesës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *(...)*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

21. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".*

22. Gjykata konsideron se, duke i marrë parasysh këto dispozita ligjore, parashtruesi është palë e autorizuar, se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj dhe e ka dorëzuar kërkesën në afatin e paraparë ligjor.

23. Megjithatë, Gjykata gjithashtu duhet të marrë parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar (...)".*

24. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 36, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

(c) kërkesa është qartazi e bazuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...],

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...], ose

(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

25. Parashtruesi i kërkesës nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e pranueshmërisë, pasi që kërkesa është qartazi e pabazuar.

26. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesi e kontestoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë në Gjykatën e Apelit, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Tani, ai e konteston aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Gjykatën Kushtetuese, sepse aktgjykimi i kontestuar e kishte shkelur të drejtën e tij të garantuar për barazi para ligjit dhe mbrojtjen gjyqësore të të drejtave.

27. Në fillim, Gjykata rikujton se, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi i kërkesës duhet të ngrejë shkeljen e pretenduar kushtetuese në gjykatat e rregullta që në radhë të parë të sigurojë respektimin e të drejtave themelore të mishëruara në Kushtetutë.

28. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk e kishte ngritur në Gjykatën e Apelit shkeljen e pretenduar kushtetuese të së drejtës së tij të garantuar për barazi para ligjit dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

29. Ndërkohë, Gjykata përkujton se Gjykata e Apelit e kishte refuzuar ankesën e tij, sepse "*kontrata e përgjithshme kolektive ka skaduar me 1 janar 2008 dhe më tutje nuk është vazhduar, kështu që nuk*

prodhon efekt juridik në këtë çështje konkrete". Sidoqoftë, parashtruesi nuk sqaron saktësisht pse dhe si vendimi i tillë ia kishte shkelur atij të drejtën e barazisë para ligjit dhe mbrojtjen gjyqësore.

30. Për më tepër, Gjykata konsideron se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ka dhënë arsyetim të gjerë dhe të plotë të fakteve të çështjes dhe konstatimet e tij ligjore janë të arsyetuara mirë dhe të qarta në përgjigjen ndaj pretendimit të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës. Prandaj, Gjykata konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

31. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28, shih gjithashtu rastin Nr. KI70/11, parashtrues Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

32. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë që procedurat në përgjithësi dhe të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese ka pasur gjykim të drejtë (shih, ndër të tjera, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

33. Si përmbledhje, Gjykata nuk mund të gjejë argumente dhe dëshmi se Aktgjykimi i kontestuar, Ac. nr. 4952/2012, i Gjykatës së Apelit të Kosovës, i 27 majit 2013, është nxjerrë në mënyrë qartazi të padrejtë dhe arbitrare.

34. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe protokollet e tij ose me Deklaratën Universale për të Drejta të Njeriut.

35. Nga kjo rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe si e tillë e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 7 shkurt 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI51/13, Shemsi Haliti, Aktvendim i datës 11 mars 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 113/2010, të 19 dhjetorit 2012

Rasti KI 51/13, vendim i 11 marsit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, cenim i të drejtave dhe lirive kushtetuese neni 46, kërkesa e papranueshme.

Parashtruesi ka paraqitur kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese janë cenuar me aktgjykimet e gjykatave të rregullta të të gjitha shkallëve. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese, që të vlerësojë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të dy aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët, me të cilat I janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut në mbrojtjen e pronës së paluajtshme, si pasojë e mosgjykimit të paanshëm, respektivisht si pasojë e moszbatimit të drejtë të dispozitave material, që është e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.

Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se, gjatë shqyrtimit të rastit të gjykatave të rregullta u mungonte paanshmëria ose që procedurat ishin në ndonjë mënyrë të padrejta. Fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih, rastin Mezotur-Tiszasugi Tarsulat kundër Hungarise, Nr. 5503/02, Vendimi i 26 korrikut 2005).

Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit nuk kanë qenë të mbështetura me prova dhe argumente bindëse dhe duhet të shpallen si qartazi të pabazuara, ne pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores se punës. Për arsyet e theksuara më lart, kërkesa është e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI51/13
Parashtrues
Shemsi Haliti
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 113/2010, të 19 dhjetorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Shemsi Haliti nga Prishtina, i cili përfaqësohet nga avokati z. Gjuran Q. Dema.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), Rev. nr. 113/2010, të 19 dhjetorit 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 1 shkurt 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së parashtruar në Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 113/2010, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit, i është cenuar e drejta e pronës, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 28 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 8 prill 2013, Gjykata Kushtetuese pranoi kërkesën e parashtruar nga parashtruesi dhe e regjistroi atë me nr. KI51/13.

6. Më 10 prill 2013, Sekretariati i Gjykatës njoftoi përfaqësuesin juridik të parashtruesit lidhur me regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi të dorëzonte në Gjykatë autorizimin me shkrim për përfaqësimin e parashtruesit në Gjykatën Kushtetuese.

7. Më 16 prill 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI51/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI51/13, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović (anëtar) dhe Enver Hasani (anëtar).

8. Më 18 prill 2013, përfaqësuesi juridik i parashtruesit dorëzoi në Gjykatë autorizimin me shkrim të kërkuar nga Gjykata më 10 prill 2013.

9. Më 11 mars 2014, Kryetari i Gjykatës, i kërkoi Gjykatës në përbërje të plotë përjashtimin e tij nga gjykimi i këtij rasti. Të njëjtën ditë, Zëvendëskryetari i Gjykatës, e hodhi në votim kërkesën e Kryetarit për përjashtimin e tij dhe zëvendësimin e tij si anëtar i Kolegjit shqyrtues. Me vota unanime Gjykata e miratoj kërkesën e Kryetarit të Gjykatës për përjashtim dhe po ashtu me vota unanime u mor vendim që në vend të Kryetarit të Gjykatës, të emërohet gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi anëtare e Kolegjit shqyrtues.

10. Më 11 mars 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 1 korrik 1989, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontratë mbi dhuratën me babanë e tij H. H.

12. Me këtë kontratë, H. H. në cilësinë e dhuratëdhënësit, i cili është pronar i parcelës kadastrale NK. Nr. 9606 me sipërfaqe prej 0.009.35 ha, të përbërë prej: shtëpisë me sipërfaqe prej 0.00,36 ha; oborrit me sipërfaqe prej 0.05,00 ha; dhe pemishtes me sipërfaqe prej 0.03,49 ha, të evidentuara në fletën poseduese nr. 3169, ia dhuroi parashtruesit, në cilësinë e dhuratëmarrësit 1/3 e sipërfaqes së përgjithshme, pa kurrfarë kompensimi.

13. Në një datë të panjohur gjatë vitit 1990, parashtruesi ka bërë regjistrimin e parcelës kadastrale nr. 9606 në emër të tij, në regjistrin e Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi në Prishtinë.

14. Më 26 shkurt 1990, Sekretariati për Urbanizëm, për Punë Komunale dhe Banesore i Komunës së Prishtinës nxjerr Aktvendimin 07 nr. 351-846, me të cilin i lejohet ndërtimi i shtëpisë individuale në P+1 në themelet e vjetra me zgjerim dhe dislokim.

15. Më 26 tetor 1990, parashtruesi lidhi kontratë me Bashkësinë Vetëqeverisëse të Interesit për qeverisjen e tokës ndërtimore në Prishtinë, me të cilën parashtruesit i është dhënë leja e rregullimit të tokës ndërtimore për ndërtim individual në dimensionet e përshkuara në aktvendimin për dhënien e lejes për ndërtim.

16. Më 15 qershor 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin C. nr. 3147/2004, me të cilin aprovoi kërkesën e paditësve: Xh. K., K. Z., Z. P., N. S., N. H., A. S., N. H., K. B., i S. Z., (trashëgimtarë të të ndjerit H. H.) për vërtetimin e të drejtave pronësore lidhur me parcelën NK. Nr. 9606, dhe theksoi se: *"paditësit janë bashkëpronarë të 1/3 së pjesës ideale të parcelës kadastrale nr. 6909, vendi i quajtur „R. Gajdiku" , me kulturë shtëpi, oborr dhe pemishte sipas fletës poseduese 3169, zona kadastrale Prishtinë, kurse paditësi R. H. është pronar i 1/3 së pjesës ideale të kësaj ngastre kadastrale".*

17. Në po të njëjtin aktgjykim, Gjykata Komunale në Prishtinë aprovoi pjesërisht kërkesën e parashtruesit (në cilësinë e kundërpaditësit) dhe vërtetoi se parashtruesi është pronar i 1/3 së pjesës ideale të pronës së lartpërmendur, të cilën e ka fituar me anë të kontratës së dhuratës.

18. Në arsyetimin e aktgjykimit, Gjykata Komunale thekson se në bazë të dëshmive të prezantuara, dëgjimit të dëshmitarëve, shikimit të regjistrave kadastralë dhe ekspertizës së ekspertit gjeodet, erdhi në

përfundim: *"se palujtshmëritë kontestuese janë ndarë në tri pjesë të barabarta nga i ati i palëve ndërgjyqëse, përkatësisht nga ish-pronari, tani i ndjeri H. H., ashtu që 1/3 pjesë ideale u është ndarë paditësit R. H. dhe të paditurit Shemsi Haliti, kurse 1/3 pjesë u është ndarë motrave të të përmendurve, përkatësisht paditëseve".*

19. Gjithashtu, Gjykata Komunale vlerësoi se: *"nuk ka kurfarë rëndësie për të drejtat pronësore të paditësve në pjesët e paluajtshmërive lëndore të cilat u janë ndarë me marrëveshjen e cekur më sipër as fakti se e tërë kjo paluajtshmëri në librat kadastralë evidencohet në emër të të paditurit. Kjo për faktin sepse nga provat e administruara, përkatësisht nga deponimet e paditësve dhe nga kontrata për dhurimin e lidhur ndërmjet të ndjerit H. H. dhe të paditurit rezulton se këtij të fundit i ka takuar vetëm 1/3 pjesë ideale e paluajtshmërisë kontestuese, nga çka rezulton se regjistrimi i pjesës tjetër të paluajtshmërive lëndore në emër të të paditurit nuk ka bazë juridike".*

20. Brenda afatit ligjor, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut, kundër Aktgjykimit C. nr. 3147/2004, të 15 qershorit 2007.

21. Më 4 shkurt 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin Ac. nr. 478/2008, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, derisa e konfirmoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

22. Në arsyetimin e aktgjykimit të saj, Gjykata e Qarkut në Prishtinë theksoi se: *"Sipas vlerësimit të kolegjit, thëniet ankimore të të paditurit lidhur me atë se aktgjykimi ankimorë është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë sikundër u theksua më lartë ka vërtetuar faktin se paditësit në njërën anë dhe kundërpaditësi – i padituri në anën tjetër, mbi bazën e marrëveshjes së arritur me të ndjerin H. H. e kanë fituar të drejtën e bashkëpronësisë në paluajtshmërinë kontestuese [...] dhe në situatën konkrete gjykata e shkallës së parë drejtë i ka zbatuar dispozitat e nenit 13 al. 1 dhe 14 al. 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet Pronësore Juridike Bazë, i cili ka qenë i zbatueshëm në kohën e marrjes së aktgjykimit ankimor".*

23. Brenda afatit ligjor, parashtruesi ka ushtruar revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit Ac. nr. 478/2008 të Gjykatës së Qarkut, për shkak të shkeljes së pretenduar të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit për procedurë kontestimore.

24. Më 19 dhjetor 2012, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 113/2010, me të cilin e refuzon si të pabazuar revizionin e parashtruesit.

25. Në arsyetimin e aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme thekson se: *" gjykatat e instancës më të ultë, drejtë kanë vlerësuar se paditësve – kundër të padituve u takojnë 2/3 e pjesës ideale të ngastrës kadastrale nr. 6906, derisa të padituri-kundërpaditësit 1/3 e pjesës ideale, ashtu siç me marrëveshjen gojore janë marrë vesh kur paraardhësi i tyre ka bërë ndarjen e kësaj patundshmërie".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pohon se *„Aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë është konfuz dhe i paqëndrueshëm, kurse të instancave më të larta nuk kanë mënjanuar këtë konfuzitet dhe paqartësitë tjera rreth kundërthënjeve në dispozitiv dhe atyre mes dispozitivit dhe arsyerave të tyre. Këto aktgjykime për shkak të mosekzistimit të masave dhe kufijve të paluajtshmërisë kontestuese nuk mund të ekzekutohen dhe si pasojë e kësaj, përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore".*

27. Më tej, parashtruesi i kërkesës insiston se : *"Nga dispozitivi rrjedh se pasuria e përfshirë në kontratën për dhurim është kthyer në masë trashëgimore, kurse kontrata ka ngelur edhe më tej në fuqi, ngase nuk është vendosur për anulimin e saj. Kjo shkelje procedurale me shkeljet tjera ligjore të paraqitura në këtë kërkesë e bën aktgjykimin e formës së prerë absolutisht të paekzekutueshëm".*

28. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se *„ me aprovimin e kërkesës së tij do të eliminohen të gjitha lëshimet në aktgjykimet e shënuara, që kanë të bëjnë me shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, me çka në rastin konkret do të vërtetohet se ankuesit me aktgjykimet e përmendura i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut, respektivisht e drejta e pronësisë të pasurisë së paluajtshme, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 46".*

29. Më tutje, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese, që: *"të vlerësojë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër dhe datë të shënuar dhe dy aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët, me të cilat i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut në mbrojtjen e*

pronës së paluajtshme, si pasojë e mosgjykimit të paanshëm, respektivisht si pasojë e moszbatimit të drejtë të dispozitave materiale".

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka plotësuar të gjitha kriteret e pranueshmërisë, siç janë përcaktuar me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të përcaktojë në mënyrë të veçantë nëse parashtruesi i ka plotësuar kushtet e parapara me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) të Rregullores së punës.

32. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

> *„Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

33. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

34. Përveç kësaj, neni 48 i Ligjit gjithashtu përcakton se:

> *„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

35. Për më tepër, rregulli 36 (2) i Rregullores së punës parasheh që:

> *„(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*
>
> *[...], ose*

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

36. Në këtë drejtim, Gjykata përsërit se nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e instancës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Edhe më tutje është domen i gjykatave të rregullta që të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës materiale dhe procedurale (shih, rastin Garcia Ruiz kundër Spanjës, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28).

37. Gjykata, vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë në mënyrë që parashtruesi të ketë pasur një gjykim të drejtë (shih, rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

38. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ka shfrytëzuar mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tij duke kundërshtuar interpretimin e fakteve dhe të ligjit, të cilat i konsideron të padrejta, në gjykatat e rregullta të të gjitha instancave. Megjithatë, Gjykata konstaton se vendimet e gjykatave të rregullta janë të arsyetuara dhe në mënyrë adekuate i përgjigjen në substancë pretendimeve të parashtruesit.

39. Pas shqyrtimit të procedurave gjyqësore në tërësi, Gjykata nuk ka gjetur se procedurat përkatëse kanë qenë në çfarëdo mënyre të padrejta apo arbitrare (shih, rastin Shub kundër Lituanisë, Nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

40. Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se, gjatë shqyrtimit të rastit, gjykatave të rregullta u mungonte paanshmëria ose që procedurat ishin në ndonjë mënyrë të padrejta. Fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih, rastin Mezotur-Tiszasugi Tarsulat kundër Hungarisë, Nr. 5503/02, Vendimi i 26 korrikut 2005).

41. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit nuk kanë qenë të mbështetura me prova dhe argumente bindëse dhe duhet të shpallen si qartazi të pabazuara, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës.

42. Rrjedhimisht, për arsyet e theksuara më lart, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d), si dhe rregullin 56 (2) të Rregullores, më 11 mars 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI92/14, Fidaie Bytyqi, Aktvendim i datës 2 korrik 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. E. nr. 1/2014, të 12 shkurtit 2014

Rasti KI92/14, vendimi i 2 korrikut 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesja e kërkesës ka pretenduar se aktgjykimi i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën e mbrojtjes së pronës si [neni 31 dhe 46 i Kushtetutës dhe të drejtën për një proces të rregullt dhe të mbrojtjes së pronës sipas Konventës, neni 6, dhe neni 1 i Protokollit 1 të Konventës].

Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës vetëm e ka potencuar shkeljen e Kushtetutës dhe të Konventës, por nuk ka ofruar prova për mënyrën dhe natyrën e shkeljeve të pretenduara. Gjykata konsideron se vetëm përshkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës dhe pretendimi se ato janë shkelur, pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, pa i përcaktuar rrethanat, pa i specifikuar veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me gjykimin e drejtë e të paanshëm, nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të Konventës lidhur me një proces të rregullt dhe të paanshëm.

Gjykata gjen se faktet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e së drejtës kushtetuese dhe nuk mund të konkludohet se kërkesa është e bazuar dhe, prandaj, në pajtim me rregullin 36 paragrafi 2 pika b, gjeti se kërkesa duhet të refuzohet si qartazi e pabazuar dhe te deklarohet e papranueshme.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 2 korrik 2014, njëzëri deklaron se kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI92/14
Parashtrues
Fidaie Bytyqi
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. E. nr. 1/2014, të 12 shkurtit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Fidaie Bytyqi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës) nga Malisheva, pronare e NNP "Shkoza F07", me seli pune në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Nezir Bytyqi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. E. nr. 1/2014, i 12 shkurtit 2014, të cilin parashtruesja e kërkesës e ka pranuar më 26 mars 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme për të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon se ia ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Kosovës, sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], si dhe nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] dhe nenit 1 të Protokollit 1 [Mbrojtja e Pronës] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 maj 2014, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 10 qershor 2014, me Vendimin Nr. GJR. KI92/14, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues, dhe të njëjtën ditë caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 11 qershor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe Qeverinë e Kosovës-Ministrinë e Infrastrukturës, për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 11 qershor 2014, Gjykata Supreme u njoftua për regjistrimin e kërkesës dhe iu dërgua një kopje e kërkesës.

9. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi me shkrim Gjykatën për përjashtimin e tij nga seancat shqyrtuese, për periudhën qershor – korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë, lidhur me pretendimet e ngritura ndaj tij.

10. Më 2 korrik 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 15 tetor 2009, NNP "Shkoza F07", ndërmarrja private, pronare e së cilës është parashtruesja e kërkesës, ka lidhur kontratën nr. MTPT 9/087511 me Ministrinë e Transportit dhe të Postë-Telekomit (në tekstin e mëtejmë: MTPT, tani e transformuar si Ministria e Infrastrukturës) për kryerjen e punëve: asfaltim i rrugëve lokale Dubovc-Beqiq-Skënderaj-Vushtrri. Pas përfundimit

të punëve të parapara me kontratë, punëkryesit do t'i paguhej shuma monetare e specifikuar në kontratë.

12. Sipas parashtrueses së kërkesës, gjatë ekzekutimit të punëve në terren, është paraqitur nevojë urgjente për punë shtesë, të kërkuara nga menaxheri i projektit, dhe këto punë janë evidencuar në librin e ndërtimeve dhe janë pranuar nga komisioni i themeluar nga sekretari i MTPT-së, ndërsa edhe pse punët shtesë janë përfunduar, nuk janë paguar nga ministria përkatëse përkundër disa kërkesave të parashtrueses.

13. Më 19 tetor 2010, parashtruesja e kërkesës, në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, ka ngritur padi kundër Qeverisë së Kosovës – MTPT-së, për pagesën e borxhit në emër të kryerjes së punëve shtesë.

14. Më 14 dhjetor 2010, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin I. C. nr. 384/2010, me të cilin aprovoi kërkesë padinë e parashtrueses dhe e obligoi të padituren, Qeverinë e Kosovës – MTPT-në, Prishtinë, që paditësit në emër të borxhit t'ia paguajë shumën prej 46.455,10€, me kamatë vjetore në lartësi prej 3,5% duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.
15. Në arsyetimin e aktgjykimit, ndër të tjera, Gjykata Ekonomike ka theksuar:

> "*Punimet janë kryer me urdhrin e organit mbikëqyrës i cili i ka pranuar te gjitha punimet shtese bazuar ne nenin 8.4 te Kontratës Baze. Përveç kësaj pala ka deklaruar se punimet nuk kane filluar pa nënshkrimin e organit mbikëqyrës dhe pas nënshkrimit nga organi mbikëqyrës punimet shtesë janë kryer, te njëjtat janë pranuar nga komisioni aprovues MTPT*"... dhe më tej në aktgjykim është theksuar se "*Gjykata konkludon se zbatuesit mund ti kryejnë punimet e paparashikuara edhe pa pëlqimin paraprak te porositësit në qoftë se për shkak të urgjencës se tyre nuk ka pasur mundësi te merr ketë pëlqim, neni 634 te LMD-se*".

16. Më 9 tetor 2013, Gjykata e Apelit duke vendosur sipas ankesës së Qeverisë së Kosovës – MTPT-së, ka nxjerrë Aktgjykimin Ac. nr. 159/2012, me të cilin refuzoi si të pabazuar ankesën e së padituresë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, I. C. nr 384/2010, i 14 dhjetorit 2010, është vërtetuar.

17. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit, në mes tjerash, ka konstatuar:

> *"Gjykata e Apelit e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës se parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë te plotë gjendjen faktike drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur kur kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Aktgjykimi i goditur sipas vlerësimit te kësaj gjykate nuk përmban shkelje thelbësore të procedurës kontestimore për te cilat, kjo gjykate sipas nenit 194 te LPK, kujdeset sipas detyrës zyrtare".*

18. Më 12 shkurt 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas revizionit të parashtruar nga MTPT-ja, ka nxjerrë Aktgjykimin Rev. E. nr. 1/2014, me të cilin revizionin e parashtruar e ka pranuar si të bazuar dhe ka vendosur që të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 159/2012, të 9 tetorit 2013, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, C. nr. 384/2010, të 14 dhjetorit 2010, duke e refuzuar si të pabazuar padinë e parashtrueses lidhur me kërkesën për pagesën e borxhit në emër të punëve të kryera shtesë.

19. Në arsyetimin e aktgjykimit, Gjykata Supreme ka theksuar:

> *"Gjykata Supreme e Kosovës, pranoi si te bazuara pretendimet e revizionit përkitazi me zbatimin e gabuar te se drejtës materiale, me qe gjykatat e shkalles me te ulet gabimisht kane pranuar si te bazuar kërkesëpadinë e paditësit, për faktin se paditësi nuk ka vepruar ne kuptim te nenit 633 te LMD, i aplikueshëm sipas nenit 1057 te LMD tani ne fuqi prej datës 20.12.2012, meqë sipas kësaj dispozite juridike është parapare se për çdo largim nga kontrata, zbatuesi, këtu paditësi, duhet te merr pëlqimin me shkrim të porositësit dhe ai nuk mund te kërkojë asnjë ngritje te shpërblimit të kontraktuar për punimet qe i ka kryer pa pëlqimin e porositësit te punës".*

20. Gjykata Supreme, në aktgjykimin e revizionit, më tej, ka arsyetuar:

> "*Andaj, duke u bazuar në dispozitën ligjore te larte përmendur, dhe ne faktin se paditësi nuk e ka informuar te padituri me kohe dhe ne forme te shkruar për nevojën e kryerjes se punëve shtese ne njërën anë, ne mënyrë që lidhur me atë punë te merren vesh dhe eventualisht te lidhin ndonjë aneks kontratë, dhe se ne rastin konkret nuk është fjala për punimet urgjente te paparashikuara nga neni 634 i LMD".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesja e kërkesës ka pretenduar se aktgjykimi i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën e mbrojtjes së pronës si [neni 31 dhe 46 i Kushtetutës dhe të drejtën për një proces të rregullt dhe të mbrojtjes së pronës sipas Konventës, neni 6, dhe neni 1 i Protokollit 1 të Konventës].

22. E drejta për proces të rregullt, sipas tij, i është shkelur, meqë Gjykata Supreme e ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale duke aplikuar Ligjin për marrëdhëniet detyrimore në vend të Ligjit për prokurimin publik që është një *Lex Specialis* për këtë lëmë, ndërsa si pasojë e këtij veprimi të Gjykatës, parashtrueses i është mohuar e drejta në pronë, sepse ai ka pasur një "pritje legjitime" të pronës në bazë të punëve të kryera. Parashtruesja, lidhur me këtë i është referuar edhe Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese për rastin KI40/09, *Ibrahimi dhe 48 ish-punëtorë tjerë të KEK-ut*, ku sipas saj, Gjykata ka gjetur shkelje të së drejtës në pronë.

23. Parashtruesja ka kërkuar nga "*Gjykata Kushtetuese qe te vendos për shpalljen e pavlefshme te Aktgjykimit te Gjykatës Supreme Rev. E. nr. 1/2014, dhe te ia kthej atë Gjykatës Supreme për te vendosur ne baze te shkeljeve te evidentuara dhe te gjeturave nga Gjykata Kushtetuese"*.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Për të gjykuar mbi kërkesën e parashtrueses, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

25. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

26. Gjykata vëren që parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. E. nr. 1/2014, të 12 shkurtit 2014, me të cilin iu pranua si i bazuar revizioni i MTPT-së, ndërsa u refuzua si e

pabazuar padia e parashtruesit të kërkesës për kompensim të borxhit të kërkuar nga MTPT-ja.

27. Gjykata më tej konstaton se parashtruesja pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, sikurse janë specifikuar në parag. 20 të këtij raporti, të cilat kanë këtë përmbajtje:
Neni 31 i Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronësisë është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk mund te privohet nga prona në mënyrë arbitrare. Republika, e Kosovës apo autoriteti publik i Republikës se Kosovës mund të shpronësojë pronën nëse shpronësimi i tillë është i autorizuar me ligj, është i domosdoshëm apo i përshtatshëm për arritjen e një qëllimi publik apo promovimin e interesit publik, si dhe përcillet me ofrimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat te personit apo personave, prona e të cilëve është shpronësuar.

Dhe, neni 6.1 i Konventës:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme...në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile".

Neni 1 i Protokollit Nr. 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut parasheh:

> *"Secili person fizik apo juridik ka të drejtë të gëzojë posedimet* e *tij në mënyrë të qetë. Askush nuk mund të privohet nga posedimet* e *tij/saj përveq për interes publik si dhe duke iu nënshtruar kushteve* të *përcaktuara* me *ligj, si dhe* me *parimet* e *përgjithshme të se drejtës ndërkombëtare.*
>
> *Megjithatë, dispozitat paravajtëse nuk do të pengojnë ne asnjë mënyrë të drejtën* e *shtetit qe të zbatojë ligje qe i konsideron te domosdoshme për kontrollimin e shfrytëzimit te pronës ne pajtim* me *interesin* e *përgjithshëm, apo për të siguruar pagesën e tatimeve apo kontributeve* e *dënimeve tjera".*

28. Duke shqyrtuar pretendimet e parashtrueses, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës vetëm e ka potencuar shkeljen e Kushtetutës dhe të Konventës, por nuk ka ofruar prova për mënyrën dhe natyrën e shkeljeve të pretenduara. Gjykata konsideron se vetëm përshkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës dhe pretendimi se ato janë shkelur, pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, pa i përcaktuar rrethanat, pa i specifikuar veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me gjykimin e drejtë e të paanshëm, nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të Konventës lidhur me një proces të rregullt dhe të paanshëm.

29. Gjykata gjeti se në të gjitha fazat e procesit gjyqësor, ankesat e parashtrueses së kërkesës kanë qenë të karakterit ligjor dhe asnjëherë e në asnjë fazë të natyrës kushtetuese apo të shkeljes eventuale të të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë, të cilat për herë të parë janë ngritur në Gjykatën Kushtetuese, gjë që Gjykatën e shpien të konkludojë se në të vërtetë parashtruesja është e pakënaqur me rezultatin përfundimtar të gjykimit të rastit të saj.

30. Zbatimi i ligjit të aplikueshëm dhe konstatimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike në një rast civil para një gjykate të rregullt është kompetencë e plotë dhe e padiskutueshme e po asaj gjykate dhe në rastin konkret, Gjykata Supreme qartë kishte konstatuar se "*për çdo largim nga kontrata, zbatuesi, këtu paditësi, duhet te merr pëlqimin me shkrim të porositësit dhe ai nuk mund të kërkojë asnjë ngritje te shpërblimit të kontraktuar për punimet qe i ka kryer pa pëlqimin e porositësit te punës".* Prandaj, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të ndërhyjë në këtë kompetencë dhe

në rrethana kur kontestohet aplikimi i ligjit në rastin konkret, Gjykata nuk mund të gjejë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës apo të nenit 6 të KEDNJ-së.

31. Gjykata më tej konstaton se pretendimi i parashtrueses së kërkesës për ngjashmërinë e rastit KI40/09 të Gjykatës me rastin e saj nuk është i bazuar, sepse në rastin KI40/09 Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme gabimisht ishte mbështetur në një ligj, i cili në të vërtetë nuk ishte nxjerrë asnjëherë dhe gjeti se fondi pensional dhe invalidor, nuk ishte themeluar asnjëherë. Ky veprim i Gjykatës Supreme e bënë aktgjykimin arbitrar, sepse ky ishte fakti thelbësor nga i cili varej pritshmëria legjitime për kompensimin material të parashtrueses së kërkesës. Për dallim nga kjo, në rastin e parashtrueses së kërkesës, Gjykata ka aplikuar një ligj ekzistues dhe ka vepruar në pajtim të plotë me kompetencën e vet kushtetuese dhe ligjore. Andaj, nuk mund të bëhet fjalë për asnjë lloj arbitrariteti në rastin e parashtrueses së kërkesës dhe rrjedhimisht as për shkelje të së drejtës në pronë.

32. Gjykata rithekson se ajo nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve, nuk gjykon si gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk është thjesht një instancë më e lartë gjyqësore. Për Gjykatën janë thelbësore çështjet prej ekzistimit të të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të të drejtave kushtetuese dhe jo çështjet qartazi ligjore që kryesisht kanë qenë fakte të paraqitura nga parashtruesja e kërkesës (shih, *mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë,* 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

33. Gjykata rikujton se në rastin KI53/14, të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës NTP "Llabjani" në rrethana të ngjashme, me objekt të njëjtë shqyrtimi, Gjykata vendosi për papranueshmërinë e kërkesës (shih Aktvendimin për papranueshmëri KI53/14, 7 korrik 2014).

34. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë që të ngrenë një kërkesë të argumentuar për shkelje të dispozitave të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis,*

Aktgjykimi i GJEDNJ-së, kërkesa Nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* ose aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, rasti KI128/12, i 12 korrikut 2013, të parashtruesit *Shaban Hoxha,* në kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011).

35. Në këto rrethana, Gjykata gjen se faktet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e së drejtës kushtetuese dhe nuk mund të konkludohet se kërkesa është e bazuar dhe, prandaj, në pajtim me rregullin 36 paragrafi 2 pika b, gjeti se kërkesa duhet të refuzohet si qartazi e pabazuar dhe të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 2 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI84/14, Arlind Kaçaniku, Aktvendim i datës 16 shtator 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 18/2014, të 3 shkurtit 2014

Rasti KI84/14, vendimi i 16 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, marrëdhënia e punës, qartazi e pabazuar.

Aktvendimin e Gjykatës Supreme, të 3 shkurtit 2014, me te cilin revizioni i parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit ishte refuzuar si i pabazuar. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike i kërkoi Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse gjykatat e rregullta mund të zbatojnë një ligj të miratuar pas 1989, veçanërisht në rastet kur marrëdhënia e punësimit është e mbuluar nga legjislacioni tjetër në fuqi i Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese konsideron se çështja e ngritur nga parashtruesi i kërkesës është çështje e ligjshmërisë, jo e kushtetutshmërisë.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar sepse faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të të drejtave kushtetuese në të cilat thirret ai dhe ai nuk e ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI84/14
Parashtrues
Arlind Kaçaniku
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 18/2014, të 3 shkurtit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Arlind Kaçaniku me vendbanim në Prizren, i cili përfaqësohet nga z. Ymer Koro, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 18/2014, i 3 shkurtit 2014, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 21 mars 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit, Rev. nr. 18/2014 të Gjykatës Supreme, të 3 shkurtit 2014, me të cilin revizioni i parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit (Ac. nr. 373/2013, i 11 shtatorit 2013) ishte refuzuar si i pabazuar. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 maj 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI84/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI84/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 17 qershor 2014, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën e Apelit.

8. Më 16 shtator 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

9. Duke filluar nga 25 shtatori 2000, parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar për periudhë të pacaktuar në Institucionin Mikrofinanciar "FINCA-KOSOVË" në Prizren (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi).

10. Më 25 qershor 2010, në bazë të vërejtjes së dhënë nga Komisioni Disiplinor, punëdhënësi kishte nxjerrë vendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës, me hyrje në fuqi nga data 30 qershor 2010.

11. Më 26 gusht 2010, kundër Vendimit të lartcekur të punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prizren.

12. Më 22 tetor 2012, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktvendimin C. nr. 598/2010, e hodhi poshtë padinë e parashtruesit si të pasafatshme.

13. Gjykata Komunale, bazuar në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të ligjit në fuqi, në Aktvendimin e saj vërtetoi se:

> *"Nga provat e administruara të cilat gjenden në shkresat e lëndës, është vërtetuar se paditësit i është shqiptuar vërejtja nga ana e të padituërs me datën 18.06.2010 (vërejtje kjo e cila parasheh se data efektive e ndërprerjes së marrëdhënies së punës është 30.06.2010, dhe e njëjta i është dërguar paditësi me datën 25.06.20 10, çka shihet nga flete dërgesa e PTK-së), ndërsa vendimit për shkëputjen e kontratës së punës është marr me datën 30.06.2010 (datë kjo e përmendur edhe nga vet paditësi në padi), lajmërim të cilin paditësi e ka pranuar një ditë më vonë përmes postës (fakt ky i cili është vërtetuar me anë të fletë dërgesës së postës). Ndërsa paditësi padinë e ka parashtruar me datën 26.08.2010. Nga shkresat e lëndës shihet çartë se prej vendimit efektiv për shkëputjen e marrëdhënies së punës kanë kaluar 56 ditë. Pra padia është parashtruar në gjykatë pas kalimit të afatit ligjor prej 45 ditësh […]".*

14. Si rrjedhojë e ankesës kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin Ac. nr. 373/2013, e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktvendimin C. nr. 598/2010, të 22 tetorit 2010, të Gjykatës Komunale në Prizren.

15. Kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës, me pretendimin për shkelje esenciale të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

16. Më 3 shkurt 2014, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit të saj Rev. nr. 18/2014 e refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

17. Gjykata Supreme, po ashtu duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi, gjeti dhe konfirmoi se:

> *"Sipas nenit 83 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga marrëdhënia e punës është parashikuar që punëtori i*

pakënaqur me vendimin definitiv të organit kompetent në organizate, apo nëse ky organ nuk merr vendim ne afat prej 30 ditësh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, gjegjësisht kundërshtimit, ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh ta kërkojë mbrojtjen e të drejtave të veta para gjykatës kompetente. Paditësi sipas Ligjit të Punës së Bashkuar dhe Ligjit për të Drejtat Themelore nga marrëdhënia e punës, ka mundur ta kërkojë mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës. Këto ligje kanë qenë në fuqi, për arsye se me Rregulloren e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së nr. 1999/24 (neni 1) janë përcaktuar ligjet që janë në fuqi në Kosovë. Me nenin I pika (b) janë përcaktuar ligjet që kanë qenë në fuqi në Kosovë gjer më 22.3.1989. Ligji i zbatueshëm gjer në vitin 1999, përveç ligjeve tjera ka qenë edhe Ligji i Punës së Bashkuar dhe Ligji për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, të cilat parashikojnë afatin për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve nga marrëdhënia e punës, andaj pretendimin e cekur në revizion se ligjet të cilat i kanë zbatuar gjykatat e instancës më të ulët nuk përmbajnë asnjë dispozitë sa i përket afatshmërisë së padisë, kjo gjykatë e vlerësoi si të pabazuar".

[...]

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitën e nenit 83 të LPTHMP [Ligji për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës], për arsye se ky afat është prekluziv dhe pas skadimit të këtij afati, punëtori e humb të drejtën e mbrojtjes gjyqësore, prandaj padia e paraqitur pas këtij afati doemos duhet të hidhet poshtë si e pasafatshme [...]".

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me arsyetimin si në vijim:

"[...]

Gjykatat të rregullta në rastin konkret padinë e parashtruesit e kanë refuzuar si pas afatshme duke u bazuar në Ligjin për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës të ish RSFJ-së, shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 60/1989 me dt. 08.10.1989, i cili ligj ka hyrë në fuqi pas 8 ditë nga shpallja gjegjësisht me ***14.10.1989.*** *Kjo paraqet shkelje të nenit 1.1 te Rregullores së UNMIK-ut 1999/24. Duhet cekur se neni 1.2 të kësaj Rregulloreje e përcakton mundësinë e zbatimit ndonjë ligji*

edhe pas kësaj date po qe se ky ligj nuk është ligji diskriminues dhe po qe se një çështje ose një situatë nuk mund te mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje. Por në rastin konkret një situate të tillë i përshkruar me nenin 1.2 të kësaj rregulloreje, nuk ka ekzistuar për arsye se kjo çështje (afatshmëria e padisë), është e mbuluar me Ligjin e Punës së Bashkuar (e shpallur në Gazetën Zyrtare të ish RSFJ-se 53/1976). Në të vërtet Gjykata Supreme në vendimin e vet, ka cekur se edhe ky ligj sipas Rregullores 1999/24, është ligji pozitiv, por kjo Gjykatë nuk ka konkretizuar asnjë nen të këtij ligj [...]".

19. Parashtruesi përfundon duke pretenduar se " *[...] gjykatat e rregullta nuk kanë zhvilluar një gjykim të drejte duke zbatuar një ligj jo i zbatueshëm në Kosovë dhe se kjo ka rezultuar që parashtruesi të jetë jashtë mbrojtjes ligjore, e çka paraqet shkelje të neneve 31 dhe 54 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës."*
20. Në fund, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën si në vijim:

"[...] që Gjykata Kushtetuese të deklarohet se a mund të zbatohet një ligj pas datës 22.03.1999 [1989], po qe se ligjet tjera pozitive në Kosovë para kësaj date në lëmin e marrëdhënies së punës veç rregullojnë një çështje juridike (afatshmëria e padisë)".

Pranueshmëria e kërkesës

21. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

23. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(3) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".

(4) "Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.

[...], ose

(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

24. Ashtu siç u cek më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se *[...] gjykatat e rregullta nuk kanë zhvilluar një gjykim të drejtë duke zbatuar një ligj jo i zbatueshëm në Kosovë dhe se kjo ka rezultuar që parashtruesi të jetë jashtë mbrojtjes ligjore, e çka paraqet shkelje të neneve 31 dhe 54 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës." dhe kërkon nga Gjykata " [...] të deklarohet se a mund të zbatohet një ligj pas datës 22.03.1999 [1989], po qe se ligjet tjera pozitive në Kosovë para kësaj date në lëmin e marrëdhënies së punës veç rregullojnë një çështje juridike (afatshmëria e padisë)".*

25. Në këtë rast, Gjykata gjen se çështja e ngritur nga parashtruesi i kërkesës është çështje e ligjshmërisë, jo e kushtetushmërisë.

26. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përfshirë edhe nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

27. Gjykata, po ashtu, ripërsërit se Gjykata Kushtetuese nuk mund ta zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si edhe të asaj materiale (shih rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

28. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit, të cituar në paragrafin 24, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë me Aktvendimin e Gjykatës Supreme është i qartë si dhe mbulon pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës përkitazi me zbatimin e legjislacionit në fuqi në rastin e afatshmërisë së padisë. Gjykata, gjithashtu gjeti që procedurat në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Komunale në Prizren nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

29. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar, për arsye se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese, në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës dhe ai nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me rregullat 36 (2), b) dhe d) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 16 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI73/14, Xhafer Dvorani, Aktvendim i datës 16 shtator 2014- Vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit Ac. nr. 2770/2013 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 17 marsit 2014.

Rasti KI 73/14, vendimi i 16 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: barazia para ligjit, kërkesë individuale, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës, Xhafer Dvorani parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës duke kontestuar Aktvendimin Ac. nr. 2770/2013 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, të 17 marsit 2013 si të nxjerrë në shkelje të të drejtave të parashtruesit të kërkesës për Barazi para Ligjit dhe Mbrojtje Gjyqësore e të Drejtave (nenet 3, 24, dhe 54 të Kushtetutës).

Përkitazi me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Prandaj, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe (2) d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI73/14
Parashtrues
Xhafer Dvorani
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 2770/2013, të 17 marsit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Xhafer Dvorani nga fshati Tërstenik, komuna e Gllogocit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), të cilin e përfaqëson z. Bashkim Latifi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktvendimin Ac. nr. 2770/2013 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), të 17 marsit 2013, i cili i është dorëzuar më 7 prill 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat për *Barazi para Ligjit dhe Mbrojtje Gjyqësore të të Drejtave (nenet 3 dhe 24, dhe neni 54 i Kushtetutës).*

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 prill 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 maj 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 27 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.

8. Më 16 shtator 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 12 gusht 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc (Aktvendimi C. nr. 143/013) e hodhi poshtë si të papranueshme padinë e paditësit përkitazi me dy paga jubilare dhe në emër të dy pagave mujore për përcjellje në pension, me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës, për shkak se "*padia është paraqitur para shterjes së mjeteve të lejuara (...)*".

10. Parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër këtij Aktvendimi për shkak të *"vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare"*.

11. Më 17 mars 2014, Gjykata e Apelit (Ac. nr. 2770/2013) e refuzoi si të pabazuar ankesën e paditësit dhe vërtetoi Aktvendimin e shkallës së parë. Gjykata e Apelit konstatoi se:

"[...] gjykata ka gjet se padia e tillë duhet të hedhet poshtë si e palejueshme në kuptim të dispozitave të nenit 391 pika f) të LPK-së, nga se paditësi nuk i është përmbajtur obligimeve nga neni 78 dhe 79 i Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës. (...) në rastin konkret paditësi nuk i është drejtuar organit kompetent të të paditurës, obligim të cilin paditësi e ka anashkaluar".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi pretendon se i "*janë shkelur të drejtat nga neni 3 (Barazia para Ligjit), neni 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), neni 24 (Barazia para ligjit), neni 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për Mbrojtën e të Drejtave dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj".*

13. Parashtruesi pretendon se *"[...] Gjykatat është dashur të gjykojnë pa asnjë ndikim, duke e respektuar hierarkinë e akteve juridike të cila përcaktohet me dispozitën e nenit 4 të Ligjit nr. 03/1-212 të Punës, të cilat paraqesin burim të drejtave të punëtorëve të cilat janë: Ligji i Punës, Kontrata Kolektive, Akti i Brendshëm i Punëdhënësit dhe Kontrata e Punës dhe të cilat duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit të punës dhe se me dispozitën e nenit 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës punëtorëve i garantohet mbrojtja gjyqësore e të drejtave me të cilën është parë se "Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".*

14. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që *"[...] ta detyroj të paditurën Komunën e Gllogocit - Drejtoratin e Arsimit, në Gllogoc që paditësit t'ia paguaj borxhin në emër të dy pagave jubilare dhe në emër të dy pagave mujore për përcjellje në pension, me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës".*

Pranueshmëria e kërkesës

15. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kërkesat për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit për Gjykatën që parasheh:

> "*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

17. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36 (1) c) dhe (2) d) të Rregullores së punës, që parasheh:

> *"(1)* Gjykata *mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
> *(...) c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".*

> *"(2)* Gjykata *do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: (...) d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

18. Gjykata vëren se parashtruesi ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit "*për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore*" që pretendohet se janë bërë nga gjykata e shkallës së parë. Nuk ishte ngritur asnjë pretendim për shkelje kushtetuese.

19. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar dhe as nuk ka provuar se si dhe përse i janë cenuar të drejtat dhe liritë me vendimin e Gjykatës së Apelit, e cila refuzoi ankesën e tij si të pabazuar dhe vërtetoi vendimin e Gjykatës Themelore.

20. Në të vërtetë, parashtruesi nuk e ka dëshmuar pretendimin për shkelje kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova relevante që tregojnë se të drejtat dhe liritë e tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur me vendimin e kontestuar.

21. Për më tepër, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmëria) që pretendohen të jenë bërë nga Gjykata e Apelit, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Prandaj, nuk është detyrë e Gjykatës që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i këtyre të fundit që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96,

para. 28, Raport i Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

22. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë se procedurat relevante mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë apo se ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* GJEDNJ, Vendimi përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

23. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme, sepse është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe (2) d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) c) dhe (2) d) të Rregullores së punës, më 16 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. Dr. Enver Hasani

KI104/14, Agron Çerreti, Aktvendim i datës 17 shtator 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të paspecifikuara të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës së Apelit dhe i Aktgjykimit P. nr. 88/2012 të Gjykatës Komunale në Gjilan

Rasti KI104/14, vendimi i 17 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest penal, kërkesë qartazi e pabazuar.

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendonte se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me ligjet në fuqi dhe me Kushtetutë, nga arsyet e mëposhtme: 1) se Gjykata e Apelit, me kërkesë të Prokurorisë Komunale të Gjilanit, ndryshoi dënimin me gjobë në shumë prej 700 euro, në dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajsh, edhe pse këtë PKGJ-ja nuk e kishte kërkuar në Gjykatën Komunale; 2) për faktin se Gjykata e Apelit nuk zbatoi nenin 47 të KPPK-së për mundësinë e shndërrimit të dënimit me burg në dënim me gjobë; dhe 3) për faktin se Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë me arsyetimin se parashtruesi dhe mbrojtësi i tij nuk kishin kërkuar të merrnin pjesë në Gjykatën e Apelit për të kërkuar ndryshimin e dënimit.

Sa i përket pretendimit për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, Gjykata ne rastin konkret gjeti se parashtruesi nuk kishte specifikuar se me cilën dispozitë konkrete të Kushtetutës i janë cenuar të drejtat e tij. Në këtë kontekst, Gjykata nuk mund të vlerësonte kushtetutshmërinë e vendimeve të gjykatave të rregullta, duke qenë se parashtruesi nuk kishte dorëzuar në Gjykatë vendimet e kontestuara. Prandaj, Gjykata nuk mund t'i merrte për bazë pretendimet dhe pohimet e parashtruesit, nëse ato pretendime ose pohime nuk janë të mbështetura me argumente dhe me prova materiale.

Gjykata konsideroi se parashtruesi nuk kishte ndërtuar një rast prima facie, në mënyrë që kjo Gjykatë të do të mund të vlerësonte përmbushjen së kritereve procedurale për pranueshmëri, nëse parashtruesi i kishte shterur mjetet efektive juridike, nëse kërkesa ishte dorëzuar brenda afatit të paraparë prej 4 (katër) muajsh dhe nëse pretendimet e parashtruesit për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë

paraqesin bazë të mbështetur me prova për vlerësimin e meritave të kërkesës.

Si përmbledhje, Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesit, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, ishte qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI104/14
Parashtrues
Agron Çerreti
Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të paspecifikuara të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës së Apelit dhe i Aktgjykimit
P. nr. 88/2012 të Gjykatës Komunale në Gjilan

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Agron Çerreti, me vendbanim të përhershëm në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston vendimet e paspecifikuara të Gjykatës Supreme dhe të Apelit dhe Aktgjykimin P. nr. 88/2012, të Gjykatës Komunale në Gjilan, por që asnjërin prej tyre nuk e ka dorëzuar në Gjykatë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve siç janë cekur në titullin e këtij dokumenti. Parashtruesi në përgjithësi ankohet ndaj vendimeve të gjykatave të rregullta,

duke pretenduar se ato shkelën të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

Baza juridike

4. Baza juridike për këtë rast është neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 qershor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI104/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI104/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Ćukalović.

7. Më 15 korrik 2014, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti kompletimin e kërkesës me dokumentacion relevant.

8. Më 17 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës zëvendësoi anëtarin e Kolegjit shqyrtues Robert Carolan dhe në vend të tij caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova.

9. Më 17 shtator 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës pohon se është akuzuar nga Prokuroria Komunale e Gjilanit (në tekstin e mëtejmë: PKGJ), për vepër penale të mashtrimit.

11. Parashtruesi, pohon se, në afat ligjor ka ushtruar ankesë kundër urdhrit ndëshkimor.

12. Gjykata Komunale e Gjilanit (Aktgjykimi, P. nr. 88/2012), pas seancës së shqyrtimit kryesor e shpalli fajtor parashtruesin, duke u bazuar në aktakuzën e ngritur për vepër penale të mashtrimit dhe e gjobit atë me të holla në shumën prej 700 euro. Megjithatë, Gjykata vëren se ky vendim i Gjykatës Komunale të Gjilanit, nuk është dorëzuar në Gjykatë nga parashtruesi.

13. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Gjilanit, parashtruesi ka ushtruar të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar se kjo instancë gjyqësore nxori vendim me shkeljen e të drejtave të tij të përcaktuara me ligj.

14. Gjykata e Apelit në Prishtinë, sipas pohimeve të parashtruesit, nxori vendim me të cilin refuzoi ankesën e tij dhe miratoi kërkesën e PKGJ-së përkitazi me ndryshimin e dënimit, nga dënimi me gjobë në shumë prej 700 eurosh, në dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajsh. Gjykata gjithashtu vëren se edhe ky vendim i Gjykatës së Apelit nuk është dorëzuar në Gjykatë nga parashtruesi.

15. Parashtruesi, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, përkitazi me shkeljen e dispozitave të KPP-së, përkatësisht për moszbatimin e nenit 47 të KPPK-së, ku parashtruesi pretendon se me këtë nen dënimi me burg me kohëzgjatje prej jo më shumë se 6 (gjashtë) muajsh mund të shndërrohet në dënim me gjobë.

16. Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke u arsyetuar se as parashtruesi dhe as mbrojtësi i tij nuk kishin kërkuar të merrnin pjesë në seancën kryesore të Gjykatës së Apelit. Edhe ky vendim i Gjykatës Supreme nuk është dorëzuar në Gjykatë nga parashtruesi.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me ligjet në fuqi dhe me Kushtetutë, nga arsyet e mëposhtme: 1) se Gjykata e Apelit, me kërkesë të Prokurorisë Komunale të Gjilanit, ndryshoi dënimin me gjobë në shumë prej 700 euro, në dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajsh, edhe pse këtë PKGJ-ja nuk e kishte kërkuar në Gjykatën Komunale; 2) për faktin se Gjykata e Apelit nuk zbatoi nenin 47 të KPPK-së për mundësinë e shndërrimit të dënimit me burg në dënim me gjobë; dhe 3) për faktin se Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë me arsyetimin se

parashtruesi dhe mbrojtësi i tij nuk kishin kërkuar të merrnin pjesë në Gjykatën e Apelit për të kërkuar ndryshimin e dënimit.

18. Parashtruesi, përveç shkeljeve të dispozitave ligjore, nuk ka konkretizuar ndonjë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Përkitazi me këtë kërkesë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

21. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) c) i Rregullores së punës, parasheh:

> *Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *[...]*
>
> *c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.*

22. Për më tepër, rregulli 36 (2) i Rregullores së punës parasheh:

> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;*
>
> *d) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*
>
> *[...]*

23. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të parapara me dispozitat ligjore në fuqi, duke mos ia mundësuar atij shndërrimin e dënimit me burg në dënim me gjobë. Sa i përket pretendimit për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, parashtruesi nuk ka specifikuar se me cilën dispozitë konkrete të Kushtetutës i janë cenuar të drejtat e tij.

24. Në këtë rast, Gjykata nuk mund të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimeve të gjykatave të rregullta, duke qenë se parashtruesi nuk ka dorëzuar në Gjykatë vendimet e kontestuara. Prandaj, Gjykata nuk mund t'i marrë për bazë vetëm pretendimet dhe pohimet e parashtruesit, nëse ato pretendime ose pohime nuk janë të mbështetura me argumente dhe me prova materiale.

25. Parashtruesit i është kërkuar dhe i është dhënë kohë e mjaftueshme që të kompletojë kërkesën e tij me dokumentacionin e nevojshëm, por Gjykata nuk ka pranuar asnjë vendim të gjykatave të rregullta, kushtetutshmërinë e të cilave do të mund ta vlerësonte.

26. Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka ndërtuar një rast *prima facie,* në mënyrë që kjo Gjykatë të mund të lëshohej në vlerësimin e përmbushjes së kritereve procedurale për pranueshmëri, nëse parashtruesi i ka shterur mjetet efektive juridike, nëse kërkesa është dorëzuar brenda afatit të paraparë prej 4 (katër) muajsh dhe nëse pretendimet e parashtruesit për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë paraqesin bazë të mbështetur me prova për vlerësimin e meritave të kërkesës, pasi nuk i posedon ato vendime për t'i vlerësuar.

27. Gjykata nuk mund të shndërrohet në gjykatë të gjetjes së fakteve dhe të kërkojë nga autoritetet e tjera gjyqësore dosjet e parashtruesit, duke i kërkuar ato me emër dhe me mbiemër. Gjykata, nëse vërteton se një kërkesë nuk është e kompletuar me dokumentacion relevant, do të kërkojë nga parashtruesi që, në një afat të përcaktuar me ligj, t'i dorëzojë ato dokumente, ndryshe Gjykata do të vendos vetëm në bazë të shkresave të lëndës. Barra e përgjegjësisë bie mbi palët të cilat nuk arrijnë të përmbushin kriteret e kërkuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

28. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 48 të ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) a) dhe b), si dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 17 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI229/13, Pashk Thaqi, Mark Thaqi dhe Linda Thaqi, Aktvendim i datës 23 shtator 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 147/2013, të 03 korrikut 2013

Rasti KI 229/13, vendimi i 23 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesit kanë paraqitur kërkesë bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese janë cenuar me aktgjykimet e gjykatave të rregullta të të gjitha shkallëve.
Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme kishte shkelur të drejtat e tyre nga neni 31 i Kushtetutës, neni 54 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ, si dhe neni 219 i LPK, sepse kopja e revizionit e dorëzuar nga e paditura "Kosova e Re" nuk u është dorëzuar atyre. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese qe ta anulon Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe ta kthen lëndën në rigjykim.

Gjykata thekson se ajo mundet vetëm të vlerësoj nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, te shikuara si tërësi, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre në baza kushtetuese dhe nuk kanë shpjeguar dhe dëshmuar si dhe pse të drejtat dhe liritë e tyre janë shkelur me vendimin e Gjykatës Supreme, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar pjesa që ka të bëjë me kompensimin për dëmin material për përkujdesje për personin tjetër dhe për shpenzime te ushqimit, përderisa pjesa tjetër e Aktgjykimit te Gjykatës së Qarkut ishte ndryshuar. Në fakt, parashtruesit e kërkesës nuk e kanë dëshmuar pretendimin bazuar në shkelje kushtetuese dhe nuk kane ofruar prova relevante, që dëshmojnë se të drejtat dhe liritë e tyre të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur për shkak se *"[...] një kopje* e *revizionit* e *parashtruar nga* e *paditura "Kosova e Re" nuk u është dorëzuar atyre [...J".* Parashtruesit e kërkesës nuk kanë argumentuar se si kjo paraqet shkelje kushtetuese. Deklarata e thjeshtë se Kushtetuta është shkelur nuk mund të konsiderohet si ankesë kushtetuese. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e fakteve ose te ligjit, që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Prandaj, ne pajtim me rregullin 36

(1) c) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe si e tillë e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI229/13
Parashtrues
Pashk Thaqi, Mark Thaqi dhe Linda Thaqi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 147/2013, të 3 korrikut 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Pashk Thaqi, z. Mark Thaqi dhe znj. Linda Thaqi, me vendbanim në Prizren (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të përfaqësuar nga znj. Zahide Gjonaj, avokate nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 147/2013, të 3 korrikut 2013, i cili u ishte dorëzuar atyre më 15 gusht 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 147/2013, të 3 korrikut 2013.

4. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktgjykimi i kontestuar ishte nxjerrë me shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në veçanti neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se

janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 dhjetor 2013, parashtruesit e kërkesës e kanë dërguar me postë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), e cila arriti në Gjykatë më 19 dhjetor 2013.

7. Më 15 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI229/13, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI229/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 6 shkurt 2014, Gjykata Supreme ishte njoftuar për kërkesën.

9. Më 23 shtator 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 13 nëntor 2009, parashtruesit e kërkesës ishin përfshirë në një aksident në komunikacion.

11. Më 12 dhjetor 2009, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi në Gjykatën Komunale në Rahovec (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale) kundër kompanisë së sigurimit “Kosova e Re”.

12. Më 15 shtator 2011, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 384/2009) aprovoi pjesërisht kërkesën e parashtruesve dhe urdhëroi kompaninë e sigurimit që t’ua kompensojë shumën e caktuar, të përmendur në aktgjykim.

13. Më 29 tetor 2011, parashtruesit e kërkesës ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Qarkut) për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale për pjesën II të Aktgjykimit.

14. Më 19 nëntor 2011, Gjykata e Qarkut (Aktgjykimi Ac. nr. 483/2011) e aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesve të kërkesës lidhur me paragrafin II të Aktgjykimit, ku thuhet se *"obligohet e paditura që paditësve të kompensojë kamatën ligjore deri në pagesën definitive"*. Lidhur me pjesën tjetër të ankesës, Gjykata e Qarkut e refuzoi ankesën edhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, të 15 shtatorit 2011. Ankesa e Kompanisë së Sigurimit "Kosova e Re" u refuzua në tërësi.

15. Kompania e sigurimit dorëzoi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme.

16. Më 3 korrik 2013, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 147/2013) aprovoi pjesërisht kërkesën për revizion, të dorëzuar nga Kompania e Sigurimit "Kosova e Re".

17. Revizioni i të padituruës, i parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 483/2011 të 19 nëntorit 2012 refuzohet si i pabazuar, në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit material për kujdes ndaj personit tjetër dhe për shpenzimet e ushqimit. Ndërkaq, pjesa I e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 483/2011 të 19 nëntorit 2012 ishte ndryshuar, duke e zvogëluar shumën e dhënë parashtruesve të kërkesës.

18. Në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar ishte cekur se *"Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e instancës me te ulët kanë vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale në pjesën që i referohet shpërblimit të demit material paditësve..."*.

[...]

"Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, shuma e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë në pjesën që i referohet shpërblimit të dëmit jo material paditësve... nuk është adekuate me natyrën e shpërblimit të dëmit jo-material dhe material dhe duke pas parasysh rëndësinë e shkallës së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, siç është paraparë në

nenin 200 par.1 dhe 2 të LMD, kjo gjykatë, duke pranuar pjesërisht revizionin e të paditurës e ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë, ashtu që në emër të dëmit jo material dhe material të përshkruar më lart, paditësve i pranoj shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të kësaj gjykate. Kërkesëpadinë e paditësve përtej shumave të gjykuar e refuzoj si të pa bazuar".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme "*kishte shkelur të drejtat e tyre nga neni 31 i Kushtetutës, neni 54 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ, si dhe neni 219 i LPK, sepse kopja e revizionit e dorëzuar nga e paditura "Kosova e Re" nuk u është dorëzuar atyre".*

20. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese *"që ta anulon Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe ta kthen lëndën në rigjykim".*

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh se:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

23. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) c) dhe (2) b) të Rregullores së punës, i cili përcakton se:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese";

24. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"[...] një kopje e revizionit e dorëzuar nga e paditura "Kosova e Re" nuk u është siguruar atyre [...]"*.

25. Gjykata thekson se ajo mundet vetëm të vlerësojë nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara si tërësi, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih mes tjerash, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, App. Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

26. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre në baza kushtetuese dhe nuk kanë shpjeguar dhe dëshmuar si dhe pse të drejtat dhe liritë e tyre janë shkelur me vendimin e Gjykatës Supreme, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar pjesa që ka të bëjë me kompensimin për dëmin material për përkujdesje për personin tjetër dhe për shpenzime të ushqimit, përderisa pjesa tjetër e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut ishte ndryshuar.

27. Në fakt, parashtruesit e kërkesës nuk e kanë dëshmuar pretendimin bazuar në shkelje kushtetuese dhe nuk kanë ofruar prova relevante, që dëshmojnë se të drejtat dhe liritë e tyre të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur për shkak se *"[...] një kopje e revizionit e parashtruar nga e paditura "Kosova e Re" nuk u është dorëzuar atyre [...]"*. Parashtruesit e kërkesës nuk kanë argumentuar se si kjo paraqet shkelje kushtetuese. Deklarata e thjeshtë se Kushtetuta është shkelur nuk mund të konsiderohet si ankesë kushtetuese.

28. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

29. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga këto gjykata. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

30. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe si e tillë e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës rregullat 36 (1) c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI78/14, Mentor Paçak, Aktvendim i datës 16 shtator 2014- Vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit PN. nr. 637/2013 të Gjykatës së Apelit, të 16 tetorit 2013.

Rasti KI 78/14, vendimi i 16 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e paafatshme.

Parashtruesi i kërkesës, Mentor Paçak, parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës duke kontestuar Aktvendimin PN. nr. 637/2013 të Gjykatës së Apelit, të 16 tetorit 2013, i cili pretendohet t'i jetë dorëzuar atij në nëntor të vitit 2013. Parashtruesi i kërkesës nuk ka cekur ndonjë shkelje të dispozitave të Kushtetutës; ai vetëm kërkoi nga Gjykata faljen e dënimit.

Përkitazi me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se Aktvendimi i fundit PN. nr. 637/2013 i Gjykatës së Apelit është nxjerrë më 16 tetor 2013 dhe i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës në nëntor 2013. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 5 maj 2014, që është më shumë se 4 muaj nga data kur atij i ishte dorëzuar Aktvendimi i Gjykatës së Apelit. Prandaj, Gjykata deklaroi kërkesën si të paafatshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI78/14
Parashtrues
Mentor Paçak
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit,
PN. nr. 637/2013, të 16 tetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Mentor Paçak nga Prizreni, (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), i përfaqësuar nga z. Ibrahim Paçak, nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit PN. nr. 637/2013, të 16 tetorit 2013, që pretendohet se i është dorëzuar atij në nëntor të vitit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, por parashtruesi i kërkesës nuk ka cekur ndonjë dispozitë kushtetuese.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 maj 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 18 qershor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 19 qershor 2014, Gjykata një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës së Apelit.

9. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës zëvendësoi anëtarin e Kolegjit shqyrtues gjyqtarin Robert Carolan dhe në vend të tij caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues.

10. Më 16 shtator 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në një datë të pacaktuar parashtruesi i ka parashtruar kërkesë Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren për shtyrjen e fillimit të vuajtjes së dënimit me burg, i gjykuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, nr. P. nr. 49/2011 të 8 prillit 2011, i cili është bërë i plotfuqishëm me 22 mars 2012.

12. Më 29 maj 2013, Gjykata Themelore në Prizren, (Aktvendimi Ped. nr. 231/2013), aprovoi kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e

fillimit të vuajtjes së dënimit me burg, për 3 (tre) muaj, ashtu që fillimi i mbajtjes së dënimit të shtyhet deri më 29 gusht 2013.

13. Në një datë të pacaktuar parashtruesi i ka parashtruar përsëri kërkesë Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren për shtyrjen e fillimit të vuajtjes së dënimit me burg.
14. Më 20 shtator 2013, Gjykata Themelore në Prizren (Aktvendimi PED. nr. 223/2013) refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e fillimit të vuajtjes së dënimit.

15. Më 16 tetor 2013, Gjykata e Apelit, (Aktvendimi PN. nr. 637/2013), e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, të 20 shtatorit 2013. Gjykata e Apelit konstatoi se *"[...] Meqenëse i dënuari nuk ka afruar kurrfarë prove që mbështesin pretendimin për shtyrje e në bazë të cilave gjykata do ta vlerësonte plotësimin apo jo të kushtit ligjor nga neni 20 par. 1 pika 1.4 të LMESP, kjo Gjykatë ka përfunduar se aktvendimi ankimor i shkallës së parë mbi refuzimin e lutjes për shtyrje dënimi është marrë në përputhje me dispozitat procedurale, e duke e zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dispozitat e LMESP, qëndrime të cilat i pranon edhe kjo gjykatë [...]".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi nuk ka cekur ndonjë shkelje të dispozitave të Kushtetutës por vetëm ka kërkuar nga Gjykata faljen e dënimit.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".*

19. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi, ose*
>
> *[...]".*

20. Gjykata vëren se aktvendimi përfundimtar i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 637/2013, është nxjerrë më 16 tetor 2013 dhe i është dorëzuar parashtruesit në nëntor 2013. Parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 5 maj 2014, që është më shumë se 4 (katër) muaj nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar Aktvendimi i Gjykatës së Apelit.

21. Nga sa u tha më lart, Gjykata konstaton se kërkesa është e paafatshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. Dr. Enver Hasani

KI106/14, Kompania "Adler Com sh.p.k.", Aktvendim i datës 18 shtator 2014 - Vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 47/2013, të 17 majit 2014

Rasti KI106/14, vendimi i 18 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e pronës, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar [E. Rev. nr. 47/2013] i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, dhe atë: nenin 3 (Barazia para Ligjit), nenin 7 (Vlerat), nenin 21 (Parimet e Përgjithshme), nenin 31 (E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenin 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave).

Parashtruesi ka kërkuar nga Gjykata që të anulojë Aktgjykimin [E. Rev. nr. 47/2013] të Gjykatës Supreme, Aktgjykimin [Ae. nr. 20/2012] të Gjykatës së Apelit, dhe Aktgjykimin [IV. C. nr. 229/2009] të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, në funksion të aprovimit të kërkesës së parashtruesit për kompensimin e dëmit në shumë prej 1,319,057.67 €.

Gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 47/2013, të 17 majit 2014, Gjykata Kushtetuese konstatoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij. Prandaj, Gjykata ka ardhur në përfundim se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese, ashtu që kërkesa e tij është qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI106/14
Parashtrues
Kompania „Adler Com sh. p. k.“
Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 47/2013, të 17 majit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama - Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga kompania „Adler Com sh. p. k.“, fshati Gërçinë, Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilën e përfaqëson avokati z. Bajram Morina nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 47/2013, e 17 majit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [E. Rev. nr. 47/2013] të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 17 majit 2014, me të cilin, sipas pretendimit të parashtruesit, është shkelur neni 3 [Barazia para Ligjit], neni 7 [Vlerat], neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 qershor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI106/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI106/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 14 gusht 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. KSH. KI106/14, zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtarin Almiro Rodrigues.

9. Më 18 shtator 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë kundër Komunës së Gjakovës, me të cilën ka kërkuar që pala e paditur në emër të fitimit të humbur për shkak të përjashtimit nga pjesëmarrja në tenderët komunalë, t'ia paguaj shumën në lartësi prej 1.319.057,67 €.

11. Më 15 tetor 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut nxori Aktgjykimin [IV. C. nr. 229/2009], me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e parashtruesit si e pabazuar, me arsyetim:

„[...] gjykata konsideron se paditësit nuk i takon fitimi i humbur nga kjo bazë. Kjo për arsye se shpallja e tenderit nuk paraqet ftesë për lidhje të kontratës po është ftesë për garë tenderuese. Edhe me supozim se paditësi nuk është eliminuar nga gara tenderuese, nuk është e sigurt që kishte me fituar kushtin për lidhjen e kontratës në bazë të tenderit të shpallur. Pra baza e kërkesës së paditësit është e kushtëzuar nga plotësimi i një kushti të pa sigurt dhe gjykata në këto rrethana nuk mund të bazoi aktgjykimin e saj...".

12. Më 28 dhjetor 2009, përfaqësuesi i paditësit ka paraqitur me kohë ankesë ndaj aktgjykimit për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

13. Më 24 korrik 2013, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [Ae. nr. 20/2012], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, me arsyetim:

"[...] se vlerësimi juridik i gjykatës së shkallës së parë i cili është cekur në Aktgjykimin [IV. C. nr. 229/2009], të 15 tetorit 2009, është i rregullt dhe i bazuar në dispozitat ligjore, dhe që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 të LPK, dhe rrjedhimisht Gjykata e Apelit e miraton këtë vlerësim në tërësi". Në përfundimin e Aktgjykimit, Gjykata e Apelit thekson: *"[...] se në bazë të nenit 189 paragrafi 1 të LMD është përcaktuar se i dëmtuari ka të drejtë si në kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të humbur, ndërsa me paragrafin 3 të nenit në fjalë është përcaktuar se me rastin e vlerësimit të fitimit të humbur, merret parasysh fitimi i cili vërtetë ka mundur të pritej sipas rrjedhjes së rregullt të çështjes ose sipas rrethanave të veçanta, realizimi i të cilave është penguar nga veprimi ose lëshimi i shkaktuesit të dëmit, d.m.th. përcaktohet në para në bazë të vlerës të fitimit të cilin personi i dëmtuar vërtetë do ta realizonte nisur nga mënyra e vet e zakonshme e jetesës dhe punës, sikur të mos ekzistonte veprimi dëmtues i shkaktarit të dëmit ose lëshimit të tij, dhe caktohet në bazë të çmimeve në kohën e marrjes së vendimit gjyqësor. Paditësi gjatë gjithë procedurës nuk i ka provuar këto fakte sipas të cilave kishte bazë ligjore për të kërkuar fitimin e humbur".*

14. Më 2 tetor 2013, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ae. nr. 20/2012] të 24 korrikut 2013, përfaqësuesi i paditësit ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme të anulojë aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe lënda të kthehet për rivendosje.

15. Më 13 mars 2014, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [E. Rev. nr. 47/2013], me të cilin hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit si të pabazuar, me arsyetim se:

> *"[...] janë të pabazuara thëniet e parashtruesit se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale dhe atë dispozitat e nenit 189 par. 1 dhe 3, nenit 154 par. 1, nenit 158 dhe nenit 185 par. 1 dhe 4 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit për shpërblimin e fitimit të humbur është e pabazuar, ngase gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk kanë marrë për bazë faktin se paditësi është eliminuar nga tenderi për vitin 2008 për shkak të inicimit të procedurës për kundërvajtje ndaj paditëses..."*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi ka theksuar në kërkesë se Aktgjykimi i kontestuar [E. Rev. nr. 47/2013], i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, dhe atë: neni 3 [Barazia para Ligjit], neni 7 [Vlerat], neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

17. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesë:

> *"Anulimi - Prishja e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. Nr. 47/2013, Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. Nr. 20/2012 dhe të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV/C. Nr. 229/2009 në funkcion të aprovimit të Padisë - Kërkesëpadisë së parashtruesit të kësaj kërkese për kompenzimin e dëmit në shumë të përgjithshme prej 1,319,057.67 Euro"*.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Për të qenë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës së Gjykatës.

19. Në këtë drejtim, neni 113 paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

20. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parashikon:

> *(1) "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *[...]*
>
> *c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".*

21. Siç është theksuar edhe më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [E. Rev. nr. 47/2013] i Gjykatës Supreme të Kosovës i 17 majit 2014, i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

22. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë nuk ka shpjeguar se si dhe pse Aktgjykimi [E. Rev. nr. 47/2013] i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, por ka tentuar që thëniet e tij për shkeljet e cekura t'i justifikoj me pretendimin se: *„[...] i janë cenuar rende të drejtat Kushtetuese dhe shkaktuar dëme i konsiderueshëm materiale dhe morale..."*.

23. Gjykata Kushtetuese ripërsëritë se sipas Kushtetutës nuk është detyrë e saj që të veprojë si Gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtruesi i kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

24. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zbatuar në mënyrë të tillë që parashtruesit e kërkesës kanë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).

25. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë, dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata, gjithashtu, gjeti se procedurat në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Ekonomike të Qarkut nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).

26. Për më tepër, Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj ka gjetur *„[...] se gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar drejtë të drejtën materiale kur e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe ka konfirmuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për çka ka ofruar arsye të mjaftueshme të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, si dhe ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e paditësit në revizion, se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore nga neni 182.1 dhe 182.2 (n) dhe në kundërshtim me nenin 204 të LPK, ngase i mungojnë arsyet valide për refuzimin e ankesës së paditësit dhe faktet vendimtare për vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, se në arsyetim nuk janë dhënë arsye për pretendimet ankimore dhe se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërthënie me arsyet të dhëna dhe shkresat të lëndës”.*

27. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit me rezultatin e rastit, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim të argumentuar për shkelje të dispozitave të Kushtetutës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

28. Si përmbledhje, Gjykata gjen se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, ngase parashtruesi nuk ka dëshmuar se vendimi i kontestuar i shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

29. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 18 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI83/14, Sahit Rakaj, Aktvendim i datës 23 shtator 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 188/2013, të 7 nëntorit 2013

Rasti KI83/14, vendimi i 23 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi të pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme shkel të drejtat kushtetuese të garantuara me nenet: 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut]; si dhe nenin 49 [E Drejta në Punë dhe Ushtrimit të Profesionit], duke pretenduar se Gjykata Supreme aktgjykimin e ka bazuar në "institutin e skadimit të kontratës së punës" edhe pse të gjithë të punësuarit tjerë kanë pasur status të njëjtë të punësimit por atyre u është vazhduar kontrata e punës.

Parashtruesi ka përmendur në kërkesë edhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut[KEDNJ] por pa specifikuar konkretisht shkeljen e ndonjë të drejte të mbrojtur me këtë Konventë.

Gjykata thekson se parashtruesi vetëm ka potencuar shkeljen e këtyre dispozitave kushtetuese por nuk ka ofruar asnjë provë të vetme për mënyrën dhe natyrën e shkeljes, për rrethanat eventuale në të cilat shkelja e pretenduar ka ndodhur, nuk ka shpjeguar se cilat janë pasojat kushtetuese të shkeljeve eventuale të Kushtetutës.

Gjykata konsideron se, vetëm përshkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës dhe pretendimi se ato janë shkelur, pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, pa përcaktuar rrethanat dhe pa specifikuar veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me normat kushtetuese nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ.

Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë e të paanshëm.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2014, njëzëri deklaron kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI83/14
Parashtrues
Sahit Rakaj
Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 188/2013, të 7 nëntorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Sahit Rakaj nga fshati Vërmicë, komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar nga parashtruesi është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), Rev. nr. 188/2013, i 7 nëntorit 2013, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 28 prill 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 188/2013, të 7 nëntorit 2013, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet: 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut]; si dhe nenin 49 [E Drejta në Punë dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Baza juridike e kërkesës është: neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 dhe 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji)

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 maj 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI83/14 caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Vendimin KSH. KI83/14, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 10 qershor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe informoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 15 shtator 2014, me vendim të Kryetarit, gjyqtari Robert Carolan u zëvendësua me gjyqtarin Altay Suroy si kryesues i Kolegjit shqyrtues.

9. Më 23 shtator 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 30 gusht 2010, parashtruesi i kërkesës lidhi kontratë pune në kohë të caktuar me Komunën e Prizrenit-Drejtoria për Arsim dhe Shkencë (DASH), në kohëzgjatje prej 1 shtator 2010 deri më 31 gusht 2011, për mësimdhënie në lëndën e Biologjisë dhe Mbrojtje të Ambientit, në dy paralelet e ndara të gjimnazit "Remzi Ademaj" në Prizren.

11. Më 19 tetor 2011, parashtruesi ka paraqitur ankesë në DASH të Komunës së Prizrenit, meqë kontrata e punës nuk i ishte vazhduar.

12. Më 9 nëntor 2011, DASH refuzoi ankesën e parashtruesit, për faktin se parashtruesi, paraprakisht është dashur të parashtroi ankesë në shkollën ku ai ka punuar, duke e arsyetuar refuzimin e ankesës se shkolla ku ai ka punuar e dinë më mirë gjendjen reale se

përse parashtruesi ka mbetur pa orë të mësimit nga shtatori i vitit 2011.

13. Më 21 nëntor 2011, parashtruesi ka ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Prizren, duke kërkuar që kjo gjykatë të konstatojë se mosvazhdimi i kontratës së punës është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe duke kërkuar që gjykata ta detyrojë DASH-Prizren, që parashtruesin ta kthejë në punë si mësimdhënës në vendin e punës ku ai ka punuar.

14. Më 6 qershor 2012, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi, C. nr. 795/11), aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit, duke konstatuar se mosvazhdimi i kontratës së punës së tij është në kundërshtim me ligjin për arsim dhe ligjin e punës dhe e obligoj Komunën e Prizrenit që parashtruesin ta kthej në vendin e punës ku kishte punuar para se kontrata të mos i vazhdohej.

15. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi në mes tjerash gjykata komunale ka konstatuar: "*Si përfundim, gjykata vlerëson se e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të parapara me nenet 71.2, 72.1 dhe 72.2 të Ligjit të Punës, me rastin e mos vazhdimit të kontratës së punës së paditësit, andaj vendosi që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar në ligj dhe në fakte*".

16. Më 14 mars 2013, Gjykata e Apelit, duke vendosur sipas ankesës së avokatit publik të Komunës së Prizrenit, nxori Aktgjykimin CA. nr. 3650/2012, me të cilin miratoi ankesën e Komunës së Prizrenit, duke ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit, C. nr. 795/2011 të 6 qershorit 2012 ashtu që padinë e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar.

17. Në arsyetimin e aktgjykimit të saj Gjykata e Apelit kishte theksuar: "*Duke shqyrtuar aktgjykimin e atakuar kjo gjykatë gjeti se në mënyrë të bazuar tregohet me ankesë se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje thelbësore të LPK-së dhe atë të nenit 182 paragrafi 2 pika n). Me fjalë tjera, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i palogjikshëm dhe i njëjti është në kundërshtim me vetveten si dhe me arsyet e fakteve vendimtare të dhëna në arsyetim".*

18. Gjykata e Apelit, për më tepër, arsyeton aktgjykimin duke theksuar se: *"gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe në masë të mjaftueshme, por në një gjendje të këtillë të vërtetuar, është zbatuar gabimisht e drejta materiale*" dhe se "*neni 67 i Ligjit të*

punës parasheh që kontrata e punës ndërpritet sipas vetë ligjit ndër të tjera edhe me kalimin e kohës për të cilën është lidhur kontrata".

19. Më 7 nëntor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës së parashtruesit për revizion, nxori Aktgjykimin Rev. nr. 188/2013, me të cilin në pikën I të dispozitivit e refuzoi si të pabazuar revizionin e paraqitur nga parashtruesi në pjesën që i referohet kthimit të tij në vendin e punës ku kishte punuar, ose të sistemohej në ndonjë vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes së tij profesionale, dhe në pikën II aprovoj revizionin e parashtruesit në pjesën që i referohet pagesës së një page mujore duke e detyruar Komunën e Prizrenit-DASH, që parashtruesit t'ia paguaj një pagë mujore që ai e ka realizuar sipas kontratës së punës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme shkel të drejtat kushtetuese të garantuara me nenet: 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut]; si dhe nenin 49 [E Drejta në Punë dhe Ushtrimit të Profesionit], duke pretenduar se Gjykata Supreme aktgjykimin e ka bazuar në *"institutin e skadimit të kontratës së punës"* edhe pse të gjithë të punësuarit tjerë kanë pasur status të njëjtë të punësimit por atyre u është vazhduar kontrata e punës.

21. Parashtruesi ka përmendur në kërkesë edhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut[KEDNJ] por pa specifikuar konkretisht shkeljen e ndonjë të drejte të mbrojtur me këtë konventë.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
23. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

24. Lidhur me si më sipër Gjykata konstaton se parashtruesi është palë e autorizuar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, se ka shterur mjetet juridike të parapara me ligj dhe se kërkesën e ka dorëzuar në Gjykatë brenda afatit prej 4 (katër) muajve të paraparë me nenin 49 të Ligjit...

25. Duke vlerësuar pretendimet e parashtruesit për shkeljet e Kushtetutës, Gjykata konstaton se dispozitat kushtetuese, shkelja e të cilave pretendohet, kanë këtë përmbajtje:

Neni 3 paragrafi 2 [Barazia para Ligjit]

"Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre".

Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]

"*Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut".*

Neni 24.1 [Barazia para Ligjit]

"Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim".

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

"*1. E drejta e punës garantohet. 2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës".*

26. Përkitazi me këtë Gjykata thekson se parashtruesi vetëm ka potencuar shkeljen e këtyre dispozitave kushtetuese por nuk ka ofruar asnjë provë të vetme për mënyrën dhe natyrën e shkeljes, për rrethanat eventuale në të cilat shkelja e pretenduar ka ndodhur, nuk ka shpjeguar se cilat janë pasojat kushtetuese të shkeljeve eventuale të Kushtetutës.

27. Gjykata konsideron se, vetëm përshkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës dhe pretendimi se ato janë shkelur, pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, pa përcaktuar rrethanat dhe pa specifikuar

veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me normat kushtetuese nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ .

28. Gjykata, duke bërë shqyrtimin e kërkesës së parashtruesit dhe të fakteve të paraqitura me kërkesë, gjen se në të gjitha fazat e procesit gjyqësor ankesat e parashtruesit kanë qenë të karakterit ligjor dhe asnjëherë e në asnjë fazë të natyrës kushtetuese apo të shkeljes eventuale të të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë, të cilat për herë të parë janë ngritur në Gjykatën Kushtetuese, gjë që gjykatën e shpien të konkludojë se në të vërtetë parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin përfundimtar të gjykimit të rastit të tij.

29. Gjykata edhe më tutje thekson se nuk është gjykatë e faktit dhe nuk gjykon si gjykatë e instancës së katërt, dhe nuk është thjeshtë një instancë më tepër gjyqësore. Gjykata në parim nuk gjykon faktin nëse gjykatat e rregullta në mënyrë të drejtë dhe të plotë e kanë konstatuar gjendjen faktike apo të vërtetojë nëse punësimi i parashtruesit ishte ndërprerë në bazë ligjore apo joligjore, sepse kjo është kompetencë e gjykatës së rregullt. Për Gjykatën janë thelbësore çështjet prej ekzistimit të të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të të drejtave kushtetuese, dhe jo çështjet qartazi ligjore që kryesisht kanë qenë fakte të paraqitura nga parashtruesi (shih*, mutatis mutandis, i. a., Akdivar kundër Turqisë,* 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

30. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë për të parashtruar një kërkesë të argumentueshme për shkeljen e dispozitave të Kushtetutës (shih*, mutatis mutandis,* Aktgjykimi i GJEDNJ-së, kërkesa Nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, ose Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, rasti KI128/12, i 12 korrikut 2013, të parashtruesit *Shaban Hoxha,* në kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011).

31. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë e të paanshëm, andaj në përputhje me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës mund të konstatohet se kërkesa është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI124/14, Zineta Nikočević, Vendim i datës 18 shtator 2014- e Kërkesë për përshpejtimin e procedurës në Gjykatën Themelore

Rasti KI-124/14, vendimi i 18 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, përshpejtimi i procedurës, mosshterimi i mjeteve juridike.

Parashtruesja e parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së Punës.

Parashtruesja e kërkesës nuk i kontestoi vendimet e autoriteteve publike, por kërkoi përshpejtimin e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë për shkak të pasivitetit dhe mosveprimit të gjykatës sipas padisë civile (Nr. C 2904/12), të 9 nëntorit 2012, në të cilën parashtruesja e kërkesës paraqitet në cilësinë e paditëses private.

Parashtruesja e kërkesës nuk ka saktësuar se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur, por pretendon se përkundër dërgimit të disa shkresave në Gjykatën Themelore, gjykata nuk ka caktuar procedurën, dhe se me një qëndrim të tillë pasiv dhe me mosveprimin e saj, Gjykata i shkakton dëm parashtrueses dhe pronës së saj.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrueses është e parakohshme, pasi që procedura e parashtrueses të cilën ajo e ka iniciuar në Gjykatën Themelore është në zhvillim, përkatësisht që nuk ekzistojnë vendimet e autoriteteve kompetente të cilat Gjykata do t'i kishte shqyrtuar si bazë për shkelje.

Gjykata vendosi se parashtruesja e kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike sipas ligjeve të Kosovës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI124/14
Parashtrues
Zineta Nikočević
Kërkesë për përshpejtimin e procedurës në Gjykatën Themelore për shkak të pasivitetit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtar
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Zineta Nikočević (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës nuk i konteston vendimet e organeve publike, por kërkon përshpejtimin e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për shkak të pasivitetit dhe mosveprimit sipas padisë civile (Nr. C. 2904/12), të 9 nëntorit 2012, në të cilën parashtruesja e kërkesës paraqitet në cilësinë e paditëses private.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është përshpejtimi i procedurës në Gjykatën Themelore sipas padisë civile të paraqitur nga parashtruesja për shkak të lirimit dhe dorëzimit të paluajtshmërisë në posedim.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 korrik 2014, parashtruesja dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI124/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI124/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 13 gusht 2014, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 18 shtator 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 9 nëntor 2012, parashtruesja e kërkesës ka parashtruar padi civile (nr. C. 2904/12) në Gjykatën Themelore në Prishtinë për lirimin dhe dorëzimin e paluajtshmërisë në posedim, e cila në regjistrin kadastral është evidentuar me numër P-71914059-07596-2, në sipërfaqe prej 72.76 ari.

10. Më 7 shkurt 2014, 2 qershor 2014, 27 qershor 2014 dhe 25 korrik 2014, parashtruesja e kërkesës ka dërguar shkresa në Gjykatën Themelore në të cilat ka kërkuar përshpejtimin e procedurës sipas padisë civile të 9 nëntorit 2012.

Pretendimet e parashtruesit

11. Parashtruesja e kërkesës nuk ka saktësuar se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur, por pretendon se përkundër dërgimit të disa shkresave në Gjykatën Themelore, gjykata nuk ka caktuar procedurën, dhe se me një qëndrim të tillë pasiv dhe me mosveprimin e saj, Gjykata i shkakton dëm parashtrueses dhe pronës së saj.

12. Parashtruesja i drejtohet Gjykatës me kërkesë:

> *"që Gjykata të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe të përfundoj padinë".*

Pranueshmëria e kërkesës

13. Për të qenë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

14. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenin 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

15. Nga ana tjetër, neni 47.2 i Ligjit parasheh:

> *„Individi mund të ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

16. Për më tepër, rregulli 36 (1) a) parasheh:

> *„Gjykata mund t'i shqyrtoj kërkesat vetëm nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtar".*

17. Gjykata thekson se kërkesa e parashtrueses shqyrtohet nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesja në kërkesën e saj nuk ka specifikuar se cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë i janë cenuar me pasivitetin e Gjykatës Themelore, në të cilin ajo thirret, edhe pse me nenin 48 të Ligjit është parashikuar që: *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilën parashtruesi dëshiron të kontestoj".*

18. Prandaj, Gjykata konsideron se në rastin konkret faktet mbi të cilat parashtruesja e ka bazuar ankesën e saj kushtetuese nuk paraqesin shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutën e

Kosovës dhe KEDNJ, dhe rrjedhimisht, qëndrimi i Gjykatës është që kërkesa e parashtrueses është e parakohshme, pasi që procedura e parashtrueses të cilën ajo e ka iniciuar në Gjykatën Themelore është në zhvillim, përkatësisht që nuk ekzistojnë vendimet e organeve kompetente të cilat Gjykata do t'i kishte shqyrtuar si bazë për shkelje.

19. Gjykata përkujton se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesja të shterë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore të njeriut.

20. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve kompetente, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i vendit siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih Aktvendimin për papranueshmëri: *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës* KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

21. Në këtë rast, Gjykata gjen se parashtruesja e kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike sipas ligjeve të Kosovës.

22. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 18 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI76/14, Jakup Berisha, Aktvendim i datës 23 shtator 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 292/2013, të 9 dhjetorit 2013

Rasti KI 76/14, vendimi i 23 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkrkesë individuale, mohimi i të drejtës së garantuar me nenin 49, 51, 53, 54 të Kushtetutës, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev.nr.292/2013 të 9 dhjetorit 2013.

Parashtruesi i kërkesës e prashtroj kërkesën e tij në bazë të nenit 113.7 të Kushetutës Kosovës i cili pretendon që i është mohuar e drejta e tij e përcaktuar me nenin 49 të Kushtetutës,Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosoves shkel të drejtat e ti të garantuar me Kushtetutë, perkatesisht nenin 51 [Mbrojta Shëndetësore dhe Sociale], neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave]

Gjykata në këtë rast vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin në baza kushtetuese dhe nuk ka siguruar prova për të dëshmuar se të drejtat dhe liritë e tij themelore janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

Gjykata Kushtetuese në pajtim me rregullin 36 (1) C të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar, dhe si e tillë e papranueshme.
Gjykata më tej konsideron se parashtruesi nuk ka qartësuar pse dhe si i është shkelur e drejta e tij në pronë që i garantohet me nenin 46 të Kushtetutës. Deklarata e thjeshtë se Kushtetuta është shkelur nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose ligjit (ligjshmerisë) që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, perveq dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe lirite e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Për shkak të arsyeve të përmendura,Gjykata vendosi të hedh poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI76/14
Parashtrues
Jakup Berisha
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 292/2013, të 9 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Jakup Berisha me vendbanim në Siqevë, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës). Në procedurën në Gjykatën Kushtetuese, ai përfaqësohet nga znj. Merita Bajraktari, avokate nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), Rev. nr. 292/2013 të 9 dhjetorit 2013, i cili i është dorëzuar atij më 19 shkurt 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar i cili pretendohet t'i ketë *"mohuar të drejtën në nenin 49 të Kushtetutës"*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121

(në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 prill 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI76/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI76/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 23 korrik 2014, Gjykata i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.

8. Më 22 shtator, Kryetari zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan si anëtar i kolegjit shqyrtues, me gjyqtarin Altay Suroy.

9. Më 23 shtator 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 8 nëntor 2003, Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK-u), e aprovoi kërkesën e parashtruesit për pension në kategorinë "A" (Vendimi nr. 162) në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 dhe Statutin e Fondit Pensional të KEK-ut.

11. Vendimi i lartpërmendur kishte përcaktuar se pagesa e pensionit për parashtruesin e kërkesës do të fillojë më 1 shtator 2003 dhe do të përfundojë më 1 shtator 2008, përderisa shuma e pensionit mujor do të jetë 105 euro. Për më tepër, në vendim theksohej se pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Komisionin për shqyrtimin e kontesteve.

12. Sipas dokumenteve të dorëzuara, nuk është paraqitur asnjë ankesë kundër këtij vendimi.

13. Pas 1 shtatorit 2008, KEK-u ndërpreu pagesën e pensionit për parashtruesin e kërkesës, siç ishte specifikuar në marrëveshje.

14. Parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale).

15. Më 18 prill 2012, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 2206/2011) e refuzoi padinë e paraqitur nga parashtruesi duke konstatuar se *"e paditura e ka realizuar në tërësi detyrimin ndaj paditësit dhe sipas vendimit të cituar e paditura përveç detyrimit për ta paguar për 60 muaj pensionin në lartësi prej 105 Euro, në muaj për paditësin nuk ka marrë kurrfarë detyrimi tjetër. Edhe sipas dispozitave nga Statuti i Fondit Pensional Suplementar i vitit 2002, detyrimet e të padituruës ndaj çdo përfituesi përfundojnë në momentin e përfundimit të periudhës prej 60 muaj në pagesës së pensionit. Gjykata po ashtu ka gjetur se paditësi në asnjë formë nuk e ka kundërshtuar vendimi në aplikim për pension"*.

16. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale (Aktgjykimi C. nr. 2206/2011).

17. Më 27 qershor 2013, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ca. nr. 4556/2012) e refuzoi si të pabazuar ankesën e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 18 prillit 2012.

18. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

19. Më 9 dhjetor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 292/2013) e refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.

20. Gjykata Supreme konstatoi se:

> *"Me vendimin e cekur më lart të padituruës, është përcaktuar se pagesa e pensionit fillon më 1.9.2003 dhe përfundon më 1.9.2008, në lartësinë mujore prej 105 €. Kundër këtij vendimi paditësi ka mund të paraqes ankesë Komitetit për shqyrtimin e mospajtimeve përmes administratës së Fondit Pensional, por ankesë nuk ka ushtruar dhe pensionin e ka pranuar gjer më 1.9.2008. Kjo Gjykatë vlerëson se paditësi është pajtuar që marrëdhënien e tij të punës ta shndërrojë në marrëdhënie tjetër juridike, ndërsa thëniet e revizionit se paditësi nuk e ka kontestuar marrëveshjen e cekur, por në bazë të Statutit të Fondit Pensional Suplementar të KEK-ut neni 2 par. 2 paditësi*

pas shërimit (rehabilitimit), gëzon të drejtën e kthimit në punë, kjo Gjykatë e shqyrtoi por e njëjta nuk pat ndikim për të vendosur ndryshe, ngase në vendimin e të paditurës është cekur se (me këtë vendim zëvendësohen të gjitha aktet e gjertanishme të nënshkruara në mes KEK-ut dhe shfrytëzuesit). Kjo Gjykatë vlerëson se e paditura ka përmbushur obligimin e saj ndaj paditësit, ngase ka vepruar konform vendimit të cekur i cili nuk është kundërshtuar nga paditësi. Me nenin 11.1 pika (b) të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, është paraparë se kontrata e punës mund të shkëputet me marrëveshje me shkrim ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesë

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës *"shkel të drejtën e tij të garantuar me Kushtetutë, përkatësisht nenin 51 [Mbrojta Shëndetësore dhe Sociale], neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave]".*

22. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata që *"pasi gjendja ime shëndetësore më është përkeqësuar çka e dëshmojnë edhe raportet mjekësore, kërkojë që e paditura KEK të vazhdojë me kompensim të përkohshëm të pagës në shumë prej 105 Euro në muaj, duke vazhduar nga dita e ndërprerjes së njëanshme të pagës me dt. 01.09.2008, e deri në plotësimin e kushteve ligjore për pensionimin e paditësit, krejt kjo me kamatë ligjore nga dita e parashtrimit të padisë deri te pagesa e plotë definitive, si dhe shpenzimet e procedurës".*

Pranueshmëria e kërkesës

23. Para së gjithash, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kriteret për pranueshmëri.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

25. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) c) dhe (2) b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".*
>
> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

26. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin në baza kushtetuese dhe nuk ka siguruar prova për të dëshmuar se të drejtat dhe liritë e tij themelore janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

27. Gjykata mundet vetëm të trajtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, App. Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

28. Gjykata vëren se Gjykata Supreme e ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme Aktgjykimin e saj, prandaj Gjykata nuk mund të konstatojë se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* GJEDNJ, Vendim për papranueshmëri të kërkesës Nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009).

29. Gjykata rikujton se në rastet tjera (v. g. KI40/09) është gjykuar përkitazi me Kompensimin e Përkohshëm për ndërprerjen e punësimit nga KEK-u. Megjithatë, Gjykata vëren se kjo kërkesë KI76/14 ndryshon nga rastet e sipërpërmendura (v. g. KI40/09). Në fakt, në këto raste, KEK-u dhe ish-punëtorët kanë nënshkruar një marrëveshje për kompensim të përkohshëm deri në themelimin e Fondit Pensional Invalidor të Kosovës, pra duke iu referuar një date të pacaktuar; përderisa në rastin konkret KI76/14, KEK-u dhe ish–punëtorët nënshkruan një marrëveshje për kompensim të përkohshëm për një afat prej 5 (pesë) vjetësh, pra duke iu referuar një date të caktuar.

30. Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka qartësuar pse dhe si i është shkelur e drejta e tij në pronë siç garantohet me nenin 46 të

Kushtetutës. Deklarata e thjeshtë se Kushtetuta është shkelur nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

31. Pra, Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si edhe të asaj materiale (shih *mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës*, [DHM], nr. 30544/96, para 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

32. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) c të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar, dhe si e tillë e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, rregullat 36 (1) c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 74/14, Radomir Filipović, Aktvendim i datës 15 shtator 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 86/2011, të 23 janarit 2013

KI 74/14, vendimi i 15 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 86/2011, të 23 janarit 2013. Parashtruesi parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Klinë kundër të padituve si në vijim: Qeveria e Kosovës; Komuna e Klinës, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Forca Paqeruajtëse e Kosovës. Ai kishte kërkuar kompensimin e dëmit për shkak të plaçkitjes, vjedhjes dhe shkatërrimit të pronës së tij në vitin 1999. Gjykata Komunale në Klinë refuzoi padinë e tij si të pabazuar. Gjykata e Qarkut në Pejë refuzoi ankesën e tij kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Klinë si të pabazuar. Parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme e cila gjithashtu u refuzua si e pabazuar duke vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Klinë.

Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese me pretendimin se Aktgjykimi i kontestuar kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të njëjtat të drejta të mbrojtura me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu u ankua, në përgjithësi, për mungesën e një mekanizmi për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në pronën e tij në vitin 1999 përkitazi me të drejtën për një mjet juridik dhe të drejtën për mbrojtjen e pronës.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme. Gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata Kushtetuese i ndau pretendimet e parashtruesit në tri pika kryesore:

A) *Përkitazi* me vendimin e Gjykatës Supreme për të refuzuar kërkesën e tij për revizion;

B) Përkitazi me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë; dhe

C) Përkitazi me mungesën e një mekanizmi për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në 1999 lidhur me të drejtën për mjet juridik dhe të drejtën për mbrojtjen e pronës.

Gjykata Kushtetuese adresoi këto pretendime veç e veç dhe ofroi arsyet për papranueshmërisë për të gjitha tri pikat. Në lidhje me pretendimet nën A), Gjykata Kushtetuese vlerësoi se Gjykata Supreme, duke refuzuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë, e ka arsyetuar vendimin e saj dhe se argumentet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës kanë të bëjnë me çështje të ligjshmërisë, e jo të kushtetutshmërisë. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese iu referua doktrinës së shkallës së katërt dhe i përkujtoi parashtruesit të kërkesës se ajo nuk është gjykatë e shkallës së katërt. Në lidhje me pretendimet nën B), Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesi i kërkesës duhej të kishte ngritur këto pretendime në gjykatat e rregullta dhe duhej t'u kishte dhënë atyre mundësinë për të shqyrtuar këto ankesa të veçanta dhe nëse është e nevojshme t'i korrigjojnë ato në pajtim me juridiksionin dhe kompetencat e tyre ligjore.
Në lidhje me pretendimet nën C), Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Kushtetuese duhet të marrë një qëndrim në këtë çështje të caktuar nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe si e tillë nuk i shërben të ngre një çështje kushtetuese brenda kompetencave të parapara me nenin 113.7 të Kushtetutës. Kështu, kjo pjesë e kërkesës duhej të deklarohej e papranueshme sepse nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën. Në përgjithësi, kërkesa u deklarua e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI74/14
Parashtrues
Radomir Filipović
Vlerësimi i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 86/2011,
të 23 janarit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Radomir Filipović me vendbanim në Srbobran (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), Republika e Serbisë. Ai përfaqësohet nga përfaqësuesit e Projektit të Ndihmës Juridike me seli në Beograd, Republika e Serbisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 86/2011, të 23 janarit 2013, i cili iu dorëzua atij më 26 dhjetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 86/2011, të 23 janarit 2013. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme, duke refuzuar kërkesën e tij për revizion ka shkelur të drejtat e tij për barazi para ligjit, gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ndalim të diskriminimit, mjete juridike dhe mbrojtje të pronës, siç garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe Konventën Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi gjithashtu pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë.

5. Në përgjithësi, parashtruesi ankohet edhe për mungesë të një mekanizmi për kompensimin e dëmit të shkaktuar në pronën e tij në vitin 1999 përkitazi me të drejtën për mjete juridike dhe të drejtën për mbrojtje të pronës.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 17 prill 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. GJR. KI74/14 caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI74/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

9. Më 21 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë autorizimin për përfaqësuesit, të cilët i kishte paraqitur në kërkesën e tij. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Pejë për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të sigurojë një kopje të fletëdërgesës që tregon datën se kur parashtruesi ose përfaqësuesit e kanë pranuar aktgjykimin. Së fundi, të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

10. Më 27 maj 2014, Gjykata kontaktoi parashtruesin me telefon në mënyrë që të vërtetojë nëse ai e ka pranuar letrën e dërguar nga Gjykata. Parashtruesi u përgjigj pozitivisht duke thënë se ai do ta dorëzojë dokumentin e kërkuar në Gjykatë.

11. Më 28 maj 2014, Gjykata Themelore në Pejë e dorëzoi dokumentin e kërkuar në Gjykatë.

12. Më 9 qershor 2014, parashtruesi e dorëzoi dokumentin e kërkuar në Gjykatë.
13. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI74/14 zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi.

14. Më 15 shtator 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 1 prill 2005, parashtruesi parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Klinë kundër këtyre të padituve: Qeveria e Kosovës; Komuna e Klinës; Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: UNMIK); dhe Forca Paqeruajtëse e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KFOR). Parashtruesi kërkoi kompensim për dëme, në shumën prej 10,000.00 euro dhe kamatën e përllogaritur për shkak të plaçkitjes së pretenduar, vjedhjes dhe shkatërrimit të pronës së tij në fshatin Krnjicë, Komuna e Klinës.

16. Më 19 mars 2009, Gjykata Komunale në Klinë, me Aktgjykimin, P. nr. 299/2006 e refuzoi padinë e parashtruesit si të pabazuar dhe konstatoi:

> *"[...] gjykata konstatoi se paditësi* [parashtruesi] *pretendon se i është shkaktuar dëm gjatë vitit 1999, ndërsa në këtë kohë Qeveria e Kosovës dhe Komuna e Klinës nuk ishin themeluar ende, gjë që dihet dhe nuk ka nevojë të vërtetohet.*
>
> *Në bazë të provave të parashtruara në përputhje me nenin 73 të LPK [*Ligji i Procedurës Kontestimore*], gjykata vendosi ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit, sepse të padituve Komuna e Klinës dhe Qeveria e Kosovës u mungon legjitimiteti pasiv.*
>
> *Për sa i përket kërkesëpadisë që ka të bëjë me të padituin e tretë dhe të padituin e katërt, respektivisht UNMIK-u dhe KFOR-i, gjykata hodhi poshtë padinë, sepse, sipas neneve 2.1 dhe 2.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47, të 18.08.2000 Për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut, KFOR-i dhe prona e pasuria e tij janë të liruara prej çfarëdo procedure ligjore, kurse personeli i KFOR-it është i liruar nga juridiksioni para gjykatave të Kosovës".*

17. Më 15 maj 2009, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë, për shkak të *"shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale"*.

18. Më 9 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë, (Aktgjykimi, Gz. nr. 235/09) e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe konstatoi:

> *"[...] Gjykata e Qarkut e aprovon qëndrimin ligjor të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm, sepse aktgjykimi i kontestuar nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore [...]. Sa i përket vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike[...] gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar drejt të drejtën materiale"*.

19. Më 11 shkurt 2011, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke pretenduar se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë ishte nxjerrë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Më konkretisht, parashtruesi argumentoi:

> *"[...] Aktgjykimi i kontestuar parandalon drejtpërdrejtë zbatimin e Konventës [*KEDNJ*] në këtë rast sepse asnjë nga të paditurat nuk gëzon legjitimitet pasiv; kjo do të thotë se askush nuk është përgjegjës për shkatërrimin e pronës së paditësit. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë nuk kanë dhënë asnjë provë gjatë procedurave. Ne konsiderojmë se situata faktike nuk është vërtetuar fare dhe nuk është e qartë se në çfarë baze gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kishin nxjerrë vendimet e tyre"*.

20. Më 23 janar 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, (Aktgjykimi, Rev. nr. 86/2011) e refuzoi kërkesën e parashtruesit për revizion dhe përfundoi:

> "*[...] Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, janë të pabazuara pretendimet e kërkesës për revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Në këtë drejtim, kjo Gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar drejt të drejtën materiale kur [...], e refuzoi padinë e paditësit për shpërblimin e dëmit material [...] në kohën kur paditësit i ishte shkaktuar dëmi material, përgjegjësinë për sigurinë publike dhe për administrim civil nuk e kanë pasur të*

padituri, prandaj ata, rrjedhimisht, nuk janë të obliguar të bëjnë kompensimin e tij. Kjo Gjykatë gjithashtu gjen se gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar drejt të drejtën materiale, kur hodhi poshtë [...] padinë e paditësit kundër të padituve UNMIK dhe KFOR, sepse ata ishin të liruar nga çfarëdo procedure ligjore dhe juridiksioni në Kosovë."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Duket se parashtruesi është duke bërë pretendim të trefishtë në lidhje me çështjet në vijim: vendimi i Gjykatës Supreme për të refuzuar kërkesën e tij për revizion; shkelja e së drejtës për gjykim të drejtë; dhe e drejta për mjet juridik dhe mbrojtje të pronës. Gjykata do të merret me çdo pretendim në veçanti, duke përshkruar dhe analizuar ato.

A. Përkitazi me vendimin e Gjykatës Supreme për të refuzuar kërkesën e tij për revizion

22. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi, Rev. nr. 86/2011 i Gjykatës Supreme, i 23 janarit 2013, me të cilin refuzohet kërkesa e tij për revizion, kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike]], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe të drejtat e tij të garantuara me KEDNJ, përkatësisht nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt], nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive], nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit 1.

B. Përkitazi me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë

23. Përkitazi me shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, parashtruesi pretendon: *"[...] se është bërë shkelja e së drejtës për qasje në gjykatë, sepse gjatë procedurës së zhvilluar nuk është shqyrtuar në thelb shkelja e së drejtës për gëzimin e qetë të pronës"*. Parashtruesi pretendon më tej shkeljen e " *së drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor",* sepse gjykata nuk i kishte shqyrtuar të gjitha parashtresat e bëra nga parashtruesi. Së fundmi, parashtruesi pretendon "*shkeljen e parimit të barazisë së armëve"* pasi që në shqyrtimin kryesor parashtruesi pretendon se i është dorëzuar raporti në gjuhën shqipe, të cilin ai nuk e kishte kuptuar.

24. Prandaj, parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta kishin shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë duke mos i siguruar atij qasje të duhur në drejtësi dhe në barazi të armëve në procedurë dhe duke mos i arsyetuar vendimet e tyre në mënyrë të mjaftueshme.

C. Përkitazi me mungesën e mekanizmit për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në vitin 1999 në lidhje me të drejtën për mjet juridik dhe e drejta për mbrojtjen e pronës

25. Sa i përket shkeljes së pretenduar të të drejtave të tij sipas nenit 32 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së, parashtruesi deklaron: *"[...] legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë i mundëson parashtruesit të iniciojë procedurë kundër qeverisë (qendrore dhe lokale) për kompensimin e lëndimeve të pësuara për shkak të sulmeve terroriste ose trazirave. Megjithatë, në praktikë ky mjet është plotësisht jo efektiv*. Rrjedhimisht, parashtruesi argumenton se edhe pas shterjes të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, rezultati është se: "*askush nuk është përgjegjës për kompensimin e dëmit dhe as që ka mekanizëm tjetër për ta kompensuar paditësin"*.

26. Lidhur me shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij sipas nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës, parashtruesi deklaron: *"[...] me aktet dhe procedurat e autoriteteve dhe organeve të të padituri, parashtruesit nuk i është lejuar gëzimi i qetë i pronës së tij, deri sa më vonë (pas shkatërrimit të saj) ai ishte privuar nga e drejta e tij për kompensim. Autoritetet publike janë të obliguara që ta mundësojnë gëzimin e qetë të pronës [...]"*. Parashtruesi konsideron se "*si rezultat i mosveprimit të qeverisë lokale dhe të Qeverisë së Kosovës"* është shkelur e drejta e tij në pronë.

27. Prandaj, parashtruesi në përgjithësi ankohet për mungesë të mekanizmit për kompensim të dëmeve të shkaktuara në vitin 1999 sa i përket të drejtës për mjet juridik dhe të drejtës për mbrojtje të pronës.

28. Parashtruesi përfundon duke kërkuar nga Gjykata:

> *"I. [...] ta shpallë të pranueshme këtë kërkesë, kurse aktgjykimet e përmendura të gjykatave, duke përfshirë edhe*

aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 86/2011, datë 23.1/2013 t'i shpallë të pavlefshme dhe jo kushtetuese.
II. T'i konstatojë shkeljet e numëruara më sipër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që janë kryer në dëmin tim:
- Neni 24 [Barazia para Ligjit]
- Neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]
- Neni 32 [E drejta e Mjetit Juridik]
- Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]
- Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]
Dhe shkeljet e Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut me Protokollet e saj:
a) E drejta për gjykim të drejtë, neni 6. Par. 1 i Konventës;
b) E drejta për mjet juridik efektiv, neni 13 i Konventës;
c) E drejta për gëzimin pa pengesa të pronës, neni 1 i Protokollit I të Konventës;
ç) E drejta për t'i gëzuar të drejtat dhe liritë e parashikuara nga konventa, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, neni 14 i Konventës.
III. Në bazë të shkeljeve të konstatuara, të garantuara me Kushtetutë dhe me ligje, të më caktohet shpërblimi i dëmit material dhe jo material. Në emër të dëmit material të më paguhet shuma prej 10.000 €, kurse në emër të dëmit jo material të më paguhet shuma prej 5.000 €, ose një shumë e përgjithshme prej 15.000 €".

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i ka plotësuar kriteret e nevojshme për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

A. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit lidhur me vendimin e Gjykatës Supreme për ta refuzuar kërkesën e tij për revizion

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) dhe 36 (2) b) të Rregullores së punës, që parasheh:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese,
[…]"

31. Siç u cek më lart, parashtruesi ka parashtruar padi për kompensimin e dëmit që pretendohet të jetë shkaktuar gjatë vitit 1999 në Kosovë. Pas atyre ngjarjeve, parashtruesi kishte paditur Komunën e Klinës, Qeverinë e Kosovës, KFOR-in dhe UNMIK-un me pretendimin se ata ishin përgjegjës për mosparandalimin e plaçkitjes, vjedhjes dhe shkatërrimit të pronës së tij. Si pasojë, parashtruesi vlerëson se të padituri do të duhej të konsideroheshin përgjegjës dhe të urdhëroheshin të paguanin shumën e kërkuar të kompensimit.

32. Gjykata vëren se padia e parashtruesit për kompensim të dëmit ishte refuzuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë. Gjykata gjithashtu vëren se ankesa e tij e ushtruar në Gjykatën e Qarkut ishte refuzuar si e pabazuar, siç ishte refuzuar edhe kërkesa për revizion e parashtruar në Gjykatën Supreme.

33. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme e Kosovës, me nxjerrjen e Aktgjykimit të saj, Rev. nr. 86/2011 dhe duke refuzuar kërkesën e tij për revizion dhe rrjedhimisht kërkesën e tij për kompensim të dëmit, kishte shkelur të drejtën e tij për barazi para ligjit, të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ndalimin e diskriminimit, mjete juridike dhe mbrojtje të pronës siç garantohen me Kushtetutë dhe me KEDNJ.

34. Sidoqoftë, Gjykata vëren se në procedurën ankimore, Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme, lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit, i kishin arsyetuar vendimet e tyre duke iu referuar dispozitave të ligjit në fuqi. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se ajo që ngrihet nga parashtruesi është një çështje e ligjshmërisë dhe jo e kushtetutshmërisë.

35. Në këtë drejtim, Gjykata përkujton arsyetimin e Gjykatës Supreme në përgjigjen ndaj pretendimit të parashtruesit për shkelje të ligjit, shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe vërtetim të gabuar të fakteve, që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata e Qarkut, kur kishte refuzuar ankesën e tij për kompensim të dëmit. Gjykata Supreme deklaroi:

"[…] gjykatat e shkallës më të ulët kishin vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë situatën faktike, kishin zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kishin konstatuar se padia ishte e pabazuar. Të dy

aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta përmbajnë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare relevante për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje ligjore, të pranuar si të tillë nga kjo gjykatë. Aktgjykimi i kontestuar nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ose ndonjë shkelje tjetër që do të ndikonte në rregullsinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit, siç shqyrtohen nga kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare".

36. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

37. Gjykata kushtetuese më tej thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si edhe të asaj materiale (shih rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011). Fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e tij nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave të tij, të mbrojtura me Kushtetutë.

38. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të trajtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, Apl. nr. 13071/87 *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, App. nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut i 10 korrikut 1991).

39. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se arsyetimi që i referohej kërkesës për kompensim të dëmit në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjeti se procedurat në Gjykatën e Qarkut dhe në Gjykatën Komunale nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

40. Gjykata gjithashtu dëshiron të theksojë se rasti i parashtruesit është i ngjashëm me rastin Nr. KI01/11 (shih rastin KI01/11 të

parashtruesit *Gradjevinar*, rast i Gjykatës Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri, i 4 tetorit 2011). Në atë rast, parashtruesi kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për revizion lidhur me kompensimin e dëmit në vitin 1999. Kërkesa e parashtruesit për vlerësim të kushtetutshmërisë ishte refuzuar si qartazi e pa bazuar, sipas rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës. Gjykata konstatoi se faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk kishin arsyetuar pretendimin e tij për shkelje të të drejtave kushtetuese.

41. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi është përpjekur ta argumentojë pretendimin e tij, përmes renditjes së rasteve të ndryshme të praktikës gjyqësore dhe argumenteve të tjera. Megjithatë, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të të drejtave kushtetuese, të thirrura nga parashtruesi.

42. Rrjedhimisht, kjo pjesë e kërkesës është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) b) të Rregullores së punës.

B. Sa i përket pretendimit të parashtruesit për shkelje të së drejtës së tij për një gjykim të drejtë nga gjykatat e rregullta

43. Siç u theksua më lart, parashtruesi pohon se gjykatat e rregullta kishin shkelur disa komponentë të së drejtës së tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, përkatësisht "*të drejtën e qasjes në gjykata*"; *"të drejtën e tij për një vendim të arsyetuar"* dhe *"të drejtën për barazi të armëve"*.

44. Lidhur me këto pretendime të veçanta, Gjykata vëren se parashtruesi nuk e kishte pretenduar asnjëherë në Gjykatën e Qarkut ose Gjykatën Supreme shkeljen e së drejtës së tij për gjykim të drejtë. Ai thjesht këmbëngul: *"Komuna e Klinës dhe Qeveria e Kosovës janë përgjegjëse në bazë të nenit 180 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore"* dhe se *"ekziston përgjegjësia e KFOR-it dhe UNMIK-ut, në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së"*.

45. Gjykata vëren se parashtruesi ka pasur mundësi të shumta t'i paraqesë pretendimet e tij në gjykatat e rregullta. Megjithatë, parashtruesi i ngre këto pretendime për herë të parë në Gjykatë.

46. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i ka ngritur gjithnjë shqetësimet e tij lidhur me çështjen e *"legjitimitetit pasiv"* për Komunën e Klinës dhe Qeverinë e Kosovës dhe çështjen se *"KFOR-i dhe UNMIK-u nuk duhet të jenë imun për nga përgjegjësia"*. *Megjithatë,* ai nuk e ka ngritur asnjëherë pretendimin se e drejta e tij për gjykim të drejtë ishte cenuar apo shkelur në ndonjë mënyrë.

47. Me fjalë të tjera, parashtruesi vetëm ankohet në bazë të *"shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore"*; "*vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike"*; dhe *"aplikimit të gabuar të së drejtës materiale"* që lidheshin drejtpërdrejt me kërkesën e tij për kompensim të dëmit. Ai asnjëherë nuk kishte pretenduar, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, se ishte shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë. Kështu, Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme nuk kanë mundur t'i marrin parasysh pretendimet e tilla, sepse ato nuk ishin ngritur para tyre.

48. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se njëri nga parimet themelore të gjykimit kushtetues është ai i subsidiaritetit. Në kontekstin e veçantë të Gjykatës, kjo do të thotë se detyra për të siguruar respektimin e të drejtave të parashikuara me Kushtetutë u takon në radhë të parë autoriteteve të rregullta gjyqësore dhe jo drejtpërsëdrejti dhe menjëherë Gjykatës Kushtetuese (shih *Scordino kundër Italisë*, nr. 1, GJEDNJ, Aktgjykim i 29 marsit 2006, § 140).

49. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi është dashur t'iu japë mundësinë gjykatave të rregullta që t'i shqyrtojnë këto ankesa konkrete dhe, nëse është e nevojshme, t'i korrigjojnë ato në pajtim me juridiksionin dhe kompetencat e tyre ligjore.

50. Prandaj, Gjykata vjen në përfundimin se nuk duhet shqyrtuar asnjë shkelje e së drejtës për gjykim të drejtë.

C. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit lidhur me mungesën e një mekanizmi për kompensim të dëmit të shkaktuar në vitin 1999 lidhur me të drejtën për mjet juridik dhe të drejtën për mbrojtjen e pronës

51. Parashtruesi, përveç ankesës për jokushtetutshmërinë e pretenduar të Aktgjykimit, Rev. nr. 86/2011 të Gjykatës Supreme, të 23 janarit 2013, ai gjithashtu ankohet, në përgjithësi, për: *"[...] mungesën e një mekanizmi për kompensimin e dëmit të shkaktuar në pronën e tij në vitin 1999, që solli shkeljet e të drejtave të tij të garantuara kushtetuese"*.

52. Në këtë drejtim parashtruesi "[...] *i bën thirrje Gjykatës Kushtetuese ti shpreh qëndrimet e veta për sa i përket kontinuitetit të këtyre obligimeve dhe sukcesionit të titullarëve të ndryshëm të detyrimeve në territorin e Republikës së Kosovës"*. Ai mundohet ta mbështesë kërkesën e tij, duke deklaruar që: *"[...] është shumë e thjeshtë që të hidhen poshtë kërkesat për kompensim të pronës së shkatërruar vetëm në bazë të situatës në vitin 1999, duke theksuar se UNMIK-u dhe KFOR-i kanë gëzuar imunitet dhe se institucionet vendore nuk kanë ekzistuar në atë kohë"*.

53. Lidhur me këtë, Gjykata konstaton se thelbi i ankesës së parashtruesit ka të bëjë me mosekzistencën e pretenduar të një mjeti efektiv sa i përket të drejtës së tij për mbrojtje të pronës, të garantuar me Kushtetutë dhe me KEDNJ. Prandaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata *"të marrë një qëndrim"* në mënyrë që të adresohet kjo çështje.

54. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit shkon përtej kontestimit të kushtetutshmërisë së vendimeve të gjykatave të rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme. Kërkesa e parashtruesit shkon përtej juridiksionit të Gjykatës, të përcaktuar me nenin 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë se: *"Individët janë autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, [...]"*.

55. Lidhur me këtë, Gjykata tërheqë vëmendjen në rregullin 36 (3) f) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet sie papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*
>
> *[...]*
>
> *f) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën"*.

56. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit që Gjykata Kushtetuese duhet "*të marrë një qëndrim*" në këtë çështje, nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Me fjalë të tjera, këto pretendime të përgjithshme, të bëra nga parashtruesi, nuk i shërbejnë të ngrejë një çështje kushtetuese brenda kompetencave të parapara me nenin 113.7.

57. Prandaj, Gjykata konstaton se, në pajtim me rregullin 36 (3) f) të Rregullores së punës, kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme sepse nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, rregullat 36 (1) c), 36 (2) b), 36 (3) f) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 15 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 217/13, "H. P. G" SH. P. K., Aktvendim i datës 23 shtator 2014- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. AC-I-13-0169, të 10 tetorit 2013

Rasti KI 217/13, vendimi i 23 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (pa pretenduar nene), kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushteutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tij kushtetuëse janë cenuar me aktgjykimin e gjykatave të rregullta. Parashtruesi i kërkeses ushtroi padi prane DHPGJS-se, duke kërkuar anulimin e vendimit të AKP-së dhe që DHPGJS-ja të nxjerrë urdhër paraprak gjyqesor me qellim të ndalimit të rihapjes së tenderit për kompaninë në fjale deri në vendimin përfundimtar.

Parashtruesi pretëndon së i është cenuar e drejta për gjykim të drejtë për shkak të veprimeve dhe lëshimeve të DHPGJS pasi që parashtruesit të kërkeses "kurre nuk i është dhënë mundësia te përgjigjet ndaj kundështimeve të të paditurit".

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrusit ishte e papranushme bazuar ne Rregullit 36 të Rregullores së punës per shkak që ishte qartazi e pabazuar. Gjykata vendimin e saj e arsyton duke theksuar që veren se parashtruesi i kërkeses vetë kishte dorezuar kërkesen për urdhër paraprak gjyqesor në DHPGJS, kërkese të cilen kjo e fundit ia dergoi AKP-së për të dorezuar verejtjet e saj. DHPGJS, në diskrecionin e saj dhe bazuar në kërkesen e parashtruesit dhe në verejtjet e AKP-së, vendosi të refuzoje kërkesen për urdhër paraprak gjyqesor. Për më tepër, parashtruesi i kërkeses paraqiti ankesë në Kolegjin e Anëksave të DHPGJS më çrast atyre u ishte dhënë mundesia për të paraqitur verejtjet e tyre lidhur me këtë pretendim. DHPGJS e arsyetoi vendimin e saj për refuzim të kërkeses për urdhër paraprak dhe kështu Gjykata nuk mund të konkludoje së procedurat relevante kanë qënë në ndonje menyre të padrejta apo arbitrare. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk mund te veproje si gjykate e shkalles se katert, perkitazi me vendimet e nxjerra

nga keto gjykata.Për shkak te arsyeve të permendura, Gjykata vendosi të hedhe poshte kërkesen si të pa prpranuëshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI217/13
Parashtrues
"H. P. G" SH. P. K.
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. AC-I-13-0169, të 10 tetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar (SH. P. K.) "H. P. G" (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), e përfaqësuar nga znj. Iliriana Osmani-Serreqi dhe z. Gani Tigani, avokatë nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS), AC-I-13-0169, të 10 tetorit 2013, që i është dorëzuar atij më 11 tetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar që pretendohet se " *është jo-kushtetues dhe si i tillë të anulohet*".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën më 27 nëntor 2013.

6. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI217/13, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI217/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 6 shkurt 2014, DHPGJS u njoftua për kërkesën.

8. Më 26 maj 2014, DHPGJS-ja dorëzoi komentet e saj.

9. Më 23 shtator 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës mori pjesë në tenderin e shpallur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) për privatizimin e kompanisë "Bankos LLC" në Pejë. Parashtruesi i kërkesës ishte ofertuesi më i lartë për tenderin në fjalë (Shkresa e AKP-së, Nr. ref. 641, e 24 shtatorit 2012).

11. Më 29 mars 2013, AKP-ja e njoftoi parashtruesin e kërkesës për anulimin e tenderit pasi që "*çmimi i ofruar ka qenë shumë i ulët*".

12. Më 17 prill 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në AKP ndaj vendimit të Bordit për anulimin e tenderit.

13. Më 18 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi pranë DHPGJS-së, duke kërkuar anulimin e vendimit të AKP-së dhe që DHPGJS-ja të nxjerrë urdhër paraprak gjyqësor me qëllim të ndalimit të rihapjes së tenderit për kompaninë në fjalë deri në vendimin përfundimtar.

14. Më 31 korrik 2013, Trupi gjykues i DHPGJS-së (Aktvendimi C-I-13-0015) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për shqiptimin e urdhrit paraprak gjyqësor.

15. DHPGJS konstatoi:

> *"Gjykata mendon se në këtë lëndë kushtet nga neni 55.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/ L-033 mbi DHPGJSK, për dhënjen e ndalimit paraprak gjyqësor, nuk janë të plotësuara. Sepse paditësi nuk ka argumentuar, që do të pësoi dëm të drejtëpërdrejtë dhe të pa riparueshëm, nëse masa e Përkohëshme nuk do të caktohet.*
> *Në të vërtet, nuk egziston asnjë provë, se do të ndodhë dëm i drejtpërdrejtë, sepse nga rrethanat mund të supozojmë se në ardhëmërinë e afërt, nuk do të hapet prapë tenderi. Sa i përket kësaj lënde, nuk egziston provë, që dëmi i drejtëpërdrejtë dhe i pariparueshëm, nuk mund të kompenzohet në mënyrë racionale me dhënjen e kompenzimit monetar".*

16. Më 28 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë ndaj Aktvendimit të DHPGJS të 31 korrikut 2012 për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

17. Më 10 tetor 2013, Kolegji i Ankesave i DHPGJS (Aktvendimi AC-I-13-0169) e refuzoi si të pabazuar ankesën e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës dhe e vërtetoi Aktvendimin e Trupit Gjykues të DHPGJS, C-I-13-0015, të 31 korrikut 2013.

18. Kolegji i Ankesave i DHPGJS konstatoi që:

> *"Arsyetimi i lart-cituar i Kolegjit të Specializuar nuk mund të konsiderohet si bazë e mjaftueshme për aktvendim. Ne fakt Kolegji e bazon aktvendimin e tij në prezumimin i cili nuk është i mjaftueshëm si bazë për aktvendim. Pos kësaj, Kolegji i Specializuar nuk ka saktësuar se cilat rrethana do ta mbështesnin këtë prezumim. Prandaj, arsyetimi është i pavlefshëm. Mirëpo, kjo nuk do të ketë ndikim në aktvendimin e marrë pasi që Kolegji i Apelit vlerëson se megjithatë, ankesa duhet të refuzohet mbi këto baza. Në këtë lëndë, apeluesi, mbi të cilin bie barra e provave, në kuptim të nenit 55.1 të Shtojcës, nuk ka siguruar prova të besueshme se ekziston e drejta e pohuar të cilën ai e ka kërkuar. Apeluesi nuk ka sjell dëshmi se rezultati i tenderit është detyrues për Agjencinë dhe se është*

dashur të çojë kah nënshkrimi i kontratës për shitblerje. Përkundrazi, në fakt rregullat e tenderit i kanë lejuar Bordin e AKP-së që ta anulojë tenderin në çdo kohë para nënshkrimit të kontratës. Neni 17.1 i Rregullave të Tenderit përcakton se: "Bordi sipas zgjedhjes së tij mund të shtyjë dhe të anulojë tenderin në çfarëdo kohe ose për çfarëdo arsye". Andaj, shpallja si fitues i përkohshëm nuk është garanci se Agjencia do ta nënshkruajë kontratën për shitblerje. Për tërheqjen e tenderit, AKP iu ka referuar kësaj dispozite të Rregullave të Tenderit".

19. Më 26 maj 2014, DHPGJS e njoftoi Gjykatën se ajo kishte vepruar në pajtim me nenin 55.2 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme ku thuhet se "*Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një vendim lidhur me shkresën për një urdhër paraprak gjyqësor pa mbajtjen e seancës dëgjimore dhe pasi që pala tjetër të ketë pasur mundësinë për të paraqitur argumentet kundërshtuese me shkrim. Kur ekzistojnë rrethana urgjente që detyrojnë Dhomën e Posaçme të veprojë menjëherë lidhur me shkresën, atëherë Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një vendim për shkresën mbi urdhrin paraprak gjyqësor pa ia dorëzuar shkresën palës tjetër. Urdhri paraprak gjyqësor lëshohet vetëm për një periudhë kohore të caktuar dhe mund të zgjatet pas parashtrimit të kërkesës".*

20. DHPGJS më tej e informoi Gjykatën se ajo kishte vendosur vetëm lidhur me urdhrin paraprak gjyqësor dhe se ende nuk kishte vendosur për meritat e rastit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i është cenuar e drejta për gjykim të drejtë për shkak të veprimeve dhe lëshimeve të DHPGJS pasi që parashtruesit të kërkesës *"kurrë nuk i është dhënë mundësia të përgjigjet ndaj kundërshtimeve të të paditurit".*

22. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"e paditura ka ushtruar Përgjegje lidhur me Kërkesën e paditësit për propozimin që të ipet Urdhëri paraprak gjyqësor ndërsa paditësit nuk i është dhënë mundësia që lidhur me kundërshtimet e të paditurit të deklarohet. Përderisa padia e paditësit i dorëzohet të paditurit për deklarim, deklarimet e të paditurit nga Përgjigja në Kërkesë për urdhër paraprak gjyqësor nuk i bëhet të njohura dhe nuk i dorëzohen në shiqim paditësit".*

23. Parashtruesi i kërkesës duket se konkludon që e drejta për gjykim të drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së i është cenuar nga DHPGJS.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Para së gjithash, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë.

25. Për më tepër, rregulli 36 (1) c dhe (2) b) i Rregullores së punës parashikon që:

> *(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.*

26. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka vërtetuar një pretendim mbi baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar dëshmi që provojnë se të drejtat dhe liritë e tij themelore janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

27. Gjykata mundet vetëm të vlerësojë nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara si tërësi, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih mes tjerash, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, App. Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

28. Përveç kësaj, sa i përket pretendimeve të parashtruesit lidhur me mundësinë për t'u përgjigjur ndaj përgjigjes së të padituërës, duhet vërejtur se sipas GJEDNJ-së, ajo *"[...] në të kaluarën ka gjetur se moskomunikimi i vërejtjeve me shkrim ose dokumenteve në procedurë dhe pamundësia e parashtruesit të kërkesës për të komentuar lidhur me to nuk përbënin shkelje të së drejtës për dëgjim të drejtë. Në arsyetimin e saj, Gjykata ka shpjeguar se, në rastet konkrete, lejimi i të drejtave dhe mundësive të tilla parashtruesit të kërkesës nuk do të kishte ndikim në rezultatin përfundimtar të procedurave sepse qasja ligjore e zgjedhur nuk ishte e hapur për diskutim"*. (shih rastin *Hudakova dhe të tjerët*

kundër Sllovakisë, Kërkesa nr. 23083/05, Aktgjykim i 27 prillit 2010).

29. Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetë kishte dorëzuar kërkesën për urdhër paraprak gjyqësor në DHPGJS, kërkesë të cilën kjo e fundit ia dërgoi AKP-së për të dorëzuar vërejtjet e saj. DHPGJS, në diskrecionin e saj dhe bazuar në kërkesën e parashtruesit dhe në vërejtjet e AKP-së, vendosi të refuzojë kërkesën për urdhër paraprak gjyqësor. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Ankesave të DHPGJS me ç'rast atyre u ishte dhënë mundësia për të paraqitur vërejtjet e tyre lidhur me këtë pretendim.

30. Gjykata vëren se DHPGJS e arsyetoi vendimin e saj për refuzim të kërkesës për urdhër paraprak dhe kështu Gjykata nuk mund të konkludojë se procedurat relevante kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, Vendim i GJEDNJ-së lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

31. Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga këto gjykata. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

32. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 vetë (1) c) të Rregullores së Punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe prandaj është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me rregullat 36 (1) c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI108/14, Sevdije Sllovinja, Aktvendim i datës 17 shtator 2014- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 107/2014, të 22 prillit 2014

Rasti KI108/14, vendim i 17 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, liritë dhe të drejtat themelore, qartazi i pabazuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave

Parashtruesja ka bazuar kërkesën e saj në nenin 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 107/2014 ka shkelur të drejtën e saj kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës i është referuar edhe nenit 6 të KEDNJ-së, i cili garanton të drejtën për një proces të rregullt.

Gjykata gjeti se parashtruesja e kërkesës nuk ka treguar pse dhe si i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë. Një deklaratë e thjeshtë se është shkelur Kushtetuta nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Gjykata më tej thekson se nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga gjykata e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Pra, kjo Gjykatë nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI108/14
Parashtrues
Sevdije Sllovinja
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 107/2014, të 22 prillit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Sevdije Sllovinja (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës) me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), Rev. nr. 107/2014, të 22 prillit 2014, i cili i ishte dorëzuar asaj në një datë të paspecifikuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar i cili pretendohet t'i ketë "*shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 qershor 2014, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. GJR. KI108/14 caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin Nr. KSH. KI108/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 23 korrik 2014, Gjykata Supreme u njoftua për kërkesën.

8. Më 17 shtator 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 13 shkurt 2004, Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK), miratoi kërkesën e parashtrueses për pension në kategorinë "A" (Vendimi nr. 43/14) në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 dhe me Statutin e Fondit Pensional Suplementar të KEK-ut.

10. Në vendimin e sipërpërmendur të KEK-ut ishte përcaktuar që pagesa e pensionit për parashtruesen e kërkesës do të fillonte më 1 shkurt 2004 dhe do të përfundonte më 28 shkurt 2009, ndërsa shuma e pensionit mujor do të jetë 105 euro. Më tej, në vendim theksohej që pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë, brenda afatit kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pranë Komitetit për shqyrtimin e mospajtimeve, nëpërmjet Administratës së Fondit Pensional.

11. Sipas dokumenteve të parashtruara, kundër këtij vendimi nuk është parashtruar ankesë.

12. Pas 1 marsit 2009, KEK-u kishte ndërprerë pagesën e pensionit për parashtruesen e kërkesës, siç specifikohej në marrëveshje.

13. Parashtruesja e kërkesës parashtroi padi pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë.

14. Më 21 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 912/2009) miratoi padinë e parashtruar nga parashtruesja e kërkesës dhe e *"detyroi KEK-un t'i vazhdoi pagesat deri në krijimin e Fondit Pensional dhe Invalidor të Kosovës"*.

15. KEK-u parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale (Aktgjykimi C. nr. 912/2009).

16. Më 8 nëntor 2013, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ca. nr. 3382/2012) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruar nga KEK-u dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 21 dhjetorit 2011.

17. KEK-u parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

18. Më 24 prill 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 107/2014) e miratoi revizionin e parashtruar nga KEK-u.

19. Gjykata Supreme konstatoi që:

> *"Gjykata Supreme e Kosovës, nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm një qëndrim të tillë juridik të gjykatave të instancës më të ulët, për shkak se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i goditur dhe ai i shkallës së parë janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale me rastin e aprovimit si të bazuar kërkesëpadisë së paditëses. Këtë qëndrim gjykata e revizionit e morri për faktin se detyrimi i të paditurës në pikëpamje të kohëzgjatjes të kësaj të drejte të paditëses respektivisht detyrimit të paditurës nuk mundë të lidhet dhe të kushtëzohet më themelimin e Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor ashtu si gabimisht vlerësojnë gjykatat e instancës më të ulët, por ndërprerja e marrëdhënies së punës është e lidhur me periudhë prej dt. 01.02.2004 dhe përfundon më dt. 29.02.2009. Në bazë të marrëveshjes - vendimit të lartcekur, (të cilën vendim e paditura nuk e ka kontestuar), saksishtë është përcaktuar kohëzgjatje e detyrimi të paditurës*

që të kompensoj pagesën e pensionit deri në me dt. 29.02.2009, ky detyrim nga ana ë të paditurës është përmbushur për periudhën prej 5 vjet (60 muaj), për çdo muaj në shumë prej 105 €, ashtu si qëndron në vendim edhe pse në bazë të vendimit të Bordit Ekzekutiv të paditurës nr. 3873/11-C, të dt. 25.07.2006 dhe në bazë të vendimit të Bordit të Menaxherëve të FPS.e e paditura, ka ndërprerë financimin ë këtij fondi nga dt. 31.07.2006".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesja e kërkesës pretendon që aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës *"shkel të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

21. Si përfundim, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata si në vijim:

"Të vërtetohet gjendja faktike, të shqyrtohen drejtë të gjitha shkresat e lëndës, dhe të më kompensohet shuma e vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës, C. nr. 912/2009 i dt. 21 dhjetor 2011".

Pranueshmëria e kërkesës

22. Para së gjithash, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) dhe rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës, që përcaktojnë se:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese,

[...]".

24. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar dëshmi se të drejtat dhe liritë e saj themelore janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

25. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë që procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë ashtu që parashtruesit e kërkesës të kenë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).

26. Gjykata thekson se Gjykata Supreme e ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme aktgjykimin e saj, prandaj Gjykata nuk mund të nxjerr përfundimin se procedurat përkatëse kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

27. Si përmbledhje, parashtruesja e kërkesës nuk ka treguar pse dhe si i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë. Një deklaratë e thjeshtë se është shkelur Kushtetuta nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga gjykata e rregullt, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Pra, kjo Gjykatë nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

28. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.

29. Për më tepër, në lidhje me rastet e tjera të gjykuara nga Gjykata sa i përket kompensimit të përkohshëm për shkëputjen e marrëdhënies së punës nga KEK-u, Gjykata konsideron që në bazë të dokumenteve të parashtruara dhe të procedurave të përfunduara, kjo kërkesë dallon nga ato të sipërpërmendurat, pasi që, për dallim

nga gjendja faktike në rastin konkret, marrëveshja e nënshkruar ndërmjet KEK-ut dhe ish-punonjësve të tjerë të KEK-ut në ato kërkesa ishte deri në krijimin e Fondit Pensional dhe Invalidor të Kosovës pa ndonjë referencë për datën e përfundimit (shih Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI10/12, KI25/12 dhe KI54/14).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 17 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KO155/14, Avokati i Popullit të Republikës së Kosovës, Aktvendim i datës 13 nëntor 2014- duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Dekretit së Presidentes së Republikës së Kosovës, për konfirmimin e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. DKGJK-001-2014,të 31 gushtit 2014

Rasti KO155/14, vendimi i 13 nëntorit 2014.

Fjalët kyçe: kontroll abstrakt, Dekreti i Presidentes së Republikës së Kosovës, mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës, parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe 135.4 të Kushtetutës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Dekretit, duke pretenduar se është në kundërshtim me procedurën kushtetuese për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të përcaktuar me nenin 114.2 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], me nenin 65 (11) [Kompetencat e Kuvendit] dhe ne nenin 84 (19) [Kompetencat e Presidentit], të Kushtetutës. Për më tepër, parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) "[...] të vendosë Masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të Dekretit të Presidentes deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës". Gjithashtu, parashtruesi kërkon që Gjykata të gjejë se "[...] është në interes të publikut dhe demokracisë që tre gjyqtarët ndërkombëtarë të mos vazhdojnë të marrin pjesë në vendimmarrjen e kësaj Gjykate derisa të sigurohet kushtetutshmëria e emërimit të tyre". të "interpretojnë dispozitat e Kushtetutës së Kosovës lidhur me vendet e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk përbëjnë shumicën në Kosovë".

Përkitazi me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se argumentet e parashtruesit të kërkesës kryesisht ndërlidhen me përmbajtjen e Marrëveshjes ndërkombëtare të lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian nëpërmjet këmbimit të letrave, e ratifikuar nga Kuvendi më 23 prill 2014, edhe pse parashtruesi pohon se ai konteston vetëm kushtetutshmërinë e Dekretit. Prandaj, parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij dhe nuk ka provuar se Dekreti është jokushtetues. Po ashtu, siç e thekson me të drejtë edhe vetë parashtruesi i kërkesës, Gjykata nuk ka juridiksion *ratione materiae* për të trajtuar çështjen nëse marrëveshjet ndërkombëtare janë në

përputhje me Kushtetutën (Shih Rastin KO95/13, parashtrues i kërkesës *Visar Ymeri dhe* 11 *deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës* së *Kosovës,* Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhe të Planit të Zbatimit për këtë Marrëveshje, Aktgjykim i 9 shtatorit 2013). Rrjedhimisht, sa i përket procedurës së ndjekur nga Presidentja, Gjykata konkludon se Dekreti është në pajtueshmëri me Kushtetutën. Prandaj, Gjykata e refuzoi kërkesën si qartazi të pabazuar, në pajtim me paragrafin (1) c) dhe 2 të rregullit 36 të Rregullores së punës.

Për sa i përket kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata konkludoi që duke qenë se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar dhe, prandaj, e papranueshme, Gjykata vendosi që kërkesa për masë të përkohshme nuk është më subjekt i shqyrtimit, dhe, rrjedhimisht, duhet refuzuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KO155/14
Parashtrues
Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës për konfirmimin e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. DKGJK-001-2014, të 31 gushtit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, z. Sami Kurteshi.

Dekreti i sfiduar

2. Parashtruesi i kërkesës sfidon Dekretin e Presidentes së Republikës së Kosovës për konfirmimin e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. DKGJK-001-2014, të 31 gushtit 2014 (në tekstin e mëtejmë: Dekreti).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon vlerësim të kushtetutshmërisë së Dekretit, duke pretenduar se ai është në kundërshtim me procedurën kushtetuese për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të përcaktuar në nenin 114.2 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], në nenin 65 (11) [Kompetencat e Kuvendit] dhe në nenin 84 (19) [Kompetencat e Presidentit], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta].

4. Për më tepër, parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) [...] të vendosë Masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të Dekretit të Presidentes deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Gjithashtu, parashtruesi kërkon që Gjykata të gjejë se "[...] *është në interes të publikut dhe demokracisë që tre gjyqtarët ndërkombëtarë të mos vazhdojnë të marrin pjesë në vendimmarrjen e kësaj Gjykate derisa të sigurohet kushtetutshmëria e emërimit të tyre*".

Baza juridike

5. Neni 113.2 (1) dhe neni 135.4 i Kushtetutës, nenet 27, 29 dhe 30 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 9 tetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 10 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KO155/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KO155/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 13 tetor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti të dorëzojë dokumente shtesë.

9. Të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Presidentes së Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga Presidentja të dorëzojë komentet e saj, së bashku me çfarëdo dokumenti që ajo e vlerëson të nevojshëm përkitazi me kërkesën e dorëzuar. Presidentja e Republikës së Kosovës nuk ka dorëzuar asnjë koment.

10. Më 14 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi dokumentet shtesë.

11. Më 4 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandim për papranueshmërinë e kërkesës.

12. Më 19 gusht 2014, Gjykata vendosi (Rasti KI124/14) të përjashtojë gjyqtarin Kadri Kryeziu nga pjesëmarrja në seancat shqyrtuese për të gjitha kërkesat e ardhshme drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ku është i përfshirë, ndër të tjerë, edhe Avokati i Popullit. Rrjedhimisht, gjyqtari Kadri Kryeziu nuk ka marrë pjesë në procedurë dhe në vendimmarrje të Gjykatës për rastin e tanishëm KO155/14.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 12 qershor 2009, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (në tekstin e mëtejmë: PCN), emëroi tre gjyqtarë ndërkombëtarë në Gjykatë për një periudhë trevjeçare (Vendimi Nr. 2009/09, Vendimi Nr. 2009/10 dhe Vendimi Nr. 2009/11).

14. Më 17 korrik 2012, PCN-ja nxori Vendimin Nr. 2012/17, Vendimin Nr. 2012/18 dhe Vendimin Nr. 2012/19, për riemërimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë deri më 31 gusht 2014.
15. Më 14 prill 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës i dërgoi letër Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri (në tekstin e mëtejmë: Bashkimi Evropian), *inter alia*, për të konfirmuar *"emërimin e [...] gjyqtarëve ndërkombëtarë që shërbejnë në Gjykatën Kushtetuese dhe të emëruar nga PCN-ja [...]"*.

16. Në të njëjtën datë, Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian iu përgjigj Presidentes së Republikës së Kosovës, duke pranuar letrën e 14 prillit 2014.

17. Më 23 prill 2014, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi me shumicë të dy të tretave Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e BE për Sundim të Ligjit në Kosovë, Nr. 04/L-274 (në tekstin e mëtejmë: Ligji Nr. 04/L-274).

18. Më 31 gusht 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës nxori "*Dekretin për konfirmimin e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës"*, në bazë të nenit 84.4 të Kushtetutës, të nenit 2 (Shtojca 1) të Ligjit Nr. 04/L-274 dhe, në përputhje me përmbajtjen e Letrës nr. 693, të 25 gushtit 2014, nga Shefi i Misionit EULEX Kosova, drejtuar Presidentes së Republikës së Kosovës.

Argumentet e paraqitura nga parashtruesi

19. Parashtruesi pohon se Dekreti i sfiduar nuk është nxjerrë në pajtim me dispozitat e aplikueshme kushtetuese.

20. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se Dekreti i Presidentes është në kundërshtim me procedurën kushtetuese për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, sepse Presidentja e Republikës së Kosovës ua vazhdoi mandatin tre gjyqtarëve ndërkombëtarë pa marrë propozim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi).

21. Parashtruesi i kërkesës shpjegon se *"gjyqtarët e asaj Gjykate emërohen nga Presidenti 'me propozimin e Kuvendit', Kushtetuta, neni 114, pika 2. Ky rol i posaçëm i Kuvendit konfirmohet edhe nga dispozita të tjera kushtetuese. Neni 65, pika 11, përcakton se 'Kuvendi i Republikës së Kosovës [...] propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese' dhe në të njëjtën mënyrë, neni 84, pika 19, përcakton se 'Presidenti i Republikës së Kosovës emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit"*.

22. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *"angazhimi i Kuvendit në procedurën e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese siguron që askush nuk mund të zënë vend në gjykatën më të lartë të vendit pa u propozuar nga përfaqësuesit e drejtpërdrejtë të popullit"*.

23. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se *"vazhdimi i mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë pa propozimin e Kuvendit, nuk justifikohet* nga *përmbajtja e marrëveshjes ndërkombëtare e vitit 2014 midis Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian"*.

24. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se *"pyetja kryesore në këtë rast është, nëse kjo marrëveshje ndërkombëtare, bashkë me emërimet e tre gjyqtarëve ndërkombëtarë nga ana e EULEX-it, mund të justifikojë anashkalimin e Kuvendit për vazhdimin e mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë, në kundërshtim me procedurën e paraparë në Kushtetutë"*.

25. Parashtruesi i kërkesës i referohet letrës së Presidentes së Republikës së Kosovës, të 14 prillit 2014, ku *inter alia* thuhet si në vijim: *"Neni 20 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i lejon Republikës që t'i bart disa kompetenca, për çështje specifike, tek organizatat ndërkombëtare. [...] Kështu, në bazë të nenit 20 të*

Kushtetutës së Republikës së Kosovës, unë ju konfirmoj që kompetencat në vijim do t'i delegohen misionit EULEX KOSOVA- (a) të emërojë gjyqtarë, sipas neneve 65, 108, 114, respektivisht 84, të Kushtetutës, duke iu nënshtruar edhe konfirmimit të atyre emërimeve nga Presidenti, pas pëlqimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës [...]".

26. Parashtruesi i kërkesës argumenton se *"megjithëse nuk specifikon që do t'i delegohet EULEX-it kompetenca për të emëruar gjyqtarë, posaçërisht të Gjykatës Kushtetuese, ky paragraf [referenca e lartpërmendur në letrën] i referohet nenit 114 [i Kushtetutës] , i cili e ka titullin 'Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese' dhe i cili përcakton se '[g]jyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit' (neni 114.2)".*

27. Parashtruesi i kërkesës më tej konsideron se, *"sipas nenit 20, në mënyrë që të delegohet një kompetencë tek një organizatë ndërkombëtare, ai delegim duhet të bazohet në një marrëveshje ndërkombëtare" [...]. "Në rastin e marrëveshjes midis Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, letra e palës së parë, Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga Presidentja Jahjaga, i bëri ftesë Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga baronesha Ashton, që të vazhdojë qëndrimin e EULEX-it deri në vitin 2016. Si pjesë e kësaj ftese, Presidentja Jahjaga propozoi që EULEX-i të marrë përsipër një sërë kompetencash, duke përfshirë kompetencën e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Sipas procedurës se zakonshme [...] përgjigja e baroneshës Ashton duhej të ishte një letër që i jep përgjigje palës së parë 'duke e riprodhuar përmbajtjen e plotë të letrës origjinale dhe duke e shprehur pëlqimin mbi të'".*

28. Sipas parashtruesit të kërkesës, kjo nuk ndodhi, por përgjigjja ishte e thjeshtë dhe aty thuhej si në vijim: *"E pranoj ftesën e bërë në letrën tuaj të datës 14 prill për të vazhduar zbatimin e mandatit të EULEX-it në Kosovë, siç është cekur në Veprimin e Përbashkët 2008/124/CFSP, të miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian me datën 4 shkurt 2008 dhe të ndryshuar, në frymën e bashkëpunimit të ndërsjellë".*

29. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Veprimi i Përbashkët e autorizon EULEX-in që të veprojë vetëm brenda institucioneve të krijuara në bazë të Rezolutës 1244. [...] Meqenëse Gjykata Kushtetuese nuk ka qenë institucion i krijuar sipas Rezolutës 1244, është e qartë se kompetenca për të emëruar gjyqtarët e kësaj Gjykate do ta sillte EULEX-in jashtë kornizës së*

Veprimit të Përbashkët. Prandaj, delegimi i kompetencës së emërimit tek EULEX-i nuk u pranua zyrtarisht nga baronesha Ashton, dhe nuk është pjesë e mirëfilltë e marrëveshjes ndërkombëtare".

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon, më tej, se Presidentja e Republikës së Kosovës, në letrën e saj të 14 prillit 2014, nuk i ka deleguar EULEX-it në mënyrë të qartë dhe specifike kompetencën për propozimin e gjyqtarëve në pajtim me nenin 31, pika 1, të Konventës së Vjenës për Traktatet Ndërkombëtare. Prandaj, pretendohet se kompetenca për të propozuar gjyqtarë mbetet te Kuvendi i Republikës së Kosovës.

31. Parashtruesi i kërkesës konkludon se Gjykata ka juridiksion *ratione materiae* për të shqyrtuar këtë rast, sepse me këtë kërkesë sfidohet kushtetutshmëria e Dekretit dhe jo e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Ai argumenton se *"[...] substanca e Dekretit të Presidentes nuk është një marrëveshje ndërkombëtare; është një konfirmim i vazhdimit të mandatit të tre gjyqtareve".* Gjithashtu, *"një akt juridik nuk mund të shpëtohet nga juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese, thjesht duke cituar një marrëveshje ndërkombëtare. Po të ishte aq e thjeshtë, atëherë Presidentja do të mund ta citonte marrëveshjen ndërkombëtare në diskutim si bazë ligjore e të gjitha dekreteve dhe akteve të saj, pavarësisht nëse në të vërtetë kanë lidhje me të ose jo. Dhe, në këtë mënyrë, ajo do të mund të mbronte të gjitha veprimet e saj si Presidente nga shqyrtimi i kushtetutshmërisë së atyre nga Gjykata".*

Pranueshmëria e kërkesës

32. Sa i përket pretendimit të parashtruesit se Dekreti nr. DKGJK-001-2014, i nxjerrë nga Presidentja e Kosovës më 31 gusht 2014, është jokushtetues, Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të gjykojë lidhur me ankesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse ai i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

33. Së pari, Gjykata duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës mund të konsiderohet palë e autorizuar. Në këtë drejtim, neni 113.2 i Kushtetutës përcakton:

"Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën";

[...]

Gjithashtu, neni 135.4 i Kushtetutës përcakton:

"Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute".

34. Në kërkesën e tanishme, Avokati i Popullit sfidon Dekretin nr. DKGJK-001-2014, të nxjerrë nga Presidentja e Republikës së Kosovës më 31 gusht 2014. Prandaj, parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe ka të drejtë ta referojë këtë çështje në Gjykatë në bazë të nenit 113.2 dhe të nenit 135.4 të Kushtetutës.

35. Sa i përket kërkesës tjetër nga neni 30 i Ligjit, sipas së cilës parashtruesi i kërkesës është dashur ta ketë dorëzuar kërkesën *"brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar"*, Gjykata konstaton se Dekreti nr. DKGJK-001-2014 është nxjerrë më 31 gusht 2014, ndërsa parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 9 tetor 2014. Parashtruesi i kërkesës, rrjedhimisht, e ka respektuar afatin për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, të paraparë me nenin 30 të Kushtetutës (shih Rastin KO97/12).

36. Gjithashtu, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pohon se ai është duke sfiduar kushtetutshmërinë e Dekretit, por jo edhe kushtetutshmërinë e Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi të cilin bazohet Dekreti.

37. Gjykata vëren se Presidentja e Republikës së Kosovës është e autorizuar të nxjerr dekret në bazë të nenit 84 (4) [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës, që thotë si në vijim: *"Presidenti i Republikës së Kosovës: [...] (4) nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë [...]"*.

38. Në rastin konkret, Gjykata i referohet nenit 11 [Mjetet e shprehjes së pëlqimit për të qenë të detyruara nga dispozitat e një traktati] dhe të nenit 13 [Pëlqimi për t'u detyruar nga dispozitat e një

traktati i shprehur nga një shkëmbim i instrumenteve që përbëjnë një traktat] të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve (23 maj 1969), ku thuhet si në vijim:

> *"Neni 11 - Pëlqimi i një shteti për t'u kufizuar nga dispozitat e një traktati mund të shprehet me nënshkrim, shkëmbim instrumentesh që konstituojnë një traktat, ratifikim, pranim, aprovim apo aderim, ose nga çdo mjet tjetër nëse kështu është rënë dakord".*

dhe

> *"Neni 13 - Pëlqimi i shteteve për t'u detyruar nga dispozitat e një traktati të lidhur përmes shkëmbimit të instrumenteve në mes tyre quhet i dhënë në rast se: (a) instrumentet parashikojnë që shkëmbimi i tyre do të ketë atë efekt; ose (b) mund të përcaktohet ndryshe sipas rrethanave të rastit se ato shtete kanë rënë dakord që shkëmbimi i instrumenteve do të ketë atë efekt".*

39. Gjykata vëren se Presidentja e Republikës së Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian shkëmbyen letra në pajtim me këto dispozita të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve (23 maj 1969).

40. Në dritën e kësaj, Gjykata rithekson të gjeturat e saj në Rastin KO95/13 që, në mënyrë që një marrëveshje ndërkombëtare të bëhet pjesë e sistemit juridik të Kosovës, Kuvendi duhet të miratojë ligj për ratifikim me shumicën e dy të tretave (Shih Rastin KO95/13, parashtrues i kërkesës *Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,* Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhe të Planit të Zbatimit për këtë Marrëveshje, Aktgjykim i 9 shtatorit 2013). Në rastin e tanishëm, Kuvendi miratoi një ligj të tillë më 23 prill 2014 (shih Ligjin nr. 04/l-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë).

41. Gjykata thekson se Dekreti i sfiduar nuk krijon obligime të reja. Në të vërtetë, Dekreti, i nxjerrë nga Presidentja, është në linjë me obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, të inkorporuara në Marrëveshjen Ndërkombëtare, të lidhur ndërmjet

Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe të ratifikuar nga Kuvendi. Në këtë kontekst, ratifikimi i Marrëveshjes Ndërkombëtare nga Kuvendi formalizon pëlqimin e shtetit për t'u detyruar nga Marrëveshja në raport me palën tjetër dhe Dekreti i Presidentes së Kosovës shërben si një akt implementues i atyre dispozitave të Marrëveshjes Ndërkombëtare që nuk janë të vetekzekutueshme.

42. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se përmbajtja e Dekretit është *"Për konfirmimin e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës"*. Pra, Dekreti ka të bëjë me vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë, tashmë të emëruar, që shërbejnë në Gjykatë që nga viti 2009, dhe që ishin riemëruar deri më 31 gusht 2014 nga PCN-ja, më 17 korrik 2012.

43. Gjykata thekson se neni 84 (19) [Kompetencat e Kuvendit], i Kushtetutës, i cili thotë, si në vijim: *"Presidenti i Republikës së Kosovës: […] emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit […]"*, ka të bëjë me emërimin e gjyqtarëve të rinj kosovarë në Gjykatë, ndërsa Dekreti ka të bëjë me vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve të tanishëm ndërkombëtarë. Kësisoj, neni 84 (19) i Kushtetutës nuk është i aplikueshëm në rastin e tanishëm.

44. Përveç kësaj, Gjykata rikujton se për emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë ishte ndjekur një procedurë tjetër dhe ishin aplikuar kërkesa të tjera nga ato për emërimin e gjyqtarëve kosovarë. Mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë dallon gjithashtu dhe është i përcaktuar me kontratë të ofruar nga aktorë ndërkombëtarë.

45. Në fund, Gjykata vëren se argumentet e parashtruesit të kërkesës kryesisht ndërlidhen me përmbajtjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare të lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian nëpërmjet këmbimit të letrave, e ratifikuar nga Kuvendi më 23 prill 2014, edhe pse parashtruesi pohon se ai sfidon vetëm kushtetutshmërinë e Dekretit. Prandaj, parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij dhe nuk ka provuar se Dekreti është jokushtetues.

46. Po ashtu, siç e thekson me të drejtë edhe vetë parashtruesi i kërkesës, Gjykata nuk ka juridiksion *ratione materiae* për të trajtuar çështjen nëse marrëveshjet ndërkombëtare janë në përputhje me Kushtetutën (Shih Rastin KO95/13, parashtrues i

kërkesës *Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,* Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhe të Planit të Zbatimit për këtë Marrëveshje, Aktgjykim i 9 shtatorit 2013).

47. Prandaj, sa i përket procedurës së ndjekur nga Presidentja, Gjykata konkludon se Dekreti është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

48. Rrjedhimisht, Gjykata e refuzon kërkesën si qartazi të pabazuar, në mbështetje të paragrafit (1) c) dhe të paragrafit (2) të rregullit 36 të Rregullores së punës.

Kërkesa për Masë të përkohshme

49. Sa i përket kërkesës për Masë të përkohshme, Gjykata vëren se parashtruesi kërkon nga Gjykata të pezullojë Dekretin e Presidentes dhe të mos lejojë tre gjyqtarët ndërkombëtarë të vazhdojnë "*të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes deri sa të sigurohet kushtetutshmëria e emërimit të tyre*".

50. Neni 27 i Ligjit dhe, në veçanti, rregulli 54 (1) i Rregullores së punës, parashohin: *"Në çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e Masës së përkohshme".*

51. Gjykata më tej i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, që parasheh:

> *(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; dhe*
>
> *(c) Masa e përkohshme është me interes publik.*

Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës.

52. Megjithatë, pasi kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar dhe, për pasojë e papranueshme, Gjykata konkludon se kërkesa për Masë të përkohshme nuk mund të jetë më objekt i shqyrtimit dhe, për pasojë, duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 29 të Ligjit dhe në mbështetje të paragrafit (1) c) e të paragrafit (2) të rregullit 36 të Rregullores së punës, më 13 nëntor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TË REFUZOJË kërkesën për Masë të Përkohshme;

III. T'IA KUMTOJË këtë vendim parashtruesit të kërkesës dhe Presidentes së Republikës së Kosovës;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI125/14, Universiteti për Biznes dhe Teknologji, Aktvendim i datës 23 shtator 2014 - Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 9/2014, të 6 marsit 2014

Rasti KI125/14, vendim i 23 shtatorit 2014.

Fjalët kyç: kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, person juridik, liritë dhe të drejtat individuale, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 9/2014 i janë cenuar të drejtat e e tij te garantuara me Kushtetutë , respektivisht e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Parashtruesi pretendonte se trupi gjykues në Gjykatën e Apelit nuk ishte i paanshëm dhe se vendimi i nxjerrë nuk ishte i arsyetuar, ndërsa Gjykata Supreme me vendimin e saj vetëm e konfirmoi vendimin e Gjykatës së Apelit.

Gjykata vlerësoi se zbatimi i gabueshëm i pretenduar i disa dispozitave të caktuara në vend të disa dispozitave tjera ka të bëjë me fushën e ligjshmërisë, e që bie në prerogativat e gjykatave të rregullta. Në anën tjetër, Gjykata gjeti se vendimet e gjykatave të rregullta ishin të arsyetuara mjaft mirë dhe pretendimet e ngritura para tyre kishin marr përgjigjet e kërkuara. Gjykata ritheksoi se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo ligjit që pretendohet se janë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të dëshmive apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Si rrjedhojë, Gjykata i shpalli të papranueshme si qartazi të pabazuara.

Për më tepër, Gjykata konstatoi se, përderisa kërkesa e parashtruesit deklarohet e papranueshme, atëherë kërkesa për Masë të përkohshme nuk mund të jetë më objekt i shqyrtimit, prandaj kërkesa për vendosjen e Masës së përkohshme duhet të refuzohet.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI125/14
Parashtrues
Universiteti për Biznes dhe Teknologji - UBT
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 9/2014, të 6 marsit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji - UBT, me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga z. Ymer Bardhi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 9/2014, të 6 marsit 2014, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 12 maj 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.

4. Për më tepër, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) vendosjen e Masës së përkohshme, përkatësisht shtyrjen e përmbarimit të aktgjykimit.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenet 29 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) .

Procedura në Gjykatë

6. Më 1 gusht 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

8. Më 19 gusht 2014, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.

9. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtarin Altay Suroy, si kryesues të Kolegjit shqyrtues.

10. Më 23 shtator 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në një datë të paspecifikuar, gjatë pjesës së dytë të vitit 2010, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontratë për transmetimin e spoteve televizive në një televizion kombëtar të quajtur GK

12. Më 13 nëntor 2012, GK parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë me propozimin për përmbarim të pagesës së borxhit nga parashtruesi i kërkesës në një shumë të caktuar parash.

13. Më 29 prill 2013, Gjykata Themelore (Aktgjykimi C. nr. 529/2012) refuzoi në tërësi kërkesëpadinë e GK për pagesën e borxhit, për shkak të parashkrimit të padisë, në pajtim me nenin 378 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore.

14. Në një datë të paspecifikuar gjatë pjesës së parë të vitit 2013, GK parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

15. Më 9 dhjetor 2012, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ae. nr. 93/2013) miratoi ankesën e GK dhe prishi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke theksuar se aplikimi i afatit të parashkrimit ishte bërë në mënyrë të gabueshme.

16. Më 10 janar 2014, parashtruesi paraqiti revizion në Gjykatën Supreme *"për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 188 të LPK-së, që është bërë bëra nga gjykata e shkallës së dytë dhe për shkak të zbatimit të drejtës materiale"*.

17. Më 6 mars 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi E. Rev. nr. 9/2014) e pranoi pjesërisht revizionin vetëm sa i përket kamatës, ashtu që detyroi parashtruesin e kërkesës "*.... t'ia paguaj kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore në mjetet e afatizuara mbi një vit pa destinim të caktuar*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar se cilat nene konkrete të Kushtetutës janë shkelur dhe cilat të drejta apo liri themelore janë cenuar. Sidoqoftë, duket se parashtruesi i kërkesës ankohet se vendimet gjyqësore të gjykatave të rregullta nuk janë të arsyetuara mirë dhe se ai sfidon paanshmërinë e trupit gjykues të Gjykatës së Apelit, që do të çonte në shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

19. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pohon si në vijim:

> *"Është rregull dhe parim juridik se aktgjykimi duhet arsyetuar në mënyrë të thukët dhe përmbajtësore, gjë që në rastin e këtij kontesti nuk është vepruar. Sipas ligjit, arsyetimi i aktgjykimit me të dhëna të paqarta dhe kontradiktore, siç është rasti i aktgjykimit të atakuar, është i barasvlershëm me mungesën e plotë të arsyetimit..."*.

20. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se:

> *"Kolegji i gjykatës e shkallës së dytë, jo vetëm që ka nxjerrë një aktgjykim të diskutueshëm, por disi brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore ka sforcuar dhe përshpejtuar*

nxjerrjen e aktgjykimit te goditur, ani pse statistikat flasin se Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e vetme e shkallës së dytë me juridiksion territorial ne tërë Republikën e Kosovës, ka numër të madh lendesh të pazgjidhura, ndërsa lëndët e natyrës së kontesteve ekonomike, siç edhe siç është edhe rasti i këtij kontesti, nuk janë lëndë që duhet trajtuar dhe vendosur me prioritet".

21. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës ka kërkuar vendosje të Masës së përkohshme dhe shtyrjen e përmbarimit të aktgjykimit deri sa të nxirret vendimi përfundimtar nga Gjykata.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Së pari, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, siç specifikohen më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës të Gjykatës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës i cili parasheh:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

24. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

25. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: […] d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

26. Gjykata rikujton se parashtruesi ankohet se Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë, pa specifikuar ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës, por duke aluduar në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë.

27. Gjykata vëren se Gjykata Supreme, gjatë përgjigjes së hollësishme ndaj çështjeve më të spikatura të ligjshmërisë, të ngritura nga parashtruesi i kërkesës, vlerësoi se *"gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale"* dhe erdhi në përfundim se *"është vërtetuar fakti se kemi të bëjmë me kërkesat e subjekteve juridike që dalin nga kontrata për qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve dhe llogaritja e afatit të parashkrimit duhet të bëhet në bazë të nenit 374, paragrafi 1, të LMD-së, e që është 3 vite".*

28. Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata Supreme më tej arsyetoi duke theksuar: *"Thëniet e revizionit se në procedurë para gjykatës së shkallës së dytë, është bërë shkelje e dispozitës së nenit 182.2 (n) të LPK, nuk qëndrojnë nga arsyeja se gjykata e shkallës së dytë jep arsye të mjaftueshme dhe bindëse, të cilat janë të pranuara edhe nga kjo Gjykatë".* Gjykata Supreme vazhdon arsyetimin duke theksuar: *"Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se në rastin konkret duhet të zbatohet neni 378 par. 1 pika 3 dhe 4 të LMD-së ku është përcaktuar afati i parashkrimit njëvjeçar, për arsye se në afarizmin në mes të subjekteve juridike që !indin ne raportin lidhur me qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve, afati i parashkrimit është përcaktuar në nenin 374 par. 1 të LMD-së që është afat 3 vjeçar".*

29. Gjykata vëren se çështja kryesore në diskutim është se si "*duhet të bëhet llogaritja e parashkrimit".*

30. Gjykata konsideron që zbatimi i gabueshëm i pretenduar i disa dispozitave të caktuara në vend të disa dispozitave tjera ka të bëjë me fushën e ligjshmërisë, e që bie në prerogativat e gjykatave të rregullta.

31. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo ligjit që pretendohet se janë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të dëshmive apo zbatimit të

ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

32. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese ripërsërit se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

33. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesit të kenë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).

34. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata konsideron që procedurat në gjykatat e rregullta nuk ishin të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).

35. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar si dhe pse Gjykata Supreme ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm duke vendosur se "*periudha e parashkrimit është (...) 3 vite*".

36. Nga sa u tha më lart, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe (2) d) të Rregullores së punës.

Kërkesa për Masë të përkohshme

37. Lidhur me kërkesën për Masë të përkohshme, Gjykata i referohet nenit 116.2 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton: "*Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse*

konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme".

38. Gjykata, gjithashtu i referohet nenit 27 të Ligjit, i cili parasheh: *"Gjykata Kushtetuese, sipas detyrës zyrtare ose* me *kërkesë të palës, mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt* i *procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse manja* e *këtyre masave të përkohshme është* në *interes publik".*

39. Për më tepër, rregulli 54 (1) i Rregullores së punës, parasheh: "*Në çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është* e *pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat* e *kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen* e *masës* së *përkohshme".*

40. Në mënyrë që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, duhet që, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, të gjejë se:

> *"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; dhe*
>
> *(c) Masa e përkohshme është me interes publik. Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".*

41. Gjykata vëren se, siç u konstatua më sipër, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.

42. Gjykata konstaton se, përderisa kërkesa e parashtruesit deklarohet e papranueshme, atëherë kërkesa për Masë të përkohshme nuk mund të jetë më objekt i shqyrtimit, prandaj kërkesa për vendosjen e Masës së përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) d), 55 (4) e 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI113/14, Albion Sherifi, Aktvendim i datës 21 tetor 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë se Urdhëresës së Kryetarit të Komunës së Ferizajt, të 30 prillit 2014

KI 113/14, vendimi i 21 tetorit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, "actio popularis", e papranueshme, palë e paautorizuar.

Parashtruesi i kërkesës është drejtor ekzekutiv i një OJQ-je nga Ferizaj, i cili konteston Urdhëresën e Kryetarit të Komunës së Ferizajt, të 30 prillit 2014, me të cilin të gjitha ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari tregtare, shërbime dhe aktivitete tjera në Komunën e Ferizajt u ishte ndaluar të punojnë gjate festës zyrtare të 1 Majit.

Parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike kërkoi nga Gjykata Kushtetuese që të vlerësojë se a mund të zbatojnë gjykatat e rregullta një ligj të miratuar pas vitit 1989, veçanërisht në rastet kur marrëdhënia e punës mbulohet me ligje tjera të zbatueshme të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese konsideroi se çështja e referuar është çështje e ligjshmërisë dhe jo e kushtetutshmërisë.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar sepse faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese dhe parashtruesi nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

Urdhëresa e kontestuar pretendohet se ka shkelur nenin 10 [Ekonomia], nenin 49 [E Drejta e Punës] dhe nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese thekson se Kushtetuta nuk parasheh ngritjen e një "actio popularis", gjegjësisht individët nuk mund të ankohen në abstrakt lidhur me legjislacionin ose aktet qeveritare të cilat nuk janë aplikuar për ata personalisht, përmes një mase të zbatimit.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme, duke përfunduar se parashtruesi i kërkesës nuk është person i autorizuar për të kontestuar në abstrakt kushtetutshmërinë e Urdhëresës së Kryetarit të Komunës së Ferizajt.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
Rastin nr. KI113/14
Parashtrues
Albion Sherifi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Urdhëresës së Kryetarit të Komunës së Ferizajt,
të 30 prillit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Albion Sherifi, me vendbanim në Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

2. Parashtruesi i kërkesës deklaron se ai është drejtor ekzekutiv i OJQ-së *"Nisma për Aktivizim"* nga Ferizaj.

3. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk e ka specifikuar nëse e ka dorëzuar kërkesën në emër të tij apo duke vepruar si përfaqësues i OJQ-së "*Nisma për Aktivizim"*.

Vendimi i kontestuar

4. Parashtruesi i kërkesës e konteston Urdhëresën e Kryetarit të Komunës së Ferizajt të 30 prillit 2014, me të cilin të gjitha ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari tregtare, shërbime dhe aktivitete tjera në Komunën e Ferizajt u ishte ndaluar të punojnë gjatë festës zyrtare të 1 Majit.

Objekti i çështjes

5. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Urdhëresës së kontestuar, e cila pretendohet të ketë shkelur nenin 10 [Ekonomia], nenin 49 [E Drejta e Punës] dhe nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 4 korrik 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 16 korrik 2014, Ndërmarrja *Scan Color* JYSK dorëzoi dokumente shtesë lidhur me Urdhëresën e kontestuar. Këto dokumente ishin dorëzuar me njohuri të parashtruesit të kërkesës dhe i referohen gjobës monetare të shqiptuar nga Inspektorati i Tregut të Ferizajt, si rezultat i afarizmit dhe aktiviteteve tregtare të kësaj ndërmarrjeje gjatë festës zyrtare më 1 Maj.

9. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

10. Më 22 gusht 2014, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kryetarit të Komunës së Ferizajt.

11. Më 16 shtator 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues.

12. Më 21 tetor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 30 prill 2014, Kryetari i Komunës së Ferizajt nxori urdhëresën si në vijim.

> *"Në bazë të nenit 13, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L/040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 51, paragrafi 2. 1, të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kryetari i Komunës me datë 30.04.2014 miratoj:*
> *Urdhëresë për ndalimin e punës për festën e një majit*
>
> *I. URDHËROHEN të gjitha ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari tregtare, shërbyese dhe veprimtari tjera që mos të punojnë për festen e një majit me datën 01.05.2014.*
>
> *II. MBIKQYRJEN e kësaj urdhërese e bëjnë Inspektorët e tregut dhe Inspektori Komunal.*
>
> *III. MOSZBATIMI i kësaj urdhërese nga ana e titullarëve, paraqet shkelje dhe sanksionohet me ligj.*
>
> *Kryetari i Komunës,*
> *[...]"*

14. Kjo urdhëresë ishte publikuar në ueb-faqen e Komunës së Ferizajt.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Siç u theksua më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Urdhëresa e Kryetarit të Komunës së Ferizajt ka shkelur nenin 10 [Ekonomia], nenin 49 [E Drejta e Punës] dhe nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës.

16. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Një urdhëresë e tillë shkel të drejtat individuale të qytetarëve të komunës së Ferizajt nga një autoritet publik siç është Komuna e Ferizajt, përkatësisht të Drejtën e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit e garantuar me nenin (49) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe paraqet ndërhyrje të shtetit në ekonominë e tregut të lirë që është një parim qenësor i funksionimit demokratik të institucioneve publike në Republikën e Kosovës"*.

17. Parashtruesi kërkon "*[...] që Gjykata të gjej që vendimi dhe veprimi i Kryetarit të Komunës është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe rendin kushtetues të Republikës në mënyrë që të mbrohen parimet themeltare të shtetit tonë, që garantojnë të drejtën e punës dhe ekonominë e bazuar në tregun e lirë[...]*".

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *(...)*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

20. Gjykata i referohet edhe nenit 47 të Ligjit, i cili parasheh:

> *1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se* pretendon *se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

21. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*
>
> *(...)*
>
> *(c) kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar;*

22. Gjykata rikujton se parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Urdhëresës së Kryetarit të Komunës së Ferizajt, të 30 prillit 2014.

23. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk pretendon dhe nuk dëshmon se të drejtat dhe liritë e tij ishin ose janë shkelur drejtpërdrejt nga ai autoritet publik.

24. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se Kushtetuta nuk parasheh ngritjen e një "*actio popularis",* gjegjësisht individët nuk mund të ankohen në abstrakt lidhur me legjislacionin ose aktet qeveritare të cilat nuk janë aplikuar për ata personalisht, përmes një mase të zbatimit (shih *Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 7525/76, GJEDNJ, vendimi i 22 tetorit 1981. Shih gjithashtu Rastin KI117/11 parashtrues i kërkesës *Ridvan Hoxha kundër Komunës së Prizrenit,* Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për Papranueshmëri i 18 korrikut 2012).

25. Gjykata përkujton se një ankesë duhet të sillet nga apo në emër të personave që pretendojnë se janë viktima të shkeljes së dispozitave kushtetuese. Këta persona duhet të jenë në gjendje të tregojnë se janë "prekur drejtpërsëdrejti" nga masa ndaj të cilës ankohen (shih rastin *Ilhan kundër Turqisë*, kërkesa nr. 22277/93, GJEDNJ, Aktgjykimi, i 27 qershorit 2000).

26. Gjykata konsideron se, siç parashihet me nenin 113.7 dhe nenin 47.1 të Ligjit, parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se një autoritet publik ka shkelur ndonjë nga të drejtat dhe liritë e tij individuale apo të OJQ-ve të garantuara me Kushtetutë.

27. Prandaj, Gjykata e konsideron jo relevante për rastin nëse parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën në emër të tij ose si përfaqësues i OJQ-së. Në të vërtetë, në të dy cilësitë, parashtruesi i kërkesës i mungon *locus standi* në këtë Gjykatë.

28. Si përmbledhje, Gjykata përfundon se parashtruesi i kërkesës nuk është person i autorizuar për të kontestuar në abstrakt kushtetutshmërinë e Urdhëresës së Kryetarit të Komunës së Ferizajt dhe prandaj kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, me nenin 47 (1) të Ligjit dhe me rregullin 36 (3) c) të Rregullores së punës, më 21 tetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI107/14, Xufe Rracaj, Aktvendim i datës 23 shtator 2014- Njoftim i Prokurorit të Shtetit, KMLC Nr. 01/2011, i 13 dhjetorit 2013

Rasti KI107/14, vendimi i 23 shtatorit 2014.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesja e kërkesës e konteston Njoftimin e Prokurorit të Shtetit KMLC Nr. 01/2011 të 13 dhjetorit 2013, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës, të garantuara me "nenin 6 (...) dhe nenin 5 të Kushtetutës", si dhe "të drejtën për kompensimin e të ardhurave personale".

Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës, duke arsyetuar kërkesën e saj, pretendon shkelje të neneve 5 dhe 6 të Kushtetutës. Këto nene kanë të bëjnë me gjuhët dhe simbolet e Republikës së Kosovës dhe asgjë me faktet e kërkesës. Pra nuk është e qartë se cilat janë pretendimet e parashtrueses së kërkesës.

Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka shpjeguar dhe nuk ka treguar si dhe pse pretendohet të jenë shkelur të drejtat e saj qoftë për gjykim të drejtë apo e drejta pronësore.

Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se rastit i ka munguar paanshmëria, ose që procedurat kanë qenë të padrejta.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2014, njëzëri deklaron se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI107/14
Parashtrues
Xufe Rracaj
Njoftim i Prokurorit të Shtetit, KMLC Nr. 01/2011,
i 13 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Xufe Rracaj, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Njoftimin e Prokurorit të Shtetit KMLC Nr. 01/2011 të 13 dhjetorit 2013.

3. Parashtruesja e kërkesës deklaron se njoftimi i kontestuar i ishte dorëzuar asaj më 23 maj 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës, të garantuara me *"nenin 6 (...) dhe nenin 5 të Kushtetutës",* si dhe "*të drejtën për kompensimin e të ardhurave personale*".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 23 qershor 2014, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 7 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 1 gusht 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Zyrës së Prokurorit të Shtetit.

9. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan, si gjyqtar kryesues të Kolegjit shqyrtues me gjyqtaren Snezhana Botusharova.

10. Më 23 shtator 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 30 dhjetor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë, në procedurën përmbarimore, të iniciuar nga parashtruesja e kërkesës, detyroi (E. nr. 322/2003) OP "Kosovodrvo-Commerce" t'i paguajë parashtrueses së kërkesës një shumë të caktuar të hollave.

12. Në një datë të pacaktuar, OP "Kosovodrvo-Commerce" ushtroi ankesë kundër aktvendimit të lartcekur.

13. Më 30 gusht 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktvendimi Ac. nr. 563/2009) e aprovoi ankesën e debitorit. Në këtë mënyrë, ishte refuzuar përmbarimi i Aktvendimit të Gjykatës Komunale.

14. Gjykata e Qarkut arsyetoi se Gjykata Komunale nuk kishte juridiksion material për të trajtuar propozimin e parashtrueses së kërkesës. Sipas Gjykatës së Qarkut "*Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës është kompetente për të vendos lidhur me këtë çështje, duke u bazuar në nenin 29 të Rregullores së UNMIK-ut.... fakti se ndërmarrja e paditur - debitori ka qenë nën autoritetin administrativ të AKM-së vërtetohet në bazë të shkresës së AKM-së numër DN- CS606 të datës 27.06.2006 drejtuar të gjitha gjykatave...*".

15. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës kërkoi nga Prokurori i Shtetit mbrojtjen e ligjshmërisë, duke pretenduar se Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut ishte nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, pasi që, sipas parashtrueses së kërkesës, Gjykata Komunale në Prishtinë kishte juridiksion material për përmbarimin e çështjes në fjalë.

16. Më 18 janar 2011, Prokurori i Shtetit (Njoftimi KMLC Nr. 01/2011) bëri përpjekje që ta informojë parashtruesen e kërkesës në adresën postare Rr. Rijeka nr. 46/A se *"nuk kam gjetur bazë ligjore për të ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë"*.

17. Më 11 dhjetor 2013, parashtruesja e kërkesës kërkoi informata lidhur me statusin e kërkesës së saj për mbrojtje të ligjshmërisë, duke pretenduar se *"ka mbi tri vite që s'më keni kthyer kurrë përgjegjëje se çka ka ndodhë me kërkesën time"*.

18. Më 13 dhjetor 2013, Prokurori i Shtetit (Njoftimi KLC Nr. 01/2011) e informoi parashtruesen e kërkesës në adresën postare "Lidhja e Lezhës" nr. 70/3 se *"...siç shihet ju njoftimin [e 30 dhjetorit 2010] nuk e keni pranuar për arsye se adresa e juaj s'ka qenë e saktë. Po ju dërgojmë edhe një herë këtë njoftim në adresën e re dhe bashkangjitur gjeni edhe njoftimin e dërguar më parë*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesja e kërkesës pretendon se, "*të gjitha mjetet juridike janë ushtruar por ka qenë e kotë dhe paramendoni nga viti 2003 deri 2008, nuk është shqyrtu kërkesa-propozimi; pastaj Prokuroria nga viti 2010- deri 2014, dt 23.05.2014 nuk ka qenë në gjendje të njoftoj palën. Kemi menduar se së paku Prokurori do të*

ngritë Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, sepse lejohet sipas LPP-së në fuqi [Ligji për Procedurën Përmbarimore]".

20. Prandaj, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata "*Të konstatohet shkelja nga Gjykata dhe Prokurori i Shtetit. Të më njihet e drejta në kompensim të pagave (e drejta e punës) e drejtë themelore. Të më bëhet pagesa (të urdhërohet AKP)".*

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh se:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

23. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) c) dhe (2) b) të Rregullores së punës, i cili përcakton se:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: ... c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:... d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

24. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës, duke arsyetuar kërkesën e saj, pretendon shkelje të neneve 5 dhe 6 të Kushtetutës. Këto nene kanë të bëjnë me gjuhët dhe simbolet e Republikës së Kosovës dhe asgjë me faktet e kërkesës. Pra nuk është e qartë se cilat janë pretendimet e parashtrueses së kërkesës.

25. Siç shihet objekti i çështjes ka të bëjë me shkeljen e së drejtës së parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë dhe të drejtës në pronë.

26. Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka shpjeguar dhe nuk ka treguar si dhe pse pretendohet të jenë shkelur të drejtat e saj qoftë për gjykim të drejtë apo e drejta pronësore.

27. Përveç kësaj, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës*, [DHM], Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ], 1999-I; Shih gjithashtu Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 983/08 të 7 shkurtit 2011).

28. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se rastit i ka munguar paanshmëria, ose që procedurat kanë qenë të padrejta (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, GJEDNJ, Vendim përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

29. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës, Gjykata konsideron se kërkesa është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI101/14, Shkodran Pllana, Aktvendimi i datës 17 shtator 2014- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 41/2014, të 7 marsit 2014

KI101/14, vendimi i 17 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme (Rev. 41/2014 i 7 marsit 2014) i pranoi një pale të tretë të drejtën në një pjesë të paluajtshmërisë në pronësi të parashtruesit të kërkesës .

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se nenet 3, 24 [Barazia para Ligjit], 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës ishin shkelur në dëm të tij.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar, sepse kërkesa nuk arriti të dëshmojë se Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI101/14
Parashtrues
Shkodran Pllana
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 41/2014,
të 7 marsit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Shkodran Pllana, i përfaqësuar nga z. Behar Ejupi, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 41/2014, të 7 marsit 2014, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 29 maj 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet *"ta ketë shkelur parimin e paanshmërisë"*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113. 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 47 të Ligjit

për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 26 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

7. Më 4 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. GJR. KI101/14 caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI101/14 caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 1 gusht 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dorëzoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.

9. Më 15 shtator 2014, me Vendimin Nr. KSH. KI101/14, gjyqtari Enver Hasani u caktua anëtar i Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Robert Carolan.

10. Më 17 shtator 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 9 shtator 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj (Aktgjykimi C. nr. 196/12) e refuzoi kërkesëpadinë e palëve të treta për anulimin e kontratës së shitjes, të lidhur në mes tyre dhe parashtruesit të kërkesës.

12. Më 29 nëntor 2013, Gjykata e Apelit të Kosovës (Aktgjykimi Ac. nr. 3631/2013) e refuzoi si të pabazuar ankesën e palëve të treta.

13. Më 7 mars 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. 41/2014) konstatoi:

"REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësit RA nga Ferizaj, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ap. nr. 363 1/2013 datë 29.1 1.2013.

PRANOHET si i bazuar revizioni i paditëses Kumrije Ahmeti nga Ferizaj, dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr. 3631/2013 datë 29.11.2013, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C. nr. 196/12, datë 09.06.2013, ashtu që pranohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kumrije Ahmeti, dhe përkitazi me pjesën bashkëpronësore të saj në lartësi prej 1/2 te paluajtshmërisë lëndore, e cila evidentohet si njësi kadastrale nr. 01833-00, ne vendin e quajtur "M. Tita" në sipërfaqe prej 351 m2, sipas çertifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 02928 ZK Ferizaj, anulohet kontrata e lidhur në mes të paditësit Rexhep Ahmeti nga Ferizaj, si shitës në njërën an[, dhe të padituri Shkodran Sharr Pllana, nga Prishtina, si blerës në anën tjetër, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj V.nr.1248/12 me datën 06.03.2012".

14. Në aktgjykimin e lartcekur, Gjykata Supreme arsyetoi se "*paditësi RA, pa marrëveshje dhe pëlqimin shprehimor të paditëses se dytë si bashkëshorte dhe si pronare e përbashkët e paluajtshmërisë lëndore, ka disponuar me tërë paluajtshmërinë kontestuese. Për arsyet e lartë përmendura, dhe për faktin se ne shkresat e lendes ekziston kontrata për shitblerje Vr. nr. 1379/05 e datës 22.04.2005, në të cilën kontratë paditësja është thirr në ankesë dhe ne revizion, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka prova se paditësja ka dhënë pëlqimin për shitjen e palujatshtmërisë kontestuese, Gjykata Supreme gjen se revizioni i paditëses është i bazuar, kështu që për pjesën prej 1/2 të paluajtshmerisë lëndore e cila paditëses KA i takon sipas nenit 47 të Ligjit mbi Familjen të Kosovës, të cilën pjesë paditësi e ka tjetërsuar në kundërshtim me nenin 47.1 dhe 4 dhe nenin 50, par.2 të Ligjit për familjen, kontratat kontestuese dhe në kuptim të nenit 103 par.1 të LMD, paraqet punë juridikisht të pavlefshme, gjegjësisht është nulë. Për këtë arsye aktgjykimet e gjykatave të shkallës më të ulët u ndryshuan ashtu që u pranua si e bazuar kërkesëpadi a paditësit se kontrata e lartcekur të anulohet lidhur me pjesën e bashkëpronësisë, sipas pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me

nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa). Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të neneve 3, 24 [Barazia para Ligjit], 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

16. Parashtruesi i kërkesës, *inter alia*, pretendon se në bazë të nenit 215 të Ligjit për procedurën kontestimore "*Gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur vetëm në pjesën e tij të goditur me anë të revizionit dhe vetëm brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt*ë".

17. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme dhe çështja e tij të kthehet në rigjykim për ½ e paluajtshmërisë, e cila i ishte njohur nga Gjykata Supreme palës kundërshtare.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

20. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".*

21. Sidoqoftë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe se ai i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe se

kërkesa është dorëzuar brenda afatit prej 4 (katër) muajve, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

22. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) c) dhe (2) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
> *...*
> *c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".*
>
> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *(...) ose*
>
> *d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

23. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për masën e shqyrtimit të revizionit nga Gjykata Supreme, Gjykata e konsideron një kërkesë të tillë të jetë çështje e ligjit që bie në kuadër të fushëveprimit të gjykatave të rregullta, e që ndërlidhet me pavarësinë e tyre në ndarjen e detyrave dhe të drejtave të dhëna me Kushtetutë.

24. Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e Kosovës kishte siguruar argumente të arsyetuara ligjore dhe logjikisht koherente sepse gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale, duke shpjeguar: i) kushtet në të cilat prona e paluajtshme mund të tjetërsohet plotësisht, dhe ii) të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve në lidhje me pronën e tyre të përbashkët në funksion të ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës.

25. Gjykata Kushtetuese thekson se konstatimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike dhe ligji i aplikueshëm është në juridiksion të plotë të gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmëri me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, gjithashtu, *mutatis mutandis,* shih, rastin KI86/11, *parashtrues i kërkesës Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

26. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo në mënyrë të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me ato të gjykatave të rregullta, dhe si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë provat para vetes. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato prova (shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

27. Fakti se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund t'i shërbejë atij të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, Aktgjykim i GJEDNJ, i 26 korrikut 2005).

28. Në këto rrethana, parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë se gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

29. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 17 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI86/14, Advije Nimani, Aktvendim i datës 17 shtator 2014- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 32/2014, të 13 marsit 2014

Rasti KI86/14, vendimi i 17 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Aktgjykimi (Rev. nr. 32/2014 i 13 marsit 2014) i Gjykatës Supreme të Kosovës ndryshoi vendimin e gjykatave të shkallës më të ulët dhe hodhi poshtë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar, sepse kërkesa nuk arriti të dëshmojë se Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI86/14
Parashtrues
Advije Nimani
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 32/2014, të 13 marsit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përberë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Advije Nimani (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), e përfaqësuar nga z. Safet Voca, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 32/2014, të 13 marsit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt çështjeje është kushtetutshmëria e vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës që sipas parashtrueses *"... është i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 31 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës"*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 maj 2014, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin Nr. GJR. KI86/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI86/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

7. Më 19 qershor 2014, parashtruesja u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë nga një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme të Kosovës, Ministrisë së Shërbimeve Publike (në tekstin e mëtejmë: MSHP) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejmë: MPB).

8. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin Nr. KSH. KI86/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Robert Carolan.

9. Më 17 shtator 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja fakteve

10. Parashtruesja kishte themeluar marrëdhënie pune me MSHP-në për kohë të caktuar duke filluar nga 1 shtatori 2003 deri më 28 shkurt 2004 në vendin e punës Zyrtare e të Dhënave në Njësinë e Regjistrimit të Automjeteve në Mitrovicë. Me Memorandumin e Mirëkuptimit nr. 840 të 21 marsit 2006 nënshkruar mes MSHP-së dhe MPB-së janë bartur përgjegjësitë për çështjet e regjistrimit të automjeteve.

11. Më 31 mars 2004, MSHP-ja kishte marrë vendim për ndërprerje të marrëdhënies së punës me parashtruesen e kërkesës për shkak të shkeljes serioze të disiplinës të përcaktuar me nenin 3.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës.

12. Vendimi i lartpërmendur ishte vërtetuar me vendimin (Ref. KA-MSHP 0807/2004 i 26 tetorit 2004) të Komisionit për Ankesa të

MSHP-së përkatësisht vendimin (nr. 1511/2006, i 25 korrikut 2006) e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

13. Më 15 maj 2007, Gjykata Komunale në Mitrovicë me Aktgjykimin C. nr. 638/2006 miratoi kërkesëpadinë e parashtrueses, anuloi vendimet e lartpërmendura të MSHP-së dhe të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës si dhe urdhëroi MPB-në që parashtruesen ta kthej në vendin e mëparshëm të punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

14. Më 18 tetor 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin Ac. nr. 785/2012 refuzoi të pabazuara ankesat e MSHP-së dhe MPB-së dhe vërtetoi aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale në Mitrovicë.

15. Më 13 mars 2014, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. nr. 32/2014 pranoi revizionin e paraqitur nga MSHP-ja dhe MPB-ja dhe ndryshoi aktgjykimet e lartpërmendura të Gjykatës Komunale në Mitrovicë përkatësisht të Gjykatës së Apelit të Kosovës si dhe kërkesëpadinë e parashtrueses e refuzoi të pabazuar.

16. Në aktgjykimin e lartpërmendur Gjykata Supreme e Kosovës, ndër të tjera, arsyetoi:

> *Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët drejt dhe ne mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike që ka të bëj me faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, por në bazë të gjendjes së tillë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gabimisht e kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.*
>
> *Kjo Gjykate vlerëson se dy aktgjykimet e gjykatave te instancës më të ulët, si bazë për aprovimin e kërkesëpadisë se paditëses kanë marrë faktin se paditësja në bazë të aktgjykimit te plotfuqishëm penal P. nr. 518/2005 datë 10.4.2006 është liruar nga aktakuza, e cila vepër ka të bëj me rastin konkret. Në bazë të nenit 14 te LPK, në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të kryesit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilën i pandehuri është shpallur fajtor, ndërsa nuk është e lidhur me aktgjykimin me të cilin është liruar nga përgjegjësia penale, pa marrë parasysh arsyet e lirimit. Nga shkresat e lëndës është vërtetuar se në veprimet e*

paditëses ka keqpërdorim të detyrave te punës që parashihen si shkelje te Rregullave te Kodit të Mirësjelljes ne SHCK, në bazë të kapitullit " nenit 2.1 pika c, q, dhe shtojca rregullat e mirësjelljes dhe SHT pika 4, 6, 10 te Rregullores 2001/36 dhe Urdhëresës administrative 2003/2 neni 30.1 nen a, c, të parapara në bazë të procedurave te menaxhimit të personelit kapitulli IX, procedurat e disiplinës, ndershmëria dhe mirësjellja, hapi 4.2 nen 1,2 hapi 5, 4.1 ,5.4.9 tejkalim i kompetencave dhe shpërdorim i detyrës zyrtare.

Paditësja si zyrtare evidentuese e të dhënave është dashur të veprojë konform shkresës se datës 4.11.2003 të paraqitur nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Automjeteve në Prishtinë, me te cilën janë njoftuar për automjetet te cilat nuk guxojnë te regjistrohen pasi qe nuk posedojnë dokumentacion valid. Ndërsa, e njëjta pa e kryer verifikimin me DUD - doganë falso ka regjistruar automjetin i cili ka pasur ndalesë për regjistrim, i cili fakt është konstatuar në bazë të kontrollit datë 27.11.2003.

Gjykatat e instancës më të ulët, gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, ngase, me nenin 30.1 nën a, b dhe t, të Urdhëresës administrative 2003/2 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të kontratës janë paraparë shkeljet e kodit të sjelljes, të cilat si rezultat kanë dënimin e paraparë disiplinor".

Pretendimet e parashtrueses

17. Parashtruesja pretendon se Gjykata Supreme *"ka vendosur sipas revizionit dhe me rastin e vendosjes sipas këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik nuk ka pasur të drejtë ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëses por vetëm ta prishë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë apo të gjykatës së shkallës së dytë dhe çështjen ta kthenë për rigjykim dhe rivendosje të sërishme".*

18. Parashtruesja pretendon se Gjykata Supreme *"me rastin e vendosjes është thirrur në shkresën e datës 14.11.2003 e cila fare nuk ekziston në shkresat e lëndës dhe asnjëherë nuk është proceduar si provë para gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë".*

19. Parashtruesja kërkon nga Gjykata *"që ta anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 32/2014 dhe të njëjtin ta*

shpallë si të kundërligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 31 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje për të gjykuar kërkesën e parashtrueses, së pari është e nevojshme të shqyrtojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

22. Gjykata po ashtu merr parasysh rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës që përcakton:

> *Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *(...)*
>
> *c) kërkesa është qartazi e bazuar.*

23. Përkitazi me pretendimet e parashtrueses, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e Kosovës ka dhënë një vendim të arsyetuar ku në mënyrë të qartë ka shtjelluar obligimet e parashtrueses si punonjëse në raport me punëdhënësin e saj, si dhe mënyrën se si duhet zbatuar e drejta materiale nga gjykatat e instancës më të ulët në rastin në fjalë.

24. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore. Prandaj Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt (shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65 dhe, po ashtu, shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

25. Përveç kësaj, kërkesa nuk arrin të dëshmojë që Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

26. Fakti që parashtruesja nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat* kundër Hungarisë, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

27. Në këto rrethana, parashtruesja nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e saj për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ajo nuk tregojnë në asnjë mënyrë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar asaj të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

28. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe si e tillë e papranueshme në përputhje me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 17 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI63/14, Misin Rifati, Aktvendim i datës 23 shtator 2014- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 71/2002, të 17 dhjetorit 2002

Rasti KI 63/14, vendimi i 23 shtatorit 2014.

*Fjalët kyçe:*kërkesë individuale, ratione temporis, kërkese e papranushme.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushteutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese janë cenuar me aktgjykimin e gjykatave të rregullta. Parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara më Kushtetutë, perkatesisht nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Prones], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqesore e të Drejtave]. Për më teper, parashtruesi kërkon nga Gjykata "të konfirmoje se prona e paluajtshme nr. 318 në "Dugaqke Njive- Arat e Gjata" duhet të trasnsformohet nën emrin tim"

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrusit ishte e papranushme bazuar ne Rregullit 36 (3) h) i cili parasheh:"Po ashtu, një kerkese mund të konsiderohet si e papranueshme kur kerkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetuten". Gjykata veren se parashtruesi i kerkeses e konteston Aktgjykimin C. nr.71/2002 të Gjykates Komunale në Ferizaj, të 17 dhjetorit 2002, i cili i ishte dorezuar atij me 20 janar 2013. Kjo do te thote qe shkelja e pretenduar e te drejtes së parashtruesit, e garantuar më Kushtetutë, kishte ndodhur para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi e Kushtetutës, dhe prej të ciles datë Gjykata ka juridiksion kohor. Prandaj, rezulton që kërkesa e parashtruesit nuk është ratione temporis në pajtim me dispozitat e Kushtetutes. Megjithate, Gjykata veren se më 2013, parashtruesi i kërkeses tanime ka bere nje parashtrese në Gjykaten Themelore, duke kerkuar nga gjykata që të shqyrtoje vendimin e kontestuar. Ky rast është ende ne pritje në kete gjykate (rasti C. nr. 180/2013). Gjykata rikujton se në perputhje me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi ka per detyre qe te shteroje te gjitha mjetet juridike të para para me ligj, siç percaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutes. Ne rastin konkret, Gjykata gjen se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, pasi që nuk ka vendim perfundimtar për t'u

kontestuar. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është e papranueshm.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI63/14
Parashtrues
Misin Rifati
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 71/2002, të 17 dhjetorit 2002

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Misin Rifati (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) me banim në Talinoc i Jerlive, komuna e Ferizajt.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin C. nr. 71/2002 të Gjykatës Komunale në Ferizaj, të 17 dhjetorit 2002, që i është dorëzuar atij më 20 janar 2003.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat e parashtruesit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 prill 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI63/14 caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI63/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 23 shtator 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Më 17 gusht 2001, sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Komunale nxori Aktvendimin T. nr. 8/2001 për ndarjen e trashëgimisë së babait të tij të ndjerë, të cilin aktvendim parashtruesi i kërkesës nuk e kishte dorëzuar në Gjykatë.

9. Më 17 dhjetor 2002, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 71/2002) (në rastin civil të S. R. kundër të tjerëve duke përfshirë parashtruesin e kërkesës), vërtetoi se S. R. është pronar i pronës së paluajtshme nr. 318 në *"Dugaqke Njive- Arat e Gjata*". Sipas dokumenteve të dorëzuara asnjë ankesë nuk është parashtruar brenda afatit të caktuar.

10. Gjatë vitit 2006, parashtruesi i kërkesës iu drejtua disa institucioneve lidhur me pakënaqësinë e tij me rezultatin e rastit të lartpërmendur.

11. Më 12 mars 2013, parashtruesi ka parashtruar një kërkesë për *"rishikimin e propozimit per ndarjen fizike"* në Gjykatën

Komunale në Ferizaj. Rasti është ende në procedurë e sipër në Gjykatën Komunale (rasti C. nr. 180/2013).

Pretendimet e parashtruesit

12. Parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

13. Për më tepër, parashtruesi kërkon nga Gjykata "*të konfirmojë se prona e paluajtshme nr. 318 në "Dugaqke Njive- Arat e Gjata" duhet të trasnsformohet nën emrin tim".*

Pranueshmëria e kërkesës

14. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë.

15. Sa i përket kësaj kërkese, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) h), i cili parasheh: *"Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme kur kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën".*

16. Për ta përcaktuar juridiksionin kohor të Gjykatës është me rëndësi të identifikohet, në secilin rast të veçantë, koha e saktë e shkeljes së pretenduar. Me këtë rast, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat parashtruesi ankohet dhe përmasën e të drejtës së Kushtetutës që pretendohet të jetë shkelur (shih, *mutatis mutandis,* Aktgjykimi i Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Rastin *Blečič kundër Kroacisë,* Kërkesa Nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, para. 82).

17. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin C. nr. 71/2002 të Gjykatës Komunale në Ferizaj, të 17 dhjetorit 2002, i cili i ishte dorëzuar atij më 20 janar 2013.

18. Kjo do të thotë që shkelja e pretenduar e të drejtës së parashtruesit, e garantuar me Kushtetutë, kishte ndodhur para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi e Kushtetutës, dhe prej të cilës datë Gjykata ka juridiksion kohor.

19. Prandaj, rezulton që kërkesa e parashtruesit nuk është *ratione temporis* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

20. Megjithatë, Gjykata vëren se më 2013, parashtruesi i kërkesës tanimë ka bërë një parashtresë në Gjykatën Themelore, duke kërkuar nga gjykata që të shqyrtojë vendimin e kontestuar. Ky rast është ende në pritje në këtë gjykatë (rasti C. nr. 180/2013).

21. Gjykata rikujton se në përputhje me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi ka për detyrë që të shterojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës.

22. Në rastin konkret, Gjykata gjen se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, pasi që nuk ka vendim përfundimtar për t'u kontestuar.

23. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me rregullat 36 (3) h) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI20/14, Musa Gjetaj, Aktvendim i datës 15 shtator 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, CA. nr. 2976/2013, të 5 dhjetorit 2013

Rasti KI 20/14, vendimi i 15 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesa individuale, qartazi e pabazuar.

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, CA. nr. 2976/2013, të 5 dhjetorit 2013. Parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë, ku ai kërkoi kompensim për punën e kryer si mësimdhënës, derisa bënte fushatë për zgjedhjet lokale. Gjykata Komunale në Gjakovë e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit e cila u refuzua si e pabazuar. Rrjedhimisht, ishte vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjakovë.

Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese me pretendim se Aktgjykimi i kontestuar kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafi 1, nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] paragrafi 4 dhe nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar. Në arsyetimin e saj, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyeton shkeljen e pretenduar të të drejtave kushtetuese. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese deklaroi se argumentet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës kanë të bëjnë me çështje të *"ligjshmërisë"* dhe jo të *"kushtetutshmërisë"*.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI20/14
Parashtrues
Musa Gjetaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. Nr. 2976/2013, të 5 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Musa Gjetaj nga Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), i cili përfaqësohet nga z. Bashkim Latifi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. Nr. 2976/2013, të 5 dhjetorit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 17 janar 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht nenin 3 [Barazia Para Ligjit], nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafi 1, nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], paragrafi 4, nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemi Gjyqësor].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (7) të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 shkurt 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

6. Më 6 mars 2014, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI20/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë me Vendimin nr. KSH KI20/14, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 13 mars 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi atij të dorëzoi autorizimin për përfaqësim për z. Bashkim Latifi. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.

8. Më 16 mars 2014, parashtruesi e dorëzoi në Gjykatë dokumentin e kërkuar.

9. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës, zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi, si anëtare të Kolegjit shqyrtues.

10. Më 15 shtator 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi është mësimdhënës me kontratë të përhershme në një shkollë fillore në Dobrixhë, Komuna e Gjakovës.

12. Në zgjedhjet lokale, të mbajtura në nëntor të vitit 2007, parashtruesi ka kandiduar për një post publik. Gjatë periudhës kur

ai ishte në fushatë, Drejtoria e Arsimit në Komunën e Gjakovës ia ka ndalur pagën si mësimdhënës.

13. Si rezultat, parashtruesi parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë, ku kërkoi kompensim për punën që kishte kryer si mësimdhënës, gjatë kohës në të cilën bënte fushatë për zgjedhjet lokale. Përfaqësuesi i parashtruesit e mbështeti padinë e parashtruesit përpara Gjykatës Komunale, duke argumentuar:

> *"[...] Paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar si mësimdhënës [...]. Gjatë gjithë kohës së fushatës parazgjedhore, paditësi me rregull ka punuar. [...] Të padituratpa të drejtë ia kanë ndal paditësit mjetet për punën e kryer gjatë fushatës parazgjedhore (muajin nëntor dhe dhjetë ditët e para të muajit dhjetor 2007)".*

14. Më 20 qershor 2013, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 58/08) e refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar. Gjykata Komunale vërtetoi:

> *"[...] Gjykata bëri nxjerrjen e provave ku pas vlerësimit veç e veç të tyre dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke, [...] gjeti se kërkesëpadia është e pabazuar dhe u refuzua.*
>
> *Udhëzimi Administrativ MAPL-nr. 2007/07 MAPL për përkufizimin e veprimtarisë politike të shërbyesve civil komunal datë 05 shtator 2007, [...] Neni 6 përcakton se shërbyesit civil komunal kur paraqesin kandidaturën për ndonjë funksion të zgjedhur publik ai ose ajo duhet të marrin pushim pa pagesë 15 ditë para fushatës parazgjedhore, me qëllim që të lirohen nga përgjegjësitë dhe obligimet në shërbimin civil komunal. Neni 9 përcakton se shërbyesit civil komunal të cilët kandidojnë për ndonjë funksion publik, kanë të drejtë të kthehen në punën e tyre brenda 1 (një) jave nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, në rast të mos zgjedhjes për postin publik në të cilin kanë kandiduar.*
>
> *[...]*
>
> *Bazuar në provat e administruara rezulton se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, edhe përkundër faktit se paditësi ka punuar në mënyrë të rregullt gjatë periudhës për të cilën kërkohet pagesa e të ardhurave personale".*

15. Parashtruesi ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, për shkak të *"shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale".*

16. Më 5 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendimi CA. Nr. 2976, 2013) e refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar dhe pranoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale.
17. Gjykata e Apelit konstatoi:

> *"Nuk ka shkelje të nenit 182.2(n) për të cilin tregohet në ankesë, sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe në pajtim me provat në lëndë. Me fjalë të tjera, nga shkresat e lëndës si e pakontestueshme rezulton se paditësi si arsimtar në Shkollën fillore [...] ka konkurruar për funksionin publik në zgjedhje t e 17 nëntorit 2007. Si kandidat në zgjedhje paditësi është dashur ta respektojë Udhëzimin administrativ nr. 2007/10 të cilin e ka nxjerrë Ministria e Administratës Lokale (në tekstin e mëtejmë: MAPL), si dhe lajmërimin e Ministrisë së Shërbimeve Publike. Me aktet e përmendura është paraparë që kandidatët të cilët marrin pjesë në aktivitetet parazgjedhore është dashur të marrin pushim pa pagesë dhe atë nga dita e publikimit të kandidaturës.*
>
> *Ky akt përdoret në tërë territorin e Kosovës dhe komunat nuk guxojnë të bëjnë përjashtim dhe të nxjerrin vendime të kundërta. Udhëzimi administrativ rregullon rregullat e sjelljes së kandidatëve për kohën e fushatës parazgjedhore në të gjitha komunat e Kosovës. Kandidati i cili ka paraqitur kandidaturën është dashur t'i përmbahet rregullave të parapara".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi pretendon se Gjykata e Apelit, duke ia refuzuar ankesën kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale, ia ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, konkretisht, nenin 3 [Barazia Para Ligjit], nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafi 1, nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], paragrafi 4, nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemi Gjyqësor]. Për më tepër, parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 23, paragrafi 2 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Parashtruesi gjithashtu pretendon se i janë shkelur të drejtat e mbrojtura nga

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe protokollet e saj, pa specifikuar asnjë nen të këtij instrumenti.

19. Parashtruesi pretendon se *"Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit me rastin e marrjes së vendimeve - aktgjykimeve kontestues, kanë bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore e sanksionuar nga neni 182,1 lidhur me dispozitën e nenit 183 dhe 182.1 (n) [...]".*

20. Parashtruesi gjithashtu pretendon se *"Gjykata e Apelit nuk e vlerësoj asnjë fakt e paraqitur në ankesë, e cila ka për obligim konform dispozitës së nenit 204 të LPK-se me të cilën është paraparë që gjykata e shkallës së dytë më arsyetimin e aktgjykimit, gjegjësisht të aktvendimit, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësisë vendimtare për dhënien e vendimit të saj. Prandaj, gjykata është dashur të gjykoj duke e respektuar hierarkinë e akteve juridike e cila përcaktohet me dispozitën e nenit 22 të Kushtetutës [...]".*

21. Duke iu referuar nenit 23, paragrafi 3, të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, parashtruesi më tutje pretendon se "*gjykatat ia kanë mohuar të drejtën e tij për shpërblim për punën e kryer".*

22. Në fund, parashtruesi kërkoi që Gjykata:

> *"[...] t'i vlerësoj shkeljet nga autoritet publike sipas aktgjykimeve të Gjykatës Themelore në Gjakovë C. nr. 56/208, dt. 20.06.2013 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AC. nr. 2976/2013, dhe të njëjtit të anulohen si jo kushtetuese dhe jo ligjore".*

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kushtet e nevojshme të pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje me Ligj dhe me Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, neni 113 (1) dhe (7) i Kushtetutës parasheh:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

25. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh se "*Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".*

26. Në këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesi ka kërkuar ndihmë për të mbrojtur të drejtat e tij në Gjykatën Komunale dhe Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit ishte shkalla e fundit në të cilën parashtruesi ka mundur të kërkojë zgjidhje, duke pasur parasysh se vlera e kontestit civil ka qenë nën 3,000.00 €. Gjykata vëren gjithashtu se parashtruesit i është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit më 17 janar 2014 dhe ai e ka parashtruar kërkesën e tij në Gjykatë më 5 shkurt 2014.

27. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi është palë e autorizuar, se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion me ligjin e aplikueshëm dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit prej 4 (katër) muajve.

28. Megjithatë, në vlerësimin e saj të mëtejmë të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata i referohet gjithashtu rregullit 36 (1) c) dhe 36 (2) b) të Rregullores së punës, të cilët parashohin se:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar.

"(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...]

29. Siç është cekur më lart, parashtruesi ka kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale para Gjykatës së Apelit për shkelje të ligjit të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

30. Përderisa, pranë Gjykatës Kushtetuese, parashtruesi pretendon shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë për sa i përket barazisë para ligjit, aplikimit direkt të marrëveshjeve dhe të instrumenteve ndërkombëtare, të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të aplikimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe të instrumenteve ndërkombëtare, të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të tij, të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, si dhe të parimeve të përgjithshme të sistemit gjyqësor.

31. Gjykata vëren se në procedurën e apelit, Gjykata e Apelit, lidhur me kërkesën e parashtruesit për kompensimin e të ardhurave personale, e arsyetoi aktgjykimin e saj duke iu referuar dispozitave të ligjit në fuqi. Në këtë drejtim, Gjykata gjen se ajo që ngre parashtruesi është çështje e ligjshmërisë dhe jo e kushtetutshmërisë.

32. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës së Apelit duke iu përgjigjur pretendimit të parashtruesit për shkelje të ligjit dhe shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat pretendohet të jenë kryer nga Gjykata e Apelit kur ia refuzoi kërkesën për kompensimin e të ardhurave personale. Gjykata e Apelit ka deklaruar:

> *"[...] Duke ekzaminuar aktgjykimin e atakuar në kufijtë e pretendimeve të përmendura në ankesë, kjo gjykatë gjeti se i njëjti është nxjerrë pa shkelje thelbësore të procedurës kontestimore, me vërtetim të drejtë të gjendjes faktike dhe me zbatim të së drejtës materiale, andaj gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt kur e ka refuzuar kërkesëpadinë si të pabazuar".*

33. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga ana e Gjykatës Supreme, përveç nëse ato kanë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

34. Gjykata Kushtetuese rithekson më tej se në bazë të Kushtetutës nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih, gjithashtu, edhe rastin KI70/11, të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese,

Aktvendimi për Papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011). Fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë për të ngritur një kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtave të tij, të mbrojtura me Kushtetutë. Gjykata vëren se parashtruesit i është ofruar mundësia e mjaftueshme për ta paraqitur rastin para gjykatave të rregullta.

35. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të rregullt dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia,* Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 13071/87, të miratuar më 10 korrik 1991).

36. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se arsyetimi që i referohet kërkesës për kompensimin e të ardhurave personale në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është i qartë dhe, pasi i ka shqyrtuar të gjitha procedurat, Gjykata ka gjetur gjithashtu se procedurat në Gjykatën Komunale nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

37. Për arsyet e mësipërme, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese në të cilat thirret parashtruesi.

38. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) c), 36 (2) b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 15 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI110/14, Sokol Stavileci, Aktvendim i datës 17 shtator 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit Nr. 254 të Bankës Qendrore të Kosovës, të 14 prillit 2014

KI110/14, vendimi i 17 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës ishte se Banka Qendrore e Kosovës duke refuzuar të shqyrtojë kërkesën e tij për kompensim kishte shkelur seriozisht të drejtat e tij kushtetuese. Parashtruesi i kërkesës nuk iu referua ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar, sepse parashtruesi nuk ka mbështetur pretendimet e tij në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe më tej të specifikuar në Ligj dhe në Rregullore të punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI110/14
Parashtrues
Sokol Stavileci
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit Nr. 254 të Bankës Qendrore të Kosovës, të 14 prillit 2014

GJYKATA KUSHTEUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Sokol Stavileci, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston njoftimin Nr. 254 të Bankës Qendrore të Kosovës, të 14 prillit 2014. Parashtruesi, gjithashtu kërkon përmbarimin e Aktvendimit Nr. 435/84 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 25 shkurtit 1988.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së njoftimit Nr. 254 të Bankës Qendrore të Kosovës, të 14 prillit 2014, nëpërmjet të cilit iu refuzua shqyrtimi për kompensimin e dëmit që parashtruesi i kërkesës e kishte pësuar në aksident trafiku në vitin 1981, për çka ai pretendon se *"i janë shkelur shumë rëndë të drejtat kushtetuese"*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit

për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 30 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 korrik 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI110/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI110/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Ćukalović.

7. Më 1 gusht 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 17 shtator 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në vitin 1981, parashtruesi i kërkesës kishte pësuar aksident trafiku.

10. Gjatë viteve 1981 dhe 1983, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar kompensim për dëmin material dhe jomaterial nga BS "Kosova" në Gjakovë dhe në Prishtinë.

11. Në vitin 1984, parashtruesi i kërkesës kishte ngritur padi ndaj BS "Kosova" në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

12. Më 25 shkurt 1988, Gjykata e Qarkut në Pejë kishte vendosur përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial.

13. Më 11 prill 2014, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Bankën Qendrore të Kosovës.

14. Më 14 prill 2014, Banka Qendrore e Kosovës ishte përgjigjur: *"Pasi kemi pranuar ankesën tuaj të datës 11.04.2014 Banka Qendrore e Kosovës, ju njofton se nuk është kompetente në shqyrtimin e rastit tuaj përkatësisht nuk është kompetente për shqyrtimin e lëndëve*

të cilat lidhen me kompanitë që kanë funksionuar para themelimit të BQK-së".

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi i kërkesës kërkon përmbarimin e Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë (Nr. 435/84, të 25 shkurtit 1988) përkitazi me kompensimin e dëmit material dhe jomaterial.

16. Parashtruesi nuk përmend shkeljen e ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti, mirëpo pretendon se *"të drejtat e tij kushtetuese janë shkelur rëndë".*

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje që të gjykoj kërkesën e parashtruesit, ajo së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

18. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

19. Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës që parasheh:

> *(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *[...]*
>
> *c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.*

20. Gjykata po ashtu merr parasysh rregullin 36 (2) b) d) të Rregullores së punës që parasheh:

> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...]

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar se cilat të drejta janë përcaktuar me Njoftimin (Nr. 254, të 14 prillit 2014) të Bankës Qendrore të Kosovës dhe as nuk ka treguar se pse dhe si ato të drejta janë cenuar nga Njoftimi i kontestuar. Prandaj, Njoftimi në fjalë nuk mund të konsiderohet si një akt i kontestuar në këtë Gjykatë siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës.

22. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit për përmbarim të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë (Nr. 435/84, të 25 shkurtit 1988), Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka treguar se ka kërkuar zhvillimin e procedurave të përmbarimit tek gjykatat e rregullta; për më tepër, vendimi në fjalë është nxjerrë në vitin 1988 çka është jashtë juridiksionit kohor të Gjykatës dhe rrjedhimisht *ratione temporis* i papajtueshëm sepse Kushtetuta ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008.

23. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se kërkesa është *prima facie* e paarsyetuar për shkak se parashtruesi nuk ka mbështetur pretendimet e tij në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe më tej të specifikuar në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe si e tillë e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 36 (2) b) d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) b) d) të Rregullores së punës, më 17 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI50/14, Shemsi Bekteshi, Aktvendim i datës 16 shtator 2014- Vlersimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr.277/2013, të dates 06.dhjetor.2013

Rasti 50/14, vendimi i 16 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta në pronë neni 46 i Kushtetutës, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosoves, Rev. fif.277/2013, të 6 dhjetorit 2013.
Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës ,duke pohuar se i është mohuar e drejta e tij me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme,e cila verteton vendimin e Gjykatave në instanc më të ulet,lidhur me pohimet e parashtruesit për fitim pensional.

Parashtruesi pretendon se në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës "ka patur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, po ashtu parashtruesi thekson që ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut".

Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit ishte qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punes,për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar ndonje provë se të drejtat dhe lirite themelore të tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

Gjykata vëren se Gjykata Supreme e ka arsyetuar mjaftueshëm Aktgjykimin e saj dhe Gjykata nuk mund të konkludoje se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, mutatis mutandis, Shub kunder Lituanise, Vendimi i GJEDNJ-se) në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr.17064/06

Gjykata më tej thekson se nuk është detyrë e Gjykatës që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga ana e Gjykatës rregullt, pervec dhe per aq sa ato mund te kene

shkelur te drejtat dhe lirite e mbrojtura me Kushtetute (kushtetutshmeria).

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI50/14
Parashtrues
Shemsi Bekteshi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 277/2013,
të 6 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Shemsi Bekteshi, me vendbanim në Dumnicë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Supreme), Rev. nr. 277/2013, të 6 dhjetorit 2013, i cili i ishte dorëzuar atij më 19 shkurt 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet se ia *"mohon të drejtën sipas nenit 46 të Kushtetutës"*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 mars 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 1 prill 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 15 maj 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës zëvendësoi gjyqtarin raportues Robert Carolan, dhe në vend të tij caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues.

9. Më 16 shtator 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 30 maj 2005, Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK), miratoi kërkesën e parashtruesit për pension nën kategorinë "A" (Vendimi nr. 90/04), në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/35 dhe me Statutin e Fondit Pensional të KEK-ut.

11. Në vendimin e lartpërmendur të KEK-ut ishte përcaktuar që pagesa e pensionit për parashtruesin e kërkesës do të fillojë më 1 qershor 2005 dhe do të përfundojë më 1 korrik 2010, ndërsa shuma e pensionit mujor do të jetë 105 Euro. Më tej, në vendim theksohej që pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë, pranë Komitetit për shqyrtimin e mospajtimeve.

12. Sipas dokumenteve të parashtruara, kundër këtij vendimi nuk është parashtruar ankesë.

13. Pas 1 korrikut 2010, siç specifikohej në marrëveshje, KEK-u kishte ndërprerë pagesën e pensionit për parashtruesin e kërkesës.

14. Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

15. Më 2 shkurt 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 2256/2010) e kishte refuzuar si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës, me pretendimin se *"KEK-u e ka përmbushur detyrimin siç specifikohet në marrëveshje dhe se kur është nënshkruar marrëveshja nuk është ushtruar asnjë ankesë"*.

16. Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

17. Më 27 maj 2013, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ca. nr. 4022/2012) e refuzoi si të pabazuar ankesën dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 2 shkurtit 2011.

18. Parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

19. Më 6 dhjetor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 277/2013) e refuzoi si të pabazuar revizionin e paraqitur nga parashtruesi.

20. Gjykata Supreme vlerëson se:

> *"Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë kanë konstatuar se paditësi vetë ka aplikuar për fitimin e pensionit - invalid kategoria e I-rë, e cila kërkesë i është miratuar nga ana e të paditurës dhe sipas vendimit nr. 90/4 datë 30.5.2005, pagesa e pensionit ka filluar më 1.6.2005 dhe ka përfunduar më 1.7.2010, në lartësinë mujore prej 105 € në muaj, derisa aplikuesi t'i mbushë 65 vite moshë ose 60 muaj pagesë të pensionit. Paditësi ka mund të paraqes ankesë kundër këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, komitetit për shqyrtimin e mospajtimeve përmes administratës së Fondit Pensional, por ankesë nuk ka ushtruar dhe pensionin e ka pranuar gjer më 1.7.2010. Kjo Gjykatë vlerëson se pas pagesës së kësaj page në kohëzgjatje prej 60 muaj, e paditura më tutje nuk ka asnjë obligim ngase ka përmbushur obligimin ligjor i cili rrjedh nga vendimi i cekur. Sipas dispozitës ligjore nga neni 11,1 nën (b) të Rregullores 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, i cili parasheh se shkëputja e kontratës së punës mund të bëhet përveç tjerash edhe me marrëveshje me shkrim ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit, andaj në rastin konkret vlerësohet se paditësi*

me nënshkrimin e tij në aktvendimin e të padituerës nr. 90/4 dhe moskundërshtimin sipas këshillës juridike, është vullnet i tij që marrëdhënien e punës ta shndërroj në një raport tjetër juridik".

...

"Thëniet e revizionit se e paditura nuk i ka ofruar paditësit vendimin me shkrim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me këshillë juridike, me çka paditësi është vënë në lajthim duke shpresuar se pas shërimit dhe rehabilitimit të tij do t'i mundësohet kthimi në vendin e punës, siç parashihet në dispozitën e nenit 2 nën (b) të Statutit të Fondit Pensional Suplementar, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi si të pabazuar, ngase i njëjti vetë ka aplikuar për pensionim invalidor dhe vetë ka nënshkruar vendimin kontestues në të cilin është potencuar se vendimi i cekur zëvendëson të gjitha aktet e gjertanishme të nënshkruara në mes të KEK-ut dhe shfrytëzuesit, e të cilin nuk e kanë kundërshtuar paditësi sipas këshillës juridike të dhënë".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi pretendon se në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës *"ka patur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, po ashtu ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut".*

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: *"Nuk është zbatuar drejtë dispozita e nenit 2, pika b e statutit të Fondit Pensional Invalidor të KEK-ut me të cilën parashihet se në rastin kur i punësuari invalid është shëruar (rehabilituar) e që shërimin e tij e konstaton IMP-ja, punëtori gëzon të drejtën e rikthimit në punë. Nuk është marrë në konsideratë fakti se komisioni i IMP-së i KEK-ut nuk ka qenë kompetent për shpalljen e paditësit si invalid i kategorisë së parë për faktin se këtë të drejtë sipas ligjit e k a vetëm komisioni profesional i Ministrisë për Punë dhe Çështje Sociale".*

23. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese *"Abrogimin e aktgjykimeve të të trija gjykatave si dhe të urdhëroj rikthimin e parashtruesit të kërkesës në punë".*

Pranueshmëria e kërkesës

24. Para së gjithash, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë.

25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*

26. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) c) dhe (2) b) të Rregullores së punës, të cilët parashikojnë se:

> *(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.*

27. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar ndonjë provë se të drejtat dhe liritë themelore të tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

28. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë sa që procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 13071/87, i 10 korrikut 1991).

29. Gjykata vëren se Gjykata Supreme e ka arsyetuar mjaftueshëm Aktgjykimin e saj dhe Gjykata nuk mund të konkludojë se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009).

30. Gjykata rikujton se rastet e tjera (v. g. KI40/09) janë gjykuar nga Gjykata lidhur me kompensimin e përkohshëm për shkëputjen e marrëdhënies së punës nga KEK-u. Megjithatë, Gjykata vëren se kërkesa e tanishme KI50/14 dallon nga ato të sipërpërmendurat (v. g. KI40/09). Në të vërtetë, në këto raste, KEK-u dhe ish-punonjësit tjerë nënshkruan marrëveshje për kompensim të përkohshëm deri në krijimin e Fondit Pensional dhe Invalidor të Kosovës pa ndonjë referencë për një datë të caktuar, përderisa në rastin konkret KI50/14, KEK-u dhe ish-punonjësit tjerë nënshkruan marrëveshje për kompensim të përkohshëm për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh, pra duke iu referuar një date të caktuar.

31. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk kishte shpjeguar pse dhe si i ishte shkelur e drejta në pronë, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës. Deklarata e thjeshtë se është shkelur Kushtetuta nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga ana e gjykatës së rregullt, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

32. Pra, kjo Gjykatë nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

33. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, rregullat 36 (1) c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 16 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI117/14, Kurtesh Halimi, Aktvendim i datës 5 nëntor 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 543/2013, të 16 majit 2014.

Rasti KI117/14, vendimi i 5 nëntorit 2014.

Fjalë kyçe: kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 543/2013, me të cilin parashtruesi pretendon se "*i janë mohuar benificionet që burojnë nga e drejta në pension*".

Parashtruesi i kërkesës pretendon se janë shkelur të drejtat e tij me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe të zbatimit të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, duke mos treguar në mënyrë të qartë se si këto vendime i kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.

Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me mospërmbushjen e Marrëveshjes kolektive dhe kërkesës për pagesën e shpërblimit jubilar, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e rregullt ku shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.

Parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur me 5 nëntor 2014, njëzëri deklaroi kërkesën si qartazi të pabazuar dhe hidhet poshtë si e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI117/14
Parashtrues
Kurtesh Halimi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 543/2013, të 16 majit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Kurtesh Halimi nga fshati Dobratin, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 543/2013, të 16 majit 2014, i cili i është dorëzuar atij më 2 korrik 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 543/2013, me të cilin parashtruesi pretendon se *"i janë mohuar benificionet që burojnë nga e drejta në pension"*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 korrik 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI117/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI117/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 25 gusht 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.

8. Më 5 nëntor 2014, pasi e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 12 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Podujevë, me Aktgjykimin C. nr. 443/10, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit.

> *"[...] Në paragrafin II të dispozitivit, detyrohet e paditura Komuna e Podujevës-Drejtoria për Arsim, që paditësit t'ia paguaj në emër të dy pagave për shpërblim jubilar, t'ia paguaj shumën prej 567,22 € dhe në emër të dy pagave përcjellëse në pension shumën prej 567,22 €, gjithsej shumën prej 1.134.44 €, me kamatë ligjore në lartësi prej 3.5%, në vit, duke filluar nga*

dita e marrjes së aktgjykimit më datë 12.11.2012, deri në pagesën definitive, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës në shumë prej 98 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

Në paragrafin III të dispozitivit, refuzohet kërkesëpadia e paditësit mbi shumën e gjykuar dhe ate në emër të përcjelljes në pension një pagë në shumë prej 283.61 € [...]".

10. Në një datë të pacaktuar, Komuna e Podujevës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Podujevë, C. nr. 443/10.

11. Më 16 maj 2014, Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 543/2013, aprovoi si të bazuar ankesën e Komunës së Podujevës dhe e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, C. nr. 443/10, të 12 nëntorit 2012, kështu që:

"[...] REFUZOHET në tërësi e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Kurtesh Halimi nga Podujeva me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Podujevës-Drejtoria për Arsim që paditësit t'ia paguaj në emër të dy pagave për shpërblim jubilar, t'ia paguaj shumën prej 567,27 € dhe në emër të dy pagave përcjellëse në pension shumën prej 567.22 €, gjithsejtë shumën prej 1.134,44 € me kamate ligjore në lartësi prej 3,5%, ne vit, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimin më datë 12.11.2012 e deri në pagesën definitive si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës në shumë prej 98 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit ligjor".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi nuk pretendon se cilat nene të Kushtetutës së Kosovës janë shkelur me këtë Aktgjykim, por pretendon si në vijim:

"*Nuk është zbatuar Kontrata kolektive e nënshkruar nga përfaqësuesi i Qeverisë së Kosovës. Komuna e Prishtinës i paguan pa padi ndërsa Komuna e Podujevës nuk i paguan".*

13. Parashtruesi kërkon nga Gjykata si në vijim:

> *"Që të arrihet pagesa e këtyre rrogave përcjellse për në pension, sepse mjaft kam punuar dhe sado kudo kam dhënë Kontributin tim në ngritjen e vetë diesimit arsimor në arsimin e Kosovës. Logjikisht me e logjikuar ashtu si duhet e kemi merituar një tretman në finalizimin e punës arsimore".*

Pranueshmëria e kërkesës

14. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

16. Neni 48 i Ligjit parasheh:

> *„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

17. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) b) të Rregullores, i cili përcakton:

> *„(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *...*
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

18. Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me mospërmbushjen e Marrëveshjes kolektive dhe kërkesës për pagesën e shpërblimit jubilar, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e rregullt ku shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

19. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 543/2013, i 16 majit 2014, në arsyetimin e tij në mënyrë të hollësishme arsyeton dhe përgjigjet në të gjitha pretendimet e parashtruesit, në kërkesëpadinë e tij, si dhe arsyet e aplikimit të rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale, me arsyetimin:

> *"Meqë paditësi ka fituar të drejtën e pensionit të pleqërisë me datën 01.04.2009 në kohën kur ka qenë në fuqi Rregullorja mbi Pensionet në Kosovë, më të cilën në asnjë nen të saj nuk parashihet pagesa e pagave përcjellëse për shkuarjen në pension, ndërsa në nenin 35 të të njëjtës Rregullore parashikohet se kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të".*

20. Parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se cilat nene të Kushtetutës janë të shkelura dhe në cilën mënyrë e mbështesin kërkesën e tij, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 48 të Ligjit.

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se janë shkelur të drejtat e tij me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe të zbatimit të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, duke mos treguar në mënyrë të qartë se si këto vendime i kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.

22. Gjykata më tej thekson se, fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të Kushtetutës (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, kërkesa nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

23. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi që të paraqes rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr.17064/ 06, i 30 qershorit 2009).

24. Përfundimisht, kriteret për pranueshmëri nuk janë plotësuar në këtë kërkesë. Parashtruesi ka dështuar të paraqesë dhe të mbështesë me prova se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të pretenduara.

25. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë si e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 nëntor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 19/14 & KI 21/14, Tafil Qorri dhe Mehdi Syla, Aktvendim i datës 16 shtator 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013

Rastet e bashkuara: KI 19/14 & KI 21/14, vendimi i 16 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesa individuale, qartazi e pabazuar.

Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së dy Aktvendimeve të Gjykatës së Apelit, përkatësisht Aktvendimi CA. nr. 2129/2013, i 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimi CA. nr. 1947/2013, i 5 dhjetorit 2013. Parashtruesit e kërkesës paraqitën paditë e njëjta, por ndarazi, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar nga Drejtoria e Arsimit të Komunës së Gllogocit që t'u paguajë parashtruesve një shumë të caktuar, me rastin e pensionimit të tyre. Gjykata Themelore në Prishtinë hodhi poshtë paditë e parashtruesve si të pabazuara. Parashtruesit pastaj parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila i refuzoi ankesat e tyre si të pabazuara. Rrjedhimisht, u vërtetuan aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me pretendim se Aktgjykimet e kontestuara kanë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Deklaratës Universale për të Drejtat të Njeriut pa specifikuar ndonjë nen të këtyre dokumenteve.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar. Në arsyetimin e saj, Gjykata Kushtetuese konkludoi se faktet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës në asnjë mënyrë nuk i arsyetojnë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese, dhe se ata nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre në mënyrë të mjaftueshme. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese deklaroi se argumentet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës kanë të bëjnë me çështje të *"ligjshmërisë"* dhe jo të *"kushtetutshmërisë"*.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastet Nr. KI19/14 dhe KI21/14
Parashtrues
Tafil Qorri dhe Mehdi Syla
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013, dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesat janë dorëzuar nga z. Fadil Qorri nga Gllogoci dhe z. Mehdi Syla nga fshati Kishnarekë, komuna e Gllogocit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit). Z. Mehdi Syla përfaqësohet nga z. Bashkim Latifi, avokat nga Prishtina, ndërsa z. Fadil Qorri nuk ka përfaqësues.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi Fadil Qorri (KI19/14) e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013, i cili i ishte dorëzuar atij më 17 janar 2014.

3. Parashtruesi Mehdi Syla (KI21/14) e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013, i cili i ishte dorëzuar atij më 17 janar 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të kontestuara, të cilat e refuzuan si të pabazuar

ankesën e parashtruesve lidhur me një shumë të caktuar të kompensimit me rastin e pensionimit të tyre.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 5 shkurt 2014, parashtruesit i dorëzuan kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 6 mars 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI19/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe me Vendimin Nr. KSH. KI19/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 11 mars 2014, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetari urdhëroi bashkimin e kërkesave KI19/14 dhe KI21/14. Me këtë urdhër, ishte vendosur që gjyqtari raportues dhe Kolegji shqyrtues për të dy rastet (KI19/14 dhe KI21/14) të jenë të njëjtë, ashtu siç ishte vendosur me vendimet e Kryetarit, GJR. KI19/14 dhe KSH. KI19/14.

9. Më 13 mars 2014, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ata që të dorëzojnë autorizimin për z. Bashkim Latifi, pasi që parashtruesit kishin njoftuar se ai do t'i përfaqësonte në Gjykatë.

10. Më 16 prill 2014, z. Mehdi Syla (KI21/14) e dorëzoi dokumentin e kërkuar në Gjykatë, ndërsa z. Tafil Qorri nuk e dorëzoi dokumentin e kërkuar.

11. Më 13 qershor 2014, Gjykata i njoftoi parashtruesit për bashkimin e këtyre dy kërkesave dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesave KI19/14 dhe KI21/14 dhe për bashkimin e këtyre dy kërkesave.

12. Më 16 shtator 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Në një datë të pacaktuar, parashtruesit paraqitën padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar nga Drejtoria e Arsimit e Komunës së Gllogocit që t'ua paguajë parashtruesve një shumë të caktuar, me rastin e pensionimit të tyre.

14. Më 4 qershor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi C. nr. 132/2013) e hodhi poshtë padinë e z. Fadil Qorri (KI19/14) si të palejueshme. Të njëjtën ditë, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi C. nr. 130/2013) e hodhi poshtë padinë e z. Mehdi Syla (KI21/14) si të palejueshme.

15. Gjykata Themelore, me rastin e hedhjes poshtë të padive të parashtruesve, arsyetoi në mënyrë identike në të dyja rastet dhe konstatoi se "*[...] Në rastin konkret paditësi nuk i është përmbajtur dispozitave të nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës së Kosovës. Mbi këtë fakt [...] Gjykata duke e aplikuar dispozitën e nenit 391 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore e hudhi poshtë padinë si të palejushme, nga se padia është paraqitur para shterrjes së mjeteve të lejuara tek e paditura*".

16. Parashtruesit ushtruan ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, për shkak të *"shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore"* dhe kërkuan që aktvendimet e kontestuara të prishen dhe rastet të kthehen për rigjykim në Gjykatën Themelore.

17. Më 5 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendimi CA. nr. 2129/2013) e refuzoi si të pabazuar ankesën e z. Fadil Qorri (KI19/14). Të njëjtën ditë, Gjykata e Apelit (Aktvendimi CA. nr. 1947/2013) e refuzoi si të pabazuar ankesën e z. Mehdi Syla (KI20/14). Në të dy rastet, Gjykata e Apelit arsyetoi se:

> "*[...] gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt kur e ka hedhur poshtë padinë e paditësit si të pa lejuar. [...] nga shkresat e lendes përfundohet se paditësi nuk iu ka drejtuar të paditurës për mbrojtjen e të drejtave të veta me rastin e shkuarjen në pension, konform nenit 78 të Ligjit të Punës të Kosovës. [...] e drejta për pension dhe beneficionet eventuale rezultojnë nga marrëdhënia e punës, andaj paditësi konform*

nenit 78 të Ligjit të Punës është dashur ta respektojë procedurën interne për realizimin e të drejtave te veta".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesit pretendojnë se aktvendimet e kontestuara përbëjnë shkelje të nenit 3 (Barazia para Ligjit), të nenit 22 (Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), të nenit 24 (Barazia para Ligjit) dhe të nenit 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës. Parashtruesit pretendojnë shkeljen e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ), pa e saktësuar ndonjë nen të këtyre dokumenteve.

19. Parashtruesit në kërkesat e tyre të ndara, por identike, pretendojnë se *"Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, e ka ngatërruar bazën juridike të kërkesëpadisë duke e trajtuar si kategori për proceduarat për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës nga neni 78 i Ligjit të Punës, ndërsa në rastin konkret fjala është kompensimi sipas kontratës kolektive si kategori nga marrëdhëniet detyrimore".*

20. Për më tepër, parashtruesit pretendojnë që *"Sipas dispozitës së nenit 102 të Kushtetutës [...] Gjykatat është dashur të gjykojnë pa asnjë ndikim, duke e respektuar hierarkinë e akteve juridike e cila përcaktohet me dispozitën e nenit 4 të Ligjit nr. 03/l-212 të Punës, te cilat paraqesin burim të drejtave të punëtoreve [...]".*

21. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që *"t'i vlerësoj shkeljet nga autoritet publike sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë [...] dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [...] dhe të njëjtit t'i anulojë si jo kushtetuese dhe jo ligjore".*

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar (...)".

24. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c), 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

(c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...], ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

25. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit i kishin kontestuar aktvendimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Tani, ata i kontestojnë aktvendimet e Gjykatës së Apelit në Gjykatën Kushtetuese, sepse aktvendimet e kontestuara pretendohet t'u kenë shkelur *"të drejtat e garantuara për barazi para ligjit dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave*".

26. Gjykata rikujton se në pajtim me parimin e subsidiaritetit, parashtruesit duhet të ngrenë çfarëdo shkelje të pretenduar kushtetuese në gjykatat e rregullta, ashtu që në radhë të parë të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre themelore të mishëruara në Kushtetutë. Parashtruesit duhet gjithashtu të mbështesin pretendimin e tyre dhe të sqarojnë si dhe pse një vendim i ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë.

27. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit nuk i kanë ngritur shkeljet e pretenduara kushtetuese të të drejtave të tyre të garantuara për barazi para ligjit dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave në Gjykatën e Apelit. Përveç kësaj, parashtruesit nuk

sqarojnë saktësisht si dhe pse aktvendimet e Gjykatës së Apelit ua kishin shkelur të drejtat e tyre për barazi para ligjit dhe për mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

28. Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit iu ishte përgjigjur të gjitha pretendimeve të parashtruesve, kur kishte refuzuar ankesën e tyre, duke gjetur se: *"Kontrata kolektive ne te cilën paditësi e mbështet të drejtën e vet është miratuar me 1.01.2005 dhe ka qenë në fuqi tri vjet, përkatësisht deri me 31.12.2007. Pas kësaj në Kosovë nuk është lidhur asnjë kontratë kolektive, gjë që është fakt i njohur. Paditësi të drejtën në pension e ka fituar më 30.04.2012 dhe nuk mund të kërkojë pagesën e pagave për shkak të shkuarjes në pension dhe pagat jubilare në bazë të Kontratës kolektive jo valide"*.

29. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se aktvendimi i Gjykatës së Apelit ka dhënë arsyetim të gjerë dhe të plotë të fakteve të çështjes dhe konstatimet e tij ligjore janë mirë të arsyetuara dhe të qarta, në përgjigjen ndaj pretendimeve të paraqitura nga parashtruesit. Prandaj, Gjykata konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

30. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28, shih gjithashtu rastin Nr. KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

31. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë që procedurat në përgjithësi dhe të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesit të kenë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë se Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

32. Pas shqyrtimit të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga parashtruesit, Gjykata konsideron se aktvendimet e kontestuara nuk ishin nxjerrë në mënyrë të padrejtë apo arbitrare.

33. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre dhe as nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do
të tregonte shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ
apo DUDNJ.

34. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konkludon se faktet e paraqitura nga parashtruesit në asnjë mënyrë nuk i arsyetojnë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese, në të cilat ata thirren dhe ata nuk i kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës dhe me rregullat 36 (1) c), 36 (2) b), 36 (2) d) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 16 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI09/14, Skender Çoçaj, Aktvendim i datës 16 shtator 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. 399/2012, të 22 gushtit 2013

Rasti KI09/14, vendimi i 16 shtatorit 2014

Fjalët kyçe: kërkesa individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi parashtroi kërkesën e tij në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar Aktvendimin Rev. 399/2012, e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 399/2012, të 22 gushtit 2013, i cili sipas pretendimeve të parashtruesit kishte shkelur nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. 399/2012, të 22 gushtit 2013, Gjykata Kushtetuese konstatoi se dëshmitë e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk kanë arsyetuar pretendimin për shkelje të së drejtës kushtetuese dhe se parashtruesi nuk e ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij. Prandaj, Gjykata konkludoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese prandaj kërkesa e tij është qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI09/14
Parashtrues
Skender Çoçaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 399/2012, të 22 gushtit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Skender Çoçaj, me vendbanim jashtë Kosovës. Ai përfaqësohet nga znj. Vahide Braha, avokate, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 399/2012, të 22 gushtit 2013. Ky vendim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 7 tetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56, paragrafi 2, të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 janar 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 shkurt 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

7. Më 26 shkurt 2014, Gjykata Supreme u njoftua për kërkesën.

8. Më 15 shtator 2014, Kryetari zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtarin Kadri Kryeziu si anëtar të Kolegjit shqyrtues.

9. Më 16 shtator 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Nga dosja e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar si referent për ekzekutime në Gjykatën Komunale në Prishtinë, që nga 19 nëntori 1973, me kontratë për periudhë të pacaktuar.

11. Gjatë luftës së vitit 1999, parashtruesi i kërkesës është larguar fillimisht në Maqedoni dhe më pas në Australi. Ai u kthye në Kosovë në vitin 2000, pas përfundimit të luftës. Pas kthimit të tij, parashtruesi i kërkesës u paraqit në punë në mënyrë që të vazhdonte detyrën e tij si referent për ekzekutime në Gjykatën Komunale të Prishtinës. Megjithatë, ai nuk u rikthye në punë. Pretendohet se ish-punonjës të tjerë të Gjykatës Komunale të Prishtinës ishin kthyer në punë.

12. Në një datë të pacaktuar në vitin 2000, parashtruesi i kërkesës pësoi sulm në zemër dhe u kthye në Australi për trajtim mjekësor. Gjatë viteve në vijim, ai vazhdoi të merrte trajtim mjekësor, e megjithatë u rikthye në Kosovë në disa raste për të kërkuar që të rikthehej në vendin e tij të punës, mirëpo pa sukses.

13. Midis viteve 2004 dhe 2007, parashtruesi i kërkesës aplikoi në disa raste për pozita të lira të punës të shpallura nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për pozitën e referentit për ekzekutime pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë. Megjithatë, me sa duket ai asnjëherë nuk ka pranuar ndonjë njoftim nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në lidhje me aplikimet e tij të ndryshme.

14. Më 9 shkurt 2009, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke kërkuar që të vërtetohet marrëdhënia e tij e punës me afat të pacaktuar nga viti 1973 si referent për ekzekutime në Gjykatën Komunale të Prishtinës. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se marrëdhënia e tij e punës për periudhë të pacaktuar nuk ishte ndërprerë asnjëherë, dhe se sipas ligjit të zbatueshëm, siç përcaktohet nga UNMIK-u, kontrata e tij e punës e vitit 1973 ishte ende e vlefshme.

15. Më 19 janar 2011, me Aktgjykimin C. nr. 276/09, Gjykata Komunale e Lipjanit e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Gjykata Komunale arsyetoi se themelimi i UNMIK-ut pas luftës kishte krijuar një realitet të ri juridik. Gjykata, *inter alia,* theksoi se:

> *"Bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/1 shprehimisht thuhet: tërë kompetenca ligjëdhënëse dhe ekzekutive, në lidhje me Kosoven duke përfshirë administrimin e gjyqësisë, i vishet UNMIK-ut dhe këtë e ushtron përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm, gjithashtu rregullorja 1999/06 lidhur me rekomandimet për strukturen dhe administraten e gjyqësisë dhe shërbimet e Prokrorisë Publike si dhe me Rregulloren 1999/7 mbi emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarve dhe prokurorve, konstatohet se: kontinuitetit i Gjykatës Komunale në Prishtinë sikur edhe i gjithë gjykatave tjera, të të gjitha instancave, është ndërprerë dhe ka fillue sipas këtyre Rregulloreve kështu që nuk mund të qëndroj pretendimi i paditësit se është një mardhenje të përhershme pune, referent i ekzekutimeve pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë që nga dt. 19.11.1973, mbi bazen e ketyre rregulloreve, me formimin e sistemit të ri gjyqësor, kompetencat të cilat i ka pas vetëm administra e UNMIK-ut, përkatësisht PSSP".*

16. Më 13 shtator 2012, me Aktgjykimin Ac. nr. 275/2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale në Lipjan. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme.

17. Më 22 gusht 2013, me Aktgjykimin Rev. nr. 399/2012, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion. Gjykata Supreme u pajtua me gjykatat e instancave më të ulëta se Rregulloret e cituara të UNMIK-ut e kishin ndërprerë vazhdimësinë e sistemit gjyqësor dhe, rrjedhimisht, edhe kontratën e punës së parashtruesit të kërkesës. Gjykata Supreme konstatoi se:

> *"[...] gjykata e shkallës së dytë drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, [...]".*

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme dhe gjykatat e shkallëve më të ulëta në mënyrë të pasaktë kanë përcaktuar ligjin e zbatueshëm në Kosovë nën autoritetin e UNMIK-ut. Parashtruesi i kërkesës thekson se sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1, si dhe sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, ligjet të cilat janë zbatuar në territorin e Kosovës para 24 marsit 1999, përkatësisht 22 marsit 1989, vazhdojnë të zbatohen. Ai thekson se kontrata e tij e punës rregullohej me ligjin jugosllav, më saktësisht me ligjin e publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 60/89 dhe nr. 42/90, i cili, në nenin 78, përcakton se:

> *"Vendimi për pushimin e marrëdhënies së punës së punëtorit dhe arsyet për miratimin e vendimit të këtillë duhet ti dërgohen punëtorit në formën me shkrim, me udhëzim me të drejtë për ushtrimin e prapësimit".*

19. Mbi bazën e vlefshmërisë së vazhdueshme të këtij ligji, parashtruesi i kërkesës pretendon se kontrata e tij e punës po ashtu ka vazhduar të jetë e vlefshme, pasi ai asnjëherë nuk ka marrë njoftim me shkrim për ndërprerje. Prandaj, ai pretendon se i është shkelur e drejta për të punuar si referent për ekzekutime në Gjykatën Komunale të Prishtinës, siç garantohet me nenin 49 të Kushtetutës.

20. Për më tepër, parashtruesi i ankesës vëren se punonjësit e tjerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë, në të vërtetë ishin kthyer në punë pas luftës. Prandaj, ai pretendon se nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me ish-kolegët e tij, duke shkelur kështu nenin 24 të Kushtetutës.

21. Së fundmi, parashtruesi i kërkesës pretendon se për shkak të interpretimit të Rregulloreve të UNMIK-ut, të cilat përcaktojnë ligjin e zbatueshëm në Kosovë, dhe duke shpërfillur trajtimin e barabartë, të cilit i është nënshtruar, Gjykata Supreme dhe gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk i kanë siguruar atij një proces të drejtë për padinë e tij kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke shkelur kështu të drejtën e tij për gjykim të drejtë siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Për të qenë në gjendje ta gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Gjykata duhet gjithashtu të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e nenit 113.7 të Kushtetutës dhe të nenit 47.2 të Ligjit.

Neni 113, paragrafi 7, përcakton:

> *"Individët janë autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

24. Vendimi i fundit në rastin e parashtruesit të kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 399/2012, i 22 gushtit 2013. Si rezultat, parashtruesi i kërkesës ka treguar se ai i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit.

25. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu duhet të dëshmojë se i ka përmbushur kriteret e nenit 49 të Ligjit përkitazi me dorëzimin e kërkesës brenda afatit ligjor. Nga dosja e lëndës mund të shihet se vendimi i fundit në rastin e parashtruesit të kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 399/2012, i 22 gushtit

2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 7 tetor 2013, ndërsa parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 23 janar 2014, që nënkupton se kërkesa është dorëzuar brenda afatit prej 4 (katër) muajsh, të përcaktuar me Ligj dhe me Rregullore të punës.

26. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e faktit ose ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Prandaj, nuk është detyrë e Gjykatës që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i këtyre të fundit që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis, Garcia kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

27. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë që procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, të jenë mbajtur në mënyrë të tillë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 13071/87, i 10 korrikut 1991).

28. Në rastin e tanishëm, parashtruesit të kërkesës i ishin ofruar mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tij dhe për të kundërshtuar interpretimin e ligjit të zbatueshëm në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe në Gjykatën Supreme. Pas shqyrtimit të procedurave në tërësi, Gjykata nuk gjen se procedurat përkatëse kanë qenë në çfarëdo mënyre të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

29. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thirret në nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata konstaton se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, i kontestuar nga parashtruesi i kërkesës, nuk ia ndalon në asnjë mënyrë atij punën apo ushtrimin e profesionit. Gjykata Supreme, me Aktgjykimin e saj, Rev. nr. 399/2012, thjesht ka vërtetuar se punësimi specifik i parashtruesit të kërkesës, nga viti 1973 deri më 1999 ka përfunduar. Kjo në asnjë mënyrë nuk e pengon apo parandalon parashtruesin e kërkesës që të angazhohet

në ndonjë punë tjetër, të cilën ai mund ta përzgjedhë. Prandaj, nuk ka asgjë në pretendimet e parashtruesit të kërkesës që e arsyeton përfundimin se e drejta e tij kushtetuese për punë është shkelur.

30. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar pretendimet e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar ndonjë provë se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

31. Rregulli 36 (2) (d) i Rregullores së punës parasheh se "*Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se (...) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij*".

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (2) (a) dhe (d) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 16 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI115/14, Azem Ademi, Vendim i datës 17 shtator 2014- Vlerësim i kushtetutshmërisë së një vendimi të paidentifikuar të një autoriteti publik të paidentifikuar

KI 115/14, vendimi i 17 shtatorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, vendim për heqje të kërkesës nga lista.

Gjykata Kushtetuese vendosi të heqë kërkesën nga lista sepse parashtruesi i kërkesës parashtroi një faqe të letrës pa kontestuar ndonjë vendim të ndonjë autoriteti publik dhe pa ndonjë pretendim lidhur me shkeljen e dispozitave kushtetuese në dëm të tij. Për më tepër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar një "kërkesë" të paqartë dhe të pakuptueshme.

VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA
në
Rastin Nr. KI115/14
Parashtrues
Azem Ademi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së një aktvendimi të paidentifikuar të një autoriteti publik të paidentifikuar

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Azem Ademi, nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk e identifikon një aktvendim të ndonjë organi publik i cili kontestohet, edhe pse ai i referohet Aktvendimit për papranueshmëri, në Rastin nr. KI62/10, parashtrues i kërkesës *Azem Ademi kundër Ministrisë së Drejtësisë,* të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 18 marsit 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës nuk pretendon shkelje të dispozitave kushtetuese në dëm të tij në çfarëdo mënyre qoftë. Sidoqoftë, parashtruesi i kërkesës përmend *"Arsyetim në lidhje me lëndën, rasti nr. KI-62"*, pa nxjerrë asnjë përfundim.

Baza juridike

4. Me sa duket kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së

Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji). Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës nuk përmend asnjë dispozitë ligjore sipas së cilës ai e parashtron kërkesën dhe ai madje as nuk e ka plotësuar formularin e kërkesës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 7 korrik 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI115/14, caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI115/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 13 gusht 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 17 shtator 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 12 korrik 2010, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, duke u ankuar, *inter alia*, se Ministria e Drejtësisë nuk i ka dhënë atij të drejtat e caktuara të cilat ai pretendon se i takojnë si qytetar i një vendi që ishte pjesë e Bashkimit Evropian.

10. Më 18 mars 2011, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmëri në Rastin nr. KI62/10 duke e refuzuar kërkesën e parashtruesit si qartazi të pabazuar.

11. Më 7 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi një faqe të letrës duke deklaruar, *inter alia*, *"Arsyetimi në lidhje me lëndën, rasti nr. KI-62".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi i kërkesës*, inter alia*, deklaron se *"Gjykata e Posaçme do t' i gjykonte akuzat, nga "Raporti për Kosovën" në rast se vërtetohen. Rasti, unë, Azem Ademi, aktualisht banor i Prishtinës, shtetas i Republika e Kosovës,nuk duhet të akuzohet ngjajshëm me*

rastin Radovan Karagjiq, shtetas jugosllav, ish jugosllavija, i akuzuar për Krime Lufte, aktualisht në procesin gjyqësor, Tribunali i Hagës".

13. Parashtruesi i kërkesës nuk thirret në shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Pranueshmëria e kërkesës

14. Para së gjithash, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

16. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest".*

17. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar një faqe të letrës pa e kontestuar ndonjë vendim të ndonjë autoriteti publik dhe pa ndonjë pretendim lidhur me shkeljen e dispozitave kushtetuese në dëm të tij. Për më tepër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar një "kërkesë" të paqartë dhe të pakuptueshme.

18. Gjykata vëren se procedurat në Gjykatën Kushtetuese janë kundërshtuese për nga natyra dhe prandaj nuk është çështje e Gjykatës ta ndërtojë rastin në emër të parashtruesit të kërkesës. Përkundrazi, kjo duhet të bëhet nga vetë parashtruesi i kërkesës, i cili duhet t'i drejtohet Gjykatës, në përputhje me të gjitha kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.

19. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se letra e lartpërmendur prej një faqeje nuk e kalon pragun minimal që të konsiderohet kërkesë. (Shih rastin nr. KI62/14, Parashtrues i kërkesës *Rexhep*

Haziri, Vendim për heqje të kërkesës nga lista, i 4 gushtit 2014, gjithashtu *mutatis mutandis* shih rastin *Starodub kundër Ukrainës,* Nr. 5483/02, Vendim i GJEDNJ-së, i 7 qershorit 2005).

20. Gjykata konkludon se nuk ka rast ose kontest të pazgjidhur lidhur me çështjen e lartpërmendur dhe në pajtim me rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, "kërkesa" duhet të hiqet nga lista.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 32 (4) a) të Rregullores së punës, më 17 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA HEQË kërkesën nga lista;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI167/14, Zelqif Berisha, Vendim për masë të përkohshme i datës 8 dhjetor 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës se Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0045-A0001, të 26 qershorit 2014

Rasti KI167/14, vendimi i 8 dhjetorit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, papranueshme.

Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme te Kosovës, lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit përkitazi me procesin e privatizimit të hotelit Grand.

Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht ta ndalojë AKP-në, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga tjetërsimi i çdo prone që është në posedim të parashtruesit të kërkesës ose për të cilën ai mund të ketë titullin ligjor, duke përfshirë tjetërsimin e mëtejshëm te aksioneve në Ndër e Re Grand Hotel.

Gjykata Kushtetuese vëren se kërkesa për vendosjen e Masës së përkohshme duhet argumentuar mbi baza reale të shkaktimit të rrezikut apo demit të paripareshëm, vlera e të cilit është e pakompensueshme në kuptimin material dhe monetar.

Gjykata Kushtetuese, pa paragjykim ndaj ndonjë vendimi të mëtejshëm që do të nxirret nga Gjykata, për pranueshmërinë ose meritat e kërkesës në të ardhmen, konstaton se kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME
në
Rastin Nr. KI167/14
Parashtrues
Zelqif Berisha,
pronar i NTP Unio Commerce
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0045-A0001, të 26 qershorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Zelqif Berisha, pronar i NTP Unio Commerce, me seli në komunën e Hanit të Elezit, i përfaqësuar nga z. Alexander Borg Olivier, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS), AC-I-13-0045-A0001, të 26 qershorit 2014, me të cilin ishte vërtetuar Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, C-I-12-0042 i 20 marsit 2013.

3. Parashtruesi i kërkesës aktgjykimin e kontestuar e kishte pranuar më 14 korrik 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit (AC-I-13-0045-A0001, të 26 qershorit 2014), për të cilin parashtruesi pretendon se i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe të drejtave të tij garantuara me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

5. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht "*Ta ndalojë AKP-në, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga tjetërsimi i çdo prone që është në posedim të parashtruesit të kërkesës ose për të cilën ai mund të ketë titullin ligjor, duke përfshirë tjetërsimin e mëtejshëm të aksioneve në Ndër. e Re Grand Hotel SHPK, dhe çdo pronë në posedim ose pronësi ose në lidhje me kompaninë [...]*".

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit, Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 (c) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 14 nëntor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

8. Më 24 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI167/14 caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin, KSH. KI167/14 caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

9. Më 26 nëntor 2014, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës DHPGJS-së dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

10. Më 8 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta refuzojë kërkesën për Masë të përkohshme si të pabazuar.

Përmbledhja e shkurtër e fakteve

11. Në vitin 2005, në kuadër të procesit të privatizimit, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM), inicioi një "Spin Off Special" të shitjes, përmes privatizimit, të objekteve të Hotelit Grand në Prishtinë.

12. Pas përfundimit të procesit të ofertimit, kontrollit të historikut, dhe çështjes gjyqësore në Dhomën e Posaçme, AKM-ja kishte shpallur si ofertues fitues parashtruesin e kërkesës.

13. Më 10 gusht 2006, AKM-ja lidhi kontratën me parashtruesin për t'i shitur këtij tërë kapitalin aksionar të Ndërmarrjes së Re Grand Hotel SHPK (në tekstin e mëtejmë: Grand Hotel). Si rrjedhojë, kapitali aksionar ishte transferuar në mënyrë të plotë dhe aksionet e Hotelit Grand ishin regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në emër të NTP Unio Commerce.

14. Kontrata e lidhur mes AKM-së dhe parashtruesit, detyronte parashtruesin për të përmbushur disa kushte të përcaktuara në marrëveshjen e zotimeve. Në mesin e atyre kushteve ishin zotimet për të realizuar investime të caktuara financiare në ndërtesën e Hotelit Grand, dhe punësimin e një numri të caktuar të punëtorëve brenda një afati të caktuar kohor.

15. Më 31 maj 2012, Bordi i Drejtorëve të AKP-së, si pasardhëse ligjore e AKM-së, me arsyetimin se parashtruesi nuk kishte vepruar në përputhje të plotë me zotimet për investime dhe punësim që ishin të përcaktuara në marrëveshjen e zotimeve, njëzëri mori vendim për kthimin e të gjitha aksioneve të blera nga parashtruesi.

16. Si rezultat i vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, aksionet dhe Hoteli Grand tani janë nën administrimin e AKP-së.

17. Më 8 qershor 2012, parashtruesi paraqiti padi në DHPGJS-së. Parashtruesi po ashtu paraqiti kërkesë për Masë të përkohshme, duke kërkuar nga DHPGJS-në të ndalojë AKP-në nga tjetërsimi i aksioneve të Hotelit Grand tek palët e treta deri në marrjen e vendimit përfundimtar përkitazi me meritat e padisë.

18. Më 29 qershor 2012, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së (Aktvendimi, C-I-12-0042), kishte refuzuar kërkesën për Masë të përkohshme, duke arsyetuar se për lëndën në fjalë nuk ka asnjë indikacion se ndonjë dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm mund të shkaktohet dhe i cili nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme dhe me anë të një kompensimi financiar.

19. Si rezultat i ankesës së parashtruesit, më 27 shtator 2012, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së (Aktvendimi, AC-I-12-0042), ankesën e parashtruesit e pranoi si pjesërisht të bazuar dhe vendosi që: *"AKP-së i ndalohet tjetërsimi i aksioneve të New Co Hotel Grand tek palët e treta, deri në vendimin përfundimtar mbi meritat e padisë"*.

20. Më 20 mars 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së (Aktgjykimi, C-I-12-0042 të 20 marsit 2013), padinë e parashtruesit e refuzoi, si të pabazuar, me arsyetimin se vendimi i AKP-së për të ushtruar tërheqjen e aksioneve të Hotelit Grand ishte i vlefshëm.

21. Kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, parashtruesi ushtroi të drejtën e ankesës në Kolegjin e Apelit të DHSPK-së, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës, vlerësim të gabuar të fakteve, dhe interpretimit të gabuar të së drejtës materiale.

22. Më 26 qershor 2014, Kolegji i Apelit të DHSPK-së refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së (C-I-12-0042 të 20 marsit 2013).

23. Në aktgjykimin e saj, DHPGJS-ja konstatoi dhe përfundoi si në vijim:

> *"Kolegji i Ankesave konsideron se paditësi nuk i ka plotësuar substancialisht kushtet e përcaktuara me marrëveshjen e zotimeve, dhe mos plotësimi i tyre është e qartë se paraqet shkelje të madhe të obligimeve kontraktuale të marrëveshjes (që është parakusht për vendimin refuzues), dhe këtu nuk ka pasur asnjë kundërshtim të argumentuar, as të vetë paditësit. Nga shkresat e lëndës kolegji i Ankesave gjeti se kishte disa parashtresa nga e paditura që ia dërgonte paditësit duke ia tërhequr vërejtjen për kalimin e afateve për përmbushje të obligimeve, madje kishte edhe penallti për këtë dështime, megjithatë, paditësi nuk ka arritur që t'i plotësoj zotimet e marra me marrëveshje"*.

Pretendimet e parashtruesit dhe kërkesa për Masë të përkohshme

24. Ashtu siç u cek më lart, parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së (AC-I-13-0045-A0001 i 26 qershorit 2014), duke vërtetuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së (C-I-12-0042 i 20 marsit 2013) ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe të drejtat të tij garantuara me nenin 6 [E Drejta për një proces të Rregullt] dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

25. Parashtruesi, përveç kërkesës për të anuluar aktgjykimin e kontestuar, kërkon që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht "*Ta ndalojë AKP-në, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga tjetërsimi i çdo prone që është në posedim të parashtruesit të kërkesës ose për të cilën ai mund të ketë titullin ligjor, duke përfshirë tjetërsimin e mëtejshëm të aksioneve në Ndër. e Re Grand Hotel SHPK, dhe çdo pronë në posedim ose pronësi ose në lidhje me kompaninë […]*".

26. Parashtruesi arsyeton se "*nëse ndonjë proces i mëtejshëm tjetërsimi ndërmerret nga ana e AKP-së në këtë fazë, siç tregohet nga faktet e çështjes deri më tani, do të paraqiten pasoja të rënda dhe të papërmirësueshme, të dëmshme për parashtruesin e kërkesës dhe të cilat sipas të gjitha gjasave nuk mund të kompensohen në mënyrë adekuate apo të rregullohen me kompensim financiar*".

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

27. Në mënyrë që Gjykata të lejojë Masë të përkohshme në pajtim me nenin 27 të Ligjit dhe me rregullin 55 (4) dhe (5) të Rregullores së punës, duhet të konstatojë se:

Neni 27 i Ligjit

1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë

të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

Rregulli 55 (4) i Rregullores

(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për papranueshmërinë e saj, rastin prima facie për papranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masë e përkohshme.

(c) Masa e përkohshme është me interes publik.

Rregulli 55 (5) i Rregullores

Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

28. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë argument dhe as nuk ka paraqitur ndonjë evidencë, pse dhe si Masa e përkohshme është e nevojshme për të evituar rreziqe, ose dëme të pariparueshme, ose nëse vendosja e kësaj Mase të përkohshme është në interes publik, ashtu siç kërkohet me nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

29. Kërkesa për vendosjen e Masës së përkohshme duhet argumentuar mbi baza reale të shkaktimit të rrezikut apo dëmit të pariparueshëm, vlera e të cilit është e pakompensueshme në kuptimin material dhe monetar (Shih, KI187/13, parashtruese *N. Jovanović*, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykim i 16 prillit 2014, paragrafi 74).

30. Prandaj, Gjykata Kushtetuese, pa paragjykim ndaj ndonjë vendimi të mëtejshëm që do të nxirret nga Gjykata, për pranueshmerinë ose meritat e kërkesës në të ardhmen, konstaton se kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 27 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullat 55 (4) dhe (5) dhe 56 (c) të Rregullores së punës, më 8 dhjetor 2014, me shumicë votash

VENDOS

I. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI94/14, Sadat Ademi, Aktvendim i datës 5 nëntor 2014,- Mospërmbarimi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Kosovë, PA1 nr. 966/2013, të 27 nëntorit 2013

Rasti KI 94/14, vendimi i 5 nëntorit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, mosshterimi i mjeteve juridike.

Pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës ishte se Aktgjykimi (PA1 nr. 966/2013 i 27 nëntorit 2013) i Gjykatës së Apelit të Kosovës nuk ishte duke u zbatuar edhe pa iu referuar ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme me arsyetimin se parashtruesi nuk kishte shteruar të gjitha mjetet juridike sipas ligjit të Kosovës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI94/14
Parashtrues
Sadat Ademi
Mospërmbarimi i Aktgjykimit
të Gjykatës së Apelit në Kosovë, PA1 nr. 966/2013,
të 27 nëntorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Sadat Ademi, me vendbanim në fshatin Pestovë, Vushtrri.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston mospërmbarimin e Aktgjykimit PA1 nr. 966/2013 të Gjykatës së Apelit në Kosovë, të 27 nëntorit 2013, i cili i është dorëzuar atij më 4 dhjetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Pa iu referuar ndonjë neni konkret të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij, pasi që Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Kosovë, i 27 nëntorit 2013, nuk është përmbaruar në pjesën me të cilën urdhërohet kthimi i një traktori të vjedhur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatë

5. Më 26 maj 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. GJR.KI94/14 caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI94/14 caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 20 qershor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai informata shtesë, përkatësisht për masat që ka ndërmarrë për të kthyer traktorin, dhe që të sigurojë një kopje të Aktgjykimit PP nr. 628/2012 të Gjykatës së Mitrovicës.

8. Më 5 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës nuk i ka përshkruar faktet e rastit. Në vend të kësaj ai deklaroi "*deri më sot nuk jam i kënaqur me vendimet e gjykatës. Tash e mas ju drejtova juve. Shpresoj që kjo Gjykatë të mos punojë dhe të mos bashkëpunoj me hajnat.*"

10. Parashtruesi i kërkesës ka bashkangjitur kopjet e disa dokumenteve nga të cilat mund të nxirren disa fakte.

11. Në të vërtetë, më 1 mars 2012, Dega në Vushtrri e Gjykatës Themelore në Mitrovicë lëshoi një urdhër për sekuestrim të përkohshëm të një traktori të llojit "Massey Fergunson", deri në një vendim tjetër të Gjykatës.

12. Më 19 korrik 2013, Gjykata Themelore (Aktgjykimi P. nr. 112/2012) e shpalli F.B. fajtor për dëmtimin e parashtruesit të kërkesës dhe për marrjen e traktorit të markës "Massey Fergunson". Gjykata Themelore i kishte shqiptuar të akuzuarit F.B. dënimin me një vit burgim dhe e urdhëroi atë "*që të dëmtuarit Sadat Ademi në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit t'ia kthejnë traktorin".*

13. Më 27 nëntor 2013, Gjykata e Apelit në Kosovë nxori Aktgjykimin (PA1. nr. 966/2013), me të cilin refuzoi ankesën e të akuzuarit F. B. dhe konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

14. Më 27 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës e njoftoi Gjykatën se ai nuk kishte ndërmarrë masa të mëtejme për ta kthyer traktorin e tij. Sidoqoftë, parashtruesi i kërkesës nuk e dorëzoi kopjen e kërkuar të Aktgjykimit PP nr. 628/2012 të Gjykatës së Mitrovicës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon që "*deri më sot mi kanë shkelur të drejtat e mia, nuk më është kthyer mjeti i vjedhur 'traktori' nuk kam të ardhura tjera.*"

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

17. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka kërkuar nga gjykata kompetente përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore (Aktgjykimi P. nr. 112/2012) të lëshuar më 19 korrik 2013, i cili mori formën e prerë më 27 nëntor 2013.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

19. Gjykata i referohet edhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Individi mund të ngrejë kërkesën vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

20. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu i referohet rregullit 36 (1) a) të Rregullores së punës, i cili parasheh se:

> "*(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: a) janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar".*

21. Gjykata vëren se parashtruesi nuk kishte ndërmarrë asnjë masë ligjore për përmbarimin e vendimit (PA1 nr. 966 / 2013) të Gjykatës së Apelit në Kosovë, të 27 nëntorit 2013, për të kthyer mjetin e tij motorik.

22. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive sipas ligjit të Kosovës, në mënyrë që Gjykata të vazhdojë me pretendimin e tij për mospërmbarim.

23. Gjykata rikujton se, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi i kërkesës është i obliguar që të shterojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, siç janë përcaktuar me nenin 113.7 dhe me dispozita tjera ligjore, siç u përmend më sipër.

24. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, t'iu ofrohet mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih Aktvendimin për papranueshmëri, *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI41/09*, parashtrues i kërkesës, i 21 janarit 2010, dhe shih *mutatis mutandis, Selmouni kundër Francës*, Nr. 25 803/94, GJEDNJ, Vendimi i 28 korrikut 1999).

25. Rrjedh se, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 te Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së Punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, më 5 nëntor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI36/14, Bojan Đokić, Ljubica Đokić, Zvonko Đokić dhe Đorđe Đokić, Aktvendim i datës 7 nëntor 2014 - Ankesë për mungesë të hetimeve të një vrasjeje dhe të kompensimit për shkatërrimin e pronës.

Rasti KI36/14, vendimi i 7 nëntorit 2014.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, *qartazi të pabazuar, ratione temporis*.

Parashtruesit e kërkesës nuk i referohen qartë ndonjë vendimi të veçantë të një autoriteti publik që duhet të kontestohet.

Ata ankohen kryesisht përkitazi me dështimin e autoriteteve "që të zhvillohen hetimet, për t'i zbardhur të gjitha rrethanat e vrasjes" së një personi të afërm.

Parashtruesit e kërkesës pohojnë se *"... me vrasjen e të ndjerit (...) dhe plaçkitjen e shkatërrimin e pasurisë së tij, janë shkelur: e drejta për jetën – neni 2 i Konventës në tërësi, neni 6. par. 1 i Konventës; – e drejta për gjykim të drejtë dhe gjykim brenda një afati të arsyeshëm, neni 13 i Konventës – e drejta për një mjet efektiv juridik dhe Protokolli I – mbrojtja e pronës. Kushtetuta e Kosovës: nenet 3 dhe 24 – barazia para ligjit, neni 25 – e drejta për jetën, neni 31 – gjykimi i drejtë dhe i paanshëm, neni 32 – e drejta për mjet juridik, neni 46 – mbrojtja e pronës, neni 54 – e drejta për mbrojtje gjyqësore".*

Gjykata paraprakisht vëren se fakti kryesor i vrasjes ndodhi më 24 qershor 1999, që do të thotë para se UNMIK-u të kishte marrë përsipër "administrimin e gjyqësorit" dhe padia civile ishte parashtruar në Gjykatën e Ferizajt më 17 shtator 2004, do të thotë shumë kohë para hyrjes në fuqi të Kushtetutës më 15 qershor 2008.

Për më tepër, Gjykata përsërit se vrasja kishte ndodhur më 24 qershor 1999, dhe padia civile ishte parashtruar në Gjykatën Themelore në Ferizaj më 17 shtator 2004.

Prandaj, Gjykata konsideron se faktet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës nuk bien brenda juridiksionit kohor të Gjykatës.

Si përmbledhje kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (3) h) të Rregullores së punës.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (3) h) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 nëntor 2014, njëzëri deklaron kërkesën të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI36/14
Parashtrues
Bojan Đokić, Ljubica Đokić, Zvonko Đokić dhe Đorđe Đokić
Ankesë për mungesë të hetimeve të një vrasjeje dhe të kompensimit për shkatërrimin e pronës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Bojan Đokić, znj. Ljubica Đokić, z. Zvonko Đokić dhe z. Đorđe Đokić, me vendbanim në Republikën e Serbisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës nuk i referohen qartë ndonjë vendimi të veçantë të një autoriteti publik që duhet të kontestohet.

3. Ata ankohen kryesisht përkitazi me dështimin e autoriteteve "*që të zhvillohen hetimet, për t'i zbardhur të gjitha rrethanat e vrasjes*" së një personi të afërm.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kërkesës së parashtruesit në mungesë të hetimit penal për vrasjen e të afërmit të tyre dhe mungesës së kompensimit për shkatërrimin e pronës. Parashtruesit konsiderojnë se të drejtat e tyre ishin shkelur, përkatësisht siç garantohen me nenin 2.6 dhe 13 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe nenin 46 të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa me sa duket bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 27 shkurt 2014, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 6 mars 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 15 prill 2014, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kallëzimit penal dhe kërkoi dokumentacion shtesë lidhur me ankesën që ata kishin paraqitur më 8 tetor 2004 te Prokurori Publik në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

9. Më 12 maj 2014, pas shqyrtimit të raportit paraprak të gjyqtarit raportues Robert Carolan, Kolegji shqyrtues vendosi njëzëri që ta shtyjë shqyrtimin e kërkesës për seancën e radhës. Kolegji shqyrtues në veçanti i rekomandoi gjyqtarit raportues që të komunikojë me parashtruesit e kërkesës dhe palët përgjegjëse me qëllim të plotësimit dhe qartësimit të fakteve të kërkesës.

10. Kështu, më 15 maj 2014, nga parashtruesit e kërkesës ishte kërkuar që ta informojnë Gjykatën për numrin e regjistrimit të kallëzimit penal dhe të bashkëngjisin ndonjë përgjigje nga gjykatat që ata mund t'i kenë.

11. Më 15 maj 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë, duke u kërkuar që ta informojnë "*nëse ka ndonjë procedurë në zhvillim e sipër"* lidhur me kallëzimin penal, dhe nëse ka, në çfarë faze është ajo procedurë.

12. Për më tepër, më 15 maj 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Themelore në Ferizaj, duke kërkuar nga ajo që ta informojë *"nëse ka ndonjë procedurë në zhvillim e sipër"* lidhur

me padinë civile të parashtruesve të kërkesës të 17 shtatorit 2004 dhe, nëse po, në çfarë faze është një procedurë e tillë.

13. Më 24 qershor 2014, Gjykata e përsëriti kërkesën e saj për informata shtesë në Zyrën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën Themelore në Ferizaj.

14. Më 25 qershor 2014, Gjykata këmbënguli me kërkesën ndaj Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe Zyrës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë për informatat shtesë.

15. Gjithashtu, më 25 qershor 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Zyrës së Prokurorisë Speciale në Prishtinë dhe kërkoi informata lidhur me procedurën, nëse ka, përkitazi me kallëzimin penal.

16. Më 30 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës Bojan Đokić plotësoi kërkesën në emër të të gjithë parashtruesve të tjerë.

17. Më 10 korrik 2014, Zyra e Prokurorisë Speciale njoftoi Gjykatën "*që Zyra e Regjistrit në PSRK deri tani nuk ka pranuar asnjë kërkesë lidhur me rastin e sipërpërmendur*".

18. Më 14 korrik 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Prokurorit të Shtetit dhe kërkoi të gjitha informatat në dispozicion lidhur me veprimet eventuale të ndërmarra në lidhje me kallëzimin penal.

19. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues në vend të gjyqtarit Robert Carolan.

20. Më 5 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

21. Më 24 qershor 1999, një i afërm i parashtruesve ishte vrarë në Ferizaj, nga një person ose disa persona të paidentifikuar dhe prona e tij ishte plaçkitur, ndërsa dy shtëpitë dhe objektet ndihmëse ishin djegur.

22. Më 25 korrik 1999, neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1 për autorizimet e administratës së përkohshme në Kosovë përcaktoi se "1. *Gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje*

me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, i vishet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm".

23. Në vitin 2002, kufoma e të ndjerit ishte identifikuar dhe mbetjet e tij mortore ishin marrë nga të afërmit, parashtruesit e tanishëm të kërkesës.
24. Më 17 shtator 2004, parashtruesit parashtruan padi civile kundër Qeverisë së Kosovës, Komunës së Ferizajt, UNMIK-ut dhe KFOR-it, në Gjykatën e atëhershme Komunale në Ferizaj për kompensim të shkatërrimit dhe dëmtimit të pronës së tyre (në tekstin e mëtejmë: padia civile).

25. Parashtruesit e kërkesës deklarojnë se *"Për të gjitha këto detaje është njoftuar Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë, më 8. 10. 2004"*.

26. Më 15 qershor 2008, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi.

27. Si rezultat i kërkesës për informata nga Gjykata, është gjetur se më 19 dhjetor 2011, Gjykata në Ferizaj (Aktgjykimi P. nr. 1403/04) vendosi që të *"hudhet si e pa lejuar padia e palës paditëse për shpërblimin e dëmit (...)"*.

28. Gjykata gjithashtu konstatoi se në lidhje me vrasjen e lartpërmendur nuk ishte filluar asnjë procedurë penale e as nuk ishin në procedurë e sipër në instancat e ndryshme prokuroriale apo gjyqësore.

29. Për më tepër, Gjykata Themelore në Ferizaj informoi se vendimi i Gjykatës në Ferizaj, i 19 dhjetorit 2011 asnjëherë nuk i është komunikuar parashtruesve as nuk ishte publikuar në ndonjë gazetë zyrtare.

Ankesat e parashtruesve

30. Parashtruesit e kërkesës ankohen për dështimin e autoriteteve publike të Kosovës *"të veprojnë sipas kërkesave të shtruara në fletëdenoncimin penal dhe me qëllim që të zhvillohen hetimet, për t'i zbardhur të gjitha rrethanat e vrasjes së të ndjerit (...), sidomos për shkak se nuk janë zbuluar dhe proceduar kryerësit e vrasjes. Ankesa, po ashtu, paraqitet edhe për shkak të shkatërrimit të pasurisë dhe për mosveprim sipas padisë për kompensimin e dëmit"*.

31. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se "*... me vrasjen e të ndjerit (...) dhe plaçkitjen e shkatërrimin e pasurisë së tij, janë shkelur: e drejta për jetën – neni 2 i Konventës në tërësi, neni 6. par. 1 i Konventës; – e drejta për gjykim të drejtë dhe gjykim brenda një afati të arsyeshëm, neni 13 i Konventës – e drejta për një mjet efektiv juridik dhe Protokolli I – mbrojtja e pronës. Kushtetuta e Kosovës: nenet 3 dhe 24 – barazia para ligjit, neni 25 – e drejta për jetën, neni 31 – gjykimi i drejtë dhe i paanshëm, neni 32 – e drejta për mjet juridik, neni 46 – mbrojtja e pronës, neni 54 – e drejta për mbrojtje gjyqësore".*

32. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata:

> *"të gjenden dhe të procedohen vrasësit e të ndjerit (...);*
> *që të zbulohet se kush ua ka plaçkitur pronën dhe në fund e ka djegur atë;*
>
> *që t'u paguhet dëmi material dhe ai jomaterial, shkaktuar me vrasjen e të ndjerit (...) dhe me shkatërrimin e pronës".*

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj dhe në Rregullore të punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

34. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës i përqendrojnë ankesat e tyre kryesisht në dy çështje: veprimet dhe mosveprimet në hetimin e vrasjes së të afërmit të ndjerë (...) dhe kompensimin e dëmeve për plaçkitjen dhe shkatërrimin e pronës.

35. Për më tepër, Gjykata paraprakisht vëren se fakti kryesor i vrasjes ndodhi më 24 qershor 1999, që do të thotë para se UNMIK-u të kishte marrë përsipër "*administrimin e gjyqësorit*" dhe padia civile ishte parashtruar në Gjykatën e Ferizajt më 17 shtator 2004, do të thotë shumë kohë para hyrjes në fuqi të Kushtetutës më 15 qershor 2008.

36. Gjykata konsideron se çështja e parë dhe kryesore që duhet të analizohet është nëse ngjarjet të cilat kanë ndodhur në vitin 1999 bien nën juridiksionin e saj kohor. Ky konsiderim paraprak është relevant me analizimin e ankesave të parashtruesve.

37. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kryesisht pohojnë: (i) shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, (ii) shkelje të nenit 6. 1 dhe 13 të KEDNJ-së dhe (iii) shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me Protokollin I të KEDNJ-së. Shkelja e dytë e pretenduar dhe shkelja e tretë e pretenduar janë logjikisht të ndërvarura. Prandaj, Gjykata do të analizojë pretendimin e parë.

38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) h) të Rregullores, i cili parasheh:

> *"Një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese: ... kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën".*

39. Gjykata, duke identifikuar çështjen kryesore në analizë, gjithashtu rikujton se është e obliguar të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

40. Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) në rastin *Mladenović kundër Serbisë*, Kërkesa nr. 1099/08, Aktgjykimi i 22 majit 2012, në paragrafin 38, thotë si më poshtë:

> *"Në pajtim me rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare (veçanërisht, neni 28 i Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve), Konventa nuk e detyron një palë ndaj ndonjë akti apo fakti që ka ndodhur ose ndonjë situatë cila ka pushuar së ekzistuari para datës së hyrjes në fuqi të traktatit dhe që ka lidhje me atë palë.* (shih *Blečić kundër Kroacisë* [DHM], nr. 59532/00, § 70, GJEDNJ 2006-III). *Megjithatë, është e qartë nga praktika gjyqësore e Gjykatës në lidhje me nenin 2 se obligimi procedural për të hetuar ka evoluar në një detyrë të veçantë dhe autonome, në gjendje që të obligojë shtetin edhe kur vdekja ka ndodhur para ratifikimit (*shih *Šilih kundër Sllovenisë* [DHM], nr. 71463/01, § 159, 9 prill 2009). *Duke pasur parasysh parimin e sigurisë juridike, juridiksioni kohor i Gjykatës në këtë drejtim megjithatë nuk është i pakufishëm (ibid, § 161). Kur vdekja ka ndodhur para ratifikimit, vetëm aktet procedurale ose mosveprimet e kryera pas kësaj date mund të bien brenda juridiksionit kohor të Gjykatës (ibid, § 162). Për më tepër, duhet të ketë një lidhje të vërtetë në mes të vdekjes dhe hyrjes në fuqi të Konventës në lidhje me atë shtet në mënyrë që detyrimi procedural të hyjë në fuqi. Në praktikë, kjo do të thotë se një pjesë e konsiderueshme*

e hapave proceduralë të kërkuar nga kjo dispozitë ka qenë, ose duhet të jetë kryer pas ratifikimit. (Shih *Hackett kundër Mbretërisë së Bashkuar* (dec)., nr. 34698/04, 10 maj 2005)".

41. GJEDNJ gjithashtu konsideronte se *"në rastet që kanë të bëjnë me obligimin për hetim sipas nenit 2 të KEDNJ, në rast se është shkaktuar një vdekje, pritet që të afërmit e ankuesit të ndërmarrin hapa për të ndjekur procesin e hetimeve dhe të dorëzojnë ankesat e tyre në mënyrën e duhur, sapo ata të jenë ndërgjegjësuar apo të duhet të ndërgjegjësohen për mungesën e një hetimi penal efektiv* (Shih, *Bulut dhe Yavuz kundër Turqisë* (vend.), nr. 73065/01, 28 maj 2002; gjithashtu, *Bayram dhe Yildirim kundër Turqisë* (vend.), nr. 38587/97, GJEDNJ 2002 III) dhe *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë* [DHM], nr. 16064/90, 16065/90, 16066/90, 16068/90, 16069/90, 16070/90, 16071/90, 16072/90 dhe 16073/90, § 158, 18 shtator 2009). (Shih Rasti *Mladenović kundër Serbisë,* Kërkesa nr. 1099/08, Aktgjykim, 22 maj 2012, para. 45)".

42. Gjykata thekson se jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese është në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së kur vendos se ngjarjet që kanë ndodhur para se të hynte në fuqi Kushtetuta më 15 qershor 2008 nuk janë në përputhje *ratione temporis* me Kushtetutën dhe kështu nuk bien nën juridiksionin e saj kohor. (Shih, ndër të tjera, aktvendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KI152/11, parashtrues *Bekim Murati*; në rastin nr. KI07/11, parashtrues *Vehbi Klaiqi*; në rastin KI128/11, parashtrues *Ismet Boshnjaku*).

43. Gjykata rikujton se vrasja kishte ndodhur në vitin 1999, parashtruesit e kërkesës kishin marrë mbetjet mortore në vitin 2002 [3 (tri) vjet më vonë], ata pretendojnë se kishin parashtruar një kallëzim penal më 8 tetor 2004 [5 (pesë) vjet më vonë], dhe ata nuk kanë përcjellë zhvillimin procedurave deri në parashtrimin e kërkesës në Gjykatë më 27 shkurt 2014 [10 (dhjetë) vjet më vonë].

44. Për më tepër, Gjykata përsërit se vrasja kishte ndodhur më 24 qershor 1999, dhe padia civile ishte parashtruar në Gjykatën Themelore në Ferizaj më 17 shtator 2004.

45. Prandaj, Gjykata konsideron se faktet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës nuk bien brenda juridiksionit kohor të Gjykatës.

46. Si përmbledhje kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (3) h) të Rregullores së punës.

47. Gjykata, duke konstatuar se ankesat e parashtruesve janë të papranueshme, konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohet veçmas pranueshmëria e ankesave të parashtruesve të kërkesës, të bëra në bazë të neneve 6. 1 dhe 13 të KEDNJ-së, dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

48. Për më tepër, Gjykata konsideron se, duke marr parasysh arsyetimin e konkludimit më lart, dispozitat kushtetuese të referuara nga parashtruesi nuk janë të zbatueshme fare për rastin.

49. Nga sa u tha më lart, Gjykata përfundimisht konkludon se ankesat për shkeljen e pretenduar të nenit 2 të KEDNJ-së nga ana e autoriteteve publike në Kosovë, për shkak të mungesës së hetimeve të një vrasjeje dhe të mungesës së kompensimit për shkatërrimin e pronës, në pajtim me rregullin 36 (3) h) të Rregullores së Punës, nuk janë *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën dhe në këtë mënyrë janë të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (3) h) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 nëntor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI85/14, Gafurr Osmani, Aktvendim i datës 16 shtator 2014- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 269/2013, të 9 dhjetorit 2013.

Rasti KI85/14, vendimi i 16 shtatorit 2014.

Fjalë kyçe: kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës. Ai në veçanti pretendon se "të tri shkallët e gjykatave kanë pasur për obligim ligjor dhe kushtetues të aplikojnë në rastin tim dispozitat ligjore të Ligjit të punës që ka qenë në fuqi para luftës në Kosovë".

Në lidhje me pretendimet e parashtruesit për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka sqaruar si dhe pse kjo e drejtë specifike kushtetuese ishte shkelur me vendimin e kontestuar, që pretendohet se ka vendosur "duke zbatuar dispozitat e ligjeve aktuale dhe jo ligjet që ishin në fuqi në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar".

Si rezultat Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, pasi që parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij dhe nuk ka paraqitur prova mbështetëse për shkeljen e pretenduar kushtetuese nga vendimet e kontestuara.

Rrjedhimisht, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të deklarohet si qartazi e pabazuar.

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, më 16 shtator 2014, njëzëri deklaron kërkesën e papranueshme si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI85/14
Parashtrues
Gafurr Osmani
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 269/2013, të 9 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Gafurr Osmani (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), me vendbanim në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 269/2013, të 9 dhjetorit 2013, i cili i është dorëzuar atij më 22 janar 2014.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e lartcekur i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) sepse: "*tri shkallët e gjykatave kanë pasur për obligim ligjor dhe kushtetues të aplikojnë në rastin tim dispozitat ligjore* të *Ligjit të Punës që ka qenë në fuqi para luftës në Kosovë*".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 maj 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI85/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI85/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Gjithashtu më 10 qershor 2014, Gjykata informoi parashtruesin lidhur me regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje Gjykatës Supreme.

8. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI85/14 caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues në vend të gjyqtarit Robert Carolan.

9. Më 16 shtator 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 8 nëntor 2011, Gjykata Komunale në Suharekë nxori Aktgjykimin (C. nr. 321/06), me të cilin kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës për anulimin e njoftimit për ndërprerjen marrëdhënies së punës ishte refuzuar si e pabazuar.

11. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Suharekë për shkak të shkeljeve substanciale të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale.

12. Më 19 qershor 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë nxori Aktgjykimin (CA. nr. 2910/2012), me të cilin ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte refuzuar si e pabazuar dhe ishte konfirmuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Suharekë.

13. Parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale dhe shkeljes së dispozitave materiale. Parashtruesi i kërkesës theksoi, *inter alia* se *"aktvendimi i shkallës së I-rë dhe i shkallës së II-të janë në kundërshtim me dispozitat materiale në dëm të paditësit e aplikimi i gabuar i të drejtës materiale ka ndikuar që edhe aktgjykimi të jetë i kundërligjshëm, këtë konstatim e bazojë në faktin se paditësi ka pasur kontratë pune të përhershme pra sipas kësaj kontrate, ligjit mbi mardhënjen e punës i viti 1989 dhe ligji i punës të viti 1977 me amendamentet përkatëse, të cilat ligje sipas rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 deri në hyrje në fuqi të ligjit të punës të Republikës së Kosovës nr. 03/L-2012 në muajin dhjetorë të viti 2010 kanë qenë në fuqi, prandaj Gjykata ka qenë e obliguar që mbrojtjen ligjore në këtë qështje ta mbështesë dhe ta bazojë në dispozitat ligjore të ligjeve që kanë qenë në fuqi e jo në bazë te rregulloreve dhe urdhëresave administrative të cilat kanë qenë në kundërshtim me dispozitat e këtyre ligjeve".*

14. Më 9 dhjetor 2013, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin e kontestuar (Rev. nr. 269/2013) dhe e refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

15. Në arsyetimin e aktgjykimit të lartcekur, thuhet, *inter alia*, se "*... aktgjykimi i goditur është marrë me zbatimin e drejtë të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të drejtës materiale, përmban arsye të mjaftueshme për faktet relevante te cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Kjo nga arsyeja se sipas nenit 1 të Rregullores 1999/24 janë përcaktuar ligjet të cilat janë në fuqi në Kosovë. Me nenin 1 nën a) ligje në fuqi në Kosovë, janë përcaktuar edhe Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me ato".*

16. Gjykata Supreme përmend edhe se, "*sipas dispozitës së nenit 6 të Rregullores nr. 2000/11 të datës 03. mars 2000, Për Themelimin Departamentit Administrativ të Arsimit dhe Shkencës, është paraparë se Rregullorja aktuale do të zëvendesoj çdo dispozitë në ligjin aplikativ që nuk është në pajtueshmëri me te, ndërsa instruksioni Administrativ i Departamentit të Arsimit dhe*

Shkencës, DES (I) 4/2000 është prurë në pajtim me këtë Rregullore".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës. Ai në veçanti pretendon se "*të tri shkallët e gjykatave kanë pasur për obligim ligjor dhe kushtetues të aplikojnë në rastin tim dispozitat ligjore të Ligjit të punës që ka qenë në fuqi para luftës në Kosovë*".

18. Më tutje, parashtruesi pretendon: "*Kërkoj anulimin e vendimeve të gjykatave të rregullta për shkak të shkeljeve për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç përcakton neni 31 i Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nëe padi mbrojtje gjyqësore gjegjësisht realizimin e të drejtave të tij, sipas ligjeve që kanë qenë në fuqi në kohën kur organet publike i kanë shkelur të drejtat e tij me vendim për shkëputjen e kontratës së punës. Gjykata pas më shumë së 10 viteve ka vendosur në dëm të kërkuesit duke u mbështetur në dispozitat ligjore të ligjeve aktuale e jo të ligjeve që kanë qenë në kohën kur ka ndodhë shkelja".*

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës i cili parasheh:

> *"Individët janë autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

21. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë*

cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

22. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 36 (2) të Rregullores së punës e cila parasheh:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
(...)
c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.

36 (2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

23. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi ka parashtruar paditë dhe ankesat në të gjitha instancat e gjyqësorit të rregullt dhe kështu ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe është person i autorizuar për të parashtruar kërkesën brenda kuptimit të nenit 113.7 të Kushtetutës.

24. Në lidhje me pretendimet e parashtruesit për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka sqaruar si dhe pse kjo e drejtë specifike kushtetuese ishte shkelur me vendimin e kontestuar, që pretendohet se ka vendosur *"duke zbatuar dispozitat e ligjeve aktuale dhe jo ligjet që ishin në fuqi në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar".*

25. Gjykata vëren se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm përmbledh një numër elementesh, dhe paraqet komponentët kyçe në mbrojtjen e të drejtave themelore individuale nga shkeljet e mundshme të kryera nga gjykatat apo autoritetet publike me vendimet e tyre.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili në mënyrë të qartë përcakton:

> *1. "Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike".*

27. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) gjithashtu përcakton se:

> "*Në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve të tij civile (...), çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.*

28. Në këtë kontekst, parashtruesi nuk sqaron në mënyrë të qartë si dhe pse pretendimi "*zbatimi i dispozitave të ligjeve aktuale*" përbën shkelje kushtetuese të së drejtës themelore për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

29. Për më tepër, citimi i lartpërmendur i vendimit të Gjykatës Supreme tregon se vendimi i kontestuar ka ofruar arsyetim gjithëpërfshirës të fakteve të rastit dhe të gjeturat e tij.

30. Më tutje, pakënaqësia me vendimin, ose thjesht përmendja e neneve ose dispozitave të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme që parashtruesi të ngrejë një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohet për shkelje të Kushtetutës, parashtruesi duhet të sigurojë një argument bindës dhe të arsyetuar mirë në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar (Shih rastin KI186/13, parashtrues *Korporata Energjetike e Kosovës*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2014).

31. Si përmbledhje, parashtruesi nuk ka mbështetur dhe dëshmuar se gjykatat e rregullta, duke vendosur "*në bazë të dispozitave të ligjit aktual*", pretendohet të kenë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.

32. Në fakt, Gjykata nuk shqyrton vendimet e gjykatave të rregullta për çështje të ligjshmërisë, e as nuk shqyrton saktësinë e çështjes së fakteve, përveç nëse ka prova të qarta dhe bindëse se vendimet e tilla janë nxjerrë në një mënyrë qartazi të padrejtë dhe arbitrare.

33. Për më tepër, nuk është detyrë e Gjykatës për të vendosur nëse gjykatat e rregullta kanë shqyrtuar në mënyrë të duhur argumentet e parashtruesve në zgjidhjen e çështjeve ligjore. Kjo mbetet juridiksion vetëm i gjykatave të rregullta. Është roli i këtyre të fundit që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1.

34. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të vlerësojë nëse gjatë procedurave në gjykatat e rregullta, gjykatat mund të kenë shkelur ndonjë të drejtë themelore të garantuar me Kushtetutë.

35. Si rezultat Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, pasi që parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij dhe nuk ka paraqitur prova mbështetëse për shkeljen e pretenduar kushtetuese nga vendimet e kontestuara.

36. Rrjedhimisht, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të deklarohet si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, më 16 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani